

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PRONËSINË INDUSTRIALE

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2023

ISBN: 9789928011527

Adresa

Rruga: “Nikolla Jorga”

Tel/fax: +355 42 427005, 04 2427006

E-mail: info@qbz.gov.al,

Web: www.qbz.gov.al

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

PËRMBAJTJA

Ligj nr.9647, datë 27.11.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Gjenevës të Marrëveshjes së Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale dhe rregulloret mbështetur në Aktin e Gjenevës, 1999	5
Ligj nr. 9648, datë 27.11.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Hagës të Marrëveshjes së Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale, 1960	20
Ligj nr. 10 179, datë 29.10.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Patentave Europiane	29
Ligj nr. 33/2018, datë 7.6.2018	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për disenjot industriale”	139
Ligj nr. 34/2018, datë 7.6.2018	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare”	145
Ligj nr. 9947, datë 7.7.2008	Për pronësinë industriale <i>ndryshuar me ligjet:</i> - nr. 10/2013, datë 14.2.2013; - nr. 55/2014, datë 29.5.2014; - nr. 17/2017, datë 16.2.2017; - nr. 96/2021, datë 7.7.2021.	153
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1707, datë 29.12.2008	Për miratimin e rregullores “Për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit” <i>ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave:</i> - nr.618, datë 7.9.2011; - nr.38, datë 21.1.2015; - nr.460, datë 26.7.2018	245
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 883, datë 13.5.2009	Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale <i>ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave:</i> - nr. 433, datë 16.6.2011; - nr. 37, datë 21.1.2015; - nr. 316, datë 31.5.2018	266
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 9.5.2018	Për përcaktimin e masës dhe të kriterëve për shpërblimin e kryetarit, anëtarëve dhe sekretarit teknik të këshillit mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI)	272
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 270, datë 16.5.2018	Për miratimin e rregullores “Për disenjot industriale”	273
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 31.5.2018	Për miratimin e rregullores “Për markat” <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 543, datë 29.7.2022</i>	293

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 31.5.2018	Për miratimin e rregullores “Për përfaqësuesit e autorizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale” <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 29.6.2022</i>	321
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 501, datë 29.8.2018	Për miratimin e rregullores për ekspertët e objekteve të pronësisë industriale <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 13.7.2022</i>	325
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 752, datë 19.12.2018	Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 24.3.2023</i>	328
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 251, datë 24.4.2019	Për miratimin e rregullores për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës	330
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 457, datë 3.7.2019	Për miratimin e procedurave për pjesëmarrje në Qendrën e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale, si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse dhe masën e shpërblimit të lektorëve <i>Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 18.5.2022</i>	344
Ligj nr. 8488, datë 13.5.1999	Për mbrojtjen e topografisë së produkteve gjysmëpërçuese <i>ndryshuar me ligjet:</i> <i>- nr. 9957, datë 17.7.2008;</i> <i>- nr. 66/2014, datë 26.6.2014</i>	346

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

LIGJ
Nr.9647, datë 27.11.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AKTIN E GJENEVËS TË MARRËVESHJES SË HAGËS PËR REGJISTRIMIN NDËRKOMBËTAR TË PROJEKTEVE INDUSTRIALE DHE RREGULLORET MBËSHTETUR NË AKTIN E GJENEVËS, 1999¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në aktin e Gjenevës të Marrëveshjes së Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale dhe rregulloret mbështetur në aktin e Gjenevës, 1999.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5151, datë 12.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

AKTI **I GJENEVËS I MARRËVESHJES SË HAGËS PËR REGJISTRIMIN NDËRKOMBËTAR TË PROJEKTEVE INDUSTRIALE DHE RREGULLORET MBËSHTETUR NË AKTIN E GJENEVËS**

2 korrik 1999

DISPOZITA HYRËSE

Neni 1

Shprehje të shkurtuara

Për qëllimet e këtij Akti:

- i) “Marrëveshja e Hagës” nënkupton Marrëveshjen e Hagës për depozitimin ndërkombëtar të projekteve industriale, që, në këtë Akt, rrimërtotet Marrëveshja e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale”;
- ii) “Akt” do të thotë Marrëveshja e Hagës, sikurse është përcaktuar nga ky Akt;
- iii) “Rregulla” nënkupton rregullat e vendosura në mbështetje të këtij Akti;
- iv) “E parashikuat” nënkupton rregullat e përcaktuara në rregullore;
- v) “Konventa e Parisit” nënkupton konventën e Parisit “Për mbrojtjen e pronësisë industriale”, të nënshkruar në Paris, më 20 mars 1883, të rishikuar dhe të ndryshuar;
- vi) “Regjistrim ndërkombëtar” do të thotë regjistrimi ndërkombëtar i një projekti industrial, i bërë në mbështetje të këtij Akti;
- vii) “Aplikim ndërkombëtar” do të thotë një kërkesë për regjistrim ndërkombëtar;
- viii) “Regjistër ndërkombëtar” do të thotë grumbullimi zyrtar i të dhënave për regjistrimet ndërkombëtare, të mbajtura nga byroja ndërkombëtare, të cilat kërkohej ose lejohen të regjistrohen në mbështetje të këtij Akti apo të rregulloreve, pavarësisht nga mjedisi ku ruhen këto të dhëna;

¹ Qendra 3e Botimeve Zyrtare. Fletore Zyrtare nr. 136. Tiranë 2006. f. 5339

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- ix) "Person" nënkupton një person fizik ose juridik;
- x) "Aplikant" nënkupton personin, në emër të të cilit paraqitet një aplikim ndërkombëtar;
- xi) "Zotërues" nënkupton personin, në emër të të cilit një aplikim ndërkombëtar regjistrohet në regjistrin ndërkombëtar;
- xii) "Organizatë ndërqeveritare" nënkupton një organizatë ndërqeveritare, të përshtatshme për t'u bërë palë në këtë Akt, në përputhje me nenin 27(1) (ii);
- xiii) "Palë kontraktuese" nënkupton çdo organizatë, shtetërore a ndërqeveritare, palë në këtë Akt;
- xiv) "Palë kontraktuese e aplikantit" nënkupton palën kontraktuese ose njërën nga palët kontraktuese, të cilat autorizojnë aplikantin të paraqesë një aplikim ndërkombëtar, duke përmblusur, në emër të palës kontraktuese, së paku njërën nga kushtet e specifikuar në nenin 3; në rast se ka dy ose më shumë palë kontraktuese, të cilat i japin të drejtën aplikantit, në bazë të nenin 3, që të paraqesë një aplikim ndërkombëtar. "Palë kontraktuese e aplikantit" nënkupton palën, ndërmjet këtyre palëve kontraktuese, të përcaktuara si të tilla në aplikimin ndërkombëtar;
- xv) "Territori i një pale kontraktuese" nënkupton, kur pala kontraktuese është një shtet, territorin e atij shteti dhe, kur pala kontraktuese është një organizatë ndërqeveritare, territorin ku zbatohet traktati kushtetues i asaj organizate ndërqeveritare;
- xvi) "Zyrë" nënkupton agjencinë, që pala kontraktuese i ka dhënë të drejtën të mbrojë projektet industriale, në interes të territorit të kësaj pale kontraktuese;
- xvii) "Zyra e shqyrtimit" nënkupton një zyrë, e cila shqyrton, në përputhje me statusin e saj, aplikimet e paraqitura pranë saj, për mbrojtjen e projekteve industriale, me qëllim që të përcaktojë së paku nëse projektet industriale përmblusin kushtin e risisë;
- xviii) "Caktim" do të thotë një kërkesë, që një regjistrim ndërkombëtar të ketë efekt ndaj një pale kontraktuese, si regjistrimi në regjistrin ndërkombëtar të kësaj kërkesë;
- xix) "Palë kontraktuese e caktuar" dhe "Zyrë e caktuar" nënkuptojnë, respektivisht, palën kontraktuese dhe zyrën e palës kontraktuese, ku kryhet procesi i caktimit;
- xx) "Akt i 1934-s" nënkupton aktin e Marrëveshjes së Hagës, të nënshkruar në Londër, më 2 qershor 1934;
- xxi) "Akt i 1960-s" nënkupton aktin e Marrëveshjes së Hagës, të nënshkruar në Hagë, më 28 nëntor 1960;
- xxii) "Akt shtesë, i vitit 1961" nënkupton shtesën e aktit të vitit 1934, të nënshkruar në Monako, më 18 nëntor 1961;
- xxiii) "Akt plotësues, i vitit 1967" nënkupton aktin plotësues, të ndryshuar, të Marrëveshjes së Hagës, nënshkruar në Stokholm, më 14 korrik 1967;
- xxiv) "Union" nënkupton Unionin e Hagës, krijuar nga Marrëveshja e Hagës, më 6 nëntor të vitit 1925 dhe të mbështetur nga aktet e viteve 1934 e 1960, si dhe nga akti shtesë i vitit 1961, akti plotësues i vitit 1967, dhe nga ky Akt;
- xxv) "Asamble" nënkupton asamblenë, së cilës i referohet neni 21(1) (a) ose çdo organ që zëvendëson këtë asamble;
- xxvi) "Organizatë" nënkupton Organizatën Botërore të Pronësisë Intelktuale;
- xxvii) "Drejtor i përgjithshëm" nënkupton drejtorin e përgjithshëm të organizatës;
- xxviii) "Byro ndërkombëtare" nënkupton byronë ndërkombëtare të organizatës;
- xxix) "Instrument ratifikimi" përfshin instrumentet e pranimit ose të miratimit.

Neni 2

Zbatueshmëria e mbrojtjes së tjetrit, dhënë nga ligjet e palëve kontraktuese dhe nga traktatet përkatëse ndërkombëtare

1. Ligjet e palëve kontraktuese dhe disa traktate ndërkombëtare

Dispozitat e këtij Akti nuk duhet të ndikojnë në zbatimin e çfarëdo lloji mbrojtjeje tjetër, më të madhe, e cila mund të garantohet nga ligji i një pale kontraktuese, si dhe, në asnjë mënyrë, në mbrojtjen e veprave të artit e të artit të aplikuar, në mbështetje të traktateve dhe të konventave ndërkombëtare për të drejtat e autorit ose në mbrojtjen e projekteve industriale, në mbështetje të Marrëveshjes për çështjet e të drejtave mbi pronësinë intelektuale, që kanë të bëjnë me tregtinë, aneks i marrëveshjes së krijimit të Organizatës Botërore të Tregtisë.

2. Detyrimi për respektimin e Konventës së Parisit

Çdo palë kontraktuese duhet të respektojë për projektet industriale dispozitat e Konventës së Parisit.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KAPITULLI I APLIKIMI DHE REGJISTRIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 3

E drejta për të paraqitur një aplikim ndërkombëtar

Çdo person, shtetas i një shteti, që është palë kontraktuese ose i një shteti, anëtar i një organizate ndërqeveritare, që është palë kontraktuese apo që ka vendbanimin, rezidencën e përhershme, a një shoqëri tregtare ose industriale, efektive, në territorin e një pale kontraktuese, ka të drejtë të paraqesë një aplikim ndërkombëtar.

Neni 4

Procedura e paraqitjes së një aplikimi ndërkombëtar

1. Paraqitja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e aplikimit
 - a) Aplikimi ndërkombëtar mund të paraqitet, sipas zgjedhjes së aplikantit, në mënyrë të drejtpërdrejtë në byronë ndërkombëtare ose nëpërmjet zyrës së palës kontraktuese të aplikantit.
 - b) Pavarësisht nga përcaktimi në shkronjën “a” të kësaj pike, çdo palë kontraktuese mund ta njoftojë drejtorin e përgjithshëm, me anë të një deklarate, se aplikimet ndërkombëtare nuk do të paraqiten përmes zyrës së tij.
2. Taksa e transmetimit në rast të një paraqitjeje të tërthortë të aplikimit
Zyra e çdo pale kontraktuese mund të kërkojë që aplikanti të paguajë taksën e transmetimit për çdo aplikim ndërkombëtar, të paraqitur në interes të aplikantit përmes saj.

Neni 5

Elementet që përmban aplikimi ndërkombëtar

- 1) Elementet e detyrueshme, që përmban aplikimi ndërkombëtar
Aplikimi ndërkombëtar duhet të jetë në gjuhën e përcaktuar ose në njërën nga gjuhët e përcaktuara dhe duhet të shoqërohet me:
 - i) një kërkesë për regjistrim ndërkombëtar, në përputhje me këtë Akt;
 - ii) të dhënat e përcaktuara për aplikantin;
 - iii) numrin e parashikuar të kopjeve të një riprodhimi ose, sipas dëshirës së aplikantit, të disa riprodhimeve të ndryshme të projektit industrial, objekt i aplikimit ndërkombëtar. Kur projekti industrial është dydimensional dhe kur është paraqitur një kërkesë për shtyrjen e afatit të publikimit, në përputhje me pikën 5 të këtij neni, në vend të riprodhimeve, aplikimi ndërkombëtar mund të shoqërohet me një numër të përcaktuar modelesh të projektit industrial;
 - iv) një tregues të produktit/produkteve, që përbëjnë projektin industrial a mbi të cilat do të përdoret projekti industrial, në bazë të parashikimeve;
 - v) një përcaktim të palëve kontraktuese, të caktuara;
 - vi) tarifat e parashikuara;
 - vii) çdo element tjetër të veçantë, të parashikuar.
- 2) Elementet suplementare të detyrueshme, që duhet të përmbajë aplikimi ndërkombëtar
 - a) Çdo palë kontraktuese, zyra e së cilës është zyrë shqyrtuese dhe ligji në fuqi, në kohën kur ajo bëhet palë e këtij akti, kërkon që aplikimi për sigurimin e mbrojtjes së një projekti industrial të përmbajë të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjën “b”, të kësaj pike, duhet të njoftojë, me anë të një deklarate, drejtorin e përgjithshëm për këto elemente, me qëllim që të përcaktohet, sipas ligjit, data e paraqitjes së aplikimit.
 - b) Elementet që duhet të përmbajë aplikimi për sigurimin e mbrojtjes së një projekti industrial:
 - i) Të dhëna për identitetin e hartuesit të projektit industrial, objekt i aplikimit;
 - ii) Një përshkrim të shkurtër të riprodhimit ose të karakteristikave dalluese të projektit industrial, objekt i aplikimit;
 - iii) Një kërkesë.
 - c) Kur në aplikimin ndërkombëtar është përcaktuar pala kontraktuese, e cila ka bërë njoftimin, në përputhje me shkronjën “a” të kësaj pike, shënohet edhe çdo element tjetër, objekt i këtij njoftimi.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Elemente të tjera, që mund të përmbajë aplikimi ndërkombëtar

Aplikimi ndërkombëtar mund të përmbajë ose të shoqërohet edhe me elemente të tjera, të cilat përcaktohen në rregullore.

4. Përfshirja e disa projekteve industriale në të njëjtin aplikim ndërkombëtar

Në përputhje me kushtet e parashikuara, një aplikim ndërkombëtar mund të përfshijë dy ose më shumë projekte industriale.

5) Kërkesa për shtyrjen e publikimit

Aplikimi ndërkombëtar mund të përmbajë një kërkesë për shtyrjen e publikimit.

Neni 6

Përparësia

1) Kërkesa për përparësi

a) Aplikimi ndërkombëtar mund të përmbajë një deklaratë, me anë të së cilës kërkohet në përputhje me nenin 4 të Konventës së Parisit, dhënien e përparësisë njëres ose më shumë aplikimeve të mëparshme, të paraqitura në çdo vend apo për çdo vend, palë në konventë a për çdo anëtar të Organizatës Botërore të Tregtisë.

b) Rregulloret mund të parashikojnë që deklaratat e përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike mund të bëhet edhe pas paraqitjes së aplikimit ndërkombëtar. Në këtë rast, rregulloret duhet të parashikojnë afatin e fundit, kur mund të bëhet deklarata.

2. Aplikimi ndërkombëtar, që shërben si bazë e kërkesës për përparësi

Aplikimi ndërkombëtar duhet të paraqitet në mënyrë të rregullt, duke filluar nga data e paraqitjes së tij dhe më pas të procedohet, në përputhje me nenin 4 të Konventës së Parisit.

Neni 7

Taksat e caktimit

1) Taksat e caktimit

Këto taksa përfshijnë, sipas pikës 2 të këtij neni, një taksë caktimi për secilën palë kontraktuese të caktuar.

2) Taksa individuale e caktimit

Çdo palë kontraktuese, zyra e së cilës është zyrtë shqyrtuese dhe çdo palë kontraktuese, që është një organizatë ndërqeveritare, mund ta njoftojnë drejtorin e përgjithshëm, me anë të një deklarate, se, për çdo aplikim ndërkombëtar, ku janë caktuar dhe për çdo regjistrim ndërkombëtar të rinovuar, taksa e caktimit, sipas pikës 1 të këtij neni, do të zëvendësohet me një taksë individuale caktimi, shuma e së cilës përcaktohet në deklaratë. Kjo shumë mund të ndryshohet me deklarata të tjera. Shuma e sipërpërmendur mund të përcaktohet nga pala kontraktuese gjatë periudhës fillestare të mbrojtjes, për çdo periudhë rinovimi, si dhe për periudhën maksimale të mbrojtjes së lejuar nga kjo palë kontraktuese. Megjithatë, kjo shumë mund të mos jetë më e madhe se shuma, që zyra e palës kontraktuese do të marrë nga aplikanti për dhënien e së drejtës së mbrojtjes për një numër të njëjtë projektsh industriale, gjatë së njëjtës periudhë, ku kjo shumë ulet me shkurtimin e procedurave ndërkombëtare.

3. Transferimi i taksave të caktimit

Taksat e caktimit, të cilat përmenden në pikat 1 e 2 të këtij neni, transferohen nga byroja ndërkombëtare te pala kontraktuese, për të cilën paguhet këto taksa.

Neni 8

Korrigjimi i parregullsive

1) Shqyrtimi i aplikimit ndërkombëtar

Nëse byroja ndërkombëtare zbulon se aplikimi ndërkombëtar nuk i përmbush kërkesat e këtij Akti dhe të rregulloreve, të nxjerra në zbatim të tij, ajo fton aplikantin të bëjë korrigjimet e nevojshme, brenda një afati të caktuar.

2) Parregullsitë e pakorrigjuara

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

a) Nëse aplikanti nuk i përgjigjet ftesës, brenda afatit të caktuar, aplikimi ndërkombëtar, objekt i shkronjës “b” të kësaj pike, do të vlerësohet si aplikim nga i cili është hequr dorë.

b) Nëse aplikanti, në rastin e një parregullsie, të parashikuar në nenin 5(2), ose të një kërkesë të posaçme, për të cilën drejtori i përgjithshëm është vënë në dijeni nga pala kontraktuese, në përputhje me rregulloret, nuk i përgjigjet ftesës brenda afatit të caktuar, nuk do të jetë e nevojshme që aplikimi ndërkombëtar të përmbajë caktimin e asaj pale kontraktuese.

Neni 9

Data e paraqitjes së aplikimit ndërkombëtar

1. Aplikimi ndërkombëtar i paraqitur në mënyrë të drejtpërdrejtë

Kur aplikimi ndërkombëtar paraqitet drejtpërdrejt në byronë ndërkombëtare, data e paraqitjes, objekt i pikës 3 të këtij neni, do të jetë data e marrjes së aplikimit ndërkombëtar nga kjo byro.

2. Aplikimi ndërkombëtar i paraqitur në mënyrë të tërthortë

Kur aplikimi ndërkombëtar paraqitet përmes zyrës së palës kontraktuese të aplikantit, data e paraqitjes do të përcaktohet sipas parashikimit.

3. Aplikimi ndërkombëtar me disa parregullsi

Kur në aplikimin ndërkombëtar, në datën e marrjes nga byroja ndërkombëtare, vërehet një parregullsi, korrigjimi i së cilës kërkon kohë, gjë që shkakton shtyrjen e datës së paraqitjes së këtij aplikimi, si datë e paraqitjes do të jetë data kur byroja ndërkombëtare do të bëjë korrigjimin e parregullsisë.

Neni 10¹

Regjistrimi ndërkombëtar data e regjistrimit ndërkombëtar, botimi i kopjeve konfidenciale të regjistrimit ndërkombëtar

1. Regjistrimi ndërkombëtar

Byroja ndërkombëtare është e detyruar të regjistrojë çdo projekt industrial, objekt i një aplikimi ndërkombëtar, menjëherë pas marrjes së tij ose, kur është e nevojshme të bëhen korrigjime, në bazë të nenit 9 më sipër, menjëherë pasi të jenë bërë korrigjimet e kërkuara. Regjistrimi do të hyjë në fuqi edhe nëse shtyhet ose jo publikimi, në përputhje me nenin 11 të këtij Akti.

2. Data e regjistrimit ndërkombëtar

a) Data e regjistrimit ndërkombëtar, objekt i shkronjës “b”, do të jetë data e paraqitjes së aplikimit ndërkombëtar.

b) Kur në aplikimin ndërkombëtar, në datën e marrjes nga byroja ndërkombëtare, vërehet parregullsi, siç përcaktohet në nenin 5(2), si datë regjistrimi ndërkombëtar do të jetë data kur byroja ndërkombëtare merr korrigjimet e kërkuara ose data e paraqitjes së aplikimit ndërkombëtar, cilado qoftë ajo.

3. Publikimi

a) Regjistrimi ndërkombëtar publikohet nga byroja ndërkombëtare dhe duhet të vlerësohet, nga të gjitha palët kontraktuese, si një publikim i mjaftueshëm dhe zotëruesi nuk ka pse të kërkojë më një publikim tjetër.

b) Byroja ndërkombëtare i dërgon çdo zyrë të caktuar një kopje të publikimit të regjistrimit ndërkombëtar.

4. Ruajtja e konfidencialitetit përpara publikimit

Byroja ndërkombëtare, sipas pikës 5 të këtij neni dhe të nenit 11(4)(b), duhet të mbajë sekret çdo aplikim ndërkombëtar dhe çdo regjistrim ndërkombëtar deri në publikimin e tyre.

5. Kopjet konfidenciale

a) Byroja ndërkombëtare dërgon, menjëherë pas hyrjes në fuqi të regjistrimit, një kopje të aplikimin ndërkombëtar, së bashku me deklaratën përkatëse, dokumentin ose modelin që shoqëron atë në zyrat e caktuara në aplikimin ndërkombëtar, të cilat e kanë njoftuar se pranojnë të marrin kopje të tilla.

b) Zyra ruan sekretin për çdo regjistrim ndërkombëtar deri sa ai të publikohet dhe mund ta përdorë kopjen e aplikimit ndërkombëtar vetëm për të shqyrtuar regjistrimin ndërkombëtar, si dhe për aplikimet për mbrojtjen e projekteve industriale, të cilat janë paraqitur nga/për palën kontraktuese, për të cilën kjo zyrë është kompetente. Ajo nuk duhet t’ia zbulojë përmbajtjen e regjistrimit ndërkombëtar asnjë personi jashtë zyrës,

¹ Konferenca diplomatike, kur e miratoi, e dinte se neni 10 nuk e pengonte aksesin ndaj aplikimit ndërkombëtar apo regjistrimin ndërkombëtar nga aplikanti, zotëruesi ose personi, që ka marrë pëlqimin e aplikantit a të zotëruesit.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

përveç zotëruesit të këtij regjistrimi, me përjashtim të rastit kur, për ndonjë procedurë, administrative a ligjore, që ka të bëjë me konfliktin e së drejtës së paraqitjes së aplikimit ndërkombëtar ku mbështetet regjistrimi ndërkombëtar. Në rastin e një procedure të tillë, administrative a ligjore, përmbajtja e regjistrimit ndërkombëtar mund t'u zbulohet në mirëbesim palëve të përfshira në proces, të cilat janë të detyruara të respektojnë konfidencialitetin e këtij zbulimi.

Neni 11

Shtyrja e publikimit

1. Të drejtat e palëve kontraktuese për shtyrjen e publikimit

a) Kur e drejta e një pale kontraktuese parashikon shtyrjen e publikimit të një projekti industrial për një periudhë më të shkurtër se periudha e parashikuar, kjo palë kontraktuese njofton, me një deklaratë, drejtorin e përgjithshëm për periudhën e lejueshme të shtyrjes.

b) Kur e drejta e një pale kontraktuese nuk parashikon shtyrjen e publikimit të një projekti industrial, pala kontraktuese njofton për këtë fakt, me një deklaratë, drejtorin e përgjithshëm.

2. Shtyrja e publikimit

Kur aplikimi ndërkombëtar përmban një kërkesë për shtyrjen e publikimit, publikimi bëhet:

i) pas mbarimit të periudhës së përcaktuar, nëse asnjëra nga palët kontraktuese, e caktuar në aplikimin ndërkombëtar, nuk ka bërë deklaratë, sipas pikës 1 të këtij neni;

ii) pas mbarimit të periudhës së përcaktuar, nëse njëra nga palët kontraktuese e caktuar në aplikimin ndërkombëtar, ka bërë një deklaratë, sipas pikës 1/a;

iii) pas mbarimit të periudhës më të shkurtër të përcaktuar në deklaratë, nëse ka më shumë se një palë kontraktuese të caktuar në aplikimin ndërkombëtar.

3. Trajtimi i kërkesave për shtyrje, kur shtyrja është e pamundur, në bazë të ligjit të zbatuar

Kur kërkohet shtyrja e publikimit dhe kur njëra nga palët kontraktuese, e caktuar në aplikimin ndërkombëtar, ka bërë një deklaratë sipas pikës 1/b dhe shtyrja e publikimit, në bazë të ligjit, nuk është e mundur:

i) byroja ndërkombëtare, sipas nënndarjes "ii", njofton aplikantin. Nëse aplikanti, pasi e ka marrë njoftimin me shkrim nga byroja ndërkombëtare, nuk tërheq brenda periudhës së caktuar, caktimin e palës kontraktuese në fjalë, atëherë byroja ndërkombëtare nuk merr parasysh kërkesën për shtyrje të publikimit;

ii) kur aplikimi ndërkombëtar nuk përmban riprodhime të projektit industrial, por shoqërohet nga modele të këtij projekti, byroja ndërkombëtare nuk merr në konsideratë caktimin e palës kontraktuese në fjalë dhe, si rrjedhojë, njofton menjëherë aplikantin.

4. Kërkesa për publikim të parakohshëm ose për akses të veçantë në regjistrimin ndërkombëtar

a) Në çdo kohë, gjatë periudhës së shtyrjes sipas pikës 2, zotëruesi mund të kërkojë publikimin e njërit ose të gjitha projekteve industriale, subjekt i regjistrimit ndërkombëtar, dhe, në këtë rast, periudha e shtyrjes së njërit ose e të gjitha projekteve industriale mbaron në datën kur merret një kërkesë për publikim të parakohshëm ose për akses të veçantë në regjistrimin ndërkombëtar nga byroja ndërkombëtare.

b) Zotëruesi mund, që në çdo kohë, gjatë periudhës së shtyrjes së zbatueshme, sipas pikës 2, t'i kërkojë byrosë ndërkombëtare ta pajisë palën e tretë, të përcaktuar nga zotëruesi, me një formular të përmbledhur ose t'i lejojë kësaj pale akses ndaj njëres ose ndaj të gjitha projekteve industriale, subjekt i regjistrimit ndërkombëtar.

5. Heqja dorë dhe kufizimi

a) Nëse gjatë periudhës së shtyrjes, të zbatueshme në bazë të pikës 2, zotëruesi, në emër të të gjitha palëve kontraktuese të caktuara, heq dorë nga regjistrimi ndërkombëtar, projekti a projektet industriale, subjekt a subjekte të regjistrimit ndërkombëtar, nuk do të publikohen.

b) Nëse gjatë periudhës së shtyrjes, të zbatueshme në bazë të pikës 2, zotëruesi, në emër të të gjitha palëve kontraktuese të caktuara, kufizon regjistrimin ndërkombëtar, të një ose disa projekteve industriale, subjekt i regjistrimit ndërkombëtar, projekti a projektet e tjera industriale, subjekt i këtij regjistrimi, nuk do të publikohen.

6. Publikimi dhe paraqitja e riprodhimeve

a) Me mbarimin e çdo periudhe shtyrjeje, të zbatueshme në bazë të dispozitave të këtij neni, byroja ndërkombëtare, objekt i pagesës së taksave të përcaktuara, publikon regjistrimin ndërkombëtar. Nëse taksat nuk paguhen sikurse janë përcaktuar, regjistrimi ndërkombëtar anulohet dhe publikimi nuk bëhet.

b) Kur aplikimi ndërkombëtar shoqërohet nga një ose më shumë modele të projektit industrial, në përputhje me nenin 5(1) (iii), zotëruesi duhet t'i paraqesë byrosë ndërkombëtare numrin e përcaktuar të kopjeve

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

të riprodhimit të secilit projekt industrial, objekt i këtij aplikimi, brenda afatit të caktuar. Nëse zotëruesi nuk vepron në këtë mënyrë, regjistrimi ndërkombëtar anulohet dhe publikimi nuk bëhet.

Neni 12 Refuzimi

1. E drejta për të refuzuar

Zyra e çdo pale kontraktuese të caktuar mund t'i refuzojë, pjesërisht ose tërësisht, efektet e regjistrimit ndërkombëtar në territorin e palës kontraktuese në fjalë, kur kushtet për dhënien e së drejtës për mbrojtje, në mbështetje të së drejtës së palës kontraktuese, nuk përmbushen për një ose për të gjitha projektet industriale. Asnjë zyrë nuk mund të refuzojë, pjesërisht ose tërësisht, efektet e një regjistrimi ndërkombëtar, për faktin se kërkesat për formën ose përmbajtjen e aplikimit ndërkombëtar nuk janë përmbushur sipas së drejtës së palës kontraktuese në fjalë.

2. Njoftimi për refuzim

a) Zyra duhet ta njoftojë byronë ndërkombëtare për refuzimin e një regjistrimi ndërkombëtar brenda periudhës së përcaktuar.

b) Në çdo njoftim për refuzim duhet të përcaktohen të gjitha arsyet, mbi të cilat mbështetet njoftimi i refuzimit.

3. Transmetimi i njoftimit të refuzimit; zhdëmtimet

a) Byroja ndërkombëtare duhet t'ia kalojë pa vonesë zotëruesit një kopje të njoftimit të refuzimit.

b) Për zotëruesin zbatohen masa të njëjta zhdëmtuese, si në rastin e çdo projekti industrial, subjekt i regjistrimit ndërkombëtar, dhe të një aplikimi për dhënien e mbrojtjes, në bazë të së drejtës së zyrës, që komunikon refuzimin. Zhdëmtime të tilla kanë të bëjnë, së paku, me mundësinë e një rishqyrtimi të refuzimit ose të një apelimi ndaj refuzimit.

4.2 Tërheqja e refuzimit

Çdo refuzim mund të tërhiqet, pjesërisht ose tërësisht, në çdo kohë nga zyra që e komunikon atë.¹

Neni 13 Kërkesa të veçanta për një projekt të unifikuar

1. Njoftimi i kërkesave të veçanta

Çdo palë kontraktuese, në mbështetje të legjislacioni të brendshëm, kur bëhet palë e këtij Akti, kërkon që projektet, objekt i të njëjtit aplikim, të jenë në përputhje me një kërkesë për një projekt, një prodhim apo një përdorim të unifikuar, ose që i përkasin të njëjtit grup a së njëjtës përbërje artikujsh, apo kur vetëm një projekt i pavarur dhe i qartë mund të kërkohet në një aplikim të vetëm, mund të njoftojë, me anë të një deklaratë, drejtorin e përgjithshëm. Megjithatë, asnjë deklaratë e tillë nuk do të ndikonte ndaj së drejtës së një aplikanti për të përfshirë dy a më shumë projekte industriale në një aplikim ndërkombëtar, në përputhje me nenin 5(4), edhe nëse në aplikim është përcaktuar pala kontraktuese, që bën deklaratën.

2. Efekti i deklaratës

Çdo deklaratë e tillë duhet të bëjë të mundur që zyra e palës kontraktuese, e cila e ka bërë këtë deklaratë, t'i refuzojë efektet e regjistrimit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 12(1) dhe sipas kërkesës së njoftuar nga pala kontraktuese.

3. Taksat e tjera, të pagueshme për shpërndarjen e regjistrimit

Kur pas njoftimit të refuzimit, sipas pikës 2 të këtij neni, një regjistrim ndërkombëtar shpërndahet në zyrën e interesuar, me qëllim që të shmanget arsyeja e refuzimit, e shprehur në njoftim, zyrës i lind e drejta të vendosë një taksë për çdo aplikim ndërkombëtar suplementar, të nevojshme për të shmangur këtë arsye refuzimi.

¹ Kur konferenca diplomatike miratoi nenet 12 (4) e 14 (2) (b), si dhe rregullin 18 (4), kuptoi se tërheqja e refuzimit nga një zyrë, e cila ka komunikuar njoftimin e refuzimit, mund të marrë formën e një deklaratë, nëse zyra e interesuar ka vendosur të pranojë pasojat e regjistrimit ndërkombëtar për njërin apo disa nga projektet industriale, për të cilat është bërë njoftimi i refuzimit. Gjithashtu, konferenca kuptoi se një zyrë mund të dërgojë, brenda periudhës së lejuar për komunikimin e njoftimit të refuzimit, një deklaratë, ku të theksohet se ajo ka vendosur t'i pranojë pasojat e regjistrimit ndërkombëtar edhe kur nuk ka komunikuar një njoftim të tillë refuzimi.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 14

Pasojat e regjistrimit ndërkombëtar

1. Pasojat e aplikimit sipas ligjit të zbatueshëm

Regjistrimi ndërkombëtar, nga data e regjistrimit, do të ketë ndaj çdo pale kontraktuese efekt të njëjtë si në rastin e një aplikimi të rregullt, për të siguruar të drejtën e mbrojtjes së projektit industrial, në bazë të ligjit të palës kontraktuese.

2. Efekti i dhënies të së drejtës së mbrojtjes sipas ligjit të zbatueshëm

a) Për çdo palë kontraktuese të caktuar, zyra e së cilës nuk ka komunikuar asnjë refuzim në përputhje me nenin 12, regjistrimi ndërkombëtar do të ketë efekt të njëjtë me garantimin e së drejtës së mbrojtjes së projektit industrial, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të palës kontraktuese, maksimumi nga data e mbarimit të afatit të lejueshëm për komunikimin e refuzimit. Kur një palë kontraktuese ka bërë një deklaratë të njëjtë, në përputhje me rregulloren, afati maksimal do të jetë koha e përcaktuar në deklaratë.

b) Kur zyra e palës kontraktuese të caktuar ka komunikuar një refuzim dhe më pas e ka tërhequr, pjesërisht ose tërësisht, regjistrimi ndërkombëtar do të ketë ndaj kësaj pale kontraktuese, sipas shkallës së tërheqjes së refuzimit, të njëjtën fuqi me dhënien e së drejtës së mbrojtjes së projektit industrial, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të palës kontraktuese, maksimumi nga data e tërheqjes së refuzimit.

c) Fuqia, që ky paragraf i jep regjistrimit ndërkombëtar, duhet të zbatohet për një ose për të gjitha projektet industriale, subjekt i regjistrimit, dërguar byrosë ndërkombëtare nga zyra e caktuar.

3. Deklarata për efektin e caktimit të palës kontraktuese të aplikantit

a) Çdo palë kontraktuese, zyra e së cilës është një zyrë shqyrtuese, mund ta njoftojë, me anë të një deklarate, drejtorin e përgjithshëm, se, në rastin e palës kontraktuese të aplikantit, nuk do të ketë efekt caktimi i kësaj pale kontraktuese në një regjistrim ndërkombëtar.

b) Kur një palë kontraktuese, e cila ka bërë deklaratën e përmendur në shkronjën “a”, caktohet në një aplikim ndërkombëtar si palë kontraktuese e aplikantit dhe palë kontraktuese e caktuar, byroja ndërkombëtare nuk e merr parasysh caktimin e kësaj pale kontraktuese.

Neni 15

Shfuqizimi

1. Kërkesa për mundësinë e mbrojtjes

Shfuqizimi, i pjesshëm a tërësor, i efekteve të regjistrimit ndërkombëtar të një pale kontraktuese të caktuar nga autoritetet kompetente në territorin e kësaj pale mund të mos gjejë zbatim pa i ofruar zotëruesit mundësinë e mbrojtjes së të drejtave të tij në kohën e duhur.

2. Njoftimi i shfuqizimit

Zyra e palës kontraktuese, në territorin e së cilës janë shfuqizuar efektet e regjistrimit ndërkombëtar, duhet ta njoftojë byronë ndërkombëtare, kur ka dijeni për shfuqizimin.

Neni 16

Regjistrimi i ndryshimeve dhe çështje të tjera, që lidhen me regjistrimin ndërkombëtar

1. Regjistrimi i ndryshimeve dhe çështje të tjera

Byroja ndërkombëtare, sikurse është përcaktuar, duhet të regjistrojë në regjistrin ndërkombëtar:

i) çdo ndryshim lidhur me pronësinë e regjistrimit ndërkombëtar, në rastin e të gjitha palëve kontraktuese të përfaqësuara dhe të gjitha projekteve industriale, objekt i regjistrimit ndërkombëtar, me kusht që pronarit të ri t'i jepet e drejta të paraqesë një aplikim ndërkombëtar, sipas nenit 3;

ii) çdo ndryshim të emrit ose të adresës së zotëruesit;

iii) përfaqësuesin e aplikantit ose të zotëruesit, si dhe çdo fakt tjetër, që lidhet me një përfaqësim të tillë;

iv) çdo heqje dorë të zotëruesit nga regjistrimi ndërkombëtar, në rastin e një ose të të gjitha palëve kontraktuese të caktuara;

v) çdo kufizim të regjistrimit ndërkombëtar nga zotëruesi, në rastin e një ose të të gjitha palëve kontraktuese të caktuara, të një ose disa projekteve industriale, objekt i regjistrimit ndërkombëtar;

vi) çdo shfuqizim të efekteve të regjistrimit ndërkombëtar nga autoritetet kompetente të një pale kontraktuese të caktuar, në territorin e kësaj pale, në rastin e një ose të të gjitha projekteve industriale, objekt i regjistrimit ndërkombëtar;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

vii. çdo fakt tjetër përkatës, të identifikuar në rregullore, për të drejtat për një ose të gjitha projektet industriale, objekt i regjistrimit ndërkombëtar.

2. Efekti i regjistrimit në regjistrin ndërkombëtar

Çdo regjistrim, i përmendur në nënndarjet (i), (ii), (iv), (v), (vi) dhe (vii) të pikës 1 të këtij neni, do të ketë të njëjtin efekt me regjistrimet e bëra në regjistrin e zyrës së secilës palë kontraktuese, me përjashtim të rastit kur një palë kontraktuese ka njoftuar, me anë të një deklarate, drejtorin e përgjithshëm, se një regjistrim i përmendur në nënndarjen (i) të pikës 1 të këtij neni, nuk do të ketë atë efekt ndaj kësaj pale kontraktuese deri sa zyra e palës kontraktuese të ketë marrë deklaratën dhe dokumentet e përcaktuara në deklaratë.

3. Taksat

Çdo regjistrim i bërë në përputhje me pikën 1 të këtij neni, mund të jetë objekt i pagesës së një takse.

4. Publikimi

Byroja ndërkombëtare duhet të botojë një njoftim për çdo regjistrim të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dhe një kopje të këtij botimi duhet t'ua dërgojë zyrave të secilës palë kontraktuese të interesuar.

Neni 17

Afati fillestar, rinovimi i regjistrimit ndërkombëtar dhe kohëzgjatja e mbrojtjes

1. Afati fillestar i regjistrimit ndërkombëtar

Regjistrimi ndërkombëtar do të jetë në fuqi për një afat fillestar prej pesë vjetësh, të llogaritur nga data e regjistrimit ndërkombëtar.

2. Rinovimi i regjistrimit ndërkombëtar

Regjistrimi ndërkombëtar mund të rinovohet për një periudhë tjetër pesëvjeçare, në përputhje me procedurën e parashikuar dhe pasi të jetë paguar taksa e parashikuar.

3. Kohëzgjatja e mbrojtjes së palëve kontraktuese të caktuara

a) Nëse regjistrimi ndërkombëtar rinovohet sipas shkronjës "b" të kësaj pike, kohëzgjatja e mbrojtjes së secilës palë kontraktuese të caktuar do të jetë 15 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit ndërkombëtar.

b) Kur legjislacioni i brendshëm i një pale kontraktuese të caktuar parashikon kohëzgjatjen e mbrojtjes për më shumë se 15 vjet, si p.sh. në rastin e një projekti industrial, për të cilin mbrojtja është dhënë sipas këtij ligji, kohëzgjatja e mbrojtjes, kur rinovohet regjistrimi ndërkombëtar, do të jetë e njëjtë me atë të parashikuar në legjislacionin e brendshëm të palës kontraktuese.

c) Secila palë kontraktuese duhet të njoftojë me shkrim drejtorin e përgjithshëm për kohëzgjatjen maksimale të mbrojtjes së parashikuar nga legjislacioni i brendshëm.

4. Mundësia e rinovimit të kufizuar

Rinovimi i regjistrimit ndërkombëtar mund të ketë efekt për njërën ose të gjitha palët kontraktuese të caktuara dhe për njërën ose të gjitha projektet industriale, objekte të regjistrimit ndërkombëtar.

5. Regjistrimi dhe publikimi i rinovimit

Byroja ndërkombëtare i regjistron rinovimet në regjistrin ndërkombëtar dhe, në këtë rast, boton njoftimin përkatës, një kopje të së cilit ia dërgon zyrave të secilës palë kontraktuese të interesuar.

Neni 18

Informacion për regjistrimet ndërkombëtare të botuara

1. Aksesimi ndaj informacionit

Byroja ndërkombëtare duhet të sigurojë, për çdo person që aplikon, pas pagesës së taksës së caktuar, pjesë nga regjistri ndërkombëtar ose informacion për përmbajtjen e tij, për çdo regjistrim ndërkombëtar të botuar.

2. Përjashtimi nga legalizimi

Pjesët e marra nga regjistri ndërkombëtar, të siguruar nga byroja ndërkombëtare, përjashtohen nga çdo kërkesë për legalizim në secilën palë kontraktuese.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KAPITULLI II DISPOZITA ADMINISTRATIVE

Neni 19

Zyra e përbashkët e disa shteteve

1. Njoftimi i zyrës së përbashkët

Nëse disa shtete, të cilat synojnë të bëhen palë e këtij Akti, kanë kërkuar ose nëse disa shtete, palë të këtij Akti, bien dakord që të kërkojnë unifikimin e legjislacionit të tyre të brendshëm për projektet industriale, ato duhet të njoftojnë drejtorin e përgjithshëm se:

- i) një zyrë e përbashkët do të zëvendësojë zyrën kombëtare të secilës prej tyre;
- ii) të gjitha territoret e tyre respektive, ku gjen zbatim legjislacioni i unifikuar duhet të jenë një palë kontraktuese e vetme, me qëllim që të zbatohen nenet 1, 3 deri në 18 dhe 31 të këtij Akti.

2. Koha kur duhet të bëhet njoftimi

Njoftimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, duhet të bëhet:

- i) në rastin e shteteve, që synojnë të bëhen palë e këtij Akti, në kohën e depozitimit të instrumenteve, të përcaktuara në nenin 27 (2);
- ii) në rastin e shteteve palë të këtij Akti, në kohën kur hyn në fuqi bashkimi i legjislacionit të tyre të brendshëm.

3. Data e hyrjes në fuqi e njoftimit

Njoftimi, i përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, hyn në fuqi:

- i) në rastin e shteteve, që synojnë të bëhen palë e këtij Akti, në kohën kur këto shtete bëhen pjesë e këtij Akti;
- ii) në rastin e shteteve palë të këtij Akti, tre muaj pas datës kur drejtori i përgjithshëm u ka komunikuar palëve kontraktuese të tjera ose në një datë të mëvonshme, të përcaktuar në njoftim.

Neni 20

Anëtarësimi në Unionin e Hagës

Palët kontraktuese do të jenë anëtare të të njëjtit Union me shtetet palë të aktit të vitit 1934 ose të aktit të vitit 1960.

Neni 21

Asambleja

1. Përbërja

a) Palët kontraktuese duhet të jenë anëtare të së njëjtës asamble me shtetet palë të nenit 2 të aktit plotësues të vitit 1967.

b) Çdo anëtar i asamblesë përfaqësohet në asamble nga një përfaqësues, i cili mund të asistohet nga përfaqësues, këshilltarë dhe ekspertë dhe çdonjëri prej tyre mund të përfaqësojë vetëm një palë kontraktuese.

c) Anëtarët e Unionit, të cilët nuk janë anëtarë të asamblesë, pranohen në mbledhjet e saj si vëzhgues.

2. Detyrat

a) Asambleja:

- i) merret me të gjitha çështjet për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Unionit dhe zbatimin e këtij Akti;
- ii) ushtron të drejtat dhe kryen detyrat që i janë caktuar në bazë të këtij Akti dhe të aktit plotësues të vitit 1967;
- iii) udhëzon drejtorin e përgjithshëm për përgatitjet për konferencat e revizionimit dhe vendos për mbledhjen e çdo konference të tillë;
- iv) ndryshon rregulloret;
- v) shqyrton e miraton raportet dhe veprimtaritë e drejtorit të përgjithshëm në lidhje me Unionin dhe i jep atij të gjitha udhëzimet e nevojshme për çështje, që janë në kompetencë të Unionit;
- vi) përcakton programin dhe miraton buxhetin dyvjeçar të Unionit, si dhe miraton shpenzimet financiare të këtij Unioni;
- vii) miraton rregulloret financiare të Unionit;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

viii) krijon komitete dhe grupe pune, të cilat i vlerëson të domosdoshme e të përshtatshme për arritjen e objektivave të Unionit;

ix) përcakton në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 21 të këtij Akti, shtete, organizata, ndërqeveritare dhe joqeveritare, që do t'i pranojë në mbledhjet e saj si vëzhgues;

x) ndërmerr çdo veprim tjetër të përshtatshëm për të realizuar objektivat e Unionit dhe kryen të gjitha funksionet e tjera, në bazë të këtij Akti.

b) Për çështje që u interesojnë unioneve të tjera, të administruara nga organizatat, asambleja do t'i marrë vendimet pasi të ketë dëgjuar këshillin e komitetit koordinues të organizatës.

3. Kuorumi

a) Gjysma e anëtarëve të asamblesë, të cilat janë shtete dhe kanë të drejtë të votojnë për një çështje të caktuar, përbëjnë numrin e nevojshëm për të marrë vendim për një çështje përmes votimit.

b) Pavarësisht nga dispozitat e shkronjës “a” të kësaj pike, asambleja mund të marrë vendime edhe nëse, në një seancë votimi, numri i anëtarëve të pranishëm të saj, që janë shtete e që kanë të drejtë të votojnë për një problem të caktuar, është më i vogël se gjysma, por sa ose më shumë se një e treta e anëtarëve të asamblesë, të cilat janë shtete dhe kanë të drejtë të votojnë për këtë çështje, me përjashtim të vendimeve që kanë të bëjnë me procedurën e kësaj asambleje. Në këtë rast vendimet do të hyjnë në fuqi vetëm nëse përmbushen kushtet e parashtruara në këtë akt. Byroja ndërkombëtare do t'ua komunikojë këto vendime shteteve anëtare të asamblesë, që kanë të drejtën e votës për çështjen në fjalë, por që nuk ishin të pranishëm, duke u kërkuar atyre, që, brenda një periudhe tremujore nga data e komunikimit të shprehin me shkrim votën ose abstenimin. Pas skadimit të kësaj periudhe, nëse numri i këtyre anëtarëve, të cilët e kanë shprehur pozitivisht votën e tyre ose kanë abstenuar, është sa numri i anëtarëve, i nevojshëm për të arritur kuorumin në seancë, vendimet do të hyjnë në fuqi, me qëllim që, në të njëjtën kohë të përftohet shumica e kërkuar.

4. Marrja e vendimeve në asamble

a) Asambleja duhet të përpiqet t'i marrë vendimet me konsensus.

b) Kur një vendim nuk mund të arrihet me konsensus, çështja në fjalë do të vendoset me anë të votës. Kur ndodh që të vendoset me anë të votës:

i) çdo palë kontraktuese, që është një shtet, ka një votë dhe do të votojë vetëm në emër të saj;

ii) çdo palë kontraktuese, që është një organizatë ndërqeveritare, mund të votojë në vend të shteteve anëtare të saj, me një numër të barabartë votash me numrin e shteteve anëtare, palë të këtij Akti, dhe asnjë organizatë e tillë nuk do të marrë pjesë në votim, nëse njëra nga shtetet anëtare të saj e ushtron të drejtën e votës dhe e kundërta.

c) Për çështje, që kanë të bëjnë vetëm me shtetet, që parashikohen në nenin 2 të aktit plotësues të vitit 1967, palët kontraktuese, të cilat nuk parashikohen në nenin e sipërpërmendur, nuk kanë të drejtën e votës, ndërsa për çështje, që kanë lidhje vetëm me palët kontraktuese, kanë të drejtën e votës vetëm këto të fundit.

5. Shumica

a) Sipas pikave 2 të neneve 24 e 26, vendimet e asamblesë merren vetëm me dy të tretat e votave.

b) Abstenimet nuk vlerësohen si vota.

6. Sesionet

a) Asambleja mbledhet një herë në çdo vit të dytë kalendarik, në sesione të zakonshme, me thirrjen e drejtorit të përgjithshëm dhe, në raste të zakonshme, mund të mbledhet në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtin vend me Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës.

b) Asambleja mbledhet, në seanca të jashtëzakonshme, me nismën e drejtorit të përgjithshëm ose me kërkesën e një të katërtës së anëtarëve të saj.

c) Axhenda e çdo seance përgatitet nga drejtori i përgjithshëm.

7. Rregullat procedurale

Asambleja miraton rregullat e veta procedurale.

Neni 22

Byroja ndërkombëtare

1. Detyrat administrative

a) Regjistrimi ndërkombëtar dhe detyrat që lidhen me të, si dhe të gjitha detyrat e tjera administrative, në lidhje me Unionin, kryhen nga byroja ndërkombëtare.

b) Byroja ndërkombëtare përgatit kryesisht mbledhjet dhe ngre sekretariatin e asamblesë, të komiteteve të

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

ekspertëve dhe të grupeve të punës, që mund të krijohen nga asambleja.

2. Drejtori i përgjithshëm

Drejtori i përgjithshëm është kryetari ekzekutiv i Unionit, si dhe përfaqësuesi i këtij Unioni në çdo veprimtari.

3. Mbledhjet jashtë seancave të asamblesë

Drejtori i përgjithshëm ka detyrë të mbledhë çdo komitet dhe grup pune, të ngritur nga asambleja dhe drejton të gjitha mbledhjet e tjera, që kanë të bëjnë me problemet e Unionit.

4. Roli i byrosë ndërkombëtare në asamble dhe mbledhje të tjera

a) Drejtori i përgjithshëm dhe personat e caktuar nga ai, marrin pjesë pa të drejtë vote në të gjitha mbledhjet e asamblesë, të komiteteve dhe të grupeve të punës, të krijuara nga asambleja dhe në çdo mbledhje tjetër, të thirrur nga drejtori i përgjithshëm, për problemet e Unionit.

b) Drejtori i përgjithshëm ose një anëtar i stafit, i caktuar nga ai, do të jetë *ex officio* sekretar i asamblesë, i komiteteve, i grupeve të punës dhe i mbledhjeve të tjera, të cilat përmenden në shkronjën “a” të kësaj pike.

5. Konferencat

a) Byroja ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimet e asamblesë, bën përgatitjet për çdo konferencë revizionuese.

b) Byroja ndërkombëtare mund të këshillohet me organizata ndërqeveritare dhe joqeveritare, ndërkombëtare dhe kombëtare, për këto përgatitje.

c) Drejtori i përgjithshëm dhe personat e caktuar nga ai, marrin pjesë pa të drejtë vote, në diskutime në konferencat e revizionimit.

6. Detyra të tjera

Byroja ndërkombëtare kryen edhe çdo detyrë tjetër, që i është caktuar lidhur me këtë Akt.

Neni 23

Financat

1. Buxheti

a) Unioni ka buxhetin e vet.

b) Buxheti përfshin të ardhurat dhe shpenzimet e Unionit, si dhe kontributin e tij për buxhetin e shpenzimeve të zakonshme të unioneve, të administruara nga organizata.

c) Shpenzimet, të cilat nuk kanë të bëjnë ekskluzivisht vetëm me Unionin, por me një ose më shumë unione të tjera, të administruara nga organizata, do të vlerësohen si shpenzime të zakonshme të tyre. Kontributi për shpenzime të tilla të zakonshme përcaktohet në bazë të interesave të vetë Unionit.

2. Bashkërendimi i buxhetit me buxhetet e unioneve të tjera

Buxheti i Unionit do të përcaktohet, duke pasur parasysh kërkesat e bashkërendimit me buxhetet e unioneve të tjera, të administruara nga organizata.

3. Burimet e financimit të buxhetit

Buxheti i Unionit financohet nga burimet e mëposhtme:

a) Taksat për regjistrimet ndërkombëtare;

b) Pagesat për shërbimet e Unionit për byronë ndërkombëtare;

c) Shitjet ose shumat e paguara për botimet e byrosë ndërkombëtare për Unionin;

ç) Dhuratat, trashëgimitë dhe donacionet;

d) Qiratë, interesat dhe të ardhura të tjera, të ndryshme.

4. Caktimi i taksave dhe i pagesave; niveli i buxhetit

a) Niveli i taksave, që përmenden në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni, caktohet nga asambleja, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm, ndërsa pagesat, që përmenden në shkronjën “b” të pikës 3 të këtij neni, caktohen nga drejtori i përgjithshëm dhe do të zbatohen përkohësisht deri në miratimin e asamblesë, në sesionin e saj të ardhshëm.

b) Niveli i taksave, të cilat përmenden në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni, do të caktohet në mënyrë të tillë, që të ardhurat e Unionit, nga taksat dhe burimet e tjera, të jenë të mjaftueshme për të mbuluar, së paku, shpenzimet që do të bëjë byroja ndërkombëtare për Unionin.

c) Nëse buxheti nuk miratohet përpara fillimit të periudhës së re financiare, ai do të qëndrojë në të njëjtin nivel me buxhetin e vitit të mëparshëm, siç parashikohet në rregulloret financiare.

5. Fondi kapital i punës

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Unioni është i detyruar të krijojë një fond kapital pune, i cili përbëhet nga pagesa e akcizave dhe, nëse nuk ka të tilla, nga një pagesë e vetme, e bërë nga çdo anëtar i Unionit. Nëse fondi është i pamjaftueshëm, asambleja vendos ta rrisë atë. Niveli dhe afatet e pagesës përcaktohen nga asambleja, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm.

6. Paradhënia nga shteti mikpritës

a) Në rastin kur një marrëveshje arrihet në territorin e shtetit, ku ka selinë qendrore organizata dhe fondi kapital i punës është i pamjaftueshëm, në këtë rast është parashikuar që shteti në fjalë t'i japë paradhënie, shuma dhe kushtet e së cilës përcaktohen, në çdo rast, me një marrëveshje të veçantë, ndërmjet shtetit në fjalë dhe organizatës.

b) Shteti, i përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike dhe organizata ka secila të drejtë të denoncojë me shkrim detyrimin për të dhënë paradhënie. Njoftimi hyn në fuqi tre vjet pas fundit të vitit, në të cilin ajo është njoftuar.

7. Auditimi i llogarive

Auditimi i llogarive kryhet nga një ose më shumë shtete anëtare të Unionit apo nga auditë të jashtëm, sikurse parashikohet në rregulloret financiare. Ata caktohen nga asambleja, me pëlqimin e tyre.

Neni 24

Rregulloret

1. Objekti

Rregulloret përmbajnë hollësi për zbatimin e këtij Akti dhe, në mënyrë të veçantë, përfshijnë dispozitat për:

- a) çështjet, që parashikon shprehimisht ky Akt;
- b) hollësi të mëtejshme ose çdo hollësi në dobi të zbatimit të dispozitave të këtij Akti;
- c) çdo kërkesë, çështje a procedurë administrative.

2. Ndryshimi i dispozitave të rregulloreve

Rregulloret mund të përcaktojnë se dispozitat e tyre mund të ndryshojnë vetëm me unanimitet ose vetëm me katër të pestat e shumicës, dhe:

a) Unanimiteti kërkohet me qëllim që kërkesa për unanimitet apo për katër të pestat e shumicës të mos zbatohet më, në të ardhmen, për ndryshimin e një dispozite të rregulloreve.

b) Katër të pestat e shumicës kërkohet me qëllim që kërkesa e unanimitetit apo me katër të pestat e shumicës të zbatohet në të ardhmen për ndryshimin e një dispozite të rregulloreve.

3. Konflikti ndërmjet këtij Akti dhe rregulloreve

Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të këtij Akti dhe dispozitave të rregulloreve do të mbizotërojë e para.

KAPITULLI III

RISHIKIMI DHE NDRYSHIMI

Neni 25

Rishikimi i këtij Akti

1. Konferencat për rishikimin

Ky Akt mund të rishihet në një konferencë të palëve kontraktuese.

2. Rishikimi ose ndryshimi i disa neneve

Enet 21, 22, 23 e 26 mund të ndryshohen nga një konferencë rishikimi ose nga asambleja, sipas dispozitave të nenit 26.

Neni 26

Ndryshimi i disa neneve nga asambleja

1. Propozimet për ndryshime

a) Propozimet për ndryshimet nga asambleja të neneve 21, 22, 23 e 26 të këtij Akti, mund të paraqiten nga çdo palë kontraktuese ose nga drejtori i përgjithshëm.

b) Propozimet për këto ndryshime u komunikohen palëve kontraktuese nga drejtori i përgjithshëm, të paktën gjashtë muaj para se të shqyrtohen nga asambleja.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Shumica

Miratimi i ndryshimeve të neneve, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, bëhet me tre të katërtat e shumicës, me përjashtim të ndryshimit të nenit 21 ose të kësaj pike, për të cilat nevojiten katër të pestat e shumicës.

3. Hyrja në fuqi

a) Me përjashtim të rasteve ku zbatohet përcaktimi i bërë në shkronjën “b”, çdo ndryshim i neneve, të përcaktuara në pikën 1, hyn në fuqi një muaj pasi drejtori i përgjithshëm ka marrë njoftimin me shkrim, në përputhje me proceset kushtetuese respektive, për pranimin nga tre të katërtat e palëve kontraktuese, të cilat, në kohën e miratimit të ndryshimit, kanë qenë anëtare të asamblesë dhe kishin të drejtën e votës për këtë ndryshim.

b) Çdo ndryshim i pikave 3 ose 4 të nenit 21 të këtij Akti ose ndryshimi i kësaj shkronje nuk do të hyjë në fuqi, nëse, brenda gjashtë muajve nga miratimi i tij nga asambleja, njëra nga palët kontraktuese njofton drejtorin e përgjithshëm se nuk e pranon këtë ndryshim.

c) Çdo ndryshim, që hyn në fuqi në përputhje me dispozitat e kësaj pike do të respektohet nga të gjitha shtetet dhe organizatat ndërqeveritare, të cilat janë palë kontraktuese në kohën, që hyn në fuqi ndryshimi ose që bëhen palë kontraktuese në një datë të mëvonshme.

KAPITULLI IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Bërja palë e këtij Akti

1. Përfshirja si palë

Në mbështetje të pikave 2 e 3 të nenit 28 të këtij Akti:

- i) çdo shtet, anëtar i organizatës, mund ta nënshkruajë këtë Akt dhe të bëhet palë e tij;
- ii) çdo organizatë ndërqeveritare, e cila ka një zyrë, ku mund të realizohet mbrojtja e projekteve industriale, në territorin ku zbatohet traktati kushtetues i organizatës ndërqeveritare, mund ta nënshkruajë këtë Akt dhe të bëhet palë e tij, me kusht që, së paku, njëra nga shtetet anëtare të organizatës ndërqeveritare të jetë anëtare e saj dhe që një zyrë e tillë të mos jetë objekt i një njoftimi, sipas nenit 19 të këtij Akti.

2. Ratifikimi ose aderimi

Çdo organizatë shtetërore ose ndërqeveritare, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të depozitojë:

- i) një instrument ratifikimi, nëse e ka nënshkruar këtë Akt;
- ii) një instrument aderimi, nëse e ka nënshkruar këtë Akt.

3. Data efektive e depozitimit

a) Në bazë të shkronjave “a”, “b” e “c” deri te shkronja “d” të kësaj pike, data efektive e depozimit të një instrumenti ratifikimi ose aderimi do të jetë data e depozitimit të këtij instrumenti.

b) Data e efektshme e depozitimit të një instrumenti ratifikimi ose aderimi të çdo shteti, për të cilin mbrojtja e projekteve industriale mund të fitohet vetëm përmes zyrës së një organizate ndërqeveritare, anëtare e së cilës është ai shtet, do të jetë data kur do të depozitohet instrumenti i kësaj organizate ndërqeveritare, nëse kjo datë është e mëvonshme se data kur është depozituar instrumenti i shtetit në fjalë.

c) Data e efektshme e depozitimit të çdo instrumenti ratifikimi ose aderimi, që përmban ose shoqërohet me njoftim, në përputhje me nenin 19 të këtij akti, do të jetë data e depozitimit të instrumentit të fundit të shteteve anëtare të grupit të shteteve, që e kanë bërë njoftimin.

d) Çdo instrument ratifikimi ose aderimi i një shteti, që përmban ose shoqërohet me një deklaratë, do të vlerësohet i depozituar, me kusht që instrumenti i një shteti tjetër a i një organizate ndërqeveritare, apo instrumentet e dy shteteve të tjera a të një shteti tjetër dhe të një organizate ndërqeveritare, të përcaktuara me emër e që kanë të drejtën të jenë palë e këtij Akti, të jenë, gjithashtu, të depozituara. Instrumenti, që përmban ose shoqërohet me një deklaratë, vlerësohet i depozituar ditën kur plotësohet kushti i përcaktuar në deklaratë. Megjithatë, kur një instrument i përcaktuar në deklaratë përmban ose shoqërohet me një deklaratë të këtij lloji, ai vlerësohet i depozituar ditën kur plotësohet kushti i përcaktuar në deklaratën e fundit.

dh) Çdo deklaratë e bërë në përputhje me përcaktimet në shkronjën “d” mund të tërhiqet, tërësisht ose pjesërisht, në çdo kohë. Çdo tërheqje sa më sipër është e efektshme ditën, kur drejtori i përgjithshëm merr njoftimin e tërheqjes.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 28

Data e efektshme e ratifikimeve dhe e aderimeve

1. Instrumentet që merren parasysht

Për qëllime të këtij neni shqyrtohen vetëm ato instrumente ratifikimi ose aderimi, të cilat janë depozituar nga shtetet ose organizatat ndërqeveritare që përcaktohen në pikën 1 të nenit 27 të këtij Akti dhe që datën e efektshme e kanë në përputhje me pikën 3 të nenit 27.

2. Hyrja në fuqi e këtij Akti

Ky Akt hyn në fuqi tre muaj pasi të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të aderimit gjashtë shtete, me kusht që tre prej tyre të përmbushin, së paku, njërën nga kushtet e mëposhtme:

i) të kenë të regjistruar, në shtetin ose për shtetin e interesuar, për mbrojtjen e projekteve industriale të paktën 3 000 aplikantë;

ii) të jenë të regjistruar, në shtetin ose për shtetin e interesuar, për mbrojtjen e projekteve industriale, të paktën 1 000 aplikantë, pjesa më e madhe të jenë banorë të shteteve të tjera dhe jo të atij shteti.

3. Hyrja në fuqi e ratifikimeve dhe e aderimeve

a) Çdo shtet a organizatë ndërqeveritare, që i ka depozituar instrumentet e ratifikimit a të aderimit tre muaj ose edhe më shumë përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij Akti, do të jetë pjesë e tij në datën e hyrjes në fuqi të këtij Akti.

b) Çdo shtet tjetër apo organizatë ndërqeveritare do të jetë pjesë e këtij Akti tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit a të aderimit ose në një datë tjetër të mëvonshme, të përcaktuar në atë instrument.

Neni 29

Ndalimi i rezervimeve

Te ky Akt nuk lejohet asnjë rezervim.

Neni 30

Deklaratat e palëve kontraktuese

1. Koha kur mund të bëhen deklaratat

Çdo deklaratë, në mbështetje të neneve 4(1)(b), 5(2)(a), 7(2), 11(1), 13(1), 14(3), 16(2) dhe 17 (3), mund të bëhet:

i) në kohën e depozitimit të instrumentit, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 27 të këtij Akti, ku në këtë rast, do të bëhet efektive në datën kur shteti a organizata ndërqeveritare, që ka bërë deklaratën, do të bëhet pjesë e Aktit;

ii) pas depozitimit të një instrumenti, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 27 të këtij Akti dhe, në këtë rast, do të bëhet efektive tre muaj pas datës së marrjes së saj nga drejtori i përgjithshëm ose në një datë të mëvonshme të përcaktuar në deklaratë. Por do të zbatohet vetëm për një regjistrim ndërkombëtar, data e të cilit është e njëjtë a e mëvonshme me datën efektive të deklaratës.

2. Deklaratat nga shtetet me një zyrë të përbashkët

Pavarësisht nga sa u përcaktua në pikën më sipër, çdo deklaratë, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni e bërë nga një shtet, i cili, së bashku me një shtet tjetër ose me shtete të tjera, ka njoftuar drejtorin e përgjithshëm, në përputhje me pikën 1 të nenit 19 të këtij Akti, për zëvendësimin e zyrës së përbashkët me zyrat e tyre kombëtare, do të bëhet efektive vetëm nëse shteti tjetër ose shtetet e tjera bëjnë edhe ata një deklaratë a deklarata të njëjta.

3. Tërheqja e deklaratave

Çdo deklaratë, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të tërhiqet në çdo kohë pas një njoftimi te drejtori i përgjithshëm. Tërheqja në këtë rast hyn në fuqi tre muaj pas datës së njoftimit të drejtorit të përgjithshëm ose në një datë tjetër të mëvonshme, të përcaktuar në njoftim. Në rastin e një deklarate të bërë sipas pikës 2 të nenit 7, tërheqja nuk do të ndikonte mbi aplikimet ndërkombëtare, të paraqitura përpara hyrjes në fuqi të kësaj tërheqjeje.

Neni 31

Zbatueshmëria e akteve të vitit 1934 dhe atij të vitit 1960

1. Marrëdhëniet ndërmjet shteteve palë të këtij Akti dhe të akteve të vitit 1934 dhe 1960

Ky Akt do të zbatohet vetëm në marrëdhëniet dypalëshe të shteteve palë të këtij Akti dhe të akteve të vitit

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

1934 dhe 1960. Megjithatë, këto shtete mund të zbatojnë në marrëdhëniet e tyre dypalëshe aktin e vitit 1934 ose atë të vitit 1960, në rastin e projekteve industriale, të depozituara në byronë ndërkombëtare, përpara datës kur ky Akt do të bëhet i zbatueshëm në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella.

2. Marrëdhëniet ndërmjet shteteve palë si të këtij Akti, edhe të akteve të vitit 1934 dhe të 1960-s dhe shteteve palë të aktit të vitit 1934 ose atij të vitit 1960, të cilët nuk janë palë të këtij Akti

a) Çdo shtet, i cili është palë e këtij Akti dhe i aktit të vitit 1934, do të vazhdojë të zbatojë aktin e vitit 1934, në marrëdhëniet e tij me shtetet palë të aktit të vitit 1934, pa qenë palë e aktit të vitit 1960 ose e këtij Akti;

b) Çdo shtet palë i këtij Akti, por edhe i aktit të vitit 1960, do të vazhdojë të zbatojë aktin e vitit 1960, në marrëdhëniet e tij me shtetet palë të aktit të vitit 1960, pa qenë palë e këtij Akti.

Neni 32

Denoncimi i aktit

1. Njoftimi

Çdo palë kontraktuese mund ta denoncojë këtë Akt me anë të një njoftimi drejtuar drejtorit të përgjithshëm.

2. Data e efektshme

Denoncimi hyn në fuqi një vit pas datës në të cilën drejtori i përgjithshëm ka marrë njoftimin ose në një datë të mëvonshme, të përcaktuar në njoftim. Denoncimi në këtë rast nuk ndikon në zbatimin e këtij Akti për çdo aplikim të ardhshëm ndërkombëtar apo në çdo regjistrim ndërkombëtar në fuqi.

Neni 33

Gjuhët e aktit dhe nënshkrimi

1. Tekstet origjinale; tekstet zyrtare

a) Ky akt do të nënshkruhet në një origjinal të vetëm, në gjuhët: anglisht, arabisht, kineze, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht, të gjitha tekstet do të kenë vlerë të barabartë.

b) Tekstet zyrtare do të përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas këshillimeve me qeveritë e interesuara, në gjuhën që do të përcaktojë asambleja.

2. Afati i nënshkrimit

Ky Akt do të mbetet i hapur për nënshkrim në selinë qendrore të organizatës deri në një vit pas miratimit të tij.

Neni 34

Depozitari

Drejtori i përgjithshëm është depozitari i këtij Akti.

LIGJ

Nr.9648, datë 27.11.2006

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AKTIN E HAGËS TË MARRËVESHJES SË HAGËS PËR REGJISTRIMIN NDËRKOMBËTAR TË PROJEKTEVE INDUSTRIALE, 1960¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në aktin e Hagës të Marrëveshjes së Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale, 1960.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr. 136. Tiranë, 2006. f. 5355

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5152, datë 12.12.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

II.AKTI I HAGËS, 28 NËNTOR 1960

TABELA E LËNDËS

- Neni 1: Krijimi i një unioni
- Neni 2: Përkufizime
- Neni 3: E drejta për të bërë depozitime ndërkombëtare
- Neni 4: Depozitimi pranë te byroja ndërkombëtare ose nëpërmjet zyrave kombëtare
- Neni 5: Forma e depozitimit; Përbajtja e kërkesës
- Neni 6: Regjistri i disenjove ndërkombëtare; data e regjistrimit; publikimi; shtyrja e publikimit; hyrja i publikut ndaj arkiva
- Neni 7: Efektet ligjore të depozitave të regjistruara
- Neni 8: Refuzimi i efekteve ligjore nga zyrat kombëtare; mjetet ligjore të mbrojtjes kundër të refuzimeve; kërkesat e mundshme shtesë që duhet të përmbushen në zyrat kombëtare
- Neni 9: E drejta e prioritetit
- Neni 10: Rinovimi i depozitimit
- Neni 11: Kohëzgjatja e mbrojtjes
- Neni 12: Ndryshime në pronësi
- Neni 13: Heqja dorë nga depozita
- Neni 14: Dallimi; njoftimi i disenjës ndërkombëtare
- Neni 15: Tarifat
- Neni 16: Tarifat që u takojnë shteteve kontraktuese
- Neni 17: Rregulloret
- Neni 18: Zbatueshmëria e mbrojtjes së siguruar nga ligjet e brendshme dhe nga marrëveshjet e së drejtës së autorit
- Neni 19: (shfuqizuar)
- Neni 20: (shfuqizuar)
- Neni 21: (shfuqizuar)
- Neni 22: (shfuqizuar)
- Neni 23: Nënshkrimi; ratifikimi
- Neni 24: Aderimi
- Neni 25: Zbatimi i marrëveshjes në bazë të ligjit të brendshëm
- Neni 26: Hyrja në fuqi
- Neni 27: Territoret
- Neni 28: Denoncimi
- Neni 29: Rishikimi
- Neni 30: Grupet rajonale
- Neni 31: Zbatueshmëria e akteve të viteve 1925 ose 1934
- Neni 32: Protokoli i bashkëlidhur
- Neni 33: Nënshkrimi; kopjet e vërtetuara

Protokoll: Zbatimi i mundshëm i aktit të vitit 1960 nga një shtet kontraktues për depozitat ndërkombëtare, me origjinë nga ai shtet.

Neni 1

1. Shtetet kontraktuese përbëjnë një union të veçantë për depozitimin ndërkombëtar të disenjove industriale.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Vetëm anëtarët e Unionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale mund të bëhen palë në këtë Marrëveshjeje.

Neni 2

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

“Marrëveshja e vitit 1925” nënkupton Marrëveshjen e Hagës, në lidhje me depozitimin ndërkombëtar të disenjove industriale të 6 nëntorit të vitit 1925;

“Marrëveshja e vitit 1934” nënkupton Marrëveshjen e Hagës, në lidhje me depozitimin ndërkombëtar të disenjove industriale të 6 nëntorit të vitit 1925, e rishikuar në Londër, më 2 qershor 1934;

“Kjo marrëveshje” nënkupton Marrëveshjen e Hagës, në lidhje me depozitimin ndërkombëtar të disenjove industriale, që vendoset nëpërmjet këtij akti;

“Rregulloret” janë rregulloret për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

“Byroja ndërkombëtare” nënkupton byronë ndërkombëtare të pronësisë intelektuale;

“Depozitimi ndërkombëtar” nënkupton një depozitim të bërë në byronë ndërkombëtare;

“Depozitimi kombëtar” nënkupton një depozitim të bërë në zyrën kombëtare të një shteti kontraktues;

“Depozitim i shumëfishtë” nënkupton një depozitim që përfshin disa diseno;

“Shteti i origjinës së një depozitimi ndërkombëtar” nënkupton shtetin kontraktues, në të cilin kërkuesi ka një aktivitet të vërtetë dhe të efektshëm industrial a tregtar ose, nëse kërkuesi një aktivitet të tillë e ka në disa shtete kontraktuese, shtetin kontraktues, që ai ka treguar në kërkesë; nëse kërkuesi nuk ka asnjë aktivitet të tillë në asnjë nga shtetet kontraktues, shtetin kontraktues ku ai ka vendbanimin; nëse ai nuk ka vendbanim në një shtet kontraktues shtetin kontraktues, shtetas i të cilit ai është;

“Shteti që kryen kontrollin e risisë” është shteti kontraktues, ligji i brendshëm i të cilit parashikon një sistem, që përbën një kontroll paraprak me iniciativën e vet dhe kontrollin nga zyra e vet kombëtare, në lidhje me risinë e çdo disenjove të depozituar.

Neni 3

Shtetasit e shteteve kontraktuese dhe personat, të cilët pa qenë shtetas të ndonjë shteti kontraktues, kanë vendbanim ose kanë një aktivitet të vërtetë dhe të efektshëm industrial a tregtar në territorin e shtetit kontraktues, mund të depozitojnë diseno në Byronë Ndërkombëtare.

Neni 4

1. Depozitimi ndërkombëtar në byronë ndërkombëtare mund të bëhet:

1) drejtpërdrejt; ose

2) me ndërmjetësimin e zyrës kombëtare të një shteti kontraktues nëse këtë e lejon ligji i atij shteti.

2. Ligji i brendshëm i një shteti kontraktues mund të kërkojë që depozitat ndërkombëtare, për të cilat ai mendohet se është shteti i origjinës, të bëhen nëpërmjet zyrës së tij kombëtare. Mospërmbushja e kësaj kërkesë nuk cenon efektet e depozitimit ndërkombëtar në shtetet e tjera kontraktuese.

Neni 5

1) Depozitimi ndërkombëtar përbëhet nga një kërkesë dhe një apo disa fotografi ose paraqitje të dizenjosh dhe kërkon pagesën e tarifave të parashikuara në rregulloret:

2) Kërkesa përmban:

1. një listë të shteteve kontraktuese ku kërkuesi kërkon të ketë efekt depozitimi ndërkombëtar;

2. emërtimin e artikullit ose artikujve ku mendohet të trupëzohet dizenoja;

3. nëse kërkuesi dëshiron të pretendojë prioritetin e parashikuar në nenin 9, përcaktimin e datës, shtetit dhe numrin e depozitimit nga rrjedh e drejta e prioritetit;

4. hollësi të tjera që mund të parashikohen nga rregulloret.

3) a) Përveç kësaj, kërkesa mund të përmbajë:

1. një përshkrim të shkurtër të tipareve karakteristike të dizenjosh;

2. një deklaram në lidhje me krijuesin e vërtetë të dizenjosh;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. një kërkesë për shtyrjen e publikimit të parashikuar nga neni 6(4).
- b) Kërkesa mund të shoqërohet edhe me mostra ose modele të artikullit apo artikujve që trupëzojnë dizenjon.
- 4) Një depozitim i shumëfishtë mund të përfshijë disa dizeno, që synohen të trupëzohen në artikujt e përfshirë në të njëjtën kategori të Klasifikimit të Dizenjos Ndërkombëtare, të përmendur në nenin 21(2) pika 4.

Neni 6

- 1) Byroja Ndërkombëtare mban Regjistrin e Dizenjove Ndërkombëtare dhe regjistron në të depozitimet ndërkombëtare.
- 2) Depozitimi ndërkombëtar mendohet të jetë bërë në datën në të cilën Byroja Ndërkombëtare ka marrë kërkesën në formën e duhur, tarifat që paguhen për kërkesën dhe fotografinë apo fotografitë apo paraqitjet e tjera grafike të dizenjos ose, nëse Byroja Ndërkombëtare i ka marrë këto në data të ndryshme, në datën e fundit të tyre, regjistrimi mban të njëjtën datë.
- 3) a) Për çdo depozitim ndërkombëtar, Byroja Ndërkombëtare boton në një buletin periodik:
 1. kopje bardh-e-zi ose, me kërkesën e kërkuarit, me ngjyra, të fotografive të depozituara ose të paraqitjeve të tjera grafike;
 2. datën e depozitimit ndërkombëtar;
 3. hollësitë e parashikuara nga rregulloret.
- b) Byroja Ndërkombëtare ua dërgon buletin periodik zyrtar kombëtar sa më parë të jetë e mundur.
- 4) a) Publikimi i përmendur në paragrafin (3)(a), me kërkesën e kërkuarit, shtyhet për atë periudhë që e kërkon ai. Kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se dymbëdhjetë muaj nga data e depozitimit ndërkombëtar. Megjithatë, nëse pretendohet prioriteti, data e fillimit të kësaj periudhe është data e prioritetit.
- b) Në çdo moment gjatë periudhës së përmendur në nënparagrafin (a), kërkuari mund të kërkojë publikimin e menjëhershëm ose mund ta tërheqë depozitimin. Tërheqja e depozitimit mund të kufizohet vetëm në një ose disa prej shteteve të kontraktuara dhe, në rastin e një depozitimi të shumëfishtë, vetëm në disa prej dizenjove të përfshira në të.
- c) Nëse kërkuari nuk i paguan në kohën e duhur tarifat e detyrueshme para skadimit të periudhës së përmendur në nënparagrafin (a), Byroja Ndërkombëtare anulon depozitimin dhe nuk e ndryshon botimin e përmendur në paragrafin (3)(a).
- d) Para përfundimit të periudhës së përmendur në nënparagrafin (a), Byroja Ndërkombëtare e mban konfidencial regjistrimin e depozitimeve që i nënshtrohen publikimit të shtyrë dhe publiku nuk mund të ketë akses në asnjë nga dokumentet ose artikujt në lidhje me këto depozitime. Këto dispozita zbatohen pa kufizim në lidhje me kohën nëse kërkuari e tërheq depozitimin para skadimit të kësaj periudhe.
- 5) Nëse nuk është parashikuar ndryshe në paragrafin (4), regjistri dhe të gjitha dokumentet dhe artikujt e depozituar te Byroja Ndërkombëtare janë të hapur për t'u parë nga publiku.

Neni 7

- 1) a) Një depozitim i regjistruar në Byronë Ndërkombëtare ka të njëjtin efekt në secilin shtet kontraktues të përcaktuar nga kërkuari në kërkesën e tij, sikur të ishin përmbushur nga kërkuari të gjitha formalitetet e parashikuara nga ligji i brendshëm për dhënien e mbrojtjes dhe sikur të ishin kryer nga zyra e këtij shteti të gjitha aktet administrative të kërkuara për këtë qëllim.
- b) Në pajtim me dispozitat e nenit 11, mbrojtja e dizenjove, depozitimi i të cilave është regjistruar në Byronë Ndërkombëtare, rregullohet në çdo shtet kontraktues nga ato dispozita të ligjit të brendshëm që zbatohen në atë shtet për dizenjot për të cilat mbrojtja pretendohet mbi bazën e një depozitimi kombëtar dhe në lidhje me të cilin janë përmbushur dhe kryer të gjitha formalitetet dhe aktet administrative.
- 2) Një depozitim ndërkombëtar nuk ka efekt në shtetin e origjinës nëse ligjet e atij shteti e parashikojnë këtë.

Neni 8

- 1) Pavarësisht dispozitave të nenit 7, zyra kombëtare e një shteti kontraktues, ligji i brendshëm i të cilit parashikon që zyra kombëtare, mbi bazën e një kontrolli administrativ me iniciativën e vet apo në pajtim me një kundërshtim të bërë nga një palë e tretë, mund të refuzojë mbrojtjen, në rast refuzimi, njofton Byronë Ndërkombëtare brenda gjashtë muajve që dizenjoja nuk i përmbush kërkesat e ligjit të tij të brendshëm, të

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

ndryshme nga formalitetet dhe aktet administrative të përmendura në nenin 7(1). Nëse një refuzim i tillë nuk njoftohet brenda gjashtë muajsh, depozitimi ndërkombëtar hyn në fuqi në atë shtet që nga data e depozitimit. Megjithatë, në një shtet kontraktues që bën kontrollin e rrisë, depozitimi ndërkombëtar, duke e ruajtur prioritetin e tij dhe nëse nuk njoftohet ndonjë refuzim brenda një periudhe gjashtëmujore, hyn në fuqi nga përfundimi i këtij afati, përveçse kur ligji i brendshëm parashikon një datë të mëparshme për depozitat e bëra në zyrën e tij kombëtare.

2) Periudha gjashtëmujore e përmendur në paragrafin (1) llogaritet nga data në të cilën zyra kombëtare merr numrin e buletinit periodik në të cilin është publikuar regjistrimi i depozitimit ndërkombëtar. Zyra kombëtare ia komunikon këtë datë çdo personi që e kërkon këtë.

3) Kërkuesi ka të njëjtat mjete të mbrojtjes ligjore kundër refuzimit të zyrës kombëtare të përmendur në paragrafin (1), sikur ta kishte depozituar dizenjën e tij në atë zyrë; në çdo rast, refuzimi i nënshtrohet një kërkesë për rikontroll ose ankimit. Njoftimi i këtij refuzimi përmban:

1. arsyet për të cilat është konstatuar që dizenjoja nuk i përmbush kërkesat e ligjit të brendshëm;
2. datën e përmendur në paragrafin (2);
3. afatin e lejuar për kërkesë për rikontroll ose ankim;
4. organin ku mund të bëhet kjo kërkesë ose ankim.

4) a) Zyra kombëtare e një shteti kontraktues, ligji i brendshëm i të cilit përmban dispozitat e llojit të përmendur në paragrafin (1) që kërkojnë një deklaratë se cili është krijuesi i vërtetë i dizenjës ose një përshkrim të dizenjës mund të parashikojë që me kërkesë dhe brenda një periudhe jo më të shkurtër se gjashtëdhjetë ditësh nga dërgimi i një kërkesë të tillë nga kjo zyrë, kërkuesi depoziton në gjuhën e kërkesës te Byroja Ndërkombëtare:

1. një deklaratë se kush është krijuesi i vërtetë i dizenjës;
2. një përshkrim të shkurtër, ku të theksohen tiparet karakteristike të dizenjës, siç tregohen nga fotografitë ose paraqitje të tjera grafike.

h) Zyra kombëtare nuk cakton asnjë tarifë në lidhje me depozitimin e këtyre deklaratave apo përshkrimeve apo për botimin e tyre të mundshëm nga kjo zyrë kombëtare.

5) a) Çdo shtet kontraktues, ligji i brendshëm i të cilit përmban dispozita të llojit të përmendur në paragrafin (1), njofton përkatësisht Byronë Ndërkombëtare.

b) Nëse në bazë të legjislacioni të tij, një shtet kontraktues ka disa sisteme për mbrojtjen e dizenjave, një prej të cilave parashikon kontrollin e rrisë, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me shtetet që kryejnë kontrolle risie, zbatohen vetëm për këtë sistem.

Neni 9

Nëse depozitimi ndërkombëtar i një dizenjoje bëhet brenda gjashtë muajve nga depozitimi i parë i së njëjtës dizenjo në një shtet anëtar të Unionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, dhe nëse pretendohet prioriteti për depozitimin ndërkombëtar, data e prioritetit është ajo e depozitimit të parë.

Neni 10

1) Një depozitim ndërkombëtar mund të rinovohet çdo pesë vjet duke paguar gjatë vitit të fundit të çdo periudhe pesëvjeçare, vetëm tarifat e rinovimit të parashikuara nga rregulloret.

2) Duke iu nënshtruar një pagese shtesë të përcaktuar në rregulloret, lejohet një afat shtesë prej gjashtë muajsh për rinovimin e depozitimit ndërkombëtar.

3) Në momentin e pagës së tarifave të rinovimit duhet të tregohet numri i depozitimit ndërkombëtar dhe gjithashtu, nëse rinovimi nuk duhet të kryhet për të gjitha shtetet kontraktuese për të cilat depozitimi është afër skadimit, ato shtete kontraktuese për të cilat duhet të realizohet rinovimi.

4) Rinovimi mund të kufizohet vetëm në disa prej dizenjave të përfshira në një depozitë të shumëfishtë.

5) Byroja Ndërkombëtare regjistron dhe publikon rinovimet.

Neni 11

1) a) Afati i mbrojtjes i dhënë nga një shtet kontraktues për dizenjot që i janë nënshtruar një depozitimi ndërkombëtar nuk është më pak se:

1. dhjetë vjet nga data e depozitimit ndërkombëtar nëse depozitimi është rinovuar;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. pesë vjet nga data e depozitimit ndërkombëtar në mungesë të rinovimit.

b) Megjithatë, në bazë të dispozitave të ligjit të brendshëm të një shteti kontraktues, i cili kryen kontrollin e risisë, mbrojtja fillon në një datë të mëvonshme nga ajo e depozitimit ndërkombëtar, afatet minimale të parashikuara në nënparagrafin (a) llogariten nga data në të cilën fillon mbrojtja në atë shtet. Fakti që depozitimi ndërkombëtar nuk rinovohet apo rinovohet vetëm një herë, nuk cenon në asnjë mënyrë afatet minimale të përcaktuara për mbrojtjen.

2) Nëse ligji i brendshëm i një shteti kontraktues parashikon mbrojtje për dizenjot që i janë nënshtruar depozitimit kombëtar, kohëzgjatja e të cilave, me apo pa rinovim, është më e gjatë se dhjetë vjet, mbrojtja në atë shtet jepet për të njëjtën kohëzgjatje, mbi bazën e depozitimit ndërkombëtar dhe rinovimeve të tij për dizenjot që i janë nënshtruar një depozitimi ndërkombëtar.

3) Një shtet kontraktues, në bazë të ligjit të tij të brendshëm, mund ta kufizojë afatin e mbrojtjes së dizenjove që i janë nënshtruar një depozitimi ndërkombëtar në afatet e parashikuara në paragrafin (1).

4) Në pajtim me dispozitat e paragrafit (1)(b), mbrojtja në një shtet kontraktues përfundon në datën e skadimit të depozitimit ndërkombëtar, përveçse kur ligji i brendshëm i atij shteti parashikon që mbrojtja vazhdon edhe pas datës së skadimit të depozitimit ndërkombëtar.

Neni 12

1) Byroja Ndërkombëtare regjistron dhe publikon ndryshimet që prekin pronësinë e një dizenjoje, të cilat i nënshtrohet një depozitimi ndërkombëtar në fuqi. Kuptohet që transferimi i pronësisë mund të kufizohet në të drejtat që rrjedhin nga depozitimi ndërkombëtar vetëm në një ose disa shtete kontraktuese dhe në rastin e një depozitimi të shumëfishtë, vetëm për disa prej dizenjove të përfshira në të.

2) Regjistrimi i përmendur në paragrafin (1) ka të njëjtin efekt sikur të ishte bërë në zyrat kombëtare të shteteve kontraktuese.

Neni 13

1) Pronari i një depozitimi ndërkombëtar, me anë të një deklarate drejtuar Byrosë Ndërkombëtare, mund të heqë dorë nga të drejtat e tij në lidhje me të gjitha ose vetëm disa shtete kontraktuese dhe në rastin e një depozitimi të shumëfishtë, në lidhje me vetëm disa prej dizenjove të përfshira në të.

2) Byroja Ndërkombëtare regjistron dhe publikon këtë deklaratë.

Neni 14

1) Asnjë shtet kontraktues nuk mund të kërkojë si kusht për njohjen e së drejtës së mbrojtjes që artikulli që trupëzon dizenjot, të ketë një shenjë apo shënim në lidhje me depozitimin e dizenjot.

2) Nëse ligji i brendshëm i një shteti kontraktues parashikon një shënim në artikullin për ndonjë qëllim tjetër, ky shtet e konsideron këtë kërkesë të përmbushur nëse të gjithë artikujt që i ofrohen publikut me autorizimin e pronarit të të drejtave të dizenjot apo etiketat e ngjitura këtyre artikujve, mbajnë shënimin e dizenjot ndërkombëtare.

3) Shënimi i dizenjot ndërkombëtare përbëhet nga simboli ... (një germe kapitale D në një rreth) e shoqëruar nga:

1. viti i depozitës ndërkombëtare dhe emri ose shkurtimi i zakonshëm i emrit të depozituesit; ose

2. numri i depozitimit ndërkombëtar.

4) Thjesht qenia e shënit të dizenjot ndërkombëtare në artikull ose etiketë nuk do të interpretohet në asnjë rast sikur nënkupton heqjen dorë nga mbrojtja me anë të së drejtës së autorit dhe për ndonjë shkak tjetër, kurdoherë që në mungesë të një shënim të tillë, kjo mbrojtje mund të pretendohet.

Neni 15

1) Tarifat e parashikuara nga rregulloret përbëhen nga:

1. tarifat e Byrosë Ndërkombëtare;

2. tarifat për shtetet kontraktuese të përcaktuara nga kërkuesi, të cilat janë:

a) një tarifë për çdo shtet kontraktues;

b) një tarifë për çdo shtet kontraktues që kryen një kontroll risie dhe që kërkon pagesën e një tarife për një kontroll të tillë.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2) Çdo tarifë e paguar në lidhje me një dhe të njëjtin depozitim për një shtet kontraktues në bazë të paragrafit (1) pika 2(a) zbritet nga shuma e tarifës së përmendur në paragrafin (1) pika 2(b), nëse kjo tarifë e fundit bëhet e detyrueshme për t'u paguar për të njëjtin shtet.

Neni 16

1) Tarifat për shtetet kontraktuese të përmendura në nenin 15(1) pika 2, mblihen nga Byroja Ndërkombëtare dhe u paguhen çdo vit shteteve kontraktuese të përcaktuara nga kërkuuesi.

2) a) Çdo shtet kontraktues mund të njoftojë Byronë Ndërkombëtare që ai heq dorë nga e drejta e tij për tarifën shtesë të përmendura në nenin 15 (1) pika 2 (a), në lidhje me depozitat ndërkombëtare për të cilat çdo shtet tjetër kontraktues që heq dorë në mënyrë të njëjtë, mendohet të jetë shteti i origjinës.

(ii) Ky shtet mund të heqë dorë në të njëjtën mënyrë në lidhje me depozitimet ndërkombëtare për të cilat ai vetë mendohet të jetë shteti i origjinës.

Neni 17

Rregulloret rregullojnë detajet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe veçanërisht:

1. gjuhët dhe numrin e kopjeve në të cilat duhet të paraqitet kërkesa për depozitim dhe të dhënat që duhet të përmbajë kërkesa;

2. shumat, datat dhe metodat e pagesave të tarifave për Byronë Ndërkombëtare dhe shtetet, duke përfshirë kufizimet e caktuara mbi tarifën për shtetet kontraktuese që kryejnë kontrollin e rrisë;

3. numrin, madhësinë dhe karakteristikat të tjera të fotografive ose paraqitjeve të tjera grafike për çdo dizeno të depozituar;

4. gjatësinë e përshkrimit të tipareve karakteristike të dizenjës;

5. kufizimet brenda të cilave dhe kushtet në të cilat mostrat ose modelet e artikujve që trupëzojnë dizenjën mund të shoqërojnë kërkesën;

6. numrin e dizenjave që mund të përfshihen në një depozitim të shumëfishtë dhe kushte të tjera që rregullojnë depozitimet e shumëfishta;

7. të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me publikimin dhe shpërndajen e buletinit periodik të përmendur në nenin 6(3)(a), duke përfshirë numrin e kopjeve të buletinit që u jepen pa pagesë zyra kombëtare dhe numrin e kopjeve që mund t'u shiten me çmim të reduktuar këtyre zyra;

8. procedura për njoftimin nga shtetet kontraktuese të çdo refuzimi të parashikuar në nenin 8(1) dhe procedura e komunikimit dhe publikimit të këtyre refuzimeve nga Byroja Ndërkombëtare;

9. kushtet për regjistrimin dhe publikimin nga Byroja Ndërkombëtare të ndryshimeve që kanë të bëjnë me pronësinë e një dizenoje të përmendur në nenin 12(1) dhe për heqjen dorë të përmendura në nenin 13;

10. disponimin e dokumenteve dhe artikujve që kanë të bëjnë me depozitimet, mundësia e rinovimit të të cilëve ka përfunduar së ekzistuari.

Neni 18

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk përjashtojnë ngritjen e një pretendimi në favor të një mbrojtjeje më të gjerë që mund të jepet nga legjislacioni i brendshëm në një shtet kontraktues, as edhe ndikojnë në ndonjë mënyrë mbi mbrojtjen e dhënë për veprat e artit dhe veprat e arteve të aplikuara nga marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare për të drejtën e autorit.

Nenet 19 deri 22

(Shfuqizuar nga neni 7(2) i Aktit Plotësues të Stokholmit (1967)).

Neni 23

1) Kjo Marrëveshje mbetet e hapur për nënshkrim deri më 31 dhjetor 1961.

2) Ajo ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit depozitohen te Qeveria e Holandës.

Neni 24

1) Shtetet anëtare të Bashkimit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale që nuk e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje mund të aderojnë në të.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2) Këto aderime i njoftohen nëpërmjet rrugëve diplomatike Drejtorit të Përgjithshëm¹ dhe ky i fundit ua njofton qeverive të shteteve kontraktuese.

Neni 25

1) Çdo shtet kontraktues merr përsipër të parashikojë mbrojtjen e dizenjove industriale dhe në pajtim me kushtetutën e vet, të miratojë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2) Në momentin që një shtet kontraktues depoziton instrumentin e vet të ratifikimit ose aderimit, ai duhet të jetë në gjendje në bazë të ligjit të vet të brendshëm t'u japë fuqi dispozitive të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 26

1) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi një muaj pas datës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm u ka dërguar një njoftim shteteve kontraktuese për depozitimin e dhjetë instrumenteve të ratifikimit ose aderimit, të paktën katër prej të cilëve janë ato shtete që në datën e kësaj Marrëveshjeje nuk janë palë as në Marrëveshjen e vitit 1925 dhe as në Marrëveshjen e vitit 1934.

2) Më pas, depozitimi i instrumenteve të ratifikimit dhe aderimit u njoftohet shteteve kontraktuese nga Drejtori i Përgjithshëm. Këto ratifikime dhe aderime hyjnë në fuqi një muaj pas datës së dërgimit të një njoftimi të tillë, përveçse kur, në rastin e aderimit, në instrumentin e aderimit tregohet një datë e mëvonshme.

Neni 27

Çdo shtet kontraktues në çdo kohë mund të njoftojë Drejtorin e Përgjithshëm që kjo Marrëveshje zbatohet për të gjitha ose ato pjesë territori për marrëdhëniet me jashtë të të cilave ai është përgjegjës. Pas kësaj, Drejtori i Përgjithshëm ua komunikon këtë njoftim shteteve kontraktuese dhe Marrëveshja zbatohet edhe për këto territore një muaj pas dërgimit të komunikimit nga Drejtori i Përgjithshëm i shteteve kontraktuese, përveçse kur në njoftim tregohet një datë e mëvonshme.

Neni 28

1) Çdo Shtet kontraktues, me anë të një njoftimi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, mund të denoncojë këtë Marrëveshje në emrin e vet dhe për llogari të të gjithave ose një pjese të territoreve të përcaktuara në njoftimin sipas nenit 27. Ky njoftim hyn në fuqi një vit pas marrjes së tij nga Drejtori i Përgjithshëm.

2) Denoncimi nuk çliron asnjë shtet kontraktues nga detyrimet e veta në bazë të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me dizenjot e depozituara në Byronë Ndërkombëtare, para datës në të cilën denoncimi hyn në fuqi.

Neni 29

1) Kjo Marrëveshje dorëzohet për rishikim, me qëllim paraqitjen e ndryshimeve të synuara për të përmirësuar mbrojtjen që rrjedh nga depozitimi ndërkombëtar i dizenjove.

2) Konferencat e rishikimit thirren me kërkesën e jo më pak se gjysmës së shteteve kontraktuese.

Neni 30

1) Dy osë më shumë shtete kontraktuese në çdo kohë mund të njoftojnë Drejtorin e Përgjithshëm që, në pajtim me kushtet e treguara në njoftim:

1. një zyrë e përbashkët zëvendëson zyrat kombëtare të secilit prej tyre;

2. ata konsiderohen të jenë një shtet i vetëm, për qëllime të zbatimit të neneve 2 deri 17 të kësaj Marrëveshjeje.

2) Ky njoftim nuk hyn në fuqi pa kaluar gjashtë muaj nga data e dërgimit të komunikimit të tij nga Drejtori i Përgjithshëm shteteve të tjera kontraktuese.

¹ Drejtor i Përgjithshëm përkufizohet në nenin 1 të Aktit Plotësues të Stokholmit (1967) si Drejtor i Përgjithshëm i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 31

1) Vetëm kjo Marrëveshje është e zbatueshme në lidhje me marrëdhëniet e ndërsjella të shteteve palë të kësaj Marrëveshjeje, si dhe të Marrëveshjes së vitit 1925 dhe Marrëveshjes së vitit 1934. Megjithatë, këto shtete, në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, zbatojnë Marrëveshjen e vitit 1925 ose Marrëveshjen e vitit 1934, sipas rastit, për dizenjtë e depozituara te Byroja Ndërkombëtare para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me marrëdhëniet e ndërsjella.

2) a) Çdo shtet palë në këtë Marrëveshje dhe në atë të vitit 1925 vazhdon ta zbatojë Marrëveshjen e vitit 1925 në marrëdhëniet e tij me shtetet palë vetëm në Marrëveshjen e vitit 1925, përveçse kur ky shtet ka denoncuar Marrëveshjen e vitit 1925.

b) Çdo shtet palë në këtë Marrëveshje dhe në atë të vitit 1934 vazhdon ta zbatojë Marrëveshjen e vitit 1934 në marrëdhëniet e tij vetëm me shtetet palë në Marrëveshjen e vitit 1934, përveçse kur ky shtet ka denoncuar marrëveshjen e vitit 1934.

3) Shtetet palë në këtë Marrëveshje nuk janë të detyruara kundrejt shteteve, të cilat pa qenë palë në këtë Marrëveshje, janë palë në Marrëveshjen e vitit 1925 dhe në Marrëveshjen e vitit 1934.

Neni 32

1) Nënshkrimi dhe ratifikimi ose aderimi në këtë Marrëveshje nga një shtet palë, në datën e kësaj Marrëveshjeje, në Marrëveshjen e vitit 1925 ose në Marrëveshjen e vitit 1934 çmohet të përfshijë nënshkrimin, ratifikimin ose aderimin në protokollin bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje, përveçse kur ky shtet bën shprehimisht një deklaratë të kundërt në momentin e nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit të tij të aderimit.

2) Çdo shtet kontraktues që ka bërë deklaratën e përmendur në paragrafin (1) ose çdo shtet tjetër kontraktues që nuk është palë në Marrëveshjen e vitit 1925 ose në Marrëveshjen e vitit 1934, mund të nënshkruajë ose aderojë në protokollin bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje. Në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të aderimit, ai mund të deklarojë që nuk çmohet i detyruar nga dispozitat e paragrafëve (2)(a) ose (2)(b) të protokollit; në këtë rast, shteti tjetër palë në protokoll nuk është i detyruar të zbatojë në marrëdhëniet me atë shtet dispozitat e përmendura në atë deklaram. Dispozitat e neneve 23 dhe 28, duke përfshirë këto nene, zbatohen në mënyrë analoge.

Neni 33

Ky Akt nënshkruhet në një kopje të vetme, i cili depozitohet në arkivat e Qeverisë së Holandës. Një kopje e vërtetuar i transmetohet nga kjo e fundit Qeverisë së çdo shteti që ka nënshkruar dhe aderuar në këtë Marrëveshje.

PROTOKOLL*

Shtetet palë në këtë protokoll kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. Dispozitat e këtij protokollit zbatohen për dizenjtë që i janë nënshtruar një depozitimi ndërkombëtar dhe nga të cilat një nga shtetet palë në këtë protokoll mendohet të jetë shteti i origjinës.

2. Në lidhje me dizenjtë e përmendura në paragrafin (1) të mësipërm:

a) afati i mbrojtjes i dhënë nga shtetet palë në këtë protokoll për dizenjtë e përmendura në paragrafin (1) nuk është më i shkurtër se pesëmbëdhjetë vjet nga data e parashikuar në paragrafët (1)(a) ose (1)(b), sipas rastit, të nenit 11;

b) shfaqja e një shënimi në artikujt që trupëzojnë dizenjtë ose në etiketat e ngjitura atyre nuk kërkohet në asnjë rast nga shtetet palë në këtë protokoll, as për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga depozitimi ndërkombëtar në territoret e tyre, dhe as për ndonjë qëllim tjetër.

* Ky protokoll nuk ka hyrë ende në fuqi.

LIGJ
Nr.10 179, datë 29.10.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E PATENTAVE EUROPIANE¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika Shqipërisë aderon në Konventën e Patentave Europiane, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6338, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA
E PATENTAVE EUROPIANE

KONVENTË
PËR DHËNIEN E PATENTAVE EUROPIANE
(KONVENTA E PATENTAVE EUROPIANE)

Teksti i Konventës, rregulloret zbatuese, protokolli mbi interpretimin e nenit 69 të KPE-së, Protokolli mbi centralizimin, protokolli njohës, protokolli mbi të drejtat paraprahe dhe imunitetet, Protokolli mbi gjendjen e personelit dhe rregullat në lidhje me tarifat

Botimi i 13-të, korrik 2007
Botuar nga Zyra e Patentave Europiane
ISBN 3-89605-090-7

Parathenie

Ky botim i 13-të i Konventës së Patentave Europiane (KPE) përmban tekstet e Konventës, Rregulloreve Zbatuese dhe protokollat dhe rregullat në lidhje me Tarifat që do të zbatohen menjëherë sapo akti i rishikimit të KPE-së i datës 29 nëntor 2000 do të hyjë në fuqi², së bashku me një pjesë nga Akti i rishikimit dhe dispozitave kalimtare.

Një listë referencash që tregon dispozitat e reja dhe ato të mëparshme përkatëse në tekst të vlefshme para hyrjen në fuqi të KPE-së së rishikuar i jepet në Aneksin II. Indeksi i vendimeve G gjendet në aneksin I, dhe indeksi i fjalëve kyçe është përditësuar në pajtim me tekstet e reja.

Mënyra e citimit

Me hyrjen në fuqi të konventës së rishikuar – ose “KPE-së 2000” -, teksti i vlefshëm deri në atë kohë

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr. 167. Tiranë, 2009. f. 7361

Anekset e ligjit nr. 10 179, datë 29.10.2009 gjenden në linkun:

<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2009/10/29/10179/6e8505fe-c2f1-44dd-87d4-f61adflace34;q=P%C3%8BR%20USHTRIMIN%20E%20PROFESIONIT%20T%C3%8B%20P%C3%8BRFAQ%C3%8BSUESTI%20T%C3%8B%20AUTORIZUAR%20T%C3%8B%20PATENTAVE>

² Ky libër shkoi për botim, data e hysjes në fuqi nuk ishte përcaktuar por do të jetë jo më vonë se 13 dhjetor 2007

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

(“KPE 1973” Shfuqizohet. Teksti i rishikuar i KPE do të citohet në të ardhmen pa përcaktorin “2000”).

Megjithatë ndonjëherë do të jetë e nevojshme të bëhet dallimi ndërmjet dy testeve. Në keto raste, “KPE - 1973” do të thotë:

- konventa për dhënien e Patentave Europiane të datës 5 tetor 1973 e ndryshuar me aktin që rishikon Nenin 63 të KPE-së së datës 17 dhjetor 1991 dhe me vendimet e Këshillit Administrativ të Organizatës së Patentave Europiane të datës 21 dhjetor 1978, 13 dhjetor 1994, 20 tetor 1995, 5 dhjetor 1996, 10 dhjetor 1998 dhe 27 tetor 2005;

Dhe/ose

-Rregulloret e saj të Zbatimit të ndryshuara së fundi nga Këshilli Administrativ i datës 9 dhjetor 2004.

Këto janë versione të publikuara në botimin e vitit 2006 (12-të) të Konventes së Patentave Europiane. Në kontekste të caktuara, për shëmbull kur citohen vendimet e renditura në Aneksin I të Bordit të Zgjeruar të Apelit, mund të ketë referenca në tekstet e mëparshme të Konventës dhe Rregulloreve Zbatuese.

Teksti i ri i KPE-së

Neni 3(1) i Aktit të Rishikuar autorizon Këshillin Administrativ për të publikuar një tekst të ri të KPE-së mbi një propozim nga Presidenti i Zyrës së Patentave Europiane. Për pasojë, Zyra hartoi një tekst të ri të KPE-së dhe protokolleve të saj për centralizimin, mbi interpretimin e Nenit 69 të KPE-së dhe mbi gjendjen e personelit, për të përshtatur tekstet e versioneve në anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Këshilli miratoi këtë tekst të ri me vendim të datës 28 qershor 2001¹, nëpërmjet të cilit ai u bë pjesë përberëse e Aktit të rishikimit (Neni 3(2) të aktit të Rishikimit).

Dispozita kalimtare

Nga dispozitat transitorie të KPE 2000, pjesa më e madhe e dispozitave të rishikuara zbatohen për patentat tashmë të dhëna dhe kërkesat që janë në shqyrtim e sipër. Megjithatë, këto janë përjashtime. Për të ndihmuar lexuesit të gjejnë se kur një dispozitë e rishikuar bëhet e zbatueshme, janë përfshirë pjesë nga Akti Rishikuar, së bashku me vendimin e Këshillit të datës 28 qershor 2001 që parashikon masat kalimtare sipas Nenit 7 të aktit.

Referencat

Në të gjithë tekstin e Konventës dhe Rregulloret e saj Zbatuese, referencat në nenet dhe rregullat perkatës (duke përjashtuar ato që janë cituar në dispoziten përkatëse) janë të vendosura në anën e djathtë. Këto nuk pretendojnë të jenë shteruese, megjithatë, ato janë pjesë e tekstit zyrtar, por janë vetëm për të lehtësuar përdorimin e tij.

Qershor 2007, Zyra e Patentave Europiane.

PËRMBAJTJA

Konventa mbi dhënien e patentave europiane (Konventa e Patentave Europiane)

Rregulloret zbatuese të Konventës për dhënien e patentave europiane

Protokolli mbi interpretimin e nenit 69 të KPE-së

Protokolli mbi centralizimin e sistemit të patentave europiane dhe mbi prezantimin e tij (protokoll mbi centralizimin)

Protokoll mbi juridiksionin dhe njohjen e vendimeve në lidhje me të drejtën për dhënien e një patente europiane (protokolli mbi njohjen)

Protokolli mbi privilegjet dhe imunitetet e Organizatës së Patentave Europiane (protokolli mbi privilegjet dhe imunitetet)

Protokolli mbi gjendjen e personelit të zyrës së patentave europiane në Hagë (protokolli mbi gjendjen e personelit)

Akti rishikues i Konventës mbi dhënien e patentave europiane (Konventa e Patentave Europiane) e datës 5 tetor 1973, së fundi e rishikuar më 17 dhjetor 1991 e datës 29 nëntor 2000 (pjesë)

Vendim i Këshillit Administrativ i datës 28 qershor 2001 mbi dispozitat kalimtare sipas nenit 7 të aktit që rishikon Konventën e Patentave Europiane të datës 29 nëntor 2000

Rregullat në lidhje me tarifën

Aneksi I

Indeksi i vendimeve dhe mendimeve të Bordit të Zgjeruar të Apelit të Publikuar në Gazetën Zyrtare të KPE-së

¹ Shih GZ KPE 2001, Botim i veçantë Nr. 4, F.55

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Aneksi II
Indeksi i dërgimeve anësore
Shkurtime
Indeksi alfabetik i fjalëve kyç

PARATHËNIE

Shtetet Kontraktuese

Me dëshirën për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet shteteve të Europës në lidhje me mbrojtjen e shpikjeve;

Me dëshirën që kjo mbrojtje të përftohet në ato shtete nga një procedurë unike për dhënien e patentave dhe nga vendosja e disa rregullave standarde që rregullojnë patentat e dhëna në këtë mënyrë;

Me dëshirën që për këtë qëllim të përfundojnë një konventë që themelon një Organizatë për Patentat Europiane dhe që përbën një marrëveshje të veçantë brenda kuptimit të nenit 19 të Konventës për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, të nënshkruar në Paris më 20 mars 1883 dhe të rishikuar së fundi më 14 korrik 1967, dhe një traktat rajonal për patentat brenda kuptimit të nenit 45, paragrafi 1, i Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat të datës 19 qershor 1970,

Kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE INSTITUCIONALE

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

E drejta europiane për dhënien e patentave

Kjo Konventë vendos një sistem ligjor të përbashkët për Shtetet Kontraktuese¹ për dhënien e patentave për shpikjet.

Neni 2 N. 63-65, 68, 69, 70, 99-105c/quater, 142

R. 75, 85, 89, 90-96

Patenta europiane

1. Patentat e dhëna sipas kësaj Konventë do të quhen patenta europiane.
2. Patenta europiane, në secilin prej Shteteve Kontraktuese për të cilët ajo është dhënë, do të ketë efektin dhe do t'i nënshtrohet të njëjtave kushte si një patentë kombëtare e dhënë nga ai Shtet, përveç kur kjo Konventë parashikon ndryshe.

Neni 3 N. 79, 149, R. 39

Efekti territorial

Dhënia e një patente europiane mund të kërkohet për një ose më shumë prej Shteteve Kontraktuese.

Neni 4² N. 4a/bis, 10-36, R. 9-13

Organizata e Patentave Europiane

1. Nëpërmjet kësaj Konvente themelohet një Organizatë për Patentat Europiane, që këtu quhet Organizata. Ajo është e pajisur me autonomi administrative dhe financiare.
2. Organet e Organizatës do të jenë:
 - a) Zyra e Patentave Europiane;
 - b) Këshilli Administrativ.

¹ Tashmë 32 Shtetet Kontraktuese janë: AT, BE, BG, CH, CY, CZ, DE, DK, EE, ES, FI, FR, GB, GR, HU, IE, IS, IT, LI, LT, LU, LV, MC, MT, NL, PL, PT, RO, SE, SI, SK, TR.

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve, G 5/88, G 7/88, G 8/88, G 1/04 (Aneksi I)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Detyra e Organizatës do të jetë dhënia e patentave Europiane. Kjo do të kryhet nga Zyra e Patentave Europiane të mbikëqyrur nga Këshilli Administrativ.

Neni 4a¹ N. 4

Konferenca e Ministrave të Shteteve Kontraktuese

Një Konferencë e ministrave të Shteteve Kontraktuese përgjegjës për çështjet e patentave mbledhet të paktën çdo pesë vjet për të diskutuar çështjet që i takojnë organizatës dhe sistemit të patentave Europiane.

KAPITULLI II

ORGANIZATA E PATENTAVE EUROPIANE

Neni 5²

Statusi Ligjor

1. Organizata do të ketë personalitet juridik.
2. Në secilin prej Shteteve Kontraktuese, Organizata do të gëzojë statusin me të gjerë ligjor që u jepet personave juridikë sipas ligjeve të brendshme të atij Shteti; ajo mund të përftojë dhe të disponojë veçanërisht pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe mund të jetë palë në procedime gjyqësore.
3. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane përfaqëson Organizatën.

Neni 6³

Zyra qendrore

1. Organizata do të ketë zyrën e saj qendrore në Munih.
2. Zyra e Patentave Europiane gjendet në Munih. Ajo do të ketë një degë në Hagë.

Neni 7⁴ N. 35

Zyrat e Shërbimeve të Zyrës së Patentave Europiane

Me vendim të Këshillit Administrativ, mund të ngrihen zyrat e shërbimeve të Zyrës së Patentave Europiane, sipas nevojës, për qëllimin e informimit dhe ndërlidhjes, në Shtetet Kontraktuese dhe me organizatat ndërqeveritare në fushën e pronësisë industriale, duke iu nënshtruar aprovimit të Shtetit Kontraktues ose organizatës përkatëse.

Neni 8

Privilegjet dhe imunitetet

Protokolli mbi Privilegjet dhe Imunitetet të bashkangjitura kësaj Konvente përcaktojnë kushtet në të cilat Organizata, anëtarët e Këshillit Administrativ, punonjësit e Zyrës së Patentave Europiane, dhe persona të tjerë të përcaktuar në këtë Protokoll që marrin pjesë në punën e Organizatës, në Shtetet Kontraktues, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre.

Neni 9

Detyrimet

1. Detyrimet kontraktuale të Organizatës do të rregullohen nga ligji i zbatueshëm në kontratën në fjalë.
2. Detyrimi jo-kontraktual i Organizatës në lidhje me një dëm të shkaktuar prej saj ose nga punonjësit e Zyrës së Patentave Europiane në përmbushje të detyrave të tyre do të rregullohet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Nëse dëmi është shkaktuar nga dega e Hagës ose një zyrë shërbimesh ose punonjësit e saj, zbatohet

¹ Futur me aktin e rishikimit të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 5/88, G 7/88, G 8/88 (Aneksi I).

³ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 5/88, G 7/88, G 8/88 (Aneksi I).

⁴ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 5/88, G 7/88.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

ligji i Shtetit Kontraktues në të cilin gjendet kjo degë ose zyrë shërbimesh.

3. Detyrimi personal i punonjësve të Zyrës së Patentave Europiane ndaj Organizatës rregullohet nga Rregulloret e tyre të Shërbimeve ose kushtet e punësimit.

4. Gjykatat që kanë juridiksion për të zgjidhur mosmarrëveshjet sipas paragrafëve 1 dhe 2 janë:

a) për mosmarrëveshjet sipas paragrafit 1, gjykatat e Republikës Federale Gjermane, nëse kontrata e lidhur ndërmjet palëve cakton një gjykatë të një Shteti tjetër;

b) për mosmarrëveshjet sipas paragrafit 2, gjykatat e Republikës Federale Gjermane, ose Shtetit në të cilin ndodhet dega ose zyra e shërbimeve.

KAPITULLI III

ZYRA E PATENTAVE EUROPIANE

Neni 10¹⁸

Menaxhimi R. 9, 11

1. Zyra e Patentave Europiane menaxhohet nga Kryetari, që është përgjegjës për aktivitetet e Këshillit Administrativ.

2. Për këtë qëllim, Kryetari ka veçanërisht funksionet dhe kompetencat e mëposhtme:

a) ai merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin e Zyrës së Patentave Europiane, duke përfshirë miratimin e udhëzimeve të brendshme administrative dhe informacionin për publikun;

b) nëse kjo Konventë nuk parashikon ndryshe, ai përcakton se cilat veprime duhet të kryhen përkatësisht nga Zyra e Patentave Europiane në Munih dhe dega e saj në Hage;

c) ai mund t'i paraqesë Këshillit Administrativ çdo propozim për ndryshimin e kësaj Konvente, për rregulloret e përgjithshme, ose për vendimet që përfshihen në kompetencën e Këshillit Administrativ;

d) ai përgatit dhe zbaton buxhetin dhe çdo buxhet të ndryshuar apo shtesë;

e) ai i paraqet në raport mbi menaxhimin Këshillit Administrativ çdo vit;

f) ai ushtron autoritet mbikëqyrës mbi personelin;

g) sipas Nenit 11, ai emëron punonjësit dhe vendos në lidhje me ngritjen e tyre në detyrë;

h) ai ushtron autoritet disiplinor mbi punonjësit e ndryshëm nga ata që përmenden në Nenin 11, dhe mund t'i propozojë masa disiplinore Këshillit Administrativ në lidhje me punonjësit e përmendur në Nenin 11, paragrafi 2 dhe 3;

i) ai mund të delegojë funksionet dhe kompetencat e tij.

3.² Kryetari mund të asistohet nga një numër Zëvendëskryetarësh. Nëse Kryetari mungon ose nuk mund të veprojë, një prej Zëvendëskryetarëve zë vendin e tij në pajtim me procedurën e përcaktuar nga Këshilli Administrativ

Neni 11³

Emërimi i punonjësve të lartë N. 21, 22, 35

1. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane emërohet nga Këshilli Administrativ.

2. Zëvendëskryetarët emërohen nga Këshilli Administrativ pasi të jetë konsultuar me Kryetarin e Zyrës së Patentave Europiane.

3. Anëtarët, duke përfshirë Kryetarin, e Bordit të Apelit dhe të Bordit të Zgjeruar të Apelit emërohen nga Këshilli Administrativ me propozim të Kryetarit të Zyrës së Patentave Europiane. Ata mund të ri-emërohen nga Këshilli Administrativ pas konsultimit me Kryetarin e Zyrës së Patentave Europiane.

4. Këshilli Administrativ ushtron autoritet disiplinor mbi punonjësit e përmendur në paragrafët 1 deri 3.

5. Këshilli Administrativ, pas konsultimit me Kryetarin e Zyrës së Patentave Europiane, mund të emërojë gjithashtu si anëtarë të Bordit të Zgjeruar të Apelit anëtarë të kualifikuar ligjërisht të gjykatave të brendshme ose autoriteteve kuazi-gjyqësore të Shteteve Kontraktues, që mund të vazhdojnë aktivitetin e tyre gjyqësor në nivel kombëtar. Ata emërohen për një afat prej tre vitesh dhe mund të ri-emërohen.

¹ Shih vendimet/mendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 5/88, G 7/88, G 8/88, G 1/02 (Aneksi I).

² Shih vendimin e Këshillit Administrativ të datës 06.07.1978 mbi zëvendësimin e Kryetarit të OPE-së (GZ OPE 1978, 326).

³ Amenduar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 12

Detyrimet

Punonjësit e Zyrës së Patentave Europiane janë të detyruar, edhe pas përfundimit të punësimit të tyre, të mos deklarojnë apo përdorin informacionin që nga natyra e tij është sekret profesional.

Neni 13

Mosmarrëveshjet ndërmjet Organizatës dhe punonjësve të Zyrës së Patentave Europiane

1. Punonjësit dhe ish-punonjësit e Zyrës Europiane të Patentave ose pasardhësit e tyre në detyrë mund t'i drejtohen Tribunalit Administrativ të Organizatës Ndërkombëtare të Punës në rastin e mosmarrëveshjeve me Organizatën e Patentave Europiane, në pajtim me Statutin e Tribunalit dhe brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në Rregulloret e Shërbimit për punonjësit e përhershëm ose Rregulloret për Skemën e Pensioneve ose që lindin nga kushtet e punësimit të punonjësve të tjerë.

2. Një ankim është i pranueshëm vetëm nëse personi përkatës ka shteruar të gjitha mjetet e tjera të ankimit që i ofrohen atij sipas Rregulloreve të Shërbimit, Rregulloreve të Skemës së Pensioneve ose kushtet e punësimit.

Neni 14 ^{1,2}

Gjuhët e Zyrës së Patentave Europiane, kërkesave për patentë europiane dhe dokumenteve të tjerë N. 70, 80, 90, 93, 97, 98, 103, 127, 129, R. 3-7, 36, 40, 49, 61, 68, 112

1. Gjuhët zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane janë anglishtja, frëngjishtja dhe gjermanishtja.

2. Një kërkesë për një patentë europiane depozitohet në një prej gjuhëve zyrtare ose, nëse depozitohet në një gjuhë tjetër, përkthehet në një nga gjuhët zyrtare në pajtim me Rregulloret e Zbatimit. Nëpërmjet procedurave përpara Zyrës së Patentave Europiane një përkthim i tillë mund të përputhet me aplikimin e depozituar. Nëse përkthimi i kërkuar nuk depozitohet në kohën e duhur, kërkesa mendohet të jetë tërhequr.

3. Gjuha zyrtare e Zyrës së Patentave Europiane në të cilën depozitohet kërkesa për patentë europiane ose në të cilën ajo është përkthyer do të përdoret si gjuhë e procedimit në të gjitha procedurat para Zyrës së Patentave Europiane, përveç kur Rregulloret Zbatuese parashikojnë ndryshe.

4. Personat fizike ose juridikë që kanë vendbanimin ose vendin e tyre kryesor të veprimtarisë brenda një Shteti Kontraktues që kanë një gjuhë të ndryshme nga gjuha angleze, frënge ose gjermane si gjuhë zyrtare, dhe shtetasit e atij Shteti që janë me vendbanim jashtë shtetit, mund të paraqesin dokumentet që duhet të paraqiten brenda një afati kohor në një gjuhë zyrtare të atij Shteti. Ata duhet të paraqesin një përkthim në një gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane në pajtim me Rregulloret e Zbatimit. Nëse një dokument i ndryshëm nga ato dokumente që përbëjnë një kërkesë për patentë Europiane, nuk paraqitet në gjuhën e parashikuar, ose nëse përkthimi i kërkuar nuk paraqitet në kohë, dokumenti mendohet të mos jetë depozituar.

5. Kërkesat për patentë europiane publikohen në gjuhën e procedimit.

6. Specifikimet e patentave europiane publikohen në gjuhën e procedimit dhe përfshijnë një përkthim të pretendimeve në të dy gjuhët e tjera zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane.

7. Të mëposhtmet publikohen në të tre gjuhët zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane:

a) Buletini i Patentave Europiane;

b) Gazeta Zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane.

8. Shkrimi në Regjistrin e Patentave Europiane bëhen në të tre gjuhët zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane. Në rast dyshimi, shkrimi në gjuhën e procedimit është autentik.

Neni 15³

Departamentet e ngarkuara me procedurën N. 16-22, 143, R. 8-13

Për zbatimin e procedurës së parashikuar në këtë Konventë, brenda Zyrës së Patentave Europiane ngrihen sa më poshtë:

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 6/91, G 2/95 (Aneksi I)

³ Shih mendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/02 (Aneksi I)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- a) Zyra e Pranimit;
- b) Sektori i Kërkimeve;
- c) Sektori i Ekzaminimit;
- d) Sektori i Ankimimeve;
- e) Sektori Juridik;
- f) Bordet e Apelit;
- g) Bordi i Zgjeruar e Apelit

Neni 16¹

Seksioni i Pranimit N. 15 ,R. 10, 11

Zyra e Pranimit është përgjegjëse për shqyrtimin mbi paraqitjen dhe shqyrtimin në lidhje me formalitetet e kërkesave për patentë Europiane.

Neni 17²

Sektori i Kërkimeve N. 15, 92, R. 11, 61-65

Sektori i Kërkimeve është përgjegjës për hartimin e raporteve mbi kërkimet europiane.

Neni 18³

Sektori i Ekzaminimit N. 15, 33, 94, 97, R. 10, 11, 70, 159

1. Sektori i Ekzaminimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për patentë Europiane.

2.⁴ Një Sektor Ekzaminimi përbëhet nga tre ekzaminues të kualifikuar teknikisht. Megjithatë, para marrjes së një vendimi për një kërkesë për patentë europiane, shqyrtimi i saj, si rregull i përgjithshëm, i besohet një anëtari të Sektorit të Ekzaminimit. Procedimi gojor do të zhvillohet para vetë Sektorit të Ekzaminimit. Nëse Sektori i Ekzaminimit mendohet se këtë e kërkon natyra e vendimit, ai mund të zgjerohet duke shtuar një ekzaminues ligjor të kualifikuar. Në rast ndarje votash të barabarta, vota e kryetarit të Sektorit të Ekzaminimit është vendimtare.

Neni 19⁵

Sektori i ankimimeve N. 99, R. 11, 75-89

1. Sektorët e Kundërshtimit janë përgjegjëse për shqyrtimin e kundërshtimeve ndaj një patente europiane.

2. Një Sektor Kundërshtimi përbëhet nga tre ekzaminuese të kualifikuar teknikisht, ku të paktën një prej të cilëve nuk duhet të ketë marrë pjesë në procedimin për dhënien e patentës me të cilën ka të bëjë kundërshtimi. Një ekzaminues që ka marrë pjesë në procedimin për dhënien e një patente europiane nuk mund të jetë Kryetar. Para marrjes së një vendimi mbi kundërshtimin, Sektori i Ankimimeve mund t'ia besojë shqyrtimin e kundërshtimit një prej anëtarëve të tij. Procedimi gojor zhvillohet para vetë Sektorit të Kundërshtimit. Nëse Sektori i Kundërshtimit është i mendimit që e kërkon natyra e vendimit, ai zgjerohet duke shtuar një ekzaminues të kualifikuar ligjor që nuk ka marrë pjesë në procedimin për dhënien e patentës. Në rastin e ndarjes së barabartë të votave, Vota e Kryetarit të Sektorit të Kundërshtimit është vendimtare.

Neni 20⁶

Sektori juridik N. 15, 127, 134, 134a/bis, R. 11

1. Sektori Juridik është përgjegjës për vendimet në lidhje me hyrjet në Regjistrin të Patentave Europiane dhe në lidhje me regjistrimin dhe fshirjen nga lista e përfaqësuesve profesionistë.

¹ Amenduar me aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

² Amenduar me aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

³ Amenduar me aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Shih mendimin e Bordit të Zgjeruar të ankimeve G 1/02 (Aneksi I)

⁵ Shih vendimin/mendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 5/91, G 1.02 (Aneksi I)

⁶ Shih vendimin e Kryetarit të ZPE-së, Botimi i veçantë nr 3, GZ ZPE 2007, G.1.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Vendimet e Sektorit Juridik merren nga një anëtar i kualifikuar ligjor.

Neni 21^{1,2}

Bordi i Apelit N. 11, 15, 106 ; R. 12, 97, 98

1. Bordi i Apelit është përgjegjës për shqyrtimin e ankimeve nga vendimet e Zyrës së Pranimit, Sektorit të Ekzaminimit dhe Sektorit të Ankimit dhe Sektorit Juridik.

2. Për ankimet nga vendimet e Zyrës së Pranimit ose Sektorit Juridik, Bordi i Apelit përbëhet nga tre anëtarë të kualifikuar ligjorë.

3. Për ankimet nga një vendim i Sektorit të Ekzaminimit, Bordi i Apelit përbëhet nga:

a) dy anëtarë të kualifikuar teknikë dhe një anëtar të kualifikuar ligjor, nëse vendimi ka të bëjë me refuzimin e një kërkesë për një patentë europiane ose dhënien, kufizimin ose revokimin e një patente europiane dhe është marrë nga Sektori i Ekzaminimit që përbëhet nga më pak se katër anëtarë;

b) tre anëtarë të kualifikuar teknikë dhe dy ligjorë, nëse vendimi është marrë nga një Sektor Ekzaminimi të përbërë nga katër anëtarë, ose nëse Bordi i Apelit mendon që këtë e kërkon natyra e ankimit;

c) tre anëtarë të kualifikuar ligjorë në të gjitha çështjet e tjera.

4) Për ankimet nga një vendim i një Sektori Kundërshtimi, Bordi i Apelit do të përbëhet nga:

a) dy anëtarë të kualifikuar teknikë dhe një anëtar i kualifikuar ligjor, nëse vendimi është marrë nga një Sektor i Kundërshtimeve i përbërë nga tre anëtarë;

b) tre anëtarë të kualifikuar teknikë dhe dy ligjorë, nëse vendimi është marrë nga një Sektor i Kundërshtimeve që përbëhet nga katër anëtarë, ose nëse Bordi i Apelit mendon se këtë e kërkon natyra e ankimit.

Neni 22³

Bordi i Zgjeruar i Apelit N. 11, 15, 112, 112a/bis ; R. 13

1. Bordi i Zgjeruar i Apelit është përgjegjës për:

a) vendimet në lidhje me çështjet ligjore që i referohen atij nga Bordi i Apelit sipas Nenit 112;

b) dhënien e mendimeve për çështjet ligjore që i referohen atij nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane sipas Nenit 112;

c) vendimet mbi kërkesat për rishikim të vendimeve të Bordit të Apelit sipas Nenit 112a.

2. Në procedimet sipas paragrafit 1(a) dhe (b), Bordi i Zgjeruar i Apelit përbëhet nga pesë anëtarë të kualifikuar ligjorë dhe dy anëtarë të kualifikuar teknikë. Në procedimet sipas paragrafit 1(c), Bordi i Zgjeruar i Apelit përbëhet nga tre ose pesë anëtarë sipas parashikimit në Rregulloret Zbatuese. Në të gjitha procedimet, një anëtar i kualifikuar ligjor është Kryetar.

Neni 23⁴

Pavarësia e anëtarëve të Bordeve R. 12, 13

1. Anëtarët e Bordit të Zgjeruar të Apelit dhe të Bordeve të Apelit emërohen për një afat prej pesë vjetësh dhe nuk mund të largohen nga detyra gjatë këtij afati, përveç kur ka shkaqe serioze për heqjen e tre dhe nëse Këshilli Administrativ, me propozim të Bordit të Zgjeruar të Apelit, merr një vendim për këtë qëllim. Pavarësisht fjalisë 1, kohëzgjatja në detyrë e anëtarëve të Bordeve përfundon nëse ata japin dorëheqje ose dalin në pension në pajtim me Rregulloret e Shërbimit për punonjësit e përhershëm të Zyrës së Patentave Europiane.

2. Anëtarët e Bordeve nuk mund të jenë anëtarë të Zyrës së Pranimit, Sektorit të Ekzaminimit, Sektorit të Ankimit ose Sektorit Juridik.

3. Në vendimet e tyre, anëtarët e Bordeve nuk u nënshtrohen udhëzimeve dhe respektojnë vetëm dispozitat e kësaj Konvente.

4. Rregullat Procedurale të Bordeve të Apelit dhe Bordi i Zgjeruar i Apelit miratohen në pajtim me Rregulloret Zbatuese. Ato i nënshtrohen aprovimit të Këshillit Administrativ⁵.

¹ Amenduar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih Vendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G2/90, G 8/95, G 1/02, G 3/03, Aneksi 1

³ Amenduar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

⁴ Amenduar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

⁵ Shih Rregullat Procedurale të Bordit të Zgjeruar të Ankimeve (GZ ZPE 2007, 303 e në vazhdim). Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 6/95 (Aneksi 1).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 24¹

Përgjashtimi dhe Refuzimi R. 144

1. Anëtarët e Bordeve të Apelit ose të Bordit të Zgjeruar të Apelit nuk mund të marrin pjesë në një çështje në të cilën ata kanë një interes personal, ose nëse ata kanë qenë përfshirë më parë si përfaqësues i një prej palëve, ose nëse ata kanë marrë pjesë në vendimin e ankimit.

2. Nëse për një nga shkaqet e përmendur në paragrafin 1, ose për një arsye tjetër, një anëtar i Bordit të Apelit ose i Bordit të Zgjeruar të Apelit mendon se ai nuk duhet të marrë pjesë në një procedim ankimi, ai informon Bordin përkatës.

3. Anëtarët e Bordit të Apelit ose të Bordeve të Zgjeruar të Apelit mund të përgjashtohen nga çdo palë për një nga shkaqet e përmendur në paragrafin 1, ose nëse dyshohet për anësi. Përgjashtimi është i papranueshëm nëse, duke qenë në dijeni të një shkakut për përgjashtimin, pala ka ndërmarrë një hap procedural. Përgjashtimi nuk mund të bazohet në shtetësinë e anëtarëve të tij.

4. Bordi i Apelit dhe Bordi i zgjeruar i Apelit vendos në lidhje me veprimin që duhet ndërmarrë në rastet e përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3, pa pjesëmarrjen e anëtarët përkatës. Për qëllimet e marrjes së këtij vendimi anëtarët i përgjashtuar zëvendësohen nga zëvendësi i tij.

Neni 25

Ekspertiza teknike

Me kërkesë të gjykatës kombëtare kompetente që shqyrton një padi për një shkelje apo revokim, Zyra e Patentave Europiane është e detyruar që, me pagesën e një tarife të përshtatshme², të japë një ekspertizë teknike në lidhje me patentën europiane që është objekt i padisë. Sektori i Ekzaminimit është përgjegjës për nxjerrjen e këtyre ekspertizave.

KAPITULLI IV

KËSHILLI ADMINISTRATIV

Neni 26

Anëtarësia

1. Këshilli Administrativ përbëhet nga Përfaqësues dhe Përfaqësues zëvendësues të Shteteve Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues ka të drejtë të emërojë një Përfaqësues dhe një Përfaqësues zëvendësues në Këshillin Administrativ.

2. Anëtarët e Këshillit Administrativ, në pajtim me Rregullat Procedurale të Këshillit Administrativ, asistohen nga këshilltarë ose ekspertë.

Neni 27

Kryesia

1. Këshilli Administrativ zgjedh një Kryetar dhe një Zëvendëskryetar nga Përfaqësuesit dhe Përfaqësuesit zëvendësues të Shteteve Kontraktuese. Zëvendëskryetari zëvendëson kryesisht Kryetarin nëse ai pengohet në përmbushjen e detyrave të tij.

2. Afati në detyrë i Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit është tre vjet. Ata mund të rizgjidhen.

Neni 28³

Bordi

1. Nëse janë të paktën tetë Shtete Kontraktues, Këshilli Administrativ mund të formojë një Bord me pesë nga anëtarët e tij.

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 5/91, G 1/05 (Aneksi 1).

² Shih Nenin 2, pika 20, të Rregullave në lidhje me Tarifën.

³ Shih vendimet e Këshillit Administrativ të datës 05.06.2003 që themelojnë Bordin e Këshillit Administrativ (GZ ZPE 2003, 333) dhe të datës 30.10.2003 në lidhje me operimin e Bordit të Këshillit Administrativ (GZ ZPE 2003, 579).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit Administrativ janë anëtarë të Bordit Kryesisht; tre anëtarët e tjerë zgjidhen nga Këshilli Administrativ.
3. Kohëzgjatja në detyrë për anëtarët e zgjedhur nga Këshilli Administrativ është tre vjet. Ata nuk mund të ri-zgjidhen.
4. Bordi përmbush detyrat që i caktohen atij nga Këshilli Administrativ në pajtim me Rregullat Procedurale.

Neni 29

Mbledhjet

1. Mbledhjet e Këshillit Administrativ thirren nga Kryetari.
2. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane merr pjesë në diskutimet e Këshillit Administrativ.
3. Këshilli Administrativ mban një mbledhje të zakonshme çdo vit. Përveç kësaj, ai mbledhet me iniciativën e Kryetarit të tij ose me kërkesë të një të tretën e Shteteve Kontraktuese.
4. Diskutimet në Këshillin Administrativ bazohen në një rend dite dhe mbahen në pajtim me Rregullat Procedurale.
5. Rendi i ditës provizor përmban çdo çështje përfshirja e së cilës është kërkuar nga çdo Shtet Kontraktues në pajtim me Rregullat Procedurale.

Neni 30

Pjesëmarrja e vëzhguesve

1. Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale përfaqësohet në mbledhjet e Këshillit Administrativ në pajtim me një marrëveshje ndërmjet Organizatës dhe Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.
2. Organizata të tjera ndër-qeveritare të ngarkuara me kryerjen e procedurave ndërkombëtare në fushën e patentave, me të cilat Organizata ka përfunduar marrëveshje, përfaqësohen në mbledhjet e Këshillit Administrativ në pajtim me një marrëveshje të tillë.
3. Çdo organizatë tjetër ndër-qeveritare ose ndërkombëtare jo-qeveritare që kryhen një aktivitet me interes për Organizatën mund të ftohet nga Këshilli Administrativ të përfaqësohet në takimet e tij gjatë çdo diskutimi të çështjeve të interesit të përbashkët.

Neni 31

Gjuhët e Këshillit Administrativ

1. Gjuhët e përdorura gjatë diskutimeve në Këshillin Administrativ janë gjuha angleze, frënge dhe gjermane.
2. Dokumentet e paraqitura në Këshillin Administrativ dhe protokollet e diskutimeve të tij përpilohen në të tre gjuhët e specifikuara në paragrafin 1.

Neni 32

Personeli, ambientet dhe pajisjet

Zyra e Patentave Europiane vë në dispozicion të Këshillit Administrativ dhe çdo komiteti të ngritur prej tij personelin, ambientet dhe pajisjet që mund të jenë të nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre.

Neni 33^{1,2}

Kompetenca e Këshillit Administrativ në çështje të caktuara. N. 35; R. 9, 12, 122

1. Këshilli Administrativ ka kompetencë të ndryshojë:
 - a) Afatet kohore të parashikuara në këtë Konventë;
 - b) Pjesët II deri VIII dhe Pjesën X të kësaj Konvente për t'i sjellë ato në pajtim me një traktat ndërkombëtar në lidhje me patentat ose legjislationin e Komunitetit Europian në lidhje me patentat;
 - c) Rregullat Zbatuese.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih vendimet/mendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 5/88, G 7/88, G 8/88, G 6/95, G 1.02 (Aneksi I)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Këshilli Administrativ ka kompetencë, në pajtim me këtë Konventë, të miratojë ose ndryshojë:
 - a) Rregullat Financiare;
 - b) Rregullat e Shërbimit për punonjësit e përhershëm dhe kushtet e punësimit të punonjësve të tjerë të Zyrës së Patentave Europiane, hierarkinë e pagave të këtyre punonjësve të përhershëm ose të tjerë, dhe natyrën e çdo përfitimi shtesë dhe rregullat për dhënien e tyre;
 - c) Rregulloret e Skemës së Pensioneve dhe çdo rritje të përshtatshme në pensionet ekzistuese duke iu përshtatur rritjes së pagave;
 - e) Rregullat në lidhje me Tarifën;
 - e) Rregullat Procedurale.
3. Pavarësisht nga Neni 18, paragrafi 2, Këshilli Administrativ ka kompetencë për të vendosur në dritën e eksperiencës që në disa kategori të caktuara të çështjeve Sektori i Ekzaminimit të përbëhet nga vetëm një ekzaminues i kualifikuar teknik. Këto vendime mund të anulohen.
4. Këshilli Administrativ ka kompetencë të autorizojë Kryetarin e Zyrës së Patentave Europiane për të negociuar dhe me aprovim të Këshillit, të përfundojë marrëveshje në emër të Organizatës së Patentave Europiane me Shtetet, organizatat ndër-qeveritare dhe me qendrat e dokumentacionit të ngritura mbi bazën e marrëveshjeve me këto organizata.
5. Këshilli Administrativ mund të mos marrë një vendim sipas paragrafit 1(b):
 - në lidhje me një traktat ndërkombëtar, para hyrjes së tij në fuqi;
 - në lidhje me legjislationin e Komunitetit Europian, para hyrjes së tij në fuqi ose, nëse ai legjislation parashikon një periudhë për zbatimin e tij, para skadimit të kësaj periudhe.

Neni 34

Të drejtat e votimit

1. E drejta e votimit në Këshillin Administrativ kufizohet në Shtetet Kontraktues.
2. Çdo Shtet Kontraktues ka një votë, përveç rastit kur zbatohet Neni 36.

Neni 35¹

Rregullat e votimit

1. Këshilli Administrativ i merr vendimet, përveç atyre të përmendur në paragrafët 2 dhe 3, me shumicë të thjeshtë të Shteteve Kontraktues të përfaqësues dhe votues.
2. Një shumicë prej tre të katërtat e votave të Shteteve Kontraktuese të përfaqësuar dhe votues kërkohet për vendimet që Këshilli Administrativ ka kompetencë të marrë në bazë të Nenit 7, Neni 11, paragrafi 1, Neni 33, paragrafi 1(a) dhe(c), dhe 2 deri 4, Neni 39, paragrafi 1, Neni 40, paragrafët 2 dhe 4, Neni 46, Neni 134a, Neni 149a, paragrafi 2, Neni 152, Neni 153, paragrafi 7, Neni 166 dhe Neni 172.
3. Unanimiteti i Shteteve Kontraktues votues kërkohet për vendimet që Këshilli Administrativ ka kompetencë të marrë sipas Nenit 33, paragrafi 1(b). Këshilli Administrativ i merr ato vendime vetëm nëse Shtetet Kontraktues janë përfaqësuar. Një vendim i marrë mbi bazën e Nenit 33, paragrafi 1(b), nuk hyn në fuqi nëse një Shtet Kontraktues deklaron, brenda dymbëdhjetë muajsh nga data e vendimit, ai nuk dëshiron të jetë i detyruar nga një vendim i tillë.
4. Abstenimet nuk konsiderohen si vota.

Neni 36

Vlerësimi i votave

1. Në lidhje me miratimin ose ndryshimin e Rregullave në lidhje me Tarifën dhe, nëse kontributi financiar që jepet nga Shtetet Kontraktues kështu do të rritej, miratimin e buxhetit të Organizatës dhe të çdo buxheti amendues ose shtesë, çdo Shtet Kontraktues mund të kërkojë, pas votimit të parë ku secili Shtet Kontraktues ka një votë, dhe çilido qoftë rezultati i kësaj vote, që të mbahet menjëherë një votim i dytë, në të cilin votat u jepen Shteteve sipas paragrafit 2. Vendimi përcaktohet si rezultat i këtij votimi të dytë.
2. Numri i votave që secili Shtet Kontraktues ka në votimin e dytë llogaritet si më poshtë:

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

a) përqindja e marrë për çdo Shtet Kontraktues në lidhje me shkallëzimin për kontributet e veçanta financiare, në pajtim me Nenin 40, paragrafët 3 dhe 4, shumëzohen me numrin e Shteteve Kontraktues dhe pjesëtohet me pesë;

b) numri i votave të dhëna rrumbullakosen deri tek numri më i madh i plotë;

c) këtij numri i shtohen pesë vota shtesë;

d) megjithatë, asnjë Shtet Kontraktues nuk ka më shumë se 30 vota.

KAPITULLI V DISPOZITA FINANCIARE

Neni 37¹

Financimi i buxhetit N. 47, 50

Buxheti i Organizatës financohet:

a) nga burimet e veta të Organizatës;

b) pagesat e bëra nga Shtetet Kontraktuese për tarifat për mbajtjen në fuqi të patentave të vendosura në këta Shtete;

c) nëse është e nevojshme, me kontributet e veçanta financiare të dhëna nga Shtetet Kontraktuese;

d) sipas rastit, nga të ardhurat e parashikuara në Nenin 146;

e) sipas rastit, dhe për sendet pasurore fizike, nga huamarrjet nga palë të treta të siguruar me tokë ose ndërtesa;

f) sipas rastit, nga financimi i palëve të treta për projekte specifike.

Neni 38²

Burimet e veta të Organizatës N. 40

Burimet e veta të Organizatës përbëhen nga:

a) të gjitha të ardhurat nga tarifat dhe burimet e tjera dhe gjithashtu rezervat e Organizatës;

b) burimet e Fondit të Rezervave për Pensionet që trajtohen si një kategori e veçantë sendesh pasurore të Organizatës, të caktuar për të mbështetur skemën e pensioneve të organizatës duke dhënë rezervat e përshtatshme.

Neni 39

Pagesat e Shteteve Kontraktues në lidhje me tarifat e mbajtjes në fuqi të patentave europiane N. 35, 40, 41, 47, 50, 141, 146, 147, 176

1.³ Secili Shtet Kontraktues i paguan Organizatës, për çdo patentë europiane të mbajtur në fuqi në këtë Shtet një shumë të barabartë me një përqindje të asaj tarife, që caktohet nga Këshilli Administrativ; përqindja nuk kalon 75% dhe është e njëjtë për të gjithë Shtetet Kontraktues. Megjithatë, nëse kjo përqindje përputhet me një shumë që është më e vogël se një shumë e njësuar e caktuar nga Këshilli Administrativ, Shteti Kontraktues i paguan Organizatës atë minimum.

2. Secili Shtet Kontraktues i komunikon Organizatës atë informacion që Këshilli Administrativ e konsideron të nevojshëm për të përcaktuar shumën e këtyre pagesave.

3. Datat kur duhet të bëhen këto pagesa duhet të përcaktohen nga Këshilli Administrativ.

4. Nëse një pagesë nuk bëhet e plotë në datën e kërkueshme, Shteti Kontraktues paguan interesin nga data e kërkueshme për shumën e mbetur të papaguar.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

³ Shih vendimin e Këshillit Administrativ të datës 08.06.1984 mbi raportin e tarifave të mbajtjes në fuqi të patentave europiane që i jepen OPE-së (GZ OPE 1984, 296).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 40

Nivelet e tarifave dhe pagesave – Kontributet e veçanta financiare N. 35, 36, 47, 50, 146, 170, 176

1. Shumat e tarifave të përmendura në Nenin 38 dhe përqindja e përmendur në Nenin 39 caktohen në nivel të tillë që të sigurojnë që të ardhurat në lidhje me to të jenë të mjaftueshme për balancimin e buxhetit të Organizatës.

2. Megjithatë, nëse Organizata nuk është në gjendje të balancojë buxhetin e saj sipas kushteve të parashikuara në paragrafin 1, Shtetet Kontraktuese i japin Organizatës kontribute të veçanta financiare, shuma e të cilave përcaktohet nga Këshilli Administrativ për periudhën financiare në fjalë.

3. Këto kontribute të veçanta financiare përcaktohen në lidhje me çdo Shtet Kontraktues mbi bazën e numrit të kërkesave për patentë të depozituara në vitin e parafundit para atij të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe llogariten në mënyrën e mëposhtme:

a) një gjysmë në raport me numrin e kërkesave për patenta të depozituara në atë Shtet Kontraktues;

b) një gjysmë në raport me numrin e dytë më të madh të kërkesave për patenta të depozituara në Shtetet e tjerë Kontraktues nga personat fizikë dhe juridikë që kanë vendbanimin ose vendin kryesor të aktivitetit në atë Shtet Kontraktues. Megjithatë, shumat që kontribuohen nga Shtetet në të cilët numri i kërkesave për patenta të depozituara e kalon 25 000 merren si një e tërë dhe hartohet një shkallëzim i ri në raport me numrin e plotë të kërkesave për patenta të depozituara në këta Shtete.

4. Nëse pozicioni në shkallëzim i një Shteti Kontraktues nuk mund të caktohet në pajtim me paragrafin 3, Këshilli Administrativ, me pëlqimin e atij Shteti, vendos pozicionin e tij në shkallëzim.

5. Neni 39, paragrafët 3 dhe 4, zbatohen *mutatis mutandis* në kontributet e veçanta financiare.

6. Kontributet e veçanta financiare shlyhen me interes që është i njëjtë për të gjithë Shtetet Kontraktues. Shlyerjet bëhen, sa më shpejtë të jetë e mundur e të parashikuar për këtë qëllim në buxhet; shuma e dhënë në këtë mënyrë shpërndahet ndërmjet Shteteve Kontraktues në pajtim me shkallëzimin e përmendur në paragrafët 3 dhe 4.

7. Kontributet e veçanta financiare të paguara në çdo periudhë financiare shlyhen plotësisht para se të shlyhen kontributet ose pjesët e tyre në periudhat pasuese financiare.

Neni 41

Parapagimet N. 50, 146

1. Me kërkesë të Kryetarit të Zyrës së Patentave Europiane, Shtetet Kontraktuese i japin Organizatës parapagime për llogari të pagesave dhe kontributeve të tyre, brenda kufijve të shumave të caktuara nga Këshilli Administrativ. Shumat e këtyre parapagimeve përcaktohen në raport me shumat e kërkueshme prej Shteteve Kontraktuese për periudhën financiare në fjalë.

2. Neni 39, paragrafët 3 dhe 4, zbatohen *mutatis mutandis* për parapagimet.

Neni 42¹

Planifikimi i buxhetit

1. Buxheti i Organizatës është i balancuar. Ai hartohet në pajtim me parimet përgjithësisht të pranuar të parashikuara në Rregulloret Financiare. Nëse është e nevojshme, mund të bëhen buxhete amenduese ose plotësuese.

2. Buxheti hartohet në njësinë llogaritëse që caktohet në Rregullat Financiare.

Neni 43

Autorizimi për shpenzimet

1. Shpenzimet e përfshira në buxhet janë të autorizuar për kohëzgjatjen e një periudhe financiare, përveç kur Rregulloret Financiare parashikojnë ndryshe.

2. Në pajtim me Rregulloret Financiare, çdo burim, i ndryshëm nga ato që kanë të bëjnë me shpenzimet e

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

personelit, i pashpenzuar në fund të periudhës financiare mund të mbartet, por jo tej fundit të periudhës pasuese financiare.

3. Burimet vendosen në zëra të ndryshëm sipas tipit dhe qëllimit të shpenzimeve dhe të nën-ndara, në masën e nevojshme, në pajtim me Rregulloret Financiare.

Neni 44

Burimet për shpenzimet e paparashikuara

1. Buxheti i Organizatës mund të përmbajë arkëtime për shpenzimet e paparashikuara.
2. Përdorimi i këtyre arkëtimeve nga Organizata i nënshtrohet aprovimit paraprak të Këshillit Administrativ.

Neni 45

Periudha financiare

Periudha financiare fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Neni 46

Projektimi dhe miratimi i buxhetit N. 35

1. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane ia paraqet projekt-buxhetin Këshillit Administrativ jo më vonë se data e parashikuara në Rregullat Financiare.
2. Buxheti dhe çdo buxhet amendues dhe shtesë miratohet nga Këshilli Administrativ.

Neni 47

Buxheti provizor N. 146

1. Nëse, në fillim të periudhës financiare, buxheti nuk është miratuar nga Këshilli Administrativ, shpenzimet mund të realizohen me bazë mujore për zëra ose ndarje tjetër buxhetore, në pajtim me Rregullat Financiare, deri në një të dymbëdhjetën e burimeve të buxhetit për periudhën pararendëse financiare, me kusht që burimet që i ofrohen në këtë mënyrë Kryetarit të Zyrës së Patentave Europiane të mos e kalojnë një të dymbëdhjetën e atyre të parashikuara në projekt-buxhet.

2. Këshilli Administrativ, duke respektuar edhe dispozitat e tjera që gjenden në paragrafin 1, mund të autorizojë shpenzime tej një të dymbëdhjetën e burimeve.

3. Pagesat e përmendura në Nenin 37(b) vazhdojnë të bëhen me bazë provizore, në kushtet e përcaktuara sipas Nenit 39 për vitin para atij të cilit i përket projekt-buxheti.

4. Shtetet Kontraktuese paguajnë çdo muaj, me bazë provizore dhe në pajtim me shkallëzimin e përmendur në Nenin 40, paragrafët 3 dhe 4, çdo kontribut financiar të veçantë të nevojshëm për të siguruar zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2. Neni 39, paragrafi 4, zbatohet mutatis mutandis për këto kontribute.

Neni 48

Zbatimi i buxhetit

1. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane zbaton buxhetin dhe çdo buxhet amendues ose shtesë në përgjegjësi të tij dhe brenda kufijve të burimeve dhe caktuara.

2. Brenda buxhetit, Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane, në pajtim me Rregulloret Financiare, mund të transferojë fonde ndërmjet zërave ose nën-zërave të ndryshëm.

Neni 49

Auditimi i llogarive

1. Llogaria e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe bilanci i Organizatës shqyrtohet nga auditët pavarësia e të cilëve është jashtë çdo dyshimi, të emëruar nga Këshilli Administrativ për një periudhë prej pesë vjetësh, që mund të jetë e rinovueshme ose mund të zgjatet.

2. Auditimi do të bazohet në dokumentet e llogarisë dhe kryhet, nëse është e nevojshme, në vend. Auditimi

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

verifikon nëse të gjitha të ardhurat janë marrë dhe shpenzimet janë realizuar në një mënyrë të ligjshme dhe nëse menaxhimi financiar është i shëndetshëm. Auditët hartojnë një raport që përmban një raport të nënshkruar për auditimin pas përfundimit të çdo periudhe financiare.

3. Kryetari i Zyrës së Patentës Europiane i paraqet çdo vit Këshillit Administrativ llogaritë e periudhës pararendëse financiare në lidhje me buxhetin dhe bilancin që tregon sendet pasurore dhe detyrimet e Organizatës së bashku me raportin e auditëve.

4. Këshilli Administrativ aprovon llogaritë vjetore së bashku me raportin e auditëve dhe liron Kryetarin e Zyrës së Patentave Europiane në lidhje me zbatimin e buxhetit.

Neni 50

Rregulloret Financiare N. 33

Rregulloret Financiare parashikojnë sa më poshtë:

- masat në lidhje me krijimin dhe zbatimin e buxhetit dhe për dhënien dhe auditimin e llogarive;
- metodën dhe procedurën nëpërmjet të cilave i ofrohen Organizatës nga Shtetet Kontraktuese pagesat dhe kontributet e parashikuara në Nenin 37 dhe parapagimet e parashikuara në Nenin 41;
- rregullat në lidhje me përgjegjësitë e autorizimit dhe kontabilistëve dhe masat për mbikëqyrjen e tyre;
- interesat e parashikuara në Nenet 39, 40 dhe 47;
- metoda e llogaritjes dhe kontributet e pagueshme në bazë të Nenit 146;
- përbërja dhe detyrat që i caktohen një Komisioni të Buxhetit dhe Financës që duhet të ngrihet nga Këshilli Administrativ;
- parimet përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit mbi të cilat bazohen buxheti dhe pasqyrat financiare vjetore.

Neni 51¹

Tarifat

1. Zyra e Patentave Europiane mund të vendosë tarifa për çdo detyrë ose procedurë zyrtare të kryer në bazë të kësaj Konvente.

2. Afatet për pagesën e tarifave të ndryshme nga ato që janë caktuar nga kjo Konventë përcaktohen në Rregulloret Zbatuese.

3. Nëse Rregulloret Zbatuese parashikojnë që duhet të paguhet një tarifë, ato duhet të parashikojnë edhe pasojat juridike për mospagimin e kësaj tarife në kohën e duhur.

4. Rregullat në lidhje me Tarifat përcaktojnë veçanërisht shumat e tarifave dhe mënyrat në të cilën ato paguhet.

PJESA II

LIGJI I PATENTIMIT SUBSTANCIAL

KAPITULLI I

PATENTUESHMËRIA

Neni 52^{2,3}

Shpikje të patentueshme N. 54, 56, 57, 100, 138; R. 26, 27, 29

1. Patentat europiane jepen për çdo shpikje në të gjitha fushat e teknikës, me kusht që ato të jenë të reja, të përfshijnë një hap shpikës dhe të jenë të zbatueshme në industri.

2. Sipas Nenit 1 nuk merren në konsideratë, veçanërisht:

- zbulimet, teoritë shkencore dhe metodat matematike;
- krijimet estetike;
- skemat, rregullat dhe metodat për kryerjen e veprimeve mendore, luajtjen e lojërave bërjen e biznesit dhe programet e kompjuterëve;

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

³ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/98, G 1/03, G 2/03 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

d) prezantimet e informacionit.

3. Paragrafi 2 përjashton patentueshmërinë e objektit ose aktivitetëve të përmendura në të, vetëm në masën që një kërkesë për një patentë europiane, patentë europiane ka të bëjë me këtë objekt ose aktivitete si të tilla.

Neni 53^{1,2}

Përjashtimet nga patentueshmëria N. 54, 100, 138; R. 28, 29

Patentat europiane nuk jepen në lidhje me:

a) shpikjet, përdorimi tregtar i të cilave do të ishte në kundërshtim me “rendin publik” ose moralitetin; një shfrytëzim i tillë nuk do të konsiderohej të ishte në këtë kundërshti thjesht pasi ndalohet me ligj ose akt nënligjor të disa ose të gjithë Shteteve Kontraktuese;

b) varietetet e bimëve ose kafshëve ose thjesht proceset biologjike për prodhimin e bimëve ose kafshëve; kjo dispozitë nuk zbatohet për proceset mikro-biologjike ose produktet e tyre;

c) metodat për trajtimin e trupit të njeriut ose kafshëve me operacion ose terapi dhe metodat diagnostikuese të praktikuar në trupin e njeriut ose kafshëve; kjo dispozitë nuk zbatohet për produktet, veçanërisht lëndët ose kompozitat, për përdorim në një nga këto metoda.

Neni 54^{3,4}

Risia N. 53, 55, 56, 80, 85, 89, 100, 138, 153; R. 40, 42, 61, 138, 165

1. Një shpikje konsiderohet të jetë e re nëse ajo nuk përbën pjesë e arritjeve të mëparëshme.

2. Arritje të mëparëshme konsiderohet të përbëjë çdo gjë që i ofrohet publikut nëpërmjet një përshkrimi me gojë ose me shkrim, nëpërmjet përdorimit ose në një mënyrë tjetër, para datës së depozitimit të kërkesës për patentë europiane.

3. Po kështu, përmbajtja e kërkesave për patentë europiane të depozituara, datat e depozitimit të të cilave janë para datës së përmendur në paragrafin 2 dhe që janë publikuar në atë ose pas asaj date, konsiderohen të përfshira në arritje të mëparëshme.

4. Paragrafët 2 dhe 3 nuk përjashtojnë patentueshmërinë e asnjë substance ose kompozite, të përfshirë në arritje të mëparëshme, për përdorim në metodën e përmendur në Nenin 53(c), me kusht që përdorimi i saj për çdo metodë të tillë të mos konsiderohet i përfshirë si arritje të mëparëshme.

5. Paragrafët 2 dhe 3 nuk përjashtojnë as patentueshmërinë e asnjë substance ose kompozite të përmendur në paragrafin 4 për çdo përdorim specifik në një metodë të përmendur në Nenin 53(c), me kusht që një përdorim i tillë të mos përfshihet në arritjet e mëparëshme.

Neni 55

Deklarimet e padëmshme N. 100, 138; R. 25, 159

1. Për zbatimin e Nenit 54, një deklaram i shpikjes nuk do të merret në konsideratë nëse ka ndodhur jo më parë se gjashtë muaj para depozitimit të kërkesës për patentë europiane dhe nëse ishte për shkak të, ose si pasojë e:

a)⁵ një abuzimi të dukshëm në lidhje me kërkuesin ose përfaqësuesin e tij ligjor, ose

b) faktit që kërkuesi ose përfaqësuesi i tij ligjor ka treguar shpikjen në një ekspozitë ndërkombëtare zyrtare ose të njohur zyrtarisht brenda termave të Konventës mbi ekspozitat ndërkombëtare të nënshkruar në Paris më 22 nëntor 1928 dhe rishikuar së fundi më 30 nëntor 1972.

2. Në rastin e paragrafit 1 (b), paragrafi 1 zbatohet vetëm nëse shtetet kërkuese, gjatë depozitimit të kërkesës për patentë europiane, deklarojnë që shpikja është treguar faktikisht dhe depoziton një certifikatë shoqëruese brenda afatit kohor dhe në kushtet e parashikuara në Rregulloret e Zbatimit.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/95, G 1/98, G 1/03, G 2/03 G 1/04 (Aneksi I).

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/88, G 6/88, G 1/92, G 3/93, G 1/98, G 2/98, G 3/98, G 2/99, G 1/03, G 2/03 (Aneksi I).

⁵ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/98, G 2/99 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 56¹

Hapi shpikës N. 52, 100, 138; R. 30, 42, 61

Një shpikje konsiderohet të përfshijë një hap shpikës nëse, duke patur parasysh arritjet e mëparëshme nuk është e dukshme për një person të aftësuar në atë fushë. Nëse arritjet e mëparëshme përfshin gjithashtu dokumente brenda kuptimit të Nenit 54, paragrafi 3, këto dokumente nuk merren parasysh gjatë vendim-marrjes nëse ka patur një veprimtari shpikëse.

Neni 57²

Zbatimi industrial N. 52, 100, 138; R. 29, 30, 42

Një shpikje konsiderohet të jetë e përshtatshme për zbatim industrial nëse ajo mund të bëhet ose përdoret në një lloj industrie, duke përfshirë bujqësinë.

KAPITULLI II

PERSONAT QË KANË TË DREJTË TË KËRKOJNË DHE MARRIN PATENTË EUROPIANE – PËRMENDJA E SHPIKËSIT

Neni 58³

E drejta për të depozituar një kërkesë për patentë europiane

Një kërkesë për patentë europiane mund të depozitohet nga një person fizik ose juridik, ose çdo subjekt i barasvlershëm me një person juridik në bazë të ligjit që e rregullon atë.

Neni 59

Disa kërkesues N. 118, R. 41, 72, 151

Kërkesa për patentë europiane mund të depozitohet gjithashtu edhe nga kërkesues të përbashkët ose nga dy ose më shumë kërkesues që u përkasin Shteteve të ndryshëm Kontraktues.

Neni 60^{4,5}

E drejta për një patentë europiane N. 61, 80, 89, 138; R. 40

1. E drejta për një patentë europiane i takon shpikësit ose pasardhësit të tij në titull. Nëse shpikësi është i punësuar, e drejta për një patentë europiane përcaktohet në pajtim me ligjin e Shtetit në të cilin i punësuar ka punësimin e tij kryesor; nëse Shteti në të cilin punonjësi ka punësimin kryesor nuk mund të përcaktohet, ligji që zbatohet është ai i Shtetit në të cilin punëdhënësi ka vendin e aktivitetit tregtar të cilit i përket i punësuar.

2. Nëse dy ose më shumë persona kanë bërë një shpikje të pavarur nga njëri-tjetri, e drejta për një patentë europiane i takon personit kërkesa e të cilit për patentë europiane ka datën më të hershme të depozitimit, me kusht që kjo kërkesë e parë të jetë publikuar.

3. Në procedimet para Zyrës së Patentave Europiane, kërkesesi mendohet të ketë të drejtë të ushtrojë të drejtën për një patentë europiane.

¹ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/98, G 3/98, G 2/99, G 1/03, G 2/03 (Aneksi I).

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/03, G 2/03, G 1/04 (Aneksi I).

³ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/99, G 2/04 (Aneksi I).

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁵ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/92, G 2/98, G 1/03, G 2/03 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 61^{1,2}

Kërkesat për patentë europiane të depozituara nga personat që nuk e kanë të drejtën N. 100, 128, 138; R. 6, 14-18, 45, 51, 60, 78, 136, 143, 147

1. Nëse vendoset me vendim të formës së prerë që një person i ndryshëm nga kërkuesi ka të drejtën për marrjen e patentës europiane, ky person, në pajtim me Rregulloret Zbatuese, mund:

- a) të vazhdojë kërkesën për patentë europiane si kërkesën e tij në vend të kërkuesit;
- b) të paraqesë një kërkesë të re për patentë europiane në lidhje me të njëjtën shpikje, ose
- c) të kërkojnë që të refuzohet kërkesa për patentë europiane.

2. Neni 76, paragrafi 1, zbatohet mutatis mutandis për një kërkesë të re të patentës europiane të depozituar sipas paragrafit 1(b).

Neni 62

E drejta e shpikësit për t'u përmendur N. 81; R. 19-21, 60, 143

Shpikësi ka të drejtën, nëpërmjet kërkuesit ose pronarit të një patente europiane të përmendet si i tillë para Zyrës së Patentës Europiane.

KAPITULLI III

EFEKTET E PATENTËS EUROPIANE DHE KËRKESA PËR PATENTË EUROPIANE

Neni 63³

Kohëzgjatja e Patentës Europiane N. 2

1. Kohëzgjatja e patentës europiane është 20 vjet nga data e depozitimit të kërkesës.
2. Asgjë në paragrafin e mësipërm nuk e kufizon të drejtën e një Shteti Kontraktues për të zgjatur afatin e një patente europiane ose t'i dhënë mbrojtjen e nevojshme që pason menjëherë kohëzgjatjen e patentës, në të njëjtat kushtet si për ato që zbatohen për patentat e kombetare:
 - a) me qëllim që të merret parasysh gjendja e luftës ose kushtet e ngjashme të emergjencës që cenojnë atë Shtet;
 - b) nëse objekti i patentës europiane është një produkt ose proces për prodhimin e një produkti ose përdorim i një produkti që duhet t'i nënshtrohet një procedure administrative të kërkuar me ligj para se të futen në tregun e atij Shteti.
3. Paragrafi 2 zbatohet mutatis mutandis për patentat europiane të dhëna së bashku për një grup Shtetesh Kontraktuese në pajtim me Nenin 142.
4. Një Shtet Kontraktues që merr masa për zgjatjen e afatit ose mbrojtjes përkatëse sipas paragrafit 2(b), në pajtim me një marrëveshje të përfunduar me Organizatën, mund t'i ngarkojë Zyrës së Patentave Europiane detyra në lidhje me zbatimin e dispozitave përkatëse.

Neni 64⁴

Të drejtat nga një patentë europiane N. 2, 67, 68, 97

1. Një patentë europiane, në pajtim me dispozitat e paragrafit 2, i jep pronarit të saj nga data në të cilën përmendja e dhënies së saj publikohet në Buletinin e Patentave Europiane, në secilin Shtet Kontraktues në lidhje me të cilët është dhënë, të njëjtat të drejta që do të jepeshin nga një patentë e brendshme të dhënë në atë Shtet.
2. Nëse objekti i një patente europiane është një proces, mbrojtja e dhënë nga patentat shtrihet tek produktet të përfutuara drejtpërdrejt nga ky proces.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/92 (Aneksi I).

³ Amenduar nga akti rishikues i Nenit 63 të KPE-së, të datës 17.12.1991, që ka hyrë në fuqi në datën 04.07.1997 (GZ OPE 1992, 1 e në vazhdim).

⁴ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/88, G 1/98 (Aneks).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Çdo shkelje e një patente Europiane trajtohet sipas ligjit kombëtar.

Neni 65¹

Përkthimi i patentës europiane N. 2, 70; R. 71, 82

1. Çdo Shtet Kontraktues, nëse patentë europiane është dhënë, amenduar ose kufizuar nga Zyra e Patentave Europiane nuk është përpiluar në një nga gjuhët zyrtare, mund të parashikojë që pronari i patentës t'i paraqesë zyrës së tij qendrore të pronësisë industriale një përkthim të patentës sic është dhënë, ndryshuar ose kufizuar në një nga gjuhët zyrtare sipas zgjedhjes të tij, ose nëse ai Shtet ka parashikuar përdorimin e një gjuhe specifike zyrtare, në atë gjuhë. Afati për dorëzimin e përkthimit përfundon tre muaj pas datës në të cilën publikohet përmendja e dhënies, ruajtjes në formë të ndryshuar ose kufizimi i patentës Europiane në Buletinin e Patentave Europiane, përveç kur Shteti përkatës parashikon një periudhë më të gjatë.

2. Çdo Shtet Kontraktues që ka miratuar masa në pajtim me paragrafin 1 mund të parashikojë që pronari i patentës të paguajë të gjitha ose një pjesë të shpenzimeve për publikimin e këtij përkthimi brenda një periudhë të parashikuar nga ai Shtet.

3. Çdo Shtet Kontraktues mund të parashikojë që në rastin e mosrespektimit të masave të miratuara në pajtim me paragrafët 1 dhe 2, patentë europiane do të konsiderohet të jetë i pavlefshme në atë Shtet ab initio.

Neni 66^{2,54}

Ekuivalenca e depozitimit Europian me depozitim kombëtar N. 80, 87, 88, 135, 137, 140; R. 40, 155

Një kërkesë për patentë europiane që i është dhënë një datë depozitimi, në Shtetin Kontraktues të caktuar, është ekuivalente me një depozitim të rregullt kombëtar, duke pretenduar sipas rastit prioritetin e kërkesës për patentë europiane.

Neni 67^{3,4}

Të drejtat nga një kërkesë për patentë europiane pas publikimit N. 68, 70, 93, 153 ;R. 68

1. Një kërkesë për patentë europiane, nga dita e publikimit të saj, i jep kërkuarit përkohësisht mbrojtjen e parashikuar në Nenin 64 në Shtetet Kontraktuese të caktuara në kërkesë.

2. Çdo Shtet Kontraktues mund të parashikojë që një kërkesë për patentë europiane të mos e sigurojë këtë mbrojtje që parashikohet në Nenin 64. Megjithatë, mbrojtja që ka të bëjë me publikimin e kërkesës për patentë europiane nuk mund të jetë më e ulët se ajo që ligjet e atij Shteti përkatës parashikojnë për publikimet e detyruara të kërkesave për patenta kombëtare të pashqyrtuara. Në çdo rast, secili Shtet siguron të paktën që nga data e publikimit të një kërkesë për patentë europiane, që kërkuari të mund të pretendojë kompensim të arsyeshëm sipas rrethanave nga çdo person që ka përdorur shpikjen në atë shtet në rrethanat ku ai person do të ishte përgjegjës në bazë të ligjeve të kombëtare për shkeljen e një patente europiane.

3. Çdo Shtet Kontraktues ku gjuha e procedimit nuk është gjuhë zyrtare mund të parashikojë që mbrojtja e përkohshme në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të mësipërm të mos jetë në fuqi deri në momentin që përkthimi i pretendimeve në një prej gjuhëve të tij zyrtare sipas zgjedhjes së kërkuarit ose, nëse ai Shtet ka parashikuar përdorimin e një gjuhe specifike zyrtare, në atë gjuhë:

a) i është ofruar publikut në mënyrën e parashikuar sipas ligjit të kombëtar, ose

b) i është komunikuar personit që përdor shpikjen në atë Shtet.

4. Kërkesa për patentë europiane mendohet të mos ketë asnjëherë efektet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 nëse ajo tërhiqet, mendohet të jetë tërhequr ose refuzohet përfundimisht. E njëjta vlen në lidhje me efektet e kërkesës për patentë europiane në një Shtet Kontraktues përcaktimi i të cilit është tërhequr ose mendohet të jetë tërhequr.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih mendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 4/98 (Aneksi I).

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Shih mendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 4/98 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 68¹

Efektet e rikthimit ose kufizimit të patentës europiane N. 2, 101, 105b/ter

Kërkesa për patentë europiane dhe patenta europiane konsiderohet të mos ketë patur nga fillimi efektet e parashikuara në Nenet 64 dhe 67, në masën që patenta është rikthyer ose kufizuar në procedimet e kundërshtimit, kufizimit apo revokimit.

Neni 69^{2,3}

Fusha e mbrojtjes N. 2, 164

1. Masa e mbrojtjes së dhënë nga një patentë europiane ose një kërkesë për një patentë europiane përcaktohet në bazë të pretendimeve. Megjithatë, përshkrimi dhe skicat do të përdoren për të interpretuar pretendimet.

2. Për periudhën deri në dhënien e patentës europiane, masa e mbrojtjes së dhënë nga kërkesa për patentë europiane përcaktohet në bazë të pretendimeve që gjenden në kërkesën e publikuar. Megjithatë, patenta europiane e dhënë ose e ndryshuar në procedimet e kundërshtimit, kufizimit ose rikthimit përcakton me fuqi prapavepruese mbrojtjen e dhënë nga kërkesa, në masën që kjo mbrojtje nuk jepet nga kjo e fundit.

Neni 70⁴

Teksti autentik i një kërkesë për patentë europiane ose patente europiane N. 2 ; R. 7

1. Teksti i një kërkesë për patentë europiane ose një patentë europiane në gjuhën e procedimit është tekst autentik në çdo procedim para Zyrës së Patentave Europiane dhe në çdo Shtet Kontraktues.

2. Megjithatë, nëse kërkesa për patentë europiane është depozituar në një gjuhë që nuk është gjuhë zyrtare e Zyrës së Patentave Europiane, ai tekst do të jetë kërkesa që depozitohet sipas kuptimit të kësaj Konvente.

3. Çdo Shtet Kontraktues mund të parashikojë që një përkthim në një prej gjuhëve të tij zyrtare, të parashikuar prej tij sipas kësaj Konvente, të konsiderohet në atë Shtet autentik, përveç procedimit të rikthimit, në rastin e kërkesës për patentë europiane ose patentës europiane në gjuhën e përkthimit që jep një mbrojtje më të ngushtë se ai që jepet nga gjuha e procedimit.

4. Çdo Shtet Kontraktues që miraton një dispozitë sipas paragrafit 3:

a) i lejon kërkesit ose pronarit të patentës të depozitojë një përkthim të korrigjuar të kërkesës për patentë europiane ose patentë europiane. Ky përkthim i korrigjuar nuk ka asnjë efekt ligjor nëse nuk respektohet ndonjë nga kushtet e përcaktuara nga Shteti Kontraktues sipas Nenit 65, paragrafi 2, ose Neni 67, paragrafi 3;

b) mund të parashikojë që çdo person që, në atë Shtet, në mirëbesim ka përdorur ose ka bërë përgatitje efikase dhe serioze për përdorimin e shpikjes përdorimi i së cilës nuk do të përbënte shkelje të kërkesës ose patentës në përkthimin origjinal, pasi të ketë hyrë në fuqi përkthimi i korrigjuar, mund të vazhdojë përdorimin në kuadrin e biznesit të tij ose për nevojat e tij pa pagesë.

KAPITULLI IV

KËRKESA PËR PATENTË EUROPIANE SI OBJEKT PASUROR

Neni 71

Transferimi dhe lindja e të drejtave R. 22, 23, 85

Një kërkesë për patentë europiane mund të transferohet ose të shkaktojë lindjen e të drejtave për një ose më shumë nga Shtetet e caktuara Kontraktues.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000. Protokolli mbi Interpretimin e Nenit 69 KPE (shih f 431) është pjesë përbërëse e Konventës në pajtim me Nenin 164, paragrafi 1).

³ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/88, G 6/88 (Aneksi I).

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 72

Transferimi me veprim juridik R. 22, 85

Një transferim me veprim juridik i një kërkesë për patentë europiane bëhet me shkrim dhe duhet të ketë firmën e palëve në kontratë.

Neni 73

Licencimi kontraktual R. 23, 24

Një kërkesë për patentë europiane mund të licencohet plotësisht ose pjesërisht për të gjithë ose një pjesë të territoreve të Shteteve të caktuar Kontraktuese.

Neni 74

Ligji i zbatueshëm N. 148

Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Konventë, kërkesa për patentë europiane si objekt pasuror, në çdo Shtet Kontraktues të caktuar dhe me fuqi për këtë Shtet, i nënshtrohet ligjit të zbatueshëm në atë Shtet për kërkesat për patenta kombëtare.

PJESA III

KËRKESA PËR PATENTË EUROPIANE

KAPITULLI I

DEPOZITIMI DHE KUSHTET E KËRKESËS PËR PATENTË EUROPIANE

Neni 75¹

Depozitimi i një kërkesë për patentë europiane N. 76, 120, 130, 153 ; R. 35, 41, 133, 134, 147

1. Një kërkesë për patentë europiane mund të depozitohet:

a) ² tek Zyra e Patentave Europiane, ose

b) nëse ligji i një Shteti Kontraktues e lejon, dhe në pajtim me Nenin 76, paragrafi 1, tek zyra qendrore e pronësisë industriale ose një autoritet tjetër kompetent i atij Shteti. Çdo kërkesë që depozitohet në këtë mënyrë do të ketë të njëjtin efekt sikur të depozitohet në të njëjtën datë tek Zyra e Patentave Europiane.

2. Paragrafi 1 nuk përjashton zbatimin e masave legjislative ose rregullatore që, në një Shtet Kontraktues:

a) rregullojnë shpikjet që, sipas natyrës së objektit të tyre, nuk mund të komunikohet jashtë shtetit pa autorizimin paraprak të autoriteteve kompetente të atij Shteti, ose

b) parashikojnë që çdo kërkesë duhet të depozitohet fillimisht tek një autoritet kombëtar, ose të bëhet depozitim i drejtpërdrejtë tek një autoritet tjetër duke iu nënshtruar autorizimit paraprak.

Neni 76^{3,4}

Kërkesat e ndarë për patente europiane N. 61, 75, 100, 128, 138; R. 4, 6, 16, 36, 41, 45, 51, 60, 143, 147

1. Një kërkesë e ndarë për patentë europiane depozitohet drejtpërdrejt tek Zyra e Patentave Europiane në pajtim me Rregulloret e Zbatimit. Ajo mund të depozitohet vetëm në lidhje me objektin dhe nuk del tej përmbajtjes së kërkesës së mëparshme të depozituar; nëse kjo kërkesë respektohet, kërkesa e pjesshme konsiderohet të jetë bërë në datën e depozitimit të kërkesës së mëparshme dhe gëzon të drejtën e prioritetit.

2. Të gjithë Shtetet Kontraktuese të caktuar në kërkesën e mëparshme në momentin e depozitimit të një kërkesë të pjesshme europiane konsiderohen të jenë të caktuar në kërkesën e pjesshme.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih vendimin e Kryetarit të OPE-së, Botimi i veçantë nr 3, GZ OPE 2007, A.1.

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Shih vendimin/opinionin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 4/98, G 1/05 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 77¹

Transmetimi i kërkesave për patentë europiane N. 135, 137; R. 35, 37, 45, 112, 134, 155

1. Zyra qendrore e pronësisë industriale e një Shteti Kontraktues ia transmeton Zyrës së Patentave Europiane çdo kërkesë për patentë europiane të depozituar tek ajo ose çdo autoritet tjetër kompetent në atë Shtet, në pajtim me Rregulloret e Zbatimit.
2. Një kërkesë për patentë europiane objekti i së cilës është klasifikuar sekret nuk i transmetohet Zyrës së Patentave Europiane.
3. Një kërkesë për patentë europiane që nuk i transmetohet Zyrës së Patentave Europiane në kohën e duhur konsiderohet të jetë tërhequr.

Neni 78²

Kushtet e një kërkesë për patentë europiane N. 79, 80, 83-85, 90, 121; R. 6, 17, 31-33, 36, 38-50, 135, 139

1. Një kërkesë për patentë europiane përmban:
 - a) një kërkesë për dhënien e një patente europiane;
 - b) një përshkrim të shpikjes;
 - c) një ose më shumë pretendime;
 - d) çdo skicë të përmendur në përshkrimin e pretendimeve;
 - e) një përmbledhje,dhe përmbush kërkesat e parashikuara në Rregulloret Zbatuese.
2. Një kërkesë për patentë europiane i nënshtrohet pagesës së tarifës së depozitimit dhe tarifës së kërkimit. Nëse tarifa e depozitimit ose tarifa e kërkimit nuk paguhet në kohën e duhur, kërkesa konsiderohet të jetë tërhequr.

Neni 79³

Caktimi i Shteteve Kontraktues N. 3, 66, 80, 121, 149 R. 15-17, 36, 39, 40, 41, 70, 71, 72, 112, 135, 139, 143, 159, 160

1. Të gjithë Shtetet Kontraktues palë në këtë Konventë në momentin e depozitimit të kërkesës për patentë europiane konsiderohen të jenë emëruar në kërkesën për dhënien e një patente europiane.
- 2.⁴ Caktimi i një Shteti Kontraktues mund t'i nënshtrohet pagesës së një tarife emërimi.
3. Caktimi i një Shteti Kontraktues mund të tërhiqet në çdo kohë deri në dhënien e një patente europiane.

Neni 80^{5,6}

Data e depozitimit N. 54, 60, 66, 78, 79, 83, 84, 90, 92 R. 19, 30, 38, 39, 40-42, 49, 55, 56, 60, 143

Data e depozitimit të një kërkesë për patentë europiane është data në të cilën përmbushen formalitetet e parashikuara në Rregulloret Zbatuese.

Neni 81

Përmendja e shpikësit N. 62, 90; R. 19-21, 41, 60, 143, 144, 163

Kërkesa për patentë europiane duhet të përmend shpikësin. Nëse kërkuesi nuk është shpikësi ose nuk është shpikësi i vetëm, caktimi përmban një deklaratë që tregon origjinën e së drejtës për patentë europiane.

Neni 82⁷

Njësimi i shpikjes R. 43, 44, 64, 164

Kërkesa për patentë europiane ka të bëjë vetëm me një shpikje ose me një grup shpikjesh të lidhura në mënyrë të tillë që përbëjnë një koncept të vetëm të përgjithshëm shpikjeje.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Shih mendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 4/98, (Aneksi 1)

⁵ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁶ Shih vendimin/opinionin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/95, G 4/98, G 1/05 (Aneksi 1)

⁷ Shih vendimin/opinionin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/91, G 2/92 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 83¹

Deklarimi i shpikjes N. 78, 80, 100, 138; R. 31-34, 40, 42

Kërkesa për patentë europiane deklaron shpikjen në një mënyrë të qartë dhe të plotë në masë të mjaftueshme për t'u zbatuar nga një person i aftësuar në këtë fushë.

Neni 84²

Pretendimet N. 78, 80; R. 40, 43, 45, 49, 57, 162

Pretendimet përkufizojnë çështjen për të cilën kërkohet mbrojtja. Ato janë të qarta dhe të prera dhe mbështeten nga përshkrimi.

Neni 85

Përmbledhja N. 78; R. 47, 49, 66, 68

Përmbledhja i shërben vetëm qëllimit të informacionit teknik; ajo nuk mund të merret parasysh për asnjë qëllim tjetër, veçse për interpretimin e objektit të mbrojtjes së kërkuar ose zbatimin e Nenit 54, paragrafi 3.

Neni 86³

**Tarifat e mbajtjes në fuqi të kërkesave për patenta europiane
N. 122, 141; R. 14, 51, 71, 112, 135, 136, 142, 159**

1. Tarifat mbajtjes në fuqi për kërkesat për patenta europiane i paguhen Zyrës së Patentave Europiane në pajtim me Rregulloret e Zbatimit. Këto tarifa kërkohen në lidhje me vitin e tretë dhe çdo vit pauses të llogaritur nga data e depozitimit të kërkesës. Nëse një tarifë e mbajtjes në fuqi nuk paguhet në kohën e duhur, kërkesa konsiderohet të jetë tërhequr.

2. Detyrimi për të paguar tarifat e mbajtjes në fuqi pushon me pagesën e tarifës së mbajtjes në fuqi në lidhje me vitin në të cilin fakti i dhënies së patentës europiane është publikuar në Buletinin e Patentave Europiane.

KAPITULLI II PRIORITETI

Neni 87^{4,5}

E drejta e prioritetit N. 66, 122; R. 52, 57-59, 136

1. Çdo person që ka depozituar rregullisht në ose për
 - a) çdo Shtet palë në Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale, ose
 - b) çdo Anëtar të Organizatës Botërore të Tregtisë, një kërkesë për një patentë, model përdorimi ose certifikatë përdorimi, apo pasuesi i tij në titull, gëzon, për qëllimin e depozitimit të një kërkesë për patenta europiane në lidhje me të njëjtën shpikje, një të drejtë prioriteti gjatë një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh nga data e depozitimit të kërkesës së parë.
2. Çdo depozitim që është i barasvlershëm me një depozitim të rregullt kombëtar sipas ligjit kombëtar të Shtetit ku ai është bërë ose sipas marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, duke përfshirë këtë Konventë, duhet të konsiderohet të sjellë të drejtën e prioritetit.
3. Një depozitim i rregullt kombëtar është çdo depozitim që është i mjaftueshëm për të përcaktuar datën në të cilën është bërë kërkesa, cildo qoftë rezultati i kërkesës.
4. Një kërkesë pasuese në lidhje me të njëjtin objekt si një kërkesë e mëparshme dhe të depozituar tek dhe për të njëjtin Shtet konsiderohet si kërkesa e parë për qëllimin e përcaktimit të prioritetit, me kusht që, në datën e depozitimit të kërkesës pasuese, kërkesa e mëparshme të jetë tërhequr, hequr dorë ose refuzuar, pa qenë e hapur për inspektim publik dhe kur të drejtat nuk mbeten në fuqi, dhe të mos ketë shërbyer si bazë për

¹ Shih vendimin/opinionin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/93, G 2/98 (Aneksi 1)

² Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/98, G 1/03, G 2/03, G 1/04 (Aneksi 1)

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁵ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/93, G 2/95, G 2/98, G 1/03, G 2/03 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

pretendimin e së drejtës së prioritetit. Kërkesa e mëparshme pas kësaj nuk mund të shërbejë si bazë për të pretenduar të drejtën e prioritetit.

5. Nëse depozitimi i parë është bërë tek një autoritet i pronësisë industriale që nuk i nënshtrohet Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale ose Marrëveshjes Themeluese të Organizatës Botërore të Tregtisë, zbatohen paragrafët 1 deri 4 nëse ai autoritet, në pajtim me një komunikim të nxjerrë nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane, njeh që depozitimi i parë i bërë tek Zyra e Patentave Europiane sjell një të drejtë prioriteti në kushtet dhe me pasojat e barasvlershme me ato të parashikuara në Konventën e Parisit.

Neni 88^{1,2}

Pretendimi prioritetit

1. Një kërkesë që dëshiron të përfitojë nga prioriteti i një kërkesë të mëparshme depoziton një deklaratë prioriteti dhe çdo dokument tjetër të kërkuar, në pajtim me Rregulloret Zbatuese.

2. Në lidhje me një kërkesë për patentë europiane mund të pretendohen disa prioritete, pavarësisht faktit që ata e kanë origjinën në vende të ndryshme. Sipas rastit, për çdo pretendim mund të pretendohen disa prioritete. Nëse pretendohen disa prioritete, afatet kohore që ecin nga data e prioritetit fillojnë të ecin nga data më e hershme e prioritetit.

3. Nëse në lidhje me një kërkesë për patentë europiane pretendohet një ose disa prioritete, e drejta e prioritetit mbulon vetëm ato elementë të kërkesës për patentë europiane që përfshihen në kërkesë ose kërkesa prioriteti i të cilave pretendohet.

4. Nëse elementë të caktuar të një shpikjeje për të cilën pretendohet prioriteti nuk gjenden tek pretendimet e formuluar në kërkesën e parë, prioriteti megjithatë jepet, me kusht që dokumentet e kërkesës së mëparshme, si një e tërë, të shprehë në mënyrë të veçantë këta elementë.

Neni 89³

Efekti i së drejtës së prioritetit

E drejta e prioritetit ka efektin që data e prioritetit llogaritet si data e depozitimit të kërkesës për patentë europiane për qëllimet e Nenit 54, paragrafi 2 dhe 3, dhe Neni 60, paragrafi 2.

PJESA IV

PROCEDURA DERI TE DHËNIA

Neni 90^{4,5}

Verifikimi i hyrjes së kërkesës dhe ekzaminimi formal N. 16, 78, 80, 88, 92

R. 6, 10, 38, 40, 45, 53, 55-60, 111-113, 137, 139, 140, 142, 152, 153

1. Zyra e Patentave Europiane shqyrton, në pajtim me Rregulloret Zbatuese, nëse kërkesa përmbush kushtet për njohjen e një date depozitimi.

2. Nëse një datë depozitimi nuk mund të caktohet pas shqyrtimit sipas paragrafit 1, kërkesa nuk trajtohet si një kërkesë për patentë europiane.

3. Nëse kërkesës për patentë europiane i është caktuar një datë depozitimi, Zyra e Patentave Europiane shqyrton, në pajtim me Rregulloret e Zbatimit, nëse janë përmbushur kërkesat e Neneve 14, 78 dhe 81, dhe sipas rastit, Nenit 88, paragrafi 1, dhe Nenit 133, paragrafi 2, si dhe kërkesat e tjera të parashikuara në Rregulloret e Zbatimit.

4. Nëse Zyra e Patentave Europiane gjatë kryerjes së shqyrtimit sipas paragrafëve 1 ose 3 vë re që ka mungesa që mund të korrigjohen, ajo i jep mundësi kërkuarit t'i korrigjojë ato.

5. Nëse një mungesë e evidentuar gjatë shqyrtimit sipas paragrafit 3 nuk korrigjohet, kërkesa për patentë europiane refuzohet, nëse në këtë Konventë nuk parashikohet një pasojë e ndryshme ligjore. Nëse një mungesë ka të bëjë me një të drejtë prioriteti, kjo e drejtë humbet për kërkesën.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih vendimin/opinionin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/93, G 2/98 (Aneksi 1)

³ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/93, G 2/98, G 3/98, G 2/99 (Aneksi 1)

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁵ Shih opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 4/98, G 1/02 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 91¹

(shfuqizuar)

Neni 92²

Përpilimi i raportit europian të hulumtimit N. 17, 80, 153; R. 30, 61-66, 70, 137

Zyra e Patentave Europiane, në pajtim me Rregulloret Zbatuese, përpilon dhe publikon një raport europian kërkimi në lidhje me kërkesën për patentë europiane në bazë të pretendimeve, duke i kushtuar rëndësinë e duhur përshkrimit dhe çdo skicimi.

Neni 93^{3,4}

Publikimi i kërkesës për patentë europiane

N. 14, 16, 54, 67, 69, 88, 92, 98, 115, 127, 128, 153 ; R. 10, 14, 20, 47, 48, 52, 53, 66-69, 114, 143

1. Zyra e Patentave Europiane publikon kërkesën për patentë europiane sa më shpejt të jetë e mundur:
 - a) pas skadimit të një afati prej tetëmbëdhjetë muajsh nga data e depozitimit, ose nëse është pretenduar prioritet, nga data e prioritetit, ose
 - b) me kërkesë të kërkuarit, para skadimit të këtij afati.
2. Kërkesa për patentë europiane publikohet në të njëjtën kohë si dhe specifikimi i patentës europiane nëse vendimi për dhënien e patentës hyn në fuqi para skadimit të periudhës së përmendur në paragrafin 1(a).

Neni 94⁵

Shqyrtimi i kërkesës për patentë europiane

N. 18, 121, 129, 150; R. 6, 10, 69, 70, 71, 112-114, 135-138, 142, 159

1. Zyra e Patentave Europiane, në pajtim me Rregulloret Zbatuese, shqyrton nëse kërkesa për patentë europiane dhe shpikja që lidhet me të përmbushin kërkesat e kësaj Konvente. Kërkesa konsiderohet të jetë paraqitur në momentin e pagesës së tarifës së shqyrtimit.
2. Nëse kërkesa për shqyrtim nuk bëhet në kohën e duhur, kërkesa mendohet të jetë tërhequr.
3. Nëse shqyrtimi zbulon që kërkesa ose shpikja së cilës ajo i përket nuk përmbush kërkesat e kësaj Konvente, Sektori i Ekzaminimit e fton kërkuar, aq shpesh sa të jetë e nevojshme, të depozitojë vërejtjet e tij dhe në pajtim me Nenin 123, paragrafi 1, të ndryshojnë kërkesën.
4. Nëse kërkuari nuk përgjigjet në kohën e duhur ndaj një komunikimi të Sektorit të Ekzaminimit, kërkesa konsiderohet të jetë tërhequr.

Neni 95⁶

(shfuqizuar)

Neni 96⁷

(shfuqizuar)

Neni 97^{8,9}

Dhënia e patentës ose refuzimi N. 14, 64, 65, 113, 129, 141; R. 71, 72, 111-114, 138, 140

1. Nëse Sektori i Ekzaminimit është i mendimit që kërkesa për patentë europiane dhe shpikja së cilës i përket i përmbushin kërkesat e Konventës, ai vendos dhënien e një patente europiane, me kusht që të përmbushen kushtet e parashikuara në Rregullat e Zbatimit.

¹ Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Shih vendimin e Kryetarit të ZPE-së, botim i veçantë nr 3, GZ OPE 2007, D. 3. Shih Mendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/98 (Aneksi 1).

⁵ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁶ Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁷ Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁸ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 10/93 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Nëse Sektori i Ekzaminimit është i mendimit që kërkesa për patentë europiane ose shpikja së cilës i përket nuk i përmbush kërkesat e kësaj Konvente, ai refuzon kërkesën, përveç kur kjo Konventë parashikon një pasojë tjetër ligjore.

3. Vendimi për dhënien e një patente europiane hyn në fuqi në datën në të cilën në Buletinin e Patentave Europiane publikohet përmendja e dhënies.

Neni 98¹

Publikimi i specifikimit të patentës europiane N. 14, 93 ;R. 20, 21, 52, 53, 73, 74, 138

Zyra e Patentave Europiane publikon specifikimet e patentës europiane menjëherë sapo të jetë e mundur pasi përmendja e dhënies së patentës europiane të jetë publikuar në Buletinin e Patentës Europiane.

PJESA V

PROCEDURA E KUNDËRSHTIMIT DHE KUFIZIMIT²

Neni 99^{3,4}

Kundërshtimi N. 105 ;R. 3, 6, 14, 73, 76-78, 84-86, 89, 112, 142, 143

1. Brenda nëntë muajve nga publikimi i përmendjes së dhënies së patentës europiane në Buletinin e Patentave Europiane, çdo person mund të njoftojë Zyrën e Patentave Europiane për kundërshtimin e asaj patente, në pajtim me Rregulloret e zbatimit. Njoftimi i kundërshtimit nuk konsiderohet të jetë depozituar deri në momentin që paguhet tarifa e kundërshtimit.

2. Kundërshtimi zbatohet për patentën europiane në të gjithë Shtetet Kontraktuese në të cilën ajo patentë është në fuqi.

3. Kundërshtuesit janë palë në procedimin e kundërshtimit si edhe pronari i patentës.

4. Nëse një person jep prova që në një Shtet Kontraktues, pas një vendimi të formës së prerë, ai është regjistruar në regjistrin e patentave të këtij Shteti në vend të pronarit të mëparshëm, ky person, me kërkesë të tij, zëvendëson pronarin e parë në lidhje me këtë Shtet. Pavarësisht nga Neni 118, pronari i mëparshëm dhe personi që bën kërkesën nuk konsiderohen si pronarë të përbashkët, përveç kur e kërkojnë të dy.

Neni 100⁵

Shkaqet e kundërshtimit N. 76, 83, 101, 123; R. 76, 80

Kundërshtimi mund të depozitohet bazuar në shkaqet e mëposhtme:

a) objekti i patentës europiane nuk është i patentueshëm sipas Neneve 52 deri 57;
b) patenta europiane nuk e deklaron shpikjen të qartë në masën e mjaftueshme dhe të plotë që ajo të zbatohet nga një person i aftësuar në atë fushë;

c) Objekti i patentës europiane e tejkalon përmbajtjen e kërkesës së depozituar, ose, nëse patenta është dhënë bazuar në një kërkesë të pjesshme ose në një kërkesë të re të depozituar sipas Nenit 61, tejkalon përmbajtjen e kërkesës së mëparshme të depozituar.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000. Shih vendimin e Kryetarit të ZPE-së, botim i veçantë nr 3, GZ OPE 2007, D. 3.

² Titulli i ndryshuar nga akti rishikues i Konventës së Patentës Europiane të datës 29.11.2000

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 4/88, G 5/88, G 7/88, G 8/88, G 10/91, G 9/93, G 1/95, G 7/95, G 3/97, G 4/97, G 3/99, G 1/02, G 2/04, G 3/04 (Aneksi I)

⁵ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/89, G 10/91, G 11/91, G 1/95, G 2/95, G 7/95, G 1/99, G 3/04 (Aneksi I)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 101^{1,2}

Shqyrtimi i kundërshtimit – Revokimi ose mbajtja në fuqi e patentës europiane N. 65, 68, 103l; R. 18, 77-86, 111, 113, 138, 140, 143

1. Nëse kundërshtimi është i pranueshëm, Sektori i Kundërshtimit, në pajtim me Rregulloret e Zbatimit, shqyrton nëse të paktën një prej shkaqeve të kundërshtimit sipas Nenit 100 janë në kundërshtim me mbajtjen në fuqi të patentës europiane. Gjatë këtij shqyrtimi, Sektori i Apelit fton palët, aq shpesh sa të jetë e nevojshme, të depozitojnë vërejtjet në lidhje me komunikimet nga pala tjetër ose të nxjerra vetë.

2. Nëse Sektori i Apelit është i mendimit që të paktën një shkak për kundërshtim qëndron në lidhje me mbajtjen e patentës europiane, ai e revokon patentën. Përndryshe, ai refuzon kundërshtimin.

3. Nëse Sektori i Apelit është i mendimit që, duke marrë parasysh ndryshimet e bëra nga pronari i patentës europiane gjatë procedimit të kundërshtimit, patenta dhe shpikja së cilës ajo i përket:

a) përmbush kërkesat e kësaj Konvente, ai vendos të mbajë patentën e ndryshuar, me kusht që kushtet e parashikuara në Rregulloret Zbatuese të përmbushen;

b) nuk përmbushin kërkesat e kësaj Konvente, ai revokon patentën.

Neni 102³

(shfuqizuar)

Neni 103⁴

Publikimi i një specifikimi të ri të patentës europiane N. 14; R. 20, 21, 87

Nëse patenta europiane mbahet e ndryshuar sipas Nenit 101, paragrafi 3(a), Zyra e Patentave Europiane publikon një specifikim të ri të patentës europiane sa më parë të jetë e mundur, pasi përmendja e vendimit mbi kundërshtimin të jetë publikuar në Buletinin e Patentave Europiane.

Neni 104^{5,6}

Shpenzimet N. 106; R. 11, 88, 97, 111, 140

1. Secila Palë në procedimin e kundërshtimit mbulon shpenzimet e veta që ka shkaktuar, përveç kur Sektori i Apelit, për arsyet e barazisë, urdhëron, në pajtim me Rregulloret zbatuese, një ndarja tjetër të shpenzimeve.

2. Procedura për caktimin e shpenzimeve parashikohet në Rregulloret e Zbatimit.

3. Çdo vendim i formës së prerë i Zyrës së Patentave Europiane që cakton shumën e shpenzimeve trajtohet, për qëllimet e ekzekutimit në Shtetet kontraktuese, në të njëjtën mënyrë si një vendim i formës së prerë i dhënë nga një gjykatë civile e Shtetit në të cilin duhet të kryhet ekzekutimi. Verifikimi i një vendimi të tillë kufizohet në autenticitetin e tij.

Neni 105^{7,8}

Ndërrhyrja e shkelësit të mundëshëm të të drejtave të patentës N. 99; R. 3, 76-86, 89, 112, 114

1. Çdo palë e tretë, në pajtim me Rregulloret e Zbatimit, mund të ndërhyjë në procedurën e kundërshtimit pas skadencës së periudhës së kundërshtimit, nëse pala e tretë vërteton që:

a) kundër tij ka filluar procedimi për shkeljen e të drejtave të kësaj patente, ose

b) pas kërkesës së pronarit të patentës për të ndërprerë shkeljen, pala e tretë ka filluar procedimin për një vendim që ajo nuk është në shkelje të patentës.

2. Një ndërhyrje e pranueshme trajtohet si një kundërshtim.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/88, G 1/90, G 1/91, G 9/91, G 9/92, G 4/93, G 1/99, G 1/02 (Aneksi I).

³ Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁵ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁶ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/99 (Aneksi 1)

⁷ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁸ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 4/91, G 1/94, G 2/04, G 3/04, G 1/05 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 105a¹

Kërkesa për kufizim ose revokim N. 14, 64, 68, 98, 99, 123; R. 6, 90, 92, 93, 138, 143

1. Me kërkesë të pronarit, patenta europiane mund të revokohet ose të kufizohet nëpërmjet një ndryshimi të pretendimeve. Kërkesa depozitohet në Zyrën e Patentave Europiane në pajtim me Rregulloret Zbatuese. Ajo nuk konsiderohet e depozituar deri në momentin e pagesës së tarifës.

2. Kërkesa nuk mund të depozitohet pa përfunduar procedimi për kundërshtimin në lidhje me patentën europiane.

Neni 105b²

Kufizimi ose revokimi i patentës europiane N. 14, 84, 123; R. 6, 91, 94, 95, 138, 111, 140

1. Zyra e Patentave Europiane shqyrton nëse janë përmbushur kërkesat e parashikuara në Rregulloret e Zbatimit për kufizimin ose revokimin e patentës europiane.

2. Nëse Zyra e Patentave Europiane është e mendimit që kërkesa për kufizimin ose revokimin e patentave europiane i përmbush këto kërkesa, ajo vendos të kufizojë ose revokojë patentën europiane në pajtim me Rregulloret e Zbatimit. Përndryshe, ajo e hedh poshtë kërkesën.

3. Vendimi për të kufizuar ose revokuar patentën europiane zbatohet për patentat europiane në të gjithë Shtetet Kontraktues në lidhje me të cilët ajo është dhënë. Ajo hyn në fuqi në datën në të cilën përmendja e vendimit publikohet në Buletinin e Patentave Europiane.

Neni 105c³

Publikimi i specifikimit të ndryshuar të patentës europiane N. 14; R. 20, 21, 96, 138, 143

Nëse patenta europiane është e kufizuar sipas Nenit 105b, paragrafi 2, Zyra e Patentave Europiane publikon specifikimin e ndryshuar të patentës europiane sa më shpejt të jetë e mundur pasi përmendja e kufizimit të jetë publikuar në Buletinin e Patentave Europiane.

PJESA VI

PROCEDURAT E APELIMIT

Neni 106^{4,5}

Vendimet e apeluashme N. 104, 112a/bis; R. 88, 97, 98, 101, 111, 142

1. Kundër vendimeve të Seksionit të Pranimit, Seksioneve të Ekzaminimit, Seksioneve të Kundërshtimit dhe Seksionit Juridik mund të bëhet ankim. Ai ka efekt pezullues.

2. Një vendim që nuk e pushon procedimin për njërën nga palët mund të ankimohet vetëm së bashku me vendimin përfundimtar, përveç kur vendimi lejon një ankim të veçantë.

3. E drejta për të depozituar ankim kundër vendimeve në lidhje me ndarjen ose caktimin e shpenzimeve në procedimet e kundërshtimit mund të kufizohet në Rregulloret e Zbatimit.

Neni 107⁶

PERSONAT QË KANË TË DREJTËN E ANKIMIT DHE TË JENË PALË NË PROCESIN E APELIMIT R. 101, 111

Secila palë në procedim që çenohet nga vendimi mund të bëjë apelim. Të gjitha palët pjesëmarrëse në procedim kanë të drejtë të jenë palë në procedimin e apelimit.

¹ Futur me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Futur me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

³ Futur me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁵ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/90, G 1/99, G 1/02, G 3/03 (Aneksi 1)

⁶ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/88, G 2/91, G 4/91, G 9/92, G 1/99, G 3/99, G 3/03, G 2/04, G 3/04 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 108^{1,2}

Afati dhe forma R. 3, 6, 99, 101, 111

Njoftimi i apelimit mund të depozitohet në pajtim me Rregulloret Zbatuese tek Zyra e Patentave Europiane brenda dy muajve nga njoftimi i vendimit. Njoftimi i ankimit nuk konsiderohet të jetë depozituar deri në momentin e pagesës së tarifës së ankimit. Brenda katër muajve nga njoftimi i vendimit, depozitohet një deklaratë që përcakton shkaqet e ankimit në pajtim me Rregulloret e Zbatimit.

Neni 109³

Rishikim i ndërmjetëshueshëm R. 103

1. Nëse organi, vendimi i të cilit kundërshtohet, mendon që ankimi është i pranueshëm dhe i argumentuar, ai e korrigjon vendimin. Kjo nuk zbatohet nëse ankimuesi kundërshtohet nga një palë tjetër në procedim.

2. Nëse ankimi nuk pranohet brenda tre muajve nga marrja e deklaramit të shkaqeve, ai i kalon Bordit të Apelit pa vonesë dhe pa komente në lidhje me themelin.

Neni 110^{4,5}

Shqyrtimi i apeli me R. 100-102, 111-113

Nëse apeli është i pranueshëm, Bordi i Apelit shqyrton nëse ankimi është i bazuar. Shqyrtimi i apelit kryhet në pajtim me Rregulloret e zbatimit.

Neni 111⁶

Vendimi mbi apeli me R. 100-103, 111, 140

1. Pas shqyrtimit të bazueshmërisë së apelit, Bordi i Apelit vendos në lidhje me apelin. Bordi i Apelit mund të ushtrojë çdo kompetencë brenda kuadrit të kompetencave të organit që ishte përgjegjës për vendimin e apelit ose e dërgon çështjen tek ai organ për shqyrtim të mëtejshëm.

2. Nëse Bordi i apelit e kthen çështjen për shqyrtim të mëtejshëm tek organi të cilit iu apeluar vendimi, ky sektor do të jetë i detyruar nga ratio decidendi i Bordit të Apelit, nëse faktet mbeten të njëjta. Nëse vendimi i apeluar është marrë nga Seksioni i Pranimit, Sektori i Ekzaminimit është gjithashtu i detyruar nga ratio decidendi i Bordit të Apelit.

Neni 112⁷

Vendimi ose mendimi i Bordit të Zgjeruar të Apelit N. 22; R. 111, 140

1. Me qëllim që të sigurohet zbatimi uniform i ligjit, ose nëse del një çështje ligjore e rëndësishme themelore:

a) Bordi i Apelit, gjatë procedimit të një çështjeje dhe kryesisht apo me kërkesë të një pale në procedimin e apelit, ia referon çdo çështje Bordit të Zgjeruar të Apelit nëse mendon që kërkohet një vendim për qëllimet e mësipërme. Nëse Bordi i Apelit e rrëzon kërkesën, ai jep arsyet në vendimin e vet përfundimtar;

b) Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane mund t'ia referojë një çështje ligjore një Bordi të Zgjeruar të Apelit nëse dy Borde Apeli kanë dhënë vendime të ndryshme për atë çështje.

2. Në rastet e përmendura në paragrafin 1(a), palët në procedimin e apelit janë palët në procedimin para Bordit të Zgjeruar të Apelit.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/86, G 2/97, G 1/99, G 3/03, G 2/04, G 3/04 (Aneksi 1)

³ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/03 (Aneksi 1)

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁵ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 9/91, G 10/91, G 10/93, G 3/99 (Aneksi 1)

⁶ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 9/92, G 10/93, G 3/03 (Aneksi 1).

⁷ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/86, G 2/88, G 4/88, G 5/88, G 6/88, G 7/88, G 8/88, G 1/90, G 1/92, G 3/95, G 6/95, G 2/97, G 2/98, G 3/98, G 4/98, G 1/99, G 2/99, G 3/99, G 1/02, G 1/03, G 2/03, G 3/03, G 1/04, G 2/04, G 3/04, G 1/05 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Vendimi i Bordit të Zgjeruar të Apelit i përmendur në paragrafin 1(a) është detyrues për Bordin e Apelit në lidhje me ankimin në fjalë.

Neni 112a¹

Kërkesa për rishikim nga Bordi i Zgjeruar i Apelit N. 22, 106, 111; R. 104-111, 140

1. Secila palë në procedimin e ankimit e prekur nga vendimi i Bordit të Apelit mund të depozitojë një kërkesë për rishikimin e vendimit nga Bordi i Zgjeruar i Apelit.

2. Kërkesa mund të bëhet vetëm mbi bazën që:

a) një anëtar i Bordit të Apelit kanë marrë pjesë në vendim-marrje duke shkelur Nenin 24, paragrafin 1, apo pavarësisht të qenit të përjashtuar në pajtim me një vendim sipas Nenit 24, paragrafi 4;

b) Bordi i Apelit ka angazhuar një person që nuk është emëruar si anëtar i Bordeve të Apelit;

c) ka ndodhur një shkelje themelore sipas nenit 113;

d) ka ndodhur një defekt tjetër themelor procedural i përkufizuar në Rregulloret e Zbatimit në procedimin e ankimit; ose

e) mbi vendimin mund të ketë patur ndikim një vepër penale e përcaktuar sipas kushteve të parashikuara në Rregulloret e Zbatimit.

3. Kërkesa për rishikim nuk ka efekt pezullues.

4. Kërkesa për rishikim depozitohet me një deklaratë të bazuar, në pajtim me Rregulloret e Zbatimit. Nëse bazohet në paragrafin 2(a) deri (d), kërkesa depozitohet brenda dy muajve nga njoftimi i vendimit të Bordit të Apelit. Nëse bazohet në paragrafin 2(e), kërkesa depozitohet brenda dy muajve nga data në të cilën është konstatuar vepra penale dhe në çdo rast jo më vonë se pesë vjet nga njoftimi i vendimit të Bordit të Apelit. Kërkesa nuk mendohet të jetë depozituar deri në momentin e pagesës së tarifës së parashikuar.

5. Bordi i Zgjeruar i Apelit e shqyrton kërkesën për rishikim në pajtim me Rregulloret Zbatuese. Nëse kërkesa është e bazuar, Bordi i Zgjeruar i Apelit anulon vendimin dhe ri-hap procedimin para Bordit të Apelit në pajtim me Rregulloret Zbatuese.

6. Çdo person i cili, në një Shtet Kontraktues të përcaktuar, ka përdorur në mirëbesim ose ka bërë përgatitje të efektshme dhe serioze për përdorimin e një shpikjeje që është objekt i një kërkesë të publikuar për patentë europiane, ose e një patente europiane në periudhën ndërmjet vendimit të Bordit të Apelit dhe publikimit në Buletinin e Patentave Europiane të përmendjes së vendimit të Bordit të Zgjeruar të Apelit mbi kërkesën, mund ta vazhdojë këtë përdorim pa pagesë në kuadrin e biznesit të tij ose për nevojat e tij.

PJESA VII

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA QË RREGULLOJNË PROCEDURËN

Neni 113²

E drejta për t'u dëgjuar dhe baza e vendimeve

1. Vendimet e Zyrës së Patentave Europiane mund të bazohen vetëm mbi bazën ose provat mbi të cilat palët e interesuara kanë mundësi për të bërë komentet e tyre.

2. Zyra e Patentave Europiane shqyrton dhe vendos për kërkesën për patentë europiane, ose patentën europiane vetëm në bazë të teksteve që i paraqiten asaj ose për të cilat bihet dakord nga kërkuesi ose pronari i patentës.

¹ Futur me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 7/91, G 8/91, G 4/92, G 2/04 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 114¹

Shqyrtimi kundërshtive nga Zyra e Patentave Europiane R. 116

1. Në procedimet e saj, Zyra e Patentave Europiane i shqyrton faktet dhe kundërtishtëtë e tyre; ajo nuk kufizohet në këtë shqyrtim tek faktet, provat dhe argumentet e paraqitura nga palët dhe masën e kërkuar.

2. Zyra e Patentave Europiane mund të mos marrë parasysh faktet ose provat që nuk paraqiten në kohën e duhur nga palët përkatëse.

Neni 115²

Vërejtjet nga palët e treta N. 93; R. 114

Në procedimet e Zyrës së Patentave Europiane, pas publikimit të kërkesës për patentë europiane, çdo palë e tretë, në pajtim me Rregulloret e Zbatimit, mund të paraqesë vërejtje në lidhje me patentueshmërinë e shpikjes me të cilën lidhet kërkesa ose patentë. Ai person nuk është palë në proces.

Neni 116³

Procedimi gojor R. 4, 115, 116, 124

1. Procedimi gojor bëhet në nivelin e Zyrës së Patentave Europiane nëse kjo mendohet të jetë e dobishme ose me kërkesë të një pale në procedim. Megjithatë, Zyra e Patentave Europiane mund të refuzojë një kërkesë për procedim të mëtejshëm gojor para të njëjtit sektor nëse palët dhe objekti i procedimit mbeten të pandryshuara.

2. Megjithatë, procedimi gojor kryhet tek Zyra e Pranimit, me kërkesë të kërkuarit vetëm nëse Zyra e Pranimit mendon që kjo është e dobishme ose nëse ai mendon të refuzojë kërkesën për patentë europiane.

3. Procedimi gojor para Seksionit të Pranimit, Sektorëve të Ekzaminimit dhe Sektorit Juridik zhvillohet me dyer të mbyllura.

4. Procedimi gojor, duke përfshirë shpalljen e vendimit, pas publikimit të kërkesës për patentë europiane në Bordin e Apelit, Bordin e Zgjeruar të Apelit, dhe gjithashtu në Sektorët e Kundërshtimit, zhvillohet me dyer të hapura, nëse departamenti tek i cili zhvillohet procedimi nuk vendos ndryshe në rastet kur pranimi i publikut do të kishte disavantazhe serioze dhe të pajustifikuara, veçanërisht për palën në procedim.

Neni 117^{4,5}

Mjetet e provës dhe marrja e provave R. 4, 117-124, 150

1. Në procedimin para Zyrës së Patentave Europiane mjetet e dhënies ose marrjes së provave përfshijnë sa më poshtë:

- a) dëgjimin e palëve;
- b) kërkesat për informacion;
- c) paraqitjen e dokumenteve;
- d) dëgjimin e dëshmitarëve;
- e) mendimet e ekspertëve;
- f) inspektimin;
- g) deklaratimet nën betim me shkrim.

2. Procedura e marrjes së këtyre provave parashikohet në Rregulloret e Zbatimit.

¹ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 7/91, G 8/91, G 9/91, G 10/91, G 4/92, G 9/92, G 8/93, G 10/93, G 1/95, G 7/95, G 1/99 (Aneksi 1)

² Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

³ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/94, G 4/95 (Aneksi 1)

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁵ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/89, G 11/91, G 4/95 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 118

Njësimi i kërkesës për patentë europiane ose patentës europiane N. 59, 99; R. 18, 78, 138

Nëse kërkesit ose pronarët e një patente europiane nuk janë të njëjtët në lidhje me Shtetet e ndryshme Kontraktues të caktuar, ata konsiderohen si kërkesues ose pronarë të përbashkët për qëllimet e procedimit para Zyrës së Patentës Europiane. Njësimi i kërkesës ose patentës në këto procedime nuk cenohet; veçanërisht teksti i kërkesës ose i patentës është i njësuar në të gjithë Shtetet Kontraktuese të caktuar, përveç kur Konventa parashikon ndryshe.

Neni 119¹

Njoftimi R. 112, 125-130

Vendimet, thirrjet, njoftimet dhe komunikimet njoftohen nga Zyra e Patentave Europiane kryesisht në pajtim me Rregulloret Zbatuese. Njoftimi, nëse këtë e kërkojnë rrethanat e veçanta, mund të realizohet nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrës qendrore të pronësisë intelektuale të Shtetit Kontraktues.

Neni 120²

Afatet Kohore R. 131-136, 160

Rregulloret e Zbatimit përcaktojnë:

- a) limitet kohore që duhet të respektohen në procedimin para Zyrës së Patentave Europiane dhe që nuk kanë parashikuar nga kjo Konventë;
- b) mënyrën e llogaritjes së afateve kohore dhe kushtet në të cilat afatet kohore mund të zgjaten;
- c) kufiri minimal dhe maksimal i afateve kohore caktohen nga Zyra e Patentave Europiane.

Neni 121³

Trajtimi i mëtejshëm i kërkesës për patentë europiane R. 135

1. Nëse një kërkesues nuk mund respekton një afat ndaj Zyrës së Patentave Europiane, ai mund të kërkojë shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës për patentë europiane.
2. Zyra e Patentave Europiane e pranon kërkesën, me kusht që të përmbushen kërkesat e parashikuara në Rregulloret e Zbatimit. Përndryshe, ajo e refuzon kërkesën.
3. Nëse kërkesa pranohet, pasojat ligjore të mosrespektimit të afatit kohor do të konsiderohen të mos kenë ekzistuar.
4. Shqyrtimi i mëtejshëm përjashtohet në lidhje me afatet kohore të Nenit 87, paragrafi 1, Neni 108 dhe Neni 112a, paragrafi 4, si dhe afatet kohore për kërkimin e shqyrtimit të mëtejshëm ose rivendosjen në gjendjen e mëparshme. Rregulloret e Zbatimit mund të përjashtojnë shqyrtimin e mëtejshëm për afate të tjera kohore.

Neni 122^{4,5}

Rivendosja në gjendjen e mëparshme R. 136, 143

1. Një kërkesues ose pronar i një patente europiane që, pavarësisht nga i gjithë kujdesi i treguar në bazë të rrethanave, nuk ka qenë në gjendje të respektojë një afat kohor ndaj Zyrës së Patentave Europiane me kërkesë rivendoset në gjendjen e mëparshme nëse mos-respektimi i këtij afati kohor ka pasojën e drejtpërdrejtë të shkakut të refuzimit të kërkesës për patentë europiane ose të një kërkesë tjetër, të konsiderimit se kërkesa është tërhequr, të revokimit të patentës europiane ose të humbjes së një të drejte tjetër apo mjeti mbrojtjeje.
2. Zyra e Patentave Europiane e miraton kërkesën, me kusht që të jenë përmbushur kushtet e paragrafit 1 dhe çdo kërkesë tjetër i parashikuar në Rregulloret e zbatimit. Përndryshe, ajo e refuzon kërkesën.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁵ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/86 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Nëse kërkesa miratohet, pasojat ligjore të mosrespektimit të afatit kohor konsiderohen të mos kenë ekzistuar.

4. Rivendosja në gjendjen e mëparshme përjashtohet në lidhje me afatin kohor për të kërkuar rivendosjen në gjendjen e mëparshme. Rregulloret Zbatuese mund të përjashtojnë rivendosjen në gjendjen e mëparshme për afate të tjera kohore.

5. Çdo person që në një Shtet Kontraktual të caktuar ka përdorur në mirëbesim ose ka bërë përgatitje të efektshme dhe serioze për përdorimin e një shpikjeje që është objekt i një kërkesë të publikuar për patentë europiane ose e një patente europiane në periudhën ndërmjet humbjes së të drejtave të përmendura në paragrafin 1 dhe publikimit në Buletin e Patentave Europiane të përmendjes së rivendosjes në gjendjen e mëparshme për ato të drejta, mund të vazhdojë këtë përdorim në kuadrin e biznesit të tij dhe për nevojat e tij pa pagesë.

6. Asgjë në këtë nen nuk kufizon të drejtën e një Shteti Kontraktues për të lejuar rivendosjen në gjendjen e mëparshme në lidhje me afatet kohore të parashikuara në këtë Konventë dhe që duhet të respektohen kundrejt autoriteteve të këtij Shteti.

Neni 123^{1,2}

Ndryshimet N. 100, 138; R. 4, 7, 18, 57, 58, 71, 78-82, 137, 138

1. Kërkesa për patentë europiane ose patenta europiane mund të ndryshohet në procedimet para Zyrës së Patentave Europiane, në pajtim me rregulloret e Zbatimit. Në çdo rast, kërkuarësi i jepet të paktën një mundësi për të ndryshuar vetë kërkesën.

2. Kërkesa për patentë europiane ose patenta europiane nuk mund të ndryshohet në asnjë mënyrë për të përfshirë një objekt që del tej përmbajtjes së kërkesës së depozituar.

3. Patenta europiane nuk mund të ndryshohet në asnjë mënyrë për të zgjeruar mbrojtjen e dhënë.

Neni 124³

Informacioni mbi gjendjen e teknikës N. 140; R. 112, 141

1. Zyra e Patentave Europiane, në pajtim me Rregulloret Zbatuese, mund të ftojë kërkuarësin të japë informacion mbi gjendjen e mëparshme të teknikës që merret parasysh në procedimin e brendshëm ose rajonal për patentat dhe në lidhje me një shpikje me të cilën ka të bëjë kërkesa për patentë europiane.

2. Nëse kërkuarësi nuk përgjigjet në kohën e duhur ndaj një ftese sipas paragrafit 1, kërkesa për patentë europiane konsiderohet të jetë tërhequr.

Neni 125⁴

Referenca në parimet e përgjithshme

Në mungesë të dispozitave procedurale në këtë Konventë, Zyra e Patentave Europiane merr parasysh parimet e ligjit procedural të njohura përgjithësisht në Shtetet Kontraktuese.

Neni 126⁵

(shfuqizuar)

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/88, G 3/89, G 11/91, G 1/93, G 2/95, G 2/98, G 1/99, G 1/03, G 2/03, G 1/05 (Aneksi 1)

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/99, G 3/04 (Aneksi 1)

⁵ Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KAPITULLI II INFORMACIONI PËR AUTORITETET PUBLIKE OSE ZYRTARE

Neni 127¹

Regjistri i Patentave Europiane N. 14, 20, 129; R. 21-24, 85, 143

Zyra e Patentave Europiane mban një Regjistër të Patentave Europiane në të cilin regjistrohen cilësitë që parashikohen në Rregulloret e Zbatimit. Asnjë hyrje nuk bëhet në Regjistrin e Patentave Europiane para publikimit të kërkesës për patentë europiane. Regjistri i Patentave europiane është i hapur për inspektim nga publiku.

Neni 128²

Inspektimi i dosjeve N. 76, 93, 130, 131; R. 16, 19, 31-33, 68, 113, 144-147, 149

1. Dosjet në lidhje me kërkesat për patentë europiane që nuk janë publikuar akoma nuk ofrohen për inspektim pa pëlqimin e kërkuarit.

2. Çdo person që mund të provojë që kërkuari patentës është bazuar në të drejtat sipas kërkesës për patentë europiane kundër tij mund të përftojë inspektimin e dosjes para publikimit të asaj kërkesë dhe pa pëlqimin e kërkuarit.

3. Nëse publikohet një kërkesë e pjesshme europiane ose një kërkesë e re për patentë europiane e depozituar sipas Nenit 61, paragrafi 1, çdo person mund të përftojë inspektimin e dosjeve të kërkesave të mëparshme para publikimit të asaj kërkesë pa pëlqimin e kërkuarit.

4. Pas publikimit të kërkesës për patentë europiane, dosjet në lidhje me kërkesën dhe patentën përkatëse Europiane mund të inspektohen me kërkesë, në pajtim me kufizimet e parashikuara në Rregulloret Zbatuese.

5. Edhe para publikimit të kërkesës për patentë europiane, Zyra e Patentave Europiane mund t'u komunikojë palëve të treta ose të publikojë veçantitë e përcaktuara në Rregulloret e zbatimit.

Neni 129³

Publikimet periodike N. 14, 94, 97, 127, 153; R. 21, 31-34, 69, 143

Zyra e Patentave Europiane publikon periodikisht:

a) një Buletin të Patentave Europiane që përmban hollësitë e publikimit që parashikohen në këtë Konventë, Rregulloret Zbatuese ose nga Presidenti i Zyrës së Patentave Europiane;

b) një Fletore Zyrtare që përmban njoftimet dhe informacionin e një karakteri të përgjithshëm të nxjerra nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane, si dhe çdo informacion tjetër në lidhje me këtë Konventë ose me zbatimin e saj.

Neni 130⁴

Shkëmbimi i informacionit R. 148

1. Nëse kjo Konventë ose ligjet e brendshme nuk parashikojnë ndryshe, Zyra e Patentave Europiane dhe zyra qendrore e pronësisë industriale e çdo Shteti Kontraktues, me kërkesë, i komunikojnë njëra-tjetrës çdo informacion të dobishëm në lidhje me kërkesat për patentë europiane ose kombëtare dhe këto patenta, si dhe çdo procedim në lidhje me to.

2. Paragrafi 1 zbatohet për komunikimin e informacionit në bazë të marrëveshjeve të punës ndërmjet Zyrës së Patentave Europiane dhe

a) zyrave qendrore të pronësisë industriale të Shteteve të tjerë;

b) çdo organizatë ndër-qeveritare të ngarkuar me detyrën e dhënies së patentave;

c) çdo organizatë tjetër.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Komunikimet sipas paragrafëve 1 dhe 2(a) dhe (b) nuk u nënshtrohen kufizimeve të parashikuara në Nenin 128. Këshilli Administrativ mund të vendosë që komunikimet sipas paragrafëve 2(c) të mos u nënshtrohen këtyre kufizimeve, me kusht që organizata e interesuar të trajtojë informacionin e komunikuar si konfidencial deri në publikimin e kërkesës për patentë europiane.

Neni 131

Bashkëpunimi administrative dhe ligjor N. 117; R. 117-120, 148-150

1. Nëse kjo Konventë ose ligjet e brendshme nuk parashikojnë ndryshe, Zyra e Patentave Europiane dhe gjykatat apo autoritetet e Shteteve Kontraktuese me kërkesë i japin njëri-tjetrit asistencë duke komunikuar informacion ose hapur dosjet për inspektim. Nëse Zyra e Patentave Europiane ofron dosjet për inspektim nga gjykata, Zyrat e Prokurorëve Publikë ose nga zyrat qendrore të pronësisë industriale, inspektimi nuk u nënshtrohet kufizimeve të parashikuara në Nenin 128.

2. Me kërkesë të Zyrës së Patentave Europiane, gjykatat dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese ndërmarrin, në emër të Zyrës dhe brenda kufijve të juridiksionit të tyre, çdo kërkim të nevojshëm ose masa të tjera ligjore.

Neni 132

Shkëmbimi i publikimeve

1. Zyra e Patentave Europiane dhe zyrat qendrore të pronësisë industriale të Shteteve Kontraktuese i dërgojnë njëra-tjetrës me kërkesë për përdorimin e tyre një ose disa kopje të publikimeve të tyre përkatëse falas.

2. Zyra e Patentave Europiane mund të përfundojë marrëveshje në lidhje me shkëmbimin ose dhënien e publikimeve.

KAPITULLI III PËRFAQËSIMI

Neni 133^{1,2}

Parimet e përgjithshme të përfaqësimit

N. 90, 134, 134a/bis, 144 ;R. 41, 76, 126, 130, 142, 143, 151-154

1. Në pajtim me paragrafin 2, asnjë person nuk është i detyruar të përfaqësohet nga një përfaqësues i miratuar në procedimet e parashikuara në këtë Konventë.

2. Personat fizikë ose juridikë që nuk kanë vendbanimin ose vendin kryesor të biznesit të tyre në një Shtet Kontraktues përfaqësohen nga një përfaqësues i miratuar dhe veprojnë nëpërmjet tij në të gjitha procedimet e parashikuara në këtë Konventë, përveç paraqitjes së një kërkesë për patentë europiane. Rregulloret e Zbatimit mund të lejojnë përjashtime të tjera.

3. Personat fizikë ose juridikë që kanë vendbanimin ose vendin kryesor të biznesit të tyre në një Shtet Kontraktues mund të përfaqësohen në procedimet e parashikuara në këtë Konventë nga një punonjës, që nuk është e nevojshme të jetë përfaqësues i miratuar por që autorizohet në pajtim me Rregulloret e Zbatimit. Rregulloret e Zbatimit mund të parashikojnë nëse dhe në cilat kushte një punonjës i një personi juridik mund të përfaqësojë edhe persona të tjerë juridikë që kanë vend e tyre kryesor të biznesit në një Shtet Kontraktues dhe që kanë lidhje ekonomike me personin e parë juridik.

4. Rregulloret Zbatuese mund të përmbajnë dispozita të veçanta në lidhje me përfaqësimin e përbashkët të palëve që veprojnë bashkërisht.

Neni 134^{3,4}

Përfaqësimi para Zyrës së Patentave Europiane

N. 20, 35, 133, 134a/bis ; R. 142, 143, 152-154

1. Përfaqësimi i personave fizikë dhe juridikë në procedimet e parashikuara nga kjo Konventë mund të ndërmerret nga përfaqësuesit profesionistë, emrat e të cilëve janë në një listë që mbahet për këtë qëllim nga Zyra e Patentave Europiane.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/94, G 4/95, G 3/99 (Aneksi 1)

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/94, G 4/95, G 3/99, G 2/04 (Aneksi 1)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Një person fizik që:
 - a) është shtetas i një Shteti Kontraktues;
 - b) ka vendin e biznesit të tij ose punësimit në një Shtet Kontraktues; dhe
 - c) ka kaluar provimin e kualifikimit Europian, mund të futet në listën e përfaqësuesve profesionistë.
3. Gjatë një periudhe një-vjeçare nga data në të cilën ka hyrë në fuqi aderimi i një Shteti në këtë Konventë, futja në atë listë mund të kërkohej nga çdo person fizik që:
 - a) është shtetas i një Shteti Kontraktues;
 - b) ka vendin e biznesit ose punësimit në Shtetin që ka aderuar në Konventë; dhe
 - c) ka të drejtë të përfaqësojë personat fizikë dhe juridikë në çështjet e patentave para një zyre qendrore të pronësisë industriale në atë Shtet. Nëse një e drejtë e tillë nuk kushtëzohet me kërkesën e kualifikimeve të veçanta profesionale, personi duhet të ketë vepruar rregullisht kështu në atë Shtet për të paktën pesë vjet.
4. Futja bëhet me kërkesë, e shoqëruar nga certifikatat që tregojnë që përmbushen kushtet e parashikuara në paragrafin 2 ose 3.
5. Personat emrat e të cilëve janë në listën e përfaqësuesve profesionistë kanë të drejtën të veprojnë në të gjitha procedimet e parashikuara nga kjo Konventë.
6. Për të vepruar si përfaqësues profesionist, çdo person emri i të cilit është në listën e përfaqësuesve profesionistë ka të drejtën të themelojë një vend biznesi në çdo Shtet Kontraktues ku mund të trajtohen procedimet e parashikuara nga kjo Konventë, duke patur parasysh Protokollin mbi Centralizimin të bashkangjitur kësaj Konvente. Autoritetet e këtij Shteti mund ta heqin këtë të drejtë në çështje të veçanta vetëm duke zbatuar dispozitat ligjore të miratuara për qëllimin e mbrojtjes së sigurisë dhe rendit publik. Para ndërmarrjes së këtij veprimi, konsultohet Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane.
7. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane mund të lejojë përjashtime nga:
 - a) kërkesat e paragrafëve 2(a) ose 3(a) në rrethana të veçanta;
 - b) kërkesat e paragrafit 3(c), fjalë e dytë, nëse kërkuar paraqet prova që ai ka përfutur kualifikimet e kërkuara në një mënyrë tjetër.
8. Përfaqësimet në procedimet e parashikuara nga kjo Konventë mund të ndërmerren, në të njëjtën mënyrë si nga një përfaqësues profesionist, edhe nga një praktikues ligjor i kualifikuar në një Shtet Kontraktues dhe që ka vendin e biznesit të tij në atë Shtet në masën që ai ka të drejtë të veprojë në atë Shtet si përfaqësues profesionist në çështjet e patentave. Paragrafi 6 zbatohet mutatis mutandis.

Neni 134a¹

Instituti i Përfaqësuesve të Miratuar para Zyrës së Patentave Europiane R. 12, 153

1. Këshilli Administrativ ka kompetencë të miratojë dhe ndryshojë dispozitat që rregullojnë:
 - a)² Institutin e Përfaqësuesve të Miratuar para Zyrës së Patentave Europiane, këtu të quajtura Instituti;
 - b) kualifikimet dhe trajnimin e kërkuar për një person për t'u pranuar në provimin e kualifikimit europian dhe zhvillimin e këtij provimi³;
 - c)⁴ kompetencën disiplinore që ushtrohet nga Instituti ose Zyra e Patentave Europiane në lidhje me përfaqësuesit e miratuar;
 - d) detyrimin e konfidencialitetit mbi përfaqësuesin profesionist dhe privilegjin nga deklarimi në procedimet para Zyrës së Patentave Europiane në lidhje me komunikimet ndërmjet një përfaqësuesi profesionist dhe klientit të tij apo një personi tjetër.
2. Çdo person që futet në listën e përfaqësuesve profesionistë të përmendur në Nenin 134, paragrafi 1, është anëtar i Institutit.

¹ Futur me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të vitit 29.11.2000

² Shih Rregulloren mbi themelimin e Institutit të Përfaqësuesve Profesionistë para Zyrës së Patentave Europiane (GZ EPO 1997, 350) dhe ndryshimet e datës 07.06.2002 (GZ EPO 2002, 429 e në vazhdim) dhe të datës 17.06.2004 (GZ EPO 2004, 361).

³ Shih Rregulloren mbi provimin e kualifikimit europian për përfaqësuesit profesionistë para Zyrës së Patentave Europiane të datës 24.10.2002 (GZ EPO 1994, 7 e në vazhdim; 2000, 320 e në vazhdim; 2002, 565 e në vazhdim), dispozitat plotësuese të datës 24.10.2002 (GZ EPO 1998, 364 e në vazhdim; 2003, 25 e në vazhdim), dhe Udhëzimet në lidhje me kualifikimet e kërkuara për regjistrimin në provimin e kualifikimit europian (GZ EPO 1994, 599).

⁴ Shih rregulloren e disiplinës për përfaqësuesit profesionistë të datës 21.10.1977 (GZ EPO 1978, 91 e në vazhdim), Rregullat Shtesë të Procedurës të tre Organeve Disiplinore të datës 06.06.1980 (GZ EPO 1980, 176 e në vazhdim) dhe Kodin e Sjelljes së Institutit të Përfaqësuesve Profesionistë para EPO-s (GZ EPO 2003, 523 e në vazhdim).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

PJESA VIII NDIKIMI MBI LIGJIN E BRENDSHËM KAPITULLI I KONVERTIMI NË NJË KËRKESË PËR PATENTË KOMBËTARE

Neni 135¹

Kërkesa për konvertim N. 137, 140 ;R. 37, 112, 155, 156

1. Zyra qendrore e pronësisë industriale e një Shteti Kontraktues të caktuar, me kërkesë të kërkuarit ose të pronarit të një patente europiane zbaton procedurën për dhënien e një patente kombëtare në rrethanat e mëposhtme:

a) nëse kërkesa për patentë europiane konsiderohet të jetë tërhequr sipas Nenit 77, paragrafi 3;
b) në ato raste të tjera që janë parashikuar nga ligji i kombëtar, në të cilët kërkesa për patentë europiane refuzohet ose tërhiqet apo konsiderohet e tërhequr, ose patentë europiane revokohet sipas kësaj Konvente.

2. Në rastin e përmendur në paragrafin 1(a), kërkesa për konvertim depozitohet tek zyra qendrore e pronësisë industriale me të cilën është paraqitur kërkesa për patentë europiane. Ajo zyrë, në pajtim me dispozitat që rregullojnë sigurinë kombëtare, ua transmeton kërkesën drejtpërdrejt zyrave qendrore të pronësisë industriale të Shteteve Kontraktuese të përcaktuara në të.

3. Në rastet e parashikuara në paragrafin 1(b), kërkesa për konvertim i paraqitet Zyrës së Patentave Europiane në pajtim me Rregullat e Zbatimit. Nuk konsiderohet të jetë paraqitur deri në momentin që paguhet tarifa e konvertimit. Zyra e Patentave Europiane ua transmeton kërkesën zyrave qendrore të pronësisë industriale të Shteteve Kontraktuese të përcaktuara në të.

4. Efekti i kërkesës për patentë europiane të përmendur në Nenin 66 parashkruhet nëse kërkesa për konvertim nuk paraqitet në kohën e duhur.

Neni 136²

(shfuqizuar)

Neni 137³

Dispozitat formale të konvertimit N. 140; R. 155

1. Një kërkesë për patentë europiane e transmetuar në pajtim me Nenin 135, paragrafi 2 ose 3, nuk u nënshtrohet kërkesave formale të ligjit kombëtar që janë të ndryshme nga ose shtesë mbi ato të parashikuara në këtë Konventë.

2. Çdo zyrë qendrore e pronësisë industriale së cilës i transmetohet një kërkesë për patentë europiane mund të kërkojë që kërkuari, brenda një periudhe jo më të shkurtër se dy muaj:

a) të paguajë tarifën për kërkesë kombëtare; dhe
b) depozitojë një përkthim të tekstit origjinal të kërkesës për patentë europiane në një gjuhë zyrtare të Shtetit në fjalë dhe, sipas rastit, të tekstit të ndryshuar gjatë procedimit para Zyrës së Patentave Europiane që kërkuari dëshiron të përdorë si bazë për procedurën kombëtare.

KAPITULLI II REVOKIMI DHE TË DREJTAT E MËPARSHME

Neni 138⁴

Revokimi i patentave europiane N. 76, 83, 123

1. Në pajtim me Nenin 139, një patentë europiane mund të revokohet me efekt për një Shtet Kontraktues vetëm për shkaqet që:

a) objekti i patentës europiane nuk është e patentueshme sipas Neneve 52 deri 57;

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

b) patenta europiane nuk e tregon shpikjen në masën e mjaftueshme të qartë dhe të plotë për t'u zbatuar nga një person të aftësuar në atë teknikë;

c) ¹ objekti i një patente europiane del tej përmbajtjes së kërkesës së depozituar, ose nëse patenta është dhënë në bazë të një kërkesë të pjesshme ose për një kërkesë të re të depozituar sipas Nenit 61, tej përmbajtjes së kërkesave të mëparshme të depozituara;

d) mbrojtja e dhënë nga patenta europiane është tejkaluar; ose

e) pronari i patentës europiane nuk e ka të drejtën sipas Nenit 60, paragrafi 1.

2. Nëse shkaqet për revokim ndikojnë patentën europiane vetëm pjesërisht, patenta mbetet e kufizuar nga një amendim përkatës të pretendimeve dhe revokohet pjesërisht.

3. Në procedimet para gjykatës ose organit kompetent në lidhje me vlefshmërinë e patentës europiane, pronari i patentës ka të drejtën të kufizojë patentën duke ndryshuar pretendimet. Patenta e kufizuar në këtë mënyrë përbën bazën për procedim.

Neni 139²

Të drejtat e mëparshme dhe të drejtat që lindin në të njëjtën datë N. 138, 140 ; R. 138

1. Në çdo Shtet të caktuar Kontraktues një kërkesë për patentë europiane dhe një patentë europiane, në lidhje me një kërkesë për patentë kombëtare dhe një patentë kombëtare, ka të njëjtin efekt të së drejtës së mëparshme si një kërkesë për patentë kombëtare dhe një patentë kombëtare.

2. Një kërkesë për patentë kombëtare dhe një patentë kombëtare në një Shtet Kontraktues, në lidhje me një patentë europiane që përcakton se Shteti Kontraktues ka të njëjtin efekt të së drejtës së mëparshme sikur patenta europiane të ishte një patentë kombëtare.

3. Çdo Shtet Kontraktues mund të parashikojë nëse dhe në cilat kushte një shpikje e deklaruar në një kërkesë për patentë ose patentë europiane dhe në një kërkesë ose patentë kombëtare që kanë të njëjtën datë të depozitimit ose, nëse pretendohet prioriteti, të njëjtën datë të prioritetit, mund të mbrohen njëkohësisht nga të dy kërkesat ose patentat.

KAPITULLI III EFEKTE TË NDRYSHME

Neni 140³

Modelet kombëtare të përdorimit dhe certifikatat kombëtare të përdorimit R. 112, 155, 156

Nenet 66, 124, 135, 137 dhe 139 zbatohen për modelet e përdorimit dhe certifikatat e përdorimit dhe për kërkesat për modelet e përdorimit dhe certifikatat e përdorimit të regjistruara ose depozituara në Shtetet Kontraktuese ligjet e të cilëve parashikojnë këto modele ose certifikata.

Neni 141⁴

Tarifat e mbajtjes në fuqi të patentave europiane N. 39, 97

1. Tarifat e mbajtjes në fuqi të një patente europiane mund të vendosen vetëm për vitet që pasojnë atë që përmendet në Nenin 86, paragrafi 2.

2. Çdo tarifë e mbajtjes në fuqi që bëhet e kërkueshme brenda dy muajve nga publikimi në Buletinin e Patentave Europiane i përmendjes së dhënies së patentës europiane konsiderohet të jetë paguar në mënyrë të vlefshme nëse paguhet brenda asaj periudhe. Nuk kërkohet asnjë tarifë shtesë e parashikuar sipas ligjit të brendshëm.

¹ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/89, G 11/91, G 2/95 (Aneksi I).

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 1/03, G 2/03 (Aneksi I).

³ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁴ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

PJESA IX MARRËVESHJE TË VEÇANTA

Neni 142

Patentat unike N. 2

1. Një grup Shtetesh Kontraktuese që kanë parashikuar me marrëveshje të veçantë që një patentë europiane e dhënë për ata Shtete të ketë karakter të njësuar në të gjithë territoret e tyre, mund të parashikojnë që një patentë europiane mund të jepet vetëm bashkërisht në lidhje me ata Shtete.

2. Nëse një grup Shtetesh Kontraktuese ka përdorur autorizimin e dhënë në paragrafin 1, zbatohen dispozitat e kësaj Pjese.

Neni 143

Organe të veçanta të Zyrës së Patentave Europiane N. 15, 144-146

1. Grupi i Shteteve Kontraktuese mund t'i caktojë Zyrës së Patentave Europiane detyra shtesë.

2. Brenda Zyrës së Patentave Europiane mund të ngrihen organe të veçanta të përbashkët për Shtetet Kontraktuese në grup me qëllim që të përmbushen detyrat shtesë. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane drejton këto departamente të veçanta; Neni 10, paragrafët 2 dhe 3 zbatohen mutatis mutandis.

Neni 144

Përfaqësimi para organeve të veçanta N. 133

Grupi i Shteteve Kontraktuese mund të vendosin dispozita të veçanta për të rregulluar përfaqësimin e palëve para departamenteve të përmendur në Nenin 143, paragrafi 2.

Neni 145

Komisioni i ngushte i Këshillit Administrativ

1. Grupi i Shteteve Kontraktuese mund të ngrejë një komision të ngushtë të Këshillit Administrativ për qëllimin e mbikëqyrjes së aktiviteteve të departamenteve të veçantë të ngritur sipas Nenit 143, paragrafi 2; Zyra e Patentave Europiane vë në dispozicion të saj atë personel, ambiente dhe pajisje që mund të jenë të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tij. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane është përgjegjës për aktivitetet e departamenteve të veçanta para komitetit të zgjedhur të Këshillit Administrativ.

2. Përbërja, kompetencat dhe funksionet e komitetit të zgjedhur përcaktohen nga grupi i Shteteve Kontraktuese.

Neni 146

Mbulimi i shpenzimeve për përmbushjen e detyrave të veçanta N. 37, 50

Nëse Zyrës së Patentave Europiane i janë dhënë detyra të veçanta sipas Nenit 143, grupi i Shteteve Kontraktues përballon shpenzimet e shkaktuara nga Organizata gjatë përmbushjes së këtyre detyrave. Nëse në Zyrën e Patentave Europiane janë ngritur departamente të veçanta për të përmbushur këto detyra shtesë, grupi mbulon shpenzimet për personelin, ambientet dhe pajisjet që ngarkohen në lidhje me këto departamente. Neni 39, paragrafët 3 dhe 4, Neni 41 dhe Neni 47 zbatohen mutatis mutandis.

Neni 147

Pagesat në lidhje me tarifat e mbajtjes në fuqi të patentave unike

Nëse grupi i Shteteve Kontraktues ka caktuar një normë të përbashkët të tarifave të mbajtjes në fuqi në lidhje me patentat europiane, raporti i përmendur në Nenin 39, paragrafi 1, llogaritet mbi bazën e një norme të përbashkët; shuma minimale e përmendur në Nenin 39, paragrafi 1, zbatohet për patentën unike. Neni 39, paragrafët 3 dhe 4 zbatohen mutatis mutandis.

Neni 148

Kërkesa për patentë europiane si objekt pasuror

1. Neni 74 zbatohet përveç kur grupi i Shteteve Kontraktuese ka parashikuar ndryshe.
2. Grupi i Shteteve Kontraktuese mund të parashikojë që një kërkesë për patentë europiane për të cilën janë përcaktuar këto Shtete Kontraktuese mund të transferohet, hipotekohet ose t'i nënshtrohet një mjeti tjetër ligjor të ekzekutimit në lidhje me të gjithë Shtetet Kontraktuese të grupit dhe në pajtim me dispozitat e marrëveshjes së veçantë.

Neni 149¹

Emërtimi i përbashkët Art. 3, 79, 153 ; R. 39

1. Grupi i Shteteve Kontraktuese mund të parashikojnë që këta Shtete mund të emërtohen së bashku dhe që emërtimi i një ose vetëm disa prej këtyre Shteteve konsiderohet të përbjë emërtimin e të gjithë Shteteve të grupit.
2. Nëse Zyra e Patentave Europiane vepron si një organ vendim-marrës sipas Nenit 153, paragrafi 1, paragrafi 1 zbatohet vetëm nëse kërkuksi ka treguar në kërkesën ndërkombëtare që ai dëshiron të përftojë një patentë europiane për një ose më shumë prej Shteteve të emërtuara të grupit. E njëjta zbatohet nëse kërkuksi emërton në kërkesën ndërkombëtare një prej Shteteve Kontraktuese në grup, në grup, ligji i brendshëm i të cilit parashikon që emërtimi i atij Shteti ka efektin e kërkesës që është për një patentë europiane.

Neni 149a²

Marrëveshje të tjera ndërmjet Shteteve Kontraktuese N. 35

1. Asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet si kufizim i të drejtës së disa ose të gjithë Shteteve Kontraktuese për të lidhur marrëveshje të veçanta për çdo çështje në lidhje me kërkesat për patenta europiane ose patentat europiane që në bazë të kësaj Konvente i nënshtrohen dhe rregullohen nga ligji i kombëtar, si dhe, veçanërisht:
 - a) një marrëveshje themeluese të një gjykate për patentat europiane të përbashkët për Shtetet Kontraktuese palë në të;
 - b) një marrëveshje themeluese të një subjekti të përbashkët për Shtetet Kontraktuese palë në të për të dhënë, me kërkesë të gjykatave ose autoriteteve gjysmë-gjyqësore kombëtare, mendime për çështjet e së drejtës europiane ose kombëtare të harmonizuar për patentat;
 - c) një marrëveshje në bazë të së cilës Shtetet Kontraktuese palë në të heqin dorë plotësisht ose pjesërisht nga përkthimet e patentave europiane sipas Nenit 65;
 - d) në marrëveshje në bazë të së cilës Shtetet Kontraktuese palë në të parashikojnë që përkthimet e patentave europiane sipas parashikimit në Nenin 65 mund të depozitohen tek Zyra e Patentave Europiane dhe të publikohen prej saj.
2. Këshilli Administrativ ka kompetencë për të vendosur që:
 - a) anëtarët e Bordit të Apelit ose Bordi i Zgjeruar i Apelit mund të shërbejnë në një gjykatë të patentave europiane ose në një subjekt të përbashkët dhe të marrin pjesë në procedimet para asaj gjykate ose subjekti në pajtim me çdo marrëveshje të tillë;
 - b) Zyra e Patentave Europiane i siguron subjektit të përbashkët atë personel mbështetës, ambiente dhe pajisje që mund të jenë të nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij, dhe shpenzimet e shkaktuara nga ai subjekt mbulohen plotësisht ose pjesërisht nga Organizata.

¹ Shih Traktatin ndërmjet konfederatës Zvicerane dhe Principatës së Lihtenshtainit mbi Mbrojtjen e Patentave të datës 22.12.1978 (GZ EPO 1980, 407 e në vazhdim).

² Futur me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

PJESA X¹

KËRKESAT NDËRKOMBËTARE SIPAS TRAKTATIT TË BASHKËPUNIMIT PËR PATENTAT – KËRKESAT EURO-PCT

Neni 150

Kërkesat sipas Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat R. 157-159, 165

1. Traktati i Bashkëpunimit për Patentat i datës 19 qershor 1970, këtu i quajtur PCT, zbatohet në pajtim me dispozitat e kësaj Pjese.

2. Kërkesat ndërkombëtare të depozituara sipas PCT-së mund t'u nënshtrohen procedimeve para Zyrës së Patentave Europiane. Në këto procedime, dispozitat e PCT-së dhe Rregulloreve të saj zbatohen, të plotësuara nga dispozitat e kësaj Konvente. Në rast mospërputhjeje, mbizotërojnë dispozitat e PCT-së ose të Rregulloreve të saj.

Neni 151

Zyra e Patentave Europiane si Zyrë pranimi N. 35, 153 ; R. 157

Zyra e Patentave Europiane vepron si një Zyrë pranimi brenda kuptimit të PCT-së, në pajtim me Rregulloret Zbatuese. Zbatohet Neni 75, paragrafi 2.

Neni 152²

Zyra e Patentave Europiane si një Autoritet Kërkimi Ndërkombëtar ose Autoritet Ndërkombëtar i Shqyrtimit Paraprak N. 21, 35; R. 158

Zyra e Patentave Europiane vepron si një Autoritet Kërkimi Ndërkombëtar dhe Autoritet Ndërkombëtar i Shqyrtimit Paraprak brenda kuptimit të PCT-së, në pajtim me një marrëveshje ndërmjet Organizatës dhe Zyrës Ndërkombëtare të Organizatës Botërore për Pronësinë Intelektuale, për kërkuesit që janë me vendbanim ose shtetas të një Shteti palë në këtë Konventë. Kjo marrëveshje mund të parashikojë që Zyra e Patentave Europiane të veprojë edhe për kërkues të tjerë.

Neni 153

Zyra e Patentave Europiane si Zyrë e përcaktuar ose Zyrë e zgjedhur N. 35, 92, 93, 129 ; R. 65, 68, 113, 159-165

1. Zyra e Patentave Europiane është

a) një Zyrë e përcaktuar për çdo Shtet palë në këtë Konventë në lidhje me të cilën PCT-ja është në fuqi, që është përcaktuar në kërkesën ndërkombëtare dhe për të cilin kërkuesi dëshiron të përfitojë një patentë europiane, dhe

b) një zyrë e zgjedhur, nëse kërkuesi ka zgjedhur një Shtet të përcaktuar në pajtim me germën (a).

2. Një kërkesë ndërkombëtare për të cilën Zyra e Patentave Europiane është një Zyrë e përcaktuar ose zgjedhur, që i është dhënë një datë ndërkombëtare depozitimi, është e barasvlershme me një kërkesë të rregullt europiane (kërkesa Euro-PCT).

3. Publikimi ndërkombëtar i një kërkesë Euro-PCT në një gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane zë vendin në një publikim të kërkesave për patentë europiane dhe përmendet në Buletinin e Patentave Europiane.

4. Nëse një kërkesë Euro-PCT publikohet në një gjuhë tjetër, një përkthim në një nga gjuhët zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane depozitohet tek Zyra e Patentave Europiane dhe që e publikon atë. Në pajtim me Nenin 67, paragrafi 3, mbrojtja e përkohshme sipas Nenit 67, paragrafët 1 dhe 2, hyn në fuqi nga data e publikimit.

5. Kërkesa Euro-PCT trajtohet si një kërkesë për patentë europiane dhe konsiderohet si arritje e mëparshme sipas Nenit 54, paragrafi 3, nëse janë përmbyllur kushtet e parashikuara në paragrafët 3 dhe 4 dhe në Rregulloret e Zbatimit.

¹ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

² Shih Marrëveshjen ndërmjet EPO-së dhe WIPO-së sipas PCT-së të datës 01.11.2001 (GZ EPO 2001, 601 e në vazhdim) të ndryshuar me fuqi nga data 01.01.2004 (GZ EPO 2003, 631). Një version i rishikuar i marrëveshjes mund të hyjë në fuqi më 13.12.2007 ose më 01.01.2008. Shih Njoftimin nga EPO në lidhje me kufizimin e kompetencës së EPO-së si një autoritet i PCT-së, GZ EPO 2006, 149 dhe 555.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

6. Raporti i kërimit ndërkombëtar i përpiluar në lidhje me një kërkesë Euro-CPT ose deklaratën që e zëvendëson atë dhe publikimi i tyre ndërkombëtar zë vendin e raportit të kërimit evropian dhe përmendjes së publikimit të tij në Buletinin e Patentave Europiane.

7.¹ Një raport shtesë kërkitimi evropian hartohet në lidhje me çdo kërkesë Euro-CPT sipas paragrafit 5. Këshilli Administrativ mund të vendosë që të hiqet dorë nga raporti shtesë i kërimit ose që të pakësohet tarifa e kërimit.

Neni 154²
(shfuqizuar)

Neni 155³
(shfuqizuar)

Neni 156⁴
(shfuqizuar)

Neni 157⁵
(shfuqizuar)

Neni 158⁶
(shfuqizuar)

PJESA XI
DISPOZITA KALIMTARE⁷
(shfuqizuar)

PJESA XII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 164⁸
Rregulloret dhe Protokollat zbatuese

1. Rregulloret zbatuese, Protokollin për Njohjen, Protokollin për Privilegjet dhe Imunitetet, Protokollin për Centralizimin, Protokollin për Interpretimin e Nenit 69 dhe Protokollin për gjendjen e personelit janë pjesë përbërëse të kësaj Konvente.

¹ Shih vendimin e Këshillit Administrativ të datës 21.12.1978 (GZ EPO 1979, 4, Corr. 50), 17.05.1979 (GZ EPO 1979, 248) dhe 09.06.1995 (GZ EPO 1995, 511) për të hequr dorë nga raporti shtesë i kërimit evropian. Këta vendime vazhdojnë të zbatohen për kërkesat e depozituara para datës 01.07.2005, por për ato të depozituara në ose pas asaj date, ata janë anuluar nga vendimi i këshillit të datës 10.06.2005 (GZ EPO 2005, 422), të ndryshuar më 27.10.2005 (GZ EPO 2005, 546), përveçse anulimi i vendimit të Këshillit të datës 21.12.1978 (GZ EPO 1979, 4, Corr. 50) nuk shtrohet për kërkesat ndërkombëtare për të cilat Zyra e Patentave Europiane harton raporte kërkitimi ndërkombëtar. Shih vendimin e Këshillit administrative të datës 10.06.2005 që zvogëlon tarifën për kërkitimin evropian shtesë (GZ EPO 2005, 422), i ndryshuar më 27.10.2005 (GZ EPO 2005, 546) dhe 15.12.2005 (GZ EPO 2006, 13 e në vazhdim). Shih gjithashtu vendimin e Këshillit të datës 14.09.1979 (GZ EPO 1979, 368), 11.12.1980 (GZ EPO 1981, 5), 09.12.1993 (GZ EPO 1994, 6) dhe 08.06.2000 (GZ EPO 2000, 321) që zvogëlon tarifën për kërkitimin evropian shtesë. Këta vendime vazhdojnë të zbatohen për kërkesat e depozituara para datës 01.07.2005; për ato të depozituara pas kësaj date, zbatohet vendimi i datës 27.10.2005 (GZ EPO 2005, 548).

² Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

³ Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

⁴ Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

⁵ Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

⁶ Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

⁷ Nenit 159, 160, 161, 162 dhe 163 ishin shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

⁸ Ndryshuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2.¹ Në rast mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të kësaj Konvente dhe atyre të Rregulloreve të Zbatimit, mbizotërojnë dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 165

Nënshkrimi – Ratifikimi N. 166, 178

1.² Konventa është e hapur për nënshkrim deri më 5 prill 1974 nga Shtetet që kanë marrë pjesë në Konferencën Ndër-Qeveritare për ngritjen e një Sistemi Europian për Dhënien e Patentave ose janë informuar për mbajtjen e kësaj konference dhe që u është ofruar mundësia e marrjes pjesë në të.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit; instrumentet e ratifikimit depozitohen pranë Qeverisë së Republikës Federale Gjermane.

Neni 166

Aderimi N. 35, 178

1. Kjo Konventë është e hapur për aderim nga:

- a) Shtetet e përmendur në Nenin 165, paragrafi 1;
- b) çdo Shtet tjetër Europian me ftesë të Këshillit Administrativ.

2. çdo Shtet që ka qenë palë në Konventë dhe ka pushuar së qeni si rezultat i zbatimit të Nenit 172, paragrafi 4, mund të bëhet përsëri palë në Konventë duke aderuar në të.

3. Instrumentet e aderimit depozitohen pranë Qeverisë së Republikës Federale Gjermane.

Neni 167³

(shfuqizuar)

Neni 168

Hapësira e përdorimit N. 178

1. Çdo Shtet Kontraktues mund të deklarojë në instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit, ose mund të informojë Qeverinë e Republikës Federale Gjermane me njoftim me shkrim në çdo moment pas kësaj, që kjo Konventë është e zbatueshme për një ose më shumë territore për marrëdhëniet me jashtë për të cilat është përgjegjëse. Patentat europiane të dhëna për atë Shtet Kontraktues kanë gjithashtu efekt në territoret për të cilat ka hyrë në fuqi një deklaratë e tillë.

2. Nëse deklarata e përmendur në paragrafin 1 gjendet në instrumentin e ratifikimit ose aderimit, ajo hyn në fuqi në të njëjtën datë si ratifikimi ose aderimi; nëse deklarata njoftohet pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit, një njoftim i tillë hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së saj nga Qeveria e Republikës Federale Gjermane.

3. Çdo Shtet Kontraktues në çdo kohë mund të deklarojë që Konventa pushon së zbatuari për disa ose për të gjithë territoret në lidhje me të cilat ai ka bërë njoftim në pajtim me paragrafin 1. Një deklaratë e tillë hyn në fuqi një vit pas datës në të cilën Qeveria e Republikës Federale Gjermane ka marrë njoftim për këtë.

Neni 169⁴

Hyrja në fuqi N. 178

1. Kjo Konventë hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të fundit të ratifikimit ose aderimit nga gjashtë Shtete në territorin e të cilëve numri i përgjithshëm i kërkesave për patenta të depozituara në vitin 1970 ka arritur në të paktën 180 000 për të gjitha këto Shtete.

¹ Shih vendimet/opinionet e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 2/95, G 6/95, G 1/02 (Aneksi I).

² Shtetet nënshkruese: AT, BE, CH, DE, DK, FR, GB, GR, IE, IT, LI, LU, MC, NL, NO, SE. Pjesëmarrësit në konferencë: shtetet nënshkruese plus ES, FI, PT, TR, YU. Shtetet e ftuar: Pjesëmarrësit në konferencë plus CY, IS.

³ Shfuqizuar me Aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000

⁴ Për Belgjikën, Gjermaninë, Francën, Luksemburgun, Holandën, Zvicrën dhe Mbretërinë e Bashkuar: 7 tetor 1977; Suedi: 1 maj 1978; Itali: 1 dhjetor 1978; Austri: 1 maj 1979; Lihtenshtajni: 1 prill 1980; Greqi dhe Spanjë: 1 tetor 1986; Danimarkë: 1 janar 1990; Monako: 1 dhjetor 1991; Portugali: 1 janar 1992; Irlandë: 1 gusht 1992; Finlandë: 1 mars 1996; Qipro: 1 prill 1998; Turqi: 1 nëntor 2000; Bullgari, Republika Çeke, Estoni, Sllovaki: 1 korrik 2002; Slloveni: 1 dhjetor 2002; Hungari: 1 janar 2003; Rumania: 1 mars 2003; Poloni: 1 mars 2004; Islandë: 1 nëntor 2004; Lituani: 1 dhjetor 2004; Letoni: 1 korrik 2005; Malta: 1 mars 2007.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Çdo ratifikim ose aderim pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit.

Neni 170

Kontributi fillestar

1. Çdo Shtet që ratifikon ose aderon në këtë Konventë pas hyrjes së saj në fuqi i paguan Organizatës një kontribut financiar, i cili nuk ri-imburohet.

2. Kontributi fillestar është 5% e shumës së llogaritur duke zbatuar përqindjen e përfutur për Shtetin në fjalë, në datën në të cilin hyn në fuqi ratifikimi ose aderimi, në pajtim me normën e parashikuar në Nenin 40, paragrafët 3 dhe 4, të shumës së kontributeve të veçanta financiare të kërkueshme nga Shtetet e tjera Kontraktuese në lidhje me periudhat financiare para datës së përmendur më sipër.

3. Në rastin kur kontributet e veçanta financiare nuk janë kërkuar në lidhje me periudhën financiare menjëherë para datës së përmendur në paragrafin 2, norma e kontributeve të përmendur në atë paragraf është norma që do të zbatohet për Shtetin përkatës në lidhje me vitin e fundit financiar për të cilin janë kërkuar kontributet financiare.

Neni 171

Kohëzgjatja e Konventës

Kjo Konventë është me kohëzgjatje të pakufizuar.

Neni 172

Rishikimi N. 35, 166, 175, 176

1. Kjo Konventë mund të rishikohet nga një Konferencë e Shteteve Kontraktuese.

2. Konferenca përgatitet dhe thirret nga Këshilli Administrativ. Konferenca nuk quhet e mbledhur në mënyrë të vlefshme nëse atje nuk përfaqësohen të paktën tre të katërtat e Shteteve Kontraktuese. Miratimi i tekstit të rishikuar kërkon një shumicë prej tre të katërtave të Shteteve Kontraktuese të përfaqësuar dhe që votojnë në Konferencë. Abstenimet nuk konsiderohen si vota.

3. Teksti i rishikuar hyn në fuqi nëse ai është ratifikuar ose është aderuar nga numri i Shteteve Kontraktuese të përcaktuar në Konferencë, dhe në momentin e përcaktuar nga Konferenca.

4. Këta Shtete që nuk kanë ratifikuar ose aderuar në tekstin e rishikuar të Konventës në momentin e hyrjes së saj në fuqi pushojnë së qeni palë në këtë Konventë që nga ai moment.

Neni 173

Mosmarrëveshjet ndërmjet Shteteve Kontraktuese

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Shteteve Kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente që nuk zgjidhet me bisedime, me kërkesë të një prej Shteteve të interesuara, i paraqitet Këshillit Administrativ, i cili përpiqet të arrijë marrëveshje ndërmjet Shteteve të interesuara.

2. Nëse një marrëveshje e tillë nuk arrihet brenda gjashtë muajve nga data kur mosmarrëveshja iu paraqit Këshillit Administrativ, secili prej Shteteve të interesuara mund t'ia paraqesë mosmarrëveshjen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për një vendim detyrues.

Neni 174

Denoncimi N. 175, 176, 178

Çdo Shtet Kontraktues mund ta denoncojë këtë Konventë në çdo kohë. Denoncimi i njoftohet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë. Ai hyn në fuqi një vit pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë.

Neni 175

Ruajtja e të drejtave të përfutura

1. Në rast se një Shtet pushon së qeni palë në këtë Konventë në pajtim me Nenin 172, paragrafi 4, ose Nenin 174, drejtat e përfutura sipas kësaj Konvente nuk cenohen.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Një kërkesë për patentë europiane në shqyrtim e sipër kur një Shtet i përcaktuar pushon së qeni palë në Konventë, trajtohet nga Zyra e Patentave Europiane, në lidhje me atë Shtet, sikur Konventa në fuqi pas kësaj të ishte në fuqi për atë Shtet.

3. Paragrafi 2 zbatohet për patentat europiane në lidhje me të cilat, në datën e përmendur në atë paragraf, është në shqyrtim e sipër një kundërshtim ose periudha e kundërshtimit nuk ka skaduar.

4. Asnjë në këtë Nen nuk ndikon të drejtën e asnjë Shteti që ka pushuar së qeni palë në këtë Konventë të trajtojë çdo patentë europiane në pajtim me tekstin kur ai ishte palë.

Neni 176

Të drejtat dhe detyrimet financiare të Shteteve Kontraktuese të mëparshme

1. Çdo Shtet i cili ka pushuar së qeni palë në këtë Konventë në pajtim me Nenin 172, paragrafi 4, ose Nenin 174, i ri-imbrusohen kontributet financiare të veçanta që ai ka paguar në pajtim me Nenin 40, paragrafi 2, nga Organizata vetëm në momentin kur dhe sipas kushteve që Organizata ri-imburson kontributet e veçanta financiare të paguara nga Shtetet e tjerë gjatë së njëjtës periudhë financiare.

2. Shteti i përmendur në paragrafin 1, edhe pas pushimit së qeni palë në këtë Konventë, vazhdon të paguajë pjesën sipas Nenit 39 të tarifave të mbajtjes në fuqi në lidhje me patentat europiane që mbeten në fuqi për atë shtet, me normën e datës në të cilën ai ka pushuar së qeni palë.

Neni 177

Gjuhët e Konventës

1. Kjo Konventë, e hartuar në një kopje origjinale të vetme, në gjuhën angleze, frënge dhe gjermane, depozitohet në arkivat e Qeverisë së Republikës Federale Gjermane, ku të tre tekstet janë njëllëj autentikë.

2. Tekstet e kësaj Konvente të hartuara në gjuhët zyrtare të Shteteve Kontraktuese të ndryshme nga ato të përcaktuara në paragrafin 1, nëse ato janë aprovuar nga Këshilli Administrativ, konsiderohen si tekste zyrtare. Në rastin e mosmarrëveshjeve në interpretimin e teksteve të ndryshëm, tekstet e përmendur në paragrafin 1 janë autentikë.

Neni 178

Transmetimi dhe njoftimet N. 165, 166, 169

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë përpilon kopje të certifikuara autentike të kësaj Konvente dhe ua transmeton ato Qeverive të të gjithë Shteteve nënshkrues dhe aderues.

2. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë njofton Qeverive të Shteteve të përmendur në paragrafin 1 për:

- a) depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi ose aderimi;
- b) çdo deklaratë ose njoftim të marrë sipas Nenit 168;
- c) çdo denoncim të marrë në pajtim me Nenin 174 dhe datën në të cilën hyn në fuqi një denoncim i tillë.

3. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë e regjistron këtë Konventë tek Sekretariati i Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, të Plotfuqishmit e autorizuar, duke paraqitur Plotfuqitë e tyre, të konstatuara në formën e duhur, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Munihi, më 5 tetor 1973.

Rregulloret zbatuese të Konventës për Dhënien e Patentave Europiane

Të datës 5 tetor 1973

Të miratuar me vendim të Këshillit Administrativ të Organizatës së Patentave Europiane të datës 7 dhjetor 2006

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

PJESA I RREGULLORE ZBATUESE TË PJESËS I TË KONVENTËS

KAPITULLI II DISPOZITAVE TË PËRGJITHSHME

Rregulli 1 Procedimi shkresor (R. 3, 35, 49, 50, 76, 89, 92, 114)

Në procedimet shkresore para Zyrës së Patentave Europiane, kërkesa për përdorimin e formës shkresore përmbushet nëse përmbajtja e dokumenteve mund të riprodhohet në një formë të lexueshme në letër.

Rregulli 2 Depozitimi dhe kërkesat formale të dokumenteve (R. 3, 31, 35, 49, 50, 92, 134)

1.¹ Në procedimet para Zyrës së Patentave Europiane, dokumentet mund të depozitohen nëpërmjet dorëzimit dorazi, me postë ose mjete teknike të komunikimit. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane përcakton hollësitë dhe kushtet dhe, sipas rastit, kërkesat e veçanta formale dhe teknike për depozitimin e dokumenteve. Veçanërisht, ai mund të përcaktojë që duhet të jepet konfirmimi. Nëse ky konfirmim nuk jepet në kohën e duhur, kërkesa për patentë europiane refuzohet; dokumentet e depozituara pastaj konsiderohen të mos jenë marrë.

2. Nëse Konventa parashikon që një dokument duhet të nënshkruhet, autenticiteti i dokumentit mund të konfirmohet nëpërmjet nënshkrimit me dorë ose mjete të tjera të përshtatshme përdorimi i të cilave është lejuar nga kryetari i Zyrës së Patentave Europiane. Një dokument i bërë autentik nëpërmjet një mjeti të tillë tjetër konsiderohet të përmbushë kërkesat ligjore të nënshkrimit në të njëjtën mënyrë si një dokument që ka nënshkrimin me dorë që është dorëzuar në format letre.

Rregulli 3² Gjuha në procedimin shkresor (N. 14, 99, 105, 108 R. 1, 77, 89, 101)

1. Në procedimet shkresore para Zyrës së Patentave Europiane, secila palë mund të përdorë çdo gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane. Përkthimi i përmendur në Nenin 14, paragrafi 4, mund të depozitohet në çdo gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane.

2. Ndryshimet në një kërkesë për patentë europiane ose në një patentë europiane depozitohen në gjuhën e procedimit.

3. Provat shkresore dhe, veçanërisht, publikimet mund të depozitohen në çdo gjuhë. Zyra e Patentave Europiane mund të kërkojë që të depozitohet një përkthim në një prej gjuhëve të saj zyrtare brenda një periudhe kohore që përcaktohet. Nëse një përkthim i kërkuar nuk depozitohet në kohën e duhur, Zyra e patentave Europiane mund të mos e marrë parasysh dokumentin në fjalë.

Rregulli 4 Gjuha në procedimin gojor N. 14, 116, 117, 123 R. 120

1. Secila palë në procedimet gojore para Zyrës së Patentave Europiane mund të përdorë një gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane të ndryshme nga gjuha e procedimit, nëse kjo palë e njofton Zyrën e Patentave Europiane të paktën një muaj para datës së këtij procedimi gojor ose merr masa për përkthimin në gjuhën e procedimit. Secila palë mund të përdorë një gjuhë zyrtare të një Shteti Kontraktues, nëse ai merr masa për përkthimin në gjuhën e procedimit. Zyra e Patentave Europiane mund të lejojë devijime nga këto dispozita.

2. Gjatë procedimit gojor, punonjësit e Zyrës së Patentave Europiane mund të përdorin një gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane të ndryshme nga gjuha e procedimit.

3. Kur merren provat, secila palë, dëshmitar ose ekspert që dëgjohet, i cili nuk është në gjendje të shprehet

¹ Shih vendimet e Kryetarit të EPO-së, Botim i veçantë nr 3, GZ EPO 2007, A.3., A.4., A.5.

² Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/99 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

në mënyrën e përshtatshme në një gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane ose të një Shteti Kontraktues mund të përdorë një gjuhë tjetër. Nëse merret prova me kërkesë të një pale, palët, dëshmitarët ose ekspertët që shprehen në një gjuhë të ndryshme nga një gjuhë zyrtare e Zyrës së Patentave Europiane dëgjohen vetëm nëse ajo palë merr masa për përkthimin në gjuhën e procedimit. Megjithatë, Zyra e Patentave Europiane mund të lejojë përkthimin në një nga gjuhët e saj zyrtare të tjera.

4. Nëse palët dhe Zyra e Patentave Europiane bien dakord, mund të përdoret çdo gjuhë.

5. Zyra e Patentave Europiane, nëse është e nevojshme, merr masa, me shpenzimet e saj, për përkthimin në gjuhën e procedimit, ose, sipas rastit, në gjuhët e tjera të saj zyrtare, përveç kur ky përkthim është përgjegjësi e një prej palëve.

6. Deklarimet e punonjësve të Zyrës së Patentave Europiane, palëve, dëshmitarëve ose ekspertëve të bëra në një gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane futet në protokoll në atë gjuhë. Deklarimet e bëra në një gjuhë tjetër futet në gjuhën zyrtare në të cilën ato përkthehen. Ndryshimet tek një kërkesë për patentë europiane ose patentë europiane futen në protokoll në gjuhën e procedimit.

Rregulli 5

Certifikimi i përkthimeve N. 14, 88 R. 7

Nëse kërkohet përkthimi i një dokumenti, Zyra e patentave Europiane mund të kërkojë që të depozitohet një vërtetim brenda një kohe të caktuar që përkthimi përputhet me tekstin origjinal. Nëse vërtetimi nuk depozitohet në kohën e duhur, ky dokument konsiderohet të mos jetë depozituar, përveç kur parashikohet ndryshe.

Rregulli 6

Depozitimi i përkthimeve dhe zbritja e tarifave N. 14, 61, 78, 88, 90, 99, 105a/bis, 105b/ter, 108 R. 70

1. Një përkthim sipas Nenit 14, paragrafi 2, depozitohet brenda dy muajve nga depozitimi i kërkesës për patentë europiane.

2. Një përkthim sipas nenit 14, paragrafi 4, depozitohet brenda një muaji nga depozitimi i dokumentit. Kjo zbatohet edhe për kërkesat sipas Nenit 105a. Nëse një dokument është një njoftim apelimi ose ankimi, ose një deklarambi arsyetimin e ankimit, ose një kërkesë për rishikim, përkthimi mund të depozitohet brenda periudhës së depozitimit të këtij njoftimi ose deklarambi ose kërkesës, nëse ai afat skadon më vonë.

3.¹ Nëse një person i përmendur në Nenin 14, paragrafi 4, depoziton një kërkesë për patentë europiane, një kërkesë për shqyrtim, një apelim, një ankim, një kërkesë për rishikim ose një kërkesë për kufizimin ose revokim në një gjuhë të pranuar në atë dispozitë, tarifa e depozitimit, tarifa e shqyrtimit, tarifa e apelimit, tarifa e ankimit, tarifa e kërkesës për rishikim ose tarifa e kufizimit apo revokimit reduktohet në pajtim me Rregullat në lidhje me Tarifat.

Rregulli 7

Autenticiteti ligjor i përkthimit të kërkesës për patentë europiane N. 70, 123R. 5

Përveç kur provat jepen për të kundërtën, Zyra e Patentave Europiane prezumon që për qëllimin e përcaktimit nëse objekti i një kërkesë për patentë europiane ose patente europiane shkon tej përmbajtjes së kërkesës së depozituar, që përkthimi i depozituar sipas Nenit 14, paragrafi 2, ose Rregullit 40, paragrafi 3, të jetë në pajtim me tekstin origjinal të kërkesës.

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 6/91 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KAPITULLI II ORGANIZIMI I ZYRËS SË PATENTAVE EUROPIANE

SEKSIONI 1 ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME

Rregulli 8 N. 15 ; R. 11, 61

Klasifikimi i patentave

Zyra e Patentave Europiane përdor klasifikimin e përmendur në Nenin 1 të Marrëveshjes së Strasburgut në lidhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Patentave të datës 24 mars 1971, dhe këtu quhet klasifikimi ndërkombëtar.

Rregulli 9 N. 10, 15

Struktura administrative e Zyrës së Patentave Europiane

1. Zyra e Patentave Europiane ndahet administrativisht në Drejtori të Përgjithshme, nga të cilat varen organet sipas Nenit 15, dhe shërbimet e ngritura për të trajtuar çështjet ligjore dhe administrimin e brendshëm të Zyrës.

2. Secila Drejtori i Përgjithshme drejtohet nga një Zëvendëskryetar. Caktimi i një Zëvendëskryetari tek një Drejtori e Përgjithshme bëhet nga Këshilli Administrativ, pasi të jetë konsultuar me Kryetarin e Zyrës së Patentave Europiane.

Rregulli 10 N. 15, 16, 18, 90, 93, R. 11, 159

Kompetenca e Sektorit të Pranimit dhe Sektorit të Ekzaminimit

1. Sektori i Pranimit është përgjegjës për shqyrtimin e depozitimit dhe shqyrtimin në lidhje me kërkesat formale të një kërkesë për patentë Europiane deri në momentin kur bëhet i përgjegjshëm Sektori i Ekzaminimit për shqyrtimin e kërkesës për patentë europiane sipas Nenit 94, paragrafi 1.

2. Në pajtim me paragrafët 3 dhe 4, Sektori i Ekzaminimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për patentë europiane sipas Nenit 94, paragrafi 1, nga momenti kur depozitohet kërkesa për shqyrtim

3. Nëse depozitohet një kërkesë për shqyrtim para se kërkesit t'i transmetohet raporti i kërimit europian, Sektori i Ekzaminimit, në pajtim me paragrafin 4, është përgjegjës nga momenti kur Zyra e Patentave Europiane merr një të dhënë sipas Rregullit 70, paragrafi 2.

4. Nëse një kërkesë për shqyrtim depozitohet para se kërkesit t'i jepet raporti i kërimit europian dhe nëse kërkesi ka hequr dorë nga e drejta sipas Rregullit 70, paragrafi 2, Sektori i Ekzaminimit është përgjegjës nga momenti kur raporti i kërimit i transmetohet kërkesit.

Rregulli 11¹ N. 10, 15-20, 104, R. 8, 10, 88

Ndarja e detyrave në shkallë të parë

1. Shqyrtuesit e kualifikuar teknikisht që veprojnë si anëtarë të Sektorëve të Kërimit, Ekzaminimit ose Apelimit caktohen nëpër Drejtori. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane u cakton këtyre drejtorive detyra duke iu referuar klasifikimit ndërkombëtar.

2.² Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane mund t'u caktojë edhe detyra të tjera Sektorit të Pranimit, Sektorëve të Kërimit, Ekzaminimit dhe Apelimit, si dhe Sektorit Juridik, përveç përgjegjësive që atyre u vishen në pajtim me Konventën.

3.³ Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane mund të ngarkojë punonjësit që nuk janë shqyrtues të kualifikuar teknikisht apo ligjrisht me kryerjen e detyrave që u takojnë Sektorëve të Kërimit, Ekzaminimit ose Apelimit dhe që nuk kanë vështirësi teknike ose ligjore.

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 1/02 (Aneksi I).

² Shih vendimet e Kryetarit të EPO-së, Botim i veçantë nr 3, GZ EPO 2007, G.1.

³ Shih vendimet e Kryetarit të EPO-së, Botim i veçantë nr 3, GZ EPO 2007, F.2.

Përmbledhje legjislativi për pronësinë industriale

SEKSIONI 2

ORGANIZIMI I BORDEVE TË APELIT DHE BORDIT TË ZGJERUAR TË APELIT

Rregulli 12¹ N. 15, 21, 23, 134a/bis

Kryesia e Bordeve të Apelit

1. Autoriteti autonom brenda njësisë organizative që përbëhet nga Bordet e Apelit (Kryesia e Bordeve të Apelit²) ka në përbërje Zëvendëskryetarin përgjegjës për Bordet e Apelit që vepron si kryetar dhe dymbëdhjetë anëtarë të Bordeve të Apelit, ku gjashtë janë Kryetarë dhe gjashtë janë anëtarë të tjerë.

2. Të gjithë anëtarët e Kryesisë zgjidhen nga Kryetarët dhe anëtarët e Bordeve të Apelit për dy vite pune. Nëse përbërja e plotë e Kryesisë nuk mund të arrihet, vendet bosh zihen duke caktuar Kryetarët me përvojën më të gjatë dhe anëtarët.

3. Kryesia miraton Rregullat e Procedurës të Bordeve të Apelit dhe Rregullat e Procedurës për zgjedhjen dhe caktimin e anëtarëve të tij. Kryesia vazhdon të këshillojë Zëvendëskryetarin përgjegjës për Bordet e Apelit në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e Bordeve të Apelit në përgjithësi.

4. Para fillimit të çdo viti pune, Kryesia, e zgjeruar për të përfshirë të gjithë Kryetarët, u cakton detyra Bordeve të Apelit. Në të njëjtën përbërje, ajo vendos mbi konfliktet në lidhje me caktimin e detyrave ndërmjet dy ose më shumë Bordeve të Apelit. Kryesia e zgjeruar cakton anëtarët e rregullit dhe zëvendës të Bordeve të ndryshme të Apelit. Çdo anëtar i një Bordi Apeli mund të caktohet si anëtar i më shumë se një Bordi Apeli. Këto masa, sipas rastit, mund të ndryshohen gjatë vazhdimin të vitit ushtrimor në fjalë.

5. Kryesia ka fuqi vendimmarrëse vetëm nëse janë të pranishëm të paktën pesë anëtarë të saj, dhe këta duhet të përfshijnë Zëvendëskryetarin përgjegjës për Bordin e Apelit ose zëvendësin e tij dhe Kryetarët e dy Bordeve të Apelit. Nëse bëhet fjalë për detyrat e përmendura në paragrafin 4, nëntë anëtarë duhet të jenë të pranishëm, duke përfshirë Zëvendëskryetarin përgjegjës për Bordet e Apelit ose zëvendësin e tij dhe Kryetarët e tre Bordeve të Apelit. Vendimet merren me shumicë votash; në rastin e ndarjes së votave, Kryetari ose zëvendësi i tij kanë votën vendimtare. Abstenimet nuk konsiderohen vota.

6. Këshilli Administrativ mund t'u caktojë Bordeve të Apelit detyra sipas Nenit 134a, paragrafi 1(c).

Rregulli 13² N. 23

Plani i shpërndarjes së punës për Bordin e

Zgjeruar të Apelit dhe miratimi i Rregullave të tij Procedurale

1. Para fillimit të çdo viti ushtrimor, anëtarët e Bordit të Zgjeruar të Apelit të emëruar sipas nenit 11, paragrafi 3, caktojnë anëtarët e përhershëm dhe përfaqësues të Bordit të Zgjeruar të Apelit në procedimet sipas nenit 22, paragrafi 1(a) dhe (b) dhe anëtarët e përhershëm dhe përfaqësues të tyre në procedimet sipas nenit 22, paragrafi 1(c).

2.³ Anëtarët e Bordit të Zgjeruar të Apelit të emëruar sipas nenit 11, paragrafi 3, miraton Rregullat procedurale të Bordit të Zgjeruar të Apelit.

3. Vendimet për çështjet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 mund të merren vetën nëse janë të pranishëm të paktën pesë anëtarë, duke përfshirë Kryetarin e Bordit të Zgjeruar të Apelit ose zëvendësin e tij; në rastin e ndarjes së votave, kryetari ose zëvendësi i tij kanë votën vendimtare. Abstenimet nuk konsiderohen si vota.

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 6/95 (Aneksi I).

² Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 6/95 (Aneksi I).

³ Shih Rregullat Procedurale të Bordit të Zgjeruar të Apelit, GZ EPO 2007, 303.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

PJESA II RREGULLORE ZBATUESE TË PJESËS II TË KONVENTËS

KAPITULLI I PROCEDURA NËSE KËRKUESI NUK KA TË DREJTË

Rregulli 14¹ N. 61, 86, 93, 99, R. 143

Pezullimi i procedimit

1. Nëse një palë e tretë paraqet prova që ajo ka filluar procedim kundër kërkesit duke kërkuar një vendim brenda kuptimit të Nenit 61, paragrafi 1, procedimi për dhënien pezullohet, përveç kur pala e tretë i komunikon Zyres së Patentave Europiane me shkrim pëlqimin e tij për vazhdimin e këtij procedimi. Ky pëlqim është i parevokueshëm. Megjithatë, procedimi për dhënien nuk pezullohet para publikimit të kërkesës për patentë europiane.

2. Nëse jepen prova që është marrë një vendim i formës së prerë brenda kuptimit të Nenit 61, paragrafi 1, Zyra e Patentave Europiane informon kërkesin dhe çdo palë tjetër që procedimi për dhënien do të vazhdojë nga data e caktuar në njoftim, përveç kur është depozituar një kërkesë e re për patentë europiane sipas Nenit 61, paragrafi 1(b) për të gjithë Shtetet Kontraktues të caktuar. Nëse vendimi është në favor të një pale të tretë, procedimi mund të mos vazhdojë pa kaluar tre muaj pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë, përveç kur pala e tretë kërkon vazhdimin.

3. Me pezullimin e procedimit për dhënien, ose pas kësaj, Zyra e Patentave Europiane mund të caktojë një datë në të cilën ajo synon të vazhdojë procedimin për dhënien, pavarësisht fazës së arritur në procedimin kombëtar të filluar sipas paragrafit 1. Ajo ia bën të ditur këtë datë palës së tretë, kërkesit dhe çdo pale tjetër. Nëse deri në atë datë nuk është dhënë asnjë provë që është marrë një vendim i formës së prerë, Zyra e Patentave Europiane mund të vazhdojë procedimin.

4. Të gjitha afatet e ndryshme nga ato për pagimin e tarifave të mbajtjes në fuqi, që kanë filluar të ecin në datën e pezullimit të procedimit, ndërpriten nga ky pezullim. Pjesa që nuk ka kaluar fillon të ecë në datën në të cilin rifillon procedimi. Megjithatë, afati që mbetet pas këtij rifillimi nuk duhet të jetë më i shkurtër se dy muaj.

Rregulli 15² N. 61, 79

Kufizimi i heqjes dorë

Nga data në të cilën një palë e tretë jep prova që ajo ka filluar një procedim kombëtar sipas Rregullit 14, paragrafi 1, dhe deri në datën në të cilën rifillon procedura për dhënien, nuk mund të tërhiqet as kërkesa për patentë europiane dhe as caktimi i një Shteti Kontraktues.

Rregulli 16 N. 61, 122, 128, R. 17, 60, 78, 136, 143, 147

Procedura sipas neni 61, paragrafi 1

1. Një person që ka të drejtën për t'iu dhënë një patentë europiane mund të përdorë mjetet e mbrojtjes sipas Nenit 61, paragrafi 1, nëse:

- a) ai e bën këtë jo më vonë se tre muaj pasi vendimi që njeh të drejtën e tij ka marrë formë të prerë, dhe
- b) patentat europiane nuk është dhënë akoma.

2. Këto mjete mbrojtjeje zbatohen vetëm në lidhje me Shtetet Kontraktuese të caktuar në kërkesën për patentë europiane në të cilët vendimi është marrë ose njohur ose duhet të njihet mbi bazën e protokollit mbi Njohjen.

Rregulli 17³ N. 76, 78, 79, R. 16, 18, 78

Depozitimi i një kërkesë të re për patentë europiane nga personi që ka të drejtën

1. Nëse një person që konstatohet me vendim të formës së prerë se ka të drejtë për marrjen e patentës europiane depoziton një kërkesë tjetër për patentë europiane sipas Nenit 61, paragrafi 1(b), kërkesa origjinale

¹ Shih vendimin e Kryetarit të EPO-së, Botim i veçantë nr 3, GZ EPO 2007, G.1; shih gjithashtu vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/92 (Aneksi I).

² Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/92 (Aneksi I).

³ Shih vendimin/opinionin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/92 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

konsiderohet të jetë tërhequr në datën e depozitimit të kërkesës së re për Shtetet Kontraktuese të përcaktuara në të, në të cilën vendimi është marrë ose njohur apo duhet të njihet në bazë të Protokollit për Njohjen.

2. Tarifa e depozitimit dhe tarifa e kërimit paguhet brenda një muaji nga depozitimi i kërkesës së re. Nëse tarifa e depozitimit ose tarifa e kërimit nuk paguhet në kohën e duhur, kërkesa konsiderohet të jetë tërhequr.

3. Tarifat e përcaktimit paguhen brenda gjashtë muajve nga data në të cilën Buletini i Patentave Europiane përmend publikimin e raportit të kërimit europian të përpiluar në lidhje me kërkesën e re. Zbatohet rregulli 39, paragrafët 2 dhe 3.

Rregulli 18¹ N. 61, 101, 118, 123, R. 138

Transferimi i pjesshëm i së drejtës për patentën europiane

1. Nëse një vendim i formës së prerë përcakton që një palë e tretë ka të drejtë për marrjen e një patente europiane në lidhje me vetëm një pjesë të objektit të treguar në kërkesën e parë për patentë europiane, për këtë pjesë zbatohet Neni 61, dhe Rregullat 16 dhe 17.

2. Sipas rastit, për Shtetet Kontraktuese të përcaktuara tek të cilët është marrë, njohur apo duhet të njihet vendimi në pajtim me Protokollin mbi Njohjen, kërkesa e parë për patentë europiane përmban pretendime, një përshkrim dhe skica që janë të ndryshme nga ato për Shtetet e tjerë Kontraktuese të Përcaktuara.

KAPITULLI II PËRMENDJA E SHPIKËSIT

Rregulli 19 N. 62, 128, R. 21, 60, 163

Përmendja e shpikësit

1. Kërkesa për dhënien e një patente europiane përmban përcaktimin e shpikësit. Megjithatë, nëse kërkuksi nuk është shpikësi ose nuk është shpikësi i vetëm, përcaktimi depozitohet në një dokument të veçantë. Përcaktimi përmban mbiemrin, emrat dhe adresën e plotë të shpikësit, deklarin e përmendur në Nenin 81 dhe ka firmën e kërkuksit ose përfaqësuesit të tij.

2. Zyra e Patentave Europiane nuk verifikon saktësinë e përmendjes së shpikësit.

3. Nëse kërkuksi nuk është shpikësi ose nuk është shpikësi i vetëm, Zyra e Patentave Europiane i komunikon shpikësit të përcaktuar informacionin në dokumentin që e përcakton atë dhe të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin e kërkesës për patentë europiane;
- b) datën e depozitimit të kërkesës për patentë europiane dhe, nëse është pretenduar prioritet, datën, Shtetin dhe numrin e dosjes së kërkesës së mëparshme;
- c) emrin e kërkuksit;
- d) titullin e shpikjes;
- e) Shtetet Kontraktuese të Përcaktuara.

4. Kërkuksi dhe shpikësi mund të kryejnë komunikimin sipas paragrafit 3 për gabimet që përmbahen në aplikim.

Rregulli 20 N. 62, 81, 93, 98, 103, 105c/quarter, R. 144

Publikimi i emrit të shpikësit

1. Shpikësi i emërtuar përmendet në kërkesën e publikuar për patentë europiane dhe specifikimin e patentës europiane, përveç kur ai informon Zyrën e Patentave Europiane me shkrim që ai heq dorë nga drejtë për t'u përmendur në këtë mënyrë.

2. Paragrafi 1 zbatohet nëse një palë e tretë depoziton tek Zyra e Patentave Europiane një vendim të formës së prerë që shprehet që kërkuksi ose pronari i një patente europiane duhet ta përcaktojë atë si shpikës.

Rregulli 21 N. 62, 81, 98, 103, 105c/quarter, 127, 129

Korrigjimi i emërimit të shpikësit

1. Një emërtim i pasaktë i një shpikësi mund të korrigjohet me kërkesë dhe vetëm me pëlqimin e personit të

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/92 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

përcaktuar gabim dhe, nëse kjo kërkesë depozitohet nga një palë e tretë, pëlqimin e kërkuarit ose pronarit të patentës. Rregulli 19 zbatohet mutatis mutandis.

2. Nëse një emërtim i pasaktë i shpikësit është regjistruar në Regjistrin e Patentave Europiane ose publikohet në Buletin e Patentave Europiane, korrigjimi ose anulimi i tij regjistrohet ose publikohet atje.

KAPITULLI III

REGJISTRIMI I TRANSFERIMEVE, LICENCEVE DHE TË DREJTAVE TË TJERA

Rregulli 22¹ N. 71, 72, 127, R. 23, 85, 143

Regjistrimi i transferimeve

1. Transferimi i një kërkesë për patentë europiane regjistrohet në Regjistrin e Patentave Europiane me kërkesë të një pale të interesuar, me paraqitjen e dokumenteve që provojnë këtë transferim.

2. Kërkesa nuk konsiderohet të jetë depozituar derisa nuk është paguar një tarifë administrative. Ajo mund të refuzohet vetëm nëse nuk është respektuar paragrafi 1.

3. Një transferim ka efekt ndaj Zyrës së Patentave Europiane vetëm në datën dhe në masën që janë paraqitur dokumentet e përmendur në paragrafin 1.

Rregulli 23² N. 71, 73, 127, R. 143

Regjistrimi i licencave dhe të drejtave të tjera

1. Rregulli 22, paragrafët 1 dhe 2, zbatohen mutatis mutandis për regjistrimin e dhënies ose transferimit të një licence, krijimin ose transferimin e një të drejte in rem në lidhje me një kërkesë për patentë europiane dhe çdo mjet ligjor ekzekutimi që prek një kërkesë të tillë.

2. Një regjistrim sipas paragrafit 1 anulohet me kërkesë, shoqëruar me dokumentet që provojnë që e drejta është parashkruar ose me pëlqimin me shkrim të pronarit të së drejtës për anulimin e regjistrimit. Rregulli 22, paragrafi 2, zbatohet mutatis mutandis.

Rregulli 24³ N. 73, 127

Të dhëna të veçanta për regjistrimet e licencave

Një licencë në lidhje me një kërkesë për patentë europiane regjistrohet

- a) si një licencë ekskluzive nëse këtë e kërkojnë kërkuari dhe i licencuari;
- b) si nën-licencë nëse ajo jepet nga një i licencuar licenca e të cilit është regjistruar në Regjistrin e Patentave Europiane.

KAPITULLI IV

VËRTETIMI I EKSPOZIMIT

Rregulli 25⁴ R. 159

Vërtetimi i ekspozimit

Brenda katër muajve nga depozitimi i kërkesës për patentë europiane, kërkuari depoziton certifikatën e përmendur në Nenin 55, paragrafi 2, që:

- a) lëshohet në ekspozitë nga autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e pronësisë industriale në atë ekspozitë;
- b) deklaron që shpikja është ekspozuar faktikisht atje;
- c) tregon datën e hapjes së ekspozitës dhe, nëse shpikja është ekspozuar më vonë se ajo datë, datën në të cilën është ekspozuar së pari shpikja; dhe
- d) shoqërohet nga një identifikim i shpikjes, të certifikuar rregullisht nga autoriteti i sipërpërmendur.⁵

¹ Shih vendimin e Kryetarit të EPO-së, Botim i veçantë nr 3, GZ EPO 2007, G.1;

² Shih vendimin e Kryetarit të EPO-së, Botim i veçantë nr 3, GZ EPO 2007, G.1;

³ Shih vendimin e Kryetarit të EPO-së, Botim i veçantë nr 3, GZ EPO 2007, G.1;

⁴ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/98, G 2/99 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KAPITULLI V SHPIKJET BIOTEKNOLOGJIKE

Rregulli 26¹ N. 52, 53; R. 31, 32, 33, 34
Të përgjithshme dhe përkufizime

1. Kërkesat për patentë dhe patentat europiane në lidhje me shpikjet bioteknologjike, dispozitat përkatëse të Konventës zbatohen dhe interpretohen në pajtim me dispozitat e këtij Kapitulli. Direktiva 98/44/EC e datës 6 korrik 1998² mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike përdoren si mjet shtesë për interpretimin.

2. "Shpikje bioteknologjike" janë shpikjet që kanë të bëjnë me një produkt që përbëhet ose përmban material biologjik ose një proces nëpërmjet të cilit prodhohet, përpunohet ose përdoret material biologjik.

3. "Material biologjik" është çdo material që përmban informacion gjenetik dhe në gjendje për të riprodhuar veten ose të riprodhohet në një sistem biologjik.

4. "Varietet bimor" është çdo grupim bimor brenda një kategorie të vetme botanike të nivelit më të ulët të njohur, grupimi i të cilit, pavarësisht nëse përmbushen plotësisht kushtet për dhënien e një të drejte për varietetin bimor, mund të jetë:

a) i përkufizuar nëpërmjet shprehjes së karakteristikave si rezultat i një gjenotipi ose kombinimi gjenotipesh të dhëna;

b) dallohet nga çdo grupim tjetër bimor nga shprehja e të paktën një prej karakteristikave të dhëna, dhe

c) konsiderohet si njësi në lidhje me përshtatshmërinë e tij për t'u riprodhuar i pandryshuar.

5. Një proces për prodhimin e bimëve ose kafshëve është thelbësisht biologjik nëse ai përbëhet tërësisht nga fenomene natyrore si kryqëzimi ose përzgjedhja.

6. "Procesi mikrobiologjik" është çdo proces që përfshin ose realizohet ose rezulton në material mikrobiologjik.

Rregulli 27 N. 52

Shpikjet bioteknologjike të patentueshme

Shpikjet bioteknologjike janë të patentueshme edhe nëse kanë të bëjnë me:

a) material biologjik që është i izoluar nga ambienti natyror ose prodhohet me anë të një procesi teknik edhe nëse më parë ka ndodhur në natyrë;

b) bimë dhe kafshë nëse fizibiliteti teknik i shpikjes nuk kufizohet në një varietet të caktuar bimor ose shtazor;

c) një proces mikrobiologjik ose tjetër teknik, ose një produkt të përfutur nëpërmjet një procesi të tillë të ndryshëm nga një varietet bimor ose shtazor.

Rregulli 28

Përjashtimet e patentueshmërisë

Sipas Nenit 53(a), patentat europiane nuk jepen në lidhje me shpikjet bioteknologjike që, veçanërisht, kanë të bëjnë me sa më poshtë:

a) proceset për klonimin e qenieve njerëzore;

b) proceset për modifikimin e identitetit gjenit të linjës së embrionit të qenieve njerëzore;

c) përdorimet e embrioneve njerëzore për qëllime industriale ose tregtare;

d) proceset për modifikimin e identitetit gjenetik të kafshëve që mund t'u shkaktojnë atyre vuajtje pa asnjë përfitim mjekësor thelbësor për njeriun ose kafshët dhe gjithashtu kafshë që rrjedhin nga këto procese.

Rregulli 29 N. 52, 53, 5; R. 42

Trupi i njeriut dhe pjesët përbërëse të tij

1. Trupi i njeriut, në faza të ndryshme të formimit dhe zhvillimit të tij, dhe zbulimi i thjeshtë i një prej elementëve të tij duke përfshirë sekuencën ose sekuencën e pjesshme të një gjeni nuk mund të përbëjë shpikje të patentueshme.

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/98, G 1/98 (Aneksi I).

² Shih GZ EPO 1999, 101.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Një element i veçuar nga trupi i njeriut ose i prodhuar ndryshe nga një proces teknik, duke përfshirë sekuencën ose sekuencën e pjesshme të një gjeni, mund të përbëjë një shpikje të patentueshme, edhe nëse struktura e atij elementi është identik me atë të një elementi natyror.

3. Aplikimi industrial i një sekuence ose sekuence të pjesshme të një gjeni duhet të deklarohet në kërkesën për patentë.

Rregulli 30¹ N. 56, 57, 80; R. 42

Formalitetet e kërkesave për patentë europiane në lidhje me sekuencat nucleotide dhe aminoacide

1. Nëse sekuencat nukleotide dhe aminoacide deklarohen në kërkesën për patentë europiane, përshkrimi përmban një renditje të sekuencave në pajtim me rregullat e vendosura nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane për përfaqësimin e standardizuar të sekuencave nukleotide dhe aminoacide.

2. Një renditje e sekuencave e depozituar pas datës së depozitimit nuk është pjesë e përshkrimit.

3. Nëse kërkuesi nuk ka depozituar një protokoll të sekuencave në pajtim me kërkesat sipas paragrafit 1 në datën e depozitimit, Zyra e Patentave Europiane fton kërkuetin për të paraqitur këtë protokoll të sekuencave dhe të paguajë tarifën e paraqitjes së vonuar. Nëse kërkuesi nuk paraqet protokollin e sekuencave të kërkuara dhe paguan tarifën për paraqitje të vonuar brenda një periudhe prej dy muajsh pas një ftese të tillë, kërkesa refuzohet.

Rregulli 31² N. 78, 83, 128, 129; R. 26, 34

Depozitimi i materialit biologjik

1. Nëse një shpikje përfshin përdorimin ose ka të bëjë me material biologjik që nuk i ofrohet publikut dhe nuk mund të përshkruhet në kërkesën për patentë europiane në mënyrë të tillë që shpikja të realizohet nga një person me aftësi në atë fushë, shpikja konsiderohet e deklaruar sipas parashikimit në Nenin 83, nëse:

a) një kampion i materialit biologjik është depozituar tek një institucion depozitues i njohur me të njëjtat kushte si ato të parashikuara në Traktatin e Budapestit mbi Njohjen Ndërkombëtare të Depozitimit të Mikroorganizmave për Qëllimet e Procedurave të Patentave të datës 28 prill 1977 jo më vonë se data e depozitimit të kërkesës;

b) kërkesa e depozituar jep atë informacion përkatës që ka kërkuesi mbi karakteristikat e materialit biologjik;

c) institucioni depozitues dhe numri i hyrjes së materialit biologjik të depozituar tregohen në kërkesë, dhe

d) nëse materiali biologjik është depozituar nga një person i ndryshëm nga kërkuesi, emri dhe adresa e depozituesit tregohen në kërkesë dhe Zyrës së Patentave Europiane i paraqitet një dokument që provon se depozituesi ka autorizuar kërkuetin t'i referohet materialit biologjik të depozituar në kërkesë dhe ka dhënë pëlqimin e tij të plotë dhe të pakthyeshëm që materiali i depozituar t'i ofrohet publikut në pajtim me Rregullin 33.

2. Informacioni i përmendur në paragrafin 1(c) dhe (d) mund të paraqitet:

a) brenda gjashtëmbëdhjetë muajve pas datës së depozitimit të kërkesës ose, nëse është pretenduar prioriteti, pas datës së prioritetit, dhe ky afat konsiderohet të jetë respektuar nëse informacioni komunikohet para përfundimit të përgatitjeve teknike për publikimin e kërkesës për patentë europiane;

b) deri në datën e paraqitjes së një kërkesë sipas Nenit 93, paragrafi 1(b);

c) brenda një muaji pasi Zyra e Patentave Europiane i ka komunikuar kërkuetit që ekziston e drejta për të inspektuar dosjet sipas Nenit 128, paragrafi 2. Afati që merret parasysh është ai që skadon i pari. Komunikimi i këtij informacioni konsiderohet të përbëjë pëlqimin e plotë dhe të pakthyeshëm të kërkuetit që materiali biologjik i depozituar t'i ofrohet publikut në pajtim me Rregullin 33.

Rregulli 32 N. 78, 83, 128, 129 ; R. 26, 34, 67

Zgjidhja me ekspertizë

1.³ Deri në përfundimin e përgatitjeve teknike për publikimin e kërkesës për patentë europiane, kërkuesi mund të informojë Zyrën e Patentave Europiane që:

¹ Shih vendimin e Kryetarit të EPO-së dhe Njoftimin nga EPO, Botim i veçantë nr 3, GZ EPO 2007, C.1, dhe C.2.

² Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 2/98, (Aneksi I).

³ Njoftim i Kryetarit të EPO-së, datë 28.07.1981 në lidhje me procedurën për informimin e EPO-së që "është zgjedhur opsioni i ekspertit dhe publikimi i atij fakti (GZ EPO 1981, 358).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

a) deri në momentin e publikimit të përmendjes së dhënies së patentës europiane ose, sipas rastit,
b) për njëzet vjet nga data e depozitimit, nëse kërkesa refuzohet tërhiqet ose konsiderohet të jetë tërhequr, që disponibiliteti i përmendur në Rregullin 33 do të kryhet vetëm nga lëshimi i një kampioni një ekspert i caktuar nga kërkuuesi.

2. Të mëposhtmit mund të emërohen si ekspertë:

a) një person fizik, me kusht që kërkuuesi, gjatë depozitimit të kërkesës, të vërtetojë që emërtimi i tij ka aprovimin e kërkuarit;

b)¹ një person fizik i njohur si ekspert nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane. Caktimi shoqërohet nga një deklaratë nga eksperti kundrejt kërkuarit në të cilën ai merr përsipër detyrimin e parashikuar në Rregullin 33 deri në datën në të cilën skadon patentë në të gjithë Shtetet e përcaktuara ose, nëse kërkesa refuzohet, tërhiqet ose mendohet të jetë tërhequr, në datën e përmendur në paragrafin 1(b), ku kërkuuesi konsiderohet si palë e tretë.

Rregulli 33 N. 78, 83, 128, 129; R. 26, 34

Disponibiliteti i materialit biologjik

1. Materiali biologjik i depozituar në pajtim me Rregullin 31 i jepet me kërkesë çdo personi nga data e publikimit të kërkesës për patentë europiane dhe çdo personi që ka të drejtë të inspektojë dosjet sipas Nenit 128, paragrafi 2, para asaj date. Në pajtim me Rregullin 32, kjo bëhet nëpërmjet dhënies së një kampioni të materialit biologjik personit që bën kërkesën (këtu quhet “kërkuues”).

2. Kjo dhënie bëhet vetëm nëse kërkuuesi ka marrë përsipër kundrejt kërkuarit ose pronarit të patentës për të mos ua dhënë materialin biologjik ose ndonjë material tjetër biologjik të dalë prej tij palëve të treta dhe ta përdorë atë material vetëm për qëllime eksperimentale, deri në atë kohë që kërkesa për patentë refuzohet ose tërhiqet apo konsiderohet e tërhequr, ose para se patentë europiane të ketë skaduar në të gjitha Shtetet e përcaktuara, përveç kur kërkuuesi ose pronari i patentës heq dorë shprehimisht nga një detyrim i tillë.

Detyrimi për të përdorur materialin biologjik vetëm për qëllime eksperimentale nuk zbatohet në masën që kërkuuesi e përdor materialin nën një licencë detyruese. Termi “licencë detyruese” interpretohet sikur përfshin kryesisht licencat dhe të drejtën për të përdorur shpikjet e patentuara në interesin publik.

3. Për qëllimet e paragrafit 2, materiali biologjik i marrë është çdo material që vazhdon të ekspozojë ato karakteristika të materialit të depozituar që janë thelbësore për kryerjen e shpikjes. Detyrimi sipas paragrafit 2 nuk pengon asnjë depozitim të materialit biologjik të përfutur të nevojshëm për qëllimin e procedurës së patentave.

4. Kërkesa e përmendur në paragrafin 1 i paraqitet Zyrës së Patentave Europiane në një formë të njohur nga ajo Zyra. Zyra e Patentave Europiane certifikon në formën që është depozituar një kërkesë për patentë europiane që i përket depozitimit të materialit biologjik, dhe kërkuuesi ose eksperti i caktuar prej tij sipas Rregullit 32 ka të drejtë t'i lëshohet një kampion i atij materiali. Pas dhënies së patentës europiane, kërkesa i paraqitet gjithashtu Zyrës së Patentave Europiane.

5. Zyra e Patentave Europiane u transmeton një kopje të kërkesës, me certifikimin e parashikuar në paragrafin 4, institucionit depozitues dhe kërkuarit ose pronarit të patentës.

6. Zyra e Patentave Europiane publikon në Gazetën Zyrtare listën e institucioneve depozituese dhe ekspertëve të njohur për qëllimet e Rregullave 31 deri 34.

Rregulli 34 N. 83, 129

Depozitim i ri i materialit biologjik

Nëse materiali biologjik i depozituar në pajtim me Rregullin 31 pushon së qeni i ofrueshëm nga institucioni i njohur depozitues, një ndërprerje në ofrueshmëri konsiderohet të mos ketë ndodhur nëse një depozitim i ri i atij materiali bëhet tek një institucion i njohur depozitues me të njëjtat kushte si ato të parashikuara në Traktatin e Budapestit mbi Njohjen Ndërkombëtare të Depozitimit të Mikroorganizmave për Qëllimin e Procedurës së Patentave të datës 28 prill 1977, dhe nëse një kopje e marrjes së depozitës së re e dhënë nga institucioni depozitues i transmetohet Zyrës së Patentave Europiane brenda katër muajve nga data e depozitës së re, duke treguar numrin e kërkesës për patentë europiane ose të Patentës europiane.

¹ Shih kushtet e përgjithshme të caktuara nga Kryetari i EPO-së për njohjen e ekspertëve në pajtim me Rregullin 28 EPC (1973) (GZ EPO 1981, 359 e në vazhdim, 1992, 470).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

PJESA III RREGULLORE ZBATUESE PËR PJESËN III TË KONVENTËS

KAPITULLI I DEPOZITIMI I KËRKESËS PËR PATENTË EUROPIANE

Rregulli 35¹ N. 75, 77 ; R. 1, 2

Dispozita të përgjithshme

1. Kërkesat për patentë europiane mund të depozitohen me shkrim tek zyra e Patentave Europiane në Mynih, Hagë ose Berlin, ose tek autoritetet e përmendur në Nenin 75, paragrafi 1(b).

2. Autoriteti tek i cili është depozituar kërkesa për patentë europiane shënon dokumentet që përbëjnë kërkesën me datën e marrjes së tyre, dhe i lëshon pa vonesë kërkuarit një vërtetim që përfshin të paktën numrin e kërkesës dhe natyrën, numrin dhe datën e marrjes së dokumenteve.

3. Nëse kërkesa për patentë europiane depozitohet tek një autoritet i përmendur në Nenin 75, paragrafi 1(b), ky autoritet informon pa vonesë Zyrën e Patentave Europiane për marrjen e kërkesës, dhe veçanërisht për natyrën dhe datën e marrjes së dokumenteve, numrin e kërkesës dhe datën prioritare të pretenduar.

4. Me marrjen e një kërkesë për patentë europiane të paraqitur nga zyra qendrore e pronësisë industriale të një Shteti Kontraktues, Zyra e Patentave Europiane informon kërkuarësin përkatësisht, duke treguar datën e marrjes.

Rregulli 36 N. 14, 76, 78, 79

Kërkesat e ndarë europiane

1. Kërkuarësi mund të depozitojë një kërkesë të ndarë në lidhje me një kërkesë të papërmbyshur për patentë europiane.

2. Një kërkesë e ndarë është në gjuhën e procedimit të kërkesës së mëparshme dhe depozitohet tek Zyra e Patentave Europiane në Mynih, Hagë ose Berlin.

3. Tarifa e depozitimit dhe tarifa e kerkimit paguhet brenda një muaji nga depozitimi i kërkesës së pjesshme. Nëse tarifa e depozitimit ose tarifa e kerkimit nuk paguhet në kohën e duhur, kërkesa konsiderohet të jetë tërhequr.

4. Tarifat e caktimit paguhet brenda gjashtë muajve nga data në të cilën Buletini i Patentave Europiane përmend publikimin e raportit të kerkimit europian të hartuar në lidhje me kërkesën e ndarë. Zbatohet Rregulli 39, paragrafët 2 dhe 3.

Rregulli 37 N. 135 ; R. 35, 45, 112, 134

Transmetimi i kërkesave për patentë europiane

1. Zyra qendrore e pronësisë industriale e një Shteti Kontraktues ia transmeton kërkesat për patenta europiane Zyrës së Patentave Europiane në kohën më të shkurtër në pajtim me ligjin e saj të brendshëm në lidhje me fshehtësinë e shpikjeve në interes të shtetit dhe merr të gjitha hapat për të siguruar transmetimin brenda:

a) gjashtë javëve nga depozitimi, nëse objekti i kërkesës duket haptazi se nuk i nënshtrohet fshehtësisë sipas ligjit të brendshëm; ose

b) katër muajve nga depozitimi ose, nëse është pretenduar prioriteti, brenda katërmëdhjetë muajve nga data e prioritetit, nëse kërkesa kërkon shqyrtim të mëtejshëm në lidhje me detyrimin për fshehtësi.

2. Një kërkesë për patentë europiane që nuk merret nga zyra për Patenta Europiane brenda katërmëdhjetë muajve nga depozitimi, ose, nëse është pretenduar prioritet, nga data e prioritetit, konsiderohet të jetë tërhequr. Të gjitha tarifatat paguara në lidhje me këtë kërkesë kthehen.

¹ Shih vendimet e Kryetarit të EPO-s, Botim i veçantë nr 3.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 38 N. 80, 90, 92; R. 17, 40, 57

Tarifa e depozitimit dhe tarifa e kërimit

Tarifa e depozitimit dhe tarifa e kërimit paguhen brenda një muaji nga depozitimi i kërkesës për patentë europiane.

Rregulli 39 N. 3, 78, 80, 88, 121, 149; R. 15, 17, 36, 41, 68, 112, 135, 143, 159, 160

Tarifa e caktimit

1. Tarifa e caktimit paguhet brenda gjashtë muajve nga data në të cilën Buletini i Patentave Europiane përmend publikimin e raportit të kërimit europian.

2.¹ Nëse tarifa e caktimit nuk paguhet në kohën e duhur në lidhje me një Shtet Kontraktues, përcaktimi i atij shteti mendohet të jetë tërhequr.

3. Nëse nuk paguhet asnjë tarifë caktimi në afatin e duhur ose tërhiqen caktimet e të gjithë Shteteve Kontraktuese, kërkesa për patentë europiane mendohet të jetë tërhequr.

4. Pa cenuar Rregullin 37, paragrafi 2, fjalia e dytë, tarifat e caktimit nuk ri-imbursohen.

Rregulli 40² N. 14, 54, 60, 66, 78, 79, 80, 83, 84, 90 ; R. 30, 41, 42, 43, 49, 55, 56, 143

Data e depozitimit

1. Data e depozitimit të një kërkesë për patentë europiane është data në të cilën dokumentet e depozituara përmbajnë:

- a) një tregues që kërkohej patenta europiane;
- b) informacionin që identifikon kërkuuesin ose që lejon marrjen e kontaktit me kërkuuesin; ose
- c) një përshkrim ose referencë në një kërkesë të mëparshme të depozituar.

2. Një referencë në një kërkesë të depozituar më parë sipas paragrafit 1(c) tregon datën e depozitimit dhe numrin e asaj kërkesë dhe Zyrën në të cilën ajo është depozituar. Një referencë të tillë tregon që ajo zëvendëson përshkrimin dhe çdo skicim.

3. Nëse kërkesa përmban një referencë sipas paragrafit 2, depozitohet një kopje e certifikuar e kërkesës së depozituar më parë brenda dy muajve nga depozitimi i kërkesës. Nëse një kërkesë e depozituar më parë nuk është në një gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane, depozitohet një përkthim i saj në një prej këtyre gjuhëve brenda së njëjtës periudhë. Rregulli 53, paragrafi 2, zbatohet mutatis mutandis.

KAPITULLI II DISPOZITAT QË RREGULLOJNË KËRKESËN

Rregulli 41³ N. 59, 75, 76, 78-81, 88, 133; R. 52

Kërkesa për dhënien

1. Kërkesa për dhënien e një patente europiane depozitohet në formën e përpiluar nga Zyra e Patentave Europiane.

2. Kërkesa përmban:

- a) një kërkesë për dhënien e një patente europiane;
- b) titullin e shpikjes, që tregon qartësisht dhe shkurtimisht përcaktimin teknik të shpikjes dhe përjashton çdo emër imagjinar;
- c)⁴ emrin, adresën, shtetësinë e kërkuarit dhe Shtetin në të cilin gjendet vendbanimi ose vendi i tij kryesor i biznesit. Emrat e personave fizikë tregohen nga mbiemri i personit, i ndjekur nga emrat e tij. Emrat e personave juridikë, si dhe organet e barasvlershëm me personat juridikë sipas ligjit që i rregullon atë, tregohen me

¹ Shih mendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 4/98, (Aneksi I).

² Shih vendimin/mendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 2/95, G 4/98, (Aneksi I).

³ Versioni i përditësuar i formularit publikohet rregullisht në GZ EPO dhe në faqen e internetit të EPO-së.

⁴ Shih gjithashtu vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/99 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

emërtimet e tyre zyrtare. Adresat tregohen në pajtim me kërkesat e zakonshme të zbatueshme për dorëzim të drejtpërdrejtë me postë dhe përmbledhin të gjithë njësitë përkatëse administrative, duke përfshirë numrin e ndërtesës, nëse ka. Rekomandohet që të jepen edhe numrat e telefonit dhe faksit;

d) nëse kërkuesi ka caktuar një përfaqësues, emri dhe adresa e vendit të tij të biznesit sipas parashikimit në nën-paragrafin (c);

e) sipas rastit, një tregues që kërkesa përbën një kërkesë të ndarë dhe numrin e kërkesës së mëparshme për patentë europiane;

f) në rastet e mbuluara nga Neni 61, paragrafi 1(b), numrin kërkesës origjinale për patentë europiane;

g) sipas rastit, një deklaratë që pretendohet prioriteti i një kërkesë të mëparshme dhe tregon datën në të cilën vendi ku ose për të cilin kërkesa është depozituar;

h) nënshkrimi i kërkuesit ose përfaqësuesit të tij;

i) një listë të dokumenteve shoqëruese të kërkesës. Kjo listë tregon gjithashtu numrin e faqeve të përshkrimit, pretendimet, skicimet dhe përmbledhjen e depozituar me kërkesën;

j) emërtimin e shpikësit, nëse kërkuesi është shpikësi.

3. Nëse ka më shumë se një kërkues, kërkesa është mirë të tregojë caktimin e një kërkuesi ose përfaqësuesi si një përfaqësues i përbashkët.

Rregulli 42¹ N. 54, 56, 57, 78, 80, 83; R. 29, 30, 48, 50

Përmbajtja e përshkrimit

1. Përshkrimi:

a) specifikon fushën teknike me të cilën ka të bëjë shpikja;

b) tregon të dhëna paraprake, të cilat, në masën që janë të njohura për kërkuesin, mund të konsiderohen të dobishme për të kuptuar shpikjen, përpiluar raportin e kërkimit europian dhe shqyrtuar kërkesën për patentë europiane dhe, mundësisht të citohen dokumentet që pasqyrojnë këtë gjendje;

c) deklaron shpikjen, siç pretendohet, në ato terma që problemi teknik, edhe nëse nuk tregohet shprehimisht si i tillë, dhe zgjidhja e tij mund të kuptohet dhe të tregojë të gjitha efektet pozitive të shpikjes në lidhje me gjendjen ekzistuese;

d) përshkruan shkurtimisht shifrat në vizatime, sipas rastit;

e) përshkruan me hollësi të paktën një mënyrë të zbatimit të shpikjes së pretenduar, duke përdorur shembuj, sipas rastit dhe duke iu referuar skicimeve, nëse ka;

f) tregon shprehimisht, nëse nuk del nga përshkrimi ose natyra e shpikjes, mënyrën në të cilën shpikja është industrialisht e zbatueshme.

2. Përshkrimi paraqitet në mënyrën dhe renditjen e përcaktuar në paragrafin 1, përveç kur, për shkak të natyrës së shpikjes, një prezantim i ndryshëm do të ofronte një të kuptuar më të mirë ose do të ishte më i përmbledhur.

Rregulli 43² N. 78, 80, 82, 84; R. 50

Forma dhe përmbajtja e pretendimeve

1. Pretendimet përcaktojnë çështjen për të cilën kërkohet mbrojtja në kuptimin e tipareve teknike të shpikjes. Sipas rastit, pretendimet përmbajnë:

a) një deklaratë që tregon përcaktimin e objektit të shpikjes dhe ato tipare teknike që janë të nevojshme për përkufizimin e objektit të pretenduar por që, në kombinim, formojnë arritjen e mëparëshme;

b) një pjesë karakterizuese, duke filluar me shprehjen “karakterizuar në” ose “karakterizuar nga” dhe që specifikon tiparet teknike për të cilat, në kombinim me tiparet e treguara sipas nën-paragrafit (a), kërkohet mbrojtje.

2. Pa cenuar Nenin 82, një kërkesë për patentë europiane mund të përmbajë më shumë se një pretendim të pavarur në të njëjtën kategori (produkt, proces, aparat ose përdorim) vetëm nëse objekti i kërkesës përfshin një nga sa më poshtë:

a) një numër produktesh të ndërlidhura;

¹ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 1/03, G 2/03, (Aneksi I).

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 2/03, G 1/04, (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

b) përdorime të ndryshme të një produkti ose aparati;
c) zgjidhje alternative për një problem të caktuar, nëse është e papërshtatshme për të mbuluar këto alternativa me një pretendim të vetëm.

3. Çdo deklaram që tregon tiparet thelbësore të një shpikjeje mund të pasohet nga një ose më shumë pretendime në lidhje me konkretizimin e kësaj shpikjeje.

4. Çdo pretendim që përfshin të gjitha tiparet e çdo pretendimi tjetër (pretendim i varur) përmban, nëse është e mundur në fillim, një referencë tek pretendimi tjetër dhe pastaj të tregojë tiparet shtesë. Një pretendim i varur që i referohet drejtpërdrejt një pretendimi tjetër të varur është gjithashtu i zbatueshëm. Të gjitha pretendimet e varura që i referohen një pretendimi të vetëm të mëparshëm, dhe të gjitha pretendimet e varura që u referohen disa pretendimeve të mëparshme, grupohen së bashku në masën dhe në mënyrën më të përshtatshme të mundshme.

5. Numri i pretendimeve është i arsyeshëm në lidhje me natyrën e shpikjes së pretenduar. Pretendimet numërtohen në mënyrë të njëpasnjëshme në numra arabikë.

6. Përveç kur është absolutisht e nevojshme, pretendimet nuk mbështeten mbi referenca në përshkrime ose skicime në përcaktimin e tipareve teknike të shpikjes. Veçanërisht, ato nuk përmbajnë shprehje të tilla si “siç është përshkruar në pjesën... të përshkrimit”, ose “siç është ilustruar në figurën ... të skicës”.

7. Nëse kërkesa për patentë europiane përmban skicime duke përfshirë shenja të referencës, tiparet teknike të specifikuar në pretendimet mundësisht pasohen nga ato shenja reference në lidhje me ato tipare, të vendosura në thonjëza, nëse kështu mund të rritet kuptueshmëria e pretendimit. Këto shenja reference nuk interpretohen sikur kufizojnë pretendimin.

Rregulli 44 N. 78

Uniteti i shpikjes

1. Nëse në një kërkesë për patentë europiane pretendohet një grup shpikjesh, kërkesa e njësimi të shpikjes sipas Nenit 82 përmbushet vetëm nëse ka një raport teknik ndërmjet atyre shpikjeve që përfshijnë një ose më shumë nga tipet e njëjta ose korresponduese të veçanta teknike. Shprehja “tipare të veçanta teknike” tregon ato tipare që përkufizojnë kontributin që secila prej shpikjeve të pretenduara të para së bashku përbën mbi arritjet e mëparshme.

2. Përcaktimi nëse një grup shpikjesh është aq i lidhur sa të formojë një koncept të vetëm të përgjithshëm shpikës bëhet pavarësisht nëse shpikjet pretendohen në pretendime të veçanta apo si alternativa brenda një pretendimi të vetëm.

Rregulli 45 N. 61, 76-78, 84, 90 ; R. 71, 162

Pretendimet që përfshijnë tarifa

1. Çdo kërkesë për patentë europiane që përbëhet nga më shumë se dhjetë pretendime, në lidhje me të njëmbëdhjetën dhe çdo pretendim pauses, mbart pagesën e një tarife pretendimi.

2. Tarifat e pretendimeve paguhen brenda një muaji nga depozitimi i kompletit të parë të pretendimeve. Nëse tarifat e pretendimeve nuk janë paguar në kohën e duhur, ato përsëri mund të paguhen brenda një muaji nga komunikimi në lidhje me mosrespektimin e afatit.

3. Nëse një tarifë pretendimi nuk paguhet në kohën e duhur, nga pretendimi përkatës mendohet të jetë hequr dorë.

Rregulli 46 N. 78; R. 48, 50, 57

Forma e skicave

1. Mbi faqet që përmbajnë skicime, sipërfaqja e përdorshme nuk e kalon 26.2 cm x 17 cm. Sipërfaqja e përdorshme ose e përdorur nuk rrethohet me korniza. Sipërfaqja minimale anësore do të jetë si më poshtë: në krye 2.5 cm, ana e majtë 2.5 cm, ana e djathtë 1.5 cm, dhe poshtë 1 cm.

2. Vizatimet zbatohen si më poshtë:

a) Skicimet zbatohen pa ngjyra në vija dhe prerje të qëndrueshme, të zeza, të qarta dhe të errëta në masë të mjaftueshme, të njëtrajtshme dhe të mirëvendosura.

b) Bashkimet tregohen me vijë të hollë që nuk pengon leximin e qartë të shenjave të referencës dhe të vijave treguese;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

c) Shkalla e skicimeve dhe zbatimi i tyre grafik është i tillë që riprodhimi elektronik ose fotografik me një reduktim linear në madhësi në dy të tretat lejon dallimin e të gjitha hollësive pa vështirësi. Nëse, përjashtimisht, shkalla jepet në një skicim, ajo përfaqësohet grafikisht;

d) Të gjithë numrat, gerrat dhe shenjat e referencës që shfaqen në skicime janë të thjeshta dhe të qarta. Kllapat, rrathët ose thonjëzat nuk përdoren në lidhje me numrat dhe gerrat.

e) Në përgjithësi të gjitha vijat në skicime hiqen me ndihmën e instrumenteve të projektimit;

f) Elementët e së njëjtës figure janë proporcionale me njëra-tjetrën, përveç kur një ndryshim në raport është i domosdoshëm për qartësinë e figurës;

g) Madhësia e numrave dhe germave nuk është më pak se 0.32 cm. Për gerrat e skicimeve, përdoren alfabeti latin dhe, nëse është e zakonshme, ai grek.

h) E njëjta faqe vizatimi mund të përmbajë disa figura. Nëse figurat e vizatuara në dy ose më shumë faqe përbëjnë një figurë të vetme, figurat në faqe të veçanta janë vendosur në mënyrë të tillë që e gjithë figura të mund të bashkohet pa fshehur asnjë pjesë të figurave të pjesshme. Figura të ndryshme vendosen pa harxhuar hapësirë, mundësisht në një pozicion vertikal, qartësisht të ndara nga njëra-tjetra. Nëse figurat nuk vendosen në një pozicion vertikal, ato paraqiten anash me kreun e figurës në anën e majtë të faqes. Figurat e ndryshme numërtohen në mënyrë progresive në numra arabë, pavarësisht nga numërtimi i faqeve.

i) Shenjat e referencës që nuk përmenden në përshkrim dhe pretendime nuk paraqiten në skicime, dhe anasjelltas. Shenjat e referencës për tiparet janë të njëtrajtshme në të gjithë kërkesën.

j) Skicimet nuk përmbajnë tekst. Nëse është e domosdoshme për të kuptuar skicimin, mund të përfshihen fjalë kyçe shumë të shkurtra si “ujë”, “avull”, “e hapur”, “e mbyllur”, ose “prerje mbi AB”. Çdo fjalë e tillë kyçe mund të vendoset në një mënyrë të tillë që, nëse është e nevojshme, ato mund të zëvendësohen me përkthimet e tyre pa prekur vijat e skicimit.

3. Prezantimet zinxhir dhe diagramat konsiderohen të jenë skicime.

Rregulli 47 N. 78, 85, 93 ; R. 50, 66

Forma dhe përmbajtja e përmbledhjes

1. Përmbledhja përmban titullin e shpikjes.

2. Përmbledhja përmban një përmbledhje të shkurtër të deklarimit që paraqitet në përshkrim, pretendimet dhe çdo skicim. Përmbledhja tregon fushat teknike të cilave u përket shpikja dhe përpilohet në një mënyrë që lejon kuptimin e qartë të problemit teknik, thelbin e zgjidhjes së atij problemi nëpërmjet shpikjes, dhe përdorimin ose përdorimet kryesore të shpikjes. Përmbledhja, sipas rastit, përmban formula kimike që, nga ato që gjenden në kërkesë, karakterizojnë më mirë shpikjen. Ajo nuk përmban deklarata mbi avantazhet ose vlerën e shpikjes ose zbatimet spekulative të saj.

3. Përmbledhja mundësisht nuk duhet të përmbajë më shumë se njëqind e pesëdhjetë fjalë.

4. Nëse kërkesa për patentë europiane përmban skicime, kërkuesi tregon pamjen, ose përjashtimisht, pamjet e skicimeve që duhet të publikohen me përmbledhjen. Zyra e Patentave Europiane mund të vendosë të publikojë një ose më shumë figura të tjera nëse ajo mendon që ato e karakterizojnë më mirë shpikjen. Çdo tipar i veçantë i përmendur në përmbledhje dhe e ilustruar me skicim pasohet nga një shenjë reference e futur në kllapa.

5. Përmbledhja përpilohet në mënyrë të tillë që të përbëjë një instrument eficient për qëllimin e kerkimit në fushën teknike të veçantë. Veçanërisht, ajo bën të mundur vlerësimin nëse janë të nevojshme konsultimet për vetë kërkesën për patentë europiane.

Rregulli 48 N. 78, 93; R. 50

Të dhëna të palejueshme

1. Kërkesa për patentë europiane nuk përmban:

a) deklarime ose përmbajtje tjetër në kundërshtim me “rendin publik” ose moralitetin;

b) deklarime denigruese për produkte ose procese të palëve të treta ose avantazhet apo vlefshmërinë e kërkesave ose patentave të këtyre palëve. Thjesht krahasimet me gjendjen e mëparshme nuk konsiderohet automatikisht denigruese;

c) çdo deklaratë ose përmbajtje tjetër që është haptazi pa lidhje dhe e panevojshme sipas rrethanave.

2. Nëse kërkesa përmban përbërje të ndaluar sipas paragrafit 1(a), Zyra e Patentave Europiane mund ta heqë

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

këtë përbërje nga kërkesa e publikuar, duke treguar vendin dhe numrin e fjalëve ose skicimeve të hequra.

3. Nëse kërkesa përmban përbërje të përmendura në paragrafin 1(b), Zyra e Patentave Europiane mund t'i heqë ato nga kërkesa e publikuar duke treguar vendin dhe numrin e fjalëve të hequra. Me kërkesë, Zyra e patentave Europiane jep një kopje të pjesëve të hequra.

Rregulli 49 N. 78, 80, 84, 85; R. 1, 2, 50, 57

Dispozita të përgjithshme që rregullojnë paraqitjen e dokumenteve të kërkesës

1. Çdo përkthim i depozituar sipas Nenit 14, paragrafi 2, ose Rregullit 40, paragrafi 3, konsiderohet të jetë një dokument në përbërje të kërkesës për patentë europiane.

2. Dokumentet që përbëjnë kërkesën paraqiten për të lejuar riprodhimin elektronik dhe të drejtpërdrejtë, veçanërisht nëpërmjet skanimit, fotografimit, proceseve elektrostatische, riprodhimit fotografik dhe mikrofilmimit, në një numër kopjesh të pakufizuar. Të gjitha faqet nuk duhet të kenë, grisje, rrudhosje ose palosje. Përdoret vetëm një anë e fletës.

3. Dokumentet që përbëjnë kërkesën janë në letër A4 (29.7 cm x 21 cm) që është elastike, e fortë, e bardhë, e lëmuar, pa shkëlqim dhe rezistentë. Në pajtim me paragrafin 10 dhe Rregullin 46, paragrafi 2(h), secila fletë përdoret me anët e saj të shkurtra në krye dhe në fund (në pozicionin vertikal).

4. Secili nga dokumentet që përbëjnë kërkesën (kërkesa, përshkrimi, pretendimet, skicimet dhe përmbledhja) fillojnë në një faqe të re. Fletët lidhen në mënyrë të tillë që të palosen lehtë, të ndahen dhe bashkohen përsëri.

5. Në pajtim me Rregullin 46, paragrafi 1, sipërfaqet anësore minimale janë si më poshtë:

Kreu: 2 cm

Ana e majtë: 2.5 cm

Ana e djathtë: 2 cm

Fundi: 2 cm

Sipërfaqja maksimale e rekomanduar anësore të treguar më sipër është sa më poshtë:

Kreu: 4 cm

Ana e majtë: 4 cm

Ana e djathtë: 3 cm

Fundi: 3 cm.

6. Të gjitha fletët që janë në kërkesë numërtohen në numra të njëpasnjëshëm arabikë. Këta vendosen në qendër në krye të fletës, por nuk vendosen në sipërfaqen anësore të kreut.

7. Rreshtat e secilës flete të përshkrimit dhe të pretendimeve mundësisht numërtohen në grupe me nga pesë, ku numrat vendosen në anën e majtë, në anën e djathtë të sipërfaqes anësore.

8. Kërkesa për dhënien e një patente europiane, përshkrimi, pretendimet dhe përmbledhja shkruhet me makinë shkrimi ose printohet. Vetëm simbolet dhe karakteret grafike dhe formulat kimike dhe matematike, nëse është e nevojshme, mund të vizatohen ose të shkruhen me dorë. Shkrimi me makinë ruan largësinë $1\frac{1}{2}$. E gjithë përmbajtja e tekstit është me shkronja, ku gjerat kapitale të të cilit nuk janë më të vigla se 0.21 cm të larta dhe janë në ngjyrë të errët dhe rezistente.

9. Kërkesa për dhënien e një patente europiane, përshkrimi, pretendimet dhe përmbledhja nuk përmbajnë skicime. Përshkrimi, pretendimet dhe përmbledhja mund të formulojë kimike ose matematike. Përshkrimi për përmbledhja mund të përmbajnë tabela. Pretendimet mund të përmbajnë tabela vetëm nëse objekti i tyre mundësisht përdor tabela. Tabelat dhe formulat kimike dhe matematike mund të vendosen anash në fletë nëse ato nuk mund të vihen në një mënyrë të pranueshme në pozicionin vertikal. Tabelat ose formulat kimike ose matematike të paraqitura anash vendosen në mënyrë të tillë që kreu i tabelës ose formulës të jenë në anën e matë të fletës.

10. Vlerat shprehen në njësi që përputhen me standardet ndërkombëtare, sipas rastit, në kuptimin e sistemit metrik që përdor njësitë SI. Të gjitha të dhënat që nuk përmbushin këtë kërkesë shprehet në njësi që të përputhet me standardet ndërkombëtare. Përdoren vetëm termat, konvencionet, formulat, shenjat dhe simbolet teknike përgjithësisht të pranuar në këtë fushë.

11. Terminologjia dhe shenjat duhet të jenë të njëtrajtshme në të gjithë kërkesën për patentë europiane.

12. Secila fletë normalisht nuk përmban fshirje dhe ndryshime. Mosrespektimi i këtij rregulli mund të autorizohet nëse vërtetësia e përmbajtjes nuk diskutohet dhe kërkesat për riprodhim të mirë nuk rrezikohen nëpërmjet kësaj.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 50¹ N. 78 ; R. 1, 2

Dokumentet e paraqitura më vonë

1. Rregullat 42, 43 dhe 46 deri 49 zbatohen për dokumentet që zëvendësojnë dokumentet që përbëjnë kërkesën për patentë europiane. Rregulli 49, paragrafët 2 deri 12, zbatohen edhe për përkthimin e pretendimeve të përmendur në Rregullin 71.

2. Të gjithë dokumentet përveç atyre që përbëjnë kërkesën përgjithësisht shkruhen me makinë ose printohen. Në anën e majtë të çdo faqeje do të jetë një sipërfaqe anësore prej rreth 2.5 cm.

3. Dokumentet e depozituar pas depozitimit të kërkesës nënshkruhen, me përjashtim të dokumenteve të bashkangjitur. Nëse një dokument nuk është i nënshkruar, Zyra e Patentave Europiane e fton palën e interesuar ta bëjë këtë brenda një afati kohor që i caktohet. Nëse nënshkruhet në kohën e duhur, dokumenti mban datën e tij origjinale të marrjes; përndryshe konsiderohet të mos jetë depozituar.

KAPITULLI III

TARIFAT E MBAJTJES NË FUQI

Rregulli 51 N. 61, 76, 86, 112a/bis, 122; R. 159

Pagesa e tarifave të mbajtjes në fuqi

1. Një tarifë e mbajtjes në fuqi për kërkesën për patentë europiane në lidhje me vitin e ardhshëm bëhet e kërkueshme në ditën e fundit të muajit që ka përvjetorin e datës së depozitimit të kërkesës për patentë europiane. Tarifat e mbajtjes në fuqi nuk mund të paguhet në mënyrë të vlefshme më shumë se një vit para se ato duhet të paguhet.

2. Nëse një tarifë e mbajtjes në fuqi nuk paguhet në kohën e duhur, tarifa përsëri mund të paguhet brenda gjashtë muajve nga data e kërkueshme, me kusht që brenda asaj periudhë të paguhet edhe një tarifë shtesë.

3. Tarifat e mbajtjes në lidhje me një kërkesë të ndarë behen në datën në të cilën depozitohet një kërkesë e ndarë dhe paguhet edhe për kërkesën e ndarë e cila bëhet në përputhje me datën e saj të depozitimit. Këto tarifa dhe çdo tarifë e mbajtjes në fuqi nëse bëhen brenda katër muajve nga depozitimi i kërkesës së ndarë mund të paguhet brenda asaj periudhe pa një tarifë shtesë. Zbatohet paragrafi 2.

4. Nëse një kërkesë për patentë europiane është refuzuar ose mendohet të jetë tërhequr si rezultat i mosrespektimit të afatit kohor, dhe nëse të drejtat e kërkuarit janë ri-vendosur sipas Nenit 122, një tarifë të mbajtjes në fuqi

a) që do të ishte bërë sipas paragrafit 1 në periudhën që fillon në datën në të cilën ka ndodhur humbja e të drejtave deri në dhe duke përfshirë datën e njoftimit të vendimit të rivendosjes së të drejtave bëhet në atë datë të fundit. Kjo tarifë dhe çdo tarifë e mbajtjes në fuqi, brenda katër muajve nga data e fundit mund të paguhet përsëri brenda katër muajve nga data e fundit pa një tarifë shtesë. Zbatohet paragrafi 2.

b) që, në datën në të cilën ka ndodhur humbja e të drejtave, ka qenë për tu paguar por periudha e parashikuar në paragrafin 2 nuk ka skaduar akoma, mund të paguhet përsëri brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit të vendimit të rivendosjes së të drejtave, me kusht që tarifa shtesë sipas paragrafit 2 të paguhet gjithashtu brenda asaj periudhe.

5. Nëse Bordi i Zgjeruar i Apelit rihap procedimet para Bordit të Apelit sipas Nenit 112a, paragrafi 5, fjalia e dytë, një tarifë e mbajtjes në fuqi

a) që do të ishte për tu paguar sipas paragrafit 1 në periudhën që fillon në datën në të cilën është marrë vendimi i Bordit të Zgjeruar të Apelit sipas kërkesës për rishikim, deri në dhe duke përfshirë datën e njoftimit të vendimit të Bordit të Zgjeruar të Apelit për ri-fillimin e procedimit para Bordit të Apelit, bëhet në atë datë të mëvonshme. Kjo tarifë dhe çdo tarifë e mbajtjes në fuqi për tu paguar brenda katër muajve nga data e fundit mund të paguhet përsëri brenda katër muajve nga data e fundit pa një tarifë shtesë. Zbatohet paragrafi 2.

b) që, në datën në të cilën është marrë vendimi i Bordit të Apelit, ka qenë për tu paguar por periudha e parashikuar në paragrafin 2 nuk ka skaduar akoma, mund të paguhet përsëri brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit të vendimit të Bordit të Zgjeruar të Apelit për ri-fillimin e procedimeve para Bordit të Apelit, me kusht që tarifa shtesë sipas paragrafit 2 të paguhet gjithashtu brenda asaj periudhe.

¹ Shih Vendimet e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, A. 2., A. 3., Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/99 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

6. Një tarifë rishikimi nuk paguhet për një kërkesë të re europiane të depozituar sipas nenit 61, paragrafi 1(b), në lidhje me vitin në të cilin ajo është depozituar dhe çdo vit pararendës.

KAPITULLI IV PRIORITETI

Rregulli 52 N. 88, 93, 98, 103, 105c/quarter ; R. 41, 57-59, 68, 163

Deklarimi i prioritetit

1. Deklarimi i prioritetit i përmendur në Nenin 88, paragrafi 1, tregon datën e depozitimit të mëparshëm, Shtetin palë në Konventën e Parisit ose Anëtarin e Organizatës Botërore të Tregtisë ose për të cilën është bërë dhe numrin e dosjes. Në rastin e përmendur në Nenin 87, paragrafi 5, fjalia e parë zbatohet mutatis mutandis.

2. Deklarata e prioritetit bëhet mundësisht me depozitimin e kërkesës për patentë Europiane. Ajo përsëri mund të bëhet brenda gjashtëmbëdhjetë muajsh nga prioriteti më i parë i pretenduar.

3. Kërkuesi mund të korrigjojë deklaratën e prioritetit brenda gjashtëmbëdhjetë muajsh nga data e prioritetit më të parë të pretenduar, ose, nëse korrigjimi do të shkaktonte një ndryshim në datën e prioritetit më të parë të pretenduar, brenda gjashtëmbëdhjetë muajve nga data e korrigjuar e prioritetit më të parë, cilado periudhë gjashtëmbëdhjetë mujore të skadojë më parë, me kusht që një korrigjim i tillë të mund të paraqitet deri në skadimin e katër muajve nga data e depozitimit të dhënë kërkesës për patentë europiane.

4. Megjithatë, një deklaratë e prioritetit nuk mund të bëhet ose të korrigjohet pas depozitimit të një kërkesë sipas Nenit 93, paragrafi 1(b).

5. Hollësitë e deklaramit të prioritetit paraqiten në kërkesën e publikuar për patentë europiane dhe specifikimin e patentës europiane.

Rregulli 53¹ N. 88, 90 ; R. 2, 57-59, 163

Dokumentet prioritare

1. Një kërkues që pretendon prioritet depoziton një kopje të kërkesës së mëparshme brenda gjashtëmbëdhjetë muajve nga data e prioritetit më të parë të pretenduar. Kjo kopje dhe data e depozitimit të kërkesës së mëparshme vërtetohet si e saktë nga autoriteti tek i cili është depozituar kërkesa.

2. Kopja e kërkesës së mëparshme konsiderohet të jetë depozituar rregullisht nëse një kopje e asaj kërkesë që i ofrohet Zyrës së Patentave Europiane përfshihet në dosjen e kërkesës për patentë europiane sipas kushteve të përcaktuara nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane.

3. Nëse kërkesa e mëparshme nuk është një gjuhë zyrtare e Zyrës së Patentave Europiane dhe vlefshmëria e pretendimit të prioritetit është e rëndësishme për përcaktimin e patentueshmërisë së shpikjes përkatëse, Zyra e Patentave Europiane fton kërkuesin ose pronarin e patentës europiane për të depozituar një përkthim të kërkesës në një nga gjuhët zyrtare brenda një periudhe që duhet të përcaktohet. Si alternative, mund të paraqitet një deklaratë që kërkesa për patentë europiane është një përkthim i plotë i kërkesës së mëparshme. Paragrafi 2 zbatohet mutatis mutandis.

Rregulli 54

Lëshimi i dokumenteve prioritare

Me kërkesë, Zyra e Patentave Europiane i lëshon kërkuesit një kopje të certifikuar të kërkesës për patentë europiane (dokument prioriteti), sipas kushteve të përcaktuara nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane, duke përfshirë formën e dokumentit të prioritetit dhe rrethanat në të cilat paguhet një tarifë administrative.

¹ Shih Vendimet e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, B. 1, B. 2.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

PJESA IV RREGULLORET ZBATUESE TË PJESËS IV TË KONVENTËS

KAPITULLI I SHQYRTIMI NGA SEKTORI I PRANIMIT

Rregulli 55 N. 80, 90 Shqyrtimi gjatë depozitimit

Nëse shqyrtimi sipas Nenit 90, paragrafi 1, tregon që kërkesa nuk përmbush kërkesat e parashikuara në Rregullin 40, paragrafi 1(a), ose (c), paragrafi 2 ose paragrafi 3, fjalia e parë, Zyra e Patentave Europiane njofton kërkuuesin për çdo mangësi dhe e këshillon atë që kërkesa nuk do të shqyrtohet si një kërkesë për patentë europiane, përveç kur këto mungesa korrigjohen brenda dy muajve. Nëse kërkuesi e bën këtë, ai njoftohet për datën e depozitimit që i jepet nga Zyra.

Rregulli 56 N. 80, 90 Pjesët që mungojnë në përshkrim ose skicimet që mungojnë

1. Nëse shqyrtimi sipas nenit 90, paragrafi 1, tregon që pjesë të përshkrimit ose skicimet e përmendura në përshkrim ose në pretendime duket se mungojnë, Zyra e Patentës Europiane fton kërkuuesin të depozitojë pjesët që mungojnë brenda dy muajve. Kërkuesi nuk mund të kërkojë një përfundim të një komunikimi të tillë.

2. Nëse pjesët që mungojnë të përshkrimit ose skicimet që mungojnë depozitohen më vonë se data e depozitimit, por brenda dy muajve nga data e depozitimit, nëse nxirret një komunikim sipas paragrafit 1, brenda dy muajve nga ky komunikim, kërkesa ri-datohet me datën në të cilën janë depozituar pjesët që mungojnë të përshkrimit ose skicimet që mungojnë. Zyra e Patentave Europiane njofton përkatësisht kërkuuesin.

3. Nëse pjesët e përshkrimit ose skicimet që mungojnë depozitohen brenda afatit sipas paragrafit 2, dhe kërkesa pretendon prioritetin e një kërkesë të mëparshme, data e depozitimit, me kusht që pjesët që mungojnë të përshkrimit ose skicimet që mungojnë të gjenden plotësisht në kërkesën e mëparshme, do të mbetet data në të cilën janë përmbushur kërkesat e parashikuara në Rregullin 40, paragrafi 1, nëse këtë e kërkon kërkuesi dhe depoziton brenda afatit sipas paragrafit 2:

a) një kopje të kërkesës së mëparshme, përveç kur një kopje e tillë i ofrohet Zyrës së Patentave Europiane sipas Rregullit 53, paragrafi 2;

b) nëse kërkesa e mëparshme nuk është në një gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane, një përkthim të saj në një nga këto gjuhë, përveç kur një kopje e tillë i ofrohet Zyrës së Patentave Europiane sipas Rregullit 53, paragrafi 3; dhe

c) një tregues se ku gjenden të plotë në kërkesën e mëparshme pjesët që mungojnë të përshkrimit ose skicimet që mungojnë dhe, sipas rastit, një përkthimin të saj.

4. Nëse kërkuesi:

a) nuk depoziton pjesët e mbetura të përshkrimit ose skicimet që mungojnë brenda periudhës sipas paragrafëve 1 ose 2, ose

b) tërheq sipas paragrafit 6 çdo pjesë që mungon të përshkrimit ose skicimet që mungojnë të depozituara sipas paragrafit 2,

të gjitha referencat e përmendura në paragrafin 1 konsiderohen të jenë shfuqizuar, dhe çdo depozitim i pjesëve që mungojnë të përshkrimit ose skicimeve që mungojnë konsiderohen të mos jenë bërë. Zyra e Patentave Europiane njofton përkatësisht kërkuuesin.

5. Nëse kërkuesi nuk përmbush kërkesat e përmendura në paragrafin 3(a) deri (c) brenda afatit sipas paragrafit 2, kërkesa ri-datohet me datën në të cilën janë depozituar pjesët që mungojnë të përshkrimit ose skicimet që mungojnë. Zyra e Patentave Europiane njofton kërkuuesin përkatësisht.

6. Brenda një muaji nga njoftimi i përmendur në paragrafin 2 ose 5, fjalia e fundit, kërkuesi mund të tërheqë pjesët që mungojnë të përshkrimit ose skicimet që mungojnë të depozituara, dhe në këtë rast ri-datimi nuk konsiderohet të jetë bërë. Zyra e Patentave Europiane njofton kërkuuesin përkatësisht.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 57 N. 87, 88, 90, 123 ; R. 45, 55-60, 111-113, 138, 139, 142, 152

Ekzaminimi formal

Nëse kërkesës për patentë europiane i është dhënë datë depozitimi, Zyra e Patentave Europiane shqyrton, në pajtim me Nenin 90, paragrafi 3, nëse:

- a) është depozituar në kohën e duhur një përkthim i kërkesës së kërkuar sipas Nenit 14, paragrafi 2, ose sipas Rregullit 40, paragrafi 3, fjalë e dytë;
- b) kërkesa për dhënien e një patente europiane përmbush kërkesat e Rregullit 41;
- c) kërkesa përmban një ose më shumë pretendime në pajtim me Nenin 78, paragrafi 1(c), ose një referencë tek një kërkesë e depozituar më parë në pajtim me Rregullin 40, paragrafët 1(c), 2 dhe 3, që tregojnë që ajo zëvendëson edhe pretendimet;
- d) kërkesa përmban një përmbledhje në pajtim me Nenin 78, paragrafi 1(e);
- e) është paguar tarifa e depozitimit dhe kërkimit në pajtim me Rregullin 17, paragrafi 2, Rregullin 36, paragrafi 3, ose Rregullin 38;
- f) përcaktimi i shpikësit është bërë në pajtim me Rregullin 19, paragrafi 1;
- g) sipas rastit, kërkesat e parashikuara në Rregullat 52 dhe 53 në lidhje me pretendimin e prioritetit janë përmbushur;
- h) sipas rastit, kërkesat e Nenit 133, paragrafi 2, janë përmbushur;
- i) kërkesa përmbush kërkesat e parashikuara në Rregullin 46 dhe Rregullin 49, paragrafët 1 deri 9 dhe 12;
- j) kërkesa përmbush kërkesat e parashikuara në Rregullin 30 ose 163, paragrafi 3.

Rregulli 58 N. 123; R. 137

Korrigjimi i mangësive në dokumentet e kërkesës

Nëse kërkesa për patentë europiane nuk përmbush kërkesat e Rregullit 57(a) deri (d), (h) dhe (i), Zyra e Patentave Europiane njofton përkatësisht kërkuesin dhe e fton atë të korrigjojë mungesat e vërejtura brenda dy muajve. Përshkrimi, pretendimet dhe skicimet mund të ndryshohen vetëm në një masë të mjaftueshme për të korrigjuar këto mangësi.

Rregulli 59 N. 87-89; R. 52, 53

Mangësitë në pretendimin e prioritetit

Nëse numri i dosjes së kërkesës së mëparshme sipas Rregullit 52, paragrafi 1, ose kopja e asaj kërkesë sipas Rregullit 53, paragrafi 1, nuk janë depozituar në kohën e duhur, Zyra për Patentë Europiane njofton përkatësisht kërkuesin dhe e fton atë për t'i depozituar ato brenda një afati kohor që duhet të caktohet.

Rregulli 60 N. 62, 76, 80, 81, 88, 90 ; R. 16

Përcaktimi i mëvonshëm i shpikësit

1. Nëse përcaktimi i shpikësit nuk është bërë në pajtim me Rregullin 19, Zyra e Patentave Europiane njofton kërkuesin që kërkesa për patentë europiane do të refuzohet nëse nuk bëhet përcaktimi brenda gjashtëmbëdhjetë muajve nga data e depozitimit të kërkesës ose, nëse pretendohet prioriteti, nga data e prioritetit, kjo periudhë konsiderohet të jetë respektuar nëse informacioni komunikohet para përfundimit të përgatitjeve teknike për publikimin e kërkesës për patentë europiane.

2. Nëse në një kërkesë të pjesshme ose kërkesë të re sipas nenit 61, paragrafi 1(b), përcaktimi i shpikësit nuk është bërë në pajtim me Rregullin 19, Zyra e Patentave Europiane fton kërkuesin të bëjë përcaktimin brenda një afati që duhet të caktohet.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KAPITULLI II RAPORTI EUROPIAN I HULUMTIMIT

Rregulli 61¹ N. 14, 54, 56, 92; R. 8, 65
Përmbajtja e raportit evropian të kërkimit

1. Raporti i kërkimit evropian përmend të gjithë ato dokumente që Zyra e Patentave Evropiane ka në momentin e hartimit të raportit, që mund të merret parasysh për të vendosur nëse shpikja të cilës i përket kërkesa për patentë evropiane është e re dhe përbën një hap shpikës.
2. Çdo citim u referohet pretendimeve që ai u përket. Sipas rastit, identifikohen pjesët përkatëse të dokumenteve të cituara.
3. Raporti i kërkimit evropian bën dallimin ndërmjet dokumenteve të cituara të publikuara para datës së prioritetit të pretenduar, ndërmjet kësaj date të prioritetit dhe datës së depozitimit, dhe në ose pas datës së depozitimit.
4. Çdo dokument që i referohet një deklarami gojor, një përdorimi apo një mjeti tjetër të deklaramet që është bërë para datës së depozitimit të kërkesës për patentë evropiane përmendet në raportin e kërkimit evropian, së bashku me një tregues të datës së publikimit, nëse ka, të dokumentit dhe datës së deklaramit të pashkruar.
5. Raporti i kërkimit evropian hartohet në gjuhën e procedimit.
6. Raporti i kërkimit evropian përmban klasifikimin e lëndës së kërkesës për patentë evropiane në pajtim me klasifikimin ndërkombëtar.

Rregulli 62² N. 92; R. 65
Raporti i kërkimit të zgjeruar evropian

1. Raporti i kërkimit evropian shoqërohet nga një mendim nëse kërkesa dhe shpikja së cilës ajo i përket duket se përmbush kërkesat e kësaj Konvente, përveç kur bëhet një komunikim sipas Rregullit 71, paragrafi 1 ose 3.
2. Mendimi sipas paragrafit 1 nuk publikohet së bashku me raportin e kërkimit

Rregulli 63 N. 92; R. 65
Kërkimit i paplotë

Nëse Zyra e Patentave Evropiane mendon që kërkesa për patentë evropiane nuk përputhet me këtë Konventë në atë masë që është e pamundur të kryhet një kërkim i arsyeshëm në lidhje me arritjet e mëparëshme mbi bazën e të gjithë ose një pjesë të objektit të pretenduar, ajo nxjerr një deklaratë të arsyetuar për këtë qëllim ose, nëse kjo është praktike, përpilon një raport kërkimi të pjesshëm. Deklarata ose raporti i pjesshëm konsiderohet për qëllimet e procedimit pasues si raport evropian kërkimi.

Rregulli 64³ N. 92; R. 65, 164
Raporti i kërkimit evropian nëse shpikja nuk ka unitet

1. Nëse Zyra e Patentave Evropiane mendon që kërkesa për patentë evropiane nuk përmbush kërkesat e unitetit të shpikjes, ajo harton një raport të pjesshëm kërkimi për ato pjesë të kërkesës që i përkasin shpikjes ose grupit të shpikjeve sipas kuptimit të Nenit 82, përmendur së pari në pretendimet. Ajo njofton kërkuesin që me qëllim që raporti i kërkimit evropian të mbulojë shpikjet e tjera, duhet të paguhet një tarifë shtesë kërkimi, në lidhje me çdo shpikje të përfshirë, brenda një periudhe që duhet të përcaktohet, që nuk është më e shkurtër se dy javë dhe jo më e gjatë se gjashtë javë. Raporti i kërkimit evropian hartohet për pjesët e kërkesës që kanë të bëjnë me shpikjet në lidhje me të cilat janë paguar tarifat e kërkimit.
2. Një tarifë e paguar sipas paragrafit 1 kthehet nëse gjatë shqyrtimit të kërkesës për patentë evropiane,

¹ Shih informacionin nga EPO në lidhje me Aneksin e raportit të kërkimit evropian (GZ EPO 1982, 448 ff, 1984, 381; 1999, 90).

² Futur me vendim të Këshillit Administrativ të datës 09.12.2004 që ka hyrë në fuqi më 01.07.2005 (GZ EPO 2005).

³ Shih mendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 2/92 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

kërkuesi kërkon këtë kthim dhe Sektori i Ekzaminimit konstaton që komunikimi sipas paragrafit 1 nuk është i justifikuar.

Rregulli 65 N. 17, 92, 153; R. 61-66, 70, 137 Transmetimi i raportit european të kërimit

Menjëherë pas përpilimit të tij, raporti i kërimit european i transmetohet kërkuesit së bashku me kopjet e një dokumenti të cituar.

Rregulli 66 N. 85, 92, 93; R. 47, 65, 68 Përmbajtja përfundimtare e përmbledhjes

Me përpilimin e raportit të kërimit european, Zyra e Patentave Europiane përcakton përmbajtjen përfundimtare të përmbledhjes dhe ia transmeton atë kërkuesit së bashku me raportin e kërimit.

KAPITULLI III PUBLIKIMI I KËRKESËS PËR PATENTË EUROPIANE

Rregulli 67¹ N. 93; R. 31-33 Përgatitjet teknike për publikim

1. Kryetari i Zyrës për Patenta Europiane përcakton kur përgatitjet teknike për publikimin e kërkesës për patentë europiane konsiderohen të jenë përfunduar.

2. Kërkesa nuk publikohet nëse ajo është refuzuar ose tërhequr apo konsiderohet të jetë tërhequr para përfundimit të përgatitjeve teknike për publikim.

Rregulli 68² N. 14, 67, 93, 128, 153; R. 52, 66 Forma e publikimit të kërkesave për patentë europiane dhe raporteve europiane të kërimit

1. Publikimi i kërkesës për patentë europiane përmban përshkrimin, pretendimet dhe çdo skicim të depozituar, dhe pjesën, ose nëse këto dokumente që përbëjnë kërkesën nuk janë depozituar në një gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane, një përkthim në gjuhën e procedimit, dhe, në një aneks, raportin european të kërimit, nëse ai disponohet para përfundimit të përgatitjeve teknike për publikimin. Nëse raporti i kërimit ose pjesa nuk publikohet në të njëjtën kohë me kërkesën, ajo publikohet veçmas.

2. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane përcakton formën e publikimit të kërkesës dhe të dhënat që duhet të përfshihen. E njëjta zbatohet nëse raporti european të kërimit dhe pjesët publikohen veçmas.

3. Shtetet Kontraktues të caktuar tregohen në kërkesën e publikuar.

4. Nëse pretendimet për patentë nuk janë depozituar në datën e depozitimit të kërkesës, kjo tregohet kur bëhet publikimi i kërkesës. Nëse, para përfundimit të përgatitjeve teknike të kërkesës, pretendimet janë ndryshuar sipas Rregullit 137, paragrafi 2, pretendimet e reja ose të pretenduara përfshihen në publikim duke iu shtuar pretendimeve të depozituara.

Rregulli 69 N. 93, 94, 129 Informacion mbi publikimin

1. Zyra e Patentave Europiane informon kërkuesin për datën në të cilën Buletini i Patentave Europiane përmend publikimin e raportit të kërimit european dhe tërheq vëmendjen e tij për Rregullin 70, paragrafi 1, dhe Nenin 94, paragrafi 2.

2. Kërkuesi nuk mund kërkojë të kundërshtojë komunikimin sipas paragrafit 1. Nëse në komunikim specifikohet një datë më e mëvonshme publikimi, kjo datë e mëvonshme është data përcaktuese në lidhje me periudhën e depozitimit të kërkesës për shqyrtim, përveç kur gabimi është i dukshëm.

¹ Shih Vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, D 1.

² Shih Vendimet e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, D. 3, D. 4.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 70 N. 14, 16, 18, 94, 121, 129; R. 6,
10, 65, 69, 112, 113, 142, 159

Kërkesë për shqyrtim

1. Kërkuesi mund të kërkojë shqyrtimin e kërkesës për patentë europiane deri në gjashtë muaj pas datës në të cilën Buletini për Patenta Europiane përmend publikimin e raportit të kërkimit europian. Kërkesa nuk mund të tërhiqet.

2. Nëse kërkesa për shqyrtim është depozituar para se t'i transmetohej kërkuesit raporti i kërkimit europian, Zyra e Patentave Europiane fton kërkuesin të tregojë, brenda një periudhe që duhet të përcaktohet, nëse ai do të vazhdojë më tej me kërkesën dhe i jep atij mundësinë për të komentuar mbi raportin e kërkimit dhe, sipas rastit, të ndryshojë përshkrimin, pretendimet dhe skicimet.

3. Nëse kërkuesi nuk përmbush në kohën e duhur kërkesën sipas paragrafit 2, kërkesa konsiderohet e tërhequr.

KAPITULLI IV EKZAMINIMI NGA SEKTORI I EKZAMINIMIT

Rregulli 71¹ N. 86, 94, 97, 123; R. 50-53, 70

Procedura e ekzaminimit

1. Në çdo komunikim sipas Nenit 94, paragrafi 3, Sektori i Ekzaminimit, sipas rastit, fton kërkuesin të korrigjojë çdo mangësi të shënuar dhe të ndryshojë përshkrimin, pretendimet dhe skicimet brenda një periudhe që duhet të caktohet.

2. Çdo komunikim sipas Nenit 94, paragrafi 3, përmban një deklaram të arsyetuar që mbulon, sipas rastit, të gjitha shkaqet kundër dhënies së patentës europiane.

3. Para se Sektori i Ekzaminimit të vendos për dhënien e një patente europiane, ajo informon kërkuesin për tekstin që ajo mendon ta japë atë dhe e fton atë të paguajë tarifat për dhënien dhe printimin dhe të depozitojë një përkthim të pretendimeve në gjuhët zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane të ndryshme nga gjuha e procedimit brenda një periudhe prej katër muajsh. Nëse kërkuesi paguan tarifat dhe depoziton përkthimin brenda kësaj periudhe, ai konsiderohet të ketë aprovuar tekstin për e caktuar për dhënien.

4. Nëse kërkuesi brenda periudhës së parashikuar në paragrafin 3, kërkon ndryshime sipas Rregullit 137, paragrafi 3, ose korrigjimin e gabimeve sipas Rregullit 139, ai, nëse pretendimet ndryshohen ose korrigjohen, depoziton një përkthim të pretendimeve të ndryshuara ose të korrigjuara. Nëse kërkuesi paguan tarifat dhe depoziton një përkthim brenda kësaj periudhe, ai konsiderohet të ketë aprovuar dhënien e patentës të ndryshuar ose korrigjuar.

5. Nëse Sektori i Ekzaminimit nuk jep pëlqimin për një ndryshim ose korrigjim të kërkuar sipas paragrafit 4, ai, para marrjes së vendimit, i jep kërkuesit mundësinë për të paraqitur, brenda një periudhe kohore që duhet të përcaktohet, vërejtjet e tij dhe çdo ndryshim që konsiderohet i nevojshëm nga Sektori i Ekzaminimit, dhe, nëse pretendimet ndryshohen, një përkthim të pretendimeve të ndryshuara. Nëse kërkuesi paraqet këto ndryshime, ai konsiderohet të ketë aprovuar dhënien e patentës së ndryshuar. Nëse kërkesa për patentë europiane refuzohet, tërhiqet ose mendohet të tërhiqet, tarifat për dhënien dhe printimin, nëse është paguar ndonjë tarifë sipas paragrafit 6, ri-imbursohet.

6. Nëse kërkesa për patentë europiane në tekstin që mendohet të jepet përbëhet nga më shumë se dhjetë pretendime, Sektori i Ekzaminimit fton kërkuesin të paguajë tarifat për pretendimet në lidhje me çdo pretendim shtesë brenda periudhës sipas paragrafit 3, dhe, sipas rastit, paragrafit 5, përveç kur këto tarifa janë paguar sipas Rregullit 45 ose Rregullit 162.

7. Nëse tarifat për dhënien dhe printimin ose pretendimet për pretendimet nuk paguhën në kohën e duhur, ose nëse përkthimi nuk depozitohet në kohën e duhur, kërkesa për patentë europiane konsiderohet të jetë tërhequr.

8. Nëse tarifat e caktimit duhen paguar pas komunikimit sipas paragrafit 3, përmendja e dhënies së patentës europiane nuk publikohet derisa të jenë paguar tarifat e caktimit. Kërkuesi njoftohet përkatësisht.

9. Nëse një tarifë e mbajtjes në fuqi duhet paguar pas komunikimit sipas paragrafit 3 dhe para datës tjetër të

¹ Shih Vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit, G 10/93, G 1/02 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

mundshme për publikimin e përmendjes së dhënies së patentës europiane, përmendja nuk publikohet derisa të paguhet tarifa e mbajtjes në fuqi. Kërkuesi njoftohet përkatësisht.

10. Komunikimi sipas paragrafit 3 tregon Shtetet Kontraktues të caktuar që kërkojnë një përkthim sipas Nenit 65, paragrafi 1.

11. Vendimi për dhënien e patentës europiane përcakton cili tekst i kërkesës për patentë europiane përbën bazën e vendimit.

Rregulli 72 N. 59, 97

Dhënia e patentës europiane kërkuesve të ndryshëm

Nëse në Regjistrin e Patentave Europiane janë regjistruar persona të ndryshëm si kërkues në lidhje me Shtete të ndryshëm Kontraktues, Zyra e Patentave Europiane e jep patentën europiane përkatësisht për çdo Shtet Kontraktues.

KAPITULLI V SPECIFIKIMI I PATENTËS EUROPIANE

Rregulli 73¹ N. 98, 99; R. 74, 87

Përmbajtja dhe forma e specifikimeve

1. Specifikimi i patentës europiane përfshin përshkrimin, pretendimet dhe çdo skicim. Ajo tregon gjithashtu periudhën për apelimin e patentës europiane.

2. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane përcakton formën e publikimit të specifikimit dhe të dhënat që duhet të përfshihen.

3. Shtetet Kontraktues të emërtuar tregohen në specifikim.

Rregulli 74² N. 98; R. 87

Certifikata për një patentë europiane

Menjëherë sapo të publikohet specifikimi i patentës europiane, Zyra e Patentave Europiane i lëshon pronarit të patentës një certifikatë për një patentë europiane. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane përcakton përmbajtjen, formën dhe mjetet e komunikimit të certifikatës dhe përcakton rrethanat në të cilat paguhet një tarifë administrative.

PJESA V RREGULLAT ZBATUESE PËR PJESËN V TË KONVENTËS

KAPITULLI I PROCEDURA E APELIMIT

Rregulli 75 N. 99; R. 98, 143

Mosinteresimi ose shuarja e patentës

Një apelim mund të depozitohet edhe nëse patenta europiane është dorëzuar në të gjitha Shtetet Kontraktues të përcaktuar ose ka skaduar në të gjitha ato shtete.

Rregulli 76³ N. 99, 100, 105, 133; R. 77, 89

Forma dhe përmbajtja e kundërshtimit

1. Njoftimi i kundërshtimit depozitohet në një deklaratë të arsyetuar me shkrim.

¹ Shih Vendimet e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, D. 3, D. 4.

² Shih Vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, D. 3. D. 4.

³ Shih Vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 9/91, G 10/91, G 1/95, G 7/95, G 4/97, G 3/99, G 1/04 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Njoftimi i kundërshtimit përmban:
 - a) tiparet e veçanta të kundërshtimit sipas parashikimit në Rregullin 41, paragrafi 2(c);
 - b) numrin e patentës europiane kundër së cilës është depozituar kundërshtimit, emrin e pronarit të patentës dhe titullin e shpikjes;
 - c) një deklaratë për masën në të cilën kundërshtohet patentë europiane dhe shkaqet në të cilat bazohet kundërshtimi, si dhe një tregues të fakteve dhe provave të paraqitura në mbështetje të këtyre shkaqeve;
 - d) Nëse apeluesi ka caktuar një përfaqësues, me tiparet e veçanta të parashikuara në Rregullin 41, paragrafi 2(d).
3. Pjesa III e Rregulloreve të Zbatimit zbatohen *mutatis mutandis* për njoftimin e kundërshtimit.

Rregulli 77¹ N. 99, 101, 105; R. 78, 89

Prëzimi i kundërshtimit si i papranueshëm

1. Nëse Sektori i Kundërshtimit vëren që njoftimi i kundërshtimit nuk përputhet me dispozitat e Nenit 99, paragrafi 1, ose Rregullit 76, paragrafi 2(c), ose nuk identifikon në masën e mjaftueshme patentën kundër së cilës është depozituar kundërshtimi, ai e rrëzon kundërshtimin si të papranueshëm, përveç kur mangësitë korrigjohen para skadimit të afatit të apelimit.
2. Nëse Sektori i Kundërshtimit vëren që njoftimi i kundërshtimit nuk përputhet me dispozitat e ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin 1, ai ia komunikon këtë kundërshtuesit dhe e fton atë të korrigjojë mangësitë e përmendura brenda një periudhe që duhet të përcaktohet. Nëse mangësitë nuk korrigjohen në kohën e duhur, Sektori i Kundërshtimit e rrëzon kundërshtimin si të papranueshëm.
3. Vendimi për rrëzimin të kundërshtimit si të papranueshëm i komunikohet pronarit të patentës, së bashku me një kopje të njoftimit të kundërshtimit.

Rregulli 78² N. 60, 99, 101, 105, 118, 123; R. 16, 77, 89, 138, 143

Procedura kur pronari i patentës nuk ka fituar të drejtën

1. Nëse një palë e tretë paraqet prova gjatë procedimit të kundërshtimit ose gjatë periudhës së kundërshtimit, që ai ka filluar procedimin kundër pronarit të patentës europiane, duke kërkuar një vendim në kuptimin e Nenit 61, paragrafi 1, procedimi i kundërshtimit pezullohet përveç kur pala e tretë i komunikon Zyrës së Patentave Europiane me shkrim pëlqimin e saj për vazhdimin e këtij procedimi. Një pëlqim i tillë është i parevokueshëm. Megjithatë, procedimi nuk pezullohet deri në momentin që Sektori i Kundërshtimit e konsideron kundërshtimin të pranueshëm. Rregulli 14, paragrafi 2 deri 4, zbatohen *mutatis mutandis*.
2. Nëse një palë e tretë, në pajtim me Nenin 99, paragrafi 4, ka zëvendësuar pronarin e mëparshëm për një ose disa nga Shtetet Kontraktues të përcaktuar, patentë siç qëndron në fuqi në procedimin e apelimit, për këto Shtete, mund të përmbajë pretendime, një përshkrim dhe skicime të ndryshme nga ato të Shteteve të tjerë të përcaktuar.

Rregulli 79³ N. 101, 123; R. 89

Përgatitja e shqyrtimit të kundërshtimit

1. Sektori i kundërshtimit ia komunikon njoftimin e kundërshtimit pronarit të patentës dhe i jep atij mundësinë të depozitojë vërejtjet e tij dhe të ndryshojë, sipas rastit, përshkrimin, pretendimet dhe skicimet brenda një periudhe që duhet të specifikohet.
2. Nëse janë depozituar disa njoftime kundërshtimit, Sektori i Kundërshtimit u komunikon kundërshtuesve të tjerë në të njëjtën kohë me komunikimin sipas paragrafit 1.
3. Sektori i Kundërshtimit u komunikon palëve të tjera çdo vërejtje dhe ndryshim të depozituar nga pronari i patentës dhe i fton ato, nëse e konsideron të arsyeshme, të përgjigjen brenda një periudhe që duhet të përcaktohet.

¹ Shih Vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 9/91, G 10/91, G 1/95, G 7/95, G 3/99, G 1/02 (Aneksi I).

² Shih Vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/92 (Aneksi I).

³ Shih mendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 1/02 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

4. Në rastin e një ndërhyrjeje sipas Nenit 105, Sektori i Kundërshtimit mund të mos zbatojë paragrafët 1 deri 3.

Rregulli 80¹ N. 101, 105, 123; R. 89, 137

Amendimi i patentës europiane

Pa cenuar Rregullin 138, përshkrimi, pretendimet dhe skicimet mund të amendohen, me kusht që ndryshimet të mbështeten në një shkak për kundërshtim sipas Nenit 100, edhe nëse një shkak i tillë nuk është njoftuar nga ndonjë kundërshtues.

Rregulli 81² N. 101, 105, 123; R. 89

Shqyrtimi i kundërshtimit

1. Sektori i Kundërshtimit i shqyrton ato shkaqe për kundërshtim që paraqiten në deklarin e kundërshtuesit sipas rregullit 76, paragrafi 2. Shkaqet e kundërshtimit që nuk drejtohen nga kundërshtuesi mund të shqyrtohen nga Sektori i Kundërshtimit kryesisht nëse ato do të cenonin mbajtjen e patentës europiane.

2. Komunikimet sipas Nenit 101, paragrafi 1, fjalë e dytë, dhe të gjitha përgjigjet e tyre u dërgohen të gjitha palëve, Nëse Sektori i Kundërshtimit e konsideron të arsyeshme, ai fton palët të përgjigjen brenda një afati që duhet të përcaktohet.

3. Në çdo komunikim sipas Nenit 101, paragrafi 1, fjalë e dytë, pronarit të patentës europiane, sipas rastit, i jepet mundësia të ndryshojë, sipas rastit, përshkrimin, pretendimet dhe skicimet. Sipas rastit, komunikimi përmban një deklarin të arsyetuar që mbulon shkaqet kundër mbajtjes së patentës europiane.

Rregulli 82³ N. 65, 101, 105, 123; R. 89

Mbajtja në fuqi e patentës europiane në formë të amenduar

1. Para se Sektori i Kundërshtimit vendos të mbajë patentën europiane të ndryshuar, ai u njofton palëve tekstin në të cilin ai mendon të mbajë patentën dhe i fton ato të depozitojnë vërejtjet e tyre brenda dy muajve nëse ato nuk bien dakord me tekstin.

2. Nëse një palë nuk e pranon tekstin e komunikuar nga Sektori i Kundërshtimit, mund të vazhdojë shqyrtimi i kundërshtimit. Përndryshe, Sektori i Kundërshtimit, me skadimin e afatit sipas paragrafit 1, fton pronarin e patentës të paguajë tarifën e parashikuar dhe të depozitojë një përkthim të çdo pretendimi të ndryshuar në gjuhët zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane të ndryshme nga gjuha e procedimit, brenda një periudhe prej tre muajsh. Kjo ftesë tregon Shtetet Kontraktues të përcaktuar që kërkojnë një përkthim sipas Nenit 65, paragrafi 1.

3. Nëse veprimet e kërkuara sipas paragrafit 2 nuk kryhen në kohën e duhur, ato mund të kryhen brenda dy muajve nga komunikimi në lidhje me mosrespektimin e afatit kohor, me kusht që të paguhet një tarifë shtesë për këtë periudhë. Në rast të kundërt, patentë anulohet.

4. Vendimi për mbajtjen e patentës europiane, të ndryshuar, deklaron cila pjesë e tekstit të patentës përbën bazën për vendimin.

Rregulli 83 N. 101, 105 ;R. 1, 2, 89

Kërkesa për dokumente

Dokumentet e përmendur nga një palë në procedimin e kundërshtimit depozitohen së bashku me njoftimin e kundërshtimit ose paraqitjet me shkrim. Nëse këto dokumente nuk bashkëngjiten ose depozitohen në kohë pas ftesës nga Zyra e Patentave Europiane, kjo mund të vendosë të mos i marrë parasysh argumentet e bazuar mbi to.

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 1/99 (Aneksi I).

² Shih Vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 9/92, G 1/99 (Aneksi I).

³ Shih Vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 1/88, G 1/90 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 84¹ N. 99, 101, 105; R. 75, 89

Vazhdimi i procedimit të kundërshtimit nga Zyra e Patentave Europiane

1. Nëse patenta europiane është dorëzuar në të gjithë Shtetet Kontaktues të përcaktuar ose ka skaduar në të gjithë ato Shtete, procedimi i kundërshtimit mund të vazhdojë me kërkesë të kundërshtuesit të depozituar brenda dy muajve nga komunikimi i Zyrës së Patentave Europiane që e informon atë për dorëzimin ose skadimin.

2. Në rastin e vdekjes ose pazotësisë ligjore për të vepruar nga kundërshtuesi, procedimi i apelit mund të vazhdohet kryesisht nga Zyra e Patentave Europiane, edhe pa pjesëmarrjen e trashëgimtarëve ose të përfaqësuesve ligjorë. E njëjta zbatohet nëse tërhiqet kundërshtimi.

Rregulli 85 N. 2, 99, 127

Transferimi i patentës europiane

Rregulli 22 zbatohet për çdo transferim të patentës europiane të bërë gjatë periudhës së kundërshtimit ose gjatë procedimit të kundërshtimit.

Rregulli 86² N. 99, 101, 105; R. 89

Dokumentet në procedimin e kundërshtimit

Pjesa III e Rregulloreve Zbatuese zbatohen mutatis mutandis për dokumentet e depozituara në procedimin e kundërshtimit.

Rregulli 87 N. 103

Përmbajtja dhe forma e specifikimit të ri të patentës europiane

Specifikimi i ri i patentës europiane përfshin përshkrimin, pretendimet dhe skicimet, të ndryshuara. Zbatohet Rregulli 73, paragrafët 2 dhe 3, dhe Rregulli 74.

Rregulli 88 N. 104, 106 ; R. 97

Shpenzimet

1. Ndarja e shpenzimeve përcaktohet në vendimin mbi kundërshtimin. Kjo ndarje merr parasysh vetëm shpenzimet e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e duhur të të drejtave të përfshira. Shpenzimet përfshijnë shpërblimin e përfaqësuesve të palëve.

2. Sektori i Kundërshtimit, me kërkesë, përcakton shumën e shpenzimeve që duhet të paguhet sipas një vendimi përfundimtar që bën ndarjen e tyre. Kërkesës i bashkëngjitet një faturë e shpenzimeve me provat shoqëruese. Shpenzimet mund të përcaktohen në momentin e vërtetimit të besueshmërisë së tyre.

3. Një kërkesë për një vendim nga Sektori i Kundërshtimit mund të depozitohet brenda një muaji nga komunikimi për caktimin e shpenzimeve sipas paragrafit 2. Kërkesa depozitohet me shkrim dhe përmban shkaqet mbi të cilat bazohet. Ajo nuk konsiderohet të jetë depozituar deri në momentin e pagesës së tarifës së parashikuar.

4. Sektori i Kundërshtimit vendos mbi kërkesën sipas paragrafit 3 pa procedim gojor.

Rregulli 89³ N. 99 ; R. 3, 6, 76-86, 112

Ndërhyrja e shkelësit të prezumuar

1. Njoftimi i ndërhyrjes depozitohet brenda tre muajve nga data në të cilën fillon procedimi i përmendur në Nenin 105.

2. Njoftimi i ndërhyrjes depozitohet në një deklaramë me shkrim të arsyetuar; Rregullat 76 dhe 77 zbatohen mutatis mutandis. Njoftimi i ndërhyrjes nuk konsiderohet të jetë depozituar deri në momentin e pagesës së tarifës së kundërshtimit.

¹ Shih Vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 4/88, G 7/91, G 8/91, G 8/93, G 3/99 (Aneksi I).

² Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 1/91 (Aneksi I).

³ Shih Vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 4/91, G 1/94, G 2/04, G 3/04, G 1/05 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KAPITULLI II PROCEDURA E KUFIZIMIT OSE REVOKIMIT

Rregulli 90 N. 2, 105a/bis Objekti i procedimit

Objekti i procedimit të kufizimit ose revokimit sipas Nenit 105a është patenta europiane e dhënë ose ndryshuar në procedimin e apelimit ose kufizimit para Zyrës së Patentave Europiane.

Rregulli 91 N. 105b/ter Përgjegjësia e procedimit

Vendimet mbi kërkesat për kufizimin ose revokimin e patentës europiane sipas Nenit 105a merren nga Sektori i Ekzaminimit. Neni 18, paragrafi 2, zbatohen mutatis mutandis.

Rregulli 92 N. 2, 105a/bis ; R. 6, 94, 95 Kushtet e kërkesës

1. Kërkesa për kufizimin ose revokimin e një patente europiane depozitohet me shkrim. Pjesa III e Rregulloreve zbatuese zbatohet mutatis mutandis për dokumentet e depozituar në procedimin e kufizimit ose revokimit.

2. Kërkesa përmban:

a) tiparet e veçanta të pronarit të patentës europiane që bën kërkesën (kërkuesi), sipas parashikimit të Rregullit 41, paragrafi 2(c), dhe një tregues për Shtetet Kontraktues për të cilët kërkuesi i është pronari i patentës;

b) numrin e patentës për të cilën kërkohet kufizimi ose revokimin dhe një listë të Shteteve Kontraktues në të cilët patenta kë hyrë në fuqi;

c) sipas rastit, emrat dhe adresat e pronarëve të patentës për ato Shtete Kontraktues në të cilët kërkuesi nuk është pronar i patentës, dhe prova që kërkuesi ka të drejtën për të vepruar në emër të tyre në procedim;

d) nëse kërkohet kufizimi i patentës, versionin e plotë të pretendimeve të ndryshuara dhe, sipas rastit, të përshkrimit dhe skicimeve të ndryshuara.

e) nëse kërkuesi ka emëruar një përfaqësues, tiparet e veçanta sipas parashikimit të Rregullin 41, paragrafi 2(d).

Rregulli 93 N. 105a/bis Përparësia e procedimit të kundërshtimit

1. Kërkesa për kufizimin ose revokim konsiderohet të mos jetë bërë nëse është në zhvillim e sipër një procedim kundërshtimi në lidhje me patentën në momentin e depozitimit të kërkesës.

2. Nëse, në momentin e depozitimit të një kundërshtimi për një patentë europiane, është në zhvillim e sipër një procedim kufizimi në lidhje me atë patentë, Sektori i Ekzaminimit pushon procedimin e kufizimit dhe urdhëron kthimin e tarifës së kufizimit. Kthimi urdhërohet gjithashtu në lidhje me tarifën e përmendur në Rregullin 95, paragrafi 3, fjalia e parë, nëse kërkuesi e ka paguar tashme këtë tarifë.

Rregulli 94 N. 105b/ter ; R. 92, 95 Rrëzimi i kërkesës si e papranueshme

Nëse Sektori i Ekzaminimit konstaton që kërkesa për kufizimin ose revokim nuk përmbush kërkesat e Rregullit 92, ai fton kërkuesin të korrigjojë mangësitë e caktuara brenda një periudhe kohe që duhet të caktohet. Nëse mangësitë nuk korrigjohen në kohën e duhur, Sektori i Ekzaminimit e rrëzon kërkesën si të papranueshme.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 95 N. 2, 105b/ter; R. 92, 94

Vendimi për kërkesën

1. Nëse një kërkesë për revokim është e pranueshme, Sektori i Ekzaminimit e revokon patentën dhe ia komunikon këtë kërkesës.

2. Nëse një kërkesë për kufizim është e pranueshme, Sektori i Ekzaminimit e shqyrton nëse pretendimet e ndryshuara përbëjnë një kufizim kundrejt pretendimeve të dhëna ose të ndryshuara në procedimin e kundërshtimit ose kufizimit dhe përputhen me Nenin 84 dhe Nenin 123, paragrafët 2 dhe 3. Nëse kërkesa nuk përputhet me këto kërkesa, Sektori i Ekzaminimit i jep kërkuarës mundësinë për të korrigjuar çdo mangësi të caktuar, dhe të ndryshojë pretendimet dhe, sipas rastit përshkrimin dhe skicimet, brenda një afati kohor që duhet të caktohet.

3. Nëse një kërkesë për kufizim lejohet sipas paragrafit 2, Sektori i Ekzaminimit ia komunikon këtë kërkesë dhe e fton atë të paguajë tarifën e parashikuar dhe të depozitojë një përkthim të pretendimeve të ndryshuara në gjuhët zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane të ndryshme nga gjuha e procedimit, brenda një afati prej tre muajsh; Rregulli 82, paragrafi 3, fjalë e parë zbatohet mutatis mutandis. Nëse kërkuarësi i bën këto veprime në kohën e duhur, Sektori i Ekzaminimit kufizon patentën.

4. Nëse kërkuarësi nuk i përgjigjet në kohën e duhur komunikimit të nxjerrë sipas paragrafit 2, ose nëse kërkesa për kufizim nuk lejohet, ose nëse kërkuarësi nuk kryhen veprimet e parashikuara sipas paragrafit 3 në kohën e duhur, Sektori i Ekzaminimit e rrëzon kërkesën.

Rregulli 96 N. 65, 105c/quarter

Përmbajtja dhe forma e specifikimit të patentës europiane

Specifikimi i ndryshuar i patentës europiane përfshin përshkrimin, pretendimet dhe skicimet e ndryshuara. Zbatohet Rregulli 73, paragrafi 2 dhe 3, dhe Rregulli 74.

PJESA VI

RREGULLORET ZBATUESE PËR PJESËN VI TË KONVENTËS

KAPITULLI I

PROCEDURA E ANKIMIT

Rregulli 97¹ N. 104; R. 88, 101

Ankimi kundër ndarjes dhe caktimit të shpenzimeve

1. Ndarja e shpenzimeve në procedimin e apelimit nuk mund të jetë objekti kryesor i një ankimi.
2. Vendimi që cakton shumën e shpenzimeve në procedimin e apelimit nuk mund të ankimohet, përveç kur shuma e kalon anë të tarifës së ankimit.

Rregulli 98 R. 75

Mosinteresimi ose shuarja e patentës

Vendimi i një Sektori Kundërshtimi mund të apelohej edhe nëse patenta europiane është dorëzuar në të gjithë Shtetet Kontraktues të përcaktuar ose ka skaduar në të gjithë këta Shtete.

Rregulli 99² N. 108; R.101

Përmbajtja e njoftimit të apelimit dhe argumentimi i ankesës

1. Njoftimi i apelimit përmban:

- a) emrin dhe adresën e apeluesit sipas parashikimit në Rregullin 41, paragrafi 2(c);
- b) një tregues për vendimin e ankimuar; dhe

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/03 (Aneksi I).

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 9/92, G 1/99 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- c) një kërkesë që përcakton objektin e apelimit.
2. Në deklarimin e shkaqeve të apelimit, apeluesi tregon arsyet për shfuqizimin e vendimit të ankimuar, ose masën në të cilën ai duhet të ndryshohet, dhe faktet dhe provat në të cilat është i bazuar vendimi.
3. Pjesa III e Rregulloreve Zbatuese zbatohet mutatis mutandis për njoftimin e apelimit, deklarimin e shkaqeve dhe dokumentet e depozituara në procedurën e apelimit.

Rregulli 100¹ N. 110, 111; R. 102, 111

Shqyrtimi i apelimeve

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe, në procedimin e ankimit zbatohen dispozitat në lidhje me procedimin para departamentit që ka marrë vendimin e apeluar.
2. Në shqyrtimin e ankimit, Bordi i Apelit fton palët, aq shpesh sa të jetë e nevojshme, të depozitojnë vërejtjet, brenda një afati kohor që duhet të përcaktohet, mbi komunikimet e nxjerra nga ai ose vërejtjet e paraqitura nga një palë tjetër.
3. Nëse ankimuesi nuk përgjigjet në kohën e duhur ndaj një ftese sipas paragrafit 2, kërkesa për patentë europiane konsiderohet e tërhequr, përveç kur vendimi i ankimuar është marrë nga Sektori Juridik.

Rregulli 101² N. 106-108, 110, 111; R. 97

Refuzimi i ankimit si i papranueshëm

1. Nëse ankimi nuk përputhet me Nenet 106 deri 108, Rregullin 97 ose Rregullin 99, paragrafi 1(b) ose (c) ose paragrafi 2, Bordi i Apelit e rrëzon atë si të papranueshëm, përveç kur një mangësi është korrigjuar para skadimit të afatit sipas Nenit 108.
2. Nëse Bordi i Apelit vëren që apelimi nuk përputhet me Rregullin 99, paragrafi 1(a), ai ia komunikon këtë ankimuesit dhe e fton atë korrigjojë mangësitë e vërejtura brenda një periudhe që duhet të caktohet. Nëse mangësitë nuk korrigjohen në kohën e duhur, Bordi i Apelit e rrëzon ankimin si të papranueshëm.

Rregulli 102³ N. 110, 111

Forma e vendimit të Bordit të Apelit

Vendimi siglohet nga Kryetari i Bordit të Apelit dhe nga punonjësi kompetent i regjistrit të Bordit të Apelit, me anë të nënshkrimit të tyre ose me një mjet tjetër të përshtatshëm. Vendimi përmban:

- a) një deklaram që ai është dhënë nga Bordi i Apelit;
- b) datën kur është marrë vendimi;
- c) emrat e Kryetarit dhe të anëtarëve të tjerë të Bordit të Apelit që marrin pjesë;
- d) emrat e palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
- e) kërkesat e palëve;
- f) përmbledhje të fakteve;
- g) shkaqet;
- h) urdhërimin e Bordit të Apelit, duke përfshirë sipas rastit, një vendim për shpenzimet.

Rregulli 103⁴ N. 109, 111

Kthimi i tarifave të apelimit

1. Tarifa e ankimit kthehet:
 - a) në rastin e një rishikimi të ndërmjetëm ose nëse Bordi i Apelit e konsideron një ankim të lejueshëm, nëse kjo kërkesë është e drejtë për shkak të një shkeljeje procedurale thelbësore, ose
 - b) nëse ankimi tërhiqet para depozitimit të deklaratës së shkaqeve të ankimit dhe para skadimit të periudhës së depozitimit të asaj deklarate.

¹ Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 7/91, G 8/91, G 9/91, G 10/91, G 9/92, G 8/93, G 10/93, G 6/95, G 1/99, G 3/99 (Aneksi I).

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 9/92, G 2/04 (Aneksi I).

³ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 1/05 (Aneksi I).

⁴ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/03 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. departamenti të cilit i ankimohet vendimi urdhëron kthimin nëse ai rishikon vendimin dhe e konsideron kthimin të drejtë për shkak të një shkeljeje të rëndë procedurale. Në të gjitha rastet e tjera, çështjet e kthimin vendosen nga Bordi i Apelit.

KAPITULLI II KËRKESAT PËR RISHIKIM NGA BORDI I ZGJERUAR I APELIT

Rregulli 104 N. 112a/bis Mangësi të tjera themelore procedurale

Një mangësi procedurale themelore sipas Nenit 112a, paragrafi 2(d), mund të ketë ndodhur nëse Bordi i Apelit,

- a) në kundërshtim me Nenin 116, nuk ka marrë masat për zhvillimin e procedimit gojor të kërkuar nga kërkuesi, ose
- b) ka vendosur për ankimin pa vendosur për një kërkesë në lidhje me atë vendim.

Rregulli 105 N. 112a/bis Veprat penale

Një kërkesë për rishikim mund të bazohet në Nenin 112a, paragrafi 2(e), nëse një gjykatë ose autoritet kompetent ka vendosur përfundimisht që është kryer një veprë penale; nuk është i nevojshëm fajësimi.

Rregulli 106 R. 108 Detyrimi për të ngritur apelim

Një kërkesë sipas Nenit 112a, paragrafi 2(a) deri (d), është e pranueshme vetëm nëse gjatë procedimit të ankimit është ngritur një apelim në lidhje me një mangësi procedurale dhe rrëzuar nga Bordi i Apelit, përveç kur një apelim i tillë nuk mund të ngrihet gjatë procedimit të ankimit.

Rregulli 107 N. 112a/bis; R. 2 Përmbajtja e kërkesës për rishikim

1. Kërkesa përmban:
 - a) emrin dhe adresën e kërkuarit sipas parashikimit në Rregullin 41, paragrafi 2(c);
 - b) një tregues të vendimit që duhet të rishikohet.
- 2) Kërkesa tregon shkaqet për shfuqizimin e vendimit të Bordit të Apelit dhe faktet dhe provat mbi të cilat bazohet kërkesa.
- 3) Pjesa III e Rregulloreve Zbatuese zbatohet mutatis mutandis për kërkesën për rishikim dhe dokumentet e depozituara në procedurën e ankimit.

Rregulli 108 Shqyrtimi i kërkesës

1. Nëse kërkesa nuk përputhet me Nenin 112a, paragrafët 1, 2 ose 4, Rregullin 106 ose Rregullin 107, paragrafi 1(b) ose 2, Bordi i Zgjeruar i Apelit e rrëzon atë si të papranueshëm, përveç kur një mangësi është korrigjuar para skadimit të afatit përkatës sipas Nenit 112a, paragrafi 4.
2. Nëse Bordi i Zgjeruar i Apelit vëren që kërkesa nuk përputhet me Rregullin 107, paragrafi 1(a), ai ja komunikon këtë kërkuarit dhe e fton atë të korrigjojë mangësitë e vëna re brenda periudhës që duhet të caktohet. Nëse mangësitë nuk korrigjohen në kohën e duhur, Bordi i zgjeruar i Apelit e rrëzon kërkesën si të papranueshme.
3. Nëse kërkesa lejohet, Bordi i Zgjeruar i Apelit e shfuqizon vendimin e Bordit të Apelit dhe urdhëron rifillimin e procedimit para Bordit të Apelit përgjegjës sipas Rregullit 12, paragrafi 4. Bordi i Zgjeruar i Apelit mund të urdhërojë zëvendësimin e anëtarëve të Bordit të Apelit që kanë marrë pjesë në marrjen e vendimit të shfuqizuar.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 109 N. 22

Procedura në trajtimin e kërkesave për rishikim

1. Në procedimin sipas Nenit 112a, zbatohen dispozitat në lidhje me procedimet para Bordeve të Apelit, përveç kur parashikohet ndryshe. Nuk zbatohet Rregulli 115, paragrafi 1, fjalia e dytë, Rregulli 118, paragrafi 2, fjalia e parë dhe Rregulli 132, paragrafi 2. Bordi i Zgjeruar i Apelit mund të përcaktojë një periudhë në ndryshim nga Rregulli 4, paragrafi 1, fjalia e parë.

2. Bordi i Zgjeruar i Apelit

a) që përbëhet nga dy anëtarë me kualifikim juridik dhe një anëtar me kualifikim teknik shqyrton të gjitha kërkesat për rishikim dhe rrëzon ato që janë haptazi të papranueshme ose të palejueshme; një vendim i tillë kërkon unanimitet;

b) që përbëhet nga katër anëtarë me kualifikim juridik dhe një anëtar me kualifikim teknik vendos për çdo kërkesë që nuk rrëzohet sipas nën-paragrafit (a).

3) Bordi i Zgjeruar i Apelit me përbërje sipas paragrafit 2(a) vendos pa përfshirjen e palëve të tjera dhe mbi bazën e kërkesës.

Rregulli 110 N. 112a/bis

Kthimi i tarifës për kërkesën për rishikim

Bordi i Zgjeruar i Apelit vendos kthimin e tarifës për kërkesën për rishikim nëse procedimi rihapet para Bordeve të Apelit.

PJESA VII

RREGULLORET ZBATUESE PËR PJESËN VII TË KONVENTËS

KAPITULLI I

VENDIMET DHE KOMUNIKIMET E ZYRËS SË PATENTAVE EUROPIANE

Rregulli 111¹ N. 90, 97, 101, 104, 105b/ter,

110-112a/bis; R. 97

Forma e vendimeve

1. Nëse para Zyrës së Patentave Europiane zhvillohet procedim gojor, vendimi mund të jepet gojarisht. Vendimi më vonë përpilohet me shkrim dhe u njoftohet palëve.

2. Vendimet e Zyrës së Patentave Europiane që janë të ankimeshme janë të arsyetuara dhe shoqërohen me një komunikim duke vënë në dukje mundësinë e ankimit dhe tërhequr vëmendjen e palëve për Nenin 106 deri 108, teksti i të cilëve bashkëngjitet. Palët nuk mund të kundërshtojnë moslëshimin e komunikimit.

Rregulli 112² N. 14, 77, 79, 86, 90, 94, 97, 99, 105,
106, 110, 119, 124, 136, 140 ; R. 135, 136, 142, 152, 155, 160

Verifikimi i humbjes së të drejtave

1. Nëse Zyra e Patentave Europiane vë re që ka ndodhur një humbje e të drejtave, ajo, pa asnjë vendim në lidhje me rrëzimin e kërkesës për patentë europiane ose dhënien, revokimin ose mbajtjen në fuqi patentën europiane, ose marrjen e provave, ua komunikon këtë palëve të interesuara.

2. Nëse pala e interesuar është e mendimit që konstatimi i Zyrës së Patentave Europiane është i pasaktë, ajo, brenda dy muajve nga komunikimi sipas paragrafit 1, mund të bëjë kërkesë për një vendim mbi këtë çështje. Zyra e Patentave Europiane e merr këtë vendim vetëm nëse ajo nuk është e të njëjtit mendim me palën që e kërkon atë; përndryshe, ajo njofton këtë palë.

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 12/91 (Aneksi I).

² Shih vendimet e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 1/90, G 2/97, G 1/02 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 113 N. 90, 94, 97, 101, 110, 115, 128, 153

Nënshkrimi, emri, vula

1. Çdo vendim, ftesë, njoftim dhe komunikim nga Zyra e Patentave Europiane nënshkruhet, dhe mban emrin e punonjësit përgjegjës.

2. Nëse një dokument i përmendur në paragrafin 1 nxirret nga punonjësi përgjegjës duke përdorur një kompjuter, një vulë mund të zëvendësojë firmën. Nëse dokumenti nxirret automatikisht nga një kompjuter, emri i punonjësit mund të mos vihet. E njëjta zbatohet për njoftimet dhe komunikimet e printuara paraprakisht.

KAPITULLI II

VËREJTJET NGA PALËT E TRETA

Rregulli 114 N. 93, 115; R. 1, 2

Vërejtjet nga palët e treta

1. Çdo vërejtje nga një palë e tretë depozitohet me shkrim në një gjuhë zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane dhe deklaron shkaqet mbi të cilat bazohet. Zbatohet Rregulli 3, paragrafi 3.

2. Çdo vërejtje e tillë i komunikohet kërkuesit ose pronarit të patentës, që mund të bëjnë komente për të.

KAPITULLI III

PROCEDIMI GOJOR DHE MARRJA E PROVAVE

Rregulli 115¹

Ftesa në procedimin gojor

1. Palët ftohen në procedimin gojor sipas Nenit 116, duke tërhequr vëmendjen e tyre tek paragrafi 2 i këtij Rregulli. Jepet të paktën dy muaj afat për ftesën, nëse palët nuk bien dakord për një periudhë më të shkurtër.

2. Nëse një palë e ftuar rregullisht në procedimin gojor para Zyrës së Patentave Europiane nuk paraqitet në mënyrën që ftohet, procedimi mund të vazhdojë pa atë palë.

Rregulli 116² N. 114, 116

Përgatitja e procedimit gojor

1. Në momentin e nxjerrjes së ftesës, Zyra e Patentave Europiane tërheq vëmendjen në pikat që sipas mendimit të saj duhet të diskutohen për qëllimet e vendimit që duhet të merret. Në të njëjtën kohë caktohet edhe një datë e fundit për bërjen e parashtrimeve me shkrim në përgatitje të procedimit gojor. Rregulli 132 nuk zbatohet. Faktet dhe provat e reja të paraqitura pas asaj date nuk merren parasysh, përveç kur pranohet në shkaqet që ka ndryshuar objekti i procedimit.

2. Nëse kërkuesi ose pronari i patentës është njoftuar për shkaqet që cenojnë dhënien ose mbajtjen e patentës, ai mund të ftohet të paraqesë në datën e përcaktuar në paragrafin 1, fjalë e dytë, dokumentet që përmbushin kërkesat e Konventës. Paragrafi 1, fjalë e tretë dhe e katërt, zbatohet mutatis mutandis.

Rregulli 117 N. 117, 131; R. 120

Vendimi për marrjen e provave

Nëse Zyra e Patentave Europiane e konsideron të nevojshme për të dëgjuar një palë, dëshmitar ose ekspert, apo të kryejë një inspektim ajo për këtë qëllim merr vendim, duke përcaktuar hetimin që synon të bëjë, faktet përkatës që duhet të provohen dhe datën orën dhe vendin e hetimit. Nëse dëgjimi i një dëshmitari ose eksperti kërkohet nga një palë, vendimi përcakton periudhën brenda së cilës kërkuesi duhet të bëjë të ditur emrin dhe adresën e çdo dëshmitari ose eksperti përkatës.

¹ Shih vendimin/mendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 6/95, G 4/92 (Aneksi I).

² Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 6/95, G (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 118 N. 117, 131; R. 120

Ftesa për dëshmimin e provave para Zyrës së Patentave Europiane

1. Një ftesë për të dhënë prova para Zyrës së Patentave Europiane u jepet palëve, dëshmitarëve ose ekspertëve përkatës.

2. Për ftesën që i jepet një palë, dëshmitari ose eksperti për të dëshmuar jepet të paktën një afat prej dy muajsh, nëse ato nuk bien dakord për një periudhë të shkurtër. Ftesa përmban:

a) një pjesë nga vendimi sipas Rregullit 117, që tregon datën, orën dhe vendin e hetimit të urdhëruar duke treguar faktet në lidhje me të cilat duhet të dëgjohen palët, dëshmitarët ose ekspertët;

b) emrat e palëve dhe tiparet e veçanta të të drejtave të cilat mund të kundrejtojnë dëshmitarët ose ekspertët sipas Rregullit 122, paragrafët 2 deri 4;

c) një tregues që pala, dëshmitari ose eksperti mund të kërkojë të dëgjohet nga një gjykatë kompetente në vendin e tij të vendbanimit sipas Rregullit 120, dhe një ftesë për të informuar Zyrën e Patentave Europiane, brenda një periudhe që duhet të përcaktohet, nëse ai është i përgatitur të paraqitet para saj.

Rregulli 119 N. 117, 131; R. 4, 117-124, 150

Shqyrtimi i provave para Zyrës së Patentave Europiane

1. Sektori i Ekzaminimit, Sektori i Kundërshtimit ose Bordi i Apelit mund të autorizojnë një prej anëtarëve të tyre për të shqyrtuar provat e mbledhura.

2. Para se të dëgjohet një palë, dëshmitar ose ekspert, ai informohet që Zyra e Patentave Europiane mund t'i kërkojë gjykatës kompetente në vendin e vendbanimit të personit përkatës të ri-shqyrtojë dëshminë e tij nën betim ose në një formë detyruese në masë të njëjtë.

3. Palët mund të ndjekin një hetim dhe mund të bëjnë pyetjet përkatëse palës, dëshmitarit ose ekspertit që dëshmon.

Rregulli 120 N. 117; R. 4, 117-124

Dëgjimi nga një gjykatë kombëtare kompetente

1. Një palë, dëshmitar ose ekspert që ftohet para Zyrës së Patentave Europiane mund t'i kërkojë kësaj të fundit ta lejojë atë të dëgjohet para një gjykate kompetente në vendin e tij të vendbanimit. Nëse kjo kërkohet, ose nëse nuk merret asnjë përgjigje brenda periudhës së përcaktuar në ftesë, Zyra e Patentave Europiane, në pajtim me Nenin 131, paragrafi 2, mund t'i kërkojë gjykatës kompetente të dëgjojë personin përkatës.

2. Nëse një palë, dëshmitar ose ekspert është dëgjuar nga Zyra e Patentave Europiane, kjo e fundit, nëse e konsideron të arsyeshme që dëshmia të jepet nën betim ose në një formë njëlojtë detyruese, mund të lëshojë një kërkesë sipas Nenit 131, paragrafi 2, për gjykatën kompetente në vendin e vendbanimit të personit përkatës për të ri-shqyrtuar dëshminë e tij në këto kushte.

3. Nëse një Zyrë e Patentave Europiane i kërkon një gjykate kompetente për të marrë prova, ajo mund të kërkojë që gjykata t'i marrë provat nën betim ose në një formë njëlojtë detyruese dhe të lejojë një anëtar të departamentit përkatës të jetë i pranishëm në seancë dhe t'i bëjë pyetje palës, dëshmitarit ose ekspertit, nëpërmjet një ndërmjetësi të gjykatës ose drejtpërdrejt.

Rregulli 121 N. 117; R. 120

Autorizimi i ekspertëve

1. Zyra e Patentave Europiane vendos në cilën formë do të paraqitet mendimi i një eksperti që ajo cakton.

2. Termat e referencës së ekspertit përfshijnë:

a) një përshkrim të saktë të detyrës së tij;

b) periudhën e specifikuar për paraqitjen e mendimit të tij;

c) emrat e palëve në procedim;

d) tiparet e veçanta të të drejtave që ai mund të kundrejtojë sipas Rregullit 122, paragrafët 2 deri 4.

3. Një kopje e çdo mendimi me shkrim u paraqitet palëve.

4. Palët mund të përjashtojnë ekspertin, Departamenti përkatës i Zyrës së Patentave Europiane vendos mbi përjashtimin.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 122 N. 33, 117; R. 117-121 Shpenzimet e marrjes së provave

1. Marrja e provave nga Zyra e Patentave Europiane mund të kushtëzohet me depozitimin tek ajo nga pala që kërkon marrjen e provave të një shume që caktohet nëpërmjet referimit të një vlerësimi të shpenzimeve.
2. Dëshmitarët ose ekspertët që ftohen dhe paraqiten para Zyrës së Patentave Europiane kanë të drejtën e kthimit të përshtatshëm të shpenzimeve për udhëtimin dhe qëndrimin. Atyre mund t'u jepet një parapagim i këtyre shpenzimeve. Kjo zbatohet edhe për personat që paraqiten para Zyrës së Patentave Europiane pa u ftuar prej saj dhe dëgjohen si dëshmitarë ose ekspertë.
3. Dëshmitarët dhe ekspertët që kanë të drejtën e rimbursimit sipas paragrafit 2 kanë gjithashtu të drejtë për kompensim të përshtatshëm për fitimin e munguar dhe ekspertët për honorarin për punën e tyre. Këto pagesa u bëhen dëshmitarëve dhe ekspertëve pasi ata të kenë përbushur detyrimet dhe detyrat e tyre.
4. ¹ Këshilli Administrativ përcakton hollësitë për zbatimin e paragrafëve 2 dhe 3. Çdo shumë e kërkueshme sipas këtyre dispozitave paguhet nga Zyra e Patentave Europiane.

Rregulli 123 N. 117, 120 Ruajtja e provave

1. Me kërkesë, Zyra e Patentave Europiane, pa vonesë, mund të marrë masa për të ruajtur provat e fakteve që mund të ndikojnë në një vendim që mund të kërkohej të merret në lidhje me një kërkesë për një patentë europiane ose një patentë europiane, nëse ka arsye për të dyshuar që më vonë mund të bëhet e vështirë ose e pamundur të merren prova. Data në të cilën janë marrë masat i komunikohen kërkuessit ose pronarit të patentës në kohë të mjaftueshme për t'i mundësuar atij pjesëmarrjen. Ai mund të bëjë pyetjet përkatëse.
2. Kërkesa përmban:
 - a) tiparet e veçanta të kërkuessit të parashikuara në Rregullin 41, paragrafi 2(c);
 - b) identifikimin e mjaftueshëm të kërkesës për patentë europiane ose një patentë europiane në fjalë;
 - c) një tregues të fakteve në lidhje me të cilat do të merren provat;
 - d) tiparet e veçanta të mjeteve për dhënien dhe marrjen e provave;
 - e) një deklaram që jep një prezantim me shikim të parë të dyshimit që më vonë mund të bëhet më e vështirë ose e pamundur për të marrë provat.
3. Kërkesa nuk konsiderohet e depozituar deri në momentin e pagesës së tarifës së parashikuar.
4. Vendimi mbi kërkesën dhe çdo marrje e provave që pason i takon departamentit të Zyrës së Patentave Europiane që do të duhej të merrte vendimin që mund të ndikohet nga faktet që duhet të vërtetohen. Zbatohen dispozitat në lidhje me marrjen e provave në procedimin para Zyrës së Patentave Europiane.

Rregulli 124 N. 116, 117 Procesverbali i procedimit gojor dhe marrjes së provave

1. Procesverbali i procedimit gojor dhe marrja e provave përpilohet duke përmbledhur pikat kryesore të procedimeve gojore ose të marrjes së provave, deklaratimet përkatëse të bëra nga palët, dëshmitë e palëve, dëshmitarëve ose ekspertëve dhe rezultatin e çdo inspektimi.
2. Procesverbali i dëshmisë së një dëshmitari, eksperti ose pale lexohet me zë të lartë, i paraqitet atij, në mënyrë që ai ta shqyrtojë atë ose, nëse ato janë regjistruar me mjete teknike, i prezantohen atij, përveç kur ai heq dorë nga kjo e drejtë. Shënohet në procesverbal që ky formalitet është kryer dhe që personi që ka dhënë dëshminë e aprovon procesverbalin. Nëse aprovimi nuk jepet, shënohen kundërshtimet e tij. Nuk është e nevojshme të riprezantohet procesverbali për të marrë aprovimin për to nëse dëshmia është regjistruar saktësisht duke përdorur drejtpërdrejt mjetet teknike.
3. Procesverbali nënshkruhet nga punonjësi përgjegjës për përpilimin e tyre dhe nga punonjësi që ka drejtuar procedimin gojor ose të marrjes së provës.
4. Palëve u jepet një kopje e procesverbalit.

¹ Shih Rregulloren e Këshillit Administrativ të datës 21.10.1977 mbi kompensimin e tarifave që u paguhen dëshmitarëve dhe ekspertëve (GZ EPO 1983, 102).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KAPITULLI IV NJOFTIMET

Rregulli 125 Art.119

Dispozita të përgjithshme

1. Në procedimin para Zyrës së Patentave Europiane, çdo njoftim duhet të bëhet duke marrë formën e dokumentit origjinal, një kopje e vërtetuar e të cilit ose që ka vulën e Zyrës së Patentave Europiane ose një printim nga kompjuteri që ka një vulë të tillë. Për kopjet e dokumenteve që dalin nga vetë palët nuk kërkohet një vërtetim i tillë.

2. Njoftimi bëhet:

- a) me postë në pajtim me Rregullin 126;
- b) me mjete teknike të komunikimit në pajtim me Rregullin 127;
- c) nëpërmjet dorëzimit në ambientet e Zyrës së Patentave Europiane në pajtim me Rregullin 128; ose
- d) me njoftim publik në pajtim me Rregullin 129.

3. Njoftimi nëpërmjet zyrës qendrore të pronësisë industriale të një Shteti Kontraktues bëhet në pajtim me ligjet e zbatueshme për atë zyrën në procedimet kombëtare.

4. Nëse një dokument ka mbërritur tek i adresuari, kur Zyra e Patentave Europiane nuk është në gjendje të provojë që është njoftuar rregullisht, ose kur dispozitat në lidhje me njoftimin e saj nuk janë respektuar, dokumenti konsiderohet të jetë njoftuar në datën e provuar nga Zyra e Patentave Europiane si data e marrjes.

Rregulli 126 N. 119

Njoftimi me postë

1. Vendimet që kanë një periudhë ankimi ose kërkesë për rishikim, ftesat dhe dokumentet e tjera që përcaktohen nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane njoftohen me letër të porositur me udhëzimin për dorëzim. Të gjitha njoftimet e tjera me postë kryhen me letër të regjistruar.

2. Nëse njoftimi kryhet me letër të regjistruar, me këshillim për dorëzim ose jo, kjo letër konsiderohet të dorëzohet tek i adresuari në ditën e dhjetë pas dërgimit me postë, përveç kur ai nuk ka arritur marrësin ose e ka arritur atë në një datë të mëvonshme. Në rastin e një mosmarrëveshjeje, i takon Zyrës së Patentave Europiane për të vërtetuar që ketra ka arritur në destinacion ose të vërtetojë datën në të cilën letra i është dorëzuar marrësit, sipas rastit.

3. Njoftimi me letër të regjistruar, me udhëzim ose jo, konsiderohet të jetë kryer edhe nëse refuzohet marrja e letres.

4. Në masën që njoftimi me postë nuk mbulohet në paragrafët 1 deri 3, zbatohet ligji i Shtetit në të cilin bëhet njoftimi.

Rregulli 127 N. 119

Njoftimi me mjete teknike të komunikimit

Njoftimi mund të kryhet me ato mjete teknike të komunikimit që përcaktohen nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane dhe në kushtet e përcaktuara prej tij.

Rregulli 128 N. 119

Njoftimi nëpërmjet dorëzimit dorazi

Njoftimi mund të kryhet në ambientet e Zyrës së Patentave Europiane me dorëzim dorazi të dokumentit tek marrësi, që konfirmon marrjen në momentin e dorëzimit. Njoftimi konsiderohet të jetë kryer edhe nëse marrësi refuzon marrjen e dokumentit ose të konfirmojë marrjen e tij.

Rregulli 129 N. 119

Njoftimi publik

1. Nëse adresa e marrësit nuk mund të gjendet, ose nëse njoftimi në pajtim me Rregullin 126, paragrafi 1, del i pamundur edhe pas një përpjekjeje të dytë, njoftimi bëhet me njoftim publik.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2.¹ Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane përcakton se si duhet të bëhet njoftimi publik në fillim të periudhës një-mujore, me skadimin e së cilës dokumenti konsiderohet t jetë njoftuar.

Rregulli 130 N. 119, 133 Njoftimi i përfaqësuesve

1. Nëse është caktuar një përfaqësues, njoftimet i drejtohen atij.
2. Nëse për një palë janë caktuar disa përfaqësues, njoftimi i një prej tyre është i mjaftueshëm.
3. Nëse disa palë kanë një përfaqësues të përbashkët, njoftimi për përfaqësuesin e përbashkët është i mjaftueshëm.

KAPITULLI V AFATET KOHORE

Rregulli 131 N. 120 Llogaritja e afateve

1. Afatet përcaktohen në kuptimin e viteve, muajve, javëve ose ditëve të plota.
2. Llogaritja fillon në ditën pas ditës në të cilën ka ndodhur ngjarja përkatëse, ku ngjarja është një akt procedural ose skadimi i një afati tjetër. Nëse akti procedural është një njoftim, ngjarja përkatëse është marrja e dokumentit të njoftuar, nëse nuk parashikohet ndryshe.
3. Nëse një afat shprehet si një vit ose një numër i caktuar vitesh, ai skadon në vitin përkatës pasues në muajin që ka të njëjtin emër dhe në ditën që ka të njëjtin numër si muaji dhe dita në të cilën ka ndodhur ngjarja përkatëse; nëse muaji përkatës pasues nuk ka ditë me të njëjtin numër, afati skadon në ditën e fundit të atij muaji.
4. Nëse afati shprehet si një muaj ose një numër i caktuar muajsh, ai skadon në muajin përkatës pasues në ditën që ka të njëjtin numër si dita kur ka ndodhur ngjarja; nëse muaji përkatës pasues nuk ka një ditë me të njëjtin numër, afati skadon në ditën e fundit të atij viti.
5. Nëse afati është i shprehur si një javë ose një numër i caktuar javësh, ai skadon në javën përkatëse pasuese në ditën që ka të njëjtin emër si dita në të cilën ka ndodhur ngjarja përkatëse.

Rregulli 132 N. 120; R. 109, 116 Afatet e përcaktuara nga Zyra e Patentave Europiane

1. Nëse Konventa ose këto Rregullore Zbatuese i referohen “një afati që duhet të përcaktohet”, ky afat përcaktohet nga Zyra e Patentave Europiane.
2. Nëse nuk parashikohet ndryshe, afati i përcaktuar nga Zyra e Patentave Europiane nuk është më pak se dy muaj dhe as më shumë se katër muaj; në rrethana të caktuara, ai mund të jetë deri në gjashtë muaj. Në raste te veçanta, afati mund të zgjatet me kërkesë, të paraqitur para skadimit të këtij afati.

Rregulli 133² N. 120; R. 2 Mbërritja e vonuar e dokumenteve

1. Një dokument që arrin vonë në Zyrën e Patentave Europiane konsiderohet të jetë marrë në kohën e duhur nëse ai është postuar, ose dorëzuar tek një shërbim i njohur dorëzimi, në kohën e duhur para skadimit e afatit në pajtim me kushtet e përcaktuara nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane, përveç kur dokumenti është marrë më vonë se tre muaj pas skadimit të afatit.
2. Paragrafi 1 zbatohet mutatis mutandis për çdo periudhë nëse transaksionet kryhen me autoritetin kompetent në pajtim me Nenin 75, paragrafët 1(b) ose 2(b).

¹ Shih Vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, K 1.

² Shih Vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, I 1.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 134 N. 77, 120

Zgjatja e afateve

1. Nëse një afat skadon në ditën në të cilën një nga zyrat e depozitimit të Zyrës së Patentave Europiane sipas Rregullit 35, paragrafi 1, nuk është e hapur për marrjen e dokumenteve ose në të cilën, për arsye të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin 2, nuk dorëzohet postë, afati zgjatet deri në ditën e parë pas kësaj kur zyrat e depozitimit janë hapur për marrjen e dokumenteve dhe në të cilën posta dorëzohet. Fjalja e parë zbatohet mutatis mutandis nëse dokumentet e depozituar nga një prej mjeteve teknike të komunikimit të lejuara nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane sipas Rregullit 2, paragrafi 1, nuk mund të merret.

2. Nëse një afat skadon në një ditë në të cilën ka një ndërprerje të përgjithshme në dorëzimin ose transmetimin e postës në një Shtet Kontraktues, afati zgjatet deri në ditën e parë pas fundit të intervalit të ndërprerjes për palët që janë me banim në Shtetin përkatës ose që kanë caktuar një përfaqësues me seli biznesi në atë Shtet. Nëse Shteti i interesuar është Shteti në të cilin ndodhet Zyra e Patentave Europiane, kjo dispozitë zbatohet për të gjitha palët dhe përfaqësuesit e tyre. Ky paragraf zbatohet mutatis mutandis për afatin e përmendur në Rregullin 37, paragrafi 2.

3. Paragrafët 1 dhe 2 zbatohen mutatis mutandis nëse veprimet kryhen me autoritetin kompetent në pajtim me Nenin 75, paragrafët 1(b) ose 2(b).

4. Data e fillimit dhe fundi i çdo ndërprerjeje sipas paragrafit 2 publikohet në Zyrën e Patentave Europiane.

5. Pa cenuar paragrafët 1 deri 4, çdo palë e interesuar mund të paraqesë prova që në një nga dhjetë ditët para ditës së skadimit të një afati dorëzimi ose transmetimi i postës është ndërprerë për shkak të një ndodhje të veçantë si një fatkeqësi natyrore, lufte, trazire civile, një defekt i përgjithshëm i mjeteve teknike të komunikimit të lejuar nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane sipas Rregullit 2, paragrafi 1, ose arsye të tjera që prekin lokalitetin ku pala ose përfaqësuesi i saj ligjor banon ose ka selinë e biznesit. Nëse provat e paraqitura bindin Zyrën e Patentave Europiane, një dokument i marrë më vonë do të konsiderohet të jetë marrë në kohën e duhur, me kusht që dërgimi me postë ose transmetimi të jetë kryer jo më vonë se dita e pestë pas përfundimit të ndërprerjes.

Rregulli 135 N. 120; R. 112

Trajtimi i mëtejshëm

1. Trajtimi i mëtejshëm sipas Nenit 121, paragrafi 1, kërkohet me pagesën e tarifës së parashikuar brenda dy muajve nga komunikimi në lidhje me mosrespektimin e një afati ose humbjen e të drejtave. Veprimi i pakryer kryhet brenda afatit të bërjes së kërkesës.

2. Trajtimi i mëtejshëm vendoset në lidhje me afatet e përmendura në Nenin 121, paragrafi 4, dhe afatet sipas Rregullit 6, paragrafi 1, Rregulli 16, paragrafi 1(a), Rregulli 31, paragrafi 2, Rregulli 40, paragrafi 3, Rregulli 51, paragrafët 2 to 5, Rregulli 52, paragrafët 2 dhe 3, Rregullat 55, 56, 58, 59, 64 dhe Rregulli 112, paragrafi 2.

3. Sektori kompetent për të vendosur mbi veprimin e pakryer vendos për kërkesën për trajtim të mëtejshëm.

Rregulli 136 N. 120; R. 112, 143

Rivendosja e të drejtave

1. Çdo kërkesë për rivendosjen në afat sipas Nenit 122, paragrafi 1, depozitohet me shkrim brenda dy muajve nga mënjanimi i shkakut të mosrespektimit të afatit, por jo më vonë se një vit nga skadimi i afatit të parespektuar. Megjithatë, një kërkesë për ri-vendosjen në afat në lidhje me një nga afatet e përcaktuara në Nenin 87, paragrafi 1, dhe në Nenin 112a, paragrafi 4, depozitohet brenda dy muajve nga skadimi i atij afati. Kërkesa për rivendosjen e të drejtave nuk konsiderohet të jetë bërë deri në momentin pagesës së tarifës së parashikuar.

2. Kërkesa tregon shkaqet në të cilat ajo bazohet dhe përmban faktet në të cilat ajo mbështetet. Vendimi i pakryer përmbushet brenda afatit përkatës për depozitimin e kërkesës sipas paragrafit 1.

3. Ri-vendosja e të drejtave përjashtohet në lidhje me çdo afat për të cilin po kryhet trajtim i mëtejshëm sipas Nenit 121 dhe në lidhje me afatin për kërkimin e rivendosjes së të drejtave.

4. Departamenti kompetent për të vendosur mbi veprimin e pakryer vendos për kërkesën për rivendosjen e të drejtave.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KAPITULLI VI NDRYSHIMET DHE KORRIGJIMET

Rregulli 137¹ N. 90, 92, 94, 123; R. 57, 58, 65, 68, 70, 71, 80, 161

Ndryshimi i kërkesës për patentë europiane

1. Para marrjes së raportit të kërimit europian, kërkuesi nuk mund të ndryshojë përshkrimin, pretendimet ose skicimet e një kërkesë për patentë europiane, përveç kur parashikohet ndryshe.

2. Pas marrjes së raportit të kërimit europian, kërkuesi, me iniciativën e tij, ndryshon përshkrimin, pretendimet dhe skicimet.

3. Pas marrjes së komunikimit të parë nga Sektori i Ekzaminimit, kërkuesi, me vullnetin e tij, mund ta ndryshojë përshkrimin, pretendimet dhe skicimet, me kusht që ndryshimi të depozitohet në të njëjtën kohë si kërkesa ndaj komunikimit. Asnjë ndryshim i mëtejshëm nuk mund të bëhet pa pëlqimin e Sektorit të Ekzaminimit.

4. Pretendimet e ndryshuara nuk mund t'i referohen objektit të pakërkuar që nuk kombinohet me shpikjen e pretenduar fillimisht ose grupin e shpikjeve për të formuar një koncept të përgjithshëm shpikës.

Rregulli 138² N. 54, 94, 98, 101, 105a/bis, 105b/ter, 118, 123; R. 18, 78, 80

Pretendime, përshkrim dhe skicime të ndryshme për Shtete të ndryshme

Nëse Zyra e Patentave Europiane njoftohet për ekzistencën e një të drejte të mëparshme sipas Nenit 139, paragrafi 2, kërkesa për patentë europiane ose patenta europiane, për këtë Shtet ose Shtete, mund të përmbajë pretendime dhe, sipas rastit, një përshkrim ose skicime që janë të ndryshëm nga ato të Shteteve të tjerë të përcaktuar.

Rregulli 139³ N. 78, 90; R. 71

Korrigjimi i gabimeve në dokumentet e depozituara në Zyrën e Patentave Europiane

Gabimet gjuhësore, gabimet drejtshkrimore ose gabimet në çdo dokument të depozituar tek Zyra e Patentave Europiane mund të korrigjohet me kërkesë. Megjithatë, nëse kërkesa për një korrigjim të tillë ka të bëjë me përshkrimin, pretendimet ose skicimet, korrigjimi duhet të jetë i dukshëm në kuptimin që ai të jetë shumë i qartë në mënyrë që të mos jetë synuar gjë tjetër përveç asaj që ofrohet si korrigjim.

Rregulli 140⁴ N. 90, 97, 101, 104, 105b/ter, 111, 112, 112a/bis

Korrigjimi i gabimeve në vendime

Në vendimet e Zyrës së Patentave Europiane mund të korrigjohen vetëm gabimet gjuhësore, gabimet drejtshkrimore dhe gabimet e dukshme.

KAPITULLI VII INFORMACION MBI GJENDJEN EKZISTUESE TEKNIKE

Rregulli 141 N. 124, 140; R. 112, 113

Informacion mbi mbi arritjet e mëparshme

Zyra e Patentave Europiane mund të ftojë kërkuetin të japë, brenda një afati që duhet të përcaktohet, informacion mbi arritjet e mëparshme të marrë parasysh në shqyrtimin e kërkesave për patenta kombëtare dhe rajonale dhe në lidhje me një shpikje me të cilën ka të bëjë kërkesa për patentë europiane.

¹ Shih mendimin/vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/89, G 11/91 (Aneksi I).

² Shih mendimin/vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 1/99 (Aneksi I).

³ Shih mendimin/vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/89, G 11/91, G 2/95 (Aneksi I).

⁴ Shih mendimin/vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 8/95 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KAPITULLI VIII NDËRPRERJA E PROCEDIMIT

Rregulli 142¹ N. 86, 90, 94, 99, 106, 133, 134; R. 112, 143

Ndërprerja e procedimit

1. Procedimi para Zyrës së Patentave Europiane ndërpritet:
 - a) në rastin e vdekjes ose pazotësisë ligjore e kërkuarit ose pronarit të një patente europiane ose e personit të autorizuar nga ligji i kombëtar për të vepruar në emër të tij. Në masën që ngjarjet e mësipërme nuk ndikojnë në autorizimin e një përfaqësuesi të caktuar sipas Nenit 134, procedimi ndërpritet vetëm me kërkesë të këtij përfaqësuesi;
 - b) në rastin kur kërkuari ose pronari i patentës, si rezultat i një veprimi të ndërmarrë ndaj pronës së tij, pengohet nga shkaqe ligjore në vazhdimin e procedimit;
 - c) në rastin e vdekjes ose pazotësisë ligjore të përfaqësuesit të një kërkuari ose pronarit të patentës, ose të pengimit të tij për shkaqe ligjore që rrjedhin nga veprimi ndaj pasurisë së tij në vazhdimin e procedimit.
- 2) Nëse në rastet e përmendura në paragrafin 1(a) ose (b), Zyra e Patentave Europiane është informuar për identitetin e personit të autorizuar për të vazhduar procedimin, ajo njofton këtë person dhe, sipas rastit, çdo palë të tretë, që procedimi do të vazhdojë në një datë të specifikuar.
3. Në rastin e përmendur në paragrafin 1(c), procedimi vazhdon nëse Zyra e Patentave Europiane është njoftuar për caktimin e një përfaqësuesi të ri të kërkuarit ose nëse Zyra ka njoftuar palët e tjera për emërimin e një përfaqësuesi të ri të pronarit të patentës. Nëse tre muaj pas fillimit të ndërprerjes së procedimit, Zyra e Patentave Europiane nuk është njoftuar në lidhje me emërimin e një përfaqësuesi të ri, ajo i komunikon kërkuarit ose pronarit të patentës:
 - a) nëse zbatohet Neni 133, paragrafi 2, që kërkesa për patentë europiane do të konsiderohet e tërhequr ose patenta do të revokohet nëse informacioni nuk paraqitet brenda dy muajve nga ky komunikim; ose
 - b) përndryshe, që procedimi do të ri-fillojë me kërkuarin ose pronarin e patentës që nga njoftimi i këtij komunikimi.
4. Çdo periudhë, e ndryshme nga ato që kërkojnë shqyrtimin dhe pagesën e tarifave të mbajtjes në fuqi, që është në fuqi në datën e ndërprerjes së procedimit, fillon përsëri që nga dita në të cilën rifillon procedimi. Nëse kjo datë është më parë se dy muaj nga fundi i afatit brenda të cilit duhet të depozitohet kërkesa për shqyrtim, kjo kërkesë mund të depozitohet brenda dy muajve nga kjo datë.

KAPITULLI IX INFORMACIONI PËR PUBLIKUN

Rregulli 143 N. 127, 129

Hyrjet në Regjistrin e Patentave Europiane

1. Regjistri i Patentave Europiane përmban hyrjet e mëposhtme:
 - a) numrin e kërkesës për patentë europiane;
 - b) datën e depozitimit të kërkesës;
 - c) titullin e shpikjes;
 - d) simbolet e klasifikimit të kërkesës;
 - e) Shtetet Kontraktues të përcaktuar;
 - f) tiparet e veçanta të kërkuarit ose pronarit të patentës sipas parashikimit në Rregullin 41, paragrafi 2(c);
 - g) mbiemrin, emrat e vënë dhe adresën e shpikësit të përcaktuar nga kërkuari ose pronari i patentës, përveç kur ai heq dorë nga e drejta për t'u përmendur në Rregullin 20, paragrafi 1;
 - h) tiparet e veçanta të përfaqësuesit të kërkuarit ose pronarit të patentës sipas parashikimit në Rregullin 41, paragrafi 2(d); në rastin e disa përfaqësuesve vetëm tiparet e veçanta të përfaqësuesit që përmendet i pari, e pasuar nga fjalët "dhe të tjerë" dhe, në rastin e një shoqate të përmendur në Rregullin 152, paragrafi 11, vetëm emrin dhe adresën e shoqatës;
 - i) të dhënat prioritare (datën, Shtetin dhe numrin e dosjes së kërkesës së mëparshme);

¹ Shih Vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, G 1.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- j) në rastin e një ndarjeje të kërkesës, numrat e të gjitha kërkesave të ndara;
 - k) në rastin e një kërkesë të ndarë ose të një kërkesë të re sipas Nenit 61, paragrafi 1(b), informacioni i përmendur në nën-paragrafin (a), (b) dhe (i) në lidhje me kërkesën e mëparshme;
 - l) datën e publikimit të kërkesës dhe, sipas rastit, datën e publikimit të veçantë të raportit të kërimit europian;
 - m) datën e depozitimit të kërkesës për shqyrtim;
 - n) datën në të cilën kërkesa është rrëzuar, tërhequr ose konsideruar e tërhequr;
 - o) datën e publikimit të përmendjes së dhënies së patentës europiane;
 - p) datën e skadimit të patentës europiane në një Shtet Kontraktues gjatë periudhës së apelimit dhe, sipas rastit, në pritje të një vendimi përfundimtar mbi kundërshtimin;
 - q) datën e depozitimit të kundërshtimit;
 - r) datën dhe qëllimin e vendimit të kundërshtimit;
 - s) datat e pezullimit dhe ri-fillimit të procedimit në rastet e përmendur në Rregullat 14 dhe 78;
 - t) datat e ndërprerjes dhe rifillimit të procedimit në rastin e përmendur në Rregullin 142;
 - u) datën e rivendosjes së të drejtave, nëse është bërë një hyrje sipas nënparagrafëve (n) ose (r);
 - v) depozitimin e një kërkesë për konvertim sipas Nenit 135, paragrafi 3;
 - ë) të drejtat dhe transferimi i këtyre të drejtave në lidhje me një kërkesë ose një patentë europiane nëse këto Rregullore zbatuese parashikojnë që duhet të regjistrohen;
 - x) datën dhe qëllimin e vendimit mbi kërkesën për kufizimin ose revokimin e patentës europiane;
 - y) datën dhe qëllimin e vendimit të Bordit të Zgjeruar të Apelit mbi kërkesën për rishikim;
- 2.¹ Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane mund të vendosë që hyrjet e ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin 1 të bëhen në Regjistrin e Patentave Europiane.

Rregulli 144² N. 24, 81; R. 146

Pjesë të dosjes të përjashtuara nga inspektimi

- Pjesët e dosjes të përjashtuara nga inspektimi sipas Nenit 128, paragrafi 4, janë:
- a) dokumente në lidhje me përjashtimin ose kundërshtimet për anëtarët e Bordeve të Apelit ose të Bordit të zgjeruar të Apelit;
 - b) projekt vendimet dhe njoftimet, dhe të gjitha dokumentet e tjera, që përdoren për përgatitjen e vendimeve dhe njoftimeve që nuk u janë komunikuar palëve;
 - c) përcaktimin e shpikësit, nëse ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u përmendur sipas Rregullit 20, paragrafi 1;
 - d) çdo dokument tjetër të përjashtuar nga inspektimi nga Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane me shkakun që një inspektim i tillë nuk do t'i shërbente qëllimit të informimit të publikut në lidhje me kërkesën për patentë europiane ose patentën europiane.

Rregulli 145³ N. 128; R. 149

Procedurat për inspektimin e dosjeve

1. Inspektimi i dosjeve të kërkesave për patentë dhe patentave europiane bëhet tek dokumentet origjinale ose kopje të tyre, ose tek mjetet teknike të ruajtjes, nëse dosjet janë ruajtur në këtë mënyrë.
2. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane përcakton të gjitha masat për inspektimin e dosjeve, duke përfshirë rrethanat në të cilën paguhet një tarifë administrative.

Rregulli 146

Komunikimi i informacionit që gjendet në dosje

Në pajtim me kufizimet e parashikuara në Nenin 128, paragrafët 1 deri 4, dhe në Rregullin 144, Zyra e Patentave Europiane, me kërkesë, mund të komunikojë informacionin në lidhje me çdo dosje për një kërkesë

¹ Shih Vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, E 1.

² Shih Vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, J. 3.

³ Shih Vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, J. 2.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

për patentë europiane ose patentë europiane, kundrejt pagesës së një tarife administrative. Megjithatë, Zyra e Patentave Europiane mund t'i referohet opsionit të inspektimit të dosjes nëse ajo mendon që kjo është e përshtatshme duke patur parasysh sasinë e informacionit që duhet të jepet.

Rregulli 147¹ N. 128

Krijimi, mirëmbajtja dhe ruajtja e dosjeve

1. Zyra e Patentave Europiane krijon, mban dhe ruan dosje në lidhje me të gjitha kërkesat për patenta dhe patentat europiane.

2. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane përcakton formën në të cilën këto dosje krijohen, mbahen dhe ruhen.

3. Dokumentet e përfshira në një dosje elektronike konsiderohet të jenë origjinale.

4. Të gjitha dosjet ruhen të paktën për pesë vjet nga fundi i vitit në të cilin:

a) është rrëzuar, tërhequr apo konsideruar e tërhequr kërkesa;

b) patenta është revokuar nga Zyra e Patentave Europiane; ose

c) patenta ose mbrojtja përkatëse sipas Nenit 63, paragrafi 2, skadon në Shtetin e fundit të përcaktuar.

5. Pa cenuar paragrafin 4, dosjet në lidhje me kërkesat që kanë shkaktuar kërkesa të ndara sipas nenit 76 ose kërkesa të reja sipas Nenit 61, paragrafi 1(b), ruhen për të paktën të njëjtën periudhë si dosjet në lidhje me një nga këto kërkesa të fundit. E njëjta zbatohet për dosjet në lidhje me një prej patentave europiane rezultuese.

KAPITULLI X

BASHKËPUNIMI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

Rregulli 148 N. 130, 131

Komunikimi ndërmjet Zyrës së Patentave Europiane dhe autoriteteve të Shteteve Kontraktuese

1. Komunikimet ndërmjet Zyrës së Patentave Europiane dhe zyrave qendrore të pronësisë industriale të Shteteve Kontraktuese që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Konvente kryhen drejtpërdrejt ndërmjet këtyre autoriteteve. Komunikimet ndërmjet zyrës së Patentave Europiane dhe gjykatave ose autoriteteve të tjera të Shteteve Kontraktuese mund të kryhen nëpërmjet ndërmjetësit të këtyre zyrave qendrore të pronësisë industriale.

2. Shpenzimet në lidhje me komunikimet sipas paragrafit 1 përballohen nga autoriteti që bën komunikimet, i cili përjashtohet nga tarifat.

Rregulli 149 N. 131

Inspektimi i dosjeve nga ose nëpërmjet gjykatave apo autoriteteve të Shteteve Kontraktuese

1. Inspektimi i dosjeve të kërkesave për patenta europiane ose të patentave europiane nga gjykatat ose autoritetet e Shteteve Kontraktuese bëhet në dokumentet origjinale ose kopjet e tyre; nuk zbatohet Rregulli 145.

2. Gjykatat ose zyrat e Prokurorëve Publikë të Shteteve Kontraktuese, në kuadrin e procedimeve të tyre, mund t'u komunikojnë palëve të treta dosjet ose kopje të tyre të transmetuara atyre nga Zyra e Patentave Europiane. Këto komunikime kryhen në pajtim me Nenin 128 dhe nuk i nënshtrohen asnjë tarife.

3. Zyra e Patentave Europiane, gjatë transmetimit të dosjeve, tërheq vëmendjen për kufizimet që, sipas Nenit 128, paragrafët 1 dhe 4, mund të zbatohen për inspektimin e dosjeve nga palët e treta.

Rregulli 150 N. 117, 131

Procedurat për letër porositë

1. Secili Shtet Kontraktues cakton një autoritet qendror për të marrë letërporositë të nxjerra nga zyra e Patentave Europiane dhe t'ia transmetojë ato gjykatës ose autoritetit kompetent për t'i ekzekutuar ato.

2. Zyra e Patentave Europiane përpilon letër porositë në gjuhën e gjykatës ose autoritetit kompetent ose i bashkëngjit kësaj letër porositë një përkthim në atë gjuhë.

¹ Shih Vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, J. 1.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Në pajtim me paragrafët 5 dhe 6, gjykata ose autoriteti kompetent zbaton ligjin e vendit në lidhje me procedurat që duhet të zbatohen për ekzekutimin e këtyre kërkesave dhe, veçanërisht, në lidhje masat e përshtatshme të detyrimit.

4. Nëse gjykata ose autoriteti të cilit i transmetohet letër porosia nuk është kompetent për ekzekutimin e tyre, letër porosia i dërgohet menjëherë autoritetit qendror të përmendur në paragrafin 1. Ky autoritet ia transmeton letërporosinë gjykatës ose autoriteti kompetent në atë Shtet ose Zyrës së Patentave Europiane nëse në atë Shtet nuk ka gjykatë ose autoritet kompetent.

5. Zyra e Patentave europiane informohet për kohën dhe vendin ku duhet të kryhet hetimi ose masa tjetër ligjore dhe informon palët, dëshmitarët dhe ekspertët e interesuar.

6. Nëse kjo kërkohet nga Zyra e Patentave Europiane, gjykata ose autoriteti kompetent lejon praninë e anëtarëve të departamentit të interesuar dhe i lejon ata të pyesin çdo person që jep prova drejtpërdrejt ose nëpërmjet gjykatës ose autoritetit kompetent.

7. Ekzekutimi i letërporosive nuk shkakton asnjë kthim të tarifave ose shpenzimeve të ndonjë natyre. Megjithatë, Shteti në të cilin ekzekutohen letërporositë ka të drejtën t'i kërkojë Organizatës të kthejë çdo tarifë që u paguhet ekspertëve ose përkthyesve dhe shpenzimet që rrjedhin nga procedura sipas paragrafit 6.

8. Nëse ligji i zbatuar nga gjykata ose autoriteti kompetent i detyron palët të sigurojnë provat dhe gjykata ose autoriteti kompetent nuk është vetë në gjendje të ekzekutojë letërporositë, kjo gjykatë ose autoritet, me pëlqimin e Zyrës së patentave Europiane, mund të emërojë një person të përshtatshëm për ta bërë këtë. Në kërkimin e këtij pëlqimi, gjykata ose autoriteti kompetent tregon shpenzimet e përafërta që mund të shkaktohen nga kjo procedurë. Nëse Zyra e Patentave Europiane e jep pëlqimin e saj, Organizata kthen çdo shpenzim të shkaktuar; përndryshe, Organizata nuk është përgjegjëse për këto shpenzime.

KAPITULLI XI PËRFAQËSIMI

Rregulli 151¹ N. 59, 133

Caktimi i një përfaqësuesi të përbashkët

1. Nëse ka më shumë se një kërkues dhe kërkesa për dhënien e një patente europiane nuk emërton një përfaqësues të përbashkët, kërkuesi i parë i përmendur në kërkesë konsiderohet të jetë përfaqësuesi i përbashkët. Megjithatë, nëse një nga kërkuesit është i detyruar të caktojë një përfaqësues profesionist, ky përfaqësues konsiderohet të jetë përfaqësuesi i përbashkët, përveç kur kërkuesi i emërtuar i pari ka caktuar një përfaqësues profesionist. E njëjta zbatohet për palët e treta që veprojnë bashkërisht në depozitimin e një njoftimi kundërshtimi ose ndërhyrjeje dhe për pronarët e përbashkët të një patente europiane.

2. Nëse kërkesa për patentë europiane u transferohet më shumë se një personave, dhe këta persona nuk kanë caktuar një përfaqësues të përbashkët, paragrafi 1 zbatohet mutatis mutandis. Nëse një kërkesë e tillë nuk është e mundur, zyra e Patentave Europiane i fton këta persona të caktojnë një përfaqësues të përbashkët brenda një afati që duhet të caktohet. Nëse kjo ftesë nuk respektohet, Zyra e Patentave Europiane cakton një përfaqësues të përbashkët.

Rregulli 152 N. 90, 133, 134

Autorizimi

1. ² Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane përcakton rastet në të cilat depozitohet një autorizim i nënshkruar nga përfaqësuesit që veprojnë para Zyrës së Patentave Europiane.

2. Nëse një përfaqësues nuk depoziton një autorizim të tillë, Zyra e Patentave Europiane e fton atë ta bëjë këtë brenda një afati që duhet të caktohet. Autorizimi mund të mbulojë një ose disa kërkesa për patentë europiane ose patenta europiane dhe depozitohet në numrin përkatës të kopjeve.

3. Nëse kërkesat e Nenit 133, paragrafi 2, nuk përmbushen, i njëjti afat përcaktohet për caktimin e një përfaqësuesi dhe depozitimin e autorizimit.

4. Një autorizim i përgjithshëm mund të depozitohet për t'i dhënë mundësi një përfaqësuesi të veprojë në

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 3/99 (Aneksi I).

² Shih Vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, L. 1.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

lidhje me të gjitha transaksionet për patentën e një palë. Një kopje e vetme është e mjaftueshme.

5. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane mund të përcaktojë formën dhe përmbajtjen e:

- a) një autorizimi në lidhje me përfaqësimin e personave sipas Nenit 133, paragrafi 2;
- b) një autorizimi të përgjithshëm.

6. Nëse një autorizim i kërkuar nuk depozitohet në kohën e duhur, çdo hap procedural i ndërmarrë nga përfaqësuesi, i ndryshëm nga depozitimi i një kërkesë për patentë europiane, konsiderohet të mos jetë ndërmarrë, pa cenuar asnjë pasojë tjetër ligjore të parashikuar nga kjo Konventë.

7. Paragrafët 2 dhe 4 zbatohen për tërheqjen e një autorizimi.

8. Një përfaqësues konsiderohet të jetë i autorizuar deri në momentin e komunikimit të shfuqizimit të këtij autorizimi Zyrës së Patentave Europiane.

9. Nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, një autorizim nuk shfuqizohet kundrejt Zyrës së Patentave Europiane me vdekjen e personit që e ka dhënë atë.

10. Nëse një palë cakton disa përfaqësues, ata mund të veprojnë bashkërisht ose veçmas, pavarësisht ndonjë dispozite të kundërt në komunikimin e aktimit të tyre ose në autorizim.

11. Autorizimi i një shoqate përfaqësimi konsiderohet të jetë një autorizim i çdo përfaqësuesi që mund të japë prova që ai vepron brenda asaj shoqate.

Rregulli 153 N. 133, 134, 134a/bis E drejta e përfaqësuesit profesionistë

1. Nëse kërkohet këshillim nga një përfaqësues profesionistë i miratuar në cilësinë e tij si i tillë, të gjitha komunikimet ndërmjet përfaqësuesit të miratuar dhe klientit të tij ose çdo personi tjetër në lidhje me këtë qëllim dhe që rregullohet nga Neni 2 i Rregullores për disiplinën për përfaqësuesit profesionistë të miratuar, të cilët kanë privilegjin e përhershëm të shfaqjes në procedimet para Zyrës së Patentave Europiane, përveç kur nga një privilegj i tillë hiqet dorë shprehimisht nga klienti.

2. Një privilegj i tillë i mosdeklarimit zbatohet, veçanërisht, për çdo komunikim ose dokument në lidhje me:

- a) vlerësimin e patentueshmërisë së një shpikjeje;
- b) përgatitjen ose ndjekjen penale ndaj një kërkesë për patentë europiane;
- c) çdo mendim në lidhje me vlefshmërinë, objektin e mbrojtjes ose shkeljen e një patente europiane ose një kërkesë për patentë europiane.

Rregulli 154

Ndryshimi i listës së përfaqësuesve profesionistë të miratuar

1. Hyrja e një përfaqësuesi të miratuar duhet të fshihet nga lista e përfaqësuesve të miratuar nëse ai e kërkon këtë ose nëse, pavarësisht kujtesave të përsëritura, ai nuk paguan kuotën vjetore tek Instituti para fundit të Shtatorit të vitit për të cilin kërkohet kuota.

2. Pa cenuar asnjë masë disiplinore të marra sipas Nenit 134a, paragrafi 1(c), hyrja e një përfaqësuesi të miratuar mund të fshihet kryesisht vetëm:

- a) në rastin e vdekjes ose pazotësisë së tij ligjore;
- b) nëse ai nuk vazhdon të jetë shtetas i një prej Shteteve Kontraktues, përveç kur atij i është bërë një përjashtim sipas Nenit 134, paragrafi 7(a);
- c) nëse ai nuk vazhdon të ketë vendin e tij të biznesit ose punësimit brenda një prej Shteteve Kontraktues.

3. Çdo person i future në listën e përfaqësuesve të miratuar sipas Nenit 134, paragrafët

(2) ose (3), hyrja e të cilëve është fshirë, me kërkesë, mund të ri-futen në këtë listë nëse nuk vazhdojnë të ekzistojnë kushtet për fshirjen e tyre.

PJESA VIII RREGULLORET ZBATUESE PËR PJESËN VIII TË KONVENTËS

Rregulli 155 N. 137, 140; R. 112, 156 Depozitimi dhe transmetimi i kërkesës për konvertim

1. Kërkesa për konvertim e përmendur në Nenin 135, paragrafi 1(a) ose (b), depozitohet brenda tre muajve nga tërheqja e kërkesës për patentë europiane ose nga komunikimi që kërkesa është konsideruar e tërhequr, ose

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

nga vendimi që rrëzon kërkesën ose revokon patentën europiane. Efekti i kërkesës për patentë europiane sipas Nenit 66 parashkruhet nëse kërkesa nuk depozitohet në kohën e duhur.

2. Gjatë transmetimit të kërkesës për konvertim në zyrat qendrore të pronësisë industriale të Shteteve Kontraktuese të përcaktuar në kërkesë, zyrat qendrore të pronësisë industriale të interesuara ose Zyra për Patentë Europiane i bashkëngjit kërkesës një kopje të dosjes në lidhje me kërkesën për patentë europiane ose patentën europiane.

3. Neni 135, paragrafi 4, zbatohet nëse kërkesa për konvertim e përmendur në Nenin 135, paragrafët 1(a) ose (2), nuk transmetohet para skadimit të një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh nga data e depozitimit ose, nëse është pretenduar prioriteti, nga data e prioritetit.

Rregulli 156 N. 135, 140

Informacioni për publikun në rastin e konvertimit

1. Dokumentet që shoqërojnë kërkesën për konvertim sipas Rregullit 155, paragrafi 2, i ofrohet publikut nga zyra qendrore e pronësisë industriale në të njëjtat kushte dhe në të njëjtën masë si dokumentet në lidhje me procedimet kombëtare.

2. Specifikimet e printuara të patentës kombëtare që rrjedhin nga konvertimi i një kërkesë për patentë europiane përmend atë kërkesë.

PJESA IX

RREGULLORET ZBATUESE PËR PJESËN X TË KONVENTËS

Rregulli 157 N. 150, 151

Zyra e Patentave Europiane si një Zyrë pranimi

1. Zyra e Patentave Europiane është kompetente për të vepruar si Zyrë pranimi brenda kuptimit të PCT-së nëse kërkuesi është me banim ose shtetas i një Shteti Kontraktues në këtë Konventë dhe në PCT-ë. Pa cënuar paragrafin 3, nëse kërkuesi zgjedh Zyrën e Patentave Europiane si një Zyrë pranimi, kërkesa ndërkombëtare depozitohet drejtpërdrejt tek Zyra e Patentave Europiane. Neni 75, paragrafi 2, zbatohet mutatis mutandis.

2. Nëse Zyra për Patentë Europiane vepron si një Zyrë pranimi sipas PCT-së, kërkesa ndërkombëtare depozitohet në anglisht, frëngjisht ose gjermanisht. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane mund të përcaktojë që kërkesa ndërkombëtare dhe çdo dokument mbështetës të depozitohet në më shumë se një kopje.

3. Nëse një kërkesë ndërkombëtare depozitohet tek një organ në një Shtet Kontraktues për t'iu transmetuar Zyrës së Patentave europiane si Zyrë pranimi, Shteti Kontraktues siguron që kërkesa të mbërrijë në Zyrën e Patentave Europiane jo më vonë se dy javë para fundit të muajit të trembëdhjetë nga depozitimi ose, nëse është pretenduar prioriteti, nga data e prioritetit.

4. Tarifa e transmetimit për kërkesën ndërkombëtare paguhet brenda një muaji nga depozitimi i kërkesës.

Rregulli 158 N. 35, 152

Zyrë e Patentave Europiane si Autoritet Kërkimi ndërkombëtar ose Autoritet Ndërkombëtar për Shqyrtimin Paraprak

1. Në rastin e Neni 17, paragrafi 3(a) PCT, një tarifë shtesë e kërkimit ndërkombëtar paguhet për çdo shpikje tjetër për të cilën duhet të kryhet një kërkim ndërkombëtar.

2. Në rastin e nenit 34, paragrafi 3(a) PCT, një tarifë shtesë për shqyrtimin paraprak ndërkombëtar paguhet për çdo shpikjeje tjetër për të cilën duhet të kryhet një shqyrtim paraprak ndërkombëtar.

3. ¹ Nëse është paguar një tarifë shtesë me kundërshtim, Zyra e Patentave Europiane shqyrton kundërshtimin në pajtim me Rregullin 40.2(c) deri (e) ose Rregullin 68.3(c) deri (e) PCT, duke iu nënshtruar pagesës së tarifës së parashikuar për protestën. Hollësi të mëtejshme në lidhje me procedurën përcaktohen nga kryetari i Zyrës së Patentave Europiane.

¹ Shih Vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë, Nr 3, GZ EPO 2007, L. 1., dhe Njoftimin e EPO-së, Botim i veçantë nr 3, GZ EPO 2007, N. 2.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Rregulli 159 N. 35, 150, 153; R. 10, 160-163

Zyra e Patentave Europiane si një Zyrë e emëruar ose zgjedhur – kërkesat për hyrjen në fazën europiane

1. Në lidhje me një kërkesë ndërkombëtare sipas nenit 153, kërkuesi kryhen veprimet e mëposhtme brenda tridhjetë e një muajve nga data e depozitimit të kërkesës ose, nëse është pretenduar prioriteti, nga data e prioritetit:

- a) paraqet, sipas rastit, përkthimin e kërkesës ndërkombëtare që kërkohej sipas Nenit 153, paragrafi 4;
 - b) përcakton dokumentet e kërkesës, të depozituara fillimisht ose të ndryshuara, në të cilët duhet të bazohet procedura europiane për dhënien;
 - c) paguan tarifën e depozitimit të parashikuara në Nenin 78, paragrafi 2;
 - d)¹ paguan tarifat e përcaktimit nëse periudha sipas Rregullit 39 ka skaduar më parë;
 - e) paguan tarifën e kërimit, nëse duhet të përpilohet një raport suplementar për kërkimin europian.
 - f) depoziton kërkesën për shqyrtimin e parashikuar në Nenin 94, nëse periudha sipas Rregullit 70, paragrafi 1, ka skaduar më parë;
 - g) paguan tarifën e mbajtjes në fuqi në lidhje me vitin e tretë të parashikuar në Nenin 86, paragrafi 1, nëse tarifa është bërë e kërkueshme më parë sipas Rregullit 51, paragrafi 1;
 - h) depoziton, sipas rastit, certifikatën e ekspozimit të përmendur në nenin 55, paragrafi 2, dhe Rregullit 25.
2. Sektori i Ekzaminimit është kompetent për të marrë vendimet e Zyrës së Patentave Europiane sipas Nenit 25, paragrafi 2(a) PCT.

Rregulli 160 N. 153; R. 159

Pasoja nga mospërbushja e disa kërkesave

1. Nëse nuk depozitohet në kohë përkthimi i kërkesës ndërkombëtare ose kërkesa për shqyrtim, ose nëse tarifa e depozitimit ose tarifa e kërimit nuk paguhet në kohë, apo nëse nuk paguhet në kohë tarifa e përcaktimit, kërkesa për patentë europiane konsiderohet të jetë tërhequr.

2. ² Përcaktimi i një shteti Kontraktues në lidhje me të cilin nuk është paguar tarifa e përcaktimit konsiderohet të jetë tërhequr.

3. Nëse Zyra e Patentave Europiane vëren që kërkesa ose përcaktimi i një Shteti Kontraktues konsiderohet të jetë tërhequr sipas paragrafit 1 ose 2, ai ia komunikon këtë kërkuessit. Rregulli 112, paragrafi 2, zbatohet mutatis mutandis.

Rregulli 161 N. 123

Ndryshimi i kërkesës

Pa cenuar Rregullin 137, paragrafët 2 deri 4, kërkesa mund të ndryshohet një herë, brenda një muaji nga një komunikim që njofton përkatësisht kërkuessin. Kërkesa e ndryshuar shërben si bazë për çdo kërkim shtesë që duhet të kryhet sipas Nenit 153, paragrafi 7.

Rregulli 162 N. 153; R. 45

Pretendimet që shkaktajnë tarifa

1. Nëse dokumentet e kërkesës mbi të cilën duhet të mbështetet një procedurë europiane për dhënien përmbajnë më shumë se dhjetë pretendime, një tarifë pretendimesh paguhet për të njëmbëdhjetin dhe çdo pretendim shtesë brenda afatit sipas Rregullit 159, paragrafi 1.

2. Nëse tarifat e pretendimeve nuk paguhet në kohën e duhur, ato përsëri mund të paguhet brenda një muaji nga një komunikim në lidhje me mosrespektimin e afatit. Nëse brenda këtij afati depozitohen pretendimet e ndryshuara, tarifat e kërkueshme të pretendimeve llogariten mbi bazën e këtyre pretendimeve të ndryshuara.

3. Të gjitha tarifat e pretendimeve brenda afatit sipas paragrafit 1 dhe tej atyre të kërkueshme sipas paragrafit 2, fjalia e dytë, kthehen.

¹ Shih mendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 4/98 (Aneksi I).

² Shih mendimin e Bordit të Zgjeruar të Apelit G 4/98 (Aneksi I).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

4. Nëse një tarifë për pretendime nuk paguhet në kohën e duhur, nga pretendimi përkatës konsiderohet të jetë hequr dorë.

Rregulli 163 N. 81, 88, 153

Shqyrtimi i disa kërkesave formale nga Zyra e Patentave Europiane

1. Nëse përcaktimi i shpikësit sipas Rregullit 19, paragrafi 1, nuk është bërë brenda afatit sipas Rregullit 159, paragrafi 1, Zyra e Patentave Europiane fton kërkuarësin për të bërë përcaktimin brenda dy muajve.

2. Nëse pretendohet prioriteti i një kërkesë të mëparshme dhe numri i dosjes së kërkesës së mëparshme ose kopja e saj i parashikuar në Rregullin 52, paragrafi 1, dhe Rregulli 53 nuk janë paraqitur brenda afatit sipas Rregullit 159, paragrafi 1, Zyra e Patentave Europiane fton kërkuarësin të japë atë numër ose kopje brenda dy muajve. Zbatohet Rregulli 2 dhe 3.

3. Nëse, me skadimin e afatit sipas Rregullit 159, paragrafi 1, Zyrës së Patentave Europiane nuk i është dhënë një listë renditjeje në përmbushje me standardet e parashikuara në Udhëzimet Administrative sipas PCT-së, kërkuarësi ftohet të depozitojë një listë renditjeje në pajtim me rregullat e përcaktuara nga kryetari i Zyrës së Patentave Europiane brenda dy muajve. Rregulli 30, paragrafët 2 dhe 3 zbatohen mutatis mutandis.

4. Nëse me skadimin e afatit sipas Rregullit 159, paragrafi 1, adresa, shtetësia ose shteti në të cilën gjendet vendbanimi ose vendi kryesor i biznesit mungon në lidhje me një kërkuarë, Zyra e Patentave Europiane fton kërkuarësin të paraqesë këto tregues brenda dy muajve.

5. Nëse me skadimin e afatit sipas Rregullit 159, paragrafi 1, nuk janë përmbushur kërkesat e Nenit 133, paragrafi 2, Zyra e Patentave Europiane fton kërkuarësin të caktojë një përfaqësues profesional brenda dy muajve.

6. Nëse mangësitë e vërejtura sipas paragrafëve 1, 4 ose 5 nuk korrigjohen në kohën e duhur, kërkesa për patentë europiane refuzohet. Nëse mangësitë e vërejtura në paragrafin 2 nuk korrigjohen në kohën e duhur, e drejta e prioritetit për kërkesën humbet.

Rregulli 164 N. 82, 153

Shqyrtimi i unitetit nga Zyra e Patentave Europiane

1. Nëse Zyra e Patentave Europiane është e mendimit që dokumentet e kërkesës që do të shërbejnë si bazë e kërimit suplementar nuk përmbushin kërkesat e unitetit të shpikjes, një raport i kërimit suplementar hartohet për ato pjesë të kërkesës që kanë të bëjnë me shpikjen, ose grupin e shpikjeve brenda kuptimit të nenit 82, përmendur së pari në pretendime.

2. Nëse Sektori i Ekzaminimit konstaton që dokumentet e kërimit mbi të cilat do të mbështetet procedura europiane për dhënien nuk përmbushin kërkesat e unitetit të shpikjes, ose mbrojtja kërkohet për një shpikje që nuk mbulohet nga raporti i kërimit ndërkombëtar ose, sipas rastit, nga raporti i kërimit suplementar, ai fton kërkuarësin të kufizojë kërkesën në një shpikje të mbuluar nga raporti i kërimit ndërkombëtar ose raporti i kërimit suplementar.

Rregulli 165

Kërkesa Euro-PCT si kërkesë konfliktuale sipas Nenit 54, paragrafi 3

Një kërkesë Euro-PCT konsiderohet të jetë bërë si arritje e mëparshme sipas Nenit 54, paragrafi 3, nëse përveç kushteve të parashikuara në Nenin 153, paragrafi 3 ose 4, tarifa e depozitimit sipas Rregullit 159, paragrafi 1(c) është paguar.

Protokolli për Interpretimin e Nenit 69 EPC

Të datës 5 tetor 1973

Të rishikuar nga Akti rishikues i EPC-së të datës 29 nëntor 2001

Neni 1

Parime të përgjithshme

Neni 69 nuk duhet të interpretohet në kuptimin që masa e mbrojtjes së dhënë nga një patentë europiane duhet të kuptohet si ai i përkufizuar nga kuptimi rigoroz dhe fjalë për fjalë i tekstit të përdorur në pretendime,

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

përshkrim dhe skicime që përdoren vetëm për qëllimin e zgjidhjes së një pasaktësie që gjendet në pretendime. Ai nuk duhet të konsiderohet gjithashtu as sikur pretendimet shërbejnë si një udhëzim dhe që mbrojtja faktike e dhënë mund të shtrihet në atë që, nga një shqyrtim i përshkrimit dhe skicimeve nga një person me aftësi në atë fushë teknike, ka parashikuar pronari i patentës. Përkundrazi, ai duhet të interpretohet si përkufizim i një pozicioni ndërmjet këtyre ekstremeve që kombinon një mbrojtje të drejtë për pronarin e patentës me një shkallë të arsyeshme të sigurisë ligjore për palët e treta.

Neni 2

Elementet e barasvlershëm

Për qëllimin e përcaktimit të masës së mbrojtjes së dhënë nga një patentë europiane, duhet të merret parasysh çdo element që është i barasvlershëm me një element të përcaktuar në pretendime.

¹Teksti i ri i Protokollit i miratuar nga Këshilli Administrativ i Organizatës së Patentave Europiane në vendimin e saj të datës 28 qershor 2001, shih GZ EPO 2001, Botimi i veçantë nr 4, f. 55) është bërë pjesë përbërëse e Aktit të Rishikimit të datës 29 nëntor 2000 sipas Nenit 3(2), fjalia e dytë, e atij Akti

Protokoll mbi Centralizimin e sistemit të Patentave Europiane dhe mbi Prezantimin e tij (Protokoll mbi Centralizimin)

Të datës 5 tetor 1973 të rishikuar nga Akti rishikues i EPC-së të datës 29 nëntor 2000¹

Seksioni I²

1. (a) Me hyrjen në fuqi të Konventës, Shtetet palë në të, që janë gjithashtu anëtarë të Institutit të Patentave Ndërkombëtare të themeluar me Marrëveshjen e Hagës të datës 6 Qershor 1947 merr të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar transferimin në Zyrën e Patentave Europiane jo më vonë se data e përmendur në Nenin 162, paragrafi 1, të Konventës të gjitha kreditë dhe debitë dhe të gjithë anëtarët e personelit të Institutit të Patentave Ndërkombëtare. Ky transferim do të bëhet nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet Institutit të Patentave Ndërkombëtare dhe Organizatës së Patentave Europiane. Shtetet e mësipërme dhe Shtetet e tjerë palë në Konventë marrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që marrëveshja të zbatohet jo më vonë se data e përmendur në Nenin 162, paragrafi 1, i Konventës. Me zbatimin e marrëveshjes, ato Shtete Anëtare të Institutit të Patentave Ndërkombëtare që janë gjithashtu palë në Konventë marrin përsipër të ndërpresin pjesëmarrjen e tyre në Marrëveshjen e Hagës.

b) Shtetet palë në Konventë marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që të gjitha kreditë dhe debitë dhe të gjithë anëtarët e Institutit të Patentave Ndërkombëtare të përfshihet në Zyrën e Patentave Europiane në pajtim me marrëveshjen e përmendur në nën-paragrafin (a). Pas zbatimit të asaj marrëveshjeje detyrat që i takojnë Institutit të Patentave Ndërkombëtare në datën në të cilën Konventa hapet për nënshkrim dhe veçanërisht ato të kryera kundrejt Shteteve Anëtare të saj, pavarësisht nëse ato bëhen palë në Konventën apo jo, dhe ato detyra që ai ka marrë përsipër në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës për ti kryer kundrejt Shteteve që në atë datë janë anëtarë të Institutit të Patentave Ndërkombëtare dhe palë në Konventë, të merren përsipër nga Zyra e Patentave Europiane. Përveç kësaj, Këshilli Administrativ i Organizatës së Patentave Europiane mund të caktojë detyra të tjera në fushën e kërkimit të Zyrës së Patentave Europiane.

c) Detyrimet e mësipërme zbatohen gjithashtu mutatis mutandis për degën e ngritur në bazë të Marrëveshjes së Hagës në kushtet e caktuara në marrëveshjen ndërmjet Institutit të Patentave Ndërkombëtare dhe Qeverisë së Shtetit Kontraktues përkatës. Kjo Qeveri merr përsipër të bëjë një marrëveshje të re me Organizatën e Patentave Europiane në vend të asaj që është bërë me Institutin e Patentave Ndërkombëtare për të harmonizuar klauzolat në lidhje me organizimin, funksionimin dhe financimin e degës me dispozitat e këtij Protokollit.

2) Në pajtim me dispozitat e Seksionit III, Shtetet palë në Konventë, në emër të zyrave qendrore të pronësisë industriale, dorëzojnë në favor të Zyrës së Patentave Europiane çdo aktivitet si Autoritete të Kërkimit Ndërkombëtar sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Patentat që nga data e përmendur në Nenin 162, paragrafi 1, e Konventës.

3)(a) Një degë e Zyrës së Patentave Europiane do të ngrihet në Berlin që nga data e përmendur në Nenin 162, paragrafi 1, e Konventës. Ajo do të operojë nën drejtimin e degës në Hagë.

b) Këshilli Administrativ përcakton detyrat që duhet t'i caktohen degës në Berlin duke patur parasysh konsideratat e përgjithshme dhe kërkesat e Zyrës së Patentave Europiane.

c) Të paktën në fillim të periudhës pas zgjerimit progresiv të fushës së veprimtarisë së Zyrës së Patentave Europiane, sasia e punës të caktuar asaj dege do të jetë e mjaftueshme për t'i mundësuar personelit shqyrtues të

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Aneksit të Berlinit të Zyrës së Patentave Gjermane, në gjendjen e datës në të cilën Konventa hapet për nënshkrim, të punësohet tërësisht.

d) Republika Federale e Gjermanisë mbulon çdo shpenzim shtesë që shkaktohet nga Organizata e Patentave Europiane në ngritjen dhe mbajtjen e degës në Berlin.

Seksioni II

Në pajtim me dispozitat e Seksioneve III dhe IV, Shtetet palë në Konventë, në emër të zyrave të tyre qendrore të pronësisë industriale, dorëzojnë në favor të Zyrës së Patentave Europiane çdo aktivitet si Autoritete të Shqyrtimit Paraprak Ndërkombëtar sipas Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat. Ky detyrim zbatohet vetëm në masën që Zyra e Patentave Europiane mund të shqyrtojë kërkesat për patenta europiane në pajtim me Nenin 162, paragrafi 2, të Konventës dhe nuk zbatohet deri në dy vjet pas datës në të cilën Zyra e Patentave Europiane ka filluar aktivitetet e shqyrtimit në fushat e teknologjisë përkatëse, mbi bazën e një plani pesë-vjeçar që zgjeron në mënyrë progresive aktivitetet e Zyrës së Patentave Europiane në të gjitha sferat e teknologjisë dhe që mund të ndryshohet vetëm me vendim të Këshillit Administrativ. Procedurat për zbatimin e këtij detyrimi përcaktohet me vendim të Këshillit Administrativ.

Seksioni III

1. Zyra qendrore e pronësisë industriale e çdo Shteti palë në Konventë në të cilën gjuha zyrtare nuk është një prej gjuhëve zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane autorizohet të veprojë si një Autoritet i Kërkimit Ndërkombëtar dhe si një Autoritet i Shqyrtimit Paraprak Ndërkombëtar në bazë të Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat. Ky autorizim i nënshtrohet detyrimit të Shtetit përkatës të kufizojë këto aktivitete në kërkesat ndërkombëtare të depozituara nga shtetas ose persona me vendbanim në këtë Shtet dhe nga shtetasit dhe personat me vendbanim të Shteteve palë të Konventës që kufizohen me atë Shtet. Këshilli Administrativ mund të vendosë të autorizojë zyrën qendrore të pronësisë industriale të çdo Shteti palë në Konventë të zgjerojë këto aktivitete për të mbuluar këto kërkesa ndërkombëtare që mund të depozitohen nga shtetasit ose personat me vendbanim në Shteteve jo-Kontraktuese që kanë të njëjtën gjuhë zyrtare si Shteti Kontraktues në fjalë dhe të përpiluar në atë gjuhë.

2. Për qëllimin e harmonizimit të aktiviteteve të kërkimit sipas Traktatit të bashkëpunimit për Patentat në kuadrin e sistemit europian për dhënien e patentave, bashkëpunimi vendoset ndërmjet Zyrës së Patentave Europiane dhe çdo zyre qendrore të pronësisë industriale sipas këtij Seksioni. Ky bashkëpunim bazohet në një marrëveshje të veçantë që mund të mbulojë p.sh, procedurat dhe metodat e kërkimit, kualifikimet e kërkuara për rekrutimin dhe trajnimin e shqyrtuesve, udhëzimet për shkëmbimin e shërbimeve të kërkimit dhe të tjera ndërmjet zyrave si dhe masa të tjera që nevojiten për të vendosur kontrollin dhe mbikëqyrjen e duhur.

Seksioni IV

1.(a) Me qëllim lehtësimin e përshtatjes së zyrave të patentave kombëtare të Shteteve palë në Konventë me sistemin e patentave europiane, Këshilli Administrativ, nëse e konsideron të dëshirueshme, dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara më poshtë, i ngarkon zyrat qendrore të pronësisë industriale të atyre Shteteve ku është e mundur të zhvillohen procedime në një prej gjuhëve zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane detyra në lidhje me shqyrtimin e kërkesave për patenta europiane të përpiluara në atë gjuhë që, në pajtim me Nenin 18, paragrafi 2, të Konventës, si rregull i përgjithshëm, i besohen një anëtar i Sektorit të Ekzaminimit. Këto detyra përbushen në kuadrin e procedimeve për dhënien të parashikuar në Konventë; vendimet për këto kërkesa merren nga Sektori i Ekzaminimit që përbëhet në pajtim me Nenin 18, paragrafi 2.

b) Detyrat e caktuara në bazë të nën-paragrafit (a) nuk do të jenë në më shumë se 40% të numrit të përgjithshëm të kërkesave për patenta europiane të depozituara; detyrat e ngarkuara një Shteti të caktuar nuk janë në lidhje me më shumë se një e treta e numrit të përgjithshëm të kërkesave për patenta europiane të depozituara. Këto detyra ngarkohen për një periudhë prej 15 vjetësh nga hapja e Zyrës së Patentave Europiane dhe zvogëlohet në mënyrë progresive (parimisht 20% në vit) deri në zero gjatë 5 viteve të fundit të periudhës.

c) Këshilli Administrativ vendos, duke marrë parasysh dispozitat e nën-paragrafëve (b), për natyrën, origjinën dhe numrin e kërkesave për patenta europiane në lidhje me të cilat detyrat e shqyrtimit mund t'u besohen zyrave qendrore të pronësisë industriale të secilit prej Shteteve Kontraktues të përmendur më sipër.

d) Procedurat e përmendura më sipër përcaktohen me marrëveshje të veçantë ndërmjet zyrës qendrore të pronësisë industriale të Shtetit Kontraktues dhe Organizatës së Patentave Europiane.

e) Një zyrë me të cilën është lidhur një marrëveshje e tillë mund të veprojë si një Autoritet i Shqyrtimit Paraprak Ndërkombëtar në bazë të Traktatit të bashkëpunimit për Patentat, deri në skadimin e periudhës 15 vjeçare.

2. (a) Nëse Këshilli Administrativ është i mendimit që është në pajtim me funksionimin e përshtatshëm të

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Zyrës së Patentave Europiane dhe me qëllim mënjanimin e vështirësive që mund të lindin për disa Shtete Kontraktuese nga zbatimi i Seksionit I, paragrafi 2, ai mund t'ua ngarkojë kërkimin në lidhje me kërkesat për patenta europiane zyrtare qendrore të pronësisë industriale të atyre Shteteve në të cilët gjuha zyrtare është një prej gjuhëve zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane, me kusht që këto zyra të kenë kualifikimet e nevojshme për t'u emëruar si Autoritete të Kërkimit Ndërkombëtar në pajtim me kushtet e parashikuara në Traktatin e Bashkëpunimit për Patentat.

b) Për kryerjen e kësaj pune të ndërmarrë nën përgjegjësinë e Zyrës së patentave Europiane, zyrat qendrore të pronësisë industriale të interesuara respektojnë udhëzimet e zbatueshme për hartimin e raportit të kërkimit europian.

c) Dispozitat e paragrafit 1(b), fjalia e dytë, dhe nën-paragrafi (d) i këtij Seksioni zbatohet për këtë paragraf.

Seksioni V

1. Dega e përmendur në Seksionin I, paragrafi 1(c), autorizohet të kryejë kërkimet nëpërmjet dokumentacionit që zotëron dhe që është në gjuhën zyrtare të Shtetit në të cilin gjendet degë, në lidhje me kërkesat për patenta europiane të depozituara nga shtetasit dhe personat me vendbanim në atë Shtet. Ky autorizim jepet me kushtin që procedura për dhënien e patentave europiane nuk do të vonohet dhe nuk do të shkaktohen shpenzime shtesë për Organizatën e Patentave Europiane.

2. Dega e përmendur në paragrafin 1 autorizohet të kryejë, sipas zgjedhjes së kërkuesit për një patentë europiane dhe me shpenzimet e tij, një kërkim për kërkesën e tij për patentë nëpërmjet dokumentacionit të përmendur në paragrafin 1. Ky autorizim është në fuqi deri sa të zgjasë kërkimi i parashikuara në Nenin 92 të Konventës, në pajtim me Seksionin VI, për të mbuluar këtë dokumentacion dhe jepet me kushtin që procedura për dhënien e patentave europiane nuk do të vonohet.

3. Këshilli Administrativ mund t'i japë autorizimet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2, sipas kushteve të atyre paragrafëve, edhe zyrës qendrore të pronësisë industriale të një Shteti Kontraktues që nuk ka si gjuhë zyrtare një prej gjuhëve zyrtare të Zyrës së Patentave Europiane.

Seksioni VI

Kërkimi i parashikuar në Nenin 92 të Konventës, në parim, në lidhje me të gjitha kërkesat për patentë europiane, shtrihet tek patentat e publikuara, kërkesat e publikuara për patenta dhe dokumente të tjerë përkatës të Shteteve Kontraktuese që nuk përfshihen në dokumentacionin e kërkimit të Zyrës së Patentave Europiane në datën e përmendur në Nenin 162, paragrafi 1, i Konventës. Masa, kushtet dhe koha e çdo shtrirjeje të tillë përcaktohet nga Këshilli Administrativ mbi bazën e një studimi në lidhje veçanërisht me aspektet teknike dhe financiare.

Seksioni VII

Dispozitat e këtij Protokoll mbizotërojnë mbi çdo dispozitë të Konventës që vijnë në kundërshtim.

Seksioni VIII

Vendimet e Këshillit Administrativ të parashikuara në këtë Protokoll kërkojnë një shumicë prej tre të katërtat (Neni 35, paragrafi 2, i Konventës). Zbatohen dispozitat që rregullojnë rëndësinë e votave (Neni 36 i Konventës).

Protokoll mbi Juridiksionin dhe Njohjen e Vendimeve në lidhje me të Drejtën e Dhënies së një Patente Europiane

(Protokoll mbi Njohjen)

Të datës 5 tetor 1973

SEKSIONI I JURIDIKSIONI

Neni 1¹

1. Gjykatat e Shteteve Kontraktuese, në pajtim me Nenet 2 deri 6, kanë juridiksion për të vendosur për pretendimet, ndaj kërkuesit, për të drejtën për dhënien e një patente europiane në lidhje me një ose më shumë Shtete Kontraktuese të përcaktuar në kërkesën për patentë europiane.

2. Për qëllimet e këtij Protokoll, termi "gjykata" përfshin autoritetet që, sipas ligjit të brendshëm të një Shteti

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimit G 3/92 (Aneksi I)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Kontraktues, kanë juridiksion për të vendosur për pretendimet e përmendur në paragrafin 1. Çdo Shtet Kontraktues njofton Zyrën për Patentë Europiane për identitetin e një autoriteti të cilit i jepet ky juridiksion dhe Zyra e Patentave Europiane njofton përkatësisht Shtetet e tjerë Kontraktues.

3. Për qëllimet e këtij Protokoll, termi “Shtet Kontraktues” i referohet një Shteti Kontraktues që nuk ka përjashtuar zbatimin e këtij Protokoll në pajtim me Nenin 167 të Konventës.

Neni 2

Në pajtim me Nenet 4 dhe 5, nëse një kërkues i një patente europiane ka vendbanimin e tij ose vendin kryesor të biznesit brenda një prej Shteteve Kontraktues, procedimi kundër tij nis në gjykatat e atij Shteti Kontraktues.

Neni 3

Në pajtim me Nenet 4 dhe 5, nëse kërkuesi i një patente europiane ka vendbanimin ose vendin e tij kryesor të biznesit jashtë Shteteve Kontraktuese, dhe nëse pala që pretendon të drejtën e dhënies së patentës europiane ka vendbanimin e saj ose vendin kryesor të biznesit brenda një prej Shteteve Kontraktuese, gjykatat e këtij Shteti kanë juridiksion ekskluziv.

Neni 4

Në pajtim me Nenin 5, nëse objekti i një kërkesë për patentë europiane është shpikje e një punonjësi, gjykatat e Shtetit Kontraktues, sipas rastit, ligji i të cilit përcakton të drejtën për patentën europiane në pajtim me Nenin 60, paragrafi 1, fjali e dytë, e Konventës, kanë juridiksionin ekskluziv për procedimin ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit.

Neni 5

1. Nëse palët në një mosmarrëveshje në lidhje me të drejtën për dhënien e një patente europiane kanë lidhur një marrëveshje, me shkrim ose me gojë me konfirmim me shkrim, me qëllim që një gjykatë ose gjykatat e një Shteti të caktuar Kontraktues të vendosin për një mosmarrëveshje të tillë, gjykata ose gjykatat e atij Shteti kanë juridiksion ekskluziv.

2. Megjithatë, nëse palët janë një punonjës dhe punëdhënësi i tij, paragrafi 1 zbatohet vetëm në masën që ligji i brendshëm që rregullon kontratën e punësimit e lejon marrëveshjen në fjalë.

Neni 6

Në rastet kur as Nenet 2 deri 4 dhe as Neni 5, paragrafi 1, nuk zbatohen, gjykatat e Republikës Federale të Gjermanisë kanë juridiksion ekskluziv.

Neni 7

Gjykatat e Shteteve kontraktuese para të cilave sillen pretendimet e përmendura në Nenin 1, vendosin kryesisht nëse ata kanë juridiksion në pajtim me Nenet 2 deri 6.

Neni 8

1. Në rastin e procedimit të bazuar në të njëjtin pretendim dhe ndërmjet të njëjtave palë që sillen para gjykatave të Shteteve të ndryshëm Kontraktues, gjykata tek e cila bëhet një kërkesë e mëvonshme refuzon kryesisht juridiksionin në favor të gjykatës tek e cila është bërë një kërkesë e mëparshme.

2. Në rastin kur kundërshtohet juridiksioni i gjykatës tek e cila është paraqitur një kërkesë e mëparshme, gjykata tek e cila bëhet një kërkesë e mëvonshme pezullon procedimin deri sa gjykata tjetër të marrë një vendim përfundimtar.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

SEKSIONI II NJOHJA

Neni 9¹

1. Në pajtim me dispozitat e Nenit 11, paragrafi 2, vendimi përfundimtar i dhënë një prej Shteteve Kontraktuese mbi të drejtën e dhënie së patentës europiane në lidhje me një ose më shumë Shtete Kontraktuese të përcaktuar në kërkesën për patentë europiane njihen pa kërkuar një procedurë të veçanta në Shtetet e tjera Kontraktuese.

2. Juridiksioni i gjykatës vendimi i së cilës duhet të njihet dhe vlefshmëria e këtij mendimi nuk mund të rishikohet.

Neni 10

Neni 9, paragrafi 1, nuk zbatohet nëse:

a) një kërkuar për një patentë europiane që nuk ka kundërshtuar një pretendim provon që dokumenti që fillon procedimin nuk i është njoftuar atij rregullisht dhe në kohën e duhur për t'u mbrojtur; ose

b) një kërkuar provon që vendimi nuk është në pajtim me një vendim tjetër të dhënë në një Shtet Kontraktues në procedimin ndërmjet të njëjtave palë që ka filluar para atij në të cilin është dhënë vendimi që duhet të njihet.

Neni 11

1. Në marrëdhëniet ndërmjet çdo Shteti Kontraktues, dispozitat e këtij protokoll do të mbizotërojnë mbi çdo dispozitë të marrëveshjeve të tjera që është në kundërshtim për juridiksionin ose njohjen e vendimeve.

2. Ky Protokoll nuk ka efekt mbi zbatimin e asnjë prej marrëveshjeve ndërmjet një Shteti Kontraktues dhe një Shteti që nuk detyrohet nga ky Protokoll.

Protokoll mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Organizatës së Patentave Europiane (Protokoll mbi Privilegjet dhe Imunitetet)

i datës 5 tetor 1973

Neni 1

1. Ambientet e Organizatës janë të pacenueshme.

2. Autoritetet e Shteteve në të cilën Organizata kë ambientet nuk hyjnë në këto ambiente, përveç se me pëlqimin e Kryetarit të Zyrës së Patentave Europiane. Ky pëlqim presumohet i marrë në rastin e zjarrit ose fatkeqësive të tjera që kërkojnë veprim të menjëhershëm mbrojtës.

3. Dorëzimi i njoftimit të padisë në ambientet e Organizatës dhe çdo instrumenti tjetër procedural në lidhje me shkakun e një padie kundër organizatës nuk përbën shkelje të paprekshmërisë.

Neni 2

Arkivat e Organizatës dhe të gjithë dokumenteve që i përkasin ose mbahen prej saj janë të paprekshme.

Neni 3

1. Brenda gamës së aktiviteteve të saj zyrtare, organizata ka imunitet ndaj juridiksionit dhe ekzekutimit të vendimeve, përveç

a) në masën që Organizata ka hequr dorë shprehimisht nga ky imunitet në një çështje të caktuar;

b) në rastin e një padie civile të ngritur nga një palë e tretë për dëmet që rrjedhin nga një aksident të shkaktuar nga një automjet që i takon ose që operohet në emër të Organizatës, ose në lidhje me një vepër penale në trafikun rrugor që ka të bëjë me një automjet të tillë;

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimit G 3/92 (Aneksi I)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- c) në lidhje me ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi të dhënë sipas Nenit 23.
2. Pasuria dhe sendet pasurore të Organizatës, kudo që të jenë, kanë imunitet nga çdo formë pretendimi, konfiskimi, shpronësimi ose sekuestrimi.
3. Pasuria dhe sendet pasurore të Organizatës kanë gjithashtu imunitet nga çdo formë shtrëngimi administrativ ose gjyqësor provizor, përveç kur mund të jetë përkohësisht e nevojshme në lidhje me parandalimin, hetimin e aksidenteve në lidhje me automjetet që i takojnë ose operohen nga Organizata.
4. Aktivitetet zyrtare të Organizatës, për qëllimet e këtij Protokoll, janë të tilla aq sa janë rigorozisht të nevojshme për funksionimin e saj administrativ dhe teknik, sipas parashikimit në Konventë.

Neni 4

1. Brenda gamës së aktiviteteve të saj zyrtare, Organizata, prona dhe të ardhurat e saj janë të përjashtuara nga tatimet e drejtpërdrejta.
2. Nëse për ushtrimin e aktiviteteve të saj zyrtare nga Organizata bëhen blerje të mëdha dhe në çmimin e të cilave përfshihen tatime ose detyrime, merren masa të përshtatshme, sipas rastit nga Shtetet Kontraktuese për të kthyer ose ri-imbursuar organizatës shumën e këtyre tatimeve ose detyrimeve.
3. Nuk bëhet asnjë përjashtim në lidhje me detyrimet dhe tatimet që nuk janë gjë tjetër përveçse shërbime nga ndërmarrjet publike.

Neni 5

Mallrat e importuara ose eksportuara nga Organizata për ushtrimin e aktiviteteve të saj zyrtare përjashtohen nga detyrimet dhe tarifatat e importit dhe eksportit të ndryshme nga tarifatat dhe tatimet që përfaqësojnë shërbimet e dhëna, dhe nga të gjitha detyrimet dhe refuzimet mbi importin ose eksportin.

Neni 6

Asnjë përjashtim nuk jepet në bazë të Neneve 4 dhe 5 në lidhje me mallrat e blerë ose importuar për nevoja personale të punonjësve të Zyrës së Patentave Europiane.

Neni 7

1. Mallrat që i përkasin Organizatës që janë përftuar ose importuar në bazë të Nenit 4 ose Nenit 5 nuk shiten ose jepen përveç se në pajtim me kushtet e përcaktuara nga Shtetet Kontraktuese që janë lejuar përjashtimet.
2. Transferimi i mallrave dhe dhënia e shërbimeve ndërmjet ndërtesave të ndryshme të Organizatës përjashtohet nga detyrimet dhe kufizimet e çfarëdo lloji; sipas rastit, shtetet Kontraktuese marrin të gjitha masat e nevojshme për të kthyer ose ri-imbursuar shumën e këtyre detyrimeve ose për të hequr këto kufizime.

Neni 8

Transmetimi i publikimeve dhe materialeve të tjera informative nga ose tek Organizata nuk kufizohet në asnjë mënyrë.

Neni 9

Shtetet Kontraktuese e përjashtojnë Organizatën nga disa detyrime valutore që janë të nevojshme për ushtrimin e aktiviteteve të saj zyrtare.

Neni 10

1. Në lidhje me komunikimet zyrtare dhe transferimin e të gjitha dokumenteve të saj, Organizata, në çdo Shtet Kontraktues, gëzon trajtimin më të favorshëm që ai Shtet i jep çdo organizate tjetër ndërkombëtare.
2. Asnjë censurim nuk ushtrohet në komunikimet zyrtare të Organizatës nga cildo mjet komunikimi.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 11

Shtetet Kontraktuese marrin të gjitha masat e përshtatshme për të lehtësuar hyrjen, qëndrimin dhe largimin e punonjësve të Zyrës së Patentave Europiane.

Neni 12

1. Përfaqësuesit e Shteteve Kontraktuese, Përfaqësuesit zëvendësues dhe këshilltarët ose ekspertët e tyre, sipas rastit, gëzojnë gjatë ndjekjes së takimeve të Këshillit Administrativ dhe çdo organi të krijuar prej saj, dhe në kuadër të udhëtimeve të tyre për në dhe nga vendi i takimit, privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) imunitet ndaj arrestit ose ndalimit dhe ndaj sekuestrimit të bagazhit të tyre personal, përveç kur kapen në flagrancë duke kryer, përpjekur për të kryer ose sapo kryer një vepër penale;

b) imunitet nga juridiksioni, edhe pas përfundimit të misionit të tyre, në lidhje me veprimet duke përfshirë fjalët e shkruara ose të folura, të kryera prej tyre në përmbushje të funksioneve të tyre; ky imunitet nuk zbatohet në rastin e një vepre penale në trafikun rrugor të kryer nga një prej personave të përmendur më sipër, dhe as në rastin e dëmit të shkaktuar nga një automjet që i takon ose drejtohet nga një person i tillë;

c) paprekshmëri të shkresave dhe dokumenteve të tyre zyrtare;

d) të drejtën për të përdorur kode dhe pranuar dokumente ose korrespondencë me korrier të veçantë ose zarf të vulosur;

e) përjashtimin e tyre dhe bashkëshortëve të tyre nga të gjitha masat e hyrjes dhe nga formalitetet e regjistrimit për të huajt;

f) të njëjtat lehtësi në çështjen e kontrollit të valutës dhe këmbimit që u jepen përfaqësuesve të Qeverive të huaja me misione të përkohshme zyrtare.

2. Privilegjet dhe imunitetet u jepen personave të përmendur në paragrafin 1, jo për përfitimin e tyre personal por me qëllim që të sigurohet pavarësia e plotë në ushtrim të funksioneve të tyre në lidhje me Organizatën. Për pasojë, një Shtet Kontraktues ka për detyrë të heqë dorë nga imuniteti në të gjitha rastet kur, sipas mendimit të atij Shteti, ky imunitet do të pengonte drejtësinë dhe nëse nga ai mund të hiqet dorë pa cenuar qëllimet për të cilat ai është dhënë.

Neni 13

1. Në pajtim me dispozitat e Nenit 6, Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane gëzon privilegjet dhe imunitetet e dhëna agjentëve diplomatikë sipas Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet Diplomatike të datës 18 prill 1961.

2. Megjithatë, imuniteti nga juridiksioni nuk zbatohet në rastin e një vepre penale në trafikun rrugor të kryer nga kryetari i Zyrës së Patentave Europiane ose një dëm të shkaktuar nga një automjet që i takon ose drejtohet prej tij.

Neni 14

Punonjësit e Zyrës së Patentave Europiane:

a) edhe pasi të kenë mbaruar shërbimin, kanë imunitet nga juridiksioni në lidhje me veprimet duke përfshirë fjalët e shkruara ose të folura, të kryera prej tyre në përmbushje të funksioneve të tyre; ky imunitet nuk zbatohet në rastin e një vepre penale në trafikun rrugor të kryer nga një punonjës i Zyrës së Patentave Europiane, dhe as në rastin e dëmit të shkaktuar nga një automjet që i takon ose drejtohet nga një person i tillë;

b) përjashtohet nga të gjitha detyrimet në lidhje me shërbimin ushtarak.

c) gëzon paprekshmërinë e shkresave dhe dokumenteve të tij zyrtare;

d) gëzon të njëjtat lehtësi në lidhje me përjashtimin nga të gjitha masat që kufizojnë imigrimin dhe që rregullojnë regjistrimin e të huajve që normalisht u jepen anëtarëve të personelit të organizatave ndërkombëtare, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre që janë pjesë e ekonomisë së tyre shtëpiake;

e) gëzon të njëjtat privilegje në lidhje me rregulloret e këmbimit që normalisht u jepen anëtarëve të personelit të organizatave ndërkombëtare;

f) gëzon të gjitha lehtësitë si riatdhesimi si agjentët diplomatikë në momentin e krizave ndërkombëtare, si dhe anëtarët e familjeve të tyre që janë pjesë e ekonomisë së tij shtëpiake;

g) ka të drejtën të importojë pa tarifë doganore orënditë e tyre dhe sendet personale në momentin e marrjes

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

së postit të tyre në Shtetin përkatës dhe të drejtën me mbarimin e funksioneve të tyre në atë Shtet për të eksportuar pa tarifë doganore të orendive të tyre dhe sendeve personale, duke iu nënshtruar kushteve që konsiderohen të nevojshme nga Qeveria e Shtetit në territorin e të cilit ushtrohet e drejta dhe me përjashtim të pasurisë së përfutur në atë Shtet që i nënshtrohet ndalimit të eksportit.

Neni 15

Ekspertët që kryejnë funksionet në emër të, ose zbatojnë misione për Organizatën gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme, në masën që këto janë të nevojshme për përmbushjen e funksioneve të tyre, duke përfshirë udhëtimet e bëra në përmbushje të funksioneve të tyre dhe gjatë këtyre misionëve:

- a) imunitet nga juridiksioni në lidhje me veprimet duke përfshirë fjalët e shkruara ose të folura, të kryera prej tyre në përmbushje të funksioneve të tyre, përveç në rastin e një veprë penale në trafikun rrugor të kryer nga një ekspert, dhe në rastin e dëmit të shkaktuar nga një automjet që i takon ose drejtohet prej tij; ekspertët vazhdojnë të gëzojnë këtë imunitet edhe pasi të kenë pushuar së qeni të punësuar nga Organizata;
- b) paprekshmërinë për të gjitha shkresat dhe dokumentet e tyre zyrtare;
- c) lehtësitë e këmbimit të nevojshme për transferimin e shpërblimit të tyre.

Neni 16

1. Personat e përmendur në Nenet 13 dhe 14 i nënshtrohen një tatimi në interes të Organizatës mbi pagat dhe shpërblimet që paguhet nga Organizata, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara nga Këshilli Administrativ brenda një periudhe prej një viti nga data e hyrjes në fuqi të Konventës. Nga data në të cilën aplikohet kjo taksë, këto paga dhe shpërblime përjashtohen nga tatimi i brendshëm mbi të ardhurat. Megjithatë, Shtetet Kontraktuese marrin parasysh pagat dhe shpërblimet e përjashtuara gjatë vlerësimit të masës së tatimit që duhet të zbatohet për të ardhurat e tyre nga burime të tjera.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet për pensionet dhe honorarët që Organizata u paguan punonjësve të saj të mëparshëm të Zyrës së Patentave Europiane.

Neni 17

Këshilli Administrativ vendos për kategoritë e punonjësve për të cilët zbatohen dispozitat e nenit 14, plotësisht ose pjesërisht, dhe Nenit 16 dhe kategoritë e ekspertëve për të cilat zbatohen dispozitat e nenit 15. emrat, titujt dhe adresat e punonjësve të përfshira në këto kategori u komunikohen herë pas here Shteteve Kontraktuese.

Neni 18

Në rast se Organizata ngre skemën e vetë të sigurimeve sociale, Organizata dhe punonjësit e Zyrës së Patentave Europiane janë të përjashtuar nga të gjitha kontributet e detyrueshme në skemat e brendshme për sigurimet sociale, në pajtim me marrëveshjet e bëra me Shtetet Kontraktuese në pajtim me dispozitat e Nenit 25.

Neni 19

1. Privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në këtë Protokoll nuk janë të destinuara për t'u dhënë avantazhe personale punonjësve të Zyrës së Patentave Europiane ose ekspertëve që përmbushin funksionet për ose në emër të Organizatës. Ato jepen vetëm për të siguruar, në çdo rrethanë, funksionimin normal të Organizatës dhe pavarësinë e plotë të personave të cilëve ato u jepen.

2. Kryetari i Zyrës së Patentave Europiane ka detyrën për të hequr dorë nga imuniteti nëse ai është i mendimit që ky imunitet pengon zbatimin normal të drejtësisë dhe kur është e mundur të hiqet dorë nga ky imunitet pa cenuar interesat e Organizatës. Këshilli Administrativ mund të heqë dorë nga imuniteti i Presidentit për të njëjtat arsye.

Neni 20

1. Organizata bashkëpunon gjithmonë me autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese me qëllim që të lehtësohet administrimi i përshtatshëm i drejtësisë, për të siguruar respektimin e plotë të rregulloreve për rendin, rregulloreve në lidhje me shëndetin publik, inspektimit të punës dhe legjislacionin tjetër të ngjashëm të

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

brendshëm dhe për të parandaluar çdo abuzim me privilegjet, imunitetet dhe lehtësitë të parashikuara në këtë Protokoll.

2. Procedura e bashkëpunimit e përmendur në paragrafin 1 mund të parashikohet në marrëveshjet plotësuese të përmendura në Nenin 25.

Neni 21

Secili Shtet Kontraktues mban të drejtën të marrë të gjitha masat paraprake të nevojshme në interes të sigurisë së tij.

Neni 22

Asnjë Shtet Kontraktues nuk është i detyruar të shtrijë privilegjet dhe imunitetet e përmendur në nenin 12, Nenin 13, Nenin 14, nën-paragrafët (b), (c) dhe (g), dhe Nenin 15, nën-paragrafin (c), tek:

- a) shtetasit e tij;
- b) një person që në momentin e fillimit të funksioneve të tij në Organizatë e ka vendbanimin e përhershëm në atë Shtet dhe nuk është një punonjës i ndonjë organizate tjetër ndër-qeveritare personeli i së cilës është i përfshirë në Organizatë.

Neni 23

1. Çdo Shtet Kontraktues mund t'ia paraqesë një gjykatë ndërkombëtare arbitrazhi çdo mosmarrëveshje në lidhje me Organizatën ose një punonjës të Zyrës së Patentave Europiane ose një ekspert që përmbush funksione për ose në emër të saj, në masën që Organizata ose punonjësit dhe ekspertët e saj kanë pretenduar një privilegj ose imunitet sipas këtij Protokoll në rrethanat që nga imuniteti nuk është hequr dorë.

2. Nëse një Shtet Kontraktues synon të paraqesë një mosmarrëveshje në arbitrazh, ai njofton Kryetarin e Këshillit Administrativ, që menjëherë njofton çdo Shtet Kontraktues për këtë njoftim.

3. Procedura e parashikuar në paragrafin 1 të këtij Neni nuk zbatohet për procedurat ndërmjet Organizatës dhe punonjësve ose ekspertëve në lidhje me Rregulloret e Shërbimit ose kushtet e punësimit ose, në lidhje me punonjësit, Rregulloren e Skemës së Pensioneve.

4. Kundër vendimit të gjykatës së arbitrazhit nuk bëhet ankim, i cili është i formës së prerë dhe detyrues për palët. Në rastin e mosmarrëveshjes për kuptimin ose objektin e vendimit, i takon gjykatës së arbitrazhit ta interpretojë atë me kërkesë të njëres prej palëve.

Neni 24

1. Gjykata e arbitrazhit e përmendur në Nenin 23 përbëhet nga tre anëtarë, një gjyqtar i caktuar nga Shteti ose Shtetet palë në arbitrazh, një gjyqtar e cakton Këshilli Administrativ dhe një gjyqtar i tretë që është kryetari, i caktuar nga këta dy arbitra.

2. Arbitrat caktohen nga një panel që nuk përbëhet nga më shumë se gjashtë arbitra të caktuar nga secili Shtet Kontraktues dhe gjashtë arbitra të caktuar nga këshilli Administrativ. Kjo trupë gjyqtarësh ngrihet sa me shpejt të jetë e mundur pas hyrjes në fuqi të protokollit dhe rishikohet çdo herë që del e nevojshme.

3. Nëse, brenda tre muajve nga data e njoftimit të përmendur në Nenin 23, paragrafi 2, një palë nuk bën emërimin e përmendur në paragrafin 1 më sipër, zgjedhja e arbitrit, me kërkesë të palës tjetër, bëhet nga personat e përfshirë në këtë panel. Kjo zbatohet edhe nëse kërkohet nga një palë, kur brenda një muaji nga data e caktimit të arbitrit të dytë, dy arbitrat e parë nuk janë në gjendje të bien dakord për emërimin e arbitrit të tretë. Megjithatë, nëse, në këto dy raste, Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë pengohet në bërjen e zgjedhjes ose nëse ai është shtetas i një prej Shteteve palë në mosmarrëveshje, Zëvendëskryetari i Gjykatës ndërkombëtare të Drejtësisë bën emërimet e sipërpërmendura, me kusht që ai vetë të mos jetë një shtetas i një prej Shteteve palë në mosmarrëveshje; nëse është, anëtar i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që nuk është shtetas i një prej Shteteve palë në mosmarrëveshje dhe që është zgjedhur nga Kryetari ose Zëvendëskryetari i bën këto emërimet. Një shtetas i Shtetit që bën kërkesë për arbitrazh nuk mund të zgjidhet për të zënë vendin e gjyqtarit emërimi i të cilit i delegohet Këshillit Administrativ dhe asnjë person i përfshirë në panel dhe i emëruar nga Këshilli Administrativ nuk mund të zgjidhet për të zënë vendin e një gjyqtari emërimi i të cilit i delegohet Shtetit që është pretenduesi. Asnjë person i këtyre kategorive nuk mund të zgjidhet Kryetar i Gjykatës.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

4. Gjykata e arbitrazhit përpilon rregullat e veta të procedurës.

Neni 25

Organizata, me vendim të Këshillit Administrativ, mund të përfundojë me një ose më shumë Shtete Kontraktuese marrëveshje plotësuese për t'u dhënë fuqi dispozitive të këtij Protokollit në lidhje me këtë Shtet ose Shtete dhe masa të tjera për të siguruar funksionimin efikas të Organizatës dhe garantimin e interesave të saj.

Protokoll mbi Gjendjen e Personelit të Zyrës së Patentave Europiane në Hagë (Protokoll mbi Gjendjen e Personelit)

i datës 29 nëntor 2000¹

Organizata e Patentave Europiane siguron që raporti i vendeve të punës së Zyrës së Patentave Europiane të dhëna në qendrën e punës në Hagë sipas përcaktimit të planit të themelimit dhe tabelës së vendeve të vitit 2000 të mbetet në thelb e pandryshuar. Çdo ndryshim në numrin e vendeve të caktuara në qendrën e punës në Hagë që rezulton në një devijim të më shumë se dhjetë përqind të atij raporti, që provohet e nevojshme për funksionimin e rregullt të Zyrës së Patentave Europiane, i nënshtrohet një vendimi nga këshilli Administrativ i Organizatës me propozim të kryetarit të Zyrës së Patentave Europiane pas konsultimit me Qeveritë e Republikës Federale Gjermane dhe Mbretërisë së Holandës².

Akt rishikues i Konventës për Dhënien e Patentave Europiane (Konventa e Patentave Europiane) e datës 5 tetor 1973, rishikuar së fundi më 17 dhjetor 1991

e datës 2000
(ekstraktë)

Preambulë

Shtetet Kontraktuese në Konventën për Patentat Europiane,

Duke ditur që bashkëpunimi i vendeve të Europës mbi bazën e Konventës së Patentës Europiane dhe procedurës së vetme për dhënien e patentave të caktuara në të i kushton vëmendje të veçantë integritetit ligjor dhe ekonomik të Europës,

Me dëshirën për të nxitur novacionin dhe rritjen ekonomike në Europë me më shumë efektivitet duke vendosur baza për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të patentave europiane,

Duke dashur, nën dritën e karakterit gjithmonë e më ndërkombëtar të sistemit të patentave, të përshtatë Konventën e Patentave Europiane me zhvillimet teknologjike dhe ligjore që kanë ndodhur që nga koha e përfundimit të saj,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Ndryshimi i Konventës së Patentave Europiane

Konventa e Patentave Europiane ndryshohet si më poshtë:

...

(1. Nenet e mëposhtëm janë shtuar:

Nenet 4a, 105a, 105b, 105c, 112a, 134a dhe 149a.

¹ Teksti i ri i Protokollit të miratuar nga Këshilli Administrativ i Organizatës së Patentave Europiane në vendimin e tij të datës 28 qershor 2001 (shih GZ EPO 2001, Botim i veçantë nr 4, f 55) është bërë një pjesë përbërëse e Aktit të Rishikimit të datës 29 nëntor 2000 sipas Nenit 3(2), fjalë e dytë, e atij Akti.

² Bashkëngjitur në Konventën e Patentave Europiane si pjesë përbërëse e saj me aktin rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29.11.2000.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Nenet e mëposhtëm janë ndryshuar:

Nenet 11, 14, 16, 17, 18, 21, 22, 23, 33, 35, 37, 38, 42, 50, 51, 52, 53, 54, 60, 61, 65, 67, 68, 69, 70, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 86, 87, 88, 90, 92, 93, 94, 97, 98, 99, 101, 103, 104, 105, 106, 108, 110, 115, 117, 119, 120, 121, 122, 123, 124, 127, 128, 129, 130, 133, 134, 135, 137, 138, 140, 141, 150, 151, 152, 153 dhe 164.

3. Nenet e mëposhtëm janë shfuqizuar:

Nenet 91, 95, 96, 102, 126, 136, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163 dhe 167.)

Neni 2

Protokollet

...

1. Ndryshimi i Protokollit mbi Interpretimin e Nenit 69 EPC dhe Seksionit I të Protokollit mbi Centralizimin e sistemit të patentave Europiane dhe mbi Prezantimin e tij (Protokolli mbi Centralizimin).

2. Futja e Protokollit mbi Gjendjen e Personelit të Zyrës së Patentave Europiane në Hagë (Protokolli mbi Gjendjen e Personelit.)

Neni 3¹

Teksti i ri i Konventës

1. Këshilli Administrativ i Organizatës së Patentave Europiane autorizohet të përpilojë, me propozim të Kryetarit të Zyrës së Patentave Europiane, tekstin e ri të Konventës së Patentave Europiane. Në tekstin e ri, teksti i dispozitave të Konventës, sipas rastit, mund të renditet në të tre gjuhët zyrtare. Dispozitat e Konventës duhet të rinumërohen progresivisht dhe dërgimet në dispozitat e tjera të Konventës mund të ndryshohen në pajtim me numërtimin e ri.

2. Këshilli Administrativ miraton tekstin e ri të Konventës me shumicë prej tre të katërtat e votave të Shteteve Kontraktuese që përfaqësohen në votim. Pas miratimit të tij, teksti i ri i Konventës bëhet pjesë përbërëse e këtij akti Rishikimi.

Neni 4

Nënshkrimi dhe Ratifikimi

1. Ky Akt rishikimi është i hapur për nënshkrim nga Shtetet Kontraktuese në Zyrën e Patentave Europiane në Munihi deri më 1 shtator 2001.

2. Ky Akt Rishikimi i nënshtrohet ratifikimit; instrumentet e ratifikimit depozitohen tek Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Neni 5

Aderimi

1. Ky Akt Rishikimi është i hapur, deri në hyrjen e tij në fuqi, për aderim nga Shtetet Kontraktuese në Konventë dhe Shtetet që ratifikojnë Konventën ose aderojnë në të.

2. Instrumentet e aderimit depozitohen tek Qeveria e Republikës Federale Gjermane.

Neni 6

Zbatimi provizor

Neni 1, pikat 4-6 dhe 12-15, Neni 2, pikat 2 dhe 3 dhe Nenet 3 dhe 7 të këtij Akti rishikimi zbatohen provizorisht.

¹ Me vendim të datës 28 qershor 2001 të Këshillit Administrativ të Organizatës së Patentave Europiane, teksti i ri i miratuar i APC-së (shih OJ EPO 2001, Botim i veçantë nr 4, f 55).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 7¹

Dispozitat kalimtare

1. Versioni i rishikuar i Konventës zbatohet për të gjitha kërkesat e patentave europiane të depozituara pas hyrjes së saj në fuqi, si dhe për të gjitha patentat e dhëna për këto kërkesa. Ajo nuk zbatohet për patentat europiane të dhëna në momentin e hyrjes së saj në fuqi, ose për kërkesat për patenta europiane në shqyrtim e sipër, përveç kur vendoset ndryshe nga Këshilli Administrativ i Organizatës së Patentave Europiane.

2. Këshilli Administrativ i Organizatës së Patentave Europiane e merr një vendim sipas paragrafit 1 jo më vonë se data 30 qershor 2001, me shumicë prej tre të katërtat e Shteteve Kontraktuese të përfaqësuar dhe që votojnë. Ky vendim bëhet pjesë përbërëse e aktit të Rishikimit.

Neni 8

Hyrja në fuqi

1. Teksti i rishikuar i Konventës së Patentave Europiane hyn në fuqi dy vjet pasi Shteti Kontraktues i pesëmbëdhjetë ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose depozitimit, ose në ditën e parë të muajit të tretë pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit nga Shteti Kontraktues që e ndërmerr këtë hap si i fundit i Shteteve Kontraktuese, nëse kjo kryhet më parë.

2. Me hyrjen në fuqi të tekstit të rishikuar të Konventës, teksti i vlefshëm deri në atë moment pushon së zbatuari.

Neni 9

Transmetimi dhe njoftimet

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë përpilon kopje të vërtetuara autentike të këtij akti Rishikimi dhe ua transmeton ato qeverive të Shteteve Kontraktuese dhe të Shteteve që janë në gjendje të aderojnë Konventën e Patentave Europiane sipas Nenit 166, paragrafi 1.

2. Qeveria e Republikës së Gjermanisë i njofton qeveritë e përmendura në paragrafin 1 në lidhje me:

a) depozitim të çdo instrumenti ratifikimi ose aderimi;

b) datën e hyrjes në fuqi të këtij Akti Rishikimi.

Në dëshmi të kësaj, të Plotfuqishmit e autorizuar, duke paraqitur Plotfuqinë e tyre, që konstatohet të jetë në gjendje të rregullt dhe të përshtatshme, kanë nënshkruar këtë Akt Rishikimi.

Bërë në Mynih, më 29 nëntor 2000, në një origjinal të vetëm në gjuhët angleze, frënge dhe gjermane, ky të tre tekstet janë njëloj autentikë. Ky tekst origjinal depozitohet në arkivat e Republikës Federale të Gjermanisë.

Vendimi i Këshillit Administrativ

I datës 28 qershor 2001 i dispozitave kalimtare sipas nenit 7 të Aktit të rishikimit të Konventës së Patentave Europiane të datës 29 nëntor 2000

Këshilli Administrativ i Organizatës së Patentave Europiane,

duke patur parasysh Nenin 7, paragrafi 2, i Aktit rishikues të Konventës së patentave Europiane të datës 29 nëntor 2000 ("Akti i Rishikimit"),

Me propozim të kryetarit të Zyrës së Patentave Europiane,

duke patur parasysh mendimin e Komiteti mbi të Drejtën e Patentave,

Kanë vendosur si më poshtë:

Neni 1

Në pajtim me Nenin 7, paragrafi 1, fjalë e dytë, e Aktit të Rishikimit, dispozitat e mëposhtme kalimtare zbatohen për dispozitat e ndryshuara dhe të reja të Konventës së Patentave Europiane të përcaktuara më poshtë:

¹ Shih vendimin e Këshillit Administrativ të datës 28 qershor 2001 mbi dispozitat kalimtare sipas Nenit 7 të Aktit rishikues të Konventës së Patentave Europiane të datës 29 nëntor 2000, f 497.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

1. Nenet 14(3) deri (6), 51, 52, 53, 54(3) dhe (4), 61, 67, 68 dhe 69, Protokolli për Interpretimin e Nenit 69, dhe Nenet 70, 86, 88, 90, 92, 93, 94, 97, 98, 106, 108, 110, 115, 117, 119, 120, 123, 124, 127, 128, 129, 133, 135, 137 dhe 141 zbatohet për kërkesat për patenta europiane në shqyrtim e sipër në momentin e hyrjes së tyre në fuqi dhe për patentat europiane që në atë moment janë dhënë. Megjithatë, Neni 54(4) i versionit të Konventës në fuqi para asaj kohe vazhdon të zbatohet për këto kërkesa dhe patenta.

2. Nenet 65, 99, 101, 103, 104, 105, 105a-c dhe 138 zbatohen për patentat europiane të dhëna në momentin e hyrjes së tyre në fuqi dhe për patentat europiane të dhëna në lidhje me kërkesat për patenta europiane në shqyrtim e sipër.

3. Neni 54(5) zbatohet për kërkesat për patenta europiane në shqyrtim e sipër në momentin e hyrjes së saj në fuqi, në masën që një vendim për dhënien e patentës nuk është marrë.

4. Neni 112a zbatohet për vendimet e Bordit të Apelit të marra në datën e hyrjes së tij në fuqi.

5. Nenet 121 dhe 122 zbatohen për kërkesat për patenta europiane në shqyrtim e sipër në momentin e hyrjes së tyre në fuqi dhe për patentat europiane të dhëna në atë moment, në masën që kufijtë kohorë për të kërkuar përpunimin ose rivendosjen e të drejtave nuk kanë skaduar në atë moment.

6. Neni 150 deri 153 zbatohen për kërkesat ndërkombëtare në shqyrtim e sipër në momentin e hyrjes së tyre në fuqi. Megjithatë, Nenet 154(3) dhe 155(3) të versionit të Konventës në fuqi para atij momenti vazhdon të zbatohet për këto kërkesa.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të tekstit të rishikuar të Konventës në pajtim me Nenin 8 të aktit të Rishikimit.

Bërë në Muni, në datën 28 qershor 2001.

Për Këshillin Administrativ
Kryetari
Roland GROSSENbacher

Rregullat për Tarifat

të datës 20 tetor 1977

miratuar me vendim të Këshillit Administrativ të Organizatës së Patentave Europiane

të datës 7 dhjetor 2006

Përmbajtja

Neni 1 Të përgjithshme

Neni 2 Tarifa e parashikuara në Konventë dhe në Rregulloret Zbatuese

Neni 3 Tarifat, shpenzimet dhe çmimet e caktuara nga Kryetari i Zyrës

Neni 4 Data e kërkueshme e tarifave

Neni 5 Pagesa e tarifave

Neni 6 Hollësi në lidhje me pagesat

Neni 7 Data që konsiderohet si datës e kryerjes së pagesës

Neni 8 Pamjaftueshmëria e shumës së paguar

Neni 9 Kthimi i tarifave të kërimit

Neni 10 Kthimi i tarifës për një mendim teknik

Neni 11 Kthimi i tarifës së shqyrtimit

Neni 12 Kthimi i shumave të vogla

Neni 13 Vendimet që caktojnë shpenzimet e ankimueshme

Neni 14 Zbritja e tarifave

Neni 15 Hyrja në fuqi

Këshilli Administrativ i Organizatës së Patentave Europiane, duke patur parasysh

Konventën e Patentave Europiane dhe veçanërisht Nenin 33, paragrafin 2(d), të saj,

Ka miratuar rregullat e mëposhtme në lidhje me tarifat:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 1 Të përgjithshme

Sa më poshtë vihen në pajtim me dispozitat që gjenden në këto Rregulla:

a) tarifat e kërkueshme nga Zyra e Patentave Europiane (këtu quhet Zyra) sipas parashikimit në Konventë dhe në Rregulloret Zbatuese dhe tarifat dhe shpenzimet që Kryetari i Zyrës i cakton në pajtim me Nenin 3, paragrafi 1;

b) tarifat dhe shpenzimet në pajtim me Traktatin e Bashkëpunimit për Patentat (këtu quhet PCT), shumat e të cilave mund të caktohen nga Zyra.

Neni 2 Tarifat e parashikuara në Konventë dhe në Rregulloret Zbatuese

Tarifat që duhet t'i paguhen Zyrës sipas nenit 1 janë si më poshtë:	EUR
1. Tarifa e depozitimit (Neni 78, paragrafi 2) ku	95
- kërkesa për patentë europiane ose, në rastin e një kërkesë ndërkombëtare, forma e hyrjes në fazën europiane (EPO Form 1200) depozitohet me postë elektronike	
- kërkesa për patentë europiane ose, në rastin e një kërkesë ndërkombëtare, forma e hyrjes në fazën europiane (EPO Form 1200) nuk depozitohet me postë elektronike	170
2. Tarifë kërkitimi në lidhje me	1 000
- një kërkim europian ose plotësues për një kërkesë të depozituar më ose pas datës 1 korrik 2005 (Neni 78, paragrafi 2, Rregulli 62, Rregulli 64, paragrafi 1, Neni 153, paragrafi 7)	
- një kërkim europian ose plotësues për një kërkesë të depozituar më ose pas datës 1 korrik 2005 (Neni 78, paragrafi 2, Rregulli 64, paragrafi 1, Neni 153, paragrafi 7)	720
- një kërkim ndërkombëtar (Rregulli 16.1 PCT dhe Rregulli 158, paragrafi 1)	1615 ¹
3. Tarifë e përcaktimit për çdo Shtet Kontraktues të përcaktuar (Neni 79, paragrafi 2), tarifat e përcaktimit që konsiderohen të paguara për të gjitha Shtetet Kontraktuese me pagesën e shtatëfishit të shumës së kësaj tarife	80
3a. Tarifë e përcaktimit të përbashkët për Konfederatën Zvicerane dhe Principatën e Lihtenshtainit	80
4. Tarifa rinovimi për kërkesat për patenta europiane (Neni 86, paragrafi 1) llogaritur për çdo rast nga data e depozitimit të kërkesës	400
- për vitin e tretë	400
- për vitin e katërt	425
- për vitin e pestë	450
- për vitin e gjashtë	745
- për vitin e shtatë	770
- për vitin e tetë	800
- për vitin e nëntë	1 010
- për vitin e dhjetë dhe çdo vit në vazhdim	1 065
5. Tarifë shtesë për pagesën e vonuar të një tarife rinovimi 10 % e tarifës së rinovimit të vonuar Për kërkesën për patentë europiane (Rregulli 51, paragrafi 2)	
6. Tarifa e shqyrtimit (Neni 94, paragrafi 1)	
- një kërkesë depozituar para datës 1 korrik 2005	1 490
- një kërkesë depozituar më ose pas datës 1 korrik 2005	1 335
- një kërkesë ndërkombëtare të depozituar më ose pas datës 1 korrik 2005 për të cilën nuk përpilohet raport plotësues kërkitimi (Neni 153, paragrafi 7)	1 490
7. Tarifa për dhënien, duke përfshirë tarifën për printimin e specifikimit të patentës europiane (Rregulli 71, paragrafi 3), ku dokumentet e kërkesës që printohen përbëhen nga:	
7.1 jo më shumë se 35 faqe	750
7.2 më shumë se 35 faqe	750
plus EUR 11 përfaqen e 36të dhe çdo faqe pasuese	

¹ Shih vendimin e Këshillit Administrativ të datës 11.10.2000 në lidhje me zgjedhjen e kësaj tarife në favor të shtetasve të shteteve të caktuara (GZ EPO 2000, 446).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

8. Tarifë për printimin e një specifíkimi të ri të patentës europiane (Rregulli 82, paragrafi 2, Rregulli 95, paragrafi 3)- tarifë e prerë	55
9. Tarifë shtesë për kryerjen e vonuar të veprimeve për të mbajtur patentën europiane në formën e ndryshuar (Rregulli 82, paragrafi 3, Rregulli 95, paragrafi 3)	
- tarifë e prerë	100
10. Tarifë e kundërshtimit (Neni 99, paragrafi 1, dhe Neni 105, paragrafi 2)	635
10a. Tarifa e kufizimit ose revokimit (Neni 105a, paragrafi 1)	
- kërkesë për kufizim	1 000
- kërkesë për revokim	450
11. Tarifë për ankime (Neni 108)	1 065
11a. Tarifë e kërkesës për rishikim (Neni 112a, paragrafi 4)	2 500
12. Tarifë për trajtim të mëtejshëm (Rregulli 135, paragrafi 1)	
- në rastin e pagesës së vonuar të një tarife	50% të tarifës përkatëse
- në rastin e kryerjes së vonuar të veprimeve të kërkuara sipas Rregullit 71, paragrafi 3	210
- raste të tjera	210
13. Tarifë për rivendosjen e të drejtave / tarifë për kërkesën për rivendosjen e të drejtave (Rregulli 136, paragrafi 1, Rregulli 26bis.3(d) PCT, Rregulli 49ter.2(d) PCT)	550
14. Tarifë konvertimi (Neni 135, paragrafi 3, dhe Neni 140)	55
14a. Tarifë për dhënien e vonuar të listë së renditjes (Rregulli 30, paragrafi 3)	200
15. Tarifa e pretendimeve për pretendimin e njëmbëdhjetë dhe çdo pretendim pasues (Rregulli 45, paragrafi 1, Rregulli 71, paragrafi 7, dhe Rregulli 162, paragrafi 1)	45
16. Tarifë për caktimin e shpenzimeve (Rregulli 88, paragrafi 3)	55
17. Tarifë për ruajtjen e provave (Rregulli 123, paragrafi 3)	55
18. Tarifë e transmetimit për një kërkesë ndërkombëtare (Rregulli 157, paragrafi 4)	105
19. Tarifë për shqyrtimin paraprak të një kërkesë ndërkombëtare (Rregulli 58 PCT dhe Rregulli 158, paragrafi 2)	1 595 ¹
20. Tarifë për një mendim teknik (Neni 25)	3 185
21. Tarifa e protestës (Rregullat 40.2(e) dhe 68.3(e) PCT)	
- për kërkesat ndërkombëtare në shqyrtim e sipër më (data e hyrjes në fuqi e EPC 2000)	1 065
- për kërkesat ndërkombëtare të depozituara më ose pas (data e hyrjes në fuqi e EPC 2000) (Rregulli 158, paragrafi 3)	750

¹ Shih vendimin e Këshillit Administrativ të datës 11.10.2000 në lidhje me zgjedhjen e kësaj tarife në favor të shtetasve të shteteve të caktuar (GZ EPO 2000, 446).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 3¹

Tarifat, shpenzimet dhe çmimet e caktuara nga Kryetari i Zyrës

1. Kryetari i Zyrës cakton shumën e tarifave administrative të parashikuara në Rregulloret Zbatuese dhe, sipas rastit, shumën e tarifave dhe shpenzimeve për çdo shërbim të dhënë nga Zyra të ndryshëm nga ato që përcaktohen në nenin 2.
2. Ai cakton gjithashtu çmimet për publikimin e përmendur në nenet 93, 98, 103 dhe 129 të Konventës.
3. Shumat e tarifave të parashikuara në Nenin 2 dhe të tarifave dhe shpenzimeve të parashikuara në pajtim me paragrafin 1 publikohen në Gazetën Zyrtare dhe në faqen e internetit të Zyrës së Patentave Europiane.

Neni 4

Data e kërkueshme e tarifave

1. Tarifat në lidhje me të cilat data e kërkueshme nuk përcaktohet në dispozitat e Konventës ose të PCT-së ose të Rregulloreve zbatuese të saj bëhen të kërkueshme në datën e marrjes së kërkesës për shërbimin që shkakton tarifën përkatëse.
2. Kryetari i Zyrës mund të vendosë të mos japë shërbime në kuptimin e paragrafit 1 në varësi të parapagesës së tarifës përkatëse.

Neni 5

Pagesa e tarifave

1. Tarifat e kërkueshme nga Zyra paguhen në Euro:
 - a) me pagesë ose transfertë në një llogari bankare që mbahet nga Zyra;
 - b) me pagesë ose transfertë në një llogari rrjedhëse që mbahet nga Zyra, ose
 - c) dorëzim ose dërgim çeku të pagueshëm për Zyrën.
- 2.² Kryetari i Zyrës mund të lejojë metoda të tjera të pagesës së tarifave të ndryshme nga ato të caktuara në paragrafin 1.

Neni 6

Hollësi në lidhje me pagesat

1. Çdo pagesë duhet të tregojë emrin e personit që bën pagesën dhe duhet të përmbajë hollësitë e nevojshme për t'i mundësuar Zyrës të përcaktojë menjëherë qëllimin e pagesës.
2. Nëse qëllimi i pagesës nuk mund të përcaktohet menjëherë, Zyra i kërkon personit që bën pagesat të njoftojë me shkrim këtë qëllim brenda një afati që ai cakton. Nëse ai nuk e përmbush këtë kërkesë në kohën e duhur, pagesa konsiderohet të mos jetë bërë.

Neni 7

Data që konsiderohet si datë e kryerjes së pagesës

1. Data në të cilën një pagesë do të konsiderohet që i është bërë Zyrës është si më poshtë:
 - a) në rastet e përmendura në Nenin 5, paragrafi 1(a) dhe (b): data në të cilën shuma e pagesës ose e transfertës futet faktikisht në llogarinë bankare ose llogarinë rrjedhëse që mbahet nga Zyra;
 - b) në rastin e përmendur në Nenin 5, paragrafi 1(c): data e marrjes së çekut nga Zyra, me kusht që çekut të shndërrohet në para.
2. Nëse Kryetari i Zyrës lejon, në pajtim me dispozitat e Nenit 5, paragrafi 2, metoda të tjera të pagesës së tarifave të ndryshme nga ato të parashikuara në Nenin 5, paragrafi 1, ai përcakton edhe datën në të cilën këto pagesa konsiderohen të jenë bërë.
3. Nëse, në bazë të dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2, pagesa e një tarife nuk konsiderohet të jetë bërë deri pas skadimit të periudhës në të cilën ajo duhej të ishte bërë, konsiderohet që ky afat është respektuar nëse Zyrës i jepen prova që personi i cili ka bërë pagesën:

¹ Shih vendimin e Kryetarit të EPO-së, Botim i Veçantë nr 3, GZ EPO 2007, M. 1.

² Shih Masat për llogaritë e depozitave (Shoqëruese e GZ EPO 10/2007)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

a) ka përmbushur një prej kushteve të mëposhtme në një Shtet Kontraktues brenda afatit në të cilin duhej të ishte bërë pagesa:

- i) ai ka bërë pagesën nëpërmjet një institucioni bankar ose postë;
- ii) ai ka bërë rregullisht porosinë në një institucion bankar ose postë për të transferuar shumën e pagesës;
- iii) ai ka dërguar me postë një letër që ka adresën e Zyrës dhe që përmban një çek në kuptimin e Nenit 5, paragrafi 1(c), me kusht që çeku të shndërrohet në para, dhe

b) ka paguar një tarifë shtesë 10% mbi tarifën ose tarifat përkatëse, por që nuk kalin 150 Euro; nuk paguhet tarifë shtesë nëse një kusht sipas nën-paragrafit (a) është përmbushur jo më vonë se dhjetë ditë para skadimit të afatit të pagesës.

4. Zyra mund të kërkojë që personi që ka bërë pagesën të japë prova në lidhje me datën në të është përmbushur një kusht në pajtim me paragrafin 3(a) dhe, sipas rastit, të paguajë tarifën shtesë të përmendur në paragrafin 3(b), brenda afatit që duhet të specifikohet prej tij. Nëse ai nuk e përmbush këtë kërkesë ose nëse provat janë të pamjaftueshme, ose nëse tarifa shtesë e kërkuar nuk paguhet në kohën e duhur, afati i pagesës nuk konsiderohet të jetë respektuar.

Neni 8

Pamjaftueshmëria e shumës së paguar

1. Një afat kohor për pagesën në parim konsiderohet të jetë respektuar vetëm nëse shumë plotë e tarifës është paguar në kohën e duhur. Nëse tarifa nuk paguhet e plotë, shumë që është paguar kthehet pas skadimit të afatit të pagesës. Megjithatë, Zyra, në masën që kjo është e mundur brenda kohës së mbetur para skadimit të afatit, i jep personit që bën pagesën mundësinë për të paguar pjesën diferencën. Gjithashtu, nëse kjo konsiderohet e justifikuar, ajo mund të mos marrë parasysh diferencat e vogla të papaguara pa cenuar të drejtat e personit që bën pagesën.

2. Nëse shumë e paguar si tarifa përcaktimi është e pamjaftueshme për të mbuluar tarifat e përcaktimit që paguhet për të gjithë Shtetet Kontraktuese, shumë e paguar zbatohet në pajtim me specifikimet e bëra nga kërkuesi jo më vonë se në momentin e pagesës. Nëse kërkuesi nuk bën specifikime të tilla, tarifat konsiderohen të jenë paguar vetëm për ato përcaktime që mbulohen nga shumë e paguar dhe në renditjen në të cilën Shtetet Kontraktuese renditen në kërkesën për dhënie.

Neni 9

Kthimi i tarifës së kërkimit

1. Tarifa e kërkimit e paguar për një kërkim europian ose europian plotësues kthehet plotësisht nëse kërkesa për patentë europiane tërhiqet ose refuzohet ose konsiderohet të tërhiqet në momentin kur Zyra nuk ka filluar akoma të përpilojë raportin e kërkimit.

2.¹ Nëse raporti i kërkimit europian nuk bazohet në një raport kërkimi të mëparshëm të përgatitur nga Zyra në një kërkesë prioriteti i së cilës pretendohet ose në një kërkesë në kuptimin e Nenit 76 të Konventës ose të Rregullit 17 të Konventës, Zyra i kthen kërkuesit, në pajtim me një vendim të Kryetarit të saj, një shumë që varet nga tipi i kërkimit të mëparshëm dhe masa në të cilën Zyra përfiton nga një raport kërkimi i mëparshëm kur kryhen një raport pasues kërkimi.

Neni 10

Kthimi i tarifës për një mendim teknik

Një shumë prej 75% të tarifës për një mendim teknik sipas Nenit 25 të Konventës kthehet nëse kërkesa për një mendim teknik tërhiqet në momentin kur Zyra nuk ka filluar akoma të përpilojë mendimin teknik.

¹ Shih vendimin e Kryetarit të EPO-së mbi ri-imbursimin e tarifave të kërkimit, Botimi i veçantë nr 3, GZ EPO 2007, M. 2, përditësime të mëvonshme të këtij vendimi publikuar në GZ EPO dhe Njoftimi nga Kryetari i EPO-së, të datës 01.07.2005 në lidhje me kriteret për ri-imbursimin e tarifave të kërkimit (GZ EPO 2005, 433 e në vazhdim, 520).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 11¹

Kthimi i tarifës së shqyrtimit

Tarifa e shqyrtimit e parashikuar në Nenin 94, paragrafi 1, i Konventës kthehet:

- a) plotësisht nëse kërkesa për patentë europiane tërhiqet, rrëzohet ose konsiderohet të jetë tërhequr para se Sektorët e Ekzaminimit të kenë marrë përsipër përgjegjësi;
- b) në një masë prej 75% nëse kërkesa për patentë europiane tërhiqet, rrëzohet ose konsiderohet të jetë tërhequr pasi Sektorët e Ekzaminimit të kenë marrë përsipër përgjegjësi, por para se të ketë filluar shqyrtimi lëndës.

Neni 12²

Kthimi i shumave të pakonsiderueshme

Nëse paguhet një shumë më e madhe për të mbuluar një tarifë, teprica nuk kthehet nëse shumat është e pakonsiderueshme dhe pala e interesuar nuk ka kërkuar shprehimisht kthimin. Kryetari i Zyrës përcakton se cila është një shumë e parëndësishme

Neni 13

Vendimet që përcaktojnë shpenzimet e ankimueshme

Në pajtim me Rregullin 97, paragrafi 2, i Konventës, vendimet që përcaktojnë shumat e shpenzimeve të procedimit të kundërshtimit mund të ankimohen nëse shumat është më e madhe se tarifa e ankimit.

Neni 14

Pakësimi i tarifave

1. Pakësimi i parashikuar në Rregullin 6, paragrafi 3, i Konventës është 20% e tarifës së depozitimit, tarifës së shqyrtimit, tarifës së kundërshtimit, tarifës së ankimit tarifës për rishikim ose kufizim ose tarifës së anulimit.
2. Nëse Zyra e Patentave Europiane ka hartuar një raport të kerkimit paraprak ndërkombëtar, tarifa e shqyrtimit do të pakësohet më 50%. Nëse raporti është përpiluar për pjesë të caktuara të kërkesës ndërkombëtare në pajtim me Nenin 34, paragrafi 3(c), PCT, tarifa nuk pakësohet nëse objekti që nuk mbulohet nga raporti duhet të shqyrtohet.

Neni 15

Hyrja në Fuqi

Këto rregulla hyjnë në fuqi më 20 tetor 1977*.

Bërë në Mynih, 20 tetor 1977

Për Këshillin Administrativ

Kryetari

*** Ndryshuar me endim të këshillit Administrativ
të datës 7 dhjetor 2006 (CA/D 11/06)**

¹ Shih vendimin e Bordit të Zgjeruar të Ankimeve G 3/03 (Aneksi I); shih gjithashtu Njoftimin e Kryetarit të EPO-së, GZ EPO 1988, 354.

² Shih vendimin e Kryetarit të EPO-së, botim i veçantë nr 3, GZ EPO 2007, M. 3.

LIGJ
Nr. 33/2018

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN E LOKARNOS
“PËR PËRCAKTIMIN E NJË KLASIFIKIMI NDËRKOMBËTAR PËR DISENJOT
INDUSTRIALE”¹

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen e Lokarnos “Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për disenjot industriale”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 7.6.2018

Shpallur me dekretin nr. 10814, datë 25.6.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJA E LOKARNOS
PËR PËRCAKTIMIN E NJË KLASIFIKIMI NDËRKOMBËTAR PËR DISENJOT INDUSTRIALE
E nënshkruar në Lokarno, më 8 tetor 1968
dhe e ndryshuar më 28 shtator 1979

Neni 1

Themelimi i një Unioni të Posaçëm; miratimi i një Klasifikimi Ndërkombëtar

1. Vendet ku zbatohet kjo Marrëveshje përbëjnë një Union të Posaçëm.
2. Këto vende miratojnë një klasifikim të vetëm për disenjot industriale (në vijim i referuar si “Klasifikimi Ndërkombëtar”).
3. Klasifikimi Ndërkombëtar përbëhet nga:
 - i. një listë e klasave dhe e nënklasave;
 - ii. një listë alfabetike e mallrave ku përfshihen disenjot industriale, me një tregues të klasave dhe nënklasave ku ato kategorizohen;
 - iii. shënime shpjeguese.
4. Lista e klasave dhe e nënklasave është lista bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje, objekt i këtyre ndryshimeve dhe shtesave, siç përcaktohet nga Komiteti i Ekspertëve, sipas nenit 3 (në vijim i referuar si “Komiteti i Ekspertëve”).
5. Lista alfabetike e mallrave dhe e shënimeve shpjeguese miratohet nga Komiteti i Ekspertëve, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 3.
6. Klasifikimi Ndërkombëtar mund të ndryshohet ose plotësohet nga Komiteti i Ekspertëve, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 3.
7. a) Klasifikimi Ndërkombëtar hartohet në gjuhët angleze dhe frënge.
b) Tekstet zyrtare të Klasifikimit Ndërkombëtar, në gjuhë të tjera, siç mund të përcaktohen nga Asambleja e përmendur në nenin 5, përcaktohen pas konsultimit me qeveritë e interesuara, nga Byroja Ndërkombëtare e

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr. 97. Tiranë, 2018. f. 6111

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Pronësisë Intelektuale (në vijim e referuar si “Byroja Ndërkombëtare”), e përmendur në Konventën për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (në vijim e referuar si “Organizata”).

Neni 2

Përdorimi dhe fusha ligjore e veprimit të Klasifikimit Ndërkombëtar

1. Sipas kërkesave të përshkruara në këtë Marrëveshje, Klasifikimi Ndërkombëtar ka vetëm karakter administrativ. Megjithatë, secili vend mund të vendosë atë fushë ligjore veprimi që e çmon të përshtatshme. Në veçanti, Klasifikimi Ndërkombëtar nuk i detyron vendet e Unionit të Posaçëm në lidhje me natyrën dhe objektin e mbrojtjes që u jepet dizenjove në ato vende.

2. Secili vend i Unionit të Posaçëm rezervon të drejtën për të përdorur Klasifikimin Ndërkombëtar si një sistem parësor ose sistem ndihmës.

3. Zyrtat e vendeve të Unionit të Posaçëm duhet të përfshijnë në dokumentet zyrtare për depozitim ose për regjistrimin e dizenjove dhe, nëse janë botuar zyrtarisht, në botimet në fjalë, numrat e klasave dhe të nënklasave të Klasifikimit Ndërkombëtar ku kategorizohen mallrat që i përkasin dizenjosh.

4. Në përzgjedhjen e kushteve për përfshirjen në listën alfabetike të mallrave, Komiteti i Ekspertëve tregon kujdes të arsyeshëm për shmangien e përdorimit të kushteve ku mund të ekzistojnë të drejtat ekskluzive. Megjithatë, përfshirja e ndonjë fjale në indeksin alfabetik nuk përbën shprehje të opinionit të Komitetit të Ekspertëve në lidhje me faktin nëse është objekt i të drejtave ekskluzive apo jo.

Neni 3

Komiteti i Ekspertëve

1. Komitetit të Ekspertëve i besohen detyrat e përmendura në nenin 1, paragrafët 4 dhe 5 dhe në nenin 1, paragrafi 6. Çdo vend i Unionit të Posaçëm përfaqësohet në Komitetin e Ekspertëve, i cili organizohet sipas rregullave të procedurës të miratuara me shumicë të thjeshtë të vendeve të përfaqësuara.

2. Komiteti i Ekspertëve miraton listën alfabetike dhe shënimet shpjeguese me shumicë të thjeshtë të votave të vendeve të Unionit të Posaçëm.

3. Propozimet për ndryshime ose shtesa në Klasifikimin Ndërkombëtar mund të kryhen nga zyra e çdo vendi të Unionit të Posaçëm ose nga Byroja Ndërkombëtare. Çdo propozim që paraqitet nga një zyre përcillet nga ajo zyre pranë Byrosë Ndërkombëtare. Propozimet nga zyrtat dhe Byroja Ndërkombëtare përcillen nga këto të fundit tek anëtarët e Komitetit të Ekspertëve jo më vonë se dy muaj para seancës së Komitetit ku do të shqyrtohen propozimet e lartpërmendura.

4. Vendimet e Komitetit të Ekspertëve, në lidhje me miratimin e ndryshimeve dhe të shtesave të Klasifikimin Ndërkombëtar, do të merren me shumicë të thjeshtë votash të vendeve të Unionit të Posaçëm. Megjithatë, nëse këto vendime sjellin krijimin e një klase të re ose transferim të mallrave nga njëra klasë në tjetrën, kërkohet unanimitet.

5. Çdo ekspert ka të drejtë të votojë me postë.

6. Nëse një vend nuk emëron një përfaqësues për një seancë të caktuar të Komitetit të Ekspertëve, ose nëse eksperti i emëruar nuk e ka hedhur votën e tij gjatë seancës ose brenda një afati të caktuar nga rregullat e procedurës së Komitetit të Ekspertëve, vendi në fjalë konsiderohet se e ka pranuar vendimin e Komitetit.

Neni 4

Njoftimi dhe botimi i klasifikimit dhe i ndryshimeve dhe shtesave të tyre

1. Lista alfabetike e mallrave dhe shënimet shpjeguese të miratuara nga Komiteti i Ekspertëve, si dhe çdo ndryshim ose shtim i Klasifikimit Ndërkombëtar të vendosur nga Komiteti, u përcillet zyrtarisht të vendeve të Unionit të Posaçëm nga Byroja Ndërkombëtare. Vendimet e Komitetit të Ekspertëve hyjnë në fuqi sapo ky komunikim të jetë pranuar. Megjithatë, nëse këto vendime sjellin krijimin e një klase të re ose transferimin e mallrave nga njëra klasë në tjetrën, ato hyjnë në fuqi brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data e komunikimit në fjalë.

2. Byroja Ndërkombëtare, si depozitare e Klasifikimit Ndërkombëtar, përfshin ndryshimet dhe shtesat që kanë hyrë në fuqi. Njoftimet e ndryshimeve dhe shtesave publikohen në botimin periodik që caktohet nga Asambleja.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 5

Asambleja e Unionit të Posaçëm

1. a) Unioni i Posaçëm ka një Asamble të përbërë nga vendet e Unionit të Posaçëm.
- b) Qeveria e secilit vend të Unionit të Posaçëm përfaqësohet nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegatë, këshilltarë dhe ekspertë të ndryshëm.
- c) Shpenzimet e secilit delegacion mbulohen nga qeveria që e ka caktuar atë.
2. a) Në bazë të dispozitave të nenit 3, Asambleja:
 - i. trajton të gjitha çështjet që lidhen me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Unionit të Posaçëm dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
 - ii. jep udhëzime për Byronë Ndërkombëtare në lidhje me përgatitjen për konferencat e rishikimit;
 - iii. shqyrton dhe miraton raportet dhe veprimtaritë e Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës (në vijim i referuar si “Drejtori i Përgjithshëm”) në lidhje me Unionin e Posaçëm dhe i jep atij të gjitha udhëzimet e nevojshme për çështjet që mbulohen nga Unioni i Posaçëm;
 - iv. përcakton programin dhe miraton buxhetin dyvjeçar të Unionit të Posaçëm dhe miraton llogaritë e tij përfundimtare;
 - v. miraton rregulloret financiare të Unionit të Posaçëm;
 - vi. vendos për hartimin e teksteve zyrtare të Klasifikimit Ndërkombëtar në gjuhë të ndryshme, përveç gjuhës angleze dhe frënge;
 - vii. themelon, përveç Komitetit të Ekspertëve, të krijuar sipas nenit 3, komitete të tjera ekspertësh dhe grupe pune që i çmon të përshtatshme për përbushjen e objektivave të Unionit të Posaçëm;
 - viii. përcakton cilat vende nuk janë anëtare të Unionit të Posaçëm dhe cilat organizata ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare do të pranohen në takimet e tyre në rolin e vëzhguesit;
 - ix. miraton ndryshime në nenet 5 deri 8;
 - x. ndërmerr çdo masë tjetër të përshtatshme që synon të zhvillojë më tej objektivat e Unionit të Posaçëm;
 - xi. kryen funksione të tjera të përshtatshme sipas kësaj Marrëveshjeje.
- b) Në lidhje me çështjet me interes edhe për sindikatat e tjera nën administrimin e Organizatës, Asambleja merr vendimet e saj, pasi të ketë dëgjuar këshillën e Komitetit Koordinues të Organizatës.
3. a) Çdo anëtar i vendit të Asamblesë gëzon një votë.
- b) Gjysma e vendeve anëtare të Asamblesë përbën një kuorum.
- c) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit “b”, nëse në ndonjë seancë numri i vendeve të përfaqësuara është më pak se gjysma, por i barabartë ose më i madh se një e treta e vendeve anëtare të Asamblesë, Asambleja mund të marrë vendime, por, me përjashtim të vendimeve që lidhen me procedurën e vet, të gjitha vendimet e tjera hyjnë në fuqi vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara më poshtë. Byroja Ndërkombëtare ua komunikon vendimet në fjalë vendeve anëtare të Asamblesë që nuk janë të përfaqësuara dhe i fton të hedhin me shkrim votën e tyre ose të abstenojnë brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e komunikimit. Nëse, pas skadimit të kësaj periudhe, numri i vendeve që kanë hedhur votën ose kanë abstenuar në këtë mënyrë arrin numrin e shteteve që mungonin për arritjen e kuorumit në seancë, këto vendime hyjnë në fuqi me kusht që në të njëjtën kohë të arrihet shumica e nevojshme.
- d) Në bazë të dispozitave të nenit 8, paragrafi 2, vendimet e Asamblesë kërkojnë dy të tretat e votave të hedhura.
- e) Abstenimet nuk konsiderohen si vota.
- f) Një delegat mund të përfaqësojë dhe të votojë vetëm në emër të një vendi.
4. a) Asambleja mbledhet një herë çdo vit të dytë kalendarik në seancë të zakonshme pas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm dhe, në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme, gjatë së njëjtës periudhë dhe në të njëjtin vend si Asambleja e Përgjithshme e Organizatës.
- b) Asambleja mbledhet në seancë të jashtëzakonshme pas thirrjes nga Drejtori i Përgjithshëm, me kërkesën e një të katërtës së vendeve anëtare të Asamblesë.
- c) Rendi i ditës i çdo seance përgatitet nga Drejtori i Përgjithshëm.
5. Asambleja miraton vetë rregulloren e saj të brendshme.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 6

Byroja Ndërkombëtare

1. a) Detyrimet administrative në lidhje me Unionin e Posaçëm përmbushen nga Byroja Ndërkombëtare.
b) Në veçanti, Byroja Ndërkombëtare përgatit mbledhjet dhe siguron Sekretariatin e Asamblesë, Komitetin e Ekspertëve dhe komitetet e tjera të ekspertëve dhe grupet e punës, siç janë krijuar nga Asambleja ose Komiteti i Ekspertëve.
c) Drejtori i Përgjithshëm është drejtuesi ekzekutiv i Unionit të Posaçëm dhe përfaqëson Unionin e Posaçëm.
2. Drejtori i Përgjithshëm dhe çdo anëtar tjetër i stafit të caktuar prej tij merr pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha mbledhjet e Asamblesë, të Komitetit të Ekspertëve dhe të komiteteve të tjera të ekspertëve ose të grupeve të punës që mund të jenë krijuar nga Asambleja ose Komiteti i Ekspertëve. Drejtori i Përgjithshëm ose një anëtar tjetër i stafit të caktuar prej tij është sekretar *ex officio*/i caktuar kryesisht i këtyre organeve.
3. a) Byroja Ndërkombëtare, në përputhje me udhëzimet e Asamblesë, kryen përgatitjet për konference të rishikimit të dispozitave të Marrëveshjes, përveç dispozitave të neneve 5 deri në 8.
b) Byroja Ndërkombëtare mund të konsultohet me organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare në lidhje me përgatitjet për konferencat e rishikimit.
c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet e zhvilluara në këto konferenca.
4. Byroja Ndërkombëtare kryen çdo detyrë tjetër që i është caktuar.

Neni 7

Financat

1. a) Unioni i Posaçëm ka një buxhet.
b) Buxheti i Unionit të Posaçëm përfshin të ardhurat dhe shpenzimet që i takojnë Unionit të Posaçëm, kontributin e tij në buxhetin e shpenzimeve të përbashkëta për sindikatat dhe sipas rastit, shumën e vënë në dispozicion të buxhetit të konferencës së Organizatës.
c) Shpenzimet që nuk i atribuohen ekskluzivisht Unionit të Posaçëm, por as ndonjë apo më shumë sindikatave të tjera të administruara nga Organizata, konsiderohen si shpenzime të përbashkëta për sindikatat. Pjesa e këtyre shpenzimeve të përbashkëta që i takon Unionit të Posaçëm është në raport me interesin e Unionit të Posaçëm në to.
2. Buxheti i Unionit të Posaçëm krijohet duke pasur parasysh kërkesat e koordinimit me buxhetet e sindikatave të tjera të administruara nga Organizata.
3. Buxheti i Unionit të Posaçëm financohet nga burimet e mëposhtme:
 - i. kontributet e vendeve të Unionit të Posaçëm;
 - ii. tarifatat dhe detyrimet për shërbime të kryera nga Byroja Ndërkombëtare në lidhje me Unionin e Posaçëm;
 - iii. shitjen e/ose honorarët nga botimet e Byrosë Ndërkombëtare, në lidhje me Unionin e Posaçëm;
 - iv. dhuratat, trashëgimia dhe subvencionet;
 - v. qiratë, interesat dhe të ardhura të tjera të ndryshme.
4. a) Për qëllimin e përcaktimit të kontributit të përmendur në paragrafin 3, germa “i”, secili vend i Unionit të Posaçëm i përket së njëjtës klasë që i përket në Unionin e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe paguan kontributet e tij vjetore në bazë të njësive të përcaktuara për atë klasë në atë Union.
b) Kontributi vjetor i secilit vend të Unionit të Posaçëm është shuma në raport me shumën totale që duhet të paguhet në buxhetin e Unionit të Posaçëm nga të gjitha vendet, sipas numrit të njësive në totalin e njësive të të gjitha vendeve kontribuese.
c) Kontributet duhet të paguhet në fillim të muajit janar të çdo viti.
d) Vendi që nuk paguan kontributin e tij nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij të votës në asnjë organ të Unionit të Posaçëm, nëse shuma e detyrimit të tij është e barabartë ose më e madhe se shuma e kontributeve që i detyrohen atij për dy vitet e plotë të mëparshme. Megjithatë, çdo organ i Unionit të Posaçëm mund të lejojë që ky vend të vazhdojë të ushtrojë të drejtën e tij të votës në atë organ, nëse dhe për sa kohë që bindet se vonesa e pagesës ka ndodhur për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të pashmangshme.
e) Nëse buxheti nuk miratohet para fillimit të një periudhe të re financiare, ai duhet të jetë në të njëjtin nivel me buxhetin e vitit paraprak, siç parashikohet në rregulloret financiare.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

5. Duhet të vendoset shuma e tarifave dhe e detyrimeve për shërbimet e kryera nga Byroja Ndërkombëtare, në lidhje me Unionin e Posaçëm dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i raportojë Asamblesë këtë shumë.

6. a) Unioni i Posaçëm ka një fond të kapitalit qarkullues, i cili përbëhet nga një pagesë e vetme e kryer nga çdo vend i Unionit të Posaçëm. Nëse ky fond bëhet i pamjaftueshëm, Asambleja vendos ta rrisë atë.

b) Shuma e pagesës fillestare të secilit vend në fondin në fjalë ose pjesëmarrja e tij në rritjen e këtij fondi është pjesë e kontributit të atij vendi për vitin kur është krijuar ky fond ose kur është marrë vendimi për rritjen e tij.

c) Pjesa dhe kushtet e pagesës përcaktohen nga Asambleja me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe pasi të ketë dëgjuar këshillat e Komitetit Koordinues të Organizatës.

7. a) Në Marrëveshjen për selinë, të nënshkruar me vendin në territorin e të cilit Organizata ka selinë, duhet të parashikohet që sa herë që fondi i kapitalit qarkullues të jetë i pamjaftueshëm, ky vend duhet të paguajë pagesa paraprake. Shuma e këtyre pagesave paraprake dhe kushtet e pagesës u nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta, në çdo rast, ndërmjet këtij vendi dhe Organizatës.

b) Vendi i përmendur në nënparagrafin "a" dhe Organizata kanë të drejtë të përfundojnë detyrimin për dhënien e pagesave paraprake, nëpërmjet një njoftimi me shkrim. Prishja e Marrëveshjes hyn në fuqi tre vjet pas përfundimit të vitit kur është njoftuar.

8. Auditimi i llogarive kryhet nga një ose më shumë vende të Unionit të Posaçëm ose nga auditues të jashtëm, siç parashikohet në rregulloret financiare. Ato përcaktohen nga Asambleja me miratimin e tyre.

Neni 8

Ndryshimi i neneve 5 deri në 8

1. Propozimet për ndryshimin e neneve 5, 6, 7 dhe të këtij neni mund të iniciohen nga çdo vend i Unionit të Posaçëm ose nga Drejtori i Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm u komunikon këto propozime vendeve të Unionit të Posaçëm, të paktën gjashtë muaj para shqyrtimit të tyre nga Asambleja.

2. Ndryshimet në nenet e përmendura në paragrafin 1 miratohen nga Asambleja. Ky miratim kërkon tri të katërtat e votave të hedhura, me kusht që çdo ndryshim i nenit 5 dhe i këtij paragrafi të kërkojë katër të pestat e votave të hedhura.

3. Çdo ndryshim i neneve të përmendura në paragrafin 1 hyn në fuqi një muaj pasi njoftimet me shkrim të pranimit, të miratuara në përputhje me proceset e tyre përkatëse kushtetuese, të jenë pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm nga tri të katërtat e vendeve anëtare të Unionit të Posaçëm në momentin e miratimit të këtij ndryshimi. Çdo ndryshim i këtyre neneve të pranuar në këtë mënyrë i detyron të gjitha vendet anëtare të Unionit të Posaçëm në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimit ose vendet që anëtarësohen pas kësaj date, me kusht që çdo ndryshim që rrit detyrimet financiare të vendeve të Unionit të Posaçëm të jetë detyrues vetëm për ato vende që kanë njoftuar pranimin e këtyre ndryshimeve.

Neni 9

Ratifikimi dhe aderimi; hyrja në fuqi

1. Çdo shtet palë në Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale që ka nënshkruar këtë Marrëveshje mund ta ratifikojë atë dhe, nëse nuk e ka nënshkruar këtë Marrëveshje, mund të aderojë në të.

2. Instrumentet e ratifikimit dhe të aderimit depozitohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

3. a) Në lidhje me pesë vendet e para që kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose të aderimit, kjo Marrëveshje hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të pestë.

b) Për sa i përket çdo vendi tjetër, kjo Marrëveshje hyn në fuqi tre muaj pas datës kur Drejtori i Përgjithshëm njofton për ratifikimin ose aderimin e saj, përveç nëse në instrumentin e ratifikimit ose të aderimit shënohet ndonjë datë e mëvonshme. Në rastin e fundit, kjo Marrëveshje hyn në fuqi vetëm për atë vend në datën e shënuar për këtë qëllim.

4. Ratifikimi ose aderimi sjell automatikisht pranimin e të gjitha klauzolave dhe pranimin e të gjitha përparësive të kësaj Marrëveshjeje.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 10

Zbatimi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje ka të njëjtën fuqi dhe kohëzgjatje si Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

Neni 11

Rishikimi i neneve 1 deri 4 dhe 9 deri 15

1. Nenet 1 deri 4 dhe 9 deri 15 të kësaj Marrëveshjeje mund të dërgohen për rishikim, me synim paraqitjen e përmirësimeve të dëshiruara.

2. Çdo rishikim do të shqyrtohet në një konferencë që do të zhvillohet ndërmjet delegatëve të vendeve të Unionit të Posaçëm.

Neni 12

Prishja e Marrëveshjes

1. Çdo vend mund ta prishë këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm. Prishja e kësaj Marrëveshjeje cenon vetëm vendin që prish Marrëveshjen, dhe Marrëveshja mbetet në fuqi dhe me efekt të plotë për vendet e tjera të Unionit të Posaçëm.

2. Prishja e Marrëveshjes hyn në fuqi një vit pas datës kur Drejtori i Përgjithshëm merr njoftimin.

3. E drejta e prishjes së Marrëveshjes e parashikuar në këtë nen nuk ushtrohet nga asnjë vend para përfundimit të afatit pesëvjeçar nga data kur ky vend bëhet anëtar i Unionit të Posaçëm.

Neni 13

Territoret

Dispozitat e nenit 24 të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale zbatohen për këtë Marrëveshje.

Neni 14

Nënshkrimi, gjuha, njoftimet

1. a) Kjo Marrëveshje nënshkruhet në një kopje të vetme në gjuhët angleze dhe frënge, ku tekstet në të dyja gjuhët janë njëllorj autentike dhe depozitohen në qeverinë e Zvicrës.

b) Kjo Marrëveshje mbetet e hapur për nënshkrim në Bernë, deri më 30 qershor 1969.

2. Tekstet zyrtare përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimit me qeveritë e interesuara, në gjuhë të tjera, siç përcaktohen nga Asambleja.

3. Drejtori i Përgjithshëm përcjell dy kopje të tekstit të nënshkruar të kësaj Marrëveshjeje, të certifikuara nga qeveria e Zvicrës, qeverive të vendeve që e kanë nënshkruar atë dhe, me kërkesë të tyre, qeverisë së çdo vendi tjetër.

4. Drejtori i Përgjithshëm e regjistron këtë Marrëveshje në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara.

5. Drejtori i Përgjithshëm njofton qeveritë e të gjitha vendeve të Unionit të Posaçëm për datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, nënshkrimit, depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të aderimit, pranimit e ndryshimeve të kësaj Marrëveshjeje dhe datat e hyrjes në fuqi të këtyre marrëveshjeve, dhe njoftimet e prishjes së marrëveshjeve.

Neni 15

Dispozita kalimtare

Derisa Drejtori i parë Përgjithshëm të marrë detyrën, referencat në këtë Marrëveshje për Byronë Ndërkombëtare të Organizatës ose për Drejtorin e Përgjithshëm konsiderohen përkatësisht si referenca për Byrotë e Bashkuara Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Pronësisë Intellektuale (BIRPI) ose për drejtorin e kësaj zyre.

LIGJ
Nr. 34/2018

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN
E VJENËS “PËR KLASIFIKIMIN NDËRKOMBËTAR TË ELEMENTEVE FIGURATIVE
TË MARKAVE TREGTARE”¹**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen e Vjenës “Për klasifikimin ndërkombëtar të elementeve figurative të markave tregtare”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.6.2018

Shpallur me dekretin nr. 10815, datë 25.6.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJA E VJENËS
PËR KLASIFIKIMIN NDËRKOMBËTAR
TË ELEMENTEVE FIGURATIVE TË MARKAVE TREGTARE

E nënshkruar në Vjenë, më 12 qershor 1973,
e ndryshuar më 1 tetor 1985

TABELË E LËNDËS*

- Neni 1. Themelimi i një Unioni të Posaçëm; miratimi i një Klasifikimi Ndërkombëtar
- Neni 2. Përkufizimi dhe depozitimi i Klasifikimit të Elementeve Figurative
- Neni 3. Gjuhët e Klasifikimit të Elementeve Figurative
- Neni 4. Përdorimi i Klasifikimit të Elementeve Figurative
- Neni 5. Komiteti i Ekspertëve
- Neni 6. Njoftimi, hyrja në fuqi dhe botimi i ndryshimeve, shtesave dhe vendimeve të tjera
- Neni 7. Asambleja e Unionit të Posaçëm
- Neni 8. Byroja Ndërkombëtare
- Neni 9. Financat
- Neni 10. Rishikimi i Marrëveshjes
- Neni 11. Ndryshime të disa dispozitave të caktuara të Marrëveshjes
- Neni 12. Të bërit palë në këtë Marrëveshje
- Neni 13. Hyrja në fuqi e Marrëveshjes
- Neni 14. Kohëzgjatja e Marrëveshjes
- Neni 15. Prishja e Marrëveshjes
- Neni 16. Mosmarrëveshjet
- Neni 17. Nënshkrimi, gjuhët, funksionet e depozitarit, njoftimet

Palët Kontraktuese,

duke pasur parasysh nenin 19 të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale të 20 marsit 1883, të rishikuar në Bruksel më 14 dhjetor 1900, në Uashington më 2 qershor 1911, në Hagë më 6 nëntor 1925, në Londër më 2 qershor 1934, në Lisbonë më 31 tetor 1958 dhe në Stokholm më 14 korrik 1967,

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr. 97. Tiranë, 2018. f. 6116

* Kjo tabelë e lëndës shtohet për lehtësinë e lexuesit. Ajo nuk përfshihet në tekstin e nënshkruar të Marrëveshjes.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Themelimi i Unionit të Posaçëm; miratimi i Klasifikimit Ndërkombëtar

Vendet ku zbatohet kjo Marrëveshje formojnë Unionin e Posaçëm dhe miratojnë klasifikimin e përbashkët për elementet figurative të markave (në vijim i referuar si “Klasifikimi i Elementeve Figurative”).

Neni 2

Përkufizimi dhe depozitimi i Klasifikimit të Elementeve Figurative

1. Klasifikimi i Elementeve Figurative përbëhet nga lista e kategorive, ndarjeve dhe seksioneve ku klasifikohen elementet figurative të markave, bashkë me shpjegimet përkatëse, sipas rastit.

2. Klasifikimi i Elementeve Figurative është përpiluar në një dokument origjinal, në gjuhën angleze dhe frënge, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore për Pronësinë Industriale (në vijim i referuar si “Drejtori i Përgjithshëm” dhe “Organizata”), në momentin kur kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim.

3. Ndryshimet dhe shtesat e përmendura në nenin 5, paragrafi 3, germa “i” përpilohen, gjithashtu, në një dokument origjinal në gjuhën angleze dhe frënge, të nënshkruar nga/dhe të depozituara te Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 3

Gjuhët e Klasifikimit të Elementeve Figurative

1. Klasifikimi i Elementeve Figurative është përpiluar në gjuhën angleze dhe franceze, ku të dyja tekstet janë njëllor origjinale.

2. Byroja Ndërkombëtare e Organizatës (në vijim e referuar si “Byroja Ndërkombëtare”), në konsultim me qeveritë e interesuara, përpilon një tekst zyrtar të Klasifikimit të Elementeve Figurative, në gjuhët e caktuara nga Asambleja, sipas nenit 7, në përputhje me paragrafin 2, germa “a”, pika “vi” të atij neni.

Neni 4

Përdorimi i Klasifikimit të Elementeve Figurative

1. Në bazë të kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, objekti i Klasifikimit të Elementeve Figurative është ai që jepet nga çdo vend i Unionit të Posaçëm. Në veçanti, Klasifikimi i elementeve figurative nuk i detyron vendet e Unionit të Posaçëm në lidhje me shkallën e mbrojtjes që i jepet kësaj marke.

2. Zyrtat kompetente në vendet e Unionit të Posaçëm kanë të drejtë ta përdorin Klasifikimin e Elementeve Figurative si sistem kryesor ose si sistem ndihmës.

3. Zyrtat kompetente të vendeve të Unionit të Posaçëm, në dokumentet dhe botimet zyrtare që lidhen me regjistrimin e markave dhe me rinovimin e tyre, duhet të përfshijnë numrat e kategorive, ndarjeve dhe seksioneve ku vendosen elementet figurative të asaj marke.

4. Para këtyre numrave duhet të vendosen fjalët “Klasifikimi i Elementeve Figurative” ose shkurtimi i tyre, i cili përcaktohet nga Komiteti i Ekspertëve, i përmendur në nenin 5.

5. Çdo vend, në momentin e nënshkrimit apo të depozitimit të instrumentit për ratifikim ose për aderim, mund të deklarojë se nuk merr përsipër t’i përfshijë numrat e të gjitha apo të disa seksioneve në dokumentet zyrtare dhe botimet që lidhen me depozitimin e markave dhe rinovimin e tyre.

6. Nëse ndonjë vend i Unionit të Posaçëm ia beson regjistrimin e markave ndonjë autoriteti ndërqeveritar, ai ndërmerret të gjitha masat për të garantuar që ky autoritet të shfrytëzojë Klasifikimin e Elementeve Figurative në përputhje me këtë nen.

Neni 5

Komiteti i Ekspertëve

1. Duhet të krijohet një Komitet i Ekspertëve ku do të përfaqësohet çdo vend i Unionit të Posaçëm.

2.

a) Drejtori i Përgjithshëm mund dhe, nëse kërkohet nga Komiteti i Ekspertëve, duhet të ftojë edhe vendet

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

që nuk janë anëtare të Unionit të Posaçëm, të cilat janë anëtarë të Organizatës ose Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, që të marrin pjesë si vëzhgues në takimet e Komitetit të Ekspertëve.

b) Drejtori i Përgjithshëm fton organizatat ndërqeveritare të specializuara në fushën e markave, prej të cilave të paktën një nga vendet anëtare të jetë palë në këtë Marrëveshje, që të marrin pjesë si vëzhgues në takimet e Komitetit të Ekspertëve.

c) Drejtori i Përgjithshëm mund dhe, nëse kërkohet nga Komiteti i Ekspertëve, duhet të ftojë përfaqësues të organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare ndërkombëtare të marrin pjesë në diskutime në interes të tyre.

3. Komiteti i Ekspertëve duhet:

- i. të kryejë ndryshime dhe shtesa të Klasifikimit të Elementeve Figurative;
- ii. të dërgojë rekomandime te vendet e Unionit të Posaçëm, me qëllim lehtësimin e përdorimit të Klasifikimit të Elementeve Figurative dhe nxitjen e zbatimit të unifikuar;
- iii. të ndërmarrë të gjitha masat e tjera, të cilat, pa asnjë përfshirje financiare të buxhetit të Unionit të Posaçëm ose të Organizatës, kontribuojnë në lehtësimin e zbatimit të Klasifikimit të Elementeve Figurative në vendet në zhvillim;
- iv. të gëzojë të drejtën të krijojë nënkomitete dhe grupe pune.

4. Komiteti i ekspertëve miraton rregulloren e tij të brendshme. Rregullorja parashikon mundësinë për pjesëmarrjen e organizatave ndërqeveritare të përmendura në paragrafin 2, germa "b", në takimet e nënkomiteteve dhe të grupeve të punës së Komitetit të Ekspertëve, të cilët mund të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në zhvillimin e Klasifikimit të Elementeve Figurative.

5. Propozimet për ndryshime ose shtesa të Klasifikimit të Elementeve Figurative mund të jepen nga Zyra Kompetente e çdo vendi të Unionit të Posaçëm, Byrosë Ndërkombëtare, çdo organizate ndërqeveritare të përfaqësuar në Komitetin e Ekspertëve, në përputhje me paragrafin 2, germa "b" dhe çdo vend apo organizatë të ftuar në mënyrë të veçantë nga Komiteti i Ekspertëve për depozitimin e këtyre propozimeve. Këto propozime përcillen te Byroja Ndërkombëtare, e cila ua dërgon ato anëtarëve të Komitetit të Ekspertëve dhe vëzhguesve, jo më vonë se 2 muaj para seancës së Komitetit të Ekspertëve, ku duhet të shqyrtohen këto propozime.

6.

a) Çdo vend anëtar i Komitetit të Ekspertëve gëzon të drejtën e një vote.

b) Vendimi i Komitetit të Ekspertëve kërkon një shumicë të thjeshtë të votave të vendeve të përfaqësuara dhe që gëzojnë të drejtë vote.

c) Çdo vendim që një e pesta e vendeve të përfaqësuara dhe me të drejtë vote e konsideron se sjell ndonjë ndryshim të strukturës bazë të Klasifikimit të Elementeve Figurative ose që përfshin shuma thelbësore të riklasifikimit, kërkon një shumicë prej tri të katërtave të votave të vendeve të përfaqësuara dhe që gëzojnë të drejtë vote.

d) Abstenimet nuk konsiderohen si vota.

Neni 6

Njoftimi, hyrja në fuqi dhe botimi i ndryshimeve, shtesave dhe vendimeve të tjera

1. Çdo vendim i Komitetit të Ekspertëve, në lidhje me miratimin e ndryshimeve dhe të shtesave të Klasifikimit të Elementeve Figurative, si edhe rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve, u përcillet zyryave kompetente të vendeve të Unionit të Posaçëm nga Byroja Ndërkombëtare. Ndryshimet dhe shtesat hyjnë në fuqi gjashtë muaj nga data e dërgimit të njoftimit.

2. Byroja Ndërkombëtare i përfshin këto ndryshime dhe shtesa që kanë hyrë në fuqi në Klasifikimin e Elementeve Figurative. Shpalljet e këtyre ndryshimeve dhe shtesave publikohen në botimet periodike të përcaktuara nga Asambleja e përmendur në nenin 7.

Neni 7

Asambleja e Unionit të Posaçëm

1.

a) Unioni i Posaçëm ka një Asamble të përbërë nga vendet e Unionit të Posaçëm.

b) Qeveria e secilit vend të Unionit të Posaçëm përfaqësohet nga një delegat, i cili mund të asistohet nga delegatë, këshilltarë dhe ekspertë të ndryshëm.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

c) Çdo organizatë ndërqeveritare, e përmendur në nenin 5, paragrafi 2, germa “b”, mund të përfaqësohet nga një vëzhgues në takimet e Asamblesë dhe, nëse Asambleja vendos, edhe në ato komitete dhe grupe pune të krijuara nga Asambleja.

d) Shpenzimet e secilit delegacion mbulohen nga qeveria që e ka caktuar atë.

2.

a) Në bazë të dispozitave të nenit 5, Asambleja, duhet:

i. të trajtojë të gjitha çështjet që lidhen me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Unionit të Posaçëm dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

ii. të japë udhëzime për Byronë Ndërkombëtare në lidhje me përgatitjen për konferencat e rishikimit;

iii. të shqyrtojë dhe të miratojë raportet dhe veprimtaritë e Drejtorit të Përgjithshëm në lidhje me Unionin e Posaçëm dhe t'i japë atij të gjitha udhëzimet e nevojshme për çështjet që mbulohen nga Unioni i Posaçëm;

iv. të përcaktojë programin dhe të miratojë buxhetin dyvjeçar të Unionit të Posaçëm, si dhe të miratojë llogaritë e tij përfundimtare;

v. të miratojë rregulloret financiare të Unionit të Posaçëm;

vi. të vendosë për hartimin e teksteve zyrtare të Klasifikimit të Elementeve Figurative në gjuhë të ndryshme, përveç gjuhës angleze dhe frënge;

vii. të krijojë komitete dhe grupe pune, siç mund ta çmojë të përshtatshme për të përmbushur objektivat e Unionit të Posaçëm;

viii. të vendosë, në përputhje me paragrafin 1, germa “c”, se cilat vende që nuk janë anëtare të Unionit të Posaçëm dhe cilat organizata joqeveritare ndërqeveritare dhe ndërkombëtare do të lejohen të jenë vëzhguese në takimet e tyre dhe në komitetet apo grupet e tjera të punës të themeluara prej tij;

ix. ndërmerr çdo masë tjetër të përshtatshme që synon të realizojë objektivat e Unionit të Posaçëm;

x. kryen funksione të tjera të përshtatshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Në lidhje me çështjet në interes të Unioneve të tjera të administruara nga Organizata, Asambleja merr vendimin e saj pasi të jetë konsultuar me Komitetin Koordinues të Organizatës.

3.

a) Çdo vend anëtar i Asamblesë gëzon një votë.

b) Gjysma e vendeve anëtare të Asamblesë përbën një kuorum.

c) Në mungesë të kuoromit, Asambleja mund të marrë vendime, por, me përjashtim të vendimeve që lidhen me vetë procedurën e saj, të gjitha vendimet e tjera hyjnë në fuqi vetëm nëse janë plotësuar kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje. Byroja Ndërkombëtare ua përcjell këto vendime shteteve anëtare të Asamblesë, të cilat nuk kanë qenë të pranishme dhe i fton të hedhin me shkrim votën apo abstenimin e tyre, brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e komunikimit. Nëse, pas skadimit të kësaj periudhe, numri i vendeve që kanë hedhur votën ose kanë abstenuar në këtë mënyrë arrin numrin e shteteve që mungonin për arritjen e kuoromit në seancë, këto vendime hyjnë në fuqi me kusht që në të njëjtën kohë të fitohet shumica e nevojshme.

d) Në bazë të dispozitave të nenit 11, paragrafi 2, vendimet e Asamblesë kërkojnë dy të tretat e votave të hedhura.

e) Abstenimet nuk konsiderohen si vota.

f) Një delegat mund të përfaqësojë dhe të votojë vetëm në emër të një vendi.

4.

a) Asambleja mbledhet një herë çdo dy vite kalendarike në seancë të rregullt me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm dhe, me përjashtim të kushteve të jashtëzakonshme, në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtin vend me Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës.

b) Asambleja mbledhet në seancë të jashtëzakonshme me thirrjen e Drejtorit të Përgjithshëm, me kërkesën e një të katërtës së vendeve anëtare të Asamblesë.

c) Rendi i ditës i çdo seance përgatitet nga Drejtori i Përgjithshëm.

5. Asambleja miraton rregulloren e saj të brendshme.

Neni 8

Byroja Ndërkombëtare

1.

a) Detyrimet administrative në lidhje me Unionin e Posaçëm përmbushen nga Byroja Ndërkombëtare.

b) Në veçanti, Byroja Ndërkombëtare përgatit mbledhjet dhe takimet dhe siguron Sekretariatin për

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Asamblenë, Komitetin e Ekspertëve dhe komitete të tjera apo grupet e punës, siç mund të jenë krijuar nga Asambleja ose Komiteti i Ekspertëve.

c) Drejtori i Përgjithshëm është drejtuesi ekzekutiv i Unionit të Posaçëm dhe përfaqëson Unionin e Posaçëm.

2. Drejtori i Përgjithshëm dhe çdo anëtar tjetër i stafit i emëruar prej tij merr pjesë pa të drejtë vote në të gjitha takimet e Asamblesë, Komitetit të Ekspertëve dhe komiteteve të tjera apo grupeve të punës të krijuara nga Asambleja ose Komiteti i Ekspertëve. Drejtori i Përgjithshëm ose një anëtar tjetër i stafit të caktuar prej tij, është sekretar *ex officio*/i caktuar kryesisht i këtyre organeve.

3.

a) Byroja Ndërkombëtare përgatit konferencat e rishikimit në përputhje me direktivat e Asamblesë.

b) Byroja Ndërkombëtare mund të konsultohet me organizatat ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare në lidhje me përgatitjet për konferencat e rishikimit.

c) Drejtori i Përgjithshëm dhe personat e caktuar prej tij marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet e zhvilluara në këto konferenca.

4. Byroja Ndërkombëtare kryen çdo detyrë tjetër që i është caktuar.

Neni 9

Financat

1.

a) Unioni i Posaçëm duhet të ketë një buxhet.

b) Buxheti i Unionit të Posaçëm përfshin të ardhurat dhe shpenzimet që i takojnë Unionit të Posaçëm, kontributin e tij në buxhetin e shpenzimeve të përbashkëta për sindikatat e administruara nga organizatat dhe, sipas rastit, shumën e vënë në dispozicion të buxhetit të Konferencës së Organizatës.

c) Shpenzimet që nuk i atribuohen ekskluzivisht Unionit të Posaçëm, por as ndonjë apo më shumë sindikatave të tjera të administruara nga Organizata, konsiderohen si shpenzime të përbashkëta për sindikatat. Pjesa e këtyre shpenzimeve të përbashkëta që i takon Unionit të Posaçëm është në raport me interesin e Unionit të Posaçëm në to.

2. Buxheti i Unionit të Posaçëm krijohet duke pasur parasysh kërkesat e koordinimit me buxhetet e Sindikatave të tjera të administruara nga Organizata.

3. Buxheti i Unionit të Posaçëm financohet nga burimet e mëposhtme:

i. kontributet e vendeve të Unionit të Posaçëm;

ii. tarifatat dhe detyrimet për shërbime të kryera nga Byroja Ndërkombëtare në lidhje me Unionin e Posaçëm;

iii. shitjen e/ose honorarët nga botimet e Zyrës Ndërkombëtare në lidhje me Unionin e Posaçëm;

iv. dhuratat, trashëgimia dhe subvencionet;

v. qiratë, interesat dhe të ardhura të tjera të ndryshme.

4.

a) Me qëllim përcaktimin e kontributit të tij sipas paragrafit 3, germa “i”, çdo vend i Unionit të Posaçëm i përket së njëjtës klasë që i përket në Unionin e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe paguan kontributet e tij vjetore në bazë të njësive të përcaktuara për atë klasë në atë Union.

b) Kontributi vjetor i secilit vend të Unionit të Posaçëm është shuma në raport me shumën totale që duhet të paguhet në buxhetin e Unionit të Posaçëm nga të gjitha vendet, sipas numrit të njësive në totalin e njësive të të gjitha vendeve kontribuese.

c) Kontributet duhet të paguhen në fillim të muajit janar të çdo viti.

d) Vendi që nuk paguan kontributin e tij nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij të votës në asnjë organ të Unionit të Posaçëm, nëse shuma e detyrimit të tij është e barabartë ose më e madhe se shuma e kontributeve që i detyrohen atij për dy vitet e plota të mëparshme. Megjithatë, çdo organ i Unionit të Posaçëm mund të lejojë që ky vend të vazhdojë të ushtrojë të drejtën e tij të votës në atë organ nëse, dhe për sa kohë që bindet se vonesa e pagesës ka ndodhur për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të pashmangshme.

e) Nëse buxheti nuk miratohet para fillimit të një periudhe të re financiare, ai duhet të jetë në të njëjtin nivel me buxhetin e vitit paraprak, siç parashikohet në rregulloret financiare.

5. Duhet të vendoset shuma e tarifave dhe e detyrimeve për shërbimet e kryera nga Byroja Ndërkombëtare në lidhje me Unionin e Posaçëm dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i raportojë Asamblesë këtë shumë.

6.

a) Unioni i Posaçëm ka një fond të kapitalit qarkullues, i cili përbëhet nga një pagesë e vetme e kryer nga çdo

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

vend i Unionit të Posaçëm. Nëse ky fond bëhet i pamjaftueshëm, Asambleja vendos ta rrisë atë.

b) Shuma e pagesës fillestare të secilit vend në fondin në fjalë ose pjesëmarrja e tij në rritjen e këtij fondi është pjesë e kontributit të atij vendi për vitin kur është krijuar ky fond ose kur është marrë vendimi për rritjen e tij.

c) Pjesa dhe kushtet e pagesës përcaktohen nga Asambleja me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe pasi të ketë dëgjuar këshillat e Komitetit Koordinues të Organizatës.

7.

a) Në Marrëveshjen për selinë, të nënshkruar me vendin në territorin e të cilit Organizata ka selinë, duhet të parashikohet që sa herë që fondi i kapitalit qarkullues të jetë i pamjaftueshëm, ky vend duhet të paguajë pagesa paraprake. Shuma e këtyre pagesave paraprake dhe kushtet e pagesës u nënshtrohen marrëveshjeve të veçanta, në çdo rast, midis këtij vendi dhe Organizatës.

b) Vendi i përmendur në nënparagrafin “a” dhe Organizata kanë të drejtë të përfundojnë detyrimin për dhënien e pagesave paraprake, nëpërmjet një njoftimi shkrim. Prishja e Marrëveshjes hyn në fuqi tre vjet pas përfundimit të vitit kur është njoftuar.

8. Auditimi i llogarive kryhet nga një ose më shumë vende të Unionit të Posaçëm ose nga auditues të jashtëm, siç parashikohet në rregulloret financiare. Ato përcaktohen nga Asambleja me miratimin e tyre.

Neni 10

Rishikimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mund të rishikohet herë pas here në një konferencë të veçantë të vendeve të Unionit të Posaçëm.

2. Asambleja vendos për thirrjen e çdo konference rishikuese.

3. Nenet 7, 8, 9 dhe 11 mund të ndryshohen nëpërmjet një konference rishikimi ose në përputhje me dispozitat e nenit 11.

Neni 11

Ndryshimet e dispozitave të caktuara të Marrëveshjes

1. Propozimet për ndryshimin e neneve 7, 8, 9 dhe të këtij neni mund të iniciohen nga çdo vend i Unionit të Posaçëm ose nga Drejtori i Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm u komunikon këto propozime vendeve të Unionit të Posaçëm, të paktën gjashtë muaj para shqyrtimit të tyre nga Asambleja.

2. Ndryshimet në nenet e përmendura në paragrafin 1 miratohen nga Asambleja. Ky miratim kërkon tri të katërtat e votave të hedhura, me kusht që çdo ndryshim i nenit 7 dhe i këtij paragrafi të kërkojë katër të pestat e votave të hedhura.

3.

a) Çdo ndryshim i neneve të përmendura në paragrafin 1 hyn në fuqi një muaj pasi njoftimet me shkrim të pranimi, të miratuara në përputhje me proceset e tyre përkatëse kushtetuese, të jenë pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm nga tri të katërtat e vendeve anëtare të Unionit të Posaçëm në momentin e miratimit të këtij ndryshimi.

b) Çdo ndryshim i këtyre neneve të pranuar në këtë mënyrë i detyron të gjitha vendet anëtare të Unionit të Posaçëm në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimit, me kusht që çdo ndryshim që rrit detyrimet financiare të vendeve të Unionit të Posaçëm të jetë detyrues vetëm për ato vende që kanë njoftuar pranimin e këtyre ndryshimeve.

c) Çdo ndryshim i pranuar në përputhje me dispozitat e nënparagrafit “a”, i detyron të gjitha vendet për ndryshimet e hyra në fuqi në përputhje me dispozitat e nënparagrafit “a”.

Neni 12

Të bërit palë në këtë Marrëveshje

1. Çdo vend që është palë e Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale mund të bëhet palë e kësaj Marrëveshje nëpërmjet:

- i. nënshkrimit të pasuar nga depozitimi i një instrumenti të ratifikimit; ose
- ii. depozitimit të një instrumenti për aderim.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Instrumenti për ratifikim ose aderim depozitohet te Drejtori i Përgjithshëm.
3. Dispozitat e nenit 24 të Aktit të Stokholmit të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale zbatohen për këtë Marrëveshje.
4. Paragrafi 3, në asnjë rast, nuk duhet të interpretohet se një vend i Unionit të Posaçëm njih ose pranon në heshtje gjendjen faktike në lidhje me territorin e vendit tjetër ku zbatohet kjo Marrëveshje, në bazë të paragrafit të cituar.

Neni 13

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes

1. Në lidhje me pesë vendet e para që kanë depozituar instrumentet e tyre për ratifikim ose aderim, kjo Marrëveshje hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të instrumentit të pestë për ratifikim ose aderim.
2. Në lidhje me çdo vend, përveç atyre ku kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin 1, kjo Marrëveshje hyn në fuqi tre muaj nga data kur Drejtori i Përgjithshëm ka dërguar njoftimin për ratifikimin ose aderimin e saj, përveç nëse në instrumentin për ratifikim ose aderim është caktuar një datë e mëvonshme. Në rastin e fundit, kjo Marrëveshje hyn në fuqi për atë vend në datën e caktuar për këtë qëllim.
3. Ratifikimi ose aderimi sjell automatikisht pranimin e të gjitha klauzolave dhe pranimin e të gjitha përparësive të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje ka kohëzgjatje të njëjtë si Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

Neni 15

Prishja e Marrëveshjes

1. Çdo vend i Unionit të Posaçëm mund ta prishë këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm.
2. Prishja e Marrëveshjes hyn në fuqi një vit pas ditës kur Drejtori i Përgjithshëm merr njoftimin.
3. E drejta e prishjes së Marrëveshjes e parashikuar në këtë nen nuk duhet të ushtrohet nga asnjë vend para përfundimit të afatit pesëvjeçar nga data kur ky vend bëhet anëtar i Unionit të Posaçëm.

Neni 16

Mosmarrëveshjet

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy apo më shumë vendeve të Unionit të Posaçëm në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, e cila nuk zgjidhet me bisedime, nga ana e një prej vendeve të përfshirë mund të depozitohet para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në përputhje me statutin e gjykatës, me përjashtim të rastit kur vendet në fjalë bien dakord për ndonjë mënyrë tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Vendi që depoziton mosmarrëveshjen në Gjykatë njofton Byronë Ndërkombëtare; Byroja Ndërkombëtare e sjell këtë çështje në vëmendje të vendeve të tjera të Unionit të Posaçëm.
2. Secili vend, në momentin që nënshkruan këtë Marrëveshje apo depoziton instrumentet e saj të ratifikimit apo të aderimit, mund të deklarojë se nuk konsiderohet të ketë detyrim ligjor, sipas dispozitave të paragrafit 1. Për çdo mosmarrëveshje ndërmjet ndonjë vendi që ka bërë një deklaratë të tillë dhe një vendi tjetër të Unionit të Posaçëm, dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen.
3. Çdo vend që ka dhënë deklaratë sipas dispozitave të paragrafit 2, në çdo moment mund ta tërheqë deklaratën e tij nëpërmjet një njoftimi drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 17

Nënshkrimi, gjuhët, funksionet e depozitarit, njoftimet

1.
 - a) Kjo Marrëveshje nënshkruhet në një kopje të vetme në gjuhët angleze dhe frënge, ku tekstet në të dyja gjuhët janë njëllor autentike.
 - b) Kjo Marrëveshje mbetet e hapur për nënshkrim deri më 31 dhjetor 1973, në Vjenë.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

c) Dokumenti origjinal i kësaj Marrëveshjeje, kur nuk është më i hapur për nënshkrim, depozitohet te Drejtori i Përgjithshëm.

2. Tekstet zyrtare përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimit me qeveritë e interesuara, në gjuhë të tjera, siç përcaktohen nga Asambleja.

3.

a) Drejtori i Përgjithshëm përcjell dy kopje të tekstit të nënshkruar të kësaj Marrëveshjeje, të certifikuara prej tij, qeverive të vendeve që e kanë nënshkruar atë dhe me kërkesë të tyre, qeverisë së çdo vendi tjetër.

b) Drejtori i Përgjithshëm përcjell dy kopje të çdo ndryshimi të kësaj Marrëveshjeje, të certifikuara prej tij, qeverive të të gjitha vendeve të Unionit të Posaçëm dhe me kërkesë të tyre, qeverisë së çdo vendi tjetër.

c) Drejtori i Përgjithshëm, me paraqitjen e një kërkesë, i jep qeverisë së çdo vendi që ka nënshkruar këtë Marrëveshje ose që ka aderuar në të, dy kopje të Klasifikimit të Elementeve Figurative, të certifikuara prej tij, në gjuhën angleze dhe frënge.

4. Drejtori i Përgjithshëm e regjistron këtë Marrëveshje pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

5. Drejtori i Përgjithshëm i njofton qeveritë e të gjitha vendeve që janë palë nënshkruese të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, për:

i) nënshkrimet, sipas paragrafit 1;

ii) depozitimin e instrumenteve për ratifikim ose aderim, në përputhje me nenin 12, paragrafin 2;

iii) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me nenin 13, paragrafi 1;

iv) deklaratat e dhëna sipas nenit 4, paragrafi 5;

v) deklaratat dhe njoftimet e dhëna sipas nenit 12, paragrafi 3;

vi) deklaratat e dhëna sipas nenit 16, paragrafi 2;

vii) tërheqjen e çdo deklarate të dhënë sipas nenit 16, paragrafi 3;

viii) pranimin e ndryshimeve të kësaj Marrëveshjeje sipas nenit 11, paragrafi 3;

ix) datat e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve;

x) prishjet e marrëveshjeve të marra sipas nenit 15.

REZOLUTA

E MIRATUAR NGA KONFERENCA DIPLOMATIKE PËR KLASIFIKIMIN NDËRKOMBËTAR
TË ELEMENTEVE FIGURATIVE TË MARKAVE,
8 QERSHOR 1973

1. Në pritje të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Vjenës që përcakton Klasifikimin Ndërkombëtar të Elementeve Figurative të Markave, krijohet një Komision i Përkohshëm i Ekspertëve pranë Byrosë Ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO).

2. Komiteti i Përkohshëm përfshin një përfaqësues të çdo vendi që ka nënshkruar ose ka aderuar në Marrëveshjen në fjalë. Organizatat ndërqeveritare të specializuara në fushën e markave, prej të cilave të paktën një nga vendet anëtare ka nënshkruar ose ka aderuar në këtë Marrëveshje, mund të përfaqësohen nga vëzhguesit. Çdo vend anëtar i WIPO-së ose palë në Konventën e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, i cili nuk ka nënshkruar dhe as nuk ka aderuar në Marrëveshje, mund dhe nëse kërkohet nga Komiteti i Përkohshëm, duhet të ftohet nga Drejtori i Përgjithshëm i WIPO-së që të përfaqësohet nëpërmjet një vëzhguesi.

3. Komiteti i përkohshëm rishqyrton Klasifikimin Ndërkombëtar të Elementeve Figurative të Markave dhe përgatit, nëse është e nevojshme, projektndryshimet apo shtesat e Klasifikimit në fjalë.

4. Byroja Ndërkombëtare ftohet të përgatisë punën e Komitetit të Përkohshëm.

5. Byroja Ndërkombëtare ftohet të thërrasë Komitetin e Përkohshëm, pas konsultimit me vendet që kanë nënshkruar ose kanë aderuar në këtë Marrëveshje, nëse këto ndryshime ose shtesa propozohen nga ndonjë vend i tillë ose organizatë e përmendur në paragrafin 2 më sipër, ose nëse vetë Byroja Ndërkombëtare synon të propozojë ndryshime apo shtesa.

6. Byroja Ndërkombëtare ftohet t'i përcjellë Komitetit të Ekspertëve, të krijuar sipas nenit 5 të Marrëveshjes, menjëherë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, çdo projektndryshim ose shtesë të hartuar nga Komiteti i Përkohshëm.

7. Shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës së anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm dhe të vëzhguesve mbulohen nga vendet ose organizatat që përfaqësojnë.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

LIGJ
Nr.9947, datë 7.7.2008

PËR PRONËSINË INDUSTRIALE¹

*(ndryshuar me ligjin nr. 10/2013, datë 14.2.2013, nr.55/2014,
datë 29.5.2014, nr. 17/2017, datë 16.2.2017, nr. 96/2021, datë 7.7.2021)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

*(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014,
ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)*

1. Objekt i këtij ligji është rregullimi i sistemit të dhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, si dhe rregullimi i sistemit të mbrojtjes së sekretit tregtar kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme.

Pronësia industriale ka si objekt të saj:

- a) disenjot industriale;
- b) emërtimet e origjinës;
- c) markat tregtare;
- ç) modelet e përdorimit;
- d) patentat për shpikje;
- dh) treguesit geografikë.

2. Shpikjet mbrohen nëpërmjet patentave dhe modeleve të përdorimit, të cilat lëshohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale. Disenjot industriale, markat tregtare e të shërbimit dhe treguesit geografikë mbrohen nëpërmjet regjistrimit në DPPI. Një diseno e mbrojtur nga të drejtat e disenjës së regjistruar, në përputhje me këtë ligj, përfiton edhe nga mbrojtja e së drejtës së autorit nga data e krijimit të disenjës ose fiksimit të saj në çfarëdolloj forme, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislationin në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të autorit.

Neni 2

Fusha e zbatimit të pronësisë industriale

Fusha e zbatimit të pronësisë industriale shtrihet në industri, tregti, bujqësi, si dhe në zhvillimin e të gjitha produkteve natyrore ose të përpunuara.

Neni 3

Zbatimi i ligjit

Ky ligj zbatohet:

1. Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, që përfshin hapësirën tokësore, tërësinë e ujërave territoriale dhe të brendshme detare, hapësirën ajrore që shtrihet mbi hapësirën tokësore dhe të ujërave territoriale dhe të brendshme detare, si dhe çdo vend tjetër ku shtrihet sovraniteti i shtetit shqiptar, si selitë e

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr. 121. Tiranë, 2008. f. 5315

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqiptare, anijet që mbajnë flamurin e Republikës së Shqipërisë, anijet e marinës luftarake, aviacionin ushtarak ose civil, kudo që ndodhen.

2. Për shpikjet e krijuara ose të përdorura jashtë, në hapësirë, duke përfshirë trupat qiellorë dhe anijet hapësinore, të cilat janë nën juridiksionin dhe kontrollin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

3. Për personat fizikë dhe juridikë shqiptarë, si dhe për personat e huaj:

a) nga vendet dhe territoret, palë kontraktuese të konventave dhe traktateve ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale, ku edhe Republika e Shqipërisë është palë;

b) nga vendet dhe territoret, anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë;

c) nga vendet dhe territoret, me të cilat zbatohet parimi i reciprocitetit në fushën e pronësisë industriale.

Neni 4

Përkufizime

(ndryshuar fjalët në pikën 3, 5 dhe shtuar pikat 5/a, 5/b, 17/a, 17/b, 17/c, 17/ç, 17/d me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar pika 15 dhe shtuar pikat 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017; shtuar pikat 25-34 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Person” është çdo person fizik ose juridik.

2. “Konventa e Parisit” është konventa “Për mbrojtjen e pronësisë industriale”, e miratuar në Paris më 20 mars 1883, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

3. “Ekspozitë ndërkombëtare zyrtare apo e njohur zyrtarisht” është ekspozita apo panairi në kuptimin e përdorur në konventën “Për ekspozitat ndërkombëtare”, të miratuar në Paris më 22 nëntor 1928, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

4. “Marrëveshja e Madridit” është marrëveshja dhe protokoli i kësaj marrëveshjeje për regjistrimin ndërkombëtar të markave, e datës 14 prill 1891, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

5. “Klasifikimi i Nicës” është klasifikimi ndërkombëtar i mallrave dhe i shërbimeve, në funksion të regjistrimit të markave, i miratuar me Marrëveshjen e Nicës më 15 korrik 1957, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

5/a. “Klasifikimi i Locarnos” është klasifikimi ndërkombëtar për disenjt industrialë në funksion të regjistrimit të disenjove industriale, i miratuar me marrëveshjen e Locarnos “Për krijimin e klasifikimit ndërkombëtar të disenjove industriale”, më 8 tetor 1968, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

5/b. “Traktati i Budapestit” është traktati për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave, për qëllime të procedurës së patentave, aderuar me ligjin nr. 9031, datë 20.3.2003”, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Budapestit për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave, për qëllime të procedurës së patentave.

6. “Buletini i DPPI-së” është botimi periodik zyrtar i kësaj drejtorie, ku botohen të dhënat e objekteve të pronësisë industriale, që mbrohen nga ky ligj.

7. “Shpikje bioteknologjike” është shpikja, që ka të bëjë me një produkt, i cili ka në përbajtje material biologjik, ose që ka të bëjë me një proces, nëpërmjet të cilit prodhohet, përpunohet ose përdoret një material biologjik.

8. “Material biologjik” është çdo material, që përmban informacion gjenetik dhe që është i aftë të riprodhojë veten ose që mund të jetë i riprodhueshëm nga një sistem biologjik.

9. “Variatet bimor” është çdo grupim bimor i një lloji të vetëm botanik, i shkallës më të ulët të njohur, grupim i cili, pavarësisht nëse përmbushen plotësisht kushtet, që t’i jepet e drejta si varietet bimor, mund të:

a) përcaktohet nëpërmjet dhënies së karakteristikave, që rezultojnë nga një tip gjeni ose nga një kombinim gjenesh;

b) dallohet nga çdo grupim tjetër bimor, nëpërmjet shfaqjes së të paktën të njëres prej karakteristikave të përmendura;

c) vlerësohet si një njësi, në lidhje me përshtatshmërinë për t’u shumëfishuar në mënyrë të pandryshueshme.

10. “Proces thelbësish biologjik për prodhimin e bimëve ose kafshëve” është një proces, që është tërësisht fenomen natyror, siç është kryqëzimi ose seleksionimi.

11. “Proces mikrobiologjik” është çdo proces, që përfshin apo realizohet nga një material mikrobiologjik ose që rezulton në një material mikrobiologjik.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

12. "TBP" është Traktati i Bashkëpunimit për Patentat, i miratuar në Uashington më 19.6.1970, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

13. "Markë e mirënjohur" është marka, në kuptimin e parashikuar në nenin 6 bis të Konventës së Parisit, e njohur në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me nenet e këtij ligji.

14. "Licencim" është dhënia e licencës, nëpërmjet së cilës pronari i regjistrimit të njërit prej objekteve të pronësisë industriale (licencuesi) lejon palën tjetër (të licencuarin) të kryejë çdo akt apo veprim të përmendur, përkatësisht, në nenet 46, 47, 129 e 163 të këtij ligji.

15. "Licencë ekskluzive" është licenca që pronari i një objekti të pronësisë industriale i jep ekskluzivisht vetëm një të licencuari të drejtën për ta përdorur atë.

16. "Licencë joekskluzive" është licenca që nuk i heq të drejtën pronarit të një objekti të pronësisë industriale ta përdorë ose ta licencojë atë te persona të tjerë.

17. "Gjykatë" është Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

17/a. "ZEP" është Zyra Europiane e Patentave.

17/b. "KEP" është Konventa Europiane e Patentave, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 10 179, datë 29.10.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Patentave Europiane".

17/c. "Mutatis mutandis" do të thotë "në të njëjtën mënyrë".

17/ç. "Ex officio" do të thotë "e drejta që ka një person për shkak të pozicionit që mban".

17/d. "Vis-a-vis" do të thotë "kundrejt".

18. "Mjet elektronik" është çdo mjet, me anë të të cilit mundësohet dërgimi fillestar i informacionit e marrja e tij nga marrësi i përcaktuar me anë të pajisjeve elektronike për përpunimin (duke përfshirë ngjeshjen shifrore) dhe ruajtja e të dhënave, tërësisht të transmetuara, të përcjella apo të marra përmes kabllave, valëve radio, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, përfshirë dhe internetin.

19. "Mjedisi për aplikimin elektronik" është portali elektronik i DPPI-së, i aksesueshëm nëpërmjet faqes zyrtare në internet, e hapur nga DPPI-ja, ku mundësohet ofrimi i shërbimit për publikun në distancë, duke komunikuar drejtpërdrejt me sistemin qendror të DPPI-së, nëpërmjet mjeteve elektronike.

20. "Sistemi i administrimit të pronësisë industriale, SAPI" është mjeti elektronik, përfshirë dhe bazën e të dhënave, për administrimin e pronësisë industriale nga DPPI-ja.

21. "EO" është shkurtimi i shprehjes "Emërtim origjine".

22. "EOM" është shkurtimi i shprehjes "Emërtim origjine i mbrojtur".

23. "TGJ" është shkurtimi i shprehjes "Tregues gjeografik".

24. "TGJM" është shkurtimi i shprehjes "Tregues gjeografik i mbrojtur".

25. "Akti i Gjenevës" është Akti i Gjenevës i Marrëveshjes së Lisbonës për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë, i datës 20.5.2015, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

26. "Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut" është organi përgjegjës i ngarkuar me ligj për procedurat e inspektimit në Republikën e Shqipërisë, i cili vepron në përputhje me kërkesat ligjore specifike të përcaktuara në këtë ligj lidhur me mallrat e falsifikuara, mallrat pirate ose mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale.

27. "Kërkesë-ankesë për inspektim" është kërkesa që paraqitet pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut për të ndërmarrë veprime lidhur me mallrat e falsifikuara, mallrat pirate ose mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale.

28. "Kërkues i kërkesë-ankesës për inspektim" është pronari ose mbajtësi i të drejtave të pronësisë industriale dhe/ose përfaqësuesi i autorizuar i tij, në emër të të cilit paraqitet një kërkesë-ankesë për inspektim sipas këtij ligji.

29. "Mallra të falsifikuara" nënkuptojnë:

i. mallra, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel një markë tregtare dhe, pa lejen e mbajtësit të së drejtës, mbajnë një shenjë identike me markën tregtare të regjistruar rregullisht për të njëjtat lloje mallrash ose që në thelb është e padallueshme nga kjo markë;

ii. mallra, të cilat janë objekt i një veprimi që shkel një tregues gjeografik/emërtim origjine dhe mbajnë ose janë të përshkruara me një emër ose term të mbrojtur lidhur me atë tregues gjeografik/emërtim origjine;

iii. çdo paketim, etiketë, ngjitës, broshurë, udhëzues përdorimi, dokument garancie ose artikull tjetër i ngjashëm, edhe nëse paraqitet veçmas, që është objekt i një veprimi që shkel një markë tregtare ose një tregues gjeografik/emërtim origjine, që përfshin një shenjë, emër ose term që është identik me një markë tregtare të regjistruar rregullisht ose tregues gjeografik/emërtim origjine të mbrojtur, ose që në thelb është e padallueshme

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

nga një markë tregtare apo tregues gjeografik/emërtim origjine i tillë dhe që mund të përdoret për të njëjtin lloj mallrash si ai për të cilin është regjistruar marka tregtare ose treguesi gjeografik/emërtim origjine.

30. “Mallra pirate” janë mallra të cilat janë objekt i një veprimi që shkel të drejtat e një disenoje industriale në Republikën e Shqipërisë dhe janë/ose përmbajnë kopje të bëra pa pëlqimin e mbajtësit të të drejtave të lidhur me disenjon industriale apo të një personi të autorizuar prej mbajtësit në vendin e prodhimit.

31. “Mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale” janë mallrat e identifikuar në Republikën e Shqipërisë, të cilat, në pamje të parë, kanë tregues të arsyeshëm se:

- i. janë objekt i një veprimi që shkel një të drejtë të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë;
- ii. kanë pajisje, produkte apo komponentë që janë projektuar, prodhuar ose përshtatur, kryesisht me qëllim për të mundësuar apo lehtësuar shmangien nga çdo teknologji, pajisje apo komponent, që në rrjedhën normale të operacionit të tij parandalon ose kufizon veprime lidhur me vepra të paautorizuara nga mbajtësi i të drejtave të pronësisë industriale dhe që lidhet me një veprim që shkel këto të drejta në Republikën e Shqipërisë;
- iii. kanë çdo format apo matricë të disenuar apo të përshtatur specifikisht për prodhimin e mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë industriale, nëse këto formate apo matrica lidhen me një veprim që shkel të drejtën e pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.

32. “Marrëveshja e Lisbonës” është marrëveshja për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar, e datës 3.10.1958, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

33. “Mbajtës/tregtar i mallrave” është personi që ka në posedim ose në pronësi dhe/ose tregon mallra të falsifikuara, mallra pirate ose mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale apo që ka të drejta të ngjashme për tjetërsimin/shkatërrimin ose kontrollin fizik të këtyre mallrave, me përjashtim të mallrave të mëposhtme:

- a) mallra të natyrës jo tregtare, që ndodhen në posedimin dhe/ose pronësinë e një individi;
- b) mallra të cilat janë prodhuar nga një person me pëlqimin e mbajtësit të së drejtës apo mallra që janë prodhuar nga një person i autorizuar ligjërisht nga mbajtësi i së drejtës për prodhimin e një sasie të caktuar të mallrave, në tejkallim të sasive për të cilat është rënë dakord ndërmjet personit në fjalë dhe mbajtësit të së drejtës.

34. “Shkatërrim” është shkatërrimi fizik, riciklimi ose asgjësimi i mallrave jashtë kanaleve tregtare në një mënyrë të tillë që të parandalojë dëmtimet ndaj pronarit ose mbajtësit të të drejtave të pronësisë industriale, proces i cili kryhet pas heqjes së mallrave nga tregu dhe vendosjes së tyre në një vend të caktuar.

PJESA II PATENTAT PËR SHPIKJET DHE MODELET E PËRDORIMIT

KREU I PATENTUESHMËRIA E SHPIKJEVE

Neni 5 Shpikjet e patentueshme

1. Patenta jepet për shpikje, në të gjitha fushat e teknologjisë, me kusht që:
 - a) të përbëjë risi;
 - b) të përmbajë hap shpikës;
 - c) të jetë e zbatueshme në industri.
2. Nuk vlerësohen shpikje, në kuptimin e pikës 1 të këtij neni, veçanërisht:
 - a) zbulimet, teoritë shkencore dhe metodat matematikore;
 - b) krijimet estetike;
 - c) skemat, rregullat dhe metodat për kryerjen e veprimeve mendore, për zhvillimin e lojërave dhe biznesit, si dhe programet kompjuterike;
 - ç) paraqitjet e informacionit.
3. Objektet ose veprimtaritë e përmendura në pikën 2 të këtij neni, përjashtohen nga patentueshmëria, në atë masë sa aplikimi për patentë ose patenta lidhet me vetë këto objekte apo me këto veprimtari.
4. Objekti i shpikjes, që mbrohet nga një patentë, mund të jetë një produkt ose një proces.
5. Shpikjet bioteknologjike janë të patentueshme, nëse kanë të bëjnë me:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- a) material biologjik, që merret ose izolohet nga mjedisi i tij natyror, apo që prodhohet me anën e një procesi teknik, edhe nëse ka ndodhur më parë në natyrë;
- b) bimët ose kafshët, nëse mundësia teknike e shpikjes nuk kufizohet në një varietet të veçantë bimor apo shtazor;
- c) një proces mikrobiologjik ose proces tjetër teknik apo një produkt i përfutur nëpërmjet një procesi të tillë, me përjashtim të rastit kur përfutrohet një varietet bimor apo shtazor;
- ç) një element i marrë apo i izoluar nga trupi i njeriut ose i prodhuar ndryshe, nëpërmjet një procesi teknik, duke përfshirë një sekuençë apo një sekuençë të pjesshme të një gjeni, mund të përbëjë shpikje të patentueshme, edhe nëse struktura e tij është identike me strukturën e elementit natyral. Aplikimi industrial i sekuençës ose i sekuençës së pjesshme të një gjeni duhet të bëhen publikë në aplikimin për patentë.

Neni 6

Përjashtimet nga patentueshmëria

(ndryshuar fjalia e dytë e pikës 1 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

Nuk jepen patenta për:

1. Shpikjet, përdorimi tregtar i të cilave bie në kundërshtim me rendin publik, moralitetin ose shëndetin publik dhe jetën e njerëzve. Shfrytëzimi i një shpikjeje nuk konsiderohet se bie ndesh me moralin ose rendin publik, vetëm për shkak se ai ndalohet me ligj ose akt nënligjor, përveçse kur cenon një normë urdhëruese. Mbi këtë bazë vlerësohen, veçanërisht, të papatentueshme, objektet e mëposhtme:
 - a) proceset e klonimit të qenies njerëzore;
 - b) proceset për modifikimin e vijës embrionale të identitetit gjenetik të qenieve njerëzore;
 - c) përdorimi i embrionit njerëzor për qëllime industriale apo tregtare;
 - ç) proceset për modifikimin e identitetit gjenetik të kafshëve, të cilat ka të ngjarë t'u shkaktojnë atyre vuajtje, pa ndonjë përfitim thelbësor mjekësor të njeriut apo kafshës, si dhe kafshët, që rezultojnë nga procese të tilla.
2. Varietetet bimor ose shtazore apo proceset thelbësisht biologjike për prodhimin e bimëve apo të kafshëve, pa cenuar patentueshmërinë e shpikjeve, që lidhen me një proces mikrobiologjik ose proces tjetër teknik, apo me një produkt, që sigurohet nëpërmjet një procesi të tillë.
3. Trupin njerëzor, në fazat e ndryshme të formimit dhe të zhvillimit, si dhe thjesht për zbulimin e njërit prej elementeve të tij, përfshirë një sekuençë apo një sekuençë të pjesshme të një gjeni.
4. Metodën për trajtimin e trupit të njeriut ose të kafshës me anën e kirurgjisë apo të terapisë, si dhe metodat diagnostikuese, të praktikuar në trupin e njeriut ose të kafshës. Kjo dispozitë nuk zbatohet ndaj produkteve, veçanërisht ndaj substancave apo përbërësve, që përdoren në secilën prej këtyre metodave.
5. Substancat, që përfutrohen nëpërmjet transformimeve të brendshme nukleare për qëllime ushtarake.

Neni 7

Risia

(shtuar fjaltë në pikën 4 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Një shpikje përbën risi, nëse ajo nuk është pjesë e një arritjeje të mëparshme.
2. Bërja e njohur në publik e një dokumenti apo çdo lloj bërje e njohur në publik duhet të merret e izoluar kur vlerësohet risia.
3. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 2 të këtij neni, kur vlerësohet risia, veçoritë e një dokumenti të dytë mund të kombinohen me ato të një dokumenti të parë, nëse dokumenti i parë përmban një referim të veçantë të këto veçori dhe veçoritë janë, pa mëdyshje, pjesë e shpikjes.
4. Arritja e mëparshme përfshin gjithçka, që është bërë e njohur për publikun kudo në botë, nëpërmjet një përshkrimi, me gojë ose me shkrim, nëpërmjet përdorimit ose në çdo mënyrë tjetër, para datës së depozitimit të aplikimit për patentë apo para datës më të hershme se data e depozitimit të aplikimit kur kërkohet prioritet, sipas nenit 24 të këtij ligji, e cila në vijim do të quhet datë prioritet.
5. Arritja e mëparshme përfshin edhe aplikimet për patentë, të depozituara në Republikën e Shqipërisë ose të vlefshme për Shqipërinë, data e depozitimit ose data e prioritetit të të cilave, është më e hershme se data e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, kur ato janë publikuar nga DPPI-ja, sipas nenit 26 të këtij ligji, në këtë datë apo pas kësaj date.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 8

Përdorimi mjekësor i parë dhe i mëpasshëm

Përcaktimet e nenit 6 të këtij ligji nuk përjashtojnë:

1. Patentueshmërinë e një substance ose të një përbërjeje, që përfshihet në arritjen e mëparshme, për përdorimin e secilës prej tyre në një metodë, kirurgjikale apo diagnostikuese, ose në një metodë të trajtimit terapeutik, me kusht që ky përdorim për çdo metodë të tillë të mos përfshihet në arritjen e mëparshme.
2. Patentueshmërinë e një substance ose të një përbërjeje, që përmendet në pikën 1 të këtij neni, për çdo përdorim të veçantë të saj, në një metodë, kirurgjikale apo diagnostikuese, ose në një metodë trajtimi terapeutik, me kusht që një përdorim i tillë të mos përfshihet në arritjen e mëparshme.

Neni 9

Hap shpikës

(ndryshuar fjalët në pikën 1 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Një shpikje përbën hap shpikës nëse, duke pasur parasysh arritjen e mëparshme, shpikja nuk është dukshëm e qartë për një person të kualifikuar në fushën e arritjes, ku përfshihet ajo.
2. Nëse arritja e mëparshme përfshin dokumente, në kuptimin e pikës 5 të nenit 7 të këtij ligji, këto dokumente nuk do të vlerësohen, kur të vendoset, nëse përbëjnë hap shpikës ose jo.

Neni 10

Zbatueshmëria në industri e bujqësi

1. Një shpikje vlerësohet e zbatueshme në industri, kur mund të bëhet ose përdoret në çdo lloj industrie, përfshirë edhe bujqësinë.
2. Zbatueshmëria në industri e një sekuece ose e një sekuece të pjesshme të një gjeni duhet të bëhet e njohur në aplikimin për patentë.

Neni 11

Deklarimet e padëmshme

(ndryshuar titulli dhe pikat 1, 2 dhe shtuar fjalët në pikën 2 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Në zbatim të nenit 7, bërja publike e shpikjes nuk do të merret parasysh, në rast se ndodh jo më parë se 6 muaj përpara datës së depozitimit të kërkesës për patentë në DPPI dhe nëse ka ndodhur për shkak të ose si pasojë e:
 - a) një abuzimi në lidhje me kërkuesin ose përfaqësuesin e tij ligjor;
 - b) publikimit të shpikjes në një ekspozitë ndërkombëtare zyrtare apo e njohur zyrtarisht nga kërkuesi ose përfaqësuesi i tij ligjor.
2. Aplikanti, në rastin e përcaktuar në shkronjën “b”, e pikës 1 të këtij neni, duhet të deklarojë, në çastin e depozitimit të aplikimit pranë DPPI-së, se shpikja është paraqitur në një ekspozitë të tillë, si dhe të depozitojë certifikatën përkatëse, brenda afatit dhe kriterëve të përcaktuar në rregulloren përkatëse, dalë në zbatim të këtij ligji.

KREU II

E DREJTA PËR PATENTË

Neni 12

E drejta për të aplikuar për patentë

Aplikimi për patentë mund të depozitohet nga çdo person ose nga çdo ent tjetër, që barazohet me personin juridik. Aplikimi për patentë mund të depozitohet edhe nga dy apo më shumë aplikantë të përbashkët.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 13

E drejta për patentë

1. E drejta për patentë i përket shpikësit ose zëvendësuesit të tij ligjor. Aplikantët e përbashkët kanë të drejta të barabarta ndërmjet tyre, përveç rasteve kur ata, me marrëveshje, kanë rënë dakord ndryshe.

2. Nëse dy apo më shumë aplikime janë depozituar për të njëjtën shpikje nga persona të ndryshëm, të cilët e kanë shpikur në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, e drejta për patentë i përket aplikantit, aplikimi i të cilit mban datë më të hershme depozitimi ose, kur kërkohet prioritet, datën më të hershme të prioritetit, me kusht që aplikimi i parë të jetë publikuar.

Neni 14

Aplikime nga persona, që nuk kanë të drejta mbi patentën

1. Nëse me vendim gjyqësor të formës së prerë vendoset që e drejta për patentë t'i jepet një personi dhe jo aplikantit, personi mund:

- a) të procedojë me aplikimin për patentë, si të ishte aplikimi i tij dhe jo i aplikantit;
- b) të depozitojë një aplikim të ri për patentë, për të njëjtën shpikje;
- c) të kërkojë refuzimin e aplikimit për patentë.

2. Neni 23 zbatohet në të njëjtën mënyrë (*mutatis mutandis*) ndaj aplikimit të ri, të depozituar sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni.

Neni 15

Shpikja nga një punëmarrës

(ndryshuar shkronja "a" e pikës 2 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Nëse një shpikje është bërë në kuadër të një kontrate ose marrëveshjeje pune:

a) e drejta për patentë i përket personit, që porositi kryerjen e saj ose punëdhënësit, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratë;

b) kur shpikja ka një vlerë ekonomike shumë më të lartë nga ajo, që palët kishin parashikuar në kohën e nënshkrimit të kontratës së punës, punëmarrësi ka të drejtën e një kompensimi të veçantë. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve për vlerën e kompensimit, kjo vendoset nga gjykata.

2. Kur një punëmarrës, edhe pse kontrata e punës nuk e detyron të merret me veprimtari shpikëse, bën një shpikje, duke përdorur të dhëna dhe mjete të tjera, që i bëhen të njohura nëpërmjet punësimit të tij:

a) e drejta për patentë për këtë shpikje i përket punëmarrësit, përveç rasteve, kur brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data kur raporti, sipas shkronjës "b" të pikës 2 të këtij neni, i është paraqitur punëdhënësit, ose nga data kur punëdhënësi është njoftuar për shpikjen në mënyra të tjera, duke filluar nga data më e hershme prej këtyre datave, punëdhënësi njofton punëmarrësin nëpërmjet një deklarate me shkrim se është i interesuar për shpikjen;

b) ky punëmarrës, që ka bërë shpikjen, në përputhje me shkronjën "a" të pikës 2 të këtij neni, duhet t'i paraqesë punëdhënësit menjëherë një raport me shkrim për shpikjen;

c) nëse brenda periudhës së përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 2 të këtij neni, punëdhënësi lëshon një deklaratë, ku shpreh interes për shpikjen, atëherë e drejta për patentë i përket punëdhënësit, që nga fillimi. Në varësi të pagës, vlerës ekonomike të shpikjes dhe fitimit, që punëdhënësi siguron nga shpikja, punëmarrësi ka të drejtën e kompensimit. Nëse palët nuk bien dakord për vlerën e kompensimit, ajo do të vendoset nga gjykata.

3. Çdo kontratë, që është më pak e favorshme për shpikësin se parashikimet e këtij neni, është e pavlefshme.

Neni 16

Emri i shpikësit

1. Në çdo publikim të DPPI-së, ku botohen patentat ose aplikimet për patentë, është e detyrueshme të përmendet emri i shpikësit apo i shpikësve.

2. Emri i shpikësit nuk përmendet vetëm në rast se shpikësi njofton me shkrim DPPI-në se heq dorë nga e drejta për t'u përmendur.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KREU III APLIKIMI DHE PROCEDURA PËR DHËNIEN E NJË PATENTE

Neni 17

Kërkesa e një aplikimi për patentë

1. Aplikimi për patentë duhet të përmbajë:
 - a) një kërkesë për dhënie të patentës;
 - b) një përshkrim të shpikjes;
 - c) një ose disa pretendime;
 - ç) vizatimet, të përmendura në përshkrimin ose në pretendimet;
 - d) një abstrakt;
 - dh) dokumentin e prioritetit, nëse pretendohet për prioritet.
2. Aplikimi përmban emrin e shpikësit ose, kur janë disa, emrat e të gjithë shpikësve. Nëse aplikanti nuk është shpikësi ose nuk është njëri prej shpikësve, aplikimi duhet të përmbajë një deklaratë, që tregon origjinën e së drejtës për patentë.
3. Aplikimi shoqërohet me pagesën e tarifave të caktuara.
4. Të dhënat për elementet e aplikimit për patentë, mënyrën e depozitimit të tij pranë DPPI-së dhe procedura përkatëse parashikohen në rregulloren, në zbatim të këtij ligji.

Neni 18

Data e depozitimit

(ndryshuar pika "c" e shfuqizuar fjalët në pikën "a" me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Data e depozitimit të një aplikimi për patentë është data kur aplikimi i depozituar pranë DPPI-së përmban dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) dokumentin, që tregon se kemi të bëjmë me një aplikim për patentë;
 - b) dokumentin, që përmban të dhënat identifikuese për aplikantin dhe që mundëson kontaktet me të;
 - c) dokumentin, që në pamje të parë duket se është përshkrimi i shpikjes ose që referon në një aplikim tjetër të mëparshëm. Në rastin e referimit në një aplikim të mëparshëm, dokumenti duhet të përmbajë numrin e aplikimit, datën e depozitimit dhe zyrën ku është bërë aplikimi i mëparshëm. Ky dokument zëvendëson përshkrimin e shpikjes ose çdo vizatim që lidhet me të.
2. Dokumentet e përcaktuara në shkronjat "a" e "b" të pikës 1 të këtij neni depozitohen në gjuhën shqipe, ndërsa dokumenti i përcaktuar në shkronjën "c" të pikës 1 të këtij neni mund të paraqitet edhe në gjuhë të huaja, me kusht që përkthimi në gjuhën shqipe të depozitohet brenda dy muajve nga data e depozitimit të aplikimit.
3. Nëse data e depozitimit nuk mund të jepet në vijim të ekzaminimit, sipas pikave të lartpërmendura, aplikimi nuk trajtohet si aplikim për patentë.
4. DPPI-ja, në përputhje me pikat 1 e 2 të këtij neni, përcakton datën e depozitimit dhe njofton pa vonesë aplikantin.

Neni 19

Përshkrimi e shpikjes

(ndryshuar titulli, pikat 1, 2 dhe shtuar pika 3 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; shtuar pikat 4, 5, 6, 7, 8 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017; ndryshuar shkronjën "c" e pikës 4 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Përshkrimi e një shpikjeje duhet të jetë e qartë dhe të përmbajë informacionin e nevojshëm për një person të kualifikuar të fushës, që mund ta realizojë atë.
2. Nëse shpikja përfshin përdorimin e një materiali biologjik ose kur ka të bëjë me një material të tillë, që nuk gjendet në publik dhe që nuk mund të përshkruhet në aplikim, në mënyrë të tillë që të jetë i mundur riprodhimi i tij nga një person i kualifikuar i fushës, aplikimi duhet të shoqërohet me prova që vërtetojnë se kampioni i këtij materiali është depozituar në institucionin përgjegjës jo më vonë se data e depozitimit të aplikimit për patentë. Institucioni që plotëson kërkesat e Traktatit të Budapestit konsiderohet institucion përgjegjës.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Aplikimi për patentë, në këtë rast, duhet të përmbajë, gjithashtu, edhe të gjithë informacionin e rëndësishëm që disponon depozituesi, në lidhje me karakteristikat e materialit biologjik të depozituar, emrin e institutit të depozitimit dhe numrin e regjistrimit të depozitimit.

4. Aksesimi në materialin biologjik të depozituar sigurohet nëpërmjet furnizimit të një kampioni:

a) deri në publikimin e parë të aplikimit për patentë, vetëm ndaj atyre personave, të cilët janë të autorizuar, sipas parashikimeve të këtij ligji për patentat kombëtare;

b) ndërmjet publikimit të parë të aplikimit dhe dhënies së patentës, ndaj çdo personi që e kërkon atë ose, nëse aplikanti e kërkon kështu, vetëm ndaj një eksperti të pavarur;

c) pasi patentë është dhënë dhe pavarësisht nga shfuqizimi ose anulimi i saj, te të gjithë që e kanë kërkuar atë.

5. Kampioni jepet vetëm nëse personi që e kërkon atë merr përsipër që gjatë kohës në të cilën patentë është në fuqi:

a) të mos ua vërë në dispozicion atë apo ndonjë material që rrjedh prej saj palëve të treta;

b) të mos e përdorë atë apo ndonjë material që rrjedh prej saj, përveç për qëllime eksperimentale, vetëm nëse aplikuesi ose pronari i patentës, sipas rastit, shprehimisht heq dorë nga kjo kërkesë.

6. Me kërkesë të aplikantit, kur një aplikim është refuzuar ose tërhequr, leja për materialin e depozituar kufizohet për një ekspert të pavarur për 20 vjet nga data kur është depozituar aplikimi për patentë. Në këtë rast do të zbatohet pika 5 e këtij neni.

7. Kërkesat e aplikantit referuar shkronjës "b", të pikës 4, të këtij neni, dhe pikës 6, të këtij neni, mund të bëhen vetëm deri në datën në të cilën konsiderohet se kanë përfunduar përgatitjet teknike për publikimin e aplikimit për patentë.

8. Nëse materiali biologjik i depozituar në përputhje me këtë nen nuk është më i disponueshëm nga institucioni në të cilin është depozituar, një depozitë e re e materialit do të pranohet me të njëjtat kushte me ato të parashikuara në Traktatin e Budapestit.

9. Çdo depozitë e re shoqërohet me një deklaratë të nënshkruar nga depozituesi që vërteton se materiali biologjik i sapodepozituar është i njëjtë me atë të depozituar në fillim.

Neni 20

Pretendimet

Pretendimet duhet:

1. Të përcaktojnë objektin, për të cilin kërkohet mbrojtja;

2. Të jenë të qarta, të përmbledhura saktë dhe të mbështetura nga përshkrimi i shpikjes;

3. Të paraqiten sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren përkatëse.

Neni 21

Abstrakti

Abstrakti shërben vetëm për të dhënë informacionin teknik. Ai nuk do të merret parasysh për asnjë qëllim tjetër, veçanërisht për interpretimin e objektit të mbrojtjes së kërkuar ose për zbatimin e pikës 5 të nenit 7 të këtij ligji.

Neni 22

Uniteti i shpikjes

1. Uniteti i shpikjes ka të bëjë me paraqitjen në aplikim të një shpikjeje të vetme ose të një grupi shpikjesh, të lidhura në një mënyrë të tillë, saqë së bashku formojnë një koncept shpikës, të vetëm e të përgjithshëm.

2. Mospërmbushja e kërkesës së unitetit të shpikjes nuk shërben si shkak për pavlefshmërinë (shfuqizimin) e një patente.

Neni 23

Aplikimi i ndarë

1. Aplikanti mund ta ndajë aplikimin fillestar në dy ose më shumë aplikime të veçanta, me kusht që secili prej tyre të mos shtrihet përtej përmbajtjes së aplikimit fillestar, siç është depozituar.

2. Çdo aplikim i ndarë vlerësohet se është depozituar në datën e depozitimit ose në datën e prioritetit të aplikimit fillestar.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Dokumentet e prioritetit dhe të gjitha përkthimet e nevojshme, të paraqitura në DPPI për aplikimin fillestar, janë të vlefshme për të gjitha aplikimet e ndara.

Neni 24

E drejta për prioritet

(ndryshuar pikat 6, 7 dhe shtuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Një aplikim i depozituar pranë DPPI-së mund të përmbajë një deklaratë, ku kërkohet prioritet dhe të gëzojë një të drejtë prioriteti, kur ai është i njëjtë me një ose disa aplikime të mëparshme e të rregullta kombëtare, të depozituara nga aplikanti ose zëvendësuesi i tij ligjor:

a) në bazë të legjislacioni kombëtar të njërit prej shteteve anëtare të Konventës së Parisit;

b) në bazë të legjislacioni kombëtar të njërit prej shteteve anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë;

Aplikim i rregullt kombëtar, në kuptim të këtij neni, do të quhet çdo aplikim, i cili ka plotësuar kërkesat e nevojshme për të marrë një datë depozitimi, pavarësisht se ç'ka ndodhur më vonë me aplikimin.

2. DPPI-ja, kur aplikimi përmban deklaratën e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, i kërkon aplikantit të depozitojë, brenda tri muajve nga data e depozitimit të aplikimit, një kopje të certifikuar të aplikimit të mëparshëm.

3. E drejta e prioritetit, e fituar në bazë të parashikimeve të këtij neni, sjell si pasojë, që data e prioritetit të quhet datë e depozitimit të aplikimit pranë DPPI-së vetëm për efekt të nenit 7 dhe të pikës 2, të nenit 13.

4. Kur DPPI-ja vëren se kërkesat e këtij neni nuk janë përmbushur, njofton aplikantën të rregullojë apo të plotësojë mangësitë brenda një periudhe kohe, siç përcaktohet në rregulloren përkatëse. Nëse mangësitë nuk rregullohen ose plotësohen brenda kohës së caktuar, deklarata është e pavlefshme.

5. Aplikimi i depozituar pranë DPPI-së gëzon të drejtën e prioritetit nga data e depozitimit të aplikimit të mëparshëm, me kusht që kërkesa pranë DPPI të bëhet brenda një periudhe prej 12 muajsh nga data e depozitimit të aplikimit të mëparshëm. Afati 12-mujor fillon nga e nesërmja e datës së depozitimit të aplikimit të mëparshëm dhe, nëse dita e fundit e afatit bie në një ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas asaj të pushimit.

6. Kur aplikimi që pretendon prioritet depozitohet pas kalimit të periudhës 12-mujore, sipas parashikimit të pikës 5, të këtij neni, aplikuesi mund të depozitojë një kërkesë për rivendosjen e së drejtës së prioritetit, duke përcaktuar arsyet për mosrespektimin e periudhës së prioritetit, me gjithë marrjen e masave të nevojshme, dhe paguan tarifën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji. Kërkesa depozitohet brenda dy muajve nga data e përfundimit të periudhës së prioritetit, sipas pikës 5, të këtij neni. Kërkesa refuzohet nëse nuk plotëson kërkesat e sipërpërmendura.

7. Aplikuesi mund të depozitojë një kërkesë për ndryshimin ose shtimin e prioritetit brenda 16 muajve nga data më e hershme e prioritetit të pretenduar, ose kur ndryshimi apo shtesa shkakton ndryshim të datës më të hershme të prioritetit të pretenduar, kërkesa depozitohet brenda 16 muajve nga data më e hershme e prioritetit të ndryshuar, cilado periudhë 16-mujore mbaron e para, me kusht që kërkesa për ndryshim të mund të depozitohet para mbarimit të periudhës katërmujore nga data e depozitimit të aplikimit. Prioriteti nuk deklarohet dhe as nuk ndryshohet nëse aplikuesi ka depozituar kërkesë për publikim të parakohshëm, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 26. Kërkesa refuzohet, nëse aplikuesi nuk paguan tarifën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

Neni 25

Ndryshimet, korrigjimet dhe heqja dorë nga një aplikim

1. Ndryshimet dhe korrigjimet formale në një aplikim mund të bëhen me nismën e vetë aplikantit ose me kërkesë të DPPI-së, deri në datën e dhënies së patentës, e cila bëhet vetëm pas pagesës së një tarife.

2. Aplikanti ka të drejtë të heqë dorë nga aplikimi në çdo kohë përpara dhënies së patentës, me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar DPPI-së.

3. Heqja dorë nga një aplikim për patentë bëhet vetëm me vendim unanim të të gjithë aplikantëve të përbashkët.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 26

Publikimi i aplikimeve për patentë

(shtuar fjalia 2 në pikën 4 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. DPPI-ja publikon çdo aplikim për patentë, të depozituar në përputhje me nenin 18 të këtij ligji:
 - a) menjëherë pas përfundimit të një periudhe prej 18 muajsh nga data e depozitimit ose, kur kërkohet prioritet, nga data e prioritetit. Megjithatë, nëse aplikanti kërkon, me shkrim, që aplikimi të publikohet përpara plotësimit të afatit prej 18 muajsh, DPPI-ja e publikon atë në buletin e radhës;
 - b) sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren përkatëse.
2. DPPI-ja nuk i publikon aplikimet nëse ato janë tërhequr ose refuzuar përpara mbarimit të afatit prej 18 muajsh, i cili fillon nga data e depozitimit, ose, kur ka kërkesë për prioritet, nga data e prioritetit.
3. DPPI-ja publikon aplikimin për patentë në të njëjtën kohë me specifikimin e patentës, kur vendimi për dhënien e patentës lëshohet përpara mbarimit të afatit të parashikuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni.
4. DPPI-ja, menjëherë pas vendimit për dhënien e patentës, e publikon atë së bashku me specifikimin, në përputhje me rregulloren përkatëse. DPPI-ja publikon në buletin të gjitha ndryshimet e patentës ose të statusit të saj ligjor. Shpikjet, të cilat vlerësohen sekret shtetëror, trajtohen sipas dispozitave të veçanta të kësaj rregulloreje.

Neni 27

Të drejtat e siguruara nga publikimi i një aplikimi

Publikimi i një aplikimi për patentë i jep aplikantit, përkohësisht, të drejta të njëjta me ato që do t'i siguronte publikimi i vetë patentës.

Neni 28

Ekzaminimi i aplikimit dhe dhënia e patentës

(ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014;

ndryshuar fjalia e fundit e pikës 3 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. DPPI-ja, pas verifikimit nëse aplikimi i depozituar është në përputhje me nenet 17, 18, 19, 20, 21, 22 e 24 të këtij ligji dhe pas pagesës së tarifës së caktuar, jep patentën përkatëse.
2. Nëse aplikimi nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ose i përmbush ato pjesërisht, DPPI-ja njofton aplikantin, i cili, brenda tre muajve, duhet të plotësojë mangësitë. Nëse përsëri nuk korrigjohen ose nuk plotësohen brenda kohës së caktuar, aplikimi refuzohet dhe DPPI-ja njofton aplikantin për këtë vendim.
3. Kundër vendimit të marrë, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, mund të bëhet apelim në bordin e apelimit të DPPI-së, brenda tre muajve nga data e marrjes së njoftimit, pasi të bëhet pagesa e tarifës së apelimit. Kundër vendimit të Bordit të Apelimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Bordit të Apelimit.
4. DPPI-ja nuk kryen ekzaminim thelbësor të shpikjes, në përputhje me nenet 5, 6, 7, 9 e 10 të këtij ligji. Patenta e dhënë nga DPPI-ja ka efekte ligjore, sipas pikës 1, të nenit 40, vetëm nëse, para mbarimit të periudhës 10-vjeçare nga data e depozitimit, pronari i patentës depoziton prova shkresore për patentueshmërinë e shpikjes. Prova shkresore mund të jetë rezultat i ekzaminimit thelbësor të kryer mbi të njëjtën patentë nga ZEP-i, nga një zyrë kombëtare, e cila gëzon statusin e Autoritetit Ndërkombëtar për Ekzaminim Paraprak, sipas nenit 32, të Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat ose nga zyra kombëtare, e cila ka marrëveshje bashkëpunimi me DPPI-në, si dhe një patentë e dhënë për të njëjtën shpikje nga një prej këtyre zyrave. Në rast se nuk paraqiten prova shkresore të patentueshmërisë, të përmendura më sipër, patenta nuk do të ketë më efekt pas kalimit të periudhës 10-vjeçare.

Neni 29

Regjistri i patentave

(ndryshuar fjalia e parë e pikës 1 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. DPPI-ja mban regjistrin e patentave, ku regjistrohen të gjitha aplikimet, për të cilat është dhënë data e depozitimit. Asnjë aplikim për patentë nuk regjistrohet në regjistrin e patentave, përpara se patenta të publikohet. Patentat e dhëna regjistrohen sipas numrit të regjistrimit.
2. Të gjitha të dhënat dhe informacioni për patentën regjistrohen në regjistër, sipas mënyrës së përcaktuar në

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

dispozitat e këtij ligji dhe në rregulloren përkatëse. DPPI-ja regjistron korrigjimet, plotësimet, ndryshimet e pronësisë dhe të dhënat e tjera.

3. Ekstrakti i lëshuar për regjistrin e patentës është një dokument deklarativ (prima facie) për të gjithë informacionin e shënuar në të, sipas dispozitave të këtij ligji.

4. DPPI-ja i lëshon kopje të certifikuara për shënimet e ndryshme, të bëra në regjistrin e patentave, çdo personi të interesuar, pasi ky të ketë paguar tarifën e caktuar.

Neni 30

Inspektimi i dosjeve

1. Regjistri i patentave është i hapur për inspektim nga publiku, sipas rregullave të parashikuara në rregulloren përkatëse.

2. Dosjet e papublikuara, që lidhen me një aplikim për patentë, nuk mund të inspektohen pa pëlqimin e aplikantit.

3. Pas publikimit të aplikimit për patentë, dosjet e aplikimit mund të inspektohen vetëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Çdo personi, i cili provon se një aplikant ka përdorur kundër tij të drejtat, që burojnë nga aplikimi për patentë, mund t'i sigurohet inspektimi i dosjeve përpara publikimit të aplikimit dhe pa pëlqimin e aplikantit.

Neni 31

Shpikjet që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë

1. Kërkesat për shpikje, që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e vendit, vlerësohen si “sekret shtetëror” dhe depozitohen pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Ministria e Mbrojtjes dhe DPPI-ja klasifikojnë një aplikim për patentë si “sekret shtetëror” jo më vonë se pesë muaj pasi sigurojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për aplikimin për patentë, si dhe përcaktojnë datën e depozitimit.

2. Kur DPPI-ja e klasifikon një aplikim për patentë “sekret shtetëror” njofton aplikantin, i cili, brenda një periudhe kohe të parashikuar në rregullore, deklaron:

a) se është dakord me vlerësimin e DPPI-së dhe aplikimi i dërgohet për ekzaminim Ministrisë së Mbrojtjes;

b) se nuk e pranon vlerësimin dhe provon të kundërtën, që pranohet dhe në këtë rast DPPI-ja fillon procedurën e ekzaminimit dhe të dhënies së patentës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

c) se nuk pranon vlerësimin e DPPI-së, por nuk është në gjendje të sjellë prova për ta rrëzuar këtë vlerësim dhe në këtë rast DPPI-ja e dërgon aplikimin në Ministrinë e Mbrojtjes për ekzaminim.

3. Nëse Ministria e Mbrojtjes gjykon se shpikja nuk duhet të vlerësohet “sekret shtetëror”, si dhe e nxjerr nga lista e klasifikuar “sekret shtetëror” shpikja i kthehet DPPI-së, e cila e trajton atë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Kur një shpikje “sekret shtetëror” nuk klasifikohet më si e tillë, Ministria e Mbrojtjes ia dërgon dosjen e plotë të patentës DPPI-së, e cila e regjistron në regjistrin e patentave, jep patentën dhe publikon specifikimin, në përputhje me pikën 5 të nenit 28 të këtij ligji.

5. Të gjitha aplikimet për patentë sekrete dhe patentat sekrete trajtohen sipas rregullave të veçanta, të parashikuara në rregulloren e DPPI-së dhe në këtë ligj, si dhe në aktet e tjera nënligjore për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

6. Personat fizikë ose juridikë shqiptarë mund të kërkojnë patenta për shpikje, që përbëjnë “sekret shtetëror” jashtë Republikës së Shqipërisë vetëm me miratimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

7. Aplikimi për patentë, për shpikjet e bëra në Republikën e Shqipërisë, nuk mund të paraqitet në asnjë shtet tjetër pa kaluar 5 muaj nga data e paraqitjes së tij në DPPI. Kur shpikësi qëndron zakonisht në Shqipëri dhe nuk ka të dhëna që të provojnë të kundërtën, shpikja quhet se është bërë në Shqipëri.

8. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimet përkatëse për patentat “sekret shtetëror”, ku parashikohen procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për ekzaminimin e tyre.

Neni 32

Shfrytëzimi i patentave sekrete

1. Ministria e Mbrojtjes ka të drejtë t'i përdorë patentat sekrete.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Aplikanti ose pronari i një patente sekrete kompensohet nga Ministria e Mbrojtjes.
3. Palët, me marrëveshje, caktojnë shumën e kompensimit, të përmendur në pikën 2 të këtij neni. Nëse nuk arrihet marrëveshje, aplikanti ose pronari i patentës i drejtohet gjykatës për caktimin e vlerës së kompensimit.
4. Kontratat për transferimin e pronësisë së patentave sekrete nënshkruhen dhe janë të vlefshme vetëm pasi të jetë bërë miratimi me shkrim nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme ose Shërbimi Informativ i Shtetit.
5. Marrëveshjet për licencimin e patentave sekrete nënshkruhen dhe janë të vlefshme vetëm pasi të jetë bërë miratimi me shkrim nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme ose Shërbimi Informativ i Shtetit.

Neni 33

Kundërshtimi për dhënien e një patente *(ndryshuar pika 6 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)*

1. Çdo person ka të drejtë, brenda nëntë muajve nga data e publikimit, të depozitojë një kundërshtim për dhënien e patentës në bordin e apelimit të DPPI-së, pasi të ketë bërë pagesën e tarifës së caktuar.
2. Kundërshtimi për dhënien e një patente mund të bëhet kur patenta është dhënë në kundërshtim me kërkesat e neneve 13, 17, 18, 19, 20, 21, 22 e 24 të këtij ligji.
3. Sipas pikës 1 të këtij neni, një kopje e kundërshtimit i dërgohet pronarit të patentës, i cili ka të drejtë të paraqesë argumentet e veta, brenda tri muajve nga data e marrjes së njoftimit.
4. Bordi i apelimit vlerëson kërkesën e kundërshtimit. Çdo palë ka të drejtë të marrë pjesë në procedurën e kundërshtimit dhe të paraqesë argumentet e veta, me gojë ose me shkrim, brenda një periudhe kohe të përcaktuar nga bordi i apelimit.
5. Bordi i apelimit, në përputhje me rezultatet e vlerësimit, merr vendim për shfuqizimin e patentës ose për refuzimin e kërkesës së kundërshtimit.
6. Çdo palë, kundër vendimit të Bordit të Apelimit, mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Bordit të Apelimit.

Neni 34

Shqyrtimi i mëtejshëm i aplikimit për patentë *(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)*

1. Nëse aplikanti nuk arrin të respektojë një afat (vis-à-vis) ndaj DPPI-së, ai mund të kërkojë shqyrtim të mëtejshëm të aplikimit.
2. DPPI-ja e pranon kërkesën, pasi të jenë përmbushur kërkesat e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për patentat, të dalë në zbatim të këtij ligji, si dhe pasi të jetë bërë pagesa e tarifës përkatëse, në të kundërt e refuzon atë.
3. Nëse kërkesa është pranuar, pasojat ligjore të mosrespektimit të afatit vlerësohen se nuk kanë ndodhur.
4. Shqyrtimi i mëtejshëm nuk lejohet për sa u përket afateve të parashikuara në nenin 24 të këtij ligji, si dhe për sa u përket afateve për kërkimin e shqyrtimit të mëtejshëm apo për rivendosjen e të drejtave. Rregullorja përkatëse mund të mos lejojë shqyrtimin e mëtejshëm për afate të tjera.

Neni 35

Rivendosja e të drejtave *(ndryshuar pikat 2, 4 dhe shtuar pika 6 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)* *(shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)*

1. Kur aplikanti ose pronari i një patente, pavarësisht nga vullneti, por për shkak të rrethanave të krijuara, nuk ka qenë në gjendje të respektojë afatin kundrejt (vis-à-vis) DPPI-së, mund të kërkojë rivendosjen e së drejtës, nëse mosrespektimi i këtij afati ka si pasojë të drejtpërdrejtë refuzimin e aplikimit për patentë apo të një kërkesë tjetër, vlerësimin e aplikimit si të dorëhequr, humbjen e ndonjë të drejte tjetër ose të mjeteve për mbrojtjen e të drejtave.
2. Në kërkesën për rivendosjen e së drejtës përcaktohen arsyet që kanë penguar aplikuesin të respektojë afatin. Kërkesa shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse dhe depozitohet brenda afatit që mbaron më herët nga afatet e mëposhtme:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- a) dy muaj nga data e mbarimit të shkaktit që ka penguar respektimin e afatit për veprimin në fjalë;
- b) 12 muaj nga data e mbarimit të afatit për veprimin në fjalë, ose kur kërkesa ka të bëjë me mospagimin e tarifës së rinovimit për ripërtëritjen e patentës, 12 muaj nga data e mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 3, të nenit 41, të këtij ligji.
3. Nëse kërkesa pranohet, pasojat ligjore, për shkak të mosrespektimit të afatit, vlerësohen se nuk kanë ndodhur.
4. Rivendosja e të drejtave nuk lejohet për:
 - a) një procedim para bordit të apelimit në DPPI;
 - b) bërjen e një kërkesë për shqyrtim të mëtejshëm, sipas nenit 34 të këtij ligji ose të një kërkesë për rivendosjen e së drejtës, sipas këtij neni;
 - c) depozitimin e përkthimit, sipas pikës 2 të nenit 18;
 - ç) depozitimin e kërkesës për rivendosjen e së drejtës së prioritetit.
5. Çdo person, i cili në mirëbesim ka përdorur ose ka bërë përgatitje efektive e serioze për përdorimin e një shpikjeje, objekt i një aplikimi për patentë ose i një patente, të cilat janë publikuar, në periudhën ndërmjet humbjes së të drejtave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe publikimit në buletin e DPPI-së për rivendosjen e këtyre të drejtave, mund ta vazhdojë këtë përdorim pa pagesë gjatë kryerjes së biznesit të vet ose për nevojat e këtij biznesi.
6. Procedura për depozitimin dhe shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen e së drejtës kryhet në mënyrën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

KREU IV EFEKTET E NJE PATENTE

Neni 36

Të drejtat që sigurohen nga një patentë (shtuar pikat 4, 5, 6 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Kur një patentë ka të bëjë me një produkt, pronari i patentës ka të drejtën ekskluzive të ndalojë palët e treta të kryejnë, pa autorizimin e tij, bërjen, përdorimin, ofrimin për shitje, shitjen ose importimin për këto qëllime të produktit.
2. Kur një patentë ka të bëjë me një proces, pronari i patentës ka të drejtën ekskluzive të ndalojë palët e treta të kryejnë, pa autorizimin e tij, veprimet që vijnë:
 - a) të përdorë procesin, që përbën objektin e patentës;
 - b) të përdorë, të ofrojnë për shitje, të shesë ose të importojë, për këto qëllime, të paktën produktin, që përfitohet drejtpërdrejt nga ky proces.
3. Pronari i patentës ka të drejtë të emërojë dhe t'ua transferojë patentën zëvendësuesve të tij ligjorë, si dhe të lidhë kontrata licencimi për patentën.
4. Mbrojtja e dhënë nga një patentë, një material biologjik me karakteristika specifike, si rezultat i shpikjes, shtrihet mbi çdo material tjetër biologjik që rrjedh nga materiali fillestar, nëpërmjet riprodhimit apo shumëfishimit, në formë të njëjtë ose të ndryshme, dhe ka të njëjtat karakteristika.
5. Mbrojtja e dhënë nga një patentë, një procesi, i cili mundëson prodhimin e një materiali biologjik me karakteristika specifike, si rezultat i shpikjes, shtrihet mbi materialin biologjik që përftohet direkt nga ai proces, si dhe mbi çdo material tjetër biologjik, të përfutur nga materiali i përfutur direkt nëpërmjet përhapjes apo shtimit në formë të njëjtë ose të ndryshme dhe ka të njëjtat karakteristika.
6. Mbrojtja e dhënë nga një patentë, një produkti i cili mbart ose përbëhet nga informacion gjenetik, shtrihet mbi të gjithë materialin në të cilin përfshihet ky produkt dhe në të cilin informacioni gjenetik mbartet dhe kryen funksionin e tij, me përjashtim të trupit të njeriut, në të gjitha fazat e ndryshme të formimit dhe zhvillimit të tij dhe rastit të zbulimit të thjeshtë të një prej elementeve të tij, duke përfshirë këtu edhe sekuençën e plotë apo të pjesshme të një gjeni.

Neni 36/a

E drejta e pengut për patentat e shpikjeve (shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Patentat e shpikjeve mund të jenë objekt i një kontrate garancie ose pengu.
2. Me kërkesë të njëres prej palëve në kontratë, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, një kontratë e

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

nënshkruar garancie ose pengu regjistrohet në regjistrin e patentave dhe publikohet në buletin e DPPI-së.

3. Kontrata e përmendur në pikën 1, të këtij neni, prodhon efekt për palët e treta pasi të regjistrohet në regjistrin e patentave. Megjithatë, një kontratë e tillë mund të ketë efekt për një palë të tretë para sesa të regjistrohet, nëse provohet se ajo ka pasur dijeni për të. Pala e tretë nuk ngarkohet me barrën që të provojë dijeninë e saj.

4. Dispozitat e këtij neni për ndryshimet në lidhje me garancinë dhe pengun zbatohen si për kërkesën për patentë, ashtu dhe për kërkesën për certifikatën e mbrojtjes shtesë.

Neni 36/b

Procedura për zbatimin e veprimeve përmbarrimore

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Patenta mund të jetë objekt i veprimeve përmbarrimore.

2. Me kërkesë të njëres prej palëve në kontratë, e shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, një veprim përmbarrimor regjistrohet në regjistrin dhe publikohet.

3. Një veprim përmbarrimor, i vendosur ndaj një patente, krijon pasoja juridike ndaj personave të tretë vetëm pas regjistrimit të tij në regjistrin dhe publikimit të tij në buletin e DPPI-së, përveç kur regjistrimi i veprimit i njoftohet pronarit të patentës më parë me një njoftim zyrtar të DPPI-së.

4. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e një veprimi përmbarrimor përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për patentat.

5. Dispozitat e këtij neni me ndryshimet përkatëse aplikohen edhe për certifikatën e mbrojtjes shtesë.

Neni 37

Ndalimi i përdorimit tërthorazi të shpikjes

1. Pronari i patentës ka të drejtë të ndalojë palët e treta, përveç atyre që e kanë fituar të drejtën e shfrytëzimit të shpikjes, për të cilën është dhënë patentë, t'i japin ose t'i ofrojnë një personi, përveç atij që ka të drejtë ta shfrytëzojë shpikjen e patentuar, mjete që lidhen me një element thelbësor të shpikjes, për vënien e saj në zbatim, kur pala e tretë ka dijeni, ose kur, nga rrethanat, bëhet e qartë se këto mjete janë të përshtatshme dhe synojnë vënien në zbatim të shpikjes në fjalë.

2. Kjo dispozitë nuk zbatohet nëse këto mjete janë produkte tregtare bazë, përveçse kur pala e tretë e nxit personin, të cilit i janë dhënë mjetet, të kryejë veprime, që ndalohen prej nenit 36 të këtij ligji.

Neni 38

Kufizimi i efekteve të patentës

(shtuar fjalët në pikën "dh" me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

Të drejtat, që sigurohen nga patentë, nuk do të shtrihen mbi:

- a) veprimet e kryera privatisht, jo për qëllime tregtare;
- b) veprimet e kryera thjesht për qëllime eksperimentale, që kanë lidhje me objektin e shpikjes;
- c) përgatitjen individuale e të improvizuar të një bari, në një farmaci, sipas një recete mjekësore ose me anë të proceseve të tjera, që çojnë në përgatitjen e tij;
- ç) përdorimin në bordin e anijeve të vendeve të tjera të Unionit të Parisit të pajisjeve, që janë objekt i shpikjes, në trupin e anijes, në makineri, ingranazhe, si dhe në pjesë të tjera, kur këto anije kanë hyrë në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë, përkohësisht ose aksidentalisht, me kusht që këto pajisje të përdoren vetëm dhe ekskluzivisht për nevojat e anijes;
- d) përdorimin e pajisjeve, të cilat janë objekt i patentës në ndërtimin ose funksionimin e një avioni, anijeje hapësinore ose mjeti lëvizës tokësor të vendeve të tjera të Unionit të Parisit ose të pjesëve të këtyre avionëve, anijeve ose mjeteve lëvizëse tokësore, kur këto hyjnë përkohësisht në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- dh) materialin biologjik, të përftuar nga riprodhimi ose shumëfishimi i materialit biologjik, i hedhur në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë nga mbajtësi i patentës ose me pëlqimin e tij, ku shumëfishimi ose riprodhimi rezulton nga aplikimi, për të cilin është tregtuar materiali biologjik, me kusht që materiali i përftuar të mos përdoret më pas për riprodhime dhe shumëfishime të tjera;
- e) përdorimin nga një fermer të një produkti nga prodhimet e veta bujqësore, për riprodhimin ose

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

shumëfishimin e prodhimit, me kusht që materiali bimor i riprodhuar t'i jetë shitur apo tregtuar fermerit për qëllime bujqësore nga mbajtësi i patentës ose me pëlqimin e këtij të fundit;

ë) përdorimin nga një fermer të gjësë së gjallë, të mbrojtur, për qëllime të fermës, me kusht që gjëja e gjallë për shumim ose materiali tjetër për riprodhimin e saj t'i jetë shitur apo tregtuar fermerit nga mbajtësi i patentës ose me pëlqimin e tij. Një përdorim i tillë përfshin dhënien e gjësë së gjallë ose të materialeve të tjera për riprodhimin e saj për qëllime të veprimtarisë bujqësore të vetë fermerit, por jo shitjen si pjesë apo për qëllime të veprimtarisë riprodhuese tregtare.

Neni 39

Të drejtat që nuk mund të mbrohen

Të drejtat e siguruara nga një patentë nuk shtrihen mbi veprimet e kryera në Republikën e Shqipërisë për një produkt të mbrojtur nga patenta, kur produkti në fjalë është hedhur në tregun e Republikës së Shqipërisë nga pronari i patentës ose me pëlqimin e tij.

Neni 40

Afati kohor i patentës

1. Afati kohor i një patente është 20 vjet nga data e depozitimit të aplikimit.
2. Dhënia e certifikatës së mbrojtjes shitesë për produktet mjekësore dhe produktet për mbrojtjen e bimëve është objekt i kërkesave që parashikohen në kreun XVI të këtij ligji.

Neni 41

Tarifat e ripërtëritjes

(ndryshuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Vlefshmëria e patentës kushtëzohet nga kryerja e pagesës së tarifës vjetore të ripërtëritjes.
2. Tarifa vjetore e ripërtëritjes së patentës, duhet paguar në ditën e fundit të muajit të datës së depozitimit, duke filluar nga viti i parë pas dhënies së patentës.
3. Nëse tarifa e ripërtëritjes nuk paguhet brenda afatit të lartpërmendur, ajo mund të paguhet brenda gjashtë muajve pas ditës së fundit të muajit, në të cilin përfshihet data e depozitimit, me kusht që brenda kësaj periudhe të paguhet një tarifë shitesë. Ky afat mund të zgjatet me dy muaj, duke paguar një tarifë shitesë për shtyrjen e afatit të ripërtëritjes. Nëse DPPI-ja konstaton se pronari i një patente nuk paguan tarifën e ripërtëritjes, sipas pikës 2, të këtij neni, ajo njofton pronarin apo përfaqësuesin e tij, brenda dy muajve nga data e mbarimit të këtij afati për mundësinë që ka për të bërë ripërtëritjen, sipas kësaj pike. Njoftimet bëhen vetëm në adresat që pronarët e patentave ose përfaqësuesit e tyre kanë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në shkronjën "b", të pikës 2, të nenit 35, kur nuk respektohen afatet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, patenta konsiderohet e mbaruar në datën e ripërtëritjes së saj.

Neni 42

Shtrirja e mbrojtjes dhe interpretimi i pretendimeve

1. Shtrirja e mbrojtjes e siguruar nga një patentë përcaktohet nga pretendimet. Përshkrimi dhe vizatimet shërbejnë për të interpretuar pretendimet.
2. Për përcaktimin e shtrirjes së mbrojtjes, që sigurohet nga patenta, mbahet parasysh çdo element, i barasvlershëm me një element të specifikuar te pretendimet.

Neni 43

Përdoruesit e mëparshëm

1. Të drejtat, që sigurohen nga një patentë, nuk sjellin asnjë pasojë ndaj personave brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët kanë përdorur ose janë në proces përgatitjesh serioze dhe efektive për përdorimin e patentës përpara datës së depozitimit të aplikimit ose, kur kërkohet prioritet, përpara datës së prioritetit. Këta persona kanë të drejtë të vazhdojnë përdorimin ose përgatitjet për përdorim.
2. E drejta e përdorimit të mëparshëm mund të transferohet te ndërmarrja ose shoqëria apo te një pjesë e ndërmarrjes ose shoqërisë, ku bëhet përdorimi apo janë bërë përgatitjet për përdorim.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KREU V NDRYSHIMI I PRONËSISË DHE PRONËSIA E PËRBASHKËT

Neni 44

Ndryshimi i pronësisë së aplikimit për patentë ose të patentës

1. Çdo kontratë për ndryshim pronësie të një aplikimi për patentë ose të një patente bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët kontraktuese, në të kundërt kontrata është e pavlefshme.

2. Çdo ndryshim pronësie i një aplikimi për patentë ose i një patente kryhet kundrejt pagesës së tarifës përkatëse. Në rastin e kalimit të pronësisë së një patente, ndryshimi regjistrohet në regjistrin e patentave. Pronari i patentës ka të drejtë të fillojë një proces gjyqësor për patentën, vetëm nëse ndryshimi i pronësisë është i regjistruar në këtë regjistrë. DPPI-ja boton ndryshimet në pronësinë e patentave.

3. Kalimi i pronësisë së aplikimit për patentë ose të patentës ka efekte ndaj palëve të treta vetëm pas regjistrimit të kalimit të kësaj pronësie në regjistrin e patentave. Megjithatë, kalimi i pronësisë përpara regjistrimit vlen për palët e treta, të cilat i kanë fituar të drejtat për patentën pas datës së këtij kalimi, edhe pse ishin në dijeni për këtë kalim në datën në të cilën ato i fituan të drejtat.

Neni 45

Pronësia e përbashkët për aplikimin për patentë ose për patentën

1. Nëse dy apo më shumë aplikantë paraqesin së bashku një aplikim për patentë, secili prej tyre ka të drejtë ta transferojë pjesën e vet të aplikimit. Nënshkrimi i një marrëveshjeje licencimi me palët e treta bëhet vetëm me vendim unanim të të gjithë aplikantëve të përbashkët.

2. Kur një patentë ka disa pronarë të përbashkët, transferimi i patentës dhe nënshkrimi i një marrëveshjeje licencimi me palët e treta bëhet vetëm me vendim unanim të të gjithë pronarëve të përbashkët. Secili prej tyre ka të drejtë, pa marrë pëlqimin e pronarëve të tjerë, të fillojë një proces gjyqësor ndaj shkeljes së të drejtave të patentës, kundër çdo personi, që cenon patentën. Përdorimi i patentës nga secili prej pronarëve të përbashkët nuk kërkon miratimin e pronarëve të tjerë.

3. Dispozitat e këtij neni janë të zbatueshme vetëm nëse nuk ekziston një marrëveshje e ndryshme ndërmjet tyre.

KREU VI MARRËVESHJA E LICENCIMIT

Neni 46

Marrëveshje licencimi

1. Marrëveshja e licencimit bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët, në të kundërt ajo është e pavlefshme.

2. Objekt i një marrëveshjeje licencimi mund të jetë aplikimi për patentë ose patenta.

3. Licenca regjistrohet në regjistrin e patentave pasi të jetë paguar tarifa përkatëse. Licencuesi ka të drejtë të fillojë një proces gjyqësor në bazë të marrëveshjes së licencimit, vetëm nëse kjo është e regjistruar në regjistrin e patentave.

4. Licencimi i një aplikimi për patentë ose i një patente ka pasoja ndaj palëve të treta, vetëm pas regjistrimit të saj në regjistrin e patentave. Pavarësisht nga kjo, licencimi ende i paregjistruar ka efekt ndaj palëve të treta, që i kanë fituar nga licenca të drejtat për patentën, pas datës së licencimit, por që ishin në dijeni për licencimin në ditën kur i fituan të drejtat e licencimit.

5. Nëse pronari i një patente nuk paguan tarifën e ripërtëritjes, sipas pikës 1 të nenit 41 të këtij ligji dhe licenca në favor të një personi të tretë është regjistruar në regjistrin e patentave, DPPI-ja njofton të licencuarin se pagesa nuk është kryer dhe se ai duhet të paguajë tarifën brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit, me qëllim që të ruajë vlefshmërinë e licencës së regjistruar. Në rast mosmarrëveshjeje për sigurimin e të drejtave të regjistruara të të licencuarit, gjykata mund të vendosë kalimin e patentës tek i licencuari.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 47

Të drejtat e të licencuarit

1. Një marrëveshje licencimi i siguron të licencuarit të gjitha të drejtat e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji. Ajo shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në çdo zbatim të shpikjes, përveç kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e licencimit.

2. I licencuari nuk ka të drejtë të lejojë palët e treta të kryejnë veprimet e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji, përveç kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e licencimit.

Neni 48

Të drejtat e licencuesit

1. Nëse marrëveshja e licencimit është ekskluzive, si licencuesit edhe palëve të treta u ndalohej të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji.

2. Në mungesë të një dispozite të kundërt, marrëveshja e licencimit është joekskluzive. Në këtë rast, licencuesi mund t'i lejojë vetes dhe të licencuarve të tjerë të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji.

Neni 49

Licencat vullnetare

1. Nëse pronari i një patente njofton DPPI-në, me anë të një deklarate me shkrim, se është gati të lejojë çdo person të përdorë shpikjen si i licencuar, përkundërt një kompensimi të përshtatshëm, tarifat e ripërtëritjes, që janë për t'u bërë pas dorëzimit të deklarates, reduktohen, në përputhje me rregulloren përkatëse.

2. Deklarata me shkrim, parashikuar në pikën 1 të këtij neni, mund të tërhiqet nga pronari i patentës në çdo kohë, me anë të një njoftimi me shkrim, drejtuar DPPI-së me përjashtim të rastit kur një person e ka njoftuar me shkrim pronarin, për qëllimin për ta përdorur shpikjen.

3. Deklarata me shkrim, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, është e pavlefshme për sa kohë që në regjistrin e patentave është regjistruar një licencë ekskluzive ose kur në DPPI gjendet një kërkesë për regjistrimin e kësaj licence.

4. Në bazë të deklarates, çdo person ka të drejtë të përdorë shpikjen si i licencuar, në përputhje me kushtet e parashikuara në rregulloren përkatëse, dalë në zbatim të këtij ligji, si dhe është i detyruar t'i japë pronarit, në fund të çdo viti kalendarik, të dhëna rreth mënyrës së përdorimit të saj dhe të paguajë kompensimin e caktuar. Licenca e siguruar, sipas kushteve të këtij neni, trajtohet si licencë kontraktore.

KREU VII

LICENCAT JOVULLNETARE

Neni 50

Licencat jovullnetare

*(ndryshuar pika 2 dhe shërkronja "c" e pikës 4,
shërkronja pika 2/a, 2/b me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)*

1. Në bazë të kërkesës, gjykata ka të drejtë t'i japë licencë jovullnetare çdo personi, i cili provon se ka aftësi për të shfrytëzuar shpikjen, objekt i patentës së dhënë në Republikën e Shqipërisë, si dhe plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në rregulloren përkatëse, dalë në zbatim të këtij ligji, me kusht që:

- a) të kenë kaluar katër vjet nga depozitimi i aplikimit për patentë ose tre vjet nga dhënia e patentës;
- b) pronari i patentës të mos e ketë përdorur patentën për një periudhë kohore të arsyeshme ose të mos ketë bërë përgatitje, serioze e efektive, për shfrytëzimin e saj, përveç kur paraqet arsye ligjore për mosveprim;
- c) të ketë bërë të gjitha përpjekjet për të marrë autorizimin nga pronari i patentës, në kushte dhe afate të arsyeshme, si dhe këto përpjekje të mos kenë rezultuar të suksesshme, brenda një periudhe kohore të arsyeshme.

2. Në bazë të kërkesës, gjykata, për përdorim jo ekskluziv të shpikjes së mbrojtur nga patentat ose të varietetit bimor të mbrojtur nga kjo e drejtë, ka të drejtë t'i japë licencë jovullnetare për një patentë të mëparshme pronarit të një patente ose mbajtësit të një të drejte mbi një varietet bimor, i cili nuk mund të përdorë patentën e dytë ose të drejtën mbi një varietet bimor, pa cenuar patentën e parë, përkundërt një pagese të caktuar nga eksperti i zgjedhur nga gjykata, me kusht që:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

a) shpikja e pretenduar në patentën e dytë ose varieteti bimor i mbrojtur të jetë një përparim teknik me rëndësi ekonomike të konsiderueshme krahasuar me shpikjen e përmendur në patentën e parë;

b) ata t'i kenë kërkuar zotëruesit të patentës ose të së drejtës për një varietet bimor të drejtën për të marrë një licencë kontraktore dhe nuk e kanë marrë atë.

2/a. Gjykata për përdorim joekskluziv të shpikjes së mbrojtur, merr çdo masë që e konsideron të nevojshme për të verifikuar ekzistencën e një situatë të tillë.

2/b. Në rastin e një licence jovullnetare, të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, pronari i patentës së parë apo mbajtësi i një të drejte për një varietet bimor ka të drejtë të marrë një licencë të ndërsjellë me kushte të arsyeshme për të përdorur shpikjen e mbrojtur nga patenta e dytë apo nga varieteti bimor i mbrojtur.

3. Në bazë të kërkesës, gjykata ka të drejtë të japë licencë jovullnetare për patentat dhe certifikatat e mbrojtjes shitesë, për prodhimin dhe shitjen e produkteve farmaceutike, kur këto produkte synohet të eksportohen në vende informuese “në nevojë” për të përballuar problemet shëndetësore publike, në përputhje me rregulloren përkatëse, të dalë në zbatim të këtij ligji.

4. Lloji i përdorimit, që mbulohet nga licence jovullnetare, si dhe kushtet, që duhet të plotësohen, specifikohen nga gjykata, e cila merr parasysh që:

a) fusha dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit të kufizohen brenda qëllimit, për të cilin është dhënë autorizimi;

b) shfrytëzimi të jetë joekskluziv;

c) shfrytëzimi të jetë i patransferueshëm.

Në rastin e një licence jovullnetare, siç parashikohet në pikën 2, të këtij neni, shfrytëzimi i autorizuar në lidhje me patentën e parë është i transferueshëm, vetëm në rastin kur transferohet patenta e dytë ose varieteti bimor.

ç) sasia e produktit farmaceutik, që do të prodhohet në bazë të licencës jovullnetare, nuk duhet të tejkalojë nevojat e vendit ose të vendeve importuese, të lartpërmendura në aplikim, duke pasur parasysh edhe sasinë e produkteve të prodhuara, në bazë të licencave të tjera jovullnetare.

5. Shfrytëzimi i një licence jovullnetare autorizohet veçanërisht për të furnizuar tregun e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

6. Licenca jovullnetare është e vlefshme deri në mbarimin e periudhës kohore, të caktuar nga gjykata, ose deri në mbarimin e afatit të patentës. Me kërkesë të arsyetuar, gjykata mund të anulojë autorizimin, për shkak të mbrojtjes së interesave legjitimë të personave të autorizuar, në rastin kur rrethanat, që çuan në dhënien e autorizimit, kanë pushuar së ekzistuari dhe nuk ka mundësi të përsëriten.

7. Licencat jovullnetare regjistrohen në regjistrin e patentave.

8. Pronari i patentës ka të drejtë të marrë një kompensim të përshtatshëm për çdo licencë jovullnetare, duke pasur parasysh vlerat ekonomike të autorizimit. Kur palët nuk bien dakord, vlera e kompensimit vendoset nga gjykata.

9. Mbajtësi i një licence jovullnetare mund të heqë dorë prej saj në çdo kohë. Nëse mbajtësi i licencës jovullnetare nuk fillon shfrytëzimin e saj brenda një viti nga data përfundimtare e dhënies së licencës, pronari i patentës mund të kërkojë ndryshimin ose anulimin e licencës jovullnetare.

10. Kërkesat e përcaktuara në pikat 1 shkronja “c” dhe 5 të këtij neni nuk zbatohen, kur një përdorim i tillë bëhet për të ndrequr një praktikë, që vlerësohet se cenon parimet e konkurrencës së ndershme, në përfundim të një procesi gjyqësor ose administrativ. Nevoja për të rregulluar praktikën, që cenon parimet e konkurrencës së ndershme, mbahet parasysh kur vendoset vlera e shpërblimit. Gjykata ka të drejtë të refuzojë përfundimin e një licence jovullnetare, nëse kushtet, që çuan në dhënien e kësaj licence, mund të përsëriten.

Neni 51

Shfrytëzimi nga qeveria ose nga palë të treta të autorizuar nga qeveria

1. Kur e kërkojnë interesa të rëndësishëm të mbrojtjes ose të sigurisë kombëtare, Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Shëndetësisë, edhe pa miratimin e pronarit të patentës ose të aplikantit të saj, nëpërmjet një njoftimi në buletin e DPPI-së, mund të autorizojnë një agjenci, një institucion shtetëror ose një person të caktuar të bëjë, të përdorë ose të shesë shpikjen, për të cilën është paraqitur një aplikim ose është dhënë një patentë, kundrejt pagesës së një shpërblimi të drejtë dhe të përshtatshëm të pronarit të patentës ose të aplikantit të patentës. Pronari i patentës ose aplikanti i patentës, sipas rastit, duhet të njoftohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Kundër vendimit të Ministrit të Mbrojtjes ose Ministrit të Shëndetësisë mund të bëhet ankim në gjykatë.

KREU VIII

(shfuqizuar kreu me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

KREU IX

(shfuqizuar kreu me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

KREU X

(shfuqizuar kreu me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

KREU XI

NDRYSHIMET, DORËHEQJA DHE SHFUQIZIMI I PATENTAVE

Neni 70

Korrigjimet në një patentë

1. Pronari i një patente ka të drejtë t'i kërkojë DPPI-së të bëjë ndryshime në një patentë për korrigjimin e gabimeve apo pasaktësive formale, të paqëllimshme. Hollësitë rreth pasqyrimit të korrigjimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse.

2. DPPI-ja publikon ndryshimet e bëra në një patentë, sipas përcaktimeve të këtij neni.

Neni 71

Heqja dorë nga patenta

(ndryshuar fjalia e 2 e pikës 2 me ligjin 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Kur pronari i një patente kërkon të heqë dorë nga patenta, ai paraqet një kërkesë me shkrim pranë DPPI-së. Heqja dorë nga një patentë, që u përket pronarëve të përbashkët, bëhet vetëm me vendim unanim të tyre. Heqja dorë mund të kufizohet te një ose më shumë pretendime, të mbrojtura nga patenta.

2. DPPI-ja regjistron heqjen dorë nga patenta në regjistrin e patentave dhe e publikon atë në buletin. Efekti i heqjes dorë nga patenta fillon nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Shqyrtimi i kërkesës për dorëheqje mund të fillojë vetëm pasi të jetë njoftuar pala e tretë, që ka fituar një të drejtë mbi patentën.

Neni 72

Mbarimi

Patenta mbaron:

- a) 20 vjet pas datës së depozitimit të aplikimit;
- b) kur pronari i patentës heq dorë vullnetarisht nga patenta;
- c) kur nuk është paguar në kohën e duhur tarifa ripërtëritëse apo ndonjë pagesë shtesë.

Neni 73

Shfuqizimi i patentës

1. Kur kundërshtohet vlefshmëria e një patente, gjykata ka të drejtë ta shfuqizojë ose të kufizojë patentën, në qoftë se:

- a) objekti i patentës nuk është i patentueshëm, në bazë të kërkesave të neneve 5, 6, 7, 8, 9 e 10 të këtij ligji;
- b) shpikja nuk është bërë e njohur në mënyrë të qartë dhe të plotë, sa të mund të zbatohet nga një person i kualifikuar i fushës së arrijës;
- c) objekti i patentës shtrihet përtej përmbajtjes së aplikimit për patentë, ashtu siç është depozituar ose, nëse patenta është dhënë në bazë të një aplikimi të ndarë, përtej përmbajtjes së aplikimit më të hershëm, ashtu siç është depozituar;
- ç) mbrojtja e siguruar nga patenta është zgjatur;
- d) pronarit të patentës i ka humbur e drejta, sipas neneve 13 e 15 të këtij ligji.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Nëse vlefshmëria e një patente kundërshtohet në gjykimin e filluar nga mbajtësi i një licence ekskluzive, gjykim në të cilin nuk merr pjesë pronari i patentës, vendimi i gjykatës bëhet i detyrueshëm vetëm për palët në gjykim.

3. Gjatë ekzaminimit të një kërkesë për shfuqizim, gjykata mund t'i kërkojë pronarit të patentës t'i paraqesë asaj, për qëllime ekzaminimi, publikime dhe dokumente të tjera, që tregojnë arritjen e mëparshme, së cilës i ishte referuar aplikimi për patentë ose që ishte marrë parasysh nga zyrat e tjera ekzaminuese.

4. Në rast se është filluar një procedurë kundërshtimi ndaj një patente, në bordin e apelimit të DPPI-së, gjykimi në proces për shfuqizimin ndërpritet derisa të merret një vendim, sipas pikës 5 të nenit 33 të këtij ligji.

Neni 74

Pasojat e shfuqizimit

1. Çdo patentë, pretendim ose pjesë e një pretendimi që shfuqizohet, vlerësohet i paqenë dhe i pavlefshëm që nga fillimi.

2. Nëse shkaqet për shfuqizim ndikojnë vetëm pjesërisht ndaj patentës, shfuqizimi kryhet në formë të pjesshme ndaj kësaj patente. Kufizimi mund të zbatohet në formën e një ndryshimi të pretendimit.

3. Nëse gjykata vendos shfuqizimin e një patente, tërësisht ose pjesërisht, ajo njofton DPPI-në, e cila regjistron vendimin në regjistrin e patentave dhe e publikon atë në buletin.

KREU XII

APLIKIMET NDËRKOMBËTARE, SIPAS TRAKTATIT TË BASHKËPUNIMIT PËR PATENTË

Neni 75

Zbatimi i traktatit të bashkëpunimit për patentë (TBP)

1. Për qëllime të këtij ligji, “aplikim ndërkombëtar” është aplikimi për patentë, i depozituar sipas TBP-së.

2. Kur në këtë ligj përmendet TBP-ja, përfshihen edhe rregulloret e dala në zbatim të saj.

3. TBP-ja dhe rregulloret e saj kanë fuqi të plotë juridike dhe zbatohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Dispozitat e TBP-së dhe të rregulloreve të saj, kur aplikimi ndërkombëtar është objekt i procedimeve në DPPI, zbatohen të plotësuara me dispozitat e këtij ligji dhe të legjislacioni të tij zbatues. Në rast konflikti, dispozitat e TBP-së kanë përparësi.

Neni 76

Zyra e caktuar dhe zyra e përzgjedhur

1. Aplikimi ndërkombëtar i caktuar për Republikën e Shqipërisë, të cilit i është dhënë një datë ndërkombëtare depozitimi, është i njëjtë me aplikimin e depozituar në DPPI, sipas nenit 18 të këtij ligji. Për aplikime të tilla, DPPI-ja është zyra e caktuar ose, sipas rastit, zyra e përzgjedhur në kuptim të TBP-së. Data ndërkombëtare e depozitimit është data e depozitimit në çdo lloj procedimi, sipas këtij ligji.

2. Për një aplikim ndërkombëtar, për të cilin Republika e Shqipërisë është e caktuar ose e përzgjedhur dhe aplikanti dëshiron mbrojtje, sipas krerëve I deri IX të këtij ligji, aplikanti, brenda tridhjetë e një muajve nga data e depozitimit të aplikimit ose kur kërkohet prioritet nga data e prioritetit:

a) paraqet një përkthim në gjuhën shqipe të aplikimit ndërkombëtar;

b) paguan tarifën e caktuar të depozitimit.

3. Nëse nuk plotësohen kërkesat e shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni, aplikimi mund të vlerësohet i dorëhequr dhe aplikanti njoftohet për këtë.

4. Çdo aplikim ndërkombëtar, i caktuar për Republikën e Shqipërisë, i cili është publikuar, sipas nenit 21 të TBP-së, fiton të njëjtat të drejta si të ishte një aplikim i publikuar, sipas nenit 26 të këtij ligji. Të drejtat mbi aplikimin për patentë fillojnë nga data, në të cilën publikohen në gjuhën shqipe pretendimet e aplikimit ndërkombëtar. Ky përkthim publikohet brenda tre muajve nga data e paraqitjes së tij nga aplikanti te DPPI-ja, si dhe pasi të jetë paguar tarifa e caktuar e depozitimit.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 77

Aplikimet ndërkombëtare të depozituara në DPPI

1. DPPI-ja vepron si zyrë pritëse, në kuptim të TBP-së, nëse aplikanti është banues i përhershëm ose shtetas i Republikës së Shqipërisë.

2. Çdo aplikim ndërkombëtar varet nga pagesa e tarifës, e cila paguhet brenda një muaji nga data e marrjes së aplikimit ndërkombëtar.

3. Kur DPPI-ja vepron si zyrë pritëse, sipas TBP-së, aplikimi ndërkombëtar depozitohet në shqip ose anglisht.

KREU XIII

PATENTAT EUROPIANE TË SHTRIRA

(ndryshuar titulli i kreu me ligjin 55/2014, datë 29.5.2014)

Neni 78

Shtrirja e efekteve të patentave europiane

(ndryshuar shkronja "a" e pikës 2 me ligjin 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Një aplikim për patentë europiane dhe një patentë europiane, që shtrihet në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e mëposhtme, ka të njëjtin efekt dhe u nënshtrohet të njëjtave kërkesa si aplikimi për patentë kombëtare dhe patenta kombëtare, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Për qëllim të dispozitave të këtij kreu:

a) "Aplikim për patentë europiane" është aplikimi për një patentë të depozituar në përputhje me Konventën Europiane për Patentat (KEP) para 1 majit 2010, si dhe aplikimi ndërkombëtar, i depozituar para 1 majit 2010, sipas traktatit të bashkëpunimit për patentë, për të cilin Zyra Europiane e Patentave (ZEP) vepron si zyrë e caktuar ose e zgjedhur, aplikime në të cilat është e caktuar Shqipëria;

b) "Patentë e shtrirë europiane" është patenta europiane e dhënë nga ZEP-i në bazë të aplikimit për patentë europiane, për të cilën është kërkuar shtrirja në Shqipëri;

c) "Aplikim për patentë kombëtare" është aplikimi për patentë, që depozitohet në DPPI, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) "Patentë kombëtare" është patenta e dhënë në bazë të këtij ligji.

Neni 79

Kërkesa për shtrirje

1. Aplikimi për patentë europiane dhe patenta europiane, e dhënë në bazë të këtij aplikimi, shtrihet në Shqipëri me kërkesë të aplikantit. Kërkesa për shtrirje vlerësohet se është depozituar në çdo aplikim për patentë europiane të depozituar, në ose pas datës kur marrëveshja e bashkëpunimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Europiane të Patentave ka hyrë në fuqi.

2. Çdo kërkesë për shtrirje, për të cilën është paguar rregullisht tarifa e shtrirjes, sipas nenit 80 të këtij ligji, publikohet nga DPPI-ja sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi kjo drejtori të jetë informuar nga ZEP-i, por jo para mbarimit të afatit prej 18 muajsh, nga data e depozitimit ose, nëse është pretenduar prioritet, nga data më e hershme e prioritetit.

3. Kërkesa për shtrirje mund të tërhiqet në çdo kohë. Ajo vlerësohet e tërhequr kur nuk është kryer pagesa e parashikuar për shtrirjen ose kur aplikimi për patentë europiane është refuzuar, tërhequr ose vlerësuar i tërhequr përfundimisht. DPPI-ja e publikon këtë sa më shpejt që të jetë e mundur, nëse kërkesa për shtrirje është publikuar tashmë prej saj, në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

Neni 80

Tarifa e shtrirjes

(ndryshuar pika 1 dhe 2 me ligjin 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Tarifa e shtrirjes, sipas pikës 2, të nenit 79, të këtij ligji, i paguhet ZEP-it brenda gjashtë muajve nga data, në të cilën Buletini i Patentave Europiane përmend publikimin e raportit european të kërimit ose, sipas rastit, brenda periudhës së kryerjes së akteve të nevojshme për hyrjen në fazën europiane të një aplikimi ndërkombëtar, sipas kuptimit të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 78, të këtij ligji.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Pagesa e tarifës së shtrirjes është ende e vlefshme nëse ajo bëhet brenda dy muajve nga periodha e përcaktuar në pikën 1 të nenit 80, me kusht që brenda kësaj periudhe të kryhet një pagesë shtesë prej 50 për qind.

3. Për pagesën e tarifave të shtrirjes, rregullat e ZEP-it, që lidhen me tarifën, zbatohen *mutatis mutandis*. Pagesat e tarifave të shtrirjes, të bëra në mënyrë të vlefshme, nuk kthehen.

Neni 81

Efektet e aplikimeve për patentë europiane

1. Aplikimi për patentë europiane, të cilit i është dhënë një datë depozitimi, është i njëjtë me një aplikim të rregullt për patentë kombëtare dhe, kur është rasti, merret parasysh prioriteti i kërkuar në aplikimin për patentë europiane, pavarësisht nga përfundimi që do të ketë aplikimi.

2. Një aplikim për patentë europiane i publikuar siguron përkohësisht të njëjtën mbrojtje, që jep ky ligj, duke filluar nga data kur aplikanti i ka komunikuar personit, që përdor shpikjen në Republikën e Shqipërisë, përkthimin në shqip të pretendimeve të aplikimit për patentë europiane të publikuar.

3. Aplikimi për patentë europiane vlerësohet se nuk i ka sjellë pasojat e përmendura në pikën 2 të këtij neni (që nga fillimi) (*ab initio*), në rast se kërkesa për shtrirje është tërhequr ose mendohet e tërhequr.

Neni 82

Efektet e patentave europiane

(ndryshuar pika 3, shtuar pika 3/a dhe ndryshuar fjalët në pikat 4 e 6 me ligjin 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Patenta e shtrirë europiane, objekt i pikave 2 deri në 6 të këtij neni, siguron, nga data e publikimit të miratimit të dhënies së saj nga ZEP-i, të njëjtat të drejta të një patente kombëtare, sipas përcaktimeve të dispozitave të këtij ligji.

2. Brenda tre muajve nga data e publikimit të miratimit të dhënies së patentës europiane, pronari i patentës i paraqet DPPI-së një përkthim në gjuhën shqipe të pretendimeve të patentës europiane dhe paguan tarifën e parashikuar për publikim.

3. Nëse si rezultat i një kundërshtimi ose i një kërkesë për kufizim, të depozituar në ZEP, patenta europiane ripërtërihet me pretendime të ndryshuara, pronari i patentës, brenda tre muajve nga data e publikimit të vendimit për ripërtëritjen ose kufizimin, duhet t'i paraqesë DPPI-së përkthimin e pretendimeve të ndryshuara në gjuhën shqipe dhe të paguajë tarifën e parashikuar për publikim.

3/a. Kur pretendimi përmban shenja referencë të përdorura në vizatime, këto vizatime i bashkëlidhen përkthimit, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni.

4. DPPI-ja ka detyrimin të publikojë në buletin e radhës çdo përkthim të depozituar rregullisht, sipas pikës 2 ose 3 të këtij neni.

5. Nëse përkthimi, i përmendur në pikën 2 apo 3 të këtij neni, nuk depozitohet në kohën e duhur ose tarifa e parashikuar nuk paguhet në kohën e duhur, shtrirja e patentës europiane vlerësohet e pavlefshme *ab initio*.

6. Patenta e shtrirë europiane dhe aplikimi për patentë europiane, mbi të cilin ajo bazohet, vlerësohen se nuk i kanë sjellë *ab initio* pasojat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni dhe në pikën 2 të nenit 81 të këtij ligji, në masën që patenta është shfuqizuar në procedimet kundërshtuese apo në një procedim shfuqizimi qendror ose është kufizuar në një procedurë kufizimi para ZEP-it.

Neni 83

Teksti autentik i aplikimeve për patentë europiane ose i patentave europiane

(ndryshuar pika 3 me ligjin 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Teksti i aplikimit për një patentë europiane ose i një patente europiane në gjuhën e aplikimit në ZEP shërben si tekst autentik për të gjitha procedurat në Republikën e Shqipërisë.

2. Përkthimi, siç parashikohet në nenet 81 e 82 të këtij ligji, vlerësohet autentik, me përjashtim të rastit kur ndiqet procedura për shfuqizim, ku aplikimi ose patenta në gjuhën e përkthyer siguron një mbrojtje më të kufizuar se ajo e siguruar prej saj në gjuhën e aplikimit.

3. Aplikuesi ose pronari i patentës mund të depozitojë një përkthim të korrigjuar të pretendimeve të aplikimit për patentë europiane ose të patentës europiane. Përkthimi i korrigjuar i pretendimeve të një aplikimi

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

për një patentë europiane të publikuar nuk ka efekte ligjore, derisa ai t'i komunikohet personit që përdor shpikjen në Republikën e Shqipërisë nga ana e aplikuesit. Përkthimi i korigjuar i pretendimeve të një patente europiane të shtrirë nuk ka efekte ligjore, derisa ai të publikohet nga DPPI-ja. Çdo person, i cili në mirëbesim përdor ose ka bërë përgatitje të vërteta dhe serioze për të përdorur një shpikje, përdorimi i së cilës nuk përbën cenim të aplikimit ose të patentës në përkthimin origjinal, mund ta vazhdojë këtë përdorim gjatë zhvillimit të biznesit të vet ose për nevoja të ndryshme, pa kryer ndonjë pagesë, pasi përkthimi i korigjuar të bëhet i vlefshëm.

Neni 84

Të drejtat e datës më të hershme

1. Aplikimi për patentë europiane, për të cilën është paguar tarifa e shtrirjes, si dhe për patentë të shtrirë europiane sjellin, në lidhje me aplikimin për patentë kombëtare dhe me patentën kombëtare, të njëjtat pasoja për arritjet e mëparshme, siç do të kishte një aplikim për patentë kombëtare dhe patentë kombëtare, sipas këtij ligji.
2. Aplikimi për një patentë kombëtare dhe një patentë kombëtare sjellin, në lidhje me një patentë europiane të shtrirë, të njëjtat pasoja për arritjen e mëparshme, siç do të kishin sjellë në lidhje me një patentë kombëtare, sipas këtij ligji.

Neni 85

Mbrojtje e njëhershme

Në rastin kur një patentë e shtrirë europiane dhe një patentë kombëtare, që kanë të njëjtën datë depozitimi ose, kur pretendohet prioritet, të njëjtën datë prioriteti, i është dhënë të njëjtit person ose zëvendësuesit të tij ligjor, patentat kombëtare nuk sjell pasoja në masën që ajo mbulon të njëjtën shpikje me atë të patentës së shtrirë europiane, që nga data kur ka përfunduar afati për depozitim të një kundërshtimi të patentës europiane, pa u depozituar një kundërshtim i tillë, ose që nga data kur procedura e kundërshtimit ka rezultuar me një vendim përfundimtar në favor të patentës europiane.

Neni 86

Tarifat e ripërtëritjes për patentat e shtrira europiane

(shtuar pika 2 me ligjin 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Tarifat e ripërtëritjes për një patentë të shtrirë europiane do t'i paguhen DPPI-së, duke filluar nga viti pasardhës i atij, në të cilin është publikuar dhënia e kësaj patente.
2. Paragrafi 2, i nenit 141, të KEP-it, zbatohet *mutatis mutandis*.

Neni 87

Zbatimi i KEP-it

(ndryshuar me ligjin 55/2014, datë 29.5.2014)

Dispozitat e Konventës Europiane të Patentave dhe të rregulloreve në zbatim të saj nuk zbatohen në lidhje me kreun XIII, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë kre.

KREU XIII/1

PATENTAT EUROPIANE

(shtuar kreu dhe nenet 87/a, 87/b, 87/c, 87/d, 87/dh, 87/e, 87/ë, 87/f, 87/g dhe 87/gj me ligjin 55/2014, datë 29.5.2014)

Neni 87/a

Efekti i patentave europiane në Shqipëri

1. Për qëllim të dispozitave të këtij kreu:
 - a) "Aplikim për patentë europiane" është aplikimi për një patentë europiane të depozituar më ose pas 1 majit 2010, në përputhje me Konventën Europiane për Patentat (KEP), si dhe aplikimi ndërkombëtar i depozituar më ose pas 1 majit 2010, sipas traktatit të bashkëpunimit për patentë, për të cilin Zyra Europiane e

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Patentave (ZEP) vepron si zyrë e caktuar ose e zgjedhur, aplikime në të cilat është e caktuar Shqipëria;

b) "Patentë europiane" është patenta europiane e dhënë nga ZEP-i, në bazë të aplikimit për patentë europiane, për të cilën është caktuar Shqipëria;

c) "Aplikim për patentë kombëtare" është aplikimi për patentë, që depozitohet në DPPI, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) "Patentë kombëtare" është patenta e dhënë në bazë të këtij ligji.

2. Aplikimi për patentë europiane dhe patenta europiane, sipas dispozitave të këtij ligji, kanë të njëjtin efekt dhe u nënshtrohen të njëjtave kërkesa si aplikimi për patentë kombëtare dhe patenta kombëtare, të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 87/b

Depozitimi i aplikimit për patentë europiane

1. Aplikimi për patentë europiane mund të depozitohet në:

a) ZEP;

b) DPPI.

2. Një aplikim i ndarë për patentë europiane dhe aplikimi i ri për patentë evropiane, sipas shkronjës "b", paragrafi 1, i nenit 61, të KEP-it, depozitohen direkt në ZEP.

3. Kur shpikja në fjalë është me interes për sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare, aplikuesi me vendbanim ose vendqëndrim në Shqipëri e depoziton aplikimin për patentë europiane vetëm në DPPI.

4. Aplikimi për patentë europiane i depozituar në DPPI ka të njëjtin efekt sikur të ishte depozituar në të njëjtën datë në ZEP, me kusht që DPPI-ja t'ia ketë transmetuar atë ZEP-it, në përputhje me dispozitat e KEP-it.

5. Aplikimi për patentë europiane, që depozitohet në DPPI, sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, mund të depozitohet në çdo gjuhë të parashikuar në paragrafët 1 dhe 2, të nenit 14, të KEP-it.

6. Nëse nga aplikimi që depozitohet në DPPI nuk del qartë që aplikimi është për patentë europiane, atëherë aplikuesi duhet të depozitojë një deklaram në gjuhën shqipe apo angleze, me anë të të cilit kërkohet një patentë europiane.

Neni 87/c

Tarifat dhe kostot procedurale për aplikimet për patentë europiane

Tarifat dhe kostot procedurale për aplikimet për patentë europiane i paguhen ZEP-it në përputhje me parashikimet e KEP-it.

Neni 87/ç

Efektet e aplikimit për patentë europiane

1. Aplikimi për patentë europiane, të cilit i është dhënë një datë depozitimi, është i njëjtë me një aplikim të rregullt për patentë kombëtare dhe, kur është rasti, merret parasysh prioriteti i kërkuar në aplikimin për patentë europiane, pavarësisht nga përfundimi që do të ketë aplikimi.

2. Aplikimi për patentë europiane i publikuar i siguron aplikuesit të saj të njëjtën mbrojtje që ofron aplikimi për patentë kombëtare, i publikuar sipas nenit 27, të këtij ligji, duke filluar nga data në të cilën përkthimi në shqip i pretendimeve të aplikimit për patentë europiane të publikuar është publikuar nga DPPI-ja.

3. Aplikimi për patentë europiane vlerësohet se nuk i ka sjellë, që nga fillimi, pasojat e përmendura në pikën 2, të këtij neni, nëse është tërhequr, mendohet se është tërhequr, është refuzuar përfundimisht ose nëse përcaktimi i Shqipërisë është tërhequr apo konsiderohet si i tërhequr.

Neni 87/d

Efektet e patentës europiane

1. Patenta evropiane, sipas përcaktimeve të këtij neni, siguron nga data e publikimit të miratimit të dhënies së saj nga ZEP-i të njëjtat të drejta si të një patente kombëtare të dhënë nga DPPI-ja.

2. Brenda tre muajve nga data e publikimit të miratimit të dhënies së patentës europiane, pronari i patentës i paraqet DPPI-së një kërkesë për regjistrimin e patentës europiane në Regjistrin e Patentave. Kërkesa shoqërohet me:

a) përkthimin në anglisht të specifikimeve të patentës europiane të dhënë nëse ajo nuk është lëshuar në anglisht, si dhe përkthimin në shqip të pretendimeve të saj;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

b) vërtetimin e pagesës së tarifës së publikimit.

3. Nëse si rezultat i një kundërshtimi ose i një kërkesë për kufizim, të depozituar në ZEP, patenta europiane mbahet në fuqi me pretendime të ndryshuara, pronari i patentës, brenda tre muajve nga data e publikimit të vendimit për mbajtjen në fuqi me ndryshimet e bëra ose kufizimin, duhet t'i paraqesë DPPI-së përkthimin e pretendimeve në gjuhën shqipe dhe të paguajë tarifën e parashikuar për publikim.

4. Kur pretendimi përmban shenja referencë të përdorura në vizatime, këto vizatime i bashkëlidhen përkthimit, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni.

5. DPPI-ja publikon, sa më parë, çdo përkthim të depozituar rregullisht, sipas pikës 2 ose 3 të këtij neni.

6. Nëse përkthimi i përmendur në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, nuk depozitohet në kohën e duhur ose tarifa e parashikuar nuk paguhet në kohën e duhur, patenta europiane vlerësohet e pavlefshme që nga fillimi, për Shqipërinë. Nenet 34 dhe 35, të këtij ligji, zbatohen *mutatis mutandis*. Afati i përmendur në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, mund të zgjatet me një muaj nëse aplikuesi paguan tarifën shtesë, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

7. Aplikimi për patentë europiane dhe patenta evropiane, mbi të cilën ajo bazohet, vlerësohen se nuk i kanë sjellë që nga fillimi pasojat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, dhe në pikën 2, të nenit 87/ç, të këtij ligji, në masën që patenta është shfuqizuar ose kufizuar në procedimet kundërshtuese, kufizuese apo shfuqizuese.

Neni 87/dh

Teksti autentik i aplikimit për patentë europiane ose i patentës europiane

1. Teksti i aplikimit për një patentë europiane ose i një patente europiane në gjuhën e aplikimit shërben si tekst autentik për të gjitha procedurat në Republikën e Shqipërisë.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1, të këtij neni, përkthimi i paraqitur në përputhje me pikën 2, të nenit 87/ç, dhe pikat 2 dhe 3, të nenit 87/d, të këtij ligji, vlerësohet autentik, me përjashtim të rastit kur ndiqet procedura për shfuqizim, ku aplikimi ose patenta në gjuhën e përkthyer siguron një mbrojtje më të kufizuar se ajo e siguruar prej saj në gjuhën e aplikimit.

3. Aplikuesi ose pronari i patentës mund të depozitojë një përkthim të korrigjuar në çdo kohë. Përkthimi i korrigjuar i një patente europiane nuk ka efekte ligjore, derisa ai të publikohet nga DPPI-ja.

4. Çdo person, i cili në mirëbesim përdor ose ka bërë përgatitje të vërteta dhe serioze për të përdorur një shpikje, përdorimi i së cilës nuk përbën cenim të aplikimit ose të patentës në përkthimin origjinal, mund ta vazhdojë këtë përdorim gjatë zhvillimit të biznesit të vet ose për nevoja të ndryshme, pa kryer ndonjë pagesë, pasi përkthimi i korrigjuar të bëhet i vlefshëm.

Neni 87/e

Mbrojtje e njëhershme

Në rastin kur një patentë europiane që cakton Shqipërinë dhe një patentë kombëtare kanë të njëjtën datë depozitimi ose, kur pretendohet prioritet, të njëjtën datë prioriteti, i është dhënë të njëjtit person ose zëvendësuesit të tij ligjor, patenta kombëtare nuk sjell pasojat në masën që ajo mbulon të njëjtën shpikje me atë të patentës europiane, që nga data kur ka përfunduar afati për depozitim të një kundërshtimi të patentës europiane, pa u depozituar një kundërshtim i tillë, ose që nga data kur procedura e kundërshtimit ka rezultuar me një vendim përfundimtar në favor të patentës europiane.

Neni 87/ë

Konvertimi në aplikim për patentë kombëtare

1. Me kërkesë të aplikuesit për patentë europiane, DPPI-ja ndjek procedurën e dhënies së një patente kombëtare, nëse aplikimi për patentë europiane që cakton Shqipërinë:

a) konsiderohet i tërhequr, sipas pikës 3, të nenit 77, të KEP-it; ose

b) konsiderohet i tërhequr, për arsye se përkthimi i aplikimit për patentë europiane nuk është depozituar në kohën e duhur, sipas pikës 2, të nenit 14, të KEP-it; ose

c) është refuzuar, sipas pikave 3 - 5, të nenit 90, të KEP-it.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, kërkesa për konvertim depozitohet në DPPI, nëse aplikimi për patentë evropiane është depozituar fillimisht në DPPI, së bashku me kërkesën për

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

konvertim, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 87/b, të këtij ligji. DPPI-ja, pasi sigurohet se janë zbatuar kërkesat e nenit 31, të këtij ligji, e përcjell kërkesën në zyrat qendrore të pronësisë industriale të shteteve kontraktore të KEP-it, të specifikuara në kërkesë. DPPI-ja i bashkëlidh kërkesës një kopje të dosjes së aplikimit për patentë europiane.

3. Nëse, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, aplikimi për patentë europiane është depozituar fillimisht në një zyrë qendrore të pronësisë industriale të një shteti tjetër kontraktor të KEP-it, kërkesa për konvertim depozitohet në këtë të fundit. Ajo zyrë ia përcjell kërkesën DPPI-së nëse Shqipëria është e caktuar në të.

4. Afati kohor për përcjelljen e kërkesës, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, dhe sanksionet ligjore për vonesat në përcjellje parashikohen në KEP.

5. Në rastet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, kërkesa për konvertim dorëzohet në ZEP, sipas kërkesave të KEP-it.

6. Afati kohor për depozitimin e kërkesës për konvertim, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe sanksionet ligjore për vonesat në përcjellje parashikohen në KEP.

7. Me marrjen e kërkesës për konvertim, DPPI-ja njofton aplikuesin e saj. Brenda 2 muajve nga data e njoftimit të DPPI-së për marrjen e kërkesës për konvertim, aplikuesi duhet të depozitojë në DPPI:

- a) vërtetimin e pagesës së tarifës për aplikimin për patentë kombëtare; dhe
- b) përkthimin e aplikimit për patentë europiane në shqip.

Nëse aplikuesi nuk i depoziton dokumentet e sipërpërmendura brenda afatit, atëherë kërkesa vlerësohet si e tërhequr.

8. Dokumentet që shoqërojnë kërkesën për konvertim publikohen nga DPPI-ja në mënyrën e caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

9. Specifikimet e patentës, tek një patentë kombëtare që rrjedh nga konvertimi i një aplikimi për patentë europiane, duhet të përmendin këtë aplikim.

Neni 87/f

Tarifat e ripërtëritjes

Tarifat e ripërtëritjes për një patentë europiane i paguhen DPPI-së për çdo vit, duke filluar nga viti pasardhës i atij, në të cilin ZEP-i publikon dhënien e kësaj patente.

Neni 87/g

Shfuqizimi i patentës europiane

1. Patenta europiane mund të shfuqizohet nga DPPI-ja, me efekt për Shqipërinë, në bazë të dispozitave të nenit 138, të KEP-it, dhe nenit 73, të këtij ligji.

2. Nëse kërkesa për shfuqizimin e patentës europiane depozitohet në DPPI, pas fillimit të procedurës së kundërshtimit në ZEP ose fillimit të procedurës në lidhje me një kërkesë kufizimi ose shfuqizimi, sipas nenit 105/a të KEP-it, DPPI-ja pezullon procedurën e shfuqizimit deri në përfundimin e procedurës në ZEP.

Neni 87/gj

Ligji i zbatueshëm

1. Patenta europiane dhe aplikimi për patentë europiane që caktojnë Shqipërinë rregullohen nga ky ligj, përveç kur KEP-i parashikon ndryshe.

2. Në rast konflikti midis dispozitave të KEP-it dhe dispozitave të këtij ligji, dispozitat e KEP-it kanë epërsi.

KREU XIV

PATENTUESHMËRIA E MODELEVE TË PËRDORIMIT

Neni 88

Kushtet për mbrojtjen

Me përjashtim të proceseve, të varieteteve të kafshëve dhe të bimëve, mund të mbrohen, me anë të një modeli përdorimi:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- a) shpikjet, që janë të patentueshme, në përputhje me këtë ligj;
- b) shpikjet, që sjellin risi të zbatueshme në industri e që janë rezultat i një përpjekjeje krijuese.

Neni 89

Risia dhe zbatueshmëria në industri

Risia dhe zbatueshmëria në industri e modeleve të përdorimit përcaktohen në përputhje me nenet 7 e 10 të këtij ligji.

Neni 90

Afati i mbrojtjes

Afati i mbrojtjes së një modeli përdorimi është 10 vjet nga data e depozitimit të aplikimit.

Neni 91

Kthimi në një model përdorimi

Një aplikim për patentë mund të kthehet, me kërkesë me shkrim të aplikantit, në një aplikim për model përdorimi, për sa kohë që patenta nuk është dhënë nga DPPI-ja.

Neni 92

Trajtimi

Trajtimi i modeleve të përdorimit është i njëjtë me trajtimin e patentave, që parashikohet në këtë ligj, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë kapitull.

Neni 93

Mbrojtja nga shkeljet

(ndryshuar me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

Kreu XXXII i këtij ligji zbatohet edhe për modelet e përdorimit *mutatis mutandis*.

KREU XV

GJYKIMET CIVILE

Neni 94

Juridiksioni

Gjykata ka juridiksion për mosmarrëveshjet që lidhen me:

- a) shkeljen e të drejtave të një patente ose të një aplikimi për patentë;
- b) shfuqizimin e një patente ose me kundërpadinë ndaj një patente;
- c) kalimin e pronësisë ose transferimin e së drejtës së një aplikimi për patentë ose të një patente;
- ç) marrëveshjet e licencimit për patentat;
- d) dhënien e një licence jovullnetare;
- dh) vendimet e bordit të apelimit të DPPI-së, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 95

Afati kohor për kryerjen e veprimeve në gjykatë

1. Veprimet në gjykatë mund të kryhen gjatë të gjithë afatit kohor të një patente, nëse mosmarrëveshja ka lindur në bazë të:

- a) shfuqizimit të patentës, sipas nenit 73 të këtij ligji;
- b) një marrëveshjeje licencimi.

2. Për rastet e tjera të mosmarrëveshjeve, që nuk përmenden në pikën e mësipërme, afati kohor për kryerjen e veprimeve në gjykatë është brenda 3 vjetëve, nga çasti kur është shfaqur mosmarrëveshja, përveç rasteve për të cilat, në këtë ligj dhe në dispozita të tjera ligjore në fuqi, parashikohen afate të tjera kohore.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KREU XVI

DHËNIA E CERTIFIKATAVE TË MBROJTJES SHITESË PËR PRODUKTET MJEKËSORE DHE PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Neni 96

Certifikata e mbrojtjes shtesë për produktet mjekësore

Në kuptim të parashikimeve të këtij kreu:

- a) “Produkt” nënkupton përbërësit aktivë ose kombinimin e përbërësve aktivë të një produkti mjekësor, për trajtimin ose parandalimin e sëmundjeve në qeniet njerëzore apo te kafshët, si dhe çdo substancë apo përbërje, që mund të përdoren te qeniet njerëzore apo kafshët, për përcaktimin e një diagnoze mjekësore ose për rivendosjen, rregullimin apo modifikimin e funksioneve fiziologjike te njerëzit ose te kafshët;
- b) “Patentë bazë” nënkupton një patentë të caktuar nga pronari për ndjekjen e procedurës së dhënies së një certifikate, e cila mbron një produkt si ai i përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni, një proces, për të përfutur një produkt ose aplikimin e një produkti;
- c) “Certifikatë” nënkupton certifikatën e mbrojtjes shtesë.

Neni 97

Qëllimi dhe kushtet e pajisjes me certifikatë për produktet mjekësore

DPPI-ja lëshon certifikatën e mbrojtjes shtesë të produktit mjekësor për çdo produkt mjekësor, i cili, para se të hidhet në treg, i nënshtrohet regjistrimit, në përputhje me një rregullore të veçantë, me kusht që:

- produkti të mbrohet nga një patentë bazë, në fuqi, në territorin e Republikës së Shqipërisë, të jetë dhënë një autorizim i vlefshëm për ta hedhur produktin në treg si produkt mjekësor;
- produkti të mos ketë qenë më parë objekt i ndonjë certifikate;
- ç) autorizimi, i përmendur në shkronjën “b” të këtij neni, të jetë autorizues i parë, për të hedhur produktin në treg, si produkt mjekësor.

Neni 98

Certifikata e mbrojtjes shtesë për produktet për mbrojtjen e bimëve

1. “Produktet për mbrojtjen e bimëve” janë substancat dhe preparatet aktive, që përmbajnë një ose më shumë substanca aktive, të rregulluara në formën, në të cilën i ofrohen përdoruesit:

për të mbrojtur bimët ose produktet bimore ndaj çdo organizmi të dëmshëm apo për të parandaluar veprimin e organizmave të tillë, për aq sa këto substanca apo preparate të tilla nuk janë përcaktuar ndryshe më poshtë;

a) për të ndikuar në proceset jetësore të bimëve, përveç atyre që janë lëndë ushqyese (p.sh. rregullatorët e rritjes së bimëve);

b) për të ruajtur produktet bimore, për aq sa substanca ose produkte të tilla nuk u nënshtrohen dispozitave specifike për konservuesit;

ç) për të shkatërruar bimët e padëshirueshme;

për të shkatërruar pjesë të bimëve, për të kontrolluar ose parandaluar rritjen e padëshiruar të tyre.

2. “Substanca” janë elementet kimike, si dhe përbërësit e tyre natyralë ose të prodhuar, përfshirë çdo papastërti, që rezultojnë, në mënyrë të pashmangshme, si pasojë e procesit të prodhimit.

3. “Substanca aktive” janë substancat ose mikroorganizmat, përfshirë edhe viruset, që kanë veprim të përgjithshëm ose të veçantë:

a) kundër organizmave të dëmshëm;

b) mbi bimët, pjesë të bimëve, ose produktet bimore.

4. “Preparate” janë përzierjet ose solucionet e përbëra nga dy ose më shumë substanca, prej të cilave të paktën njëra është substancë aktive, për t’u përdorur si produkt për mbrojtjen e bimëve.

5. “Bimë” janë bimët e gjalla apo pjesë bimësh të gjalla, përfshirë frutat e freskëta dhe farërat.

6. “Produkte bimore” janë produktet, në gjendje të papërpunuar apo që i janë nënshtruar vetëm përgatitjes së thjeshtë, si bluarjes, tharjes ose shtrydhjes, të prejardhura nga bimët, por duke përjashtuar vetë bimët.

7. “Organizma të dëmshëm” janë insektet e bimëve ose produktet bimore, që u përkasin botës bimore dhe/ose shtazore, si dhe viruset, bakteret dhe mykoplazmat e agjentë të tjerë, të cilët shkaktojnë sëmundje.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

8. "Patentë bazë" është patenta, që mbron një produkt si të tillë, një preparat, një proces, për të përfutur një produkt, ose aplikimin e një produkti, i cili caktohet nga pronari i tij për procedurën e dhënies së një certifikate.

9. "Certifikatë" është certifikata e mbrojtjes shtesë.

10. "Produkt" nënkupton substancat aktive ose kombinimin e substancave aktive të një produkti për mbrojtjen e bimëve.

Neni 99

Qëllimi dhe kushtet për pajisjen me një certifikatë

1. DPPI-ja lëshon certifikatë të mbrojtjes shtesë për një produkt për mbrojtjen e bimëve, për çdo produkt, i cili është një substancë aktive e një produkti për mbrojtjen e bimëve, që, para se të hidhet në treg, i nënshtrohet regjistrimit, në bazë të një rregulloreje të posaçme, me kusht që:

- a) ky produkt të mbrohet nga një patentë bazë, që është në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) të jetë dhënë një autorizim i vlefshëm, për ta hedhur produktin në treg, si produkt për mbrojtjen e bimëve;
- c) të mos jetë dhënë më parë ndonjë certifikatë për produktin;
- ç) autorizimi, i përmendur në shkronjën "b" të kësaj pike, të jetë autorizimi i parë për të hedhur produktin në treg, si një produkt për mbrojtjen e bimëve.

2. Pronarit të më shumë se një patente për të njëjtin produkt nuk i jepet më shumë se një certifikatë për atë produkt.

3. Në rastin kur janë duke u shqyrtuar dy apo më shumë aplikime, që lidhen me të njëjtin produkt dhe që burojnë nga dy ose më shumë pronarë të patentave të ndryshme, për këtë produkt mund t'i lëshohet një certifikatë secilit prej pronarëve.

Neni 100

Objekti i mbrojtjes

Brenda kufijve të mbrojtjes, të siguruar nga patenta bazë, mbrojtja e siguruar nga një certifikatë shtrihet vetëm për produktin që mbulohet nga autorizimi për të hedhur në treg produktin përkatës mjekësor ose produktin për mbrojtjen e bimëve, si dhe për çdo përdorim të produktit si produkt mjekësor apo produkt për mbrojtjen e bimëve, i cili është autorizuar para mbarimit të afatit të certifikatës.

Neni 101

Efektet e certifikatës

(shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

Kjo certifikatë siguron të njëjtat të drejta, që janë dhënë nga patenta bazë dhe u nënshtrohet të njëjtave kufizime e detyrime.

Objekti i mbrojtjes dhe efektet e një certifikate të mbrojtjes shtesë zgjaten vetëm te produkti për të cilin është lëshuar autorizimi i parë për hedhjen e produktit në treg dhe për çdo përdorim të autorizuar të këtij produkti.

Neni 102

E drejta për t'u pajisur me certifikatë

Certifikata i jepet pronarit të patentës bazë ose zëvendësuesit të tij ligjor.

Neni 103

Aplikimi për t'u pajisur me certifikatë

1. Aplikimi për një certifikatë duhet të paraqitet brenda gjashtë muajve nga data e dhënies së autorizimit, për ta hedhur produktin në treg si produkt mjekësor ose si produkt për mbrojtjen e bimëve.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, nëse autorizimi për ta hedhur produktin në treg është dhënë para se të jepet patenta bazë, aplikimi për certifikatë duhet të paraqitet brenda gjashtë muajve nga data e dhënies së patentës.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 104

Përmbajtja e aplikimit për certifikatë

(shtuar fjalë në pikën “b” me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

Aplikimi për certifikatë duhet të përmbajë:

- a) kërkesën, ku të shënohen:
 - i) emri dhe adresa;
 - ii) nëse ai ka caktuar një përfaqësues, emri dhe adresa e përfaqësuesit;
 - iii) numri i patentës bazë dhe titulli i shpikjes;
 - iv) numri dhe data e autorizimit të parë, për ta hedhur produktin në treg;
- b) një kopje të autorizimit për hedhjen e produktit në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku identifikohen produkti, numri, data e autorizimit dhe përmbledhja e karakteristikave të produktit;
- c) në rastin kur autorizimi i përmendur në shkronjën “b” të këtij neni, nuk është autorizimi i parë për hedhjen në treg të produktit, si një produkt për mbrojtjen e bimëve, të dhëna për produktin, për të cilin është lëshuar një autorizim i tillë, bazën ligjore, ku është mbështetur procedura e lëshimit të autorizimit, së bashku me një kopje të njoftimit të publikimit zyrtar të autorizimit ose, kur kjo është e pamundur, çdo dokument tjetër, që provon se autorizimi është lëshuar, datën e lëshimit të tij, si dhe produktin për të cilin është lëshuar ai.

Neni 105

Paraqitja e aplikimit për certifikatë

(shtuar fjalë në pikën “ç” me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

Aplikimi për certifikatë duhet të depozitohet në DPPI.

Njoftimi i aplikimit për certifikatë duhet të publikohet nga DPPI-ja dhe duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin dhe adresën e aplikantit;
- b) numrin e patentës bazë;
- c) titullin e shpikjes;
- ç) numrin dhe datën e autorizimit për hedhjen e produktit në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe produktin e identifikuar në këtë autorizim.

Neni 106

Dhënia e certifikatës ose refuzimi i aplikimit

Në rastin kur aplikimi për certifikatë dhe produkti, me të cilin ky aplikim ka lidhje, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë kre, DPPI-ja jep certifikatën përkatëse.

Në rastin kur aplikimi për certifikatë nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 104 të këtij ligji, DPPI-ja i kërkon aplikantit të korrigjojë parregullsitë ose të kryejë pagesën, sipas rastit, brenda afatit të caktuar.

Nëse parregullsia nuk është korrigjuar ose pagesa nuk është kryer, sipas përcaktimit në pikën 2 të këtij neni, DPPI-ja refuzon aplikimin.

Neni 107

Publikimi i certifikatës

1. Njoftimi i dhënies së certifikatës publikohet nga DPPI-ja dhe duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin dhe adresën e mbajtësit të certifikatës;
- b) numrin e patentës bazë;
- c) titullin e shpikjes;
- ç) numrin dhe datën e autorizimit për hedhjen e produktit në treg dhe produktin e identifikuar në këtë autorizim;
- d) kohëzgjatjen e certifikatës.

2. Njoftimi i refuzimit të aplikimit për një certifikatë publikohet nga DPPI-ja dhe duhet të përmbajë të dhënat e parashikuara në pikën 2 të nenit 105 të këtij ligji.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 108

Kohëzgjatja e certifikatës

1. Certifikata hyn në fuqi në fund të kohëzgjatjes së patentës bazë, parashikuar në ligj, për një periudhë të barabartë me periudhën, që ka kaluar nga data në të cilën është depozituar aplikimi, në datën e autorizimit të parë për hedhjen e produktit në treg, duke e zvogëluar me një periudhë prej pesë vjetësh.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, kohëzgjatja e certifikatës nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet nga data, në të cilën ajo hyn në fuqi.

3. Për llogaritjen e kohëzgjatjes së certifikatës mund të merret parasysh edhe një autorizim provizor për hedhjen e parë në treg të produktit, por vetëm nëse ai ndiqet menjëherë nga një autorizim përfundimtar, i lëshuar për të njëjtin produkt.

Neni 109

Mbarimi i afatit të certifikatës

1. Certifikatës i mbaron afati:

- a) në fund të periudhës së parashikuar në nenin 108 të këtij ligji;
- b) kur mbajtësi i certifikatës heq dorë;
- c) kur tarifa vjetore e caktuar nuk paguhet në kohë;
- ç) kur produkti, që mbulohet nga certifikata, nuk mund të hidhet më në treg, pas heqjes dorë nga autorizimi i duhur për hedhjen e tij në treg.

DPPI-ja mund të vendosë mbarimin e afatit të certifikatës me nismën e vet ose me kërkesën e një pale të tretë.

2. Nëse certifikatës i mbaron afati, në përputhje me shkronjat “b”, “c” e “ç” të pikës 1 të këtij neni, njoftimi për këtë publikohet nga DPPI-ja.

Neni 110

Pavlefshmëria e certifikatës

1. Certifikata është e pavlefshme kur:

- a) është dhënë në kundërshtim me nenin 97 ose 99 të këtij ligji;
- b) patentës bazë i ka mbaruar afati para se të përfundonte afati i parashikuar në ligj;
- c) patentë bazë është shfuqizuar apo kufizuar në masën që produkti, për të cilin është dhënë certifikata, të mos mbrohet më nga pretendimet e patentës bazë ose pasi patentës bazë i ka përfunduar afati, apo ka arsye, të cilat justifikojnë një shfuqizim ose kufizim të certifikatës.

2. Çdo person mund të paraqesë një aplikim ose të kërkojë deklarimin e pavlefshëm të certifikatës pranë DPPI-së.

3. Nëse certifikatës i përfundon afati, atëherë njoftimi publikohet nga DPPI-ja.

Neni 111

Apelimet

Vendimet e DPPI-së, të marra sipas këtij kapitulli, janë të hapura ndaj të njëjtave apeline, si ato që parashikohen për vendimet e ngjashme, të marra për patentat.

PJESA II/a

SEKRETET TREGTARE

(shtuar pjesa II/a me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

Neni 111/a

Përkufizime

1. “Sekreti tregtar” është informacioni që përmbush kërkesat e mëposhtme:

- a) është sekret në kuptimin që në tërësinë e tij ose për sa i përket konfigurimit të saktë dhe kombinimit të pjesëve përbërëse të tij, nuk është gjerësisht i njohur ose lehtësisht i aksesueshëm për personat që përgjithësisht merren me llojin e informacionit në fjalë;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- b) ka vlerë tregtare, sepse është sekret;
- c) u është nënshtruar hapave të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit, sipas rrethanave, nga personi që zotëron në mënyrë të ligjshme informacionin për të mbajtur sekretin të fshehtë.
- 2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, me informacion dhe hapa të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit do të kuptojmë:
 - a) informacioni i referuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni përfshin, ndër të tjera, njohuritë teknike, informacionet për shoqërinë tregtare dhe informacionet teknologjike;
 - b) informacioni i referuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni ka vlerë tregtare, ndër të tjera, në ato raste kur përvetësimi, përdorimi ose bërja publike e paligjshme e sekretit tregtar ka mundësi të dëmtojë interesat e personit që kontrollon në mënyrë të ligjshme këtë sekret tregtar, duke cenuar potencialin e tij shkencor dhe teknik, interesat financiare të shoqërisë tregtare, pozicionet strategjike ose mundësinë për të konkurruar;
 - c) hapat e arsyeshëm të referuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni mund të përfshijnë përgatitjen e një akti të brendshëm për administrimin e një sekretit tregtar dhe grupin përkatës të personave, që është përgjegjës për administrimin e tij apo masat për mbrojtjen fizike ose virtuale në aksesin e administrimin e sekretit tregtar.
- 3. “Mbajtës i sekretit tregtar” është çdo person fizik ose juridik që zotëron në mënyrë të ligjshme një sekret tregtar.
- 4. “Shkelës” është çdo person fizik ose juridik që ka përvetësuar, përdorur ose ka bërë publik në mënyrë të kundërligjshme një sekret tregtar.
- 5. “Mallra në shkelje” janë mallrat, disenjimi, karakteristikat, funksionimi, procesi i prodhimit ose tregtimi i të cilave sjell në mënyrë të dukshme përfitime nga sekretet tregtare e të përvetësuara, të përdorura ose të bëra publike në mënyrë paligjshme.

Neni 111/b

Objekti i mbrojtjes dhe fusha e zbatimit të sekretit tregtar

- 1. Objekt i pjesës II/a të këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar.
- 2. Rregullat e përcaktuara në pjesën II/a të këtij ligji kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar nuk cenojnë:
 - a) ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit, duke përfshirë respektimin e lirisë dhe të pluralizmit të medias, sipas legjislacionit në fuqi;
 - b) zbatimin e rregullave që u kërkojnë mbajtësve të sekretit tregtar që të bëjnë publike, për arsye të interesit publik, informacione, përfshirë sekretet tregtare, për publikun ose autoritetet administrative apo gjyqësore gjatë kryerjes së detyrave të tyre;
 - c) zbatimin e rregullave që u kërkojnë ose u lejojnë institucioneve dhe organeve apo autoriteteve publike kombëtare të bëjnë publik informacionin e paraqitur nga shoqëritë tregtare, të cilin këto institucione, organe ose autoritete publike kombëtare mbajnë në përputhje me të drejtat e detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- 3. Asnjë dispozitë e pjesës II/a të këtij ligji nuk përbën arsye për kufizimin e lëvizjes së lirë të punonjësve. Në mënyrë të posaçme, në lidhje me ushtrimin e së drejtës për lëvizjen e lirë të punonjësve, pjesa II/a e këtij ligji nuk paraqet asnjë arsye për:
 - a) kufizimin e përdorimit të informacionit nga punonjësit, i cili nuk përbën sekret tregtar sipas pikës 1 të nenit 111/a;
 - b) kufizimin e përdorimit të eksperiencës dhe të njohurive teknike të përfthuara në mënyrë të ndershme nga punonjësit gjatë veprimtarisë së zakonshme të punësimit të tyre;
 - c) vendosjen e ndonjë kufizimi shtesë ndaj punonjësve në kontratat e tyre të punës, përveç kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin.

Neni 111/c

Përvetësimi, përdorimi dhe bërja publike në mënyrë të ligjshme e sekretit tregtar

- 1. Përvetësimi i sekretit tregtar do të konsiderohet i ligjshëm në rast se sekreti tregtar është siguruar në njëtrën prej mënyrave të mëposhtme:
 - a) një zbulim ose krijim i pavarur;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

b) vëzhgimi, studimi, çmontimi ose testimi i një produkti ose objekti që është bërë i disponueshëm për publikun ose që është në mënyrë të ligjshme në posedimin e përfutuesit të informacionit, i cili është i lirë nga çdo detyrim ligjor i vlefshëm që vendos kufizime për përvetësimin e sekretit tregtar;

c) ushtrimi i së drejtës së punonjësve ose i përfaqësuesve të punonjësve për informim, këshillim dhe pjesëmarrje në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) çdo praktikë tjetër, e cila, sipas rrethanave, është në përputhje me praktikën e ndershme tregtare.

2. Përvetësimi, përdorimi ose bërja publike e sekretit tregtar konsiderohen të ligjshme deri në atë masë që ky përvetësim, përdorim ose bërje publike e sekretit tregtar kërkohet ose lejohet nga ligje të tjera të posaçme.

Neni 111/ç

Përvetësimi, përdorimi dhe bërja publike në mënyrë të paligjshme e sekretit tregtar

1. Mbajtësi i sekretit tregtar ka të drejtë të kërkojë zbatimin e masave, të procedurave dhe të mjeteve mbrojtëse të parashikuara në këtë ligj, me qëllim parandalimin ose shpërblimin e dëmit në rastin e përvetësimit, përdorimit ose bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar.

2. Përvetësimi i sekretit tregtar pa miratimin e mbajtësit të sekretit tregtar do të konsiderohet i paligjshëm në çdo rast që ai kryhet nëpërmjet:

a) aksesit të paautorizuar, përvetësimit ose kopjimit të çdo dokumenti, objekti, materiali, substance ose dosjeje elektronike që ndodhet në mënyrë të ligjshme në zotërim të mbajtësit të sekretit tregtar dhe përmban sekretin tregtar ose prej nga mund të nxirret sekreti tregtar;

b) çdo lloj sjelljeje tjetër që sipas rrethanave do të konsiderohet në kundërshtim me praktikën e ndershme tregtare.

3. Përdorimi ose bërja publike e sekretit tregtar do të konsiderohet e paligjshme në të gjitha ato raste që kryhet pa miratimin e mbajtësit të sekretit tregtar nga një person, i cili rezulton se plotëson një nga kushtet e mëposhtme:

a) ka përvetësuar në mënyrë të paligjshme sekretin tregtar sipas pikës 2 të këtij neni;

b) është në shkelje të marrëveshjes së konfidencialitetit ose të çdo detyrimi tjetër për të mos bërë publik sekretin tregtar;

c) është në shkelje të një detyrimi kontraktual ose çdo detyrimi tjetër që përcakton kufizimin për përdorimin e sekretit tregtar.

4. Përvetësimi, përdorimi ose bërja publike e sekretit tregtar do të konsiderohen gjithashtu të paligjshme në çdo rast që një person në kohën e përvetësimit, përdorimit ose bërjes publike të sekretit tregtar ishte në dijeni ose, sipas rrethanave, duhet të ishte në dijeni të faktit që sekreti tregtar është përfutur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte nga një person tjetër, i cili ishte duke përdorur apo duke bërë publik sekretin tregtar në mënyrë të paligjshme, sipas kuptimit të pikës 3 të këtij neni.

5. Prodhimi, ofrimi, vendosja në treg e mallrave në shkelje ose importimi, eksportimi ose magazinimi i mallrave në shkelje për këto qëllime konsiderohen gjithashtu një përdorim i paligjshëm i sekretit tregtar, kur personi që kryen veprimtarinë të tilla e dinte ose, sipas rrethanave, duhet të ishte në dijeni që sekreti tregtar ishte përdorur në mënyrë të paligjshme, sipas kuptimit të pikës 3 të këtij neni.

Neni 111/d

Përgjashtimet nga zbatimi i masave, i procedurave dhe i mjeteve juridike për mbrojtjen e sekretit tregtar

Kërkesa për zbatimin e masave, të procedurave dhe të mjeteve juridike të parashikuara në këtë ligj refuzohet kur përvetësimi, përdorimi ose bërja publike e supozuar e sekretit tregtar kryhet në njërin prej rasteve të mëposhtme:

a) për ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes dhe informimit, siç përcaktohet në nenin 111/b të këtij ligji, përfshirë respektimin e lirisë dhe pluralizmin e medias sipas legjislacionit në fuqi;

b) për zbulimin e një sjelljeje joprofesionale, shkeljeje ose veprimtarie të paligjshme, me kusht që i padituri të ketë vepruar me qëllimin e mbrojtjes së interesit të përgjithshëm publik;

c) bërja publike e sekretit tregtar nga punonjësit në favor të përfaqësuesve të tyre në kuadër të ushtrimit të ligjshëm të funksioneve të përfaqësuesve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me kusht që bërja publike e sekretit tregtar të jetë e nevojshme për ushtrimin e këtyre funksioneve;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

ç) për qëllim të mbrojtjes së një interesi të ligjshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 111/dh

Parashikime të përgjithshme

Në këtë ligj përcaktohen masat, procedurat e mjetet juridike, që zbatohen për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të sekretit tregtar dhe mundësinë e kompensimit civil kundrejt përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar.

Neni 111/e

Veprimet që përbëjnë shkelje të të drejtave të sekretit tregtar dhe abuzimi me të drejtën për të ngritur padi

1. Veprimet e kryera nga çdo person lidhur me përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar, sipas pikës 111/ç të këtij ligji, përbëjnë shkelje të të drejtave të sekretit tregtar.

2. E drejta për të ngritur padi në gjykatë për shkelje të të drejtave të sekretit tregtar, sipas këtij ligji, i përket mbajtësit të sekretit tregtar.

3. Gjykata kompetente për gjykimin e çështjeve dhe të mosmarrëveshjeve të lidhura me sekretin tregtar është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Me kërkesë të të paditurit, gjykata mund të marrë masa dhe të vendosë dënimin e paditësit që abuzon me të drejtën për të ngritur padi në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile. Konsiderohet se paditësi abuzon me të drejtën për të ngritur padi kur padia e paraqitur prej tij lidhur me përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar është haptazi e pambështetur dhe është konstatuar se paditësi ka filluar procedurat ligjore në mënyrë abuzive ose në keqbesim.

5. Sipas rastit, masa të tilla mund të përfshijnë dënimin me gjobë të paditësit deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, shpërblimin e dëmit ndaj të paditurit dhe detyrimin për publikimin e vendimit gjyqësor në përputhje me nenin 111/k të ligjit.

Neni 111/ë

Afati për ngritjen e padisë

Padia kundër përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar depozitohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 3 (tre) vjetëve nga data kur paditësi merr dijeni për shkeljen e shkelësin.

Neni 111/f

Ruajtja e konfidencialitetit të sekretit tregtar gjatë procesit gjyqësor

1. Palët, avokatët e tyre ose përfaqësuesit e tjerë, personeli gjyqësor, dëshmitarët, ekspertët dhe çdo person tjetër që merr pjesë në procese gjyqësore, që lidhen me përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar, ose që kanë akses në dokumente, të cilat janë pjesë e këtyre proceseve gjyqësore, nuk duhet të përdorin ose të bëjnë publik sekretin tregtar apo sekretin tregtar të supozuar, të cilin gjykata, në përgjigje të një kërkesë të arsyetuar nga një palë e interesuar, e ka identifikuar si informacion konfidencial dhe për të cilin ka marrë dijeni si rezultat i pjesëmarrjes ose i aksesit në të.

2. Masa për ruajtjen e konfidencialitetit të sekretit tregtar mund të merret nga gjykata edhe me vetë iniciativën e saj.

3. Detyrimi i referuar në pikën 1 të këtij neni do të mbetet në fuqi edhe pas përfundimit të procesit gjyqësor.

Pavarësisht për sa më sipër, ky detyrim pushon së ekzistuari në njërin prej rasteve të mëposhtme:

a) kur sekreti tregtar i supozuar ka rezultuar me një vendim të formës së prerë se nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 111/a; ose

b) kur me kalimin e kohës, informacioni në fjalë bëhet gjerësisht i njohur ose lehtësisht i aksesueshëm për personat që përgjithësisht merren me llojin e informacionit në fjalë.

4. Gjykata, bazuar në një kërkesë të arsyetuar nga secila prej palëve, mund të marrë masa specifike për të ruajtur konfidencialitetin e sekretit tregtar ose të sekretit tregtar të supozuar që është përdorur ose referuar gjatë proceseve gjyqësore që lidhen me përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

5. Masat specifike të referuara në pikën 2 të këtij neni, mund të merren edhe me iniciativë të vetë gjykatës, duke përfshirë secilën prej mundësive të mëposhtme:

a) kufizimin e aksesit mbi çdo dokument që përmban sekrete tregtare ose sekrete tregtare të supozuara nga palët ose palë të treta, tërësisht ose pjesërisht, për një numër të kufizuar personash;

b) kufizimin e aksesit në seanca dëgjimore, ku sekretet tregtare ose sekretet tregtare të supozuara mund të bëhen publike, dhe kufizimin e regjistrimeve ose të transkriptimeve përkatëse të këtyre seancave dëgjimore për një numër të kufizuar personash;

c) vënien në dispozicion për çdo person të interesuar, i cili nuk përfshihet në numrin e kufizuar të personave të referuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, të një versioni jokonfidencial të vendimit për çdo vendim gjyqësor, në të cilin pjesët që përmbajnë sekrete tregtare janë hequr ose redaktuar.

6. Numri i personave të referuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 5 të këtij neni, nuk duhet të jetë më i madh se sa është e nevojshme, për të garantuar përputhshmërinë me të drejtën e palëve për të pasur mjete juridike të efektshme dhe të drejtën e palëve për një proces të rregullt gjyqësor, dhe ky numër do të përfshijë të paktën një person fizik nga secila palë dhe avokatët përkatës ose përfaqësuesit e tjerë të këtyre palëve në proces gjyqësor.

7. Kur vendos për masat e përmendura në pikën 2 të këtij neni dhe vlerëson proporcionalitetin e tyre, gjykata merr parasysh nevojën për të siguruar të drejtën e palëve për të pasur mjete juridike të efektshme dhe të drejtën e tyre për një proces të rregullt gjyqësor, interesat legjitime të palëve dhe, kur është e përshtatshme, interesat legjitime të palëve të treta, si dhe çdo dëm të mundshëm që pranimi ose refuzimi i këtyre masave ka shkaktuar për secilën palë dhe kur është e përshtatshme për palët e treta.

8. Përpunimi i të dhënave personale në përputhje me pikat e mësipërme të këtij neni, do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 111/g

Masat e përkohshme

1. Gjikata, me kërkesën e mbajtësit të sekretit tregtar, urdhëron vendosjen e masave të përkohshme, me qëllimin e përfundimit ose të ndërprerjes së veprimeve të përvetësimit, përdorimit ose të bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar, duke përfshirë ndër të tjera:

a) ndalimin e prodhimit, ofrimit, hedhjes në treg ose përdorimit të mallrave cenuese, si dhe ndalimin e importimit, të eksportimit apo të ruajtjes së mallrave cenuese për këto qëllime;

b) konfiskimin ose vënien nën kontroll të mallrave të dyshuara si cenuese deri në përfundim të procesit gjyqësor, duke përfshirë mallrat e importuara, në mënyrë që të ndalohet hyrja ose qarkullimi i tyre në treg;

c) ndalimin e ofrimit ose të sigurimit të shërbimeve që përdorin sekretin tregtar;

ç) ruajtjen e provave të rëndësishme për shkeljen e pretenduar, me kusht që të mbrohet informacioni konfidencial;

d) konfiskimin ose vënien nën kontroll të mjeteve të përdorura për prodhimin e mallrave të dyshuara si cenuese deri në përfundim të procesit gjyqësor;

dh) urdhëron, në rastin e një shkeljeje të kryer në shkallë tregtare dhe, nëse pala e dëmtuar demonstroi rrethana të tilla, që mund të rrezikojnë riparimin e dëmeve, bllokimin e përkohshëm të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të shkelësit të pretenduar, përfshirë edhe bllokimin e llogarive të tij bankare dhe të aseteve të tjera. Për këtë qëllim gjykata mund të urdhërojë paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare, ose shfrytëzimin e mundësive të tjera të përshtatshme për të zotëruar informacionin përkatës.

2. Gjikata vendos për marrjen e masave të përkohshme pa dëgjuar palën tjetër, veçanërisht kur vonesa mund t'i shkaktojë dëme të pariparueshme mbajtësit të sekretit tregtar ose kur provat mund të shkatërrohen.

Pala, kundër së cilës është vendosur masa, njoftohet menjëherë për masat e marra, por jo më vonë se menjëherë pas ekzekutimit të tyre.

Rishikimi, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar, bëhet me kërkesë të palës kundër së cilës është vendosur masa, për të vendosur brenda një kohe të arsyeshme pas njoftimit të marrjes së masave nëse këto masa duhet të ndryshohen, të revokohen ose të konfirmohen.

3. Kur vendos për marrjen e masave të përkohshme, gjykata cakton një afat, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, brenda të cilit personi që ka kërkuar këto masa duhet të ngrejë padi në gjykatë për shkelje të të drejtave të sekretit tregtar.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

4. Masat e përkohshme, duke përfshirë masat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, mund të jepen kundër shkelësit të pretenduar të sekretit tregtar, si dhe në kushte të njëjta kundër ndërmjetësit, shërbimet e të cilit janë përdorur nga pala e tretë për të cenuar këtë të drejtë.

Neni 111/gj

Kushtet dhe kriteret për marrjen e masave të përkohshme

1. Gjykata, lidhur me masat e përmendura në nenin 111/g, ka të drejtë t'i kërkojë paditësit që të paraqesë prova se:

- a) sekreti tregtar ekziston;
- b) paditësi është mbajtës i sekretit tregtar;
- c) sekreti tregtar është përvetësuar, është duke u përdorur ose është bërë publik në mënyrë të paligjshme, ose kur përvetësimi, përdorimi apo bërja publike e sekretit tregtar në mënyrë të paligjshme ka shumë mundësi që të ndodhë.

2. Gjykata, kur vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës për marrjen e masave të përkohshme dhe vlerëson proporcionalitetin e masave, merr parasysh rrethanat specifike të çdo rasti, duke përfshirë, kur është e përshtatshme:

- a) vlerën dhe veçoritë e tjera specifike të sekretit tregtar;
- b) masat e marra për mbrojtjen e sekretit tregtar nga paditësi;
- c) sjelljen e të paditurit në përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar;
- ç) pasojat që ka sjellë përdorimi ose bërja publike në mënyrë të paligjshme e sekretit tregtar;
- d) interesat e ligjshme të palëve dhe pasojat që mund të sjellë miratimi ose refuzimi i masave të përkohshme mbi palët;
- dh) interesat e ligjshme të palëve të treta;
- e) interesin publik; dhe
- ë) mbrojtjen e të drejtave themelore.

3. Me kërkesën e të paditurit, masat e përcaktuara në nenin 111/g revokohen ose bëhen të pavlefshme në rast se:

- a) paditësi nuk paraqet një padi për themelin e çështjes në gjykatë brenda një periudhe prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e vendimit për marrjen e masave të përkohshme;
- b) informacioni në fjalë nuk plotëson më kërkesat e pikës 1 të nenit 111/a, për arsye që nuk mund t'i atribuohen të paditurit.

4. Gjykata mund të vendosë që të ndërmarrë masat e përcaktuara në nenin 111/g kundrejt depozitimit nga paditësi të një garancie të përshtatshme ose të një sigurimi tjetër, të barasvlershëm me të, që synon të sigurojë kompensimin e çdo dëmi që mund t'i shkaktohet të paditurit dhe, kur është e përshtatshme, çdo personi tjetër të prekur nga masat.

5. Kur masat e përcaktuara në nenin 111/g revokohen në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, kur vlefshmëria e këtyre masave përfundon për shkak të ndonjë veprimi apo mosveprimi të paditësit, ose kur rezulton më vonë se nuk ka pasur përvetësim, përdorim ose bërje publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar ose ndonjë rrezik për sjellje të tilla, gjykata ka të drejtë të urdhërojë paditësin, bazuar në kërkesën e të paditurit ose të një pale të tretë të dëmtuar, që t'i sigurojë të paditurit ose palës së tretë të dëmtuar kompensimin e duhur për çdo dëmtim të shkaktuar nga këto masa.

Kërkesa për kompensim u nënshtrohet procedurave të veçanta gjyqësore.

Neni 111/h

Procedurat në rast shkeljeje

1. Mbajtësi i sekretit tregtar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kundrejt çdo personi që shkel të drejtat e tij për të kërkuar:

- a) ndërprerjen e shkeljes ose, sipas rastit, ndalimin e përdorimit ose të bërjes publike të sekretit tregtar;
- b) ndalimin e veprimeve të paautorizuara që shkaktojnë një rrezik serioz për përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike, në mënyrë të paligjshme, të sekretit tregtar;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

c) ndalimin e prodhimit, ofrimit, hedhjes në treg ose përdorimit të mallrave cenuese, si dhe ndalimin e importimit, eksportimit apo ruajtjes së mallrave cenuese për këto qëllime;

ç) heqjen ose bllokimin nga qarkullimi civil të mallrave cenuese, materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura për prodhimin e mallrave cenuese apo ofrimin e shërbimeve në mënyrë të paligjshme;

d) shkatërrimin tërësisht ose pjesërisht të çdo dokumenti, objekti, materiali, substance ose dosjeje elektronike që përmban ose përfshin sekretin tregtar ose, kur është e përshtatshme, vendosjen e të gjithë ose të një pjese të këtyre dokumenteve, objekteve, materialeve, substancave ose dosjeve elektronike nën kontrollin e paditësit;

dh) publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike, sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata;

e) shpërblimin e çdo dëmi të shkaktuar nga përvetësimi, përdorimi ose bërja publike në mënyrë të paligjshme e sekretit tregtar.

2. Gjykata, kur vendos për heqjen e mallrave cenuese nga tregu, mund të urdhërojë që këto mallra t'i dorëzohen mbajtësit të sekretit tregtar ose organizatave të bamirësisë.

Çdo masë e marrë nga gjykata dhe veçanërisht masat e parashikuara në shkronjat “ç”, “d” e “dh” të pikës 1 të këtij neni do të kryhen me shpenzimet e të paditurit.

Neni 111/i

Kushtet dhe kriteret për marrjen e masave

1. Gjykata, kur vendos për marrjen e masave të parashikuara në nenin 111/h dhe vlerëson proporcionalitetin e tyre, merr parasysh rrethanat specifike të çdo rasti, duke përfshirë, kur është e përshtatshme:

a) vlerën ose karakteristikat e tjera specifike të sekretit tregtar;

b) masat e marra për të mbrojtur sekretin tregtar;

c) sjelljen e shkelësit në përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike të sekretit tregtar;

ç) pasojat që ka sjellë përdorimi ose bërja publike në mënyrë të paligjshme e sekretit tregtar;

d) interesat e ligjshme të palëve dhe pasojat që mund të sjellë miratimi ose refuzimi i masave të përkohshme mbi palët;

dh) interesat e ligjshme të palëve të treta;

e) interesin publik; dhe

ë) mbrojtjen e të drejtave themelore.

2. Kur gjykata e kufizon në kohë zgjatjen e masave të përcaktuara në nenin 111/h, kjo periudhë duhet të jetë e mjaftueshme për të eliminuar çdo avantazh tregtar ose ekonomik që shkelësi mund të ketë përfituar nga përvetësimi, përdorimi ose bërja publike në mënyrë të paligjshme e sekretit tregtar.

3. Me kërkesën e të paditurit, gjykata mund të revokojë ose të shpallë të pavlefshme masat e përcaktuara në nenin 111/h të ligjit, nëse informacioni për sekretin tregtar nuk i plotëson më kërkesat e pikës 1 të nenit 111/a të këtij ligji, për arsye që nuk mund t'i atribuohen drejtpërdrejt ose tërthorazi të paditurit.

Neni 111/j

Shpërblimi i dëmit

1. Mbajtësi i sekretit tregtar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit kundrejt shkelësit që ka pasur dijeni ose që duhet të kishte pasur dijeni për përfshirjen e tij në përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar.

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga punëmarrësi ndaj punëdhënësit të tij për përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar të punëdhënësit është e kufizuar kur provohet se punëmarrësi ka vepruar pa dashje.

2. Gjykata, në përputhje me rregullat e përgjithshme të parashikuara në Kodin Civil për shpërblimin e dëmit dhe rregullat përkatëse të përcaktuara në këtë ligj, vendos për masën e dëmshpërblimit. Gjykata, në caktimin e masës së dëmshpërblimit:

a) merr parasysh çdo dëm efektiv dhe real, përfshirë edhe fitimin e munguar që ka pësuar pala e dëmtuar;

b) çdo fitim të padrejtë të realizuar nga shkelësi si rezultat i përvetësimit, përdorimit dhe bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar, dhe, sipas rastit, dëmin moral shkaktuar mbajtësit të sekretit tregtar.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Në rast se e konsideron të përshtatshme, gjykata mund të vendosë edhe shpërblimin e menjëhershëm të dëmit të pësuar, duke llogaritur pagesat që do të kryheshin apo fitimet që do të siguroheshin në rast se shkelësi do të kishte kërkuar autorizimin/licencën për përdorimin e sekretit tregtar.

Neni 111/k

Publikimi i vendimit gjyqësor

1. Në procesin gjyqësor me objekt përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar, gjykata me kërkesë të paditësit dhe më shpenzimet e shkelësit mund të vendosë publikimin e plotë ose të pjesshëm të vendimit gjyqësor.

2. Vendimi i gjykatës publikohet duke respektuar rregullat për konfidencialitetin e sekreteve tregtare, në përputhje me parashikimet e nenit 111/f të këtij ligji.

3. Gjykata merr, gjithashtu, parasysh nëse informacioni për shkelësin është i tillë që lejon personin fizik të identifikohet dhe, në rast se po, nëse publikimi i këtij informacioni është i justifikuar, veçanërisht duke marrë parasysh ndonjë dëm të mundshëm që një masë e tillë mund të shkaktojë në privatësinë dhe reputacionin e shkelësit.

4. Gjykata, kur vendos për publikimin e vendimit gjyqësor dhe vlerëson proporcionalitetin e kësaj mase, merr parasysh vlerën e sekretit tregtar, sjelljen e shkelësit në përvetësimin, përdorimin ose bërjen publike të sekretit tregtar, pasojat që ka sjellë përdorimi ose bërja publike në mënyrë të paligjshme e sekretit tregtar dhe mundësinë për vijimin e përdorimit ose bërjes publike në mënyrë të paligjshme të sekretit tregtar nga shkelësi.

PJESA III

DISENJOT INDUSTRIALE

KREU XVII

PËRKUFIZIMI, KUSHTET DHE E DREJTA E MBROJTJES

Neni 112

Përkufizimi dhe kushtet e mbrojtjes

1. Për qëllim të këtij ligji:

a) “Disenjo industriale” (në vijim “disenjo”), nënkupton karakteristikat e formës së jashtme të një produkti, në përgjithësi, aspekti ornamental ose estetik i një produkti, si një i tërë ose i pjesëve të tij, që i jep atij një pamje të veçantë dhe që nuk përjashtohet nga mbrojtja, sipas pikës 3 të këtij neni.

b) “Produkt” është çdo artikull, i prodhuar në mënyrë industriale apo artizanale, përfshirë ndër të tjera edhe pjesët, që synohen të bashkohen në një produkt kompleks, paketimin, paraqitjen estetike, simbolet grafike dhe printimet tipografike, por duke përjashtuar programet kompjuterike.

c) “Produkt kompleks” është një produkt, i cili është i përbërë nga komponentë të shumëfishtë, që mund të zëvendësohen, duke lejuar shpërbërjen dhe riformimin e produktit.

ç) Disenjot industriale mund të jenë dydimensionale, tridimensionale ose kombinimi i tyre.

2. Për të fituar mbrojtje, një disenjo duhet të jetë e re dhe të ketë karakter individual. Një disenjo e ndërthurur ose e aplikuar në një produkt, që është pjesë përbërëse e një produkti kompleks, mund të vlerësohet e re dhe të ketë karakter individual në qoftë se:

a) Pjesa përbërëse, pasi ndërthuret me produktin kompleks, mbetet e dukshme gjatë përdorimit normal të këtij të fundit.

“Përdorim normal” do të thotë përdorimi nga konsumatorët, përjashtuar mirëmbajtjen, shërbimet ose punët riparuese.

b) Në masën, që këto tipare të dukshme të pjesës përbërëse i përmbushin, në vetvete, kërkesat e risisë dhe karakterin individual.

3. E drejta për disenjo nuk fitohet në rast se tiparet e shfaqjes së jashtme të një produkti:

a) Diktohen vetëm nga funksionimi i tij teknik;

b) Duhet të riprodhohen domosdoshmërisht në formën dhe përmasat e tyre të sakta, për të bërë të mundur që produkti, me të cilin është ndërthurur disenjoja, ose tek i cili disenjoja është aplikuar, të jetë i lidhur mekanikisht apo i vendosur në, përreth apo përkundrejt një produkti tjetër, në mënyrë që secili produkt të mund të kryejë funksionin e vet.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

4. Pavarësisht nga sa parashikohet në shkronjën “b” të pikës 3 të këtij neni, e drejta për diseno, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 113 të këtij ligji, mund të fitohet kur disenjoja i shërben qëllimit, për të lejuar bashkimin e shumëfishtë ose lidhjen e produkteve, që alternohen në mënyrë të ndërsjellë në një sistem modular.

Neni 113

Risia dhe karakteri individual

(ndryshuar pika 1, 2 dhe shtuar shkronja “c” në pikën 3 dhe fjalët në shkronjën “a” pika 3 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Një diseno përbën risi nëse ajo nuk është e njëjtë me një diseno tjetër industriale, e cila i është bërë e njohur publikut përpara datës së depozitimit të aplikimit për regjistrimin e disenos, e cila kërkohet të mbrohet ose, kur pretendohet për prioritet, përpara datës së prioritetit. Disenjt vlerësohen të njëjta, nëse karakteristikat e tyre ndryshojnë vetëm në hollësi të parëndësishme.

2. Një diseno ka karakter individual, nëse përshtypja e përgjithshme, që ajo lë te një përdorues i informuar, ndryshon nga përshtypja e përgjithshme, që lihet tek i njëjti përdorues nga çdo diseno, e cila i është bërë e njohur publikut përpara datës së depozitimit të aplikimit për regjistrimin e disenos, e cila kërkohet të mbrohet ose, kur kërkohet prioritet, përpara datës së prioritetit. Në vlerësimin e karakterit individual të disenos mbahet parasysh shkalla e lirisë së krijuesit të disenos në zhvillimin e saj.

3. Bërja publike e një disenjoje nuk do të merret parasysh në zbatim të pikave 1 e 2 të këtij neni nëse:

a) nuk do të kishte mundësi, në mënyrë të arsyeshme, të bëhej e njohur gjatë ushtrimit normal të biznesit të qarqet e specializuara, në sektorin përkatës, që funksionojnë brenda Republikës së Shqipërisë ose pas aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, në territorin e Bashkimit Europian, përpara datës së depozitimit të aplikimit për regjistrim ose, kur pretendohet për prioritet, përpara datës së prioritetit;

b) kur krijuesi i disenos, zëvendësuesi i tij ligjor ose një person i tretë, si rezultat i informacionit të siguruar ose veprimit të kryer nga krijuesi apo zëvendësuesi i tij ligjor, e ka publikuar, apo e ka përdorur publikisht disenjon, brenda një periudhe prej 12 muajve, përpara datës së depozitimit të aplikimit ose përpara datës së prioritetit, kur pretendohet për prioritet.

c) i është zbuluar një personi të tretë në kushte të shprehura ose të heshtura konfidencialiteti.

4. Shkronja “b” e pikës 3 të këtij neni zbatohet edhe nëse disenjoja është bërë e njohur për publikun si pasojë e një shpërdorimi, kundër krijuesit ose zëvendësuesit të tij ligjor.

Neni 114

E drejta për mbrojtje

(shtuar fjalia e parë në pikën 1 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. E drejta ekskluzive mbi një diseno, sipas këtij ligji, përfitohet me regjistrimin në DPPI. E drejta ekskluzive e pronësisë së një disenjoje i përket krijuesit ose zëvendësuesit të tij ligjor. Në rast se janë dy ose më shumë krijues, ata kanë të drejta të barabarta, përveç kur janë marrë vesh ndryshe në marrëveshjen ndërmjet tyre.

2. E drejta për mbrojtjen e një disenjoje i përket aplikantit, që ka depozituar një aplikim me datë më të hershme depozitimi ose, kur pretendohet për prioritet, me datë më të hershme prioriteti, nëse dy apo më shumë aplikime janë regjistruar nga persona të ndryshëm për të njëjtën diseno, të krijuar në mënyrë të pavarur.

Neni 115

Refuzimi për shkaqe absolute

(shtuar pika 3 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Një diseno nuk mbrohet nëse:

a) nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 112 të këtij ligji;

b) nuk është e re dhe nuk ka karakter individual, në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 2 të nenit 112 të këtij ligji;

c) diktohet ekskluzivisht nga funksioni i produktit ose nga qëllimi i tij për të qenë i lidhur me një produkt tjetër, apo për t'u vendosur në, përreth ose përkundrejt produktit tjetër, në përputhje me parashikimet e pikës 3 të nenit 112 të këtij ligji;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

ç) bie ndesh me moralin ose rendin publik, përfshirë paraqitjen e pahijshme të personave të mirënjohur e të një rëndësie të veçantë për historinë ose trashëgiminë kulturore shqiptare;

d) përfaqëson një skemë abstrakte ose një plan teknik, pa përfshirë shfaqjen e simboleve grafike ose të produkteve të tjera, që shprehin këto skema apo plane;

dh) përmban një stemë, flamur ose emblemë kombëtare, emrin ose shkurtimin e emrit të një vendi apo të një organizate ndërkombëtare, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë lejohet nga autoritetet shtetërore përgjegjëse ose nga organizatat e sipërpërmendura.

2. Shkronja “ç” e pikës 1 të këtij neni nuk zbatohet kur personi i interesuar ose, nëse personi nuk është gjallë, kur autoriteti përgjegjës shtetëror ka dhënë pëlqimin për paraqitjen e tij.

3. Në rastet e listuara në pikën 1, shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “dh”, të këtij neni, disenjoja mund të regjistrohet në një formë të ndryshuar, nëse në atë formë ajo përputhet me kërkesat për mbrojtjen, si dhe ruhet identiteti i disenjos.

Neni 116

Refuzimi për shkaqe relative

(shfuqizuar fjalët në shkronjën “c” dhe shkronjat “d”, “dh” pika 1, shtuar pika 4 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; shtuar shkronja “d” me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017; ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Një disenjo nuk mbrohet nëse:

a) shkel të drejtat e mëparshme të një disenjoje, që është bërë e njohur për publikun pas datës së depozitimit të aplikimit ose datës së prioritetit, kur pretendohet për prioritet dhe që mbrohet në Republikën e Shqipërisë nga një datë përpara datës së dhënë, nëpërmjet regjistrimit ose aplikimit për regjistrimin e disenjos;

b) aplikanti ose mbajtësi i së drejtës së disenjos, sipas nenit 114 të këtij ligji, nuk ka të drejta mbi të;

c) bie në kundërshtim me një të drejtë të mëparshme të pronësisë industriale;

ç) përbën përdorim të paautorizuar të një vepre të mbrojtur nga e drejta e autorit;

d) nëse kërkesa për regjistrimin e saj është bërë në keqbesim.

dh) Shfuqizuar.

2. Në rastet e parashikuara në shkronjat “a” deri në “ç” të pikës 1 të këtij neni, refuzimi i regjistrimit ose shfuqizimi i disenjos industriale, kur disenjoja është e regjistruar, mund të kërkohej vetëm nga personi ose personat, të drejtat e të cilëve janë shkelur.

Në rastin e parashikuar nga shkronja “d” e pikës 1 të këtij neni, refuzimi i regjistrimit ose shfuqizimi i disenjos industriale, kur disenjoja është e regjistruar, mund të kërkohej nga çdo person i interesuar.

3. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, personi, i cili, në bazë të nenit 114 të këtij ligji, ka të drejta mbi disenjon, mund të kërkojë, gjithashtu, të bëhet i njohur si mbajtës i ligjshëm i një disenjoje të regjistruar.

4. Në rastet e listuara në pikën 1, shkronjat “c” dhe “ç”, të këtij neni, disenjoja mund të regjistrohet në një formë të ndryshuar, nëse në atë formë ajo përputhet me kërkesat për mbrojtjen, si dhe ruhet identiteti i disenjos.

Neni 117

Disenjoja industriale, e krijuar me porosi ose nga një punëmarrës

1. Kur një disenjo është krijuar me porosi ose me kontratë pune, e drejta për mbrojtjen e saj i përket porositësit ose punëdhënësit, përveç kur parashikohet ndryshe në marrëveshje.

2. Kur një disenjo ka një vlerë ekonomike shumë më të madhe se ajo e parashikuar nga palët në kohën e nënshkrimit të kontratës, punëmarrësi ka të drejtën e një kompensimi të veçantë. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve, shuma e kompensimit përcaktohet nga gjykata.

3. Kur një punëmarrës, i cili, në bazë të kontratës së punës, nuk është i detyruar të merret me veprimtari krijuese, krijon një disenjo, duke përdorur të dhëna ose mjete të tjera, që janë bërë të njohura ose të mundshme, nëpërmjet punësimit në fushën e veprimtarisë së punëdhënësit, e drejta për mbrojtjen e kësaj disenjoje i takon punëmarrësit, me përjashtim të rasteve kur, brenda 4 muajve nga data, në të cilën i është paraqitur raporti punëdhënësit, sipas pikës 4 të këtij neni ose, nga data kur punëdhënësi është njoftuar për disenjon në mënyrë të tjera, cilado prej tyre është data më e hershme, punëdhënësi e njofton punëmarrësin me një deklaratë me shkrim, se është i interesuar për disenjon.

4. Punëmarrësi, që ka krijuar një disenjo, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, duhet t'i paraqesë menjëherë punëdhënësit një deklaratë me shkrim për disenjon.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

5. Nëse brenda periudhës së përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, punëdhënësi bën një deklaratë me shkrim, duke shprehur interes për disenjon, e drejta për mbrojtjen e saj i takon punëdhënësit që nga fillimi, ndërsa punëmarrësi ka të drejtë të kompensohet, në varësi të pagës, të vlerës ekonomike të disenjos dhe të fitimit, që merr punëdhënësi nga disenjoja. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve, shuma e kompensimit vendoset nga gjykata.

6. Çdo kontratë, që është më pak e favorshme për krijuesin sesa parashikohet në këtë nen, është e pavlefshme.

Neni 118

Emri i krijuesit

Në çdo publikim të DPPI-së për aplikimin ose për regjistrimin e një disenjoje, duhet të përmendet emri i krijuesit apo i krijuesve, përveçse kur krijuesi kërkon me shkrim që emri i tij të mos përmendet.

KREU XVIII

PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË DISENJOVE INDUSTRIALE

Neni 119

Data e depozitimit dhe kërkesat formale për aplikim

(ndryshuar titulli, pika 1 dhe 3, shtuar fjalët në pikën 4 dhe pika 4/a me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Data e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e një disenjoje vlerësohet data kur DPPI-ja merr në dorëzim aplikimin, e cila përmban elementet e mëposhtme:

- a) kërkesën për regjistrim;
- b) identitetin e aplikuesit;
- c) përfaqësimin e disenjos së përshtatshme për riprodhim;
- ç) vërtetim të pagesës së tarifës së depozitimit.

2. Dy ose më shumë disenjo mund të jenë objekt i të njëjtit aplikim, me kusht që ato t'i përkasin së njëjtës klasë edhe nënklasë, në përputhje me klasifikimin ndërkombëtar të Locarnos.

3. Aplikimi për regjistrimin e një disenjoje përmban edhe këto elemente:

- a) emrin dhe adresën e aplikuesit;
- b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit, si dhe autorizimin e përfaqësimit;
- c) treguesin e produktit, në të cilin disenjoja është e përfshirë ose mbi të cilin do të aplikohet;
- ç) përshkrimin e disenjos;
- d) kopje të përfaqësimit të disenjos, në përputhje me kërkesat e rregullores përkatëse;
- dh) klasifikimin e produkteve, në të cilat disenjoja është e përfshirë ose mbi të cilat do të aplikohet, sipas klasifikimit të Locarnos;

e) identitetin e krijuesit ose të krijuesve të disenjos dhe një deklaratë që autorizon aplikuesin ta regjistrojë disenjon kur aplikuesi nuk është krijuesi;

- ë) nënshkrimin e aplikuesit ose të përfaqësuesit të tij;
- f) kërkesa të tjera të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

4. Aplikimi për regjistrimin e një disenjoje, i depozituar pranë DPPI-së, mund të përmbajë një deklaratë, ku pretendohet për prioritet dhe të gëzojë një të drejtë prioriteti, kur ai është i njëjtë me një aplikim të mëparshëm e të rregullt kombëtar, të depozituar nga aplikanti ose zëvendësuesi i tij ligjor:

- a) në bazë të legjislacioni kombëtar të njërës prej shteteve anëtare të Konventës së Parisit;
- b) në bazë të legjislacioni kombëtar të njërës prej shteteve anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë.

Aplikimi i depozituar pranë DPPI-së gëzon të drejtën e prioritetit nga data e depozitimit të aplikimit të mëparshëm, me kusht që kërkesa pranë DPPI-së të bëhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga data e depozitimit të këtij aplikimi.

Aplikim i rregullt kombëtar quhet çdo aplikim, i cili ka plotësuar kërkesat e nevojshme, për të marrë një datë depozitimi, pavarësisht se çfarë ka ndodhur më vonë me të.

Për qëllim të nenit 113, e drejta e prioritetit, e fituar si më sipër, sjell pasojë, që data e prioritetit të quhet si datë depozitimi e disenjos së regjistruar pranë DPPI-së.

4/a. Deklarata që pretendon prioritet depozitohet brenda tre muajve nga data e depozitimit të aplikimit për

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

regjistrim, duke përcaktuar datën e depozitimit dhe numrin e aplikimit të mëparshëm, zyrën në të cilën është depozituar, si dhe duke treguar një kopje të vërtetuar të aplikimit të mëparshëm, në të kundërt e drejta e prioritetit humbet.

5. Paraqitja e aplikimit për regjistrimin e një disenoje, si dhe të gjitha procedurat e tjera përcaktohen në rregulloren përkatëse, në zbatim të këtij ligji.

Neni 119/a

Ndarja e aplikimit të shumëfishtë

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Paraqitësi i aplikimit mund të ndajë aplikimin e shumëfishtë në dy apo më tepër aplikime, të cilat mund të përmbajnë një ose disa diseno.

2. Secili aplikim i ndarë nga aplikimi i shumëfishtë do të ketë si datë depozitimi datën e depozitimit të aplikimit fillestar.

3. Kushtet për ndarjen e aplikimit të shumëfishtë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave për disenjt.

Neni 120

E drejta për prioritetet nga ekspozitat ndërkombëtare

1. Për regjistrimin e një disenoje, paraqitësi i një aplikimi, që ka ekspozuar një produkt ose produkte me këtë diseno në një ekspozitë ndërkombëtare zyrtare, e paraqet aplikimin brenda gjashtë muajve nga data, kur produkti ose produktet e ofruara me këtë diseno u paraqitën për herë të parë në ekspozitë. Në këtë rast, ai ka të drejtë që nga ajo datë të kërkojë të njëjtën prioritet, në përputhje me pikën 4 të nenit 119 të këtij ligji.

2. Certifikata e lëshuar nga autoritetet përgjegjëse të ekspozitës, e cila përmban datën e ekspozimit për herë të parë të disenjos, si dhe të dhëna për produktin ose produktet e ekspozuara, shërben si dëshmi për paraqitjen e ekspozitës së produktit ose të produkteve.

Neni 121

Ekzaminimi i përmbushjes së kërkesave

(ndryshuar neni me ligjet nr. 55/2014, datë 29.5.2014, nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Menjëherë pas marrjes së aplikimit për regjistrimin e një disenoje, DPPI-ja ekzaminon nëse aplikimi përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në pikën 1, të nenit 119. Nëse aplikimi i përmbush këto kërkesa, ai merr si datë depozitimi datën në të cilën aplikimi është paraqitur në DPPI. Nëse aplikimi nuk i përmbush të gjitha këto kërkesa, DPPI-ja njofton aplikuesin të plotësojë kërkesat e parashikuara në pikën 1, të nenit 119, brenda dy muajve nga data e njoftimit. Nëse aplikuesi i plotëson kërkesat e parashikuara në pikën 1, të nenit 119, brenda afatit, DPPI-ja lëshon dëshminë e depozitimit, duke caktuar si datë depozitimi datën në të cilën plotësimi i kërkesave formale të aplikimit është depozituar në DPPI. Nëse plotësimi i aplikimit nuk bëhet brenda këtij afati dymujor, DPPI-ja e refuzon depozitimin e aplikimit dhe njofton me shkrim për këtë aplikuesin.

2. Brenda tre muajve nga data e depozitimit të një aplikimi për regjistrimin e një disenoje, DPPI-ja shqyrton aplikimin nëse përmbush kërkesat që parashikohen në pikat 2 dhe 3, të nenit 119, të këtij ligji. Kur aplikimi nuk i përmbush të gjitha këto kërkesa, DPPI-ja njofton aplikuesin t'i plotësojë ato brenda tre muajve nga data e njoftimit. Nëse aplikuesi nuk i plotëson kërkesat brenda afatit, DPPI-ja e refuzon aplikimin dhe njofton për këtë me shkrim aplikuesin.

3. Afati për paraqitjen e plotësimeve, sipas pikës 2, të këtij neni, zgjatet deri në dy muaj shtesë, nëse aplikuesi paraqet brenda periudhës tremujore nga data e marrjes së njoftimit një kërkesë me shkrim dhe paguan tarifën përkatëse.

Neni 121/a

Ekzaminimi i arsyeve absolute për refuzim

(shtuar neni me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar pika 1 dhe 2 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Brenda 3 (tre) muajve nga data e plotësimit të formaliteteve të parashikuara në pikat 2, 3, 4 e 5 të nenit 119, DPPI-ja ekzaminon nëse disenjoja është në përputhje me të gjitha kërkesat e nenit 115 të këtij ligji, duke

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

përfshirë ekzaminimin e risisë dhe të karakterit individual, të cilat shqyrtohen nga DPPI-ja në vijim të publikimit të disenjës dhe vetëm në rast të depozitimit të një kërkesë për kundërshtim ose shfuqizim nga palë të treta sipas këtij ligji.

Kur aplikimi është në përputhje me të gjitha këto kërkesa të nenit 115, DPPI-ja publikon aplikimin për diseno industriale në buletin e DPPI-së.

2. Nëse disenjoja nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 115, të këtij ligji, DPPI-ja njofton aplikuesin dhe i jep atij mundësinë të parashtrojë, brenda dy muajve nga data e njoftimit, vërejtjet dhe shpjegimet e tij ose të depozitojë dokumente shtesë. Afati për paraqitjen e plotësimeve, sipas kësaj pike, zgjatet deri në dy muaj shtesë, nëse aplikuesi paraqet brenda periudhës dymujore nga data e marrjes së njoftimit një kërkesë me shkrim dhe paguan tarifën përkatëse.

3. Aplikimi refuzohet nëse aplikuesi nuk parashton vërejtjet e tij apo nuk depoziton dokumentet shtesë të kërkuara brenda afatit kohor ose nëse DPPI-ja vëren se aplikimi nuk është në përputhje me nenin 115 edhe pas përgjigjes së aplikuesit. Ky vendim i njoftohet aplikuesit. Vendimi për refuzimin e disenjës, bazuar mbi arsye absolute refuzimi, merret nga DPPI-ja vetëm pasi është marrë vendimi mbi kërkesat formale.

Neni 122

Publikimi i aplikimit

(ndryshuar me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. DPPI-ja publikon të dhënat e aplikimit, i cili përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin 121/a, në buletin e saj të radhës.

2. Të dhënat, që publikohen në buletin, përcaktohen në rregulloren përkatëse.

3. Nëse, së bashku me aplikimin, paraqitet një kërkesë për shtyrjen e publikimit të disenjës së regjistruar ose të disenjave, për një periudhë deri në 12 muaj pas datës së depozitimit të aplikimit, DPPI-ja publikon të dhënat për pronarin e disenjës së regjistruar dhe, pas përfundimit të periudhës, publikon disenjon e regjistruar, përveç rastit kur aplikimi është tërhequr përpara përfundimit të periudhës së shtyrjes.

Neni 122/a

Shfuqizimi ose ndryshimi i akteve administrative me gabime

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Kur DPPI-ja ka marrë një vendim ose ka nxjerrë një akt administrativ në lidhje me një diseno, i cili përmban një gabim të dukshëm të bërë nga vetë DPPI-ja, me kërkesë të palëve të interesuara ose me iniciativë të DPPI-së, kjo e fundit mund të shfuqizojë ose të ndryshojë aktin administrativ.

2. DPPI-ja merr vendim brenda dy muajve në lidhje me kërkesën e paraqitur, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe njofton palët për vendimin e marrë.

3. Kundër vendimit të marrë nga DPPI-ja, sipas pikës 2, të këtij neni, mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda 1 muaji nga data që vendimi u njoftohet palëve.

Neni 122/b

Rivendosja në afat e të drejtave

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Kur, për shkaqe e rrethana të veçanta të krijuara dhe në kundërshtim me vullnetin e tij, aplikuesi i një disenjoje ose mbajtësi i një të drejte të një disenjoje nuk ka qenë në gjendje të respektojë një afat që sjell si pasojë të drejtpërdrejtë refuzimin e aplikimit për diseno, aplikanti ka të drejtë të kërkojë rivendosjen në afat.

2. Në kërkesën për rivendosjen në afat jepen shkaqet dhe rrethanat që kanë penguar aplikuesin ose mbajtësin e së drejtës të respektojë afatin. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 2 muajve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Kërkesa për rivendosje në afat shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse.

3. Nëse kërkesa për rivendosje në afat pranohet, pasojat ligjore që shkaktohen nga mosrespektimi i afatit, konsiderohen se nuk kanë ndodhur.

4. Rivendosja në afat nuk lejohet për:

a) një kërkesë drejtuar Bordit të Apelit të DPPI-së;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- b) një kërkesë drejtuar dhomës për shfuqizim /zhvlerësim;
- c) një kërkesë drejtuar Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve;
- ç) kërkesën për rivendosje në afat, sipas këtij neni.

5. Procedura për depozitimin dhe shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat kryhet në mënyrën që përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave për disenjo.

6. Kundër vendimit të marrë nga DPPI-ja për rivendosjen në afat mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 123

Kundërshtimi ndaj një disenjoje

(shfuqizuar fjalë në shkronjën “c” dhe shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 1 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Kundërshtimi ndaj një disenjoje të publikuar depozitohet në DPPI, brenda një periudhe 3-mujore nga data e publikimit, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, nga:

a) aplikanti i një disenjoje të depozituar më parë në DPPI, ose nga pronari i një disenjoje të regjistruar më parë, në përputhje me përcaktimin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 116 të këtij ligji;

b) personi mbajtës i së drejtës për disenjon, në mbështetje të nenit 114 të këtij ligji, në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 116 të këtij ligji;

c) personi, i cili në kohën e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e një disenjoje, është pronar i një të drejte tjetër të pronësisë industriale, e cila është në konflikt me disenjon, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 116 të këtij ligji;

ç) pronari ose mbajtësi i së drejtës së autorit për një vepër, përdorimi i paautorizuar i së cilës është bërë sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 116 të këtij ligji;

d) Shfuqizuar;

dh) Shfuqizuar.

2. Periudha për paraqitjen e kundërshtimit nuk mund të zgjatet përtej periudhës së parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. DPPI-ja njofton me shkrim aplikantin e disenjos, ndaj së cilës është depozituar kundërshtimi.

4. Të dhënat për mënyrën dhe procedurat e depozitimit të kundërshtimit parashikohen në rregulloren përkatëse.

Neni 124

Procedura e kundërshtimit

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve shqyrton nëse kundërshtimi i depozituar është në përputhje me pikën 1, të nenit 123, të këtij ligji.

2. Nëse kërkesat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, nuk plotësohen, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve refuzon kërkesën për kundërshtim dhe njofton paraqitësin e kërkesës.

3. Nëse kërkesa për kundërshtim plotëson kriteret e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve njofton me shkrim dhe i dërgon një kopje të kundërshtimit aplikantit të disenjos, kundër së cilës është depozituar kundërshtimi, të paraqesë argumentet brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Afati kohor i parashikuar në pikën 3, të këtij neni, nuk mund të zgjatet.

5. Nëse aplikanti nuk i paraqet argumentet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit kohor të parashikuar, Dhoma për Shqyrtimin e kundërshtimeve pranon kundërshtimin.

6. Nëse Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve e konsideron të nevojshme, ajo mund të parashikojë mbajtjen e një seance dëgjimore për palët gjatë ndjekjes së procedurës së kundërshtimit.

Neni 124/a

Shqyrtimi i kundërshtimit

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Nëse aplikanti i disenjos së kundërshtuar paraqet argumentet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit të parashikuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve brenda dy muajve shqyrton argumentet dhe bazën ligjore mbi të cilat mbështetet kundërshtimi.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Nëse gjatë procedurës së shqyrtimit të kundërshtimit Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve konstaton se kundërshtimi është i pabazuar, ajo refuzon kundërshtimin dhe vendimi i njoftohet aplikantit dhe kundërshtuesit.

3. Nëse gjatë procedurës së shqyrtimit të kundërshtimit, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve konstaton se kundërshtimi është pjesërisht i bazuar, regjistrimi i disenjës refuzohet ose pranohet pjesërisht.

4. Kundër vendimit të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të bëhet ankim në bordin e apelit përkundërt pagesës së tarifës përkatëse brenda një periudhe 1-mujore nga data e marrjes së vendimit.

Neni 125

Regjistrimi i disenjës

(ndryshuar neni me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. DPPI-ja njofton aplikuesin të paguajë tarifën e regjistrimit pas kalimit të afatit 3-mujor nga data e publikimit të disenjës, nëse nuk janë depozituar kundërshtime apo kundërshtimet janë refuzuar.

Aplikuesi paguan tarifën e regjistrimit brenda një muaji nga data e njoftimit nga DPPI-ja.

DPPI-ja regjistron disenjon në regjistrin e disenjave dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda tre muajve nga kryerja e pagesës nga aplikuesi.

2. Nëse aplikuesi nuk e paguan tarifën e regjistrimit brenda periudhës së caktuar, në pikën 1, të këtij neni, DPPI-ja e refuzon aplikimin për regjistrimin e disenjës.

3. Disenjoja e regjistruar publikohet në buletinin e DPPI-së.

4. Të dhënat për certifikatën e regjistrimit dhe për publikimin e disenjës parashikohen në rregulloren përkatëse.

Neni 126

Apelimi i vendimit të refuzimit

(ndryshuar fjalët në pikën 1 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e aplikimit për disenjo, sipas pikës 2, të nenit 121, dhe pikës 3, të nenit 121/a, të këtij ligji, aplikanti ka të drejtë, kundërt pagesës së tarifës përkatëse, të apelojë vendimin e DPPI-së në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim.

2. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim shqyrton kërkesën për apelim, brenda një periudhe dymujore nga data e paraqitjes së tij dhe njofton apeluesin për vendimin e marrë.

3. Gjatë shqyrtimit, dhoma për shfuqizim /zhvlerësim ka të drejtë t'i kërkojë apeluesit të vendimit të paraqesë materiale dhe dokumente të tjera shtesë, brenda një periudhe të parashikuar për këtë qëllim në rregulloren përkatëse.

4. Kundër vendimit të marrë nga dhoma për shfuqizim/zhvlerësim mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

KREU XIX

EFEKTET E REGJISTRIMIT TË NJË DISENJOJE

Neni 127

Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi

(ndryshuar pika 1 dhe 3 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Pronari i një disenjoje të regjistruar ka të drejtën ekskluzive për ta përdorur atë dhe për të ndaluar çdo palë të tretë ta përdorë atë pa pëlqimin e tij. Në veçanti, pronari i një disenjoje të regjistruar ka të drejtë të ndalojë persona të tretë të prodhojnë, të ofrojnë, të importojnë, të eksportojnë, të hedhin në treg, të furnizojnë, të shpërndajnë, të përdorin ose të mbajnë në ruajtje apo zotërim, për këto qëllime, çdo produkt, në të cilin është përfshirë disenjoja ose mbi të cilin është aplikuar.

2. Mbrojtja, që sigurohet nga një disenjo, përfshin çdo disenjo që nuk krijon një përshtypje të ndryshme, në tërësi, të përdoruesit i informuar. Në vlerësimin e fushës së mbrojtjes duhet të merret parasysh shkalla e lirisë së krijuesit në zhvillimin e disenjës.

3. Të drejtat e fituara nga një disenjo e regjistruar nuk shtrihen në akte që lidhen me një produkt, në të cilin një disenjo, në kuptim të të drejtave që burojnë prej saj, është e përfshirë ose mbi të cilin është aplikuar nëse

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

produkti në fjalë është hedhur në treg nga vetë pronari ose me pëlqimin e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Të drejtat e fituara nga regjistrimi i një disenoje nuk ushtrohen për:

a) veprimet e kryera privatisht ose për qëllime jotregtare;
b) veprimet e kryera për qëllime eksperimentale;
c) veprimet riprodhuese, për qëllime referuese apo mësimdhënieje, me kusht që të jenë në përputhje me praktikatat e tregtisë së ndershme, të mos cenojnë, në mënyrë të padrejtë, përdorimin normal të disenjës, si dhe të përmendin origjinën e disenjës.

5. Gjithashtu, të drejtat, që sigurohen nga një disenoje e regjistruar, nuk ushtrohen për:

a) pajisjet e anijeve dhe të avionëve, të regjistruar në një vend tjetër, kur këto mjete kanë hyrë përkohësisht në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) importimin, në Republikën e Shqipërisë, të pjesëve të këmbimit dhe të aksesorëve të tjerë për riparimin e këtyre mjeteve;

c) riparimin e këtyre mjeteve;

ç) përdorimin, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, të një pjese përbërëse të një produkti kompleks, për riparimin e këtij produkti, për rivendosjen e pamjes së tij origjinale, me kusht që konsumatorët të jenë informuar rregullisht për origjinën e kësaj pjese, për të bërë zgjedhjen e përshtatshme ndërmjet pjesëve konkurruese të ndërrimit.

Neni 128

Kohëzgjatja dhe ripërtëritja e regjistrimit

1. Regjistrimi i një disenoje është i vlefshëm për 5 vjet, duke filluar nga data e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e saj.

2. Regjistrimi mund të ripërtëritet, kundërt një pagese të caktuar për një periudhë shtesë prej pesë vjetësh, deri në një periudhë prej 25 vjetësh, nga data e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e disenjës.

3. Të dhënat, që duhet të jepen në kërkesën për ripërtëritjen e disenjës dhe procedurat për ripërtëritjen e saj parashikohen në rregulloren përkatëse.

Neni 129

Licencimi

1. Kontrata e licencës bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët kontraktore, në të kundërt ajo është e pavlefshme. Licenca mund të jetë ekskluzive ose joekskluzive. Pronari i disenjës mund të përdorë të drejtat, që rrjedhin nga regjistrimi i disenjës, kundër të licencuarit, që shkel kushtet e përcaktuara në kontratë, për kohëzgjatjen e saj, formën, në të cilën do të përdoret, listën e cilësive të produkteve, që do të prodhojë i licencuari për të cilat është dhënë licenca.

2. Kontrata e licencës regjistrohet në DPPI, në regjistrin e disenjave, kundërt pagesës së një tarife të caktuar. I licencuari ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për kontratën e licencës, vetëm pasi kontrata të jetë regjistruar në regjistrin e disenjave. I licencuari ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë dhe të kryejë çdo veprim tjetër, të njohur me ligj, kundër shkeljes së të drejtave mbi disenjon, vetëm me pëlqimin e licencuesit, përveç kur në kontratën e licencës është parashikuar ndryshe. Kur licenca është ekskluzive, i licencuari ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë dhe të kryejë çdo veprim tjetër, të njohur me ligj, kundër shkeljes së të drejtave mbi disenjon edhe pa pëlqimin e licencuesit, nëse ai, edhe pse është njoftuar nga i licencuari, nuk kryen asnjë veprim ligjor, të njohur me ligj, për mbrojtjen e disenjës, brenda një periudhe kohe të arsyeshme. I licencuari ka të drejtë të ndërhyjë për një padi të ngritur nga licencuesi kundër shkeljes së të drejtave mbi disenjon, kur ndërhyrja ka për qëllim shpërblimin e dëmit të pësuar prej tij nga shkelja e të drejtave.

3. Të dhënat për depozitimin e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e kontratës së licencës parashikohen në rregulloren përkatëse, në zbatim të këtij ligji.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 129/a

E drejta për vendosje pengu mbi një diseno industriale

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Disenjoja industriale është objekt mbi të cilin mund të vendoset pengu.
2. Me kërkesë të njëres prej palëve në kontratë, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, kontrata e vendosjes së pengut mbi një diseno industriale regjistrohet në regjistrin e disenjove.
3. Regjistrimi i vendosjes së një pengu publikohet në buletin e DPPI-së.
4. Pengu krijon pasoja juridike vetëm pas regjistrimit të kontratës së pengut në regjistër.
5. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e pengut përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave për disenjt.

Neni 129/b

Procedura e veprimeve përmbarimore

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Disenjoja industriale mund të sigurohet dhe të jetë objekt i veprimeve përmbarimore.
2. Me kërkesën e njëres nga palët, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, një veprim përmbarimor i marrë ndaj një disenjoje regjistrohet në regjistrin e disenjove dhe publikohet në buletin e DPPI-së.
3. Një veprim përmbarimor krijon pasoja juridike pas regjistrimit të veprimit përmbarimor në regjistrin e disenjove.
4. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e një veprimi përmbarimor përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për disenjt.

Neni 130

Ndryshimi i emrit dhe/ose adresës

1. DPPI-ja, me kërkesë të pronarit të disenjës, regjistron ndryshimet në emrin dhe/ose adresën e pronarit në regjistrin e disenjove, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.
2. Të dhënat për depozitimin e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e këtyre ndryshimeve parashikohen në rregulloren përkatëse.

Neni 131

Kalimi i pronësisë së disenjës

1. DPPI-ja regjistron në regjistrin e disenjove, me kërkesë të pronarit të disenjës ose të pronarit të ri të saj, transferimin e pronësisë së kësaj disenjoje, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.
2. Pronari i një disenjoje të regjistruar mund të transferojë të drejtat e tij mbi disenjon, plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet një marrëveshjeje, të nënshkruar nga të dyja palët, e cila depozitohet në DPPI.
3. Të drejtat mbi disenjon mund të transferohen së bashku me veprimtarinë e biznesit ose pa e transferuar këtë të fundit.
4. Transferimi nuk ka efekt ligjor, nëse nuk regjistrohet në regjistrin e disenjove.
5. DPPI-ja refuzon regjistrimin në regjistër të një transferimi pronësie të kërkuar, në rast se dokumentacioni përkatës nuk paraqitet brenda afatit të caktuar.
6. Të dhënat për depozitimin e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë parashikohen në rregulloren përkatëse.

KREU XX

(shfuqizuar kreu me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KREU XXI HEQJA DORË DHE SHFUQIZIMI

Neni 137

Heqja dorë nga një diseno

1. Për të hequr dorë nga regjistrimi, pronari i disenjës duhet t'i paraqesë DPPI-së një deklaratë me shkrim, të shoqëruar me autorizimin e përfaqësimit dhe dokumentin, që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës përkatëse. Heqja dorë nga disenjoja e regjistruar hyn në fuqi në datën kur është depozituar kërkesa pranë DPPI-së. Nëse regjistrimi është bërë për një grup disenjosh të ndara, heqja dorë mund të bëhet për të gjitha ose për disa prej tyre.

2. DPPI-ja regjstron heqjen dorë nga disenjoja në regjistrin e disenjave dhe e publikon atë. Nëse për disenjon, për të cilën kërkohet dorëheqja, është regjistruar një kontratë licence, dorëheqja regjistrohet nga DPPI-ja vetëm pasi pronari i disenjës provon se i licencuari është në dijeni për këtë veprim. Nëse për disenjon, për të cilën kërkohet dorëheqja, ka filluar një procedurë gjyqësore për të drejtën për mbrojtjen e saj, parashikuar në nenin 114 të këtij ligji, dorëheqja nuk mund të regjistrohet nga DPPI-ja pa miratimin e paditësit.

Neni 138

Shfuqizimi i disenjës

(ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Personi i interesuar, përkundrejt tarifës përkatëse, mund t'i drejtohet dhomës për shfuqizim/zhvlerësim për të kërkuar shfuqizimin e një disenjoje të regjistruar, nëse ajo nuk i përmbush kushtet për t'u mbrojtur, sipas neneve 115 dhe 116, të këtij ligji, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) nëse është duke u zhvilluar një proces në lidhje me këtë disenjo në gjykatë, kërkesa duhet të bëhet në gjykatë;

b) kur, në çdo rast tjetër, kërkesa është bërë në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim, personi, në çdo fazë të procedurës në DPPI mund t'ia drejtojë kërkesën gjykatës.

2. Disenjoja e regjistruar mund të mbahet në një formë të ndryshuar, nëse në formën e ndryshuar ajo i përmbush kërkesat për mbrojtje dhe identiteti i saj ruhet.

3. Çdo disenjo e regjistruar që shfuqizohet, zhvlerësohet nga data e depozitimit të saj.

4. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim merr vendim në lidhje me kërkesën e paraqitur, sipas pikës 1, të këtij neni, brenda 3 muajve nga data plotësimit të pretendimeve, prapësimeve dhe paraqitjes së të gjitha provave nga palët.

5. Shfuqizimi i një disenjoje të regjistruar nuk mund të bëhet pa u thirrur për t'u dëgjuar pronari i saj.

6. Vendimi i dhomës për shfuqizim/zhvlerësim mund të ankimohet, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, në Bordin e Apelit, brenda 1 muaji nga data që vendimi u njoftohet palëve.

KREU XXII MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Neni 139

Kërkesat sipas Marrëveshjes së Hagës

1. Aplikimet për regjistrimin ndërkombëtar të një disenjoje depozitohen në Zyrën Ndërkombëtare të Pronësisë Industriale, në përputhje me Marrëveshjen e Hagës "Mbi regjistrimin ndërkombëtar të disenjave industriale" datë 28 nëntor 1960, plotësuar më 14 korrik 1967 dhe ndryshuar më 28 shtator 1979 dhe me rregullat e nxjerra në zbatim të saj.

2. Në përputhje me nenin 8 të Marrëveshjes së Hagës, dispozitat e këtij ligji, për mbrojtjen e një disenjoje në Republikën e Shqipërisë, zbatohen *mutatis mutandis*.

**PJESA IV
MARKAT TREGTARE DHE TË SHËRBIMIT**

**KREU XXIII
KUSHTET DHE E DREJTA PËR MBROJTJEN**

Neni 140

Shenjat që mund të përbëjnë markë
(ndryshuar fjalia e parë e pikës 2 me ligjin nr. 55/2014,
datë 29.5.2014; ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

Një markë mund të jetë çdo shenjë, në veçanti fjalët, duke përfshirë emrat personalë ose disenjimet, shkronjat, numrat, ngjyrat, formën e mallrave ose të paketimeve të tyre ose tingujt, me kusht që këto shenja të jenë të afta:

- a) të dallojnë mallrat apo shërbimet e një personi fizik apo juridik nga ato të një personi tjetër fizik apo juridik;
- b) të përfaqësohen në regjistër në mënyrë të tillë, që të mundësojnë autoritetet kompetente dhe publikun të përcaktojnë qartë dhe saktë objektin e mbrojtjes që i njihet pronarit të saj.

Neni 141

Karakteret dallues

1. Një shenjë ka karakter dallues, nëse nëpërmjet saj përdoruesi i zakonshëm dallon një numër mallrash dhe shërbimesh specifike, nga një tjetër numër mallrash dhe shërbimesh, të njëjta me të parat, e lidhur, përkatësisht, me origjinën tregtare të tyre.

2. Karakteri dallues i një shenje vlerësohet në lidhje të ngushtë me mallrat dhe shërbimet, të cilat shenja ka për qëllim t'i dallojë.

Neni 142

Refuzimi ose shfuqizimi për shkaqe absolute

(shfuqizuar shkronja "j", ndryshuar shkronja "g" dhe shtuar shkronjat "h", "i" me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014;
ndryshuar titull, pika 1 dhe 2 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Një shenjë nuk regjistrohet si markë ose nëse regjistrohet, mund të shfuqizohet kur:
- a) nuk ka karakter dallues;
 - b) përbëhet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, që shërbejnë në treg për të treguar llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin, vlerën, origjinën gjeografike ose kohën e prodhimit të mallrave apo të kryerjes së shërbimeve, ose për të treguar karakteristika të tjera të mallrave apo të shërbimeve;
 - c) përbëhet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, që janë bërë të zakonshëm në gjuhën e përditshme apo që janë kthyer në praktika tregtare;
 - ç) përbëhet nga forma ose vija, të imponuara nga vetë natyra e mallrave apo e shërbimeve dhe/ose forma apo linja thelbësore, për të përmbushur një rezultat teknik;
 - d) përbëhet nga forma, që u japin mallrave një vlerë thelbësore;
 - dh) përbëhet nga elemente, që cenojnë interesin publik ose që bien në kundërshtim me vlerat morale apo rendin publik;
 - e) përbëhet nga elemente, që kanë prirje të çorientojnë publikun për natyrën, cilësinë, origjinën gjeografike ose tregtare të mallrave dhe/ose shërbimeve, që ato kanë për qëllim të dallojnë;
 - ë) përbëhet nga tregues gjeografikë, për verërat ose pijet alkoolike, që nuk e kanë origjinën gjeografike nga vendet, që tregohen në këta tregues, edhe nëse tregohet origjina e vërtetë e produkteve, ose treguesit gjeografikë janë përkthyer apo shoqëruar me shprehje të tilla, si "lloji" "tipi" "stili" "imitimi" ose shprehje të ngjashme;
 - f) shfuqizuar;
 - g) përbëhet nga:
 - i) emra shtetesh (të plotë ose të shkurtuar);
 - ii) emblema shtetërore, medalje, urdhra nderi;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- iii) vula dhe shenja zyrtare të miratuara nga vendi;
 - iv) emblemat e organizatave të njohura ndërkombëtare ose shkurtimet e tyre;
 - v) simbolet fetare;
 - vi) flamujt kombëtarë;
 - gj) përbëhet nga elemente, që bien në kundërshtim me nenin 6 ter të Konventës së Parisit, përveç kur autoritetet kompetente kanë autorizuar përdorimin e tyre.
 - h) nuk përbën markë, sipas nenit 140 të këtij ligji;
 - i) përmban ose përbëhet nga një emërtim origjine ose një tregues gjeografik, me efekt në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse kërkesa për regjistrimin e markës është dorëzuar pas datës së dorëzimit të kërkesës për regjistrimin e emërimit të origjinës ose treguesit gjeografik dhe me qëllim mbrojtjen e tyre, të parashikuar në legjislacionin, në bazë të të cilit janë regjistruar ato dhe që kanë lidhje me të njëjtin lloj produktesh.
2. Një shenjë nuk përjashtohet nga regjistrimi si markë, në përputhje me shkronjat “a”, “b” e “c”, të pikës 1, të këtij neni, në qoftë se marka, objekt shqyrtimi, ka fituar karakter dallues në procesin e përdorimit përpara datës së aplikimit. Një markë tregtare nuk mund të zhvlerësohet për të njëjtat arsye, nëse, para datës së kërkesës për shfuqizim, për shkak të përdorimit të saj, ajo ka fituar karakter dallues.

Neni 143

Refuzimi ose shfuqizimi për shkaqe relative

*(shfuqizuar fjalët në shkronjën “ç” pika 5 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014;
ndryshuar titulli, shtuar shkronja “ç” e pikës 2, shkronjat “b”, “c”, shtuar shkronja
“d” të pikës 3, shtuar pika 6 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)*

1. Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme.
2. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur:
 - a) është e njëjtë me një markë të mëparshme dhe mallrat e shërbimet, për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme;
 - b) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëjlojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkakutit të konfuzionit të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën e mëparshme;
 - c) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, edhe kur është për t'u regjistruar ose është regjistruar për mallra apo shërbime, që nuk janë të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar marka e mëparshme, kur marka e mëparshme ka një reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimi ose regjistrimi i markës në fjalë, pa shkak të arsyeshem, fiton prioritet të padrejtë ose dëmton natyrën dalluese apo emrin e mirë të markës së mëparshme.
- ç) nëse kërkesa për regjistrimin e saj është bërë në keqbesim.
3. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nëse cenon të drejtat e mëparshme, të fituara, si:
 - a) të drejtën e emrit tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjtë apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;
 - b) të drejtën e një individi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;
 - c) të drejtat e pronësisë industriale, emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografikë;
 - ç) të drejtat e autorit të një veprë ose të një pjese të saj, me kusht që ajo të jetë e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të mbrohet.
 - d) të drejtat e një marke të paregjistruar ose një shenje tjetër, të fituara nga përdorimi për një kohë të gjatë në një aktivitet tregtar dhe shtrirja e gjerë territoriale.
4. Marka nuk mbrohet, nëse është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të regjistruar, për mallra apo shërbime të njëjta ose të ngjashme dhe nëse vlefshmëria e saj ka mbaruar për shkak të mbarimit të afatit të mbrojtjes, për një periudhë gjashtëmujore nga mbarimi i këtij afati.
5. Markë e mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet:
 - a) marka, me një datë aplikimi për regjistrim më të hershme sesa data e aplikimit për regjistrim e një marke

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

tjetër tregtare, duke pasur parasysh, kur është rasti, pretendimin për prioritet për atë markë, sipas nenit 147 të këtij ligji;

b) marka, që është regjistruar më parë, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë;

c) aplikimi për një markë, sipas përcaktimit të shkronjave “a” e “b” të kësaj pike, në varësi të regjistrimit të tyre;

ç) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit.

6. Kriteret në lidhje me markat e mirënjohura përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.

Neni 144

E drejta për markë

E drejta ekskluzive për markat, sipas këtij ligji, fitohet nëpërmjet regjistrimit të tyre në DPPI.

KREU XXIV

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË MARKËS

Neni 145

Përmbajtja e kërkesës

(shfuqizuar fjalët në shkronjën “c” dhe shkronja “ç” pika 4, ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar pika 1 dhe shtuar pika 6 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Kërkesa për të fituar të drejtën mbi një markë mund të bëhet nga çdo person.

2. Për çdo shenjë, për të cilën kërkohet mbrojtja si markë, duhet të bëhet kërkesë e veçantë.

3. Kërkesa për të regjistruar një markë përmban një ose disa klasa mallrash dhe/ose shërbimesh.

4. Kërkesa për regjistrimin e një marke përmban elementet e mëposhtme:

a) emrin dhe adresën e aplikantit;

b) përfaqësimin (pamjen) e markës, për të cilën kërkohet regjistrimi;

c) listën e mallrave dhe/ose të shërbimeve, për të cilat kërkohet regjistrimi;

ç) Shfuqizuar;

d) dokumentin, që vërteton pagesën e tarifës së caktuar për depozitimin.

5. Kërkesa për të regjistruar një markë përmban, gjithashtu:

a) emrin dhe adresën e përfaqësuesit të aplikuesit, si dhe autorizimin e përfaqësimit nëse kërkesa depozitohet nga përfaqësuesi;

b) listën e mallrave dhe/ose të shërbimeve, të grupuara në klasa, në përputhje me klasifikimin e Nicës;

c) një dokument që përcakton rregullat e përdorimit të markës në rastin e markës kolektive;

ç) deklarin e përjashtimit nga mbrojtja të elementeve të markës që janë përshkruese ose që nuk kanë karakter dallues;

d) nënshkrimin e aplikuesit apo të përfaqësuesit të tij;

dh) elemente të tjera të aplikimit, të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

6. Pas datës së lëshimit të dëshmisë së depozitimit nga DPPI-ja, ndalohet të bëhen shtesa në listën e mallrave ose shërbimeve apo ndryshime në pamjen e markës, përveç rasteve që lidhen me bërjen e korrigjimeve ortografike ose saktësimeve në listën e mallrave ose shërbimeve.

Neni 146

Data e depozitimit

(ndryshuar me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

Data e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e një marke është data kur DPPI-ja merr në dorëzim aplikimin me elementet e parashikuara në pikën 4, të nenit 145, të këtij ligji, në të kundërt, data e depozitimit të aplikimit konsiderohet data, në të cilën plotësohen kërkesat e pikës 4, të nenit 145, të këtij ligji.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 147

E drejta për prioritet

1. Aplikimi për regjistrimin e një marke, i depozituar pranë DPPI-së, mund të përmbajë një deklaratë, ku kërkohet prioritet dhe të gëzojë një të drejtë prioriteti, kur ai është i njëjtë me një aplikim të mëparshëm e të rregullt kombëtar, të depozituar për të njëjtën markë dhe për të njëjtat mallra dhe/ose shërbime nga aplikanti ose zëvendësuesi i tij ligjor, në bazë të:

legjislacioni kombëtar të njërit prej shteteve anëtare të Konventës së Parisit;

legjislacioni kombëtar të njërit prej shteteve anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë.

Aplikim i rregullt kombëtar, quhet çdo aplikim, i cili ka plotësuar kërkesat e nevojshme, për të marrë një datë depozitimi, pavarësisht se çfarë ka ndodhur më vonë me të.

2. Aplikimi i depozituar sipas pikës 1 të këtij neni, gëzon të drejtën e prioritetit nga data e depozitimit të aplikimit të parë, me kusht që kërkesa pranë DPPI-së të bëhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga data e depozitimit të aplikimit të parë. E drejta e prioritetit, e fituar si më sipër, sjell si pasojë që data e prioritetit quhet si datë depozitimi e aplikimit për regjistrimin e markës pranë DPPI-së, me qëllim për të përcaktuar se cili aplikim gëzon një të drejtë të mëparshme.

3. Aplikanti, i cili synon të përdorë të drejtën e prioritetit, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, paraqet në DPPI të gjithë informacionin për aplikimin e parë (datën, vendin dhe numrin e aplikimit të parë) dhe, brenda një periudhe tremujore nga data e paraqitjes së kërkesës, depoziton në DPPI një kopje të aplikimit të parë dhe përkthimin e tij në shqip.

Neni 148

E drejta për prioritet

(ndryshuar titulli me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Personi që ka ekspozuar mallrat dhe/ose shërbimet, me një shenjë të caktuar, në një ekspozitë të njohur në Republikën e Shqipërisë ose në një vend tjetër, që është anëtar i Konventës së Parisit, brenda gjashtë muajve mund të aplikojë për regjistrimin e markës, duke kërkuar si datë prioriteti datën e ekspozimit të mallrave dhe/ose shërbimeve në ekspozitë.

2. Kërkesa e përmendur në pikën 1 të këtij neni shoqërohet me një certifikatë të lëshuar nga autoritetet përkatëse të shtetit anëtar të Konventës së Parisit dhe një dokument, ku përcaktohen lloji i ekspozitës ose i panairit, vendi i organizimit, data e hapjes dhe e mbylljes, si dhe dita e parë e ekspozimit të produkteve dhe/ose shërbimeve, të përcaktuara në kërkesën për regjistrimin e markës.

Neni 149

Ndarja e aplikimit dhe e regjistrimit të një marke

(ndryshuar me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Aplikanti ose pronari i një marke mund të kërkojë ndarjen e një aplikimi për regjistrimin e markës ose një marke të regjistruar në dy ose më shumë aplikime, ose regjistrime të ndara, duke depozituar pranë DPPI-së një kërkesë, në të cilën të përcaktojnë saktë mallrat dhe/ose shërbimet e përfshira në aplikimin ose regjistrimin fillestar që do të mbulohen nga secili aplikim ose regjistrim i ndarë.

2. Të dhënat për mënyrën e depozitimit të kërkesës dhe procedura e nevojshme për ndarjen e aplikimit apo e regjistrimit të markës do të përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.

Neni 150

Ekzaminimi i përmbushjes së kërkesave

(ndryshuar pika 6 dhe 7 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014;

ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. DPPI-ja ekzaminon kërkesat për regjistrimin e markave, sipas numrit rendor të paraqitjes së tyre.

2. Një kërkesë ekzaminohet jashtë numrit rendor, kur:

a) depozitohet një kërkesë për regjistrim ndërkombëtar të markës, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse;

b) është depozituar një kërkesë për ekzaminim jashtë numrit rendor, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

3. Menjëherë pas marrjes së aplikimit, DPPI-ja ekzaminon nëse aplikimi është në përputhje me kërkesat e

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

pikës 4, të nenit 145, të këtij ligji. Kur aplikimi nuk i përmbush të gjitha kërkesat e pikës 4, të nenit 145, DPPI-ja njofton aplikuesin t'i plotësojë ato brenda dy muajve nga data e njoftimit. Nëse aplikimi plotësohet brenda afatit, DPPI-ja lëshon dëshminë e depozitimit, duke shënuar si datë depozitimi datën në të cilën paraqitet plotësimi i aplikimit në DPPI. Nëse plotësimi i aplikimit nuk bëhet brenda këtij afati dymujor, DPPI-ja e refuzon depozitimin e aplikimit dhe njofton me shkrim për këtë aplikuesin.

4. Brenda tre muajve nga data e lëshimit të dëshmisë së depozitimit për aplikimin për regjistrimin e një marke, DPPI-ja ekzaminon aplikimin nëse përmbushen kërkesat e pikave 1, 2, 3, 5 dhe 6, të nenit 145, të këtij ligji. Kur aplikimi nuk përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6, të nenit 145, DPPI-ja njofton aplikuesin t'i plotësojë ato brenda tre muajve nga data e njoftimit. Nëse aplikuesi nuk i plotëson kërkesat brenda afatit, DPPI-ja e refuzon aplikimin dhe njofton për këtë me shkrim aplikuesin.

5. Afati për paraqitjen e plotësimeve, sipas pikës 4, të këtij neni, zgjatet deri në dy muaj shtesë, nëse aplikuesi paraqet brenda periudhës tremujore nga data e marrjes së njoftimit një kërkesë me shkrim dhe paguan tarifën përkatëse.

Neni 150/a

Ekzaminimi i shkaqeve absolute për refuzim

(shtuar neni me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017; shtuar pika 6 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Brenda tre muajve nga data e plotësimit të kërkesave, sipas pikave 1, 2, 3, 5 dhe 6, të nenit 145, DPPI-ja ekzaminon nëse marka është në përputhje me kërkesat e neneve 140 dhe 142, të këtij ligji. Kur aplikimi është në përputhje me këto kërkesa, DPPI-ja publikon aplikimin për regjistrim marke në buletin e saj të radhës.

2. Nëse marka nuk është në përputhje me kërkesat e neneve 140 e 142, DPPI-ja njofton aplikuesin dhe i jep atij mundësinë, brenda dy muajve nga data e njoftimit, të paraqesë shpjegimet e tij, si dhe dokumente shtesë, sipas rastit. Afati për paraqitjen e plotësimeve, sipas kësaj pike, zgjatet deri në dy muaj shtesë, nëse aplikuesi paraqet brenda periudhës dymujore nga data e marrjes së njoftimit një kërkesë me shkrim dhe paguan tarifën përkatëse.

3. Nëse një markë përmban një element, i cili, sipas DPPI-së, nuk është dallues, dhe kur përfshirja e atij elementi te marka mund të ngrejë dyshime nëse marka mund të mbrohet ose jo, DPPI-ja mund t'i kërkojë aplikuesit, si kusht për regjistrimin e markës në fjalë, që të heqë dorë dhe të përjashtojë nga mbrojtja çdo të drejtë ekskluzive mbi atë element. Ky përjashtim duhet të regjistrohet dhe të publikohet së bashku me aplikimin ose regjistrimin e markës, sipas rastit.

4. Aplikimi refuzohet kur:

- a) aplikuesi nuk parashtron shpjegimet e tij;
- b) nuk plotëson dokumentacionin brenda afatit kohor;
- c) nëse DPPI-ja vëren se aplikimi nuk është në përputhje me përcaktimet e neneve 140 dhe 142, të këtij ligji, edhe pas shpjegimeve të aplikuesit.

Ky vendim i njoftohet aplikuesit.

5. Aplikimi nuk duhet të refuzohet përpara sesa t'i jetë dhënë aplikuesit njoftimi dhe afati përkatës që të paraqesë shpjegimet e tij ose përjashtimin nga mbrojtja të një elementi të markës ose ndryshimin e pranueshëm të elementit.

6. Nëse një element, i cili zë pjesën më të madhe ose dominante të përfaqësimit të shenjës së aplikuar për t'u regjistruar si markë, konsiderohet si jodallues sipas pikës 1 të nenit 142 të këtij ligji, DPPI-ja e refuzon regjistrimin e aplikimit edhe kur aplikanti kërkon përjashtimin nga mbrojtja të këtij elementi.

Neni 151

Publikimi i aplikimit

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014 dhe nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. DPPI-ja publikon të dhënat e aplikimit që plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në nenet 150 dhe 150/a në buletin e radhës.

2. Të dhënat e aplikimit, që botohen në buletin e DPPI-së, parashikohen në rregulloren përkatëse.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 151/a

Observime nga palët e treta

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Brenda tre muajve nga data e publikimit të aplikimit për regjistrimin e një marke, çdo person i interesuar mund të paraqesë një kërkesë me shkrim në Dhomën për Shqyrtimin e Kundërshtimeve për shkaqe të bazuara në nenin 142, ku të përcaktojë se përse aplikimi nuk duhet të regjistrohet nga DPPI-ja.
2. Observuesi nuk bëhet palë e kësaj procedure dhe DPPI-ja nuk ka për detyrim ta informojë atë në lidhje me masat e marra për këtë observim.
3. Kërkesa, sipas pikës 1, të këtij neni, i komunikohet aplikuesit, i cili mund të paraqesë shpjegimet e tij në lidhje me këtë kërkesë brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.
4. Kërkesa, sipas këtij neni, shqyrtohet brenda 2 muajve nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve.
5. Kundër vendimit të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të bëhet ankim, përkundërt pagesës së tarifës përkatëse, në Bordin e Apelit, brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 151/b

Shfuqizimi ose ndryshimi i akteve administrative me gabime

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Kur DPPI-ja ka marrë një vendim ose ka nxjerrë një akt administrativ në lidhje me një markë, i cili përmban një gabim të dukshëm të bërë nga vetë DPPI-ja, me kërkesë të palëve të interesuara ose me iniciativë të DPPI-së, kjo e fundit mund të shfuqizojë ose të ndryshojë aktin administrativ.
2. DPPI-ja merr vendim brenda dy muajve në lidhje me kërkesën e paraqitur, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe njofton palët për vendimin e marrë.
3. Kundër vendimit të marrë nga DPPI-ja, sipas pikës 2, të këtij neni, mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit, përkundërt pagesës së tarifës përkatëse brenda 1 muaji nga data që vendimi u njoftohet palëve.

Neni 151/c

Rivendosja në afat e së drejtës

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Kur për shkaqe e rrethana të veçanta, të krijuara në kundërshtim me vullnetin e tij, aplikuesi për regjistrim marke ose përfaqësuesi i tij nuk ka qenë në gjendje të respektojë një afat që sjell drejtpërdrejt si pasojë refuzimin e aplikimit për regjistrim marke, aplikuesi ka të drejtë të kërkojë të rivendoset në afat.
2. Kërkesa për rivendosjen në afat përmban shkaqet dhe rrethanat që kanë penguar aplikuesin të respektojë afatin. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 2 muajve nga dita kur janë eliminuar pengesat, të cilat kanë shkaktuar refuzimin e aplikimit, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Kërkesa për rivendosje në afat shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse.
3. Nëse kërkesa për rivendosje në afat pranohet, pasojat ligjore që shkaktohen nga mosrespektimi afatit, konsiderohen se nuk kanë ndodhur.
4. Rivendosja në afat nuk lejohet për:
 - a) një kërkesë drejtuar Bordit të Apelit të DPPI-së;
 - b) një kërkesë drejtuar dhomës për shfuqizim /zhvlerësim;
 - c) një kërkesë drejtuar Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve;
 - ç) kërkesën për rivendosje në afat, sipas këtij neni.
5. Procedura për depozitimin dhe shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat kryhet në mënyrën që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave për markat.
6. Kundër vendimit të marrë nga DPPI-ja për rivendosjen në afat mund të bëhet ankim në Bordin e Apelit përkundërt pagesës së tarifës përkatëse brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 152

Kundërshtimi ndaj një marke

(ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Kundërshtimi ndaj një marke të publikuar depozitohet në DPPI brenda një periudhe tremujore nga data e publikimit, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, nga:
 - a) aplikanti i një marke të mëparshme të depozituar në DPPI ose nga pronari i një marke të mëparshme;
 - b) pronari i një emri tregtar, në përputhje me përcaktimin e shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 143, të këtij ligji;
 - c) një person fizik, në bazë të përcaktimit të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 143, të këtij ligji;
 - ç) pronari i një të drejte të mëparshme të pronësisë industriale, në bazë të përcaktimit të shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 143, të këtij ligji;
 - d) çdo person që ka të drejtën e autorit, sipas përcaktimit të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 143, të këtij ligji;
 - dh) përdoruesit e autorizuar të markave certifikuese;
 - e) nga çilido subjekt i sipërpërmendur në këtë pikë, që vërteton se aplikimi është bërë në keqbesim;
 - ë) përdoruesit e autorizuar ose të licencuarit e markës nga pronari i markës.
2. Periudha për paraqitjen e kundërshtimit nuk mund të zgjatet tej periudhës së parashikuar në pikën 1, të këtij neni.
3. Të dhënat për mënyrën e depozitimit të kundërshtimit dhe procedura e nevojshme parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.

Neni 153

Procedura e kundërshtimit

(ndryshuar pika 3 dhe shfuqizuar fjalët në pikën 4 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve ekzaminon nëse kundërshtimi është depozituar në përputhje me kërkesat e pikës 1, të nenit 152, të këtij ligji.
2. Nëse kërkesat e parashikuara në pikën 1, të nenit 152, nuk janë plotësuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve refuzon kërkesën për kundërshtim dhe njofton kundërshtuesin.
3. Nëse kërkesa për kundërshtim plotëson kriteret e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve njofton me shkrim dhe i dërgon një kopje të kundërshtimit aplikantit të markës, kundër së cilës është depozituar kundërshtimi, të paraqesë argumentet brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.
4. Afati kohor i parashikuar në pikën 3, të këtij neni, nuk mund të zgjatet.
5. Nëse aplikanti nuk i paraqet argumentet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit kohor të parashikuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve e pranon kundërshtimin.
6. Kur Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve e konsideron të nevojshme, ajo fton palët në një seancë dëgjimore për t'i dëgjuar gjatë shqyrtimit të kundërshtimit.

Neni 153/a

Shqyrtimi i kundërshtimit

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Nëse aplikanti i markës së kundërshtuar paraqet argumentet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit të parashikuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve shqyrton brenda dy muajve argumentet dhe bazën ligjore mbi të cilat mbështetet kundërshtimi.
2. Pas shqyrtimit të kundërshtimit, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të vendosë që regjistrimi i markës që kundërshtohet të refuzohet ose të pranohet për të gjitha mallrat/shërbimet ose për një pjesë të tyre dhe vendimi i marrë në lidhje me këtë u njoftohet palëve.
3. Kundër vendimit të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të bëhet apelim në Bordin e Apelit përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, brenda një periudhe 1-mujore nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 154

Regjistrimi i markës

(ndryshuar me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. DPPI-ja njofton aplikuesin të paguajë tarifën e regjistrimit pas kalimit të afatit 3-mujor nga data e publikimit të markës, nëse nuk janë depozituar kundërshtime apo kundërshtimet janë refuzuar.
Aplikuesi paguan tarifën e regjistrimit brenda një muaji nga data e njoftimit nga DPPI-ja.
DPPI-ja regjistron markën në regjistrin e markave dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda tre muajve nga kryerja e pagesës nga aplikuesi.
2. DPPI-ja refuzon aplikimin nëse aplikuesi nuk e paguan tarifën e regjistrimit brenda afatit të caktuar në pikën 1 të këtij neni.
3. Marka e regjistruar publikohet në buletin e DPPI-së.
4. Të dhënat për certifikatën e regjistrimit dhe për publikimin e markës parashikohen në rregulloren përkatëse.

Neni 155

Apelimi i vendimit të refuzimit

(ndryshuar fjalët në pikën 1 dhe pika 5, shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e aplikimit, sipas neneve 150 dhe 150/a, të këtij ligji, aplikanti ka të drejtë, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, të apelojë vendimin e DPPI-së në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim.
2. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim shqyrton kërkesën për apelim, brenda tre muajve nga data e paraqitjes së tij dhe njofton apeluesin për vendimin e marrë.
3. Gjatë shqyrtimit, dhoma për shfuqizim /zhvlerësim ka të drejtë t'i kërkojë apeluesit të vendimit të paraqesë materiale dhe dokumente të tjera shtesë, brenda një periudhë të parashikuar për këtë qëllim në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.
4. Kundër vendimit të marrë nga dhoma për shfuqizim/zhvlerësim mund të bëhet apelim në Bordin e Apelit, përkundërt pagesës së tarifës përkatëse, brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

KREU XXV

EFEKTET E REGJISTRIMIT TË MARKËS

Neni 156

Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi

1. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të markës, në përputhje me të drejtat e parashikuara në këtë ligj.
2. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij:
 - a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka;
 - b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare;
 - c) një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës.
3. Në përputhje me pikën 2 të këtij neni, gjithashtu, ndalohet:
 - a) vendosja e shenjës te mallrat ose ambalazhet e tyre;
 - b) hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje, duke përdorur këtë shenjë, ose krijimi dhe mbajtja e rezervave për këto qëllime;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- c) ofrimi i shërbimeve, duke përdorur këtë shenjë;
- ç) importimi ose eksportimi i mallrave, duke përdorur këtë shenjë;
- d) përdorimi i shenjës në veprimtarinë tregtare, në reklamime ose publicitete.

4. Të drejtat, që i njihen pronarit të markës së regjistruar, sipas këtij neni, i njihen edhe pronarit të markës së mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimin e shkronjës “ç” të pikës 5 të nenit 143 të këtij ligji.

Neni 156/a

Citimi i markave tregtare në botime

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

Nëse një markë tregtare e regjistruar përmendet në një fjalor, enciklopedi apo material të ngjashëm, duke përfshirë dhe botimet elektronike, dhe shërben si referencë, duke dhënë përshtypjen e gabuar se marka tregtare përbën një emër përshkrues të mallrave apo shërbimeve, për të cilat është regjistruar, botuesi, me kërkesë të pronarit të markës tregtare, në botimin e ardhshëm tregon, me anën e një sqarimi tregues ose shenje, se kemi të bëjmë me një markë të regjistruar.

Neni 157

Kufizimi i të drejtave që rrjedhin nga regjistrimi

(shtuar pika 2 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Mbrojtja nuk i jep pronarit të markës të drejtën të ndalojë palët e treta të përdorin në treg dhe në përputhje me praktikën dhe kërkesat e biznesit:

- a) emrin dhe adresën e tij;
- b) treguesit e tipit, cilësisë, sasisë, destinacionit, vlerës, vendit të origjinës, kohës së prodhimit ose të karakteristikave të tjera të mallrave apo të shërbimeve;
- c) markën, kur ajo është e nevojshme për të treguar qëllimin e përdorimit të mallrave dhe të shërbimeve, veçanërisht në rastin e aksesorëve ose të pjesëve.

2. Marka tregtare nuk i jep të drejtë titullarit të saj të ndalojë palën e tretë të përdorë në tregti një të drejtë të mëparshme, e cila shtrihet në një territor të caktuar, nëse kjo e drejtë njihet nga legjislati shqiptar në fuqi dhe brenda territorit të caktuar.

Neni 158

Mbarimi i të drejtave që rrjedhin nga regjistrimi

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Marka tregtare nuk i jep të drejtën titullarit të saj të ndalojë përdorimin e markës për produkte të hedhura në qarkullimin civil në territorin e Republikës së Shqipërisë nga mbajtësi i saj apo me pëlqimin e tij.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastin kur ekzistojnë arsye ligjore apo shkaqe të tjera bindëse, në bazë të të cilave pronari kundërshton tregtimin e mëtejshëm të mallrave, veçanërisht kur kushtet e mallrave kanë ndryshuar ose mallrat janë prishur, kanë skaduar apo janë bërë të papërdorshme pas hedhjes në treg.

Neni 159

Detyrimi i përdorimit të markës

1. Pronari i një marke, për të ruajtur vlefshmërinë e saj, duhet ta përdorë atë për mallrat ose shërbimet, për të cilat ajo është regjistruar, përveç kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për mospërdorimin e saj, si rastet që nuk varen nga vullneti i pronarit.

2. Kur brenda një periudhe pesëvjeçare nga data e regjistrimit të markës, pronari i markës nuk e ka përdorur atë për mallrat ose shërbimet, për të cilat marka është regjistruar, ose ka pezulluar përdorimin e saj për një periudhë të pandërprerë pesëvjeçare, marka bëhet objekt i sanksioneve të parashikuara në nenin 174 të këtij ligji, përveç kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për mospërdorimin e saj, si në rastet që nuk varen nga vullneti i pronarit.

3. Përdorimi i markës, në përputhje me përcaktimet e pikave 1 e 2 të këtij neni, nënkupton, gjithashtu, përdorimin e saj në paketimin, katalogët, broshurat, manualët, reklamimet, në median e komunikimit dhe të

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

tregtisë elektronike ose në median audiovizuale, me kusht që ajo të perceptohet nga publiku si ofrim ose si ofertë për blerje apo furnizim të mallrave ose shërbimeve, që përcaktohen nga marka në Republikën e Shqipërisë.

4. Përdorimi i markës në përputhje me përcaktimet e pikave 1 e 2 të këtij neni nënkupton gjithashtu:

- a) përdorimin e saj nga i licencuari ose një person tjetër, kur lejohet nga pronari i markës apo nga çdo person, që ka autoritet të përdorë një markë kolektive;
- b) përdorimin e saj në një formë, që ndryshon vetëm ato elemente të markës, që nuk cenojnë karakterin dallues të saj në formën që ajo është regjistruar;
- c) vendosjen ose ngjitjen e markës te mallrat ose ambalazhimet e tyre në Republikën e Shqipërisë vetëm për qëllime eksporti.

Neni 160

Kufizimi i pasojës së pranimi në heshtje

1. Kur pronari i një marke të mëparshme, në përputhje me përcaktimin e pikës 5 të nenit 143 të këtij ligji, pranon në heshtje, për një periudhë të pandërprerë pesëvjeçare, përdorimin e një marke të regjistruar më vonë në Republikën e Shqipërisë, ai nuk ka më të drejtë, sipas së drejtës që rrjedh nga regjistrimi i markës së mëparshme, të kërkojë deklarimin e pavlefshëm të markës së mëvonshme ose ta kundërshtojë përdorimin e markës së mëvonshme për mallrat ose shërbimet, për të cilat marka e mëvonshme është përdorur, përveç kur regjistrimi i markës së mëvonshme është aplikuar në keqbesim.

2. Pronari i markës së mëvonshme nuk ka të drejtë të kundërshtojë përdorimin e markës së mëparshme.

Neni 161

Ndryshimet në emër, adresë dhe në listën e mallrave

1. Marka e regjistruar në regjistrin e markave të DPPI-së nuk ndryshohet gjatë kohëzgjatjes së regjistrimit dhe as me ripërtëritjen e saj. Megjithatë, kur ndryshimi ka të bëjë me emrin dhe adresën e pronarit të markës, me kërkesën e këtij të fundit, DPPI-ja i regjistron këto ndryshime në regjistrin e markave, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

2. DPPI-ja, me kërkesë të pronarit të markës, regjistron kufizimin e listës së mallrave dhe/ose shërbimeve në regjistrin e markave, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

3. Të dhënat për depozitimin e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e këtyre ndryshimeve parashikohen në rregulloren përkatëse, dalë në zbatim të këtij ligji.

Neni 162

Transferimi i pronësisë së markës

1. DPPI-ja, me kërkesën e pronarit të markës ose të pronarit të ri të saj, regjistron transferimin e pronësisë së një marke në regjistrin e markave, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

2. Pronari i një marke të regjistruar mund të transferojë të drejtat mbi markën, të gjitha ose një pjesë të tyre, nëpërmjet një marrëveshjeje të nënshkruar nga të dyja palët, e cila depozitohet në DPPI.

3. Të drejtat mbi markën mund të transferohen së bashku me veprimtarinë e biznesit ose pa e transferuar këtë të fundit.

4. Transferimi nuk ka asnjë efekt ligjor, nëse nuk është i regjistruar në regjistrin e markave. Kur nga akti i transferimit duket qartë se transferimi i pronësisë mbi markën mund të keqinformojë publikun për natyrën, cilësitë dhe origjinën gjeografike të mallrave dhe/ose shërbimeve, për të cilat është regjistruar marka, DPPI-ja refuzon të regjistrojë transferimin, nëse pronari i ri i markës nuk pranon ta kufizojë regjistrimin vetëm për mallrat dhe/ose shërbimet, të cilat nuk çojnë në keqinformimin e publikut.

5. DPPI-ja refuzon regjistrimin në regjister të një transferimi pronësie të kërkuar, në rast se dokumentacioni përkatës nuk paraqitet brenda afatit të caktuar.

6. Të dhënat për depozitimin e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë parashikohen në rregulloren përkatëse, dalë në zbatim të këtij ligji.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 163

Licencimi

1. Marka mund të licencohet për disa ose për të gjitha mallrat apo shërbimet, për të cilat ajo është regjistruar. Licenca mund të jetë ekskluzive ose joekskluzive.
2. Kontrata e licencës bëhet me shkrim, nënshkruhet nga të dyja palët dhe depozitohet në DPPI.
3. Pronari i markës së licencuar mund të përdorë të drejtat, që rrjedhin nga regjistrimi i markës, kundër të licencuarit që shkel kushtet e përcaktuara në kontratë, për kohëzgjatjen e saj, formën sipas së cilës duhet të përdoret marka, klasat e mallrave ose të shërbimeve, për të cilat është lëshuar licenca, territorin ku përdoret marka, ose për cilësinë e produkteve të prodhuara apo të shërbimeve që sigurohen nga i licencuari.
4. Kontrata e licencës nuk është e vlefshme, nëse nuk përmban detyrimet që licencuesi i vendos të licencuarit për zbatimin e kushteve të përcaktuara në kontratë, sipas pikës 3 të këtij neni.
5. Kontrata e licencës nuk ka asnjë efekt ligjor, nëse nuk është e regjistruar në regjistrin e markave të DPPI-së. I licencuari ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë dhe të kryejë çdo veprim tjetër, të njohur me ligj, kundër shkeljes së të drejtave për markën vetëm me pëlqimin e licencuesit, përveç kur në kontratën e licencës është parashikuar ndryshe. Kur licenca është ekskluzive, i licencuari ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë dhe të kryejë çdo veprim tjetër, të njohur me ligj, kundër shkeljes së të drejtave për markën edhe pa pëlqimin e licencuesit, nëse ai, edhe pse është njoftuar nga i licencuari, nuk kryen asnjë veprim të njohur me ligj për mbrojtjen e markës, brenda një periudhe kohe të arsyeshme. I licencuari ka të drejtë të ndërhyjë në një padi të ngritur nga licencuesi kundër shkeljes së të drejtave për markën, kur kjo ndërhyrje ka për qëllim shpërblimin e dëmit të pësuar prej tij nga shkelja e të drejtave.
6. DPPI-ja refuzon regjistrimin e një kontrate licence në regjister, nëse nuk paraqitet dokumentacioni përkatës në kohën e caktuar.
7. Të dhënat për depozitimin e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e kontratës së licencës parashikohen në rregulloren përkatëse, dalë në zbatim të këtij ligji.

Neni 163/a

Regjistrimi i së drejtës së pengut mbi një markë

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Marka mund të sigurohet ose të jetë objekt mbi të cilin mund të vendoset pengu.
2. Me kërkesë të njëres prej palëve në kontratë, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, kontrata e vendosjes së pengut mbi një markë tregtare regjistrohet në regjistrin e markave.
3. Regjistrimi i vendosjes së një pengu publikohet në buletin e DPPI-së.
4. Pengu krijon pasoja juridike vetëm pas regjistrimit të kontratës së pengut në regjister.
5. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e pengut përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.

Neni 163/b

Procedura e veprimeve përmbarimore

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Marka mund të jetë objekt i veprimeve përmbarimore.
2. Me kërkesë të njëres prej palëve në kontratë, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, një veprim përmbarimor i marrë ndaj një marke tregtare regjistrohet në regjistrin e markave dhe publikohet në buletin e DPPI-së.
3. Një veprim përmbarimor krijon pasoja juridike pas regjistrimit të veprimit përmbarimor në regjistrin e markave.
4. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e një veprimi përmbarimor përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 164

Kohëzgjatja dhe ripërtëritja e regjistrimit

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Marka e regjistruar mbrohet për një afat 10-vjeçar duke filluar nga data e depozitimit.
2. Marka mund të ripërtërihet pafundësisht për periudha dhjetëvjeçare, pasi pronari depoziton një kërkesë për këtë qëllim në DPPI dhe paguan tarifën përkatëse, në një periudhë jo më vonë se gjashtë muaj nga data e përfundimit të periudhës dhjetëvjeçare të regjistrimit.
3. Periudha e re e mbrojtjes së markës fillon në datën e mbarimit të periudhës së mëparshme dhjetëvjeçare.
4. Nëse pronari i markës nuk depoziton kërkesën për ripërtëritjen e saj ose nuk paguan tarifën përkatëse, sipas kërkesës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, marka në fjalë bëhet e pavlefshme.
5. Të dhënat që jepen në kërkesën për ripërtëritjen e një marke dhe procedura përkatëse për ripërtëritjen parashikohen në rregulloren e përkatëse.

KREU XXVI MARKAT KOLEKTIVE

Neni 165

Objekti i mbrojtjes së markave kolektive

(ndryshuar neni me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Markë kolektive është marka që shërben për të dalluar mallrat ose shërbimet e anëtarëve të një shoqate apo çdo forme tjetër organizimi ligjor, krijuar mes subjekteve tregtare që prodhojnë mallra, ofrojnë shërbime ose tregtojnë mallra ose shërbime të të tjerëve. Ky organizim i subjekteve tregtare është pronari i markës kolektive.
2. Të drejtat që lindin nga një markë kolektive janë të patransferueshme.
3. Parashikimet e këtij ligji për markat tregtare zbatohen, gjithashtu, për markat kolektive, me përjashtim të parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 142, të këtij ligji, në lidhje me shenjat ose treguesit që mund të shërbejnë në treg për të treguar origjinën gjeografike të mallrave ose shërbimeve, elemente të cilët mund të mbrohen si markë kolektive. Në këtë rast, pronësia mbi një markë kolektive nuk i jep të drejtën pronarit të saj të ndalojë palët e treta të përdorin në treg shenja apo tregues të tillë, me kusht që ato të përdoren në përputhje me parimet e praktikës së ndershme tregtare dhe industriale. Në mënyrë të veçantë, e drejta mbi një markë të tillë kolektive nuk mund të përdoret kundër një pale të tretë që gëzon të drejta mbi një tregues gjeografik.
4. Aplikuesi për një markë kolektive depoziton, së bashku me aplikimin për regjistrimin, dokumentet e parashikuara nga neni 145, i këtij ligji, dhe rregulloren që parashikon rregullat e përdorimit të markës kolektive. Në rregulloren e përdorimit të markës kolektive duhet të përmenden:
 - a) personat e autorizuar për ta përdorur markën;
 - b) kushtet e anëtarësimit në bashkimin ose partneritetin ligjor që kërkon regjistrimin e markës: dhe, nëse është e mundur,
 - c) kushtet e përdorimit të markës dhe sanksionet në rast shkeljeje të tyre;
 - ç) në rastin e markave të përmendura në pikën 3, të këtij neni, rregullorja e përdorimit duhet të parashikojë që çdo palë e tretë, mallrat ose shërbimet e të cilit e kanë origjinën në atë zonë të caktuar gjeografike, të mund të bëhet anëtar i bashkimit apo partneritetit ligjor që është pronar i markës kolektive.
5. Përveç shkaqeve të refuzimit të aplikimit për një markë tregtare, të parashikuara nga ky ligj, aplikimi për markë kolektive refuzohet edhe nëse nuk plotësohen kërkesat e këtij neni ose kur rregullat e përdorimit të markës bien në kundërshtim me parimet e njohura të rendit dhe moralit publik. Aplikimi për regjistrimin e një marke kolektive refuzohet, gjithashtu, nëse ekziston mundësia e keqorientimit të publikut, lidhur me karakterin ose domethënien e markës, në mënyrë të veçantë, nëse ka mundësi që ajo të kuptohet si diçka e ndryshme nga një markë kolektive.
6. Aplikimi për regjistrimin e një marke kolektive nuk refuzohet nëse aplikuesi, si rezultat i ndryshimeve në rregulloren e përdorimit të markës, arrin të plotësojë kërkesat e pikës 4 të këtij neni. Pronari i një marke kolektive duhet të depozitojë pranë DPPI-së çdo ndryshim të rregullores së përdorimit të markës dhe, nëse këto ndryshime janë në përputhje me kërkesat e këtij neni, DPPI-ja pasqyron ndryshimet në regjistrin e markave. Ndryshimet në rregullat e përdorimit të markës kolektive hyjnë në fuqi në datën e shënimit të tyre në regjistrin e markave.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

7. Përveç shkaqeve për shfuqizimin e një marke, të parashikuara në nenet 142 dhe 143, të këtij ligji, një markë kolektive e regjistruar në kundërshtim me parashikimet e pikës 4, të këtij neni, mund të shfuqizohet, gjithashtu, mbi bazën e një kërkesëpadie drejtuar gjykatës, sipas nenit 173, të këtij ligji, ose mbi bazën e një kundërpadie gjatë një procedimi gjyqësor për shkeljen e të drejtave, përveç kur pronari i markës, duke ndryshuar rregullat e përdorimit, arrin të plotësojë kërkesat e neneve të lartpërmendura.

Neni 166

Markat certifikuese

(ndryshuar neni me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Marka certifikuese është marka, e cila tregon se mallrat ose shërbimet për të cilat ajo përdoret janë të certifikuara nga pronari i markës për origjinën e tyre, materialin e përdorur, mënyrën e përgatitjes së produktit ose ofrimit të shërbimit, cilësinë, saktësinë dhe për cilësi të tjera. Pronari i markës certifikuese nuk ka të drejtë ta përdorë atë për mallra ose shërbime, të cilat ai i hedh në treg. Persona të tjerë mund të përdorin markën certifikuese me autorizim të pronarit të markës dhe nën kontrollin e tij.

2. Dispozitat e këtij ligji që rregullojnë markën tregtare zbatohen edhe për markën certifikuese. Me përjashtim të parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 142, të këtij ligji, shenjat ose treguesit, të cilët mund të shërbejnë në tregti për të përcaktuar origjinën gjeografike të mallrave ose shërbimeve, mund të konsiderohen si markë certifikuese, në kuptim të pikës 1 të këtij neni.

3. Aplikuesi për një markë certifikuese depoziton, së bashku me aplikimin për regjistrimin e një marke kolektive, dhe dokumentet e parashikuara nga neni 145, i këtij ligji, edhe rregulloren që parashikon rregullat e përdorimit të markës certifikuese. Rregullorja përmban karakteristikat që certifikohen nga marka, mënyrën e testimit të këtyre karakteristikave, masat e kontrollit që ndërmerren nga pronari dhe sanksionet që ai vendos.

KREU XXVII

(shfuqizuar kreu me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

KREU XXVIII

HEQJA DORË, SHFUQIZIMI DHE ZHVLERËSIMI

Neni 172

Heqja dorë nga regjistrimi

1. Pronari i markës së regjistruar mund të heqë dorë nga regjistrimi i saj me një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet në DPPI.

2. Heqja dorë hyn në fuqi nga data që kërkesa, së bashku me autorizimin e përfaqësimit dhe dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, janë depozituar në DPPI.

3. Heqja dorë mund të bëhet për disa ose për të gjitha klasat e mallrave apo të shërbimeve, për të cilat është regjistruar marka.

4. DPPI-ja e regjistron dorëheqjen në regjistrin e markave.

Neni 173

Shfuqizimi i markës

(ndryshuar pika 1 dhe shtuar fjalia e dytë pika 3 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017; ndryshuar pika 7 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Një markë e regjistruar mund të shfuqizohet kur:

a) regjistrimi i markës është bërë në shkelje të parashikimeve të neneve 142 e 143, të këtij ligji, në kohën kur është depozituar aplikimi për regjistrim;

b) aplikimi për regjistrimin e markës është bërë në keqbesim.

2. Kërkesa për shfuqizimin e një marke të regjistruar mund të bëhet nga çdo person, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) nëse është duke u zhvilluar një proces në lidhje me këtë markë në gjykatë, kërkesa duhet të bëhet në gjykatë;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

b) kur, në çdo rast tjetër, kërkesa është bërë në dhomën për shfuqizim/ zhvlerësim, personi, në çdo fazë të procedurës në DPPI, mund t'ia drejtojë kërkesën gjykatës.

3. Çdo markë e regjistruar që shfuqizohet, konsiderohet si e paqenë, duke filluar nga data e depozitimit të markës. Kur marka, që nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” ose “c”, të pikës 1, të nenit 142, të këtij ligji, por ka fituar karakter dallues, në përputhje me pikën 2, të nenit 142, të këtij ligji, nuk shfuqizohet, por data e depozitimit do të zhvendoset në kohë në momentin që marka e ka fituar karakterin dallues.

4. Një markë nuk mund të shfuqizohet me arsyetimin se ekziston një markë e mëparshme, që është në konflikt me atë markë, nëse marka e mëparshme nuk përmbush kërkesat e nenit 159 të këtij ligji. Nëse marka tregtare e mëparshme është përdorur vetëm për një pjesë të mallrave apo shërbimeve, për të cilat është regjistruar, konsiderohet se ajo është regjistruar vetëm për këtë pjesë mallrash apo shërbimesh.

5. Kur arsyet për refuzimin e regjistrimit ose për shfuqizimin e një marke lidhen vetëm me disa mallra ose shërbime, për të cilat është paraqitur aplikimi apo është regjistruar marka, refuzimi i regjistrimit ose shfuqizimi mbulon vetëm ato mallra ose shërbime.

6. Shfuqizimi i një marke të regjistruar nuk mund të bëhet pa u thirrur për t'u dëgjuar pronari i saj.

7. Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim merr vendim në lidhje me kërkesën e paraqitur, sipas pikës 1 të këtij neni, brenda 1 (një) muaji nga data e zhvillimit të seancës dëgjimore dhe njofton palët për vendimin e marrë.

8. Kundër vendimit të marrë nga dhoma për shfuqizim/zhvlerësim mund të bëhet ankim, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, në Bordin e Apelit, brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.

Neni 174

Zhvlerësimi i markës

(shtuar fjaltë në shkronjën “a” pika 1 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

(ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Regjistrimi i një marke zhvlerësohet kur:

a) pronari i saj, pa pasur arsye legjitime, nuk e ka përdorur markën për mallrat ose shërbimet, për të cilat marka është regjistruar, për një periudhë të pandërprerë pesëvjeçare. Megjithatë, një palë e tretë nuk mund të kërkojë zhvlerësimin e markës për mospërdorimin e saj, nëse gjatë periudhës midis mbarimit të afatit 5-vjeçar të mospërdorimit dhe datës kur është ngritur padia për zhvlerësimin e markës, pronari i markës ka filluar ta përdorë markën ose ka rifilluar përdorimin e saj. Përdorimi i markës ose rifillimi i përdorimit të saj nga pronari i markës nuk do të merret parasysh, kur janë bërë jo më parë se tre muaj para ngritjes së padisë për zhvlerësimin e markës dhe jo më herët se me mbarimin e periudhës së pandërprerë pesëvjeçare të mospërdorimit, nëse pronari i markës fillon përdorimin ose ripërdorimin e markës për arsye se ka marrë dënim për ngritjen e padisë për zhvlerësimin e saj;

b) si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të pronarit të saj, marka është bërë emër i zakonshëm në treg për mallrat ose shërbimet, për të cilat ajo është regjistruar;

c) si pasojë e përdorimit të bërë nga pronari ose me pëlqimin e tij të mallrave ose të shërbimeve, për të cilën ajo është regjistruar, marka çorienton publikun, kryesisht, për natyrën, cilësinë ose origjinën gjeografike të mallrave apo të shërbimeve.

2. Regjistrimi i një marke nuk zhvlerësohet, në kuptim të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, për mallrat dhe shërbimet, për të cilat ajo është regjistruar, kur:

a) është përdorur nga i licencuari ose një person tjetër, me lejen e pronarit të markës ose nga çdo person, që ka autoritet të përdorë një markë kolektive;

b) është përdorur në një formë, që ndryshon vetëm ato elemente të markës, që nuk cenojnë karakterin dallues të saj, në formën që ajo është regjistruar;

c) është ngjitur mallrave ose ambalazhimit të tyre në Republikën e Shqipërisë vetëm për qëllime eksporti;

ç) është përdorur për publicitet dhe korrespondencë biznesi, në përputhje me përcaktimet e pikës 3, të nenit 159, të këtij ligji.

3. Kur shkaqet për zhvlerësimin e një marke lidhen vetëm me disa mallra ose shërbime, për të cilat marka është regjistruar, zhvlerësimi shtrihet vetëm për këto mallra ose shërbime.

4. Kërkesa për zhvlerësimin e një marke të regjistruar mund të bëhet nga çdo person, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- a) nëse është duke u zhvilluar një proces në lidhje me këtë markë në gjykatë, kërkesa duhet të bëhet në gjykatë;
- b) kur, në çdo rast tjetër, kërkesa është bërë në Dhomën për shfuqizim/zhvlerësim, personi, në çdo fazë të procedurës në DPPI, mund t'ia drejtojë kërkesën gjykatës.
5. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim njofton pronarin e markës, ndaj së cilës është depozituar kërkesa për zhvlerësim, dhe e fton atë të paraqesë, brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit, argumentet, provat ose çdo dokument tjetër në lidhje me kërkesën për zhvlerësim. Ky afat mund të zgjatet me kërkesë të pronarit të markës me dy muaj shtesë.
6. Zhvlerësimi i një marke të regjistruar nuk mund të bëhet pa u njoftuar pronari i saj.
7. Nëse dhoma për shfuqizim/zhvlerësim e konsideron të nevojshme, ajo mund të thërrasë palët për t'i dëgjuar në një seancë dëgjimore gjatë ndjekjes së procedurës së zhvlerësimit.
8. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim merr në shqyrtim kërkesën, argumentet dhe provat e paraqitura nga palët dhe merr vendim brenda dy muajve, si dhe njofton palët për vendimin e marrë.
9. Kundër vendimit të marrë nga dhoma për shfuqizim/zhvlerësim mund të bëhet ankim, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, në Bordin e Apelit brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.
10. Çdo markë e regjistruar që zhvlerësohet i pushon efektet nga dita që zhvlerësimi hyn në fuqi.
11. DPPI-ja e pasqyron zhvlerësimin e një marke në regjistrin e markave.

KREU XXIX MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Neni 175

Regjistrimi ndërkombëtar i markës

(ndryshuar pika 4 dhe shtuar pikat 5, 6, dhe 7 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Pronari i markës së regjistruar ose aplikanti mund të depozitojnë në DPPI një kërkesë, kundrejt pagesës së një tarife të caktuar, për regjistrimin ndërkombëtar të markës, në mbështetje të Marrëveshjes së Madridit dhe/ose të protokollit të kësaj marrëveshjeje.
2. Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme për të gjitha çështjet, që nuk janë përfshirë në këto marrëveshje.
3. Në funksion të regjistrimit ndërkombëtar të markës, sipas Marrëveshjes së Madridit, publikimi i kërkesës, në përputhje me nenin 151 të këtij ligji, zëvendësohet me publikimin e regjistrimit ndërkombëtar në gazetën zyrtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (ONPI).
4. Afati për depozitimin e kundërshtimit ndaj regjistrimit ndërkombëtar të markës në Republikën e Shqipërisë fillon nga data e publikimit të aplikimit të markës në gazetën zyrtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.
5. Kërkesa e përmendur në pikën 1 të këtij neni depozitohet në DPPI, sipas procedurës së parashikuar në rregulloren përkatëse.
6. Afati për paraqitjen e kundërshtimit nuk mund të zgjatet tej afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni.
7. Regjistrimet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohen shqyrtimit për shkaqet absolute të refuzimit, ashtu siç i nënshtrohen edhe aplikimet kombëtare për regjistrimin e markës tregtare.
8. Nëse marka ndërkombëtare nuk është në përputhje me kërkesat e neneve 140 dhe 142, DPPI-ja njofton aplikuesin dhe i jep atij mundësinë, brenda katër muajve nga data e publikimit të njoftimit në gazetën zyrtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, të paraqesë shpjegimet e tij, si dhe dokumente shtesë, sipas rastit.

Neni 175/a

Transformimi i një regjistrimi ndërkombëtar

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Regjistrimi ndërkombëtar i një marke mund të transformohet në aplikim për markë kombëtare, sipas nenit 9quinques, të Protokollit të Madridit, si dhe sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për markat.
2. Kërkesa për transformim, sipas nenit 9quinques, të Protokollit të Madridit, duhet të depozitohet pranë DPPI-së brenda 3 muajve nga data në të cilën regjistrimi ndërkombëtar është fshirë.
3. Periudha e mbrojtjes së markës së transformuar konsiderohet se fillon në datën e regjistrimit

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

ndërkombëtar, sipas nenit 3(4), të Protokollit të Madridit, ose në datën e regjistrimit të shtrirjes territoriale, sipas nenit 3ter (2), të Protokollit të Madridit, dhe, nëse regjistrimi ndërkombëtar gëzon prioritet, i njihet data e prioritetit.

PJESA V TREGUESIT GJEOGRAFIKË DHE EMËRTIMET E ORIGJINËS (ndryshuar titulli me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

KREU XXX PËRKUFIZIMI, KUSHTET DHE E DREJTA E MBROJTJES (ndryshuar kreu kapitulli me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

Neni 176 Objekti i mbrojtjes

1. Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, që përdoren në tregti për të treguar origjinën gjeografike të produkteve, mbrohen nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. “Emërtim origjine” quhet emri që identifikon një produkt:

- a) që e ka origjinën nga një vend specifik, rajon apo, në raste të veçanta, një shtet;
- b) cilësitë ose karakteristikat e të cilit vijnë, ekskluzivisht ose esencialisht, si rezultat i një mjedisi gjeografik të veçantë, që përfshin faktorët natyrorë dhe njerëzorë, të trashëguar nga ky mjedis;
- c) hapat për prodhimin e të cilit realizohen në zonën e përcaktuar gjeografike.

3. “Tregues gjeografik” quhet emri që identifikon një produkt:

- a) që e ka origjinën në një vend specifik, rajon apo shtet;
 - b) cilësitë, reputacioni ose karakteristikat e tjera të të cilit i atribuohen esencialisht origjinës së tij gjeografike;
 - c) të paktën një nga hapat prodhues të të cilit realizohet në zonën e përcaktuar gjeografike.
4. Disa emra tradicionale gjeografikë ose jogjeografikë, të përdorur për një produkt ushqimor ose bujqësor, të cilët e kanë origjinën në një rajon apo vend specifik dhe që përmbushin kushtet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, trajtohen si emërtime të origjinës.

5. Në përjashtim të parashikimit të pikës 2, të këtij neni, disa tregues gjeografikë trajtohen si emërtime origjine në rastin kur lënda e parë e produktit vjen nga një zonë gjeografike më e gjerë ose e ndryshme nga zona ku përpunohet produkti, me kusht që:

- a) zona e prodhimit të lëndës së parë të jetë e përcaktuar;
- b) të ekzistojnë kushte specifike për prodhimin e lëndës së parë;
- c) të ekzistojnë rregullime për inspektimin që sigurojnë se këto kushte janë përmbushur.

Në kuptim të kësaj pike, vetëm kafshët e gjalla, mishi dhe qumështi mund të vlerësohen si lëndë e parë.

6. Në rastin e aplikimeve që kanë të bëjnë me pijet alkoolike, tregues gjeografik i një pijeje alkoolike do të jetë një tregues që identifikon një pije alkoolike me origjinë në territorin e një vendi ose një rajoni apo lokaliteti të këtij territori, ku një cilësi e dhënë, reputacioni apo karakteristika të tjera të asaj pijeje alkoolike i atribuohen esencialisht origjinës së tij gjeografike.

7. Në rastin e aplikimeve që kanë të bëjnë me verërat:

a) “Emërtim origjine” quhet emri i një rajoni, i një vendi specifik ose, në raste të veçanta të justifikuara në mënyrën e duhur, emri i një shteti, që përdoret për të treguar një produkt që përmbush kriteret e mëposhtme:

i) cilësitë ose karakteristikat e produktit vijnë ekskluzivisht ose esencialisht si rezultat i një mjedisi gjeografik të veçantë, që përfshin faktorët natyrorë dhe njerëzorë, të trashëguar nga ky mjedis;

ii) hardhitë nga të cilat është prodhuar produkti vijnë ekskluzivisht nga ajo zonë gjeografike;

iii) prodhimi realizohet në atë zonë gjeografike;

iv) produkti përftohet nga varietete hardhish që i përkasin llojit Vitisvinifera.

b) “Tregues gjeografik” quhet një tregues që i referohet një rajoni, një vendi specifik ose, në raste të veçanta dhe të justifikuara, në mënyrën e duhur, emri i një shteti, që përdoret për të treguar një produkt që përmbush kriteret e mëposhtme:

i) zotëron një cilësi, reputacion ose karakteristika të tjera specifike që i atribuohen asaj zone gjeografike;

ii) të paktën 85 për qind e rrushit të përdorur për prodhim vjen ekskluzivisht nga ajo zonë gjeografike;

iii) prodhimi i tij realizohet në atë zonë gjeografike;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

iv) produkti përfitohet nga varietete hardhish që i përkasin llojit Vitisvinifera ose një kryqëzim midis llojit Vitisvinifera dhe llojeve të tjera të gjinisë Vitis.

Neni 177

E drejta për të depozituar një aplikim

(ndryshuar me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014 dhe nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. “Grup” quhet çdo shoqatë, pavarësisht nga forma e saj ligjore, i përbërë kryesisht nga prodhuesit apo përpunuesit që punojnë me të njëjtin produkt.

2. Kërkesat për regjistrimin e emrave, si EOM, TGJM, mund të paraqiten vetëm nga grupet të cilat punojnë me produktet, emrat e të cilave do të regjistrohen.

3. Një person i vetëm fizik ose juridik mund të trajtohet si një grup kur plotësohen dy kushtet e mëposhtme:

a) personi është i vetmi prodhues i gatshëm të paraqesë një kërkesë;

b) për sa u përket emërtimeve të mbrojtura të origjinës dhe treguesve gjeografikë të mbrojtur, zona e përcaktuar gjeografike ka karakteristika, të cilat ndryshojnë dukshëm nga ato të zonave fqinje ose karakteristikat e produktit janë të ndryshme nga ato të prodhuara në zonat fqinje.

4. Grupet e huaja të prodhuesve mund të depozitojnë aplikim, me kusht që e drejta mbi TGM ose EOM është dhënë në vendet e origjinës dhe nëse ato plotësojnë kërkesat e këtij ligji.

Neni 178

Të drejtat që burojnë nga regjistrimi

(ndryshuar me ligjin dhe nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. E drejta e pronësisë mbi TGJ ose EO fitohet nëpërmjet regjistrimit në DPPI. Regjistrimi i një treguesi gjeografik u jep pronarëve të drejtën për ta përdorur atë. Ata nuk kanë të drejtë të japin licenca përdorimi për TGJ ose EO.

2. Pronarët kanë të drejtë të ndalojnë:

a) çdo përdorim tregtar të një TGJ ose EO për mallrat që janë të njëjta ose të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar TGJ ose EO ose çdo përdorim për mallrat, edhe kur ato nuk janë të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar TGJ ose EO, nëse nga reputacioni i mallrave, për të cilat është regjistruar TGJ ose EO, është arritur përfitim i padrejtë;

b) çdo përdorim të papërshtatshëm ose falsifikim të TGJ ose EO, edhe nëse është specifikuar origjina e vërtetë e mallrave ose çdo përdorim i përkthimit ose përdorim i shoqëruar me terma të tillë si “lloj”, “tip”, “stil” ose të tjera të ngjashme me to;

c) çdo përdorim tjetër i pasaktë dhe i pavërtetë i TGJ ose EO, i origjinës, natyrës ose cilësive thelbësore të mallrave të specifikuara në ambalazhim, në materialet e reklamimit dhe të korrespondencës për produktet, kur të dhëna të tilla shkaktojnë keqinformim për origjinën e vërtetë të produkteve;

ç) çdo përdorim të TGJ ose EO, që identifikon verëra ose pije, që nuk e kanë origjinën në vendin e përcaktuar nga treguesi gjeografik, edhe në rastet kur jepet origjina e vërtetë e tyre ose çdo përdorim i përkthimit apo përdorim i shoqëruar me terma të tilla, si “lloj”, “tip” etj.;

d) çdo veprim tjetër, që mund të shkaktojë keqinformim të përdoruesit për origjinën e vërtetë të mallrave.

3. TGJ ose EO nuk kthehen në emra të zakonshëm për aq kohë sa ato gëzojnë mbrojtje, sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Një TGJ ose EO i regjistruar është një e drejtë kolektive dhe mund të përdoret si e tillë në treg vetëm nga ata që, në përputhje me përcaktimet e nenit 176 dhe kërkesat e nenit 182 prodhojnë, përpunojnë ose përgatitin produktin.

5. Në lidhje me EOM dhe TGJM, verifikimi i përpunshmërisë me specifikimet e produktit përpara hedhjes së tij në treg do të bëhet nga:

a) autoriteti kompetent, i caktuar nga ministri përgjegjës për bujqësinë; ose

b) një ose disa nga organet e kontrollit, të miratuara nga ministri përgjegjës për bujqësinë.

Neni 179

E drejta e përdoruesit

1. E drejta për të përdorur TGJM ose EOM nuk mund të transferohet ose të lihet peng me një marrëveshje.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Nëse TGJM ose EOM përkon me elementin fjalë të markës tregtare të aplikuar ose të regjistruar më parë, marka tregtare në fjalë nuk mund të tranferohet, të licencohet ose të lihet peng me një marrëveshje.

3. Çdo produkt me prejardhje nga Shqipëria që tregtohet në bazë të TGJM ose EOM, në përputhje me këtë ligj, duhet të etiketohet me shprehjen “tregues gjeografik i mbrojtur” ose “emërtim origjine i mbrojtur” apo me logon e TGJM ose EOM.

4. Çdo produkt me prejardhje jashtë Shqipërisë, që tregtohet në bazë të treguesit gjeografik ose emërtimit të origjinës, të regjistruar, në përputhje me këtë ligj, duhet të etiketohet me shprehjen “tregues gjeografik i mbrojtur” ose “emërtim origjine i mbrojtur” apo me logon e TGJM ose EOM.

5. DPPI-ja përcakton në rregullore logon e EOM, TGJM.

Neni 180

Bazat për refuzimin e regjistrimit

Një emër nuk regjistrohet si TGJ ose EO nëse:

a) është kthyer në emër të zakonshëm në treg në Republikën e Shqipërisë, për një produkt të veçantë, pavarësisht nëse produkti e ka origjinën në vendin e përcaktuar nga TGJ ose EO në fjalë;

b) ka të njëjtin emër me atë të një produkti bujqësor ose të një varieteti shtazor të regjistruar më parë, gjë që shkakton keqinformim të përdoruesit për origjinën e vërtetë të mallrave;

c) është i njëjtë me atë të një treguesi gjeografik ose të një marke të regjistruar më parë, për të njëjtat produkte;

ç) është i njëjtë me atë të një treguesi gjeografik ose të një marke të regjistruar më parë, për produkte që janë të ngjashme ose të njëjta, gjë që shkakton keqinformim të përdoruesit;

d) orienton në mënyrë mashtruese konsumatorin të besojë se produkti vjen nga një territor tjetër;

dh) ka pushuar së përdoruri në një territor gjeografik të caktuar;

e) për personat e huaj kur nuk është i mbrojtur në vendin e origjinës.

Neni 180/a

Homonimet e treguesve gjeografikë ose emërtimeve të origjinës

Nëse emrat e dy ose më shumë vendeve të origjinës së produkteve janë identike apo pothuajse identike, mbrojtja e emrave të tillë si tregues gjeografik ose emërtime origjine do të miratohet për të gjithë prodhuesit që plotësojnë kërkesat e këtij ligji, nëse këto emra janë përdorur në përputhje me praktikën e mira të biznesit dhe informimin e vërtetë të konsumatorit, përveç nëse ata mund të çorientojnë publikun lidhur me origjinën gjeografike.

Përdoruesi i homonimeve do të sigurojë informata të mjaftueshme mbi etiketën e materialeve të paketimit, në lidhje me origjinën e vërtetë të produktit, në mënyrë që të dallohet një homonim nga një tjetër dhe të mos çorientohet konsumatori.

Neni 180/b

Mbrojtja ndërkombëtare

(ndryshuar pika 3 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Treguesit gjeografikë ose emërtimet e origjinës së mbrojtur në Republikën e Shqipërisë mund të mbrohen edhe jashtë vendit në bazë të marrëveshjeve dypalëshe për mbrojtjen e ndërsjellë ose marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Aplikimet për mbrojtje jashtë vendit mund të paraqiten vetëm nga grupe prodhuesish të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, të regjistruar në regjistrin përkatës të DPPI-së.

3. Në përputhje me Aktin e Gjenevës dhe Marrëveshjen e Lisbonës për regjistrimin ndërkombëtar të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, aplikimet për mbrojtje të një treguesi gjeografik ose emërtimi origjinë jashtë vendit mund të paraqiten nga grupet e prodhuesve nëpërmjet DPPI-së vetëm pas regjistrimit të një emri si EOM-i ose TGJM-ja në territorin e Shqipërisë.

4. Në përputhje me Aktin e Gjenevës dhe Marrëveshjen e Lisbonës për regjistrimin ndërkombëtar të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, aplikimet ndërkombëtare për mbrojtje si tregues gjeografikë apo emërtim origjinë jashtë vendit mund të paraqiten drejtpërdrejt në OBPI ose nëpërmjet DPPI-së me kërkesë të grupit të prodhuesve, vetëm pas regjistrimit të një emri si EOM-i ose TGJM-ja në territorin e Shqipërisë.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 180/c

Aplikimi nga një grup i huaj prodhuesish

Kur grupi i huaj prodhues paraqet një kërkesë për mbrojtje të një TGJ ose EO, duhet të bashkëngjitë një kopje të certifikatës ose akt tjetër juridik në gjuhën zyrtare të vendit të origjinës, të lëshuar nga autoriteti kompetent në vendin e origjinës, si një dëshmi se TGJ ose EO është i mbrojtur në atë vend, në përputhje me treguesin gjeografik të mbrojtur, në përputhje me legjislacionin kombëtar në vendin e origjinës, si dhe një përkthim të certifikuar në gjuhën shqipe.

Neni 181

Kohëzgjatja e mbrojtjes

(ndryshuar me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014 dhe nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Mbrojtja e TGJ ose EO fillon me regjistrimin në DPPI, me efekt nga data e depozitimit të aplikimit.
2. Mbrojtja ligjore e një TGJ ose EO të regjistruar është e pakufizuar në kohë dhe përfundon kur nuk ekziston më lidhja ndërmjet vetive e karakteristikave të mallrave dhe mjedisit gjeografik.

KREU XXXI

PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E NJË TREGUESI GJOGRAFIK OSE EMËRTIMI ORIGJINE

(ndryshuar kreu kapitulli me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

Neni 182

Depozitimi i aplikimit

1. Aplikimi për regjistrimin e një treguesi gjeografik ose emërtimi origjine depozitohet pranë DPPI-së.
2. Aplikimi bëhet vetëm për një tregues gjeografik ose emërtimi origjine dhe për një lloj produkti.
3. Aplikimi përmban:
 - a) emrin dhe adresën e grupit të prodhuesve dhe të autoriteteve ose, nëse disponohet, organin që verifikon përputhshmërinë me dispozitat ligjore që përcaktojnë specifikimet e produktit;
 - b) specifikimet e produktit që përfshijnë:
 - i) emrin që do të mbrohet si emërtim origjine ose tregues gjeografik, ashtu si përdoret në tregti ose në gjuhën e zakonshme;
 - ii) një përshkrim të produktit, përfshirë materialet e lëndës së parë dhe, nëse është e përshtatshme, edhe karakteristikat kryesore fizike, kimike, mikrobiologjike ose organoleptike të produktit;
 - iii) përcaktimin e zonës gjeografike;
 - iv) prova që produkti e ka origjinën nga zona gjeografike e përcaktuar;
 - v) një përshkrim të metodës së përfutimit të produktit dhe, kur është e përshtatshme, metodat lokale autentike e të pandryshueshme si dhe një informacion lidhur me paketimin, në qoftë se grupi i prodhuesve vendos kështu, dhe jep justifikime të mjaftueshme në lidhje me specifikat e produktit se përse paketimi duhet të bëhet në zonën e caktuar gjeografike për të ruajtur cilësinë, për të siguruar origjinën ose kontrollin, duke mbajtur parasysh lëvizjen e lirë të mallrave dhe ofrimin falas të shërbimeve;
 - c) detajet që përcaktojnë:
 - i) lidhjen midis cilësisë ose karakteristikave të produktit dhe mjedisit gjeografik; ose
 - ii) kur është e përshtatshme, lidhjen midis një cilësie të caktuar, reputacionit ose karakteristikave të produktit me origjinën gjeografike;
 - iii) emrin dhe adresën e autoriteteve ose, nëse është e disponueshme, emrin dhe adresën e organit që verifikon përputhshmërinë me dispozitat ligjore që përcaktojnë specifikimet e produktit;
 - iv) çdo rregull specifik për etiketimin e produktit në fjalë;
 - ç) një dokument të lëshuar nga autoritetet vendore, që vërteton kryerjen e veprimtarisë prodhuese të aplikantit në rajonin gjeografik të dhënë;
 - d) autorizimin nëse personi që aplikon përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar;
 - dh) aplikimi shoqërohet me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse.
4. Specifikimet e produktit në lidhje me verën duhet të paktën të përbëhen nga:
 - a) emri që do të mbrohet;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- b) një përshkrim i verës ose verërave;
 - i) në lidhje emërtimet e origjinës, karakteristikat kryesore analitike dhe organoleptike;
 - ii) në lidhje me treguesit gjeografikë, karakteristikat kryesore analitike, si dhe një vlerësim ose indikacione të karakteristikave të tij organoleptike;
 - c) kur është e aplikueshme, praktikat enologjike specifike të përdorura për prodhimin e verës ose verërave, si dhe kufizimet që lidhen me përgatitjen e tyre;
 - ç) kufijtë e zonës gjeografike që i përkasin;
 - d) maksimumin e prodhimit për hektar;
 - dh) një tregues për varietetin ose varietetet e rrushit, nga i cili përftohet vera ose verërat;
 - e) detajet që rezultojnë nga nënndarja “i”, e shkronjës “a”, të pikës 7, të nenit 176, ose nënndarja “i”, e shkronjës “b”, të pikës 7, të nenit 176;
 - ë) emrin dhe adresën e autoriteteve ose emrin dhe adresën e organit që verifikon përputhshmërinë me dispozitat ligjore që përcaktojnë specifikimet e produktit.
5. Procedurat dhe plotësimet e tjera për kërkesën përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

Neni 182/a

Ekzaminimi i formaliteteve

1. DPPI-ja ekzaminon kërkesat për regjistrimin e treguesve gjeografikë ose emërtimeve të origjinës, sipas numrit rendor të paraqitjes së tyre.
2. DPPI-ja, brenda tre muajve nga data e marrjes së aplikimit, ekzaminon nëse aplikimi përmban elementet e specifikuar në nenin 182 të këtij ligji.
3. Nëse kërkesa për regjistrimin e treguesit gjeografik apo emërtimeve të origjinës i përmban të gjitha elementet e nenit 182 të ligjit, DPPI-ja e publikon atë në buletin e radhës.
4. Nëse DPPI-ja vëren se nuk janë përfshirë të gjitha elementet e nenit 182 të këtij ligji dhe të rregullores së dalë në zbatim të tij, njofton aplikantin për të bërë plotësimet brenda dy muajve nga data e njoftimit. Kur aplikanti nuk kryen plotësimet e kërkuara brenda kohës së caktuar, DPPI-ja refuzon aplikimin për regjistrimin e treguesit gjeografikë apo emërtimeve të origjinës.
5. Periudha për paraqitjen e plotësimeve mund të zgjatet deri në dy muaj shtesë, nëse aplikanti paraqet një kërkesë me shkrim për zgjatje afati, të shoqëruar me pagesën përkatëse, e cila duhet të depozitohet brenda përfundimit të afatit dymujor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni.
6. Vendimi për refuzimin e aplikimit mund të apelohej brenda 1 muaji në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim.

Neni 182/b

Publikimi i aplikimit

1. DPPI-ja publikon elementet kryesore të aplikimit.
2. Të dhënat që publikohen në buletin e DPPI-së përcaktohen në rregulloren përkatëse.

Neni 182/c

Ekzaminimi në substancë

(ndryshuar pikat 5 e 6, dhe shtuar pika 8 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Në qoftë se aplikimi për një TGJ ose EO i referohet një produkti bujqësor apo ushqimor, brenda 30 ditëve nga data e mbylljes së publikimit, DPPI-ja i dërgon kërkesën, me një kopje të dosjes, ministrit përgjegjës për bujqësinë për vlerësim, në lidhje me specifikimet e produktit, në përputhje me kërkesat e shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 182, dhe nenit 176, të këtij ligji.
2. Në qoftë se aplikimi për një TGJ ose EO i referohet një produkti jobujqësor apo joushqimor, brenda një muaji nga data e mbylljes së publikimit, DPPI-ja i dërgon kërkesën me një kopje të dosjes së aplikimit autoritetit kompetent për vlerësim në lidhje me specifikimet e produktit, në përputhje me kërkesat e shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 182 dhe nenit 176, të këtij ligji.
3. Procedura në lidhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përcaktohet në rregulloren përkatëse.
4. Vlerësimi i kërkuar sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohet nga organet kompetente brenda një periudhe dymujore nga data e paraqitjes së kërkesës.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

5. Kur vlerësimi i parashikuar në pikat 1 e 2 të këtij neni është pozitiv, DPPI-ja, pas kryerjes së pagesës për regjistrim brenda afatit 3-mujor nga data e marrjes së njoftimit, regjistron treguesin gjeografik ose emërtimin e origjinës dhe lëshon certifikatën.

6. Kur vlerësimi i specifikimeve të produktit, sipas pikave 1 ose 2 të këtij neni, është negativ ose kur pagesa për regjistrimin e emërtimin të origjinës ose të treguesit gjeografik nuk është kryer brenda afatit të caktuar, DPPI-ja refuzon regjistrimin e aplikimit dhe njofton kërkuesin.

7. Vendimi i refuzimit, i lëshuar sipas pikës 6, të këtij neni, mund të apelohej në gjykatë brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit.

8. Në rastin kur aplikimi për mbrojtjen e një treguesi gjeografik ose emërtimi i origjinës është paraqitur nga një grup i huaj prodhuesish, sipas nenit 180/c të këtij ligji, DPPI-ja nuk kërkon vlerësimin e specifikimeve të produktit, siç përcaktohet në pikat 1 e 2 të këtij neni.

Neni 182/ç

Procedura e kundërshtimit

(ndryshuar pika 11 dhe shtuar pikat 11/1 e 11/2 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Çdo person fizik ose juridik që ka interes të ligjshëm mund të depozitojë një kundërshtim ndaj aplikimit brenda një afati tremujor nga data e publikimit, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, pranë Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve.

2. Kundërshtimi duhet të përfshijë:

a) emrin dhe adresën e personit që depoziton kundërshtimin;

b) të dhëna që justifikojnë interesin ekonomik ose juridik të personit që depoziton kundërshtimin.

Të dhënat për depozitimin e kundërshtimit dhe procedurat përkatëse përcaktohen në rregulloren përkatëse.

3. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve ekzaminon nëse kundërshtimi është depozituar në përputhje me kërkesat e pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Nëse kërkesat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, nuk plotësohen, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve refuzon kërkesën për kundërshtim dhe njofton paraqitësin e kërkesës.

5. Nëse kërkesat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, plotësohen, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve njofton aplikantin dhe i jep atij mundësinë të paraqesë vërejtje, shpjegime ose dokumente shtesë brenda dy muajve nga data e njoftimit.

6. Afati kohor, i parashikuar në pikën 5, të këtij neni, nuk mund të zgjatet.

7. Nëse kundërshtimi ka si objekt specifikimet e një produkti bujqësor ose ushqimor, bazuar në shkronjën “a”, të nenit 182/d, të këtij ligji, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve i dërgon dosjen e aplikimit së bashku me dosjen e plotë për kundërshtim ministrit përgjegjës për bujqësinë për miratim brenda një muaji nga plotësimi i të gjitha dokumenteve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

8. Nëse kundërshtimi ka si objekt specifikimet e një produkti jobujqësor ose joushqimor, bazuar në shkronjën “a”, të nenit 182/d, të këtij ligji, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve i dërgon dosjen e aplikimit së bashku me dosjen e plotë për kundërshtim autoritetit kompetent për miratim brenda 1 muaji nga plotësimi i të gjitha dokumenteve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

9. Nëse kundërshtimi ka si objekt një pretendim të bazuar në shkronjat “b”, “c”, dhe “d”, të nenit 182/d, të këtij ligji, kërkesa shqyrtohet nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, që del me vendim brenda 2 muajve nga plotësimi i të gjithë dokumentacionit të përcaktuar në rregulloren përkatëse. Vendimi, sipas kësaj pike, mund të apelohej në Bordin e Apelit brenda 1 muaji nga data e njoftimit të vendimit.

10. Nëse aplikanti i TGJ ose EO së kundërshtuar paraqet argumentet e tij ndaj kundërshtimit brenda afatit të parashikuar, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve shqyrton brenda dy muajve argumentet dhe bazën ligjore, mbi të cilat mbështetet kundërshtimi.

11. Bazuar në një vlerësim pozitiv lidhur me aplikimin e kundërshtuar, referuar pikave 7 e 8 të këtij neni, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve merr vendimin për regjistrimin e TGJ-së ose EO-së.

11/1. Pasi vendimi i Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve merr formë të prerë, DPPI-ja njofton aplikantin të kryejë pagesën përkatëse për regjistrimin e TGJ-së ose EO-së brenda afatit 3-mujor nga data e marrjes së njoftimit.

11/2. Brenda 3 (tre) muajve nga data e depozitimit të dokumentit të pagesës, sipas pikës 12 të këtij neni, DPPI-ja lëshon certifikatën e regjistrimit të TGJ-së ose EO-së.

12. Bazuar në një vlerësim negativ në lidhje me aplikimin e kundërshtuar, referuar pikave 7 dhe 8, të këtij

Përmbledhje legjislatoni për pronësinë industriale

neni, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve brenda një muaji merr vendim për refuzimin e regjistrimit dhe njofton aplikantin.

13. Kundër vendimit të refuzimit, të parashikuar në pikën 12, të këtij neni, mund të bëhet apelim në gjykatë brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 182/d

Bazat për kundërshtim

1. Një kundërshtim ndaj një aplikimi për regjistrimin e një TGJ ose një EO do të jetë i pranueshëm vetëm nëse ai do të depozitohet në DPPI brenda afatit tremujor të publikimit dhe nëse:

a) tregon se aplikimi për regjistrimin e TGJ ose EO nuk përmbush kushtet e parashikuara në nenin 176 dhe shkronjën “b”, të pikës 3, të nenit 182;

b) tregon se regjistrimi i emrit që kërkohet të mbrohet është në kundërshtim me nenin 180;

c) tregon se regjistrimi i emrit që kërkohet të mbrohet rrezikon një emër tërësisht ose pjesërisht identik të mbrojtur ose një markë tregtare që gëzon të drejta të mëparshme ose ekzistencën e produkteve, të cilat kanë qenë ligjërish në treg për të paktën pesë vjet para datës së regjistrimit; ose

ç) jep detaje, nga të cilat mund të konkludohet se emri për të cilin kërkohet regjistrimi është një term i përgjithshëm përshkrues.

2. Afati sipas pikës 1, të këtij neni, nuk mund të zgjatet.

Neni 182/dh

Ndryshime në specifikimet e produktit

1. Një grup që ka interes të ligjshëm mund të aplikojë për miratimin e ndryshimeve në specifikimet e produktit.

2. Aplikanti duhet të justifikojë dhe të japë arsye në lidhje me ndryshimet e kërkuara.

3. Aplikimi për ndryshim do të ndjekë procedurën e parashikuar në nenet 182, 182/a, 182/b, 182/c, 182/ç dhe 182/d të këtij ligji.

Neni 183

Shfuqizimi i një treguesi gjeografik

1. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim, me kërkesë të çdo pale që ka një interes të ligjshëm, mund të marrë vendim për shfuqizimin e një TGJM ose EOM në rastet e mëposhtme:

a) kur nuk ekziston më përputhshmëria me kushtet e specifikimeve të produktit;

b) kur nuk është hedhur në treg asnjë produkt me këtë TGJM ose EOM për një periudhë kohore të pandërprerë prej shtatë vjetësh.

2. Rregulla të hollësishme në lidhje me procedurën e shfuqizimit përcaktohen në rregulloren përkatëse.

3. Vendimi i shfuqizimit të TGJM ose EOM apelohej në gjykatë brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit mbi vendimin.

XXXI/a

BAZA E TË DHËNAVE ELEKTRONIKE E PRONËSISË INDUSTRIALE DHE SISTEMI I ADMINISTRIMIT TË PRONËSISË INDUSTRIALE (SAPI)

(shtuar kreu XXXI/a me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

Neni 183/a

Baza e të dhënave të pronësisë industriale dhe SAPI

1. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale krijon dhe administron bazën e të dhënave shtetërore për Sistemin e Administrimit të Pronësisë Industriale (në vijim “SAPI”).

2. SAPI është mjeti elektronik, përfshirë edhe bazën e të dhënave, për administrimin e objekteve të pronësisë industriale nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI).

SAPI përfaqëson regjistrin unik që mbledh e përpunon të dhënat e objekteve të pronësisë industriale, duke

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

përfshirë të gjitha kërkesat e lidhura me objektet e pronësisë industriale të depozituara nga individë/subjekte vendase apo të huaja në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pronësinë industriale.

Neni 183/b

Përmbajtja e SAPI-t

1. SAPI përmban këto të dhëna:

a) të dhënat e patentave për shpikje, të modeleve të përdorimit, të produkteve gjysmëpërçuese, markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, që janë aplikuar dhe/ose regjistruar në DPPI në përputhje me legjislacionin në fuqi për pronësinë industriale;

b) të dhënat e patentave për shpikje, të markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës ndërkombëtare të aplikuara dhe/ose regjistruara në dhe për Republikën e Shqipërisë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku vendi ynë ka aderuar ose ratifikuar;

c) të dhënat lidhur me kërkesat për regjistrimin e patentave për shpikje, të modeleve të përdorimit, të produkteve gjysmëpërçuese, të markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, të cilat janë refuzuar, zhvlerësuar, shfuqizuar apo kanë skaduar;

ç) të dhënat për çdo ndryshim në regjistrat e patentave për shpikje, të modeleve të përdorimit, produkteve gjysmëpërçuese, markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës që janë aplikuar dhe/ose regjistruar;

d) të dhënat për vizatimet dhe paraqitjet figurative të patentave për shpikje, të modeleve të përdorimit, produkteve gjysmëpërçuese, disenjove industriale, si dhe paraqitjet figurative të markave, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës;

dh) referencat për dokumentet e skanuara, të cilat janë depozituar ose lëshuar nga DPPI-ja;

e) të dhënat për dokumentet shoqëruese/akte dhe informacione që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në regjistra;

ë) të gjitha dokumentet e skanuara lidhur me kërkesat e depozituara në DPPI;

f) të dhënat për palët, individë dhe subjekte, të cilat administrohen dhe përpunohen në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;

g) informacione të tjera plotësuese për procese të punës së stafit të DPPI-së;

gj) informacione në lidhje me publikimet zyrtare të buletineve të pronësisë industriale;

h) të dhëna në lidhje me klasifikimet ndërkombëtare për objektet e pronësisë industriale, të cilat janë përdorur nga DPPI-ja gjatë procesit të ekzaminimit;

i) të dhëna referuese për ndërveprimin dhe baza të dhënash të tjera;

j) të dhëna të regjistratit të përfaqësuesve të autorizuar;

k) të dhëna të regjistratit të ekspertëve në fushën e pronësisë industriale;

l) të dhëna të kontratave të licencave të objekteve të pronësisë industriale;

ll) të dhëna në lidhje me certifikatat e mbrojtjes shtesë në përputhje me legjislacionin në fuqi për pronësinë industriale;

m) të dhëna për pagesat e kryera në lidhje me shërbimet e ofruara pranë DPPI-së;

n) të dhëna të përdoruesve të sistemit SAPI;

nj) të dhëna referuese për komunikimin me regjistrat *online* të organizmave ndërkombëtarë me të cilët DPPI-ja ka marrëveshje;

o) të dhënat e raporteve dhe të statistikave.

2. Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e mbledhura në kohë reale nga SAPI dhe që kanë të bëjnë me:

a) të dhënat që u përkasin kërkesave për regjistrimin e patentave për shpikje, modeleve të përdorimit, produkteve gjysmëpërçuese, markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës;

b) të dhënat që u përkasin patentave për shpikje, modeleve të përdorimit, produkteve gjysmëpërçuese, markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, të cilat janë refuzuar, shfuqizuar, zhvlerësuar apo kanë skaduar;

c) çdo ndryshim në regjistrat e patentave për shpikje, modeleve të përdorimit, produktet gjysmëpërçuese, markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, të cilët janë aplikuar dhe/ose regjistruar;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

ç) të dhëna për dokumentet shoqëruese/aktet dhe informacione që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në regjistria;

d) të dhënat që i përkasin numrit unik të aplikimit dhe/ose regjistrimit të patentave për shpikje, modeleve të përdorimit, markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës;

dh) referencat për dokumentet e skanuara, të cilat janë depozituar ose lëshuar nga DPPI-ja;

e) të dhëna për individë/subjekte të huaja, të cilët kërkojnë të regjistrojnë patenta për shpikje, modele përdorimi, marka, diseno industriale, tregues gjeografikë dhe emërtime të origjinës, që administrohen e përpunohen në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;

ë) tagrat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e subjekteve në marrëdhënie me të tretët;

f) të dhëna për kërkesat dhe miratimin për lëshimin e dublikatave dhe ekstrakteve nga regjistri;

g) të dhëna për kërkesat e sigurimit të informacionit në shërbim të hetimeve;

gj) të dhëna në lidhje me historikun e veprimeve të kryera për një aplikim.

3. Të dhëna dytësore janë të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash shtetërore, ku ato janë parësore, në shërbim të regjistrimit/mbrojtjes së pronësisë industriale dhe që kanë të bëjnë me:

a) të dhënat identifikuese për kërkesit, mbajtësit e të drejtave, shpikësve të patentave apo modeleve të përdorimit dhe krijuesve të disenjos industriale, duke përfshirë: emrin, mbiemrin, adresën;

b) të dhëna për ndërveprim me baza të dhënash të tjera;

c) të dhëna për individë/subjekte të huaja, të cilët kërkojnë të regjistrojnë patenta për shpikje, modele përdorimi, marka, diseno industriale, tregues gjeografikë dhe emërtime origjine në dhe për territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është subjekti përgjegjës për administrimin e bazës së të dhënave të SAPI-t.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale përfaqëson autoritetin e vetëm, i cili përcakton të drejtat dhe kufizimet e operimit në bazën e të dhënave elektronike nëpërmjet aplikimit të skemave të aksesit me nivele të shkallëzuara dhe hierarkike të administrimit të informacionit respektiv për të gjitha institucionet e tjera të interesuara për të dhënat në këtë regjistr.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është përgjegjëse për krijimin, operimin dhe mirëfunksionimin e të gjithë përdoruesve me privilegje aksesit të nivelit të parë të bazës së të dhënave elektronike të SAPI-t dhe miraton gjithashtu krijimin e përdoruesve, duke monitoruar operacionet e të gjithë këtyre përdoruesve të tjerë me privilegje aksesit të nivelit të dytë.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni administrues dhe përgjegjës i bazës së të dhënave të SAPI-t dhe i procesit të regjistrimit të saj.

8. Ofrues i informacionit që përmban SAPI është DPPI-ja dhe organizatat ndërkombëtare me të cilat DPPI-ja ka marrëveshje për shkëmbim të të dhënave të hapura për publikun.

9. Subjekte të interesuara janë:

a) ministria përgjegjëse për ekonominë;

b) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

c) Policia e Shtetit, prokuroria apo agjenci të tjera të hetimit;

ç) gjykatat;

d) organizmat ndërkombëtarë në fushën e pronësisë industriale, më të cilët Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka marrëveshje bashkëpunimi ose detyrime në bazë të ligjeve apo të marrëveshjeve ndërkombëtare të posaçme;

dh) inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut;

e) çdo subjekt tjetër publik apo privat që lidh marrëveshje me DPPI-në apo ka detyrimin në bazë të ligjeve të posaçme.

10. Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të SAPI-t është si më poshtë:

a) individët dhe subjektet fizike dhe juridike kanë të drejtë aksesit në regjistrat publikë, të cilët Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale i publikon në faqen zyrtare të saj;

b) institucionet ndërkombëtare me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale shkëmben të dhëna, kanë të drejtë aksesit në regjistrat publikë që publikohen në faqen zyrtare të saj;

c) institucionet ndërkombëtare me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale shkëmben të dhëna, kanë të drejtë të publikojnë në regjistrat e tyre *online* të dhënat e dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, siç është përcaktuar shprehimisht në marrëveshjet e lidhura ndërmjet tyre;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale gjatë aktivitetit të saj ka të drejtë akses, administrimi, përpunimi dhe modifikimi për të dhënat e ruajtura nga SAPI, në përputhje me parashikimet e legjislacioni në fuqi;

d) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, pa cenuar të drejtat e autorit, ka të drejta të plota administrative mbi sistemin lidhur me rolet:

- i. administrator;
- ii. raportues;
- iii. auditues.

dh) të drejtat e autorit mbi kodin burim janë në pronësi të Organizatës Botërore të Pronësisë Industriale;

e) subjektet e tjera, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të kenë akses në nivelin raportues ose statistikor për të monitoruar apo raportuar mbi veprimet për pronësinë industriale.

KREU XXXII USHTRIMI I TË DREJTAVE

Neni 184

Aktet që përbëjnë shkelje të të drejtave

(ndryshuar neni me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014;

ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Veprimet e kryera nga çdo person, në kundërshtim me nenet 36, 37, pika 1, 47 e 48, të ligjit, për një shpikje, e cila mbrohet nga një patentë ose nga një aplikim për patentë, përbëjnë shkelje të të drejtave të patentës.

Në gjykimet civile për shkeljet e të drejtave të një procesi të patentuar, kur objekti i një patente është një proces për përfitim të një produkti, gjykata ka të drejtë të urdhërojë të paditurin të provojë se procesi për përfitim të një produkti identik është i ndryshëm nga procesi i patentuar.

Pavarësisht nga sa parashikohet në paragrafin e mëparshëm, nëse:

- a) produkti i përfutur nga procesi është i ri;
- b) ose ka gjasë thelbësore se produkti të jetë bërë nga procesi i patentuar, por pronari i patentës nuk ka qenë në gjendje pas përpjekjesh të arsyeshme të përcaktojë procesin e përdorur faktikisht, do të prezumohet se produkti është prodhuar duke përdorur procesin e patentuar, përveç kur provohet e kundërta.

2. Përbën shkelje të së drejtës, sipas rastit, çdo përdorim, kufizim, imitim ose bashkëshoqërim i paaautorizuar i disenjos së regjistruar, markës apo treguesit gjeografik, si dhe çdo veprim tjetër që cenon të drejtat e pronarit, sipas neneve 127, 156 dhe 178, të këtij ligji. I njëjti rregull zbatohet edhe për disenjon, markën apo treguesin gjeografik të depozituar në DPPI, për të cilin është bërë kërkesë për regjistrim, sipas këtij ligji.

Neni 184/a

E drejta për të vepruar kundër shkeljes së të drejtave

(shtuar neni me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. E drejta për të ngritur padi në gjykatë për shkelje të të drejtave, sipas këtij ligji, i përket:

- a) pronarit të një patente, disenjoje ose markë të regjistruar;
- b) përdoruesit të autorizuar të një marke kolektive ose treguesi gjeografik;
- c) mbajtësit të një licence ekskluzive për një patentë ose aplikim për patentë, në përputhje me kreun XXX, si dhe mbajtësit të një licence për një disenjo industriale ose marke, në përputhje me nenet 129 dhe 163, të këtij ligji;

ç) pronarit të një marke të mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, në përputhje me shkronjën “ç”, të pikës 5, të nenit 143, të këtij ligji.

2. Pronari i një patente ose i një aplikimi për patentë ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë kundër çdo personi, që ka shkelur, po shkel ose rrezikon të shkelë të drejtat mbi patentën. Megjithatë, gjykata mund të mos vendosë në themel për çështjen, derisa të publikohet patentat e dhënë.

3. Kur i licencuari ka një licencë ekskluzive mbi një patentë ose aplikim për patentë, ai ka të drejtë të fillojë proces gjyqësor, nëse pronari i patentës ose i aplikimit për patentë, pas njoftimit zyrtar nga i licencuari, nuk fillon procesin gjyqësor kundër shkeljeve, brenda një periudhe të arsyeshme kohe. Nëse licenca e patentës është

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

joekskluzive, i licencuari mund të fillojë procesin gjyqësor kundër shkeljes vetëm nëse pronari i saj ose aplikuesi për patentë jep pëlqimin. Pronari i patentës ose aplikuesi për patentë ka të drejtë të marrë pjesë në procesin gjyqësor kundër shkeljes së filluar nga i licencuari. Në rastin kur gjykimi ndaj shkeljeve fillohet nga pronari i patentës, i licencuari ka të drejtë të marrë pjesë në gjykim si person i tretë.

Neni 184/b

Procedurat në rast shkeljeje

(shtuar neni me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Personat e përmendur në nenin 184/a, të këtij ligji, kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kundër çdo personi, që shkel të drejtat e tyre për të kërkuar:

- a) ndalimin e mallrave/shërbimeve që shkelin të drejtat e personave që parashikohen në nenin 184/a;
- b) heqjen ose bllokimin nga qarkullimi civil i materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura kryesisht për krijimin ose prodhimin e mallrave ose shërbimeve që shkelin të drejtat;
- c) në lidhje me mallrat e paligjshme (*counterfeiting*), thjesht heqja ose shpëputja e markës së ngjitur në këto mallra nuk është e mjaftueshme, përveçse në raste përjashtimore për të lejuar hedhjen në treg të këtyre mallrave.
- ç) publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e personit që ka kryer shkeljen, sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata.

2. Gjykata urdhëron zbatimin e masave të parashikuara në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c”, të këtij neni, me shpenzimet e shkelësit, përveç kur ka arsye të veçanta për të vendosur ndryshe. Në shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masave të parashikuara në pikën 1, shkronjat “b” dhe “c”, gjykata vlerëson proporcionalitetin midis rëndësisë së shkeljes dhe masës së urdhëruar, si dhe interesat e palëve të treta.

3. Masa e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, mund të merret edhe ndaj një ndërmjetësi, shërbimet e të cilit përdoren nga një palë e tretë për të shkelur një të drejtë të pronësisë industriale.

4. Padia kundër shkeljes së të drejtave duhet të depozitohet në gjykatë, brenda tre vjetëve nga data kur paditësi merr dijeni për shkeljen dhe shkelësin.

Neni 184/c

Shpërblimi i dëmeve

(shtuar neni me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

Shkelësi është përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar paditësit. Gjykata, në përputhje me dispozitat e legjislacioni në fuqi, vendos për masën e dëmshpërblimit, përveç kur është parashikuar ndryshe. Gjykata, në caktimin e masës së dëmshpërblimit:

- a) mban parasysh çdo dëm efektiv dhe real, përfshirë edhe fitimin e munguar, që ka pësuar pala e dëmtuar, çdo fitim të padrejtë, të realizuar nga shkelësi, si rezultat i konkurrencës së pandershme dhe, sipas rastit, edhe dëmin moral shkaktuar mbajtësit të të drejtave nga shkelja, cenimin e emrit apo të reputacionit të tij tregtar etj.;
- b) sipas rastit, mund të vendosë shpërblimin e menjëhershëm të dëmit duke llogaritur fitimet që do të siguroheshin ose do të merreshin në rast se shkelësi do të kishte kërkuar autorizim për përdorimin e së drejtës së pronësisë industriale në fjalë.

Neni 184/ç

Paditë kundër vendimeve të Bordit të Apelit

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

Kundër një vendimi të Bordit të Apelit mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 45 ditëve nga dita kur është marrë njoftim për vendimin.

Neni 185

E drejta e informacionit

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Gjatë procesit të shqyrtimit të shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale, gjykata në bazë të kërkesës, mund të urdhërojë që informacioni për origjinën dhe rrjetin shpërndarës të mallrave, shërbimeve që cenojnë këto të drejta, të jepet ose të sigurohet nga shkelësi dhe/ose çdo person tjetër për të cilin:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

a) është konstatuar se zotëron mallra cenuese, në kuptimin e këtij ligji, në shkallë tregtare;
b) është konstatuar se përdor shërbime cenuese, në kuptimin e këtij ligji, në shkallë tregtare;
c) është konstatuar se ofron shërbime të përdorura në veprimtaritë cenuese, në shkallë tregtare;
ç) tregohet nga personi i përmendur në shkronjat “a”, “b” ose “c” të kësaj pike se është përfshirë në prodhimin, përgatitjen apo shpërndarjen e mallrave ose në kryerjen e shërbimeve.

2. Informacioni i përmendur në pikën 1 të këtij neni, sipas rastit, përmban:

a) emrat dhe adresat e prodhuesve, fabrikuesve, shpërndarësve, furnizuesve e të mbajtësve të tjerë të mëparshëm të mallrave dhe shërbimeve, si dhe të tregtuesve me shumicë dhe pakicë;

b) të dhëna për sasitë e prodhuara, të fabrikuara, të shpërndara, të marra ose të porositura, si edhe çmimet e marra për mallrat apo shërbimet në fjalë.

3. Pikat 1 e 2 të këtij neni nuk zbatohen nëse:

a) në bazë të informacionit të paraqitur për administrim, gjykata ka arsye të besojë se e drejta për informacion është shpërdoruar;

b) informacioni i kërkuar e detyron personin e përmendur në pikën 1 të këtij neni, të pranojë pjesëmarrjen e tij ose të të afërmeve të ngushtë të tij në shkeljen e së drejtës së markës;

c) bërja e ditur ose publike e informacionit nuk mund të kërkohej për shkak të rregullave, që mbrojnë konfidencialitetin e burimeve informuese ose përpunimin e të dhënave personale.

Neni 185/a

Mbrojtja e të dhënave personale

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

Përpunimi i të dhënave personale, për qëllim të zbatimit të këtij ligji, duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 186

Provat

(shtuar pika 3 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Me kërkesë të palës, që ka paraqitur prova të mjaftueshme për mbështetjen e pretendimeve të veta dhe, për t'i bazuar këto pretendime, ka përcaktuar edhe prova të tjera, që janë në zotërim të palës kundërshtare, gjykata mund të urdhërojë që këto prova të paraqiten nga pala kundërshtare, me kusht që të mbrohet informacioni konfidencial.

2. Në po të njëjtat kushte, në rastin e shkeljes së kryer në shkallë tregtare, gjykata mund të urdhërojë, sipas rastit, me kërkesë të palës, paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare, që janë në zotërim të palës kundërshtare, me kusht që të mbrohet informacioni konfidencial.

3. Gjkata mund të urdhërojë këqyrjen e sendeve të luajtshme ose të paluajtshme dhe sigurimin e provave, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 187

Masat e përkohshme

(ndryshuar titulli, shkronja “a” e pikës 1, pika 4, 5 dhe shtuar pika 7 me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014; ndryshuar pikat 3 dhe 7 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Gjkata, me kërkesën e personit të interesuar, urdhëron vendosjen e masave të përkohshme kur ai:

a) është pronar, sipas parashikimit të këtij ligji dhe gëzon të drejtat e përcaktuara në nenet 36, 127, 156 dhe 178 të këtij ligji;

b) depoziton dokumente, që i japin mundësi gjykatës për të vendosur se e drejta e tij është shkelur, ose se ka shumë të ngjarë që shkelja të ndodhë;

c) kërkon që masat të merren pa vonesë të pajustificuar pas konstatimit të shkeljes së pretenduar.

2. Me marrjen e masave të përkohshme, gjykata:

a) ndalon shkeljet e pritshme ose shkeljet që kanë filluar të kryhen;

b) ndalon hyrjen e mallrave në rrugët tregtare;

c) urdhëron ruajtjen e provave të rëndësishme për shkeljen e pretenduar, me kusht që të mbrohet

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

informacioni konfidencial. Masa të tilla mund të përfshijnë përshkrimin e hollësishëm, me ose pa marrjen e mostrave, ose bllokimin fizik të mallrave shkelëse dhe, sipas rastit, të materialeve dhe të mjeteve të përdorura në prodhimin dhe/ose shpërndarjen e këtyre mallrave dhe të dokumenteve të lidhura me to;

c) konfiskon, nxjerr jashtë qarkullimit ose vë nën kontroll, për periudhën e vazhdimet të procesit gjyqësor, objektet që përbëjnë shkelje të të drejtave, sipas këtij ligji, ose mjetet e përdorura, kryesisht, për prodhimin e këtyre objekteve;

d) urdhëron, në rastin e një shkeljeje të kryer në shkallë tregtare dhe nëse pala e dëmtuar demonstron rrethana të tilla, që mund të rrezikojnë riparimin e dëmeve, bllokimin e përkohshëm të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të shkelësit të pretenduar, përfshirë edhe bllokimin e llogarive të tij bankare dhe të aseteve të tjera. Për këtë qëllim, gjykata mund të urdhërojë paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare, ose shfrytëzimin e mundësive të tjera, të përshtatshme, për të zotëruar informacionin përkatës.

3. Gjukata vendos për marrjen e masave të përkohshme, pa dëgjuar palën tjetër, veçanërisht kur vonesa mund t'i shkaktojë dëme të pariparueshme pronarit të së drejtës ose kur prova mund të shkatërrohet. Pala, kundër së cilës është vendosur masa, njoftohet menjëherë për masat e marra, por jo më vonë se menjëherë pas ekzekutimit të tyre.

Rishikimi, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar, bëhet me kërkesë të palës, kundër së cilës është vendosur masa, për të vendosur brenda një kohe të arsyeshme pas njoftimit të marrjes së masave nëse këto masa duhet të ndryshohen, të shfuqizohen ose të konfirmohen.

4. Kur vendos për marrjen e masave të përkohshme, gjykata cakton një afat, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, brenda të cilit personi që ka kërkuar këto masa duhet të ngrejë padi në gjykatë, në përputhje me nenin 184 të këtij ligji.

5. Masat e përkohshme, të përmendura në shkronjat "a" e "b", të pikës 2, të këtij neni, mund të jepen kundër shkelësit të pretenduar të së drejtës së pronësisë industriale, si dhe në kushte të njëjta kundër ndërmjetësit, shërbimet e të cilit janë përdorur nga pala e tretë për të cenuar këtë të drejtë.

6. Marrja e masave të përkohshme kushtëzohet me depozitimin nga paditësi të një garancie të përshtatshme ose të një sigurimi tjetër, të barasvlershëm me të, që synon të sigurojë kompensimin e çdo dëmi që i shkaktohet palës kundërshtare.

7. Nëse masat e përkohshme të parashikuara nga ky nen shfuqizohen, shuhen ose nëse ato bëhen të pavlefshme për shkak të një veprimi a mosveprimi të paditësit, gjykata urdhëron paditësin, me kërkesën e të paditurit, t'i ofrojë këtij të fundit shpërbllim të përshtatshëm për çdo dëm të shkaktuar, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 188

Masat në kufirin e vendit dhe në tregun e brendshëm

(ndryshuar me ligjin nr. 10/2013, datë 14.2.2013 dhe nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Nëse pronarët ose mbajtësit e të drejtave, në kuptim të këtij ligji, të një patente, disenoje ose marke të regjistruar ose përdoruesit e autorizuar të treguesit gjeografik të regjistruar paraqesin një kërkesë ankesë për mallrat e importuara në Republikën e Shqipërisë ose për mallrat e tjera brenda tregut, të cilat cenojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj, autoritetet doganore ose Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, sipas rastit, janë të detyruara të bëjnë verifikimet përkatëse dhe, në bazë të përfundimeve të nxjerra, të vendosin bllokimin e zhdoganimeve ose heqjen e mallrave nga tregu, si dhe vendosjen e tyre në një vend të sigurt, përveç kur importuesi ose tregtari vërteton, nëpërmjet dokumenteve të origjinës së mallrave, se ato nuk janë të falsifikuara. Autoritetet doganore dhe inspektorët e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut veprojnë edhe ex officio kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi që rregullon aktivitetin e këtyre organeve.

2. Procedurat për veprimet që ndërmarrin autoritetet doganore dhe inspektorët e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, sipas pikës 1, të këtij neni, rregullohen nga legjislacioni doganor dhe legjislacioni për inspektimet në Republikën e Shqipërisë.

3. Autoritetet doganore ose Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut njoftojnë menjëherë importuesin, pritësin e mallrave ose tregtarin për masat e marra.

4. Autoritetet doganore ose Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut i ndërpresin masat e marra, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse pronarët ose mbajtësit e të drejtave, në kuptim të këtij ligji, të një patente, disenoje ose marke të regjistruar apo përdoruesit e autorizuar të treguesit gjeografik të regjistruar, nuk ngrenë padi në gjykatë për shkeljen e të drejtave të tyre brenda 20 ditëve (ditë pune) nga data e njoftimit të marrjes së masave.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 188/a

Deklarata për mosshkelje të së drejtës së patentës

(shtuar neni me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014)

1. Çdo person i interesuar mund të ngrejë padi kundër pronarit të patentës për të provuar se një veprim i veçantë nuk përbën shkelje të patentës. I licencuari i një licence ekskluzive duhet të thirret në gjykatë si i paditur së bashku me pronarin e patentës.
2. Pronari i patentës ka detyrë të njoftojë të licencuarin për gjykimin në fjalë. I licencuari ka të drejtë të marrë pjesë në gjykim, me cilësinë e personit të tretë, përveç kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e licencimit.
3. Nëse është ngritur një padi për shkelje të një patente nga pronari ose i licencuari i saj kundër një personi, ky i fundit ka të drejtë të ngrejë kundërpadi për të provuar se veprimi i tij nuk përbën shkelje të patentës.
4. Kërkesëpadija e lartpërmendur mund të paraqitet së bashku me kërkesën për shfuqizimin e patentës.

PJESA VI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU XXXIII

(ndryshuar kërkesisht kreu me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

I DPPI-SË

Neni 189

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)

1. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucion publik jobuxhetor që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ka selinë e vet në Tiranë.
2. Drejtori i Përgjithshëm e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.
3. Veprimtaria e DPPI-së përcaktohet dhe rregullohet me këtë ligj dhe me akte të tjera të nënligjore.
4. Marrëdhëniet e punës të nëpunësve të DPPI-së rregullohen nga ligji për nëpunësin civil.
5. DPPI-ja ka logon dhe vulën e saj të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 189/a

Organet drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Organet drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 189/b

Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës është organ kolegjal, i përbërë nga 5 anëtarë, kryetari dhe 4 anëtarë, nga të cilët:
 - a) një jurist;
 - b) një financier;
 - c) një anëtar i kabinetit të Kryeministrit;
 - ç) një anëtar i kabinetit të ministrit përgjegjës për ekonominë;
 - d) një anëtar nga struktura që mbulon investimet e huaja.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga ministri përgjegjës për ekonominë.
3. Kryetar zgjidhet njëri nga anëtarët që parashikohen në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Në rast se kjo shumicë nuk arrihet, kryetari emërohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 189/c

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli i Mbikëqyrës ka këto kompetenca:

1. Mbikëqyr veprimtarinë e DPPI-së dhe ushtron çdo kompetencë tjetër sipas këtij ligji.
2. Miraton programet e zhvillimit të DPPI-së.
3. Miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe të funksionimit të DPPI-së.
4. Miraton strukturën dhe organikën e DPPI-së me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm pas marrjes së dakordësisë nga ministri përgjegjës për administratën publike dhe ministri përgjegjës për financat.
5. Miraton programin financiar të DPPI-së si dhe projektbuxhetin, i cili më pas miratohet nga Këshilli i Ministrave.
6. Miraton projektin për nivelin e pagave të punonjësve të DPPI-së, i cili më pas miratohet nga Këshilli i Ministrave.
7. Miraton çdo vit kriteret dhe masat për shpërblimet stimuluese të personelit për efektivitetin e shërbimit të kryer në DPPI, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.
8. Miraton kushtet, afatet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 189/ç

Kriteret e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Personi, që është për t'u emëruar si anëtar në Këshillin Mbikëqyrës, sipas shkronjave "a" dhe "b", të nenit 189/b, duhet të plotësojë këto kërkesa:

- a) të ketë shtetësi shqiptare;
- b) të ketë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave";
- c) të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune në profesion, në administratën publike, në institucione qendrore publike;
- ç) të mos jetë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për ndonjë vepër penale;
- d) të mos jetë larguar nga shërbimi civil;
- dh) të mos ketë vërejtje të pashuara ende;
- e) të mos ketë konflikte interesash me detyrën, sipas legjislacioni në fuqi.

Neni 189/d

Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Mandati i kryetarit dhe i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 3 vjet, pa të drejtë riemërimi, përveç rasteve kur anëtarët e zgjedhur sipas shkronjave "c", "ç" dhe "d", të nenit 189/b, lirohen nga funksionet e tyre përpara mbarimit të mandatit, të cilët do të zëvendësohen sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj për mandatin e mbetur. Anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikëqyrës, që parashikohen në shkronjat "a" dhe "b", të nenit 189/b, vazhdojnë të jenë anëtarë për atë kohë sa zgjat mandati i tyre, sipas këtij neni.

2. Kur mandati i kryetarit apo i një anëtari përfundon, ai qëndron në detyrë deri kur zëvendësohet. Një muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të Këshillit Mbikëqyrës, DPPI-ja lajmëron me shkrim ministrin përgjegjës për ekonominë, i cili fillon procedurat për emërimin e anëtarit të ri.

3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të jenë të punësuar, me kohë të plotë, në detyra të tjera, por nuk mund të jenë anëtarë të ndonjë këshilli tjetër mbikëqyrës.

Neni 189/dh

Largimi nga detyra i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës

1. Largimi nga detyra i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përpara përfundimit të mandatit bëhet kur anëtari:

- a) jep dorëheqjen;
- b) humbet pozicionin, sipas shkronjave "c", "ç" dhe "d", të pikës 1, të nenit 189/b;
- c) bëhet fizikisht i paaftë për më shumë se tre muaj të përbushë detyrën, për të cilën është emëruar;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- ç) mungon pa arsye për më shumë se tre mbledhje radhazi;
 - d) i shkakton dëm DPPI-së apo imazhit të saj për shkak të paaftësisë profesionale ose të qëndrimeve neglizhente;
 - dh) duke qenë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, ai/ajo vepron në kundërshtim me interesat e DPPI-së;
 - e) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - ë) humbet apo lë shtetësinë shqiptare.
2. Propozimi për lirim nga detyra të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës bëhet nga vetë këshilli ose nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së, shoqëruar me arsyet dhe dokumentet provuese, në bazë të të cilave kërkohet ky lirim. Ky propozim i paraqitet ministrit përgjegjës për ekonominë, i cili fillon procedurat përkatëse për lirim nga detyra.
3. Ministri, në zbatim të pikës 2, të këtij neni, mund të vendosë pezullimin e anëtarit nga kryerja e funksioneve deri në përfundim të verifikimit dhe marrjes së një vendimi.
4. Kur një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës lirohet nga detyra përpara mbarimit të mandatit, anëtari i ri zëvendësues emërohet sipas së njëjtës procedurë që u ndoq për emërimin e anëtarit që u largua.

Neni 189/e

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

1. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës thirren nga kryetari, me kërkesën e secilit prej anëtarëve ose me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPI-së. Drejtori i Përgjithshëm merr pjesë në mbledhjet e këtij këshilli pa të drejtë vote.
2. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet të paktën katër herë në vit. Mbledhjet e këshillit drejtohen nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve, i autorizuar prej tij.
3. Këshilli Mbikëqyrës harton rregulloren e tij të brendshme për funksionimin dhe organizimin e Këshillit Mbikëqyrës. Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së ia paraqet këtë rregullore për miratim ministrit përgjegjës për ekonominë.
4. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë të tij. Vendimet e tij janë të vlefshme kur shumica e anëtarëve të pranishëm votojnë në favor të tyre. Abstenimi nuk lejohet.
5. Për çdo mbledhje mbahet procesverbali nga sekretari teknik, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm, përfshi edhe sekretarin teknik, ndërsa vendimet e Këshillit Mbikëqyrës nënshkruhen nga kryetari.
6. Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së cakton një punonjës të DPPI-së në rolin e sekretarit teknik të Këshillit Mbikëqyrës.
7. Kryetari, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe sekretari teknik shpërblehen në masën dhe sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 190

Detyrimet, kufizimet dhe e drejta e shpërblimeve stimuluese të punonjësve të DPPI-së

1. Punonjësit e DPPI-së, gjatë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë, si dhe për një periudhë kohore prej një viti, pas përfundimit të punës në këtë drejtori, nuk mund të depozitojnë aplikime për patenta, marka tregtare, diseno industriale ose tregues gjeografikë. Atyre nuk u lejohet të gëzojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të drejta mbi patentat, markat tregtare ose disenjot industriale, përveç rasteve të trashëgimisë, të miratuara nga DPPI-ja, dhe as nuk mund të përfitojnë ndonjë të drejtë që rrjedh prej tyre.
2. Punonjësit e DPPI-së nuk mund të gëzojnë asnjë të drejtë për prioritet për patentat, regjistrimet e markave, disenjove industriale ose të treguesve gjeografikë ose për aplikimet për patenta, marka, diseno industriale ose tregues gjeografikë, të cilat kanë datë më të hershme se një vit nga përfundimi i punës në këtë drejtori.
3. Punonjësit e DPPI-së kanë të drejtën të marrin shpërblime stimuluese për efektivitetin e shërbimit të kryer në DPPI, sipas legjislacionit në fuqi.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 191

Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së

1. Drejtori i Përgjithshëm drejton veprimtarinë e kësaj drejtorie dhe ndjek përmbushjen e dispozitave, të parashikuara në këtë ligj dhe në rregulloret e nxjerra në zbatim të tij.
2. Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi dy apo shumëpalëshe me zyra homologe në fushën e pronësisë industriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson drejtorinë për çështje të pronësisë industriale në gjykatë, arbitrazh dhe institucionet shtetërore, brenda hapësirave të parashikuara në legjislacionin në fuqi, si dhe përfaqëson vendin për çështje të pronësisë industriale në organizatat ndërkombëtare të fushës, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.
4. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, Drejtori i Përgjithshëm i propozon për miratim Këshillit Mbikëqyrës rregulloren e brendshme të kësaj drejtorie, si dhe nxjerr urdhra, udhëzime ose akte të tjera të brendshme.
5. Drejtori i Përgjithshëm menaxhon punonjësit administrativë, në zbatim të legjislacionit në fuqi.
6. Drejtori i Përgjithshëm i propozon për miratim Këshillit Mbikëqyrës organikën, strukturën, projektin e nivelit të pagave, si dhe shpërblimet e punonjësve të DPPI-së.
7. Drejtori i Përgjithshëm i propozon për miratim Këshillit Mbikëqyrës kushtet, afatet dhe procedurat për ofrimin shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, pas marrjes së dakordësisë nga ministri përgjegjës për shoqërinë e informacionit.

Neni 191/a

Të ardhurat e DPPI-së

1. Të ardhurat që realizon DPPI-ja janë:
 - a) të ardhurat që krijohen nga aktiviteti i saj;
 - b) të ardhurat nga tarifat e Sistemit të Madridit për regjistrimin e markave ndërkombëtare, e Marrëveshjes së Hagës për aplikimet ndërkombëtare për diseno industriale, si dhe të gjitha marrëveshjet e tjera që Republika e Shqipërisë ka lidhur ose do të lidhë në fushën e pronësisë industriale;
 - c) të ardhura të tjera që mund të krijohen sipas legjislacionit në fuqi.
2. Pasqyra financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve hartohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
3. Të ardhurat përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, aktivitete të ndryshme në fushën e pronësisë industriale, brenda dhe jashtë vendit, të gjitha këto të nevojshme për ushtrimin dhe realizimin e funksioneve të DPPI-së, si dhe kontributeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë të PI-së.
4. Për projektet, aktivitetet apo investimet që zbatohen në kuadër të marrëveshjeve të lidhura nga DPPI-ja me institucione ndërkombëtare të fushës, të cilat investohen tërësisht me fondet e tyre apo pjesërisht edhe me fondet e DPPI-së, zbatohen procedurat që ndjekin këto institucione ose procedurat që përcaktohen në marrëveshjet përkatëse të lidhura me këto institucione.

Neni 191/b

Buxheti

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor.
2. Veprimtaria e DPPI-së financohet nga të ardhura të krijuara nga kryerja e veprimtarisë së saj në zbatim të këtij ligji dhe nga burime të tjera të ligjshme. Të ardhurat që DPPI-ja realizon, sipas këtij ligji, por të pashpërndara në fund të vitit, derdhen në Buxhetin e Shtetit, me përjashtim të:
 - a) fondeve të parashikuara për investime;
 - b) pagesave të menjëhershme për llogari të institucioneve ndërkombëtare të fushës, sipas të cilave Republika e Shqipërisë ka detyrime financiare.
3. DPPI-ja ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet të administrojë asetet e llogaritë e saj bankare pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 191/c

Kontabiliteti

1. DPPI-ja mban regjistrat kontabël, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet kontabël të zbatueshme.
2. Regjistrat kontabël duhet të pasqyrojnë me saktësi, në çdo kohë, gjendjen financiare të DPPI-së.
3. DPPI-ja përgatit pasqyrat financiare vjetore të veprimtarisë së vet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe, pas verifikimit dhe certifikimit të tyre nga ekspertët auditues, i raporton për rezultatin financiar ministrit përgjegjës për ekonominë.

Neni 191/ç

Raportimi nga DPPI-ja

1. Në muajin prill të vitit pasardhës DPPI-ja i paraqet ministrit:
 - a) një raport vjetor për veprimtarinë e tij, përfshirë të gjitha vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës;
 - b) pasqyrën vjetore financiare;
 - c) një raport për realizimin e planit të të ardhurave e të shpenzimeve.
2. DPPI-ja i paraqet ministrit përgjegjës për ekonominë, me kërkesë të këtij të fundit, çdo të dhënë tjetër që vlerësohet e nevojshme për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit të DPPI-së.

Neni 192

Regjistrat dhe buletini

1. DPPI-ja mban dhe administron regjistrat për:
 - a) aplikimet për regjistrimin e markave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe aplikimet për patentat e shpikjeve, modeleve të përdorimit dhe regjistrimin e topografisë së produkteve gjysmëpërçuese;
 - b) patentat e shpikjeve, modelet e përdorimit, topografia e produkteve gjysmëpërçuese, markat, disenjot industriale, treguesit gjeografikë, të regjistruara në DPPI;
 - c) përfaqësuesit e autorizuar për patentat, markat, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë;
 - ç) ekspertët e PI-së të licencuar nga DPPI-ja sipas nenit 198/b.
2. Regjistrat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, janë të hapur për inspektime nga publiku.
3. Të gjitha ndryshimet në lidhje me të dhënat e objekteve të pronësisë industriale pasqyrohen në regjistër dhe publikohen në Buletinin e Pronësisë Industriale.
4. DPPI-ja publikon Buletinin e Pronësisë Industriale të paktën një herë në muaj, në përputhje me kërkesat e këtij ligji. DPPI-ja e mban Buletinin e Pronësisë Industriale në format elektronik dhe e boton atë në faqen zyrtare të internetit.

Neni 192/a

Transmetimi i të dhënave elektronike

Për të lehtësuar procedurat e regjistrimit dhe/ose ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë, në favor të subjekteve të interesuara, DPPI-ja, në përputhje me legjislacionin në fuqi, bashkëpunon me autoritete të tjera publike, brenda dhe jashtë vendit, për ndërlidhjen dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave.

Neni 192/b

Veprimet pranë modulit për aplikimin elektronik

1. Çdo individ, pasi të jetë identifikuar elektronikisht, ka të drejtë që, në cilësinë e aplikantit apo të personit të autorizuar, të aplikojë apo të kryejë pranë sportelit elektronik çdo kërkesë për regjistrim apo veprim tjetër, sipas këtij ligji, përfshirë këtu procedurat e ankimit administrativ, dhe të marrë nga DPPI-ja nëpërmjet këtij moduli konfirmimin e marrjes nga DPPI-ja të aplikimit të tyre. Çdo aplikim/kërkesë në format elektronik duhet të shoqërohet me nënshkrimin elektronik, sipas legjislacionit në fuqi, për t'i dhënë vlerë ligjore këtij dokumenti.
2. Çdo individ, pa qenë i detyruar të identifikohet elektronikisht, ka të drejtë të kryejë pranë modulit për aplikimin elektronik kërkime elektronike në regjistër, të marrë ekstrakte, si dhe kopje të dokumenteve shoqëruese në format elektronik apo të kryejë veprime të tjera për informacione, të cilat janë të hapura për publikun dhe për të cilat identifikimi i personit, kryerja e pagesës së një tarife nëpërmjet mjeteve elektronike nuk kërkohet, sipas këtij ligji.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 192/c

Identifikimi elektronik

Veprimet pranë modulit për aplikimin elektronik të DPPI-së, për të cilat ky ligj kërkon identifikimin elektronik, kryhen nëpërmjet mjeteve elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën nëpërmjet nënshkrimit elektronik të avancuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik. Identifikimi elektronik kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

Neni 192/ç

Kushtet procedurale dhe teknike për modulën e aplikimit elektronik

1. Këshilli Mbikëqyrës përcakton kushtet, afatet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, sipas këtij ligji, nëpërmjet modulit për aplikimin elektronik, kushtet dhe mënyrat e pajisjes së individëve me të drejtat përkatëse të aksesit elektronik, procedurat për ndryshimin e tyre, kushtet e sigurisë e të ruajtjes së komunikimeve elektronike, mënyrat e vërtetimit të dokumenteve elektronike, të kërkesave e teknologjisë së zbatueshme për realizimin e tyre, sipas këtij ligji, si dhe procedurat e njoftimit publike, të realizuara nga DPPI-ja për rastet e remonteve të planifikuara apo të incidenteve teknike të modulit për aplikimin elektronik, si dhe për njoftimin e rasteve të ndërhyrjeve të paautorizuara.

2. Rregullat e parashikuara në këtë nen do të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për ofrimin e shërbimeve publike me mjete elektronike.

Neni 193

Dhoma për shqyrtimin e kundërshtimeve

1. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve është një strukturë e ngritur brenda njësisë së ekzaminimit dhe merr në shqyrtim observacionet dhe kërkesat për kundërshtim, në kuptim të këtij ligji.

2. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve përbëhet nga tre anëtarë të njësisë së ekzaminimit që emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

3. Vendimet e marra nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të ankimohen në Bordin e Apelit, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda një muaji nga data e marrjes dijeni të vendimit.

4. Organizimi dhe funksionimi i Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve rregullohen me rregulloren e brendshme të DPPI-së.

Neni 193/a

Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim

1. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim është një strukturë e ngritur brenda DPPI-së dhe merr në shqyrtim kërkesat për shfuqizim, zhvlerësim dhe apelit e vendimeve për refuzim, në kuptim të këtij ligji.

2. Dhoma për shfuqizim/zhvlerësim përbëhet nga tre anëtarë, që emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

3. Një prej anëtarëve të dhomës për shfuqizim/zhvlerësim është jurist.

4. Vendimet e marra nga dhoma për shfuqizim/zhvlerësim mund të ankimohen në Bordin e Apelit përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda një muaji nga data e marrjes dijeni të vendimit.

5. Organizimi dhe funksionimi i dhomës për shfuqizim/zhvlerësim rregullohen me rregulloren e brendshme të DPPI-së.

Neni 193/b

Bordi i Apelit

(ndryshuar fjalia e parë e pikës 1 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Bordi i Apelit përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët dy janë punonjës të DPPI-së dhe tre anëtarë të jashtëm të fushës së PI-së, të cilët plotësojnë kushtet për ekspertë të PI-së. Anëtarët e Bordit të Apelit nuk mund të jenë përfaqësues të autorizuar.

2. Anëtarët e dhomës për shfuqizim/zhvlerësim nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Apelit.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Kryetari i Bordit të Apelit është Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së. Anëtarët e Bordit të Apelit emërohen dhe lirohen nga Këshilli Mbikëqyrës, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPI-së për një periudhë 1-vjeçare, me të drejtë riemërimi.

4. Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së cakton një punonjës të DPPI-së në rolin e sekretarit teknik të Bordit të Apelit.

5. Organizimi, funksionimi i Bordit të Apelit, si dhe shpërblimi i kryetarit, anëtarëve dhe sekretarit të Bordit të Apelit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave për Bordin e Apelit.

6. Bordi i Apelit mbledhet sa herë është e nevojshme, por jo më pak se 4 herë në vit.

7. Procedurat e hollësishme për emërimin dhe lirin e anëtarëve të Bordit të Apelit parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për Bordin e Apelit.

Neni 193/c

Lirimi nga detyra i anëtarëve të Bordit të Apelit

Anëtari i Bordit të Apelit mund të lirohet nga detyra në rast se:

- a) nuk përmbush detyrat e caktuara;
- b) i është ndaluar ushtrimi i këtij aktiviteti me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) ka paraqitur dorëheqjen.

Neni 193/ç

Komisioni i Vlerësimit

1. Komisioni i Vlerësimit është një strukturë e ngritur brenda DPPI-së për licencimin e përfaqësuesve të autorizuar, si dhe ekspertëve të PI-së, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë, që emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

3. Organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Vlerësimit rregullohen me vendimin e Këshillit të Ministrave për përfaqësuesit e autorizuar dhe ekspertët.

Neni 193/d

Qendra e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Qendra e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale, pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së DPPI-së, organizon aktivitete, kurse, trajnime dhe seminare në fushën e PI-së.

2. Procedurat për pjesëmarrje në aktivitet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, tarifat përkatëse për pjesëmarrje në këto aktivitete dhe masa e shpërblimit të lektorëve në Qendrën e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 194

Informimi i publikut

1. Informimi i publikut për dokumente dhe informacione të tjera, që gjenden në DPPI, bëhet sipas legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit dhe sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Dokumentet dhe informacioni, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, jepen kundrejt tarifave të përcaktuara.

KREU XXXIV PËRFAQËSIMI

Neni 195

Përfaqësimi në DPPI

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Përfaqësimi në DPPI i personave bëhet nga përfaqësues të autorizuar, të regjistruar në këtë drejtori.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Personat mund të autorizojnë një ose më shumë përfaqësues, për të gjitha ose disa veprime në DPPI, nëpërmjet autorizimit të përfaqësimit.

3. Ndryshe nga sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, personat që kanë një adresë në Republikën e Shqipërisë ose që kryejnë veprimtari brenda territorit të saj, mund të përfaqësohen në DPPI vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tjerë, që nuk janë të regjistruar në këtë drejtori, por janë të pajisur me autorizim.

4. Të dhënat për autorizimin e përfaqësimit parashikohen në rregulloren përkatëse.

Neni 196

Shfuqizimi dhe kufizimi i përfaqësimit

1. Paraqitësi i kërkesës ose pronari i një objekti të pronësisë industriale ka të drejtë të shfuqizojë, të ndryshojë ose të kufizojë aktin e përfaqësimit apo tagrat e përfaqësimit.

2. Shfuqizimi, ndryshimi ose kufizimi i përfaqësimit sjellin pasoja, vetëm pasi për këto veprime është njoftuar me shkrim DPPI-ja.

Neni 197

Përfaqësuesit e autorizuar të patentave dhe markave

(ndryshuar neni me ligjin nr. 55/2014, datë 29.5.2014, nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Përfaqësues i autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit mund të jetë:

1.1. Çdo person me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë me kusht që:

a) të ketë përfunduar së paku studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave”;

i) në fushën e inxhinierisë ose të shkencave natyrore ose farmaceutike, si dhe të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale;

ii) në një fushë tjetër dhe të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në këtë fushë, si dhe të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale;

b) të ketë kaluar testimin për kualifikimin e përfaqësuesve të autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit.

1.2. Çdo ish-punonjës i DPPI-së i diplomuar, që ka jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale në DPPI.

2. Përfaqësues i autorizuar për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë mund të jetë:

2.1. Çdo person me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, me kusht që:

a) të ketë kryer së paku studimet e ciklit të dytë “Master profesional”, si dhe të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale;

b) të ketë kaluar testimin për kualifikimin e ekspertëve në fushën e markave, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë.

2.2. Çdo ish-punonjës i DPPI-së i diplomuar, që ka jo më pak se 3 vjet përvojë pune në çështjet e pronësisë industriale pranë DPPI-së.

3. DPPI-ja është organi i vetëm që licencon dhe vlerëson përfaqësuesit e autorizuar për objektet e pronësisë industriale, nëpërmjet testimit me shkrim.

Neni 198

Testimi kualifikues dhe Regjistri i Përfaqësuesve të Autorizuar

(ndryshuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017; ndryshuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Komisioni i Vlerësimit organizon testimin për kualifikimin e përfaqësuesve të autorizuar pranë DPPI-së. Pjesëmarrja në këtë testim bëhet kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

2. DPPI-ja regjistron në regjistrin përkatës përfaqësuesit e autorizuar të patentave, disenjove industriale, markave dhe treguesve gjeografikë, si dhe i publikon në format elektronik në faqen zyrtare të saj.

3. DPPI-ja i publikon përfaqësuesit e autorizuar të patentave, disenjove industriale, markave dhe treguesve gjeografikë, në format elektronik në faqen zyrtare të saj vetëm pasi ata kanë dorëzuar në DPPI ekstraktin e regjistrimit për lejin e ushtrimit të aktivitetit tregtar.

4. Nëse përfaqësuesi nuk e ushtron aktivitetin tregtar për një periudhë 5-vjeçare, certifikata nuk ripërtërihet dhe përfaqësuesi duhet t'i nënshtrohet edhe një herë testimit për marrjen e certifikatës.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

5. Detajet për Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar dhe për procedurat e regjistrimit përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për përfaqësuesit e autorizuar dhe ekspertët.

6. Regjistrimi i përfaqësuesve të autorizuar në regjistrin e përfaqësuesve, çdo ndryshim në këtë regjistër, si dhe publikimi në faqen zyrtare të DPPI-së bëhen kundrejt kërkesës dhe pagesës së tarifave përkatëse.

7. Regjistrimi në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar ripërtërihet çdo vit para datës së mbarimit të këtij afati kundrejt pagesës së tarifës së ripërtëritjes së regjistrimit të përfaqësuesve të autorizuar, të parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave për tarifën.

8. Detajet për ripërtëritjen e regjistrimit në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar, si dhe për procedurat e regjistrimit përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për përfaqësuesit e autorizuar dhe ekspertët.

Neni 198/a

Heqja nga Regjistri i Përfaqësuesve të Autorizuar

*(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017; ndryshuar
fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)*

1. Përfaqësuesi i autorizuar hiqet nga Regjistri i Përfaqësuesve të Autorizuar në rast se:
 - a) nuk bën pagesën e tarifës së ripërtëritjes së regjistrimit në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 5, të nenit 198, të këtij ligji;
 - b) është depozituar një kërkesë për dorëheqje nga regjistri prej vetë atij;
 - c) me vendim gjyqësor, ai është ndaluar të ushtrojë aktivitetin si përfaqësues i autorizuar;
 - ç) nuk depoziton në kohë dokumentet, nëse ka të tilla, për ripërtëritjen e regjistrimit në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar;
 - d) përfaqësuesi i autorizuar humb shtetësinë shqiptare.
2. Nëse DPPI-ja konstaton se për një përfaqësues të autorizuar ekziston një prej shkaqeve të mësipërme, sipas pikës 1, të këtij neni, vendos heqjen nga regjistri të përfaqësuesit të autorizuar dhe e publikon këtë në faqen zyrtare të DPPI-së.
3. Nëse konstatohet shkelje e etikës profesionale apo e rregullave morale përgjithësisht të njohura nga përfaqësuesi i autorizuar, Komisioni i Vlerësimit mund të marrë vendim për heqjen e certifikatës së tij për një periudhë nga dy deri në pesë vjet.
4. Kundër vendimit të marrë, sipas pikës 3, të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit.

Neni 198/b

Ekspertët e PI-së

*(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017;
ndryshuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)*

1. Ekspert për Patentat e Shpikjeve dhe Modeleve të Përdorimit mund të jetë:
 - 1.1. Çdo individ me kusht që:
 - a) të ketë qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
 - b) të ketë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” në fushën ku kërkohet ekspertizë;
 - c) të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune si përfaqësues i autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit apo të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse në fushën e pronësisë industriale;
 - ç) të ketë kaluar testimin për kualifikimin e ekspertëve të fushës për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit.
 - 1.2. Çdo ish-punonjës i DPPI-së i diplomuar në fushën ku kërkohet ekspertizë, që ka jo më pak se 4 vjet eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale dhe çdo ish-anëtar i Bordit të Apelit pranë DPPI-së, që ka jo më pak se 2 vjet pune në këtë bord.
2. Ekspert për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë mund të jetë:
 - 2.1. Çdo individ me kusht që:
 - a) të ketë qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
 - b) të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune si përfaqësues i autorizuar për markat, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë pranë DPPI-së apo të jetë kualifikuar në trajnime ose kurse të specializuara në fushën e pronësisë industriale;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

c) të ketë kaluar testimin për kualifikimin e ekspertëve në fushën e markave, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë;

ç) të ketë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave”.

2.2. çdo ish-punonjës i DPPI-së që ka jo më pak se 4 vjet eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale, si dhe çdo ish-anëtar i Bordit të Apelit pranë DPPI-së, që ka jo më pak se 2 vjet pune në këtë bord.

3. DPPI-ja është organi i vetëm që certifikon dhe vlerëson ekspertët e PI-së nëpërmjet testimit me shkrim.

4. Ekspertët nuk mund të jenë njëkohësisht edhe përfaqësues të autorizuar.

Neni 198/c

Testimi vlerësues dhe Regjistri i Ekspertëve

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017; ndryshuar fjalë në pikat 4 e 7 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Komisioni i Vlerësimit organizon testimin për vlerësimin e ekspertëve të objekteve të pronësisë industriale. Pjesëmarrja në këtë testim bëhet kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

2. DPPI-ja regjistron në Regjistrin e Ekspertëve ekspertët e patentave për shpikje, modeleve të përdorimit, markave, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë, si dhe i publikon në format elektronik në faqen zyrtare.

3. DPPI-ja i publikon ekspertët e PI-së në format elektronik në faqen zyrtare të saj, vetëm pasi ata kanë dorëzuar në DPPI ekstraktin e regjistrimit për lejimin e ushtrimit të aktivitetit tregtar.

4. Nëse eksperti i PI-së nuk e ushtron aktivitetin tregtar për një periudhë 5-vjeçare, certifikata nuk ripërtërihet dhe eksperti duhet t'i nënshtrohet edhe një herë testimit për marrjen e licencës.

5. Detajet për Regjistrin e Ekspertëve dhe për procedurat e regjistrimit përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekspertët e PI-së.

6. Regjistrimi i ekspertëve në Regjistrin e Ekspertëve, si dhe çdo ndryshim në regjistër apo publikimi në faqen zyrtare bëhet kundrejt pagesës së tarifave përkatëse që përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për tarifën.

7. Regjistrimi në Regjistrin e Ekspertëve ripërtërihet çdo vit para datës së skadimit të saj, kundrejt pagesës së tarifës për ripërtëritje të certifikatës së ekspertëve të parashikuar me vendimin e Këshillit të Ministrave për tarifën.

8. Hollësitë për ripërtëritjen e regjistrimit në Regjistrin e Ekspertëve, si dhe për procedurat e regjistrimit përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekspertët e PI-së.

Neni 198/ç

Heqja e ekspertëve nga regjistri

(shtuar me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017; ndryshuar fjalë në shkrorjen “a” të pikës 1 dhe në pikën 4 me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Ekspertët e PI-së hiqen nga Regjistri i Ekspertëve në rast se:

a) certifikata nuk është ripërtëritëse për 5 vjet radhazi;

b) është depozituar një kërkesë për dorëheqje nga regjistri;

c) ekspertit i ndalohet ushtrimi i këtij aktiviteti me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ç) si rezultat i një vendimi të Komisionit të Vlerësimit, ai është ndaluar të ushtrojë aktivitetin si ekspert për shkaqet e parashikuara në VKM-në për ekspertët dhe përfaqësuesit e autorizuar.

2. Ripërtëritja e regjistrimit për një ekspert nuk pranohet në rastet:

a) kur nuk është bërë pagesa e tarifës së ripërtëritjes së regjistrimit brenda afatit të përcaktuar në pikën 5, të nenit 198/c, të këtij ligji;

b) nëse nuk depoziton në kohë dokumentet që kërkohen për ripërtëritjen e regjistrimit në Regjistrin e Ekspertëve.

3. Kur DPPI-ja konstaton se nuk janë përmbushur kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vendos heqjen e ekspertit nga Regjistri i Ekspertëve dhe e publikon atë në faqen zyrtare të DPPI-së.

4. Nëse konstatohet shkelje e etikës profesionale apo moralit nga eksperti i PI-së, Komisionit i Vlerësimit mund të marrë vendim për heqjen e certifikatës së tij për një periudhë 5-vjeçare.

5. Kundër vendimit të marrë, sipas pikës 4, të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 1 muaji nga data e marrjes njoftimi të vendimit.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KREU XXXV KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 199

Kundërvajtjet administrative (ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 10/2013, datë 14.2.2013)

1. Çdo veprim i kryer në kundërshtim me përcaktimet e neneve 36, 127, 156 e 178 të këtij ligji, për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me dënim kryesor me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë. Gjobat vendosen nga inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut.

2. Gjoba, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të vendoset nëse kanë kaluar tre vjet nga data e kryerjes së shkeljes.

3. Në rast përsëritjeje, dënimi maksimal i parashikuar në pikën 1 të këtij neni dyfishohet. Përsëritje vlerësohet rasti kur shkelësi e kryen shkeljen për herë të dytë brenda një periudhe prej pesë vjetësh.

4. Ngarkohet Policia Tatimore për ekzekutimin e gjobës.

Neni 199/1

Ankimi (shtuar neni me ligjin nr. 10/2013, datë 14.2.2013)

Ndaj vendimit të inspektoratit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

KREU XXXVI DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 200

Kontrolli dhe mbikëqyrja e tregut të brendshëm (ndryshuar me ligjin nr. 10/2013, datë 14.2.2013)

1. Kontrolli për zbatimin e këtij ligji në tregun e brendshëm bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin nga inspektorati që mbulon fushën e mbikëqyrjes së tregut, pranë ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

2. Organizimi dhe funksionimi i këtij inspektorati përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 200/a

Kompetencat e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (shtuar me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (në vijim “ISHMT”) është përgjegjës për të monitoruar e garantuar respektimin e të drejtave të pronësisë industriale kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se një e drejtë e pronësisë industriale është shkelur nga mallrat, të cilat janë vendosur në treg dhe janë në shërbim/përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas çlirimit në qarkullim të lirë nga autoritetet doganore.

ISHMT-ja vepron ex-officio ose mbi bazën e kërkesë-ankesës për inspektim të mbajtësit të së drejtës.

Neni 200/b

Veprime mbi bazën e kërkesë-ankesës për inspektim (shtuar me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. Mbajtësi i së drejtës të pronësisë industriale ose përfaqësuesi i tij paraqesin pranë ISHMT-së një kërkesë-ankesë për inspektim për të filluar procedurat dhe veprimet përkatëse të inspektimit kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se shkelet një e drejtë e pronësisë industriale nga mallra dhe/ose shërbime të tjera identike apo të ngjashme, të cilat janë vendosur në treg dhe janë në shërbim/përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas çlirimit në qarkullim të lirë nga autoritetet doganore.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Kërkesë-ankesa për inspektim paraqitet pranë ISHMT-së në gjuhën shqipe dhe përfshin të paktën informacionin si më poshtë:

a) të dhëna identifikuese për kërkuesin e kërkesë-ankesës për inspektim (emri, adresa dhe të dhënat e kontaktit të kërkuesit);

b) statusi i kërkuesit dhe të dhëna identifikuese për përfaqësuesin e tij, në rast se kërkesë-ankesa për inspektim paraqitet nëpërmjet përfaqësuesit (emri, adresa, të dhënat e kontaktit dhe provat që personi në fjalë ka kompetenca të veprorë në cilësinë e përfaqësuesit, sipas legjislacioni në fuqi);

c) e drejta apo të drejtat e pronësisë industriale që zbatohen, e cila/të cilat duhet të jenë regjistruar pranë DPPI-së;

ç) të dhëna teknike dhe specifike për mallrat origjinale, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në: përshkrimin e mallrave, shenjat, bar-kodet, imazhet, mesatarja e vlerës në tregun kombëtar, karakteristikat dalluese të mallrave dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për identifikimin e mallrave origjinale;

d) informacionin e nevojshëm për t'u mundësuar autoriteteve inspektuese të identifikojnë mallrat origjinale, i tillë si informacioni për vendin e prodhimit të mallrave origjinale;

dh) informacionin e nevojshëm për autoritetet inspektuese për analizën dhe vlerësimin e riskut të shkeljes së të drejtës apo të të drejtave të pronësisë industriale, i tillë si informacioni për shoqëritë e përfshira në tregtimin e mallrave origjinale apo distributorët e autorizuar.

Në mënyrë opsionale, kërkuuesi mund të përfshijë në kërkesë-ankesën e tij për inspektim edhe informacionin e mëposhtëm:

i. të dhëna identifikuese për mbajtësin/tregtarin e mallrave që dyshohet se shkel të drejtat e pronësisë industriale, të tilla si: emri, adresa, emri tregtar, NIPT-i etj.;

ii. të dhëna teknike dhe specifike për mallrat cenuese;

iii. çdo informacion tjetër shtesë të nevojshëm për identifikimin e mallrave cenuese.

3. Kërkesë-ankesa për inspektim duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin vijues:

a) dokumente që provojnë se kërkuuesi është mbajtës i një të drejte në kuptim të këtij ligji, të tilla si ekstrakte të lëshuara nga DPPI-ja për regjistrimin e një të drejte të pronësisë industriale, certifikata të regjistrimit apo të ripërtëritjes së një të drejte të pronësisë industriale, licencë ekskluzive për përdorimin e të drejtës së pronësisë industriale etj.;

b) autorizimin e përfaqësimit të lëshuar nga mbajtësi i së drejtës në rast se kërkesë-ankesa për inspektim paraqitet nëpërmjet përfaqësuesit të tij;

c) në rast se është e mundur, çdo dokument tjetër provues në ndihmë të autoriteteve inspektuese dhe/ose mostra apo riprodhime të ndryshme të mallrave cenuese.

Dokumentacioni sipas kësaj pike paraqitet pranë ISHMT-së në kopje origjinale ose të njësuar me origjinalin. Të gjitha dokumentet në fjalë duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe.

4. Kërkesë-ankesa për inspektim shqyrtohet nga Drejtoria e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale pranë ISHMT-së brenda 10 ditëve punë nga data e dorëzimit të kërkesë-ankesës. Kur pas marrjes së kërkesë-ankesës ISHMT-ja vlerëson se kërkesë-ankesa nuk përmban të gjithë informacionin e kërkuar sipas paragrafit të parë të pikës 2 të nenit 220/b të këtij ligji, i kërkon kërkuuesit që të vërë në dispozicion informacionin që mungon brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit të ISHMT-së.

Kur kërkuuesi nuk vë në dispozicion informacionin e munguar brenda afatit të përcaktuar në pikën 4 të nenit 200/b të këtij ligji, ISHMT-ja refuzon kërkesë-ankesën për inspektim.

5. ISHMT-ja, brenda 20 ditëve punë nga data e dorëzimit të kërkesë-ankesës dhe informacionit të plotë ligjor, ka detyrimin që të kryejë verifikime në treg dhe pranë ambienteve të mbajtësit/tregtarit të mallrave që dyshohet se shkelin të drejtat e pronësisë industriale, në rast se kërkuuesi ka paraqitur të dhëna konkrete mbi të.

Në rast se kërkuuesi nuk ka paraqitur të dhëna konkrete për mbajtësit/tregtarin e mallrave, që dyshohet se shkel/in të drejtat e pronësisë industriale, ISHMT-ja ka të drejtë të vijojë me verifikimet dhe inspektimet në treg bazuar në informacionin e paraqitur në kërkesë-ankesën për inspektim, duke njoftuar kërkuuesin për çdo subjekt të identifikuar e të supozuar si shkelës të të drejtave të pronësisë industriale.

Në çdo rast, ISHMT-ja ka të drejtë të vendosë bllokimin e përkohshëm të mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale dhe heqjen e tyre përkohësisht nga tregu.

6. Bllokimi i mallrave do të kryhet pranë ambienteve të subjektit, duke vendosur nxjerrjen e menjëhershme nga tregu dhe ndalimin e përkohshëm të tregtimit të tyre. ISHMT-ja përpilon e mban procesverbalin/inventarin përkatës për natyrën dhe sasinë e mallit të bllokuar, duke i bashkëlidhur edhe pamjet fotografike që dokumentojnë bllokimin. Inventari dhe pamjet fotografike bëhen pjesë e praktikës përkatëse në sistemin e-inspektimi.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Në rast se mbajtësi/tregtari i mallrave kundërshton bllokimin e mallrave dhe demonstroi apo provoi ligjërisht nëpërmjet dokumenteve përkatëse se mallrat nën posedimin/përdorimin e tij janë origjinale, ISHMT-ja revokon vendimin për bllokimin e përkohshëm të mallrave dhe njofton menjëherë kërkuesin brenda 3 (tri) ditësh nga data e marrjes së vendimit të revokimit.

Kundër vendimit të revokimit mund të paraqitet ankimi sipas legjislacionit në fuqi.

7. ISHMT-ja mund të kërkojë shpjegime dhe dokumente mbështetëse për origjinën e mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale në mënyrë që ky i fundit të provojë dhe të vërtetojë se mallrat janë origjinale. Shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse të kërkuara vendosen në dispozicion të ISHMT-së brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit.

Në rast se mbajtësi/tregtari i mallrave, që dyshohet se shkel një të drejtë të pronësisë industriale, nuk paraqet shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse të kërkuara brenda afatit ligjor të përcaktuar më sipër, ISHMT-ja vijon menjëherë me shqyrtimin e kërkesë-ankesës për inspektim, duke u bazuar vetëm në dokumentet dhe informacionet e paraqitura nga kërkuesi.

8. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesë-ankesës për inspektim dhe kryerjes së verifikimeve përkatëse, ISHMT-ja vendos për:

a) pranimin e kërkesë-ankesës për inspektim dhe bllokimin përfundimtar të mallrave cenuese, duke informuar përkatësisht mbajtësin/tregtarin e mallrave dhe kërkuesin për procedurat e shkatërrimit të këtyre mallrave; ose

b) refuzimin e kërkesë-ankesës për inspektim në rast të mosplotësimit të kushteve formale dhe ligjore të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

9. Çdo vendim i marrë nga ISHMT-ja, në vijim të kërkesë-ankesës për inspektim, i njoftohet kërkuesit dhe mbajtësit/tregtar të mallrave.

Mbajtësi/tregtari i mallrave cenuese nënshkruan një deklaratë me anë të së cilës ai pranon shkatërrimin e mallrave në përdorim/posedim brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit të ISHMT-së.

Kur mbajtësi/tregtari i mallrave cenuese nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe as nuk ka kundërshtuar vendimin e shkatërrimit të këtyre mallrave brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit, ISHMT-ja prezumon se mbajtësi/tregtari i mallrave ka dhënë pëlqimin për shkatërrimin e mallrave.

10. Shkatërrimi i mallrave organizohet nën mbikëqyrjen e ISHMT-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit të shkatërrimit.

Kostot e lidhura me shkatërrimin e mallrave cenuese janë në ngarkim të kërkuesit.

Ky nen nuk cenon të drejtën e kërkuesit për të kërkuar kompensim nga shkelësi apo personat e tjerë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. Nëse mbajtësi/tregtari i mallrave refuzon dhe kundërshton shkatërrimin e mallrave të bllokuara brenda afatit të përcaktuar në pikën 9 të këtij neni, ISHMT-ja njofton menjëherë kërkuesin. Kërkuesi brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit të ISHMT-së duhet të fillojë procedimin gjyqësor për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale pranë gjykatës kompetente.

Kërkuesi brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit të ISHMT-së duhet të njoftojë, gjithashtu, ISHMT-në për ngritjen e padisë në gjykatë duke paraqitur një kopje të kërkesë-padisë përkatëse.

12. Në rast se kërkuesi depoziton kërkesë-padinë për shkelje të të drejtave në gjykatën kompetente dhe paraqet njëkohësisht kopjen e kërkesë-padisë në fjalë pranë ISHMT-së brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin/kundërshtimin e shkatërrimit të mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave, ISHMT-ja i mban mallrat të bllokuara deri në momentin e marrjes së një vendimi të formës së prerë nga gjykata për këto mallra.

13. Në rast se kërkuesi nuk depoziton kërkesë-padinë për shkelje të të drejtave në gjykatën kompetente ose nuk paraqet njëkohësisht kopjen e kërkesë-padisë në fjalë pranë ISHMT-së brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin/kundërshtimin e shkatërrimit të mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave, ISHMT-ja bën shënimin përkatës në procesverbalin/inventarin e mbajtur për këtë qëllim dhe revokon automatikisht vendimin për bllokimin e përkohshëm të mallrave në fjalë.

14. Kur një procedurë gjyqësore e filluar sipas këtij neni ndërpritet/pushohet për shkak të një veprimi apo mosveprimi të kërkuesit apo kur vërtetohet se mallrat në fjalë nuk shkelin një të drejtë të pronësisë industriale, kërkuesi është përgjegjës kundrejt çdo mbajtësi/tregtari të mallrave, i cili ka pësuar dëm nga kjo situatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 200/c

Veprime ex-officio

(shtuar me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

1. ISHMT-ja, në përputhje me analizën dhe planet e vlerësimit të riskut të kryera sipas metodologjisë përkatëse, mund të ndërmarrë veprime ex-officio në tregun e brendshëm.

2. Në rastet kur ISHMT-ja identifikon mallra që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale, i kërkon fillimisht mbajtësit/tregtarit të mallrave shpjegime dhe dokumente shtesë për origjinën e mallrave për të provuar e vërtetuar se mallrat në fjalë janë origjinale.

Mbajtësi/tregtari i mallrave duhet të paraqesë shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse brenda 5 (pesë) ditëve punë pranë ISHMT-së ose në rast të kundërt ISHMT-ja ka të drejtë të vendosë bllokimin e përkohshëm të mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale.

Të gjitha veprimet e ndërmarra nga ISHMT-ja dokumentohen nëpërmjet mbajtjes së një procesverbal/inventari, i cili nënshkruhet nga inspektorët përgjegjës dhe regjistrohet në regjistrin përkatës të institucionit.

3. Në çdo rast të identifikimit të mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale sipas pikës 2 të këtij neni, ISHMT-ja kërkon informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) për ekzistencën e të drejtave të tilla të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë, mbajtësit e regjistruar të të drejtave dhe përfaqësuesit të tyre në vendin tonë.

4. ISHMT-ja mund të kërkojë gjithashtu informacione shtesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) lidhur me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në doganë dhe ekzistencën e kërkesave për veprim pranë autoriteteve doganore.

5. Bazuar në kërkesën e ISHMT-së, DPPI-ja dhe DPD-ja sigurojnë, brenda afateve ligjore përkatëse të gjithë informacionin e nevojshëm nën administrimin e tyre për ekzistencën e të drejtave të pronësisë industriale, mbajtësve të regjistruar të të drejtave të tilla apo përfaqësuesve të tyre në Republikën e Shqipërisë, si dhe çdo të dhënë tjetër lidhur me mallrat origjinale apo mallrat që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë intelektuale.

6. Në vijim, ISHMT-ja, bazuar në informacionin e mbledhur sipas pikave 3 deri në 5 të këtij neni, njofton mbajtësin e së drejtës ose përfaqësuesin e autorizuar të tij për bllokimin e mallrave që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë industriale brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e marrjes së informacionit përkatës.

Njoftimi i ISHMT-së për bllokimin e mallrave, që dyshohet se shkelin një të drejtë të pronësisë, përfshin, duke mos u kufizuar në: natyrën dhe sasinë reale ose të vlerësuar të mallrave, pamje fotografike, mostra apo riprodhime të mallrave etj.

7. Mbajtësi i një të drejte të pronësisë industriale ose përfaqësuesi i tij duhet të konfirmojë me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të ISHMT-së se mallrat e identifikuar shkelin të drejtat e tij dhe se ai merr përsipër kostot përkatëse për shkatërrimin e mallrave nën mbikëqyrjen e ISHMT-së.

8. Në rast se ISHMT-ja nuk identifikon asnjë person me të drejta të pronësisë industriale për mallrat e bllokuara brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e vendimit të bllokimit të mallrave, vendimi i bllokimit revokohet automatikisht dhe bëhet shënimi përkatës në procesverbal.

9. Në përfundim të procedurave verifikuese përkatëse dhe të veprimeve të përcaktuara më sipër, ISHMT-ja vendos, për:

a) revokimin e vendimit për bllokimin e përkohshëm të mallrave, në rast se mbajtësi i të drejtave të pronësisë industriale nuk ka vepruar sipas pikës 7 të këtij neni, ose nuk është identifikuar asnjë person, mbajtës i të drejtave, sipas pikës 8 të këtij neni;

b) vijimin e procedurave për bllokimin përfundimtar dhe shkatërrimin e mallrave cenuese në rast se merr konfirmimin me shkrim nga mbajtësi i së drejtës, sipas pikës 7 të këtij neni, dhe mbajtësi/tregtari i mallrave nuk kundërshton vendimin e shkatërrimit.

10. Vendimi i marrë nga ISHMT-ja i njoftohet mbajtësit të identifikuar të të drejtave dhe mbajtësit/tregtarit të mallrave.

Mbajtësi/tregtari i mallrave cenuese nënshkruan një deklaratë me anë të së cilës ai pranon shkatërrimin e mallrave në përdorim/posedim brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit të ISHMT-së.

Kur mbajtësi/tregtari i mallrave cenuese nuk ka dhënë me shkrim pëlqimin e tij për shkatërrimin e mallrave dhe as nuk ka kundërshtuar vendimin e shkatërrimit të këtyre mallrave brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data e njoftimit të vendimit, ISHMT-ja mund të vlerësojë se mbajtësi/tregtari i mallrave ka dhënë pëlqimin për shkatërrimin e mallrave.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

11. Shkatërrimi i mallrave organizohet nën mbikëqyrjen e ISHMT-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit të shkatërrimit.

Kostot e lidhura me shkatërrimin e mallrave cenuese janë në ngarkim të mbajtësit të të drejtave.

Ky nen nuk cenon të drejtën e mbajtësit të të drejtave për të kërkuar kompensim nga shkelësi apo personat e tjerë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

12. Nëse mbajtësi/tregtari i mallrave refuzon dhe kundërshton shkatërrimin e mallrave të bllokuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 10 të këtij neni, ISHMT-ja njofton menjëherë mbajtësin e së drejtës. Mbajtësi i së drejtës brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit të ISHMT-së duhet të fillojë procedimin gjyqësor për shkelje të të drejtave të pronësisë industriale pranë gjykatës kompetente.

Mbajtësi i së drejtës brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit të ISHMT-së duhet të njoftojë gjithashtu ISHMT-në për ngritjen e padisë në gjykatë, duke paraqitur një kopje të kërkesë-padisë përkatëse.

13. Në rast se mbajtësi i së drejtës depoziton kërkesë-padinë për shkelje të të drejtave në gjykatën kompetente dhe paraqet njëkohësisht kopjen e kërkesë-padisë në fjalë pranë ISHMT-së brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin/kundërshtimin e shkatërrimit të mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave, ISHMT-ja i mban mallrat të bllokuara deri në momentin e marrjes së një vendimi të formës së prerë nga gjykata për këto mallra.

14. Në rast se mbajtësi i të drejtës nuk depoziton kërkesë-padinë për shkelje të të drejtave në gjykatën kompetente ose nuk paraqet njëkohësisht kopjen e kërkesë-padisë në fjalë pranë ISHMT-së brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin/kundërshtimin e shkatërrimit të mallrave nga mbajtësi/tregtari i mallrave, ISHMT-ja bën shënimin përkatës në procesverbalin/inventarin e mbajtur për këtë qëllim dhe revokon automatikisht vendimin për bllokimin e përkohshëm të mallrave në fjalë.

15. Kur një procedurë gjyqësore e filluar sipas këtij neni ndërpritet/pushohet për shkak të një veprimi apo mosveprimi të mbajtësit të të drejtës, apo kur vërtetohet se mallrat në fjalë nuk shkelin një të drejtë të pronësisë industriale, mbajtësi i të drejtës është përgjegjës kundrejt çdo mbajtësi/tregtari të mallrave, i cili ka pësuar dëm nga kjo situatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 200/ç

Masa të tjera

(shtuar me ligjin nr. 96/2021, datë 7.7.2021)

Procedurat dhe masat e ndërmarra nga ISHMT-ja sipas këtij ligji, nuk cenojnë të drejtën e këtij institucioni që ndaj veprimeve, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative sipas ligjeve të tjera të posaçme, të vendosë masat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 201

Procedurat në proces

1. Për procedurat e regjistrimit të të drejtave të pronësisë industriale, që nuk kanë përfunduar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi në çastin e aplikimit.

2. Për procedurat e shkeljeve të të drejtave të pronësisë industriale, që nuk kanë përfunduar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi në çastin e fillimit të procedurave.

Neni 202

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, 17, 18, 20, 24, 26, 29, 30, 31, 34, 35, 49, 50, 70, 75, 97, 99, 119, 122, 123, 124, 125, 126, 128, 129, 130, 131, 145, 150, 151, 152, 153, 154, 155, 161, 162, 163, 164, 166, 175, 182 dhe 195 të tij.

Neni 203

Shfuqizimi

Ligji nr.7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Dispozitë kalimtare

(e shtuar me ligjin nr. 10/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Dispozita kalimtare

(të përcaktuara me ligjin nr. 17/2017, datë 16.2.2017)

1. Për procedurat e regjistrimit të të drejtave të pronësisë industriale, që nuk kanë përfunduar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi në çastin e aplikimit.

2. Për procedurat e shkeljeve të të drejtave të pronësisë industriale, që nuk kanë përfunduar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi në çastin e fillimit të procedurave.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Drejtori i Përgjithshëm dhe punonjësit e DPPI-së vijojnë të ruajnë pozicionet e tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

4. Shndërrimi i DPPI-së në agjenci autonome me vetëfinancim i fillon efektet financiare brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 204

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi tre muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5825, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

VENDIM

Nr. 1707, datë 29.12. 2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR LËSHIMIN E PATENTAVE PËR SHPIKJET DHE MODELET E PËRDORIMIT”¹²

(ndryshuar me VKM nr.618, datë 7.9.2011; nr.38, datë 21.1.2015; nr.460, datë 26.7.2018)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenve 11, 17, 18, 20, 24, 26, 29-31, 34, 35, 49, 50, 70, 75, 97, 99 e 202 të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar me ligjin nr. 55/2014 me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

3. Urdhri nr.4, datë 8.12.1994 i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë “Rregulla për patentat, modelet e përdorimit dhe disenjot industriale”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

¹ Formularët bashkëlidhur vendimit gjenden në linkun: <https://qbz.gov.al/preview/099c670d-6dbf-43c0-bbce-9a4c9374f0e2/cons/20180726>

² Qendra e Botimeve Zyrtare. Fletore Zyrtare nr. 213. Tiranë, 2008. f. 11471

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

RREGULLORE PËR LËSHIMIN E PATENTAVE PËR SHPIKJET DHE MODELET E PËRDORIMIT

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi

1.1 Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave lidhur me:

- a) lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit;
- b) ripërtëritjen e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit;
- c) lëshimin e certifikatave të mbrojtjes shtesë për produktet farmaceutike dhe produktet për mbrojtjen e bimëve;

ç) ndryshimet e tjera në regjistrin e patentave.

2. Përkufizime

2.1. Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "TBP" është Traktati i Bashkëpunimit për Patentat, i miratuar në Uashington më 19.6.1970, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

b) "Konventa Europiane e Patentave" (KEP) është konventa mbi dhënien e patentave europiane e miratuar në 5 tetor 1973 megjithë ndryshimet e mëvonshme.

c) "Konventa e Parisit" është konventa "Për mbrojtjen e pronësisë industriale", e miratuar në Paris më 20 mars 1883, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

ç) "Ekspozitë ndërkombëtare zyrtare apo e njohur zyrtarisht" është ekspozita apo panairi në kuptimin e përdorur në konventën "Për ekspozitat ndërkombëtare", të miratuar në Paris më 22 nëntor 1928, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

d) "Aplikim për patentë europiane" është aplikimi për një patentë të depozituar në përputhje me Konventën Europiane për Patentat (KEP), si dhe aplikimi ndërkombëtar i depozituar sipas Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat (TBP), për të cilin Zyra Europiane e Patentave (ZEP) vepron si zyrë e caktuar ose e zgjedhur, aplikime në të cilat është caktuar Shqipëria;

dh) "Patentë e shtrirë europiane" është patenta europiane e dhënë nga ZEP në bazë të aplikimit për patentë europiane, për të cilën është kërkuar shtrirja në Shqipëri;

e) "Aplikim për patentë kombëtare" është aplikimi për patentë që depozitohet pranë DPPI në përputhje me ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar;

ë) "Patentë kombëtare" është patenta e dhënë në bazë të aplikimit për patentë kombëtare;

f) "Aplikim ndërkombëtar" është aplikimi për patentë i depozituar sipas TBP duke përfshirë edhe rregulloret e dala në bazë të tij;

g) "Ligji" është ligji nr. 9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar.

gj) "Patentë e vlefshme europiane" është patenta europiane e dhënë nga ZEP-i në bazë të aplikimit për patentë europiane, i depozituar pas datës 1 maj 2010, për të cilën është kërkuar vlefshmëria në Shqipëri.

3. Parime të përgjithshme

3.1 DPPI shqyrton aplikimet e depozituara dhe lëshon njoftimet dhe aktet e tjera në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar dhe të kësaj rregulloreje.

3.2 Veprimet e DPPI lidhur me këto aplikime bazohen ekskluzivisht në dokumente të shkruara. Kërkesat dhe çdo lloj dokumentacioni tjetër që depozitohet pranë DPPI duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe të shtypura.

3.3 DPPI krijon dhe administron bazën elektronike të të dhënave ku ruhen të gjitha veprimet e kryera në lidhje me patentat.

3.4 DPPI-ja regjistron, në regjistrin e patentave, përfaqësuesin e autorizuar, i cili është caktuar si përfaqësues nga aplikanti ose pronari i patentës me anë të një autorizimi të përgjithshëm, që i jep përfaqësuesit të drejtën të përfaqësojë aplikantin ose pronarin e patentës në të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar dhe nga kjo rregullore, që përfshijnë procedurat për lëshimin e patentës dhe ndryshimet e mëvonshme në regjistrin e patentave.

3.5 Aplikimet e paraqitura pranë DPPI-së nga një përfaqësues i autorizuar, i regjistruar si përfaqësues në regjistrin e patentave për një patentë të caktuar, nuk është e nevojshme të përmbajnë autorizim përfaqësimi. Kur aplikanti ose pronari i një patente e ka revokuar autorizimin e përfaqësimit të regjistruar pranë DPPI-së, ai duhet të depozitojë pranë DPPI-së autorizimin për përfaqësuesin e ri, i cili regjistrohet në regjistrin e patentave sipas parashikimeve të pikës 3.4 të këtij kreu.

4. Shfuqizuar.

5. Modelet e përdorimit

5.1 Parashikimet e kësaj rregulloreje lidhur me paraqitjen e kërkesës dhe procedurat e ekzaminimit të aplikimeve për patentat e shpikjeve zbatohen njëloj edhe për aplikimet për modelet e përdorimit.

5.2 Kërkesa për kthimin e një aplikimi për patentë në aplikim për model përdorimi, parashikuar nga neni 91 i ligjit, duhet të depozitohet pranë DPPI nga aplikanti nëpërmjet formularit *përkatës të aplikimit*, përpara lëshimit të patentës. Kërkesa duhet të nënshkruhet nga aplikanti dhe të shoqërohet me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse. DPPI e shqyrton kërkesën brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së saj dhe njofton me shkrim aplikantin për vendimin e marrë. Në rast se kërkesa refuzohet, njoftimi duhet të përmbajë edhe shkaqet e refuzimit.

KREU II

PARAQITJA E APLIKIMIT PËR PATENTË KOMBËTARE

1. Paraqitja e aplikimit

1.1 *Aplikimi për lëshimin e një patente bëhet nëpërmjet formularit përkatës të aplikimit, i cili nënshkruhet nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij dhe depozitohet pranë DPPI-së. Aplikimi për patentë mund t'i dërgohet DPPI-së nga paraqitësi i kërkesës ose përfaqësuesi i tij edhe me postë, me faks ose on-line nëse DPPI-ja e ofron. Në rastin e dërgimit me faks, aplikanti duhet që, brenda një muaji nga data e dërgimit të faksit, të depozitojë pranë DPPI-së kërkesën në formën e saj origjinale, në të kundërt kërkesa konsiderohet si e paparaqitur.*

1.2 Dosja e aplikimit shoqërohet me listën e dokumenteve të depozituara (indeksi i dosjes), e cila nënshkruhet nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij.

1.3 Kërkesa për patentë bëhet për një shpikje të vetme ose për një grup shpikjesh, të lidhura në një mënyrë të tillë sa që formojnë së bashku një koncept shpikës të vetëm e të përgjithshëm.

1.4 DPPI-ja, *ditën që merr në dorëzim formularin përkatës të aplikimit për patentë, shënon mbi formular datën, orën e paraqitjes dhe numrin e kërkesës.*

2. Elementet që duhet të përmbajë aplikimi për patentë

2.1 Në përputhje me nenin 17 të ligjit, një aplikim për patentë duhet të përmbajë:

a) *kërkesën për dhënien e patentës* të nënshkruar nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij i cili në momentin e depozitimit duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë të dhënat mbi: emrin dhe adresën e aplikantit, të shpikësve dhe përfaqësuesit të autorizuar; titullin e shpikjes dhe deklaratën për prioritet nëse pretendohet për prioritet;

b) një përshkrim të shpikjes;

c) një ose më shumë pretendime;

ç) vizatimet, referuar në përshkrimin ose në pretendimet;

d) një abstrakt (përmbledhja e shpikjes);

dh) dokumenti i prioritetit nëse pretendohet për prioritet;

e) autorizimin e përfaqësimit kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit. Autorizimi i përfaqësimit duhet të përmbajë nënshkrimin e aplikantit të vërtetuar nga noteri kur aplikanti është person fizik dhe kur aplikanti është person juridik, nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor edhe vulën e tij;

ë) deklaratën e shpikësit ose shpikësve në të cilën të shprehet vullneti për lëshimin e patentës në emrin e aplikantit. Deklarata e shpikësit duhet të bëhet me akt noterial;

f) dokumentin e pagesës së tarifës së depozitimit.

2.2 Në rast se shpikja është bërë publike në përputhje me nenin 11 pika 1 germa “c” e ligjit, aplikanti duhet të depozitojë pranë DPPI certifikatën përkatëse të lëshuar nga autoritetet kompetente të ekspozitës ndërkombëtare, brenda 3 muajve nga data e depozitimit të aplikimit për patentë.

3. Kërkesa specifike për aplikimet për patentë në lidhje me mikroorganizmat

3.1 Nëse shpikja përfshin përdorimin e një materiali biologjik ose kur ka të bëjë me një material të tillë, që nuk gjendet në publik dhe që nuk mund të përshkruhet në aplikim, për t'u bërë i mundshëm për një person të kualifikuar të fushës, duhet që:

a) një kulturë e mikroorganizmit të depozitohet pranë një institucioni depozitues të caktuar për këtë qëllim nga legjislacioni përkatës në fuqi;

b) aplikanti duhet të deklarojë në kërkesë institucionin depozitues dhe numrin e depozitimit të kulturës së depozituar si dhe një informacion mbi karakteristikat e materialit biologjik, sa ç'është në dispozicion të paraqitësit të kërkesës;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

c) aplikanti duhet të depozitojë, së bashku me aplikimin, dëshminë e depozitimit të marrë nga institucioni depozitues.

4. Kërkesa të tjera lidhur me aplikimin

4.1 Aplikanti duhet të dërgojë në mënyrë elektronike të gjithë materialin e kërkesës për patentë në adresën e vënë në dispozicion për këtë qëllim nga DPPI brenda një periudhe 2 javore nga data e paraqitjes së kërkesës, në të kundërt DPPI nuk lëshon dëshminë e depozitimit, por pa cenuar datën e depozitimit.

5. Kryerja e ndryshimeve ose heqja dorë nga aplikimi para lëshimit të patentës

5.1 Aplikanti, nëpërmjet një kërkesë me shkrim, e cila duhet të depozitohet pranë DPPI përpara datës së lëshimit të patentës, mund të kërkojë kryerjen e ndryshimeve dhe korrigjimin e gabimeve formale në një aplikim për patentë, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

5.2 Aplikanti ka të drejtë të heqë dorë nga aplikimi për patentë në çdo kohë përpara lëshimit të patentës, me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar DPPI.

6. Përmbajtja e kërkesës për hartimin e raportit të kërimit

6.1 Pas marrjes së numrit të aplikimit dhe datës së depozitimit, aplikanti ose përfaqësuesi i tij mund të depozitojë në DPPI kërkesën për hartimin e një raporti kërkitimi nga një zyrë kombëtare ose ndërkombëtare, e cila gëzon statusin e Autoritetit Ndërkombëtar për Ekzaminim Paraprak, sipas nenit 32, të Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat, ose nga zyra, me të cilat DPPI-ja ka marrëveshje bashkëpunimi, në mënyrë që të përcaktojë nëse shpikja e paraqitur në aplikimin për patentë plotëson kriteret për patentueshmëri, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar.

6.2 Kërkesa për hartimin e raportit të kërimit mund të depozitohet në çdo kohë, nëpërmjet formularit të përcaktuar nga zyra dhe të publikuar në faqen e saj zyrtare, në dy kopje identike dhe shoqërohet me pagesën përkatëse për betim, të përcaktuar nga zyra e zgjedhur prej aplikantit, e cila do të kryejë hetimin, si dhe koston e transferimit të pagesës së raportit të kërimit.

6.3 DPPI-ja, sipas rastit, mund t'i kërkojë aplikantit të depozitojë përkthimin në gjuhë tjetër të pretendimeve apo dhe të të gjithë përshterimit të patentës për ta përcjellë atë në zyrën që do të hartojë raportin e kërimit.

6.4 Kërkesa për hartimin e një raporti kërkitimi duhet të përmbajë:

a) Të dhënat e aplikantit (emri i personit juridik, kodi, adresa, kodi shtetëror, emri, mbiemri i personit fizik, adresa, kodi shtetëror, adresa e postës elektronike);

b) Të dhënat e përfaqësuesit, në rast se kërkesa për kryerjen e një raporti kërkitimi paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar (emri i përfaqësuesit të autorizuar, kodi, adresa, kodi shtetëror, adresa e postës elektronike);

c) Statusin e aplikantit;

d) Të dhënat e aplikimit të mëparshëm, nëse është pretenduar për prioritet;

e) Nënshkrimin e aplikantit ose të përfaqësuesit të tij;

f) Autorizimin e përfaqësimit, në rast se aplikimi depozitohet nga një përfaqësues i autorizuar.

6.5. Aplikuesi ose përfaqësuesi i tij është përgjegjës për korrigjimin e kërkesës së paraqitur, sipas pikave 6.1 deri në 6.4, të këtij neni, dhe i nënshtrohet të gjitha pasojave që lidhen me informacionin e pasaktë të dorëzuar.

7. Shqyrtimi nga DPPI-ja i kërkesës për hartimin e raportit të kërimit

7.1 Pas përfundimit të ekzaminimit për formalitetin aplikimit, për të cilin është kërkuar hartimi i raportit të kërimit, dhe pas aprovimit nga sektori i patentave se aplikimi përmbush kërkesat formale të ekzaminimit, DPPI-ja e përcjell kërkesën për hartimin e raportit të kërimit në zyrën e zgjedhur nga aplikanti dhe e informon atë ose përfaqësuesin e tij për këtë fakt.

7.2 Nëse, pas ekzaminimit për formalitetin e aplikimit, për të cilin është kërkuar hartimi i raportit të kërimit, është marrë vendim nga zyra për refuzimin e aplikimit, DPPI-ja do ta konsiderojë të dorëhequr kërkesën e depozituar për hartimin e raportit të kërimit, do të njoftojë me shkrim aplikantin dhe do t'i kthejë atij pagesat e depozituara për hartimin dhe transferimin e pagesës së raportit të kërimit.

7.3 Aplikanti për patentë, për të cilën është depozituar një kërkesë për hartimin e raportit të kërimit, ose përfaqësuesi i tij, pas marrjes së njoftimit nga DPPI-ja se aplikimi i plotëson kushtet formale për ekzaminim, sipas pikës 7.1, duhet të depozitojë në gjuhën angleze të gjithë aplikimin për patentë (pretendimet, abstraktin, përshterimin e shpikjes, të dhënat e aplikimit për patentë si dhe vizatimet).

7.4 Aplikanti është përgjegjës për pasojat që rrjedhin nga përkthimi i pasaktë i dokumenteve të aplikimit.

KREU III

KRITERET PËR ELEMENTET E KËRKESËS PËR PATENTË PËRSHKRIMI, PRETENDIMET, ABSTRAKTI DHE VIZATIMET

1. Përshkrimi i shpikjes

1.1 Përshkrimi i shpikjes duhet të përmbajë:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- a) titullin e shpikjes siç paraqitet në kërkesë. Titulli i shpikjes duhet të jetë i shkurtër dhe sa më përfaqësues;
- b) fushën e teknikës me të cilën lidhet shpikja;
- c) pjesët e arritjeve të mëparshme, të cilat për aq sa njihen nga paraqitësi i kërkesës, mund të jenë të dobishme për të kuptuar e shqyrtuar shpikjen dhe mundësisht të citohen dokumentet që e pasqyrojnë atë;
- ç) shpjegimin e shpikjes në mënyrë që ajo të jetë e kuptueshme për specialistët e fushës dhe të paraqesë efektet e avantazheve të saj, në qoftë se ka, duke iu referuar arritjeve të mëparshme;
- d) përshkrimin e elementeve treguese të vizatimeve, në qoftë se ka;
- dh) një përshkrim të mënyrës më të mirë të menduar nga paraqitësi i kërkesës për të vënë në zbatim shpikjen. Kjo duhet të bëhet me anë të shembujve si dhe, kur është e përshtatshme, duke iu referuar vizatimeve, në qoftë se ka;
- e) të tregojë në mënyrë të përcaktuar, kur nuk rezulton nga përshkrimi ose natyra e shpikjes, mënyrën me të cilën shpikja është e zbatueshme në industri dhe mënyrën me anë të së cilës ajo mund të prodhohet ose përdoret ose, në qoftë se ajo vetë mund të përdoret, mënyrën me të cilën mund të përdoret.

1.2 Mënyra dhe renditja e specifikuar në pikën 1.1 ndiqet gjithmonë, përveç rasteve kur për shkak të natyrës së shpikjes, një mënyrë ose një renditje e ndryshme do të rezultonte më e kuptueshme.

2. Forma dhe përmbajtja e pretendimeve për shpikjen

2.1 Numri i pretendimeve duhet të jetë i arsyeshëm duke marrë parasysh natyrën e shpikjes dhe pretendimet duhet të renditen me numra. Pretendimet duhet të referojnë në pjesën përkatëse të përshkrimit ose vizatimeve dhe duhet të përmbajnë:

- a) një pohim që tregon ato tipare teknike të shpikjes të cilat janë të domosdoshme për të përcaktuar pjesët e arritjes së mëvonshme, por që, duke u kombinuar janë pjesë e arritjeve të mëparshme;
- b) një pjesë karakterizuese që fillon me fjalët “karakterizohet nga”, “karakterizohet në”, “në çfarë konsiston shpikja” ose në fjalë të tjera që japin të njëjtin efekt dhe që pohojnë në mënyrë konçize tiparet teknike, të cilat duke u kombinuar me tiparet e përcaktuara në gjermën ”a” të kësaj pike, dëshirohen të mbrohen si shpikje.

2.2 Pretendim i varur konsiderohet se është një pretendim, i cili përmban të gjitha tiparet e një ose disa pretendimeve të tjera që pohojnë tiparet shtesë të pretenduara, në qoftë se kjo është e mundur që në fillim. Pretendimi i varur i cili i referohet më shumë se një pretendimi (pretendim i shumëvarur), do t’i referohet pretendimeve të tilla vetëm si një alternativë e mundshme. Pretendimet e shumëvarura nuk shërbejnë si bazë për ndonjë pretendim tjetër të shumëvarur.

2.3 Një pretendim i varur konsiderohet se përmban të gjitha kufizimet që përmban pretendimi të cilit ai i referohet. Kur pretendimi është i shumëvarur, ai konsiderohet se përmban të gjitha kufizimet që përmbahen në pretendimin e veçantë në lidhje me të cilin ai është marrë në konsideratë. Gjithë pretendimet e varura që i referohen një ose disa pretendimeve të mëparshme, grupohen në mënyrën më praktike të mundshme.

3. Vizatimet ose paraqitja grafike

3.1 Kërkesa për patentë duhet të përmbajë të gjitha ato vizatime ose paraqitje grafike të cilat janë të domosdoshme për të kuptuar shpikjen, për ta parashtruar atë në mënyrë të plotë, për të qartësuar formulime të dykuptimta ose të paqarta të dhëna me përshkrim, si dhe për të përfytyruar objektin e përshkruar.

3.2 Ndërmjet përshkrimit të shpikjes dhe vizatimeve ka një lidhje të drejtpërdrejtë, që realizohet nëpërmjet shenjave të referimit, të cilat mund të jenë numra ose germa. Shenjat e referimit vendosen në të dyja dokumentet, në përshkrim edhe në vizatime dhe duhet të korrespondojnë saktësisht.

3.3 Në pretendimet dhe përmbledhjen (abstraktin) e shpikjes, shenjat e referimit vendosen në kllapa për të treguar që teksti është i kuptueshëm edhe pa to, dhe që shembujt e përshkruar në vizatime nuk kufizojnë objektin e pretendimit përkatës. Në përshkrim, shenjat e referimit nuk vendosen në kllapa.

3.4 Vizatimet e kërkesës për patentë nuk janë vizatime prodhimi; ato nuk përmbajnë të gjitha detajet dhe hollësitat e domosdoshme për realizimin konkret të një produkti ose procesi dhe nuk ndërtohen në përmasa të sakta vizatimore, por janë vizatime skematike, të cilat mundësojnë nxjerrjen në pah të tipareve dalluese të shpikjes.

3.5 Vizatimet e kërkesës për patentë duhet të jenë të tilla, që të bëhet i mundur riprodhimi i drejtpërdrejtë i tyre me anën e fotokopjimit, printimit ose proceseve të ngjashme me to, për t’u përdorur lehtësisht për publikimin e patentës.

3.6 Vizatimet dhe formulat kimike në rastin kur ka të tilla, përpilohen në përputhje të plotë me standartet e gjuhës teknike dhe të simboleve kimike.

3.7 Sipërfaqja e hapësirës së përdorshme të fletës që përmbajnë vizatimet nuk duhet të tejkalojë madhësinë 26,2 cm x 17cm. Këto fletë nuk duhet të përmbajnë korniza përqark sipërfaqes së përdorshme ose të përdorur.

Përmasat minimale të lejuara të anëve duhet të jene si më poshtë:

- a) pjesa e sipërme 2,5 cm;
- b) ana e majtë 2,5 cm;
- c) ana e djathtë 1,5 cm;
- ç) pjesa e poshtme 1 cm.

3.8 Vizatimet duhet të kryhen si më poshtë:

a) me vija të qëndrueshme, të zeza, mjaftueshmërisht të trasha dhe të errëta pa ngjyrosje;

b) pamjet e seksioneve dhe të prerjeve duhet të paraqiten me anë të vijave paralele të seksionimit, të cilat nuk duhet të pengojnë leximin e qartë të shenjave të referimit dhe të vijave në lidhje me to;

c) shkalla e vizatimeve dhe dallueshmëria e kryerjes grafike të tyre duhet të jetë e tillë që një riprodhim fotografik me një reduktim linear në masën dy të tretat të bënte të mundur që të gjitha hollësitat të dallohen pa vështirësi. Në qoftë se, si një rast përjashtimor, shkalla është e dhënë në një vizatim, ajo duhet të paraqitet grafikisht;

ç) të gjitha numrat, gerrat dhe shenjat e referimit që shfaqen në vizatimet duhet të jenë të thjeshta dhe të qarta. Kllapat, rrathët ose thonjëzat nuk përdoren për të shoqëruar numrat dhe gerrat;

d) të gjitha vijat në vizatimet, si rregull, vizatohen me ndihmën e instrumenteve projektues;

dh) elementet e së njëjtës figurë duhet të jenë në proporcion me njëri-tjetrin, përveç rasteve kur një ndryshim në proporcion është i domosdoshëm për qartësinë e figurës;

e) lartësia e numrave dhe germave nuk duhet të jetë më e vogël se 0.32 cm. Për shënimin e germave dhe vizatimeve, përdoret alfabeti latin dhe kur është e zakonshme, alfabeti grek.

ë) e njëjta fletë e vizatimeve mund të përmbajë disa figura. Kur figurat e vizatuara në dy ose më shumë fletë janë paracaktuar të formojnë një figurë të tërë, që e tërë figura të mund të paraqitet e bashkuar, pa mbetur zbuluar ndonjë prej pesë figurave të pjesëshme, figurat e ndryshme duhet të sistemohen pa hapësira boshe; preferohet vendosja në pozicion perpendikular, të ndara qartësisht nga njëra tjetra. Kur figurat nuk vendosen në pozicion perpendikular, ato paraqiten të pozicionuara tërthor ndaj fletës, me pjesën e përparme të figurave në të majtë të fletës. Figurat e ndryshme numërohen në mënyrë të njëpasnjëshme (të vijueshme) me numra arabe, në mënyrë të pavarur prej numërimit të fletëve;

f) shenjat e referimit që nuk përmenden në përshkrimin dhe pretendimet nuk duhen paraqitur në vizatimet dhe anasjelltas. Tiparet e njëjta, që tregohen me anën e shenjave të referimit, duhet të shënohen, kudo në kërkesën për patentë, me të njëjtat shenja;

g) vizatimet nuk duhet të përmbajnë çështje tekstore, siç mund të jetë ndonjë përshkrim i mundshëm i figurave, me përjashtim të rasteve kur është absolutisht e domosdoshme vendosja e një fjale të vetme ose e disa fjallve, si “ujë”, “avull”, “i hapur”, “i mbyllur”, “seksioni mbi AB” etj. dhe në rastin e qarqeve elektrike dhe blloqeve skematike ose diagramave të kartave të proceseve teknologjike, mund të përdoren pak fjalë çelës të shkurtra të domosdoshme për të kuptuarit e figurave. Çdo fjalë e tillë duhet të vendoset në mënyrë të tillë që, në qoftë se kërkohet, ato mund të zhvendosen me anën e përkthimeve të tyre pa u interferuar me ndonjë nga vijat e vizatimeve;

gj) konsiderohen vizatime kartat e proceseve teknologjike, bllokskemat dhe diagramat.

4. Përmbajtja dhe forma e përmbledhjes së shpikjes

4.1 Përmbledhja e shpikjes (abstrakti) duhet të përbëhet nga:

a) titulli i shpikjes;

b) një përmbledhje e parashtrimit siç e përmban përshkrimi, pretendimet dhe ndonjë vizatim. Përmbledhja tregon fushën teknike të cilës i përket shpikja dhe duhet të formulohet në një mënyrë të tillë që të japë një kuptim të qartë problemit teknik, thelbin e zgjidhjes së problemit më anë të shpikjes dhe përdorimin ose përdorimet kryesore të shpikjes;

c) kur shpikja është e zbatueshme, paraqitet formula kimike, e cila karakterizon me mirë shpikjen midis gjithë formulave që përmban kërkesa.

4.2 Përmbledhja duhet të jetë konçize aq sa e lejon parashtrimi (preferohet nga 50 deri në 150 fjalë) dhe duhet të përpilohet në atë mënyrë që të shërbejë me efikasitet si një mjet i shpejtë për qëllime kërkimi. Përmbledhja nuk duhet të përmbajë pohime mbi meritat ose vlerat e shpikjes ose mbi zbatime spekulative të saj.

4.3 Secili nga tiparet teknike kryesore i përmendur në përmbledhje dhe i ilustruar në vizatim, duhet të shoqërohet me ndonjë nga vizatimet më ilustrative, që duhet të japë paraqitësi i kërkesës.

KREU IV

KËRKESA TEKNIKE QË DUHET TË PËRMBUSHË APLIKIMI PËR PATENTË

1. Terminologjia dhe shenjat

1.1 Një aplikim për patentë duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- a) njësitë e peshës dhe masës duhet të shprehen me terma të sistemit metrik;
- b) temperatura duhet të shprehet me gradë celcius;
- c) densiteti duhet të shprehet në njësi metrike;
- ç) për të treguar nxehtësinë, energjinë, dritën, zërin dhe magnetizimin si dhe formulat matematike dhe njësitë elektrike, zbatohen rregullat e praktikave ndërkombëtare. Për formulat kimike, simbolet, peshat atomike dhe formulat molekulare zbatohen përdorimet e zakonshme;

d) vetëm terma të tillë teknike, shenja dhe simbole duhet të përdoren siç janë pranuar.

1.2 Terminologjia dhe shenjat duhet të jenë të pandryshueshme gjatë gjithë kërkesës.

2. Kërkesat fizike të kërkesës për patentë

2.1 Kërkesa dhe ndonjë dokument ose pohim që e shoqëron atë, duhet të depozitohet në një kopje. DPPI mund të kërkojë depozitimin edhe të një kopje shtesë.

2.2 Të gjithë elementet e kërkesës paraqiten në mënyrë që të lejojnë riprodhimin e drejtpërdrejtë me anë të fotografisë, riprodhimit, fotokopjimit, mikrofilmimit etj., në një numër të pakufizuar kopjesh.

2.3 Çdo element i kërkesës duhet të fillojë në një fletë të re, të bardhë format A4 (29,7 x 21cm) si dhe duhet të përdoret vetëm një anë e saj. Të gjitha fletëve u vendoset një numër rendor në pjesën e sipërme të tyre.

2.4 Elementet e aplikimit duhet të vendosen sipas radhës së mëposhtme:

a) *formulari përkatës i aplikimit*;

b) përshkrimi;

c) pretendimet;

ç) përmbledhja (abstrakti);

d) vizatimet.

2.5 Vendosja e numrit të radhës së fletëve bëhet duke përdorur tri seri të ndara numrash. Seria e parë zbatohet vetëm te kërkesa dhe fillon me fletën e parë të kërkesës, seria e dytë fillon me fletën e parë të përshkrimit dhe vazhdon me pretendimet deri tek fleta e fundit e përmbledhjes. Seria e tretë zbatohet vetëm tek fletet e vizatimeve dhe fillon me fletën e parë të vizatimeve.

KREU V

UNITETI I SHPIKJES DHE KËRKESAT E NDARA

1. Uniteti i shpikjes

1.1 Uniteti i shpikjes në zbatim të nenit 22 të ligjit do të interpretohet në mënyrë të tillë që të lejojë një nga mundësitë e mëposhtme:

a) në shtesë të një pretendimi të pavarur për një produkt të dhënë, përfshirjen në të njëjtën kërkesë e një pretendimi të pavarur për një proces të adaptuar veçanërisht për prodhimin e produktit të dhënë, si dhe përfshirja në të njëjtën kërkesë e një pretendimi të pavarur për një përdorim të produktit të dhënë;

b) në shtesë të një pretendimi të pavarur për një proces të dhënë, përfshirjen në të njëjtën kërkesë të një pretendimi të pavarur për aparate ose mjete të projektuara për të zbatuar procesin e dhënë.

1.2 Në përputhje me nenin 22 të ligjit, lejohet të përfshihen në të njëjtën kërkesë dy ose më shumë pretendime të pavarura të së njëjtës kategori të cilat nuk mund të mbulohen nga një pretendim i vetëm i përgjithshëm.

1.3 Në përputhje me nenin 22 të ligjit, lejohet të përfshihen në të njëjtën kërkesë një numër i arsyeshëm pretendimesh të varura që kërkojnë formë specifike të shpikjes, të kërkuara në një pretendim të pavarur.

2. Kërkesa të ndara

2.1 Kërkesa për ndarjen e aplikimit fillestar, parashikuar nga neni 23 i ligjit, depozitohet pranë DPPI nga aplikanti, nëpërmjet formularit *përkatës të aplikimit* dhe duhet të përmbajë një referencë të kërkesës fillestare.

2.2 Aplikimi i ndarë gëzon të drejtën për prioritet:

a) në qoftë se paraqitësi i aplikimit fillestar pretendon që aplikimi i ndarë të përfitojë prioritetin e njohur për aplikimin fillestar, aplikimi i ndarë duhet të përmbajë një deklaratë të tillë. Në një rast të tillë, dokumentet e prioritetit të depozituara në përputhje me nenin 24 të ligjit për aplikimin fillestar do të merren të mirëqena edhe për aplikimin e ndarë;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

b) kur prioritetet e dy ose më shumë aplikimeve më të hershme pretendohen për aplikimin fillestar, aplikimi i ndarë përfiton vetëm nga prioriteti ose prioritetet e zbatueshme për të.

2.3 Për paraqitjen e çdo aplikimi të ndarë, paraqitësi i kërkesës paguan tarifën e caktuar brenda një periudhe dy mujore nga data e depozitimit të aplikimit të ndarë.

KREU VI

BËRJA E NJOHUR E MATERIALIT BIOLOGJIK TË DEPOZITUAR

1. Kushtet që duhet të plotësojë kërkuesi për njohjen e materialit biologjik

1.1 Me kërkesën e çdo personi të interesuar dhe pas dhënies së autorizimit nga aplikanti i patentës, kultura e depozituar do të jetë e arritshme për t'u njohur prej tij, që nga data e publikimit të kërkesës për patentë, me kusht që ai të deklarojë me shkrim se:

a) nuk do të lejojë ndonjë palë të tretë të njihet me kulturën e depozituar ose me çdo kulturë të prejardhur prej saj, përpara se kërkesa për patentë të jetë refuzuar ose tërhequr, ose të jete konsideruar si e tërhequr, ose, përpara mbarimit të afatit të patentës së dhënë në lidhje me këtë kulturë;

b) do ta përdorë për qëllime eksperimentale kulturën e depozituar ose çdo kulturë të prejardhur prej saj, vetëm përsa kohë kërkesa për patentë është refuzuar ose tërhequr, ose është konsideruar të jetë e tërhequr, ose, deri në datën e publikimit të patentës. Kjo dispozitë nuk zbatohet për atë kohë sa kërkuesi i kulturës së depozituar është duke e përdorur këtë kulturë mbi bazën e një licence jovullnetare.

1.2 Nga data e publikimit të kërkesës për patentë deri në datën e publikimit të patentës ose deri në datën në të cilën kërkesa për patentë është refuzuar, tërhequr ose konsideruar si e tërhequr, aplikanti mund të informojë DPPI, se kultura e depozituar mund t'i vihet në dispozicion kërkuetit të kulturës së depozituar që të njihet me të, nëpërmjet dhënies së një mostre, një eksperti të emëruar prej kërkuetit të kulturës.

2. Emërimi i ekspertit

2.1 Në zbatim të pikës 1.2 të këtij kreu, mund të emërohet si ekspert:

a) çdo person i caktuar nga kërkuesi i kulturës me kusht që për emërimin e ekspertit të jetë marrë miratimi i paraqitësit të kërkesës për patentë;

b) çdo person i njohur si ekspert prej DPPI.

2.2 Emërimi i ekspertit i bërë në këtë rast shoqërohet nga një garanci me shkrim që eksperti i jep paraqitësit të kërkesës për patentë, për përmbushjen nga ana e tij të të gjitha dispozitave të pikës 1, 2 dhe 3 të këtij kreu, duke e konsideruar vetë kërkuetin e kulturës së depozituar si një palë të tretë.

3. Përkufizim "kulturë e prejardhur"

3.1 Në zbatim të gërmes "b" të pikës 1.1 të këtij kreu, "kulturë e prejardhur" konsiderohet të jetë çdo kulturë e mikroorganizmit, që i shfaq ende ato karakteristika të kulturës së depozituar, të cilat janë thelbësore për kryerjen e shpikjes. Deklarata e përmendur në pikën 1.1 të këtij kreu, nuk e ndalon depozitimin e një kulture të prejardhur të domosdoshme për qëllimin e procedurës së patentës.

4. Kërkesa për njohjen e një kulture të depozituar dhe shqyrtimi i saj nga DPPI-ja

4.1 Kërkesa për njohjen e një kulture të depozituar, paraqitet pranë DPPI me anën e një formulari të posaçëm të njohur prej saj. DPPI vërteton, nëpërmjet këtij formulari, se një kërkesë për patentë, e cila i referohet depozitës së mikroorganizmit është depozituar, dhe se kërkuesi i kulturës së depozituar ose eksperti i emëruar prej tij e gëzon të drejtën për marrjen e një mostre të mikroorganizmit.

4.2 DPPI ia dërgon një kopje të kërkesës për njohjen e kulturës së depozituar, së bashku me vërtetimin e parashikuar në pikën 4.1 të këtij kreu, institucionit depozitues, si dhe aplikantit për patentë ose pronarit të patentës.

KREU VII

DEPOZITA E RE E NJË MIKROORGANIZMI

1. Pavlefshmëria e një mikroorganizmi të depozituar

1.1 Në qoftë se një mikroorganizëm i depozituar, në përputhje me parashikimin e pikës 3.1 të kreut II të kësaj rregulloreje pushon së qeni i vlefshëm në dispozicion prej institucionit pranë të cilit ai është depozituar sepse:

a) mikroorganizmi nuk është i aftë të mbijetojë,

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

b) institucioni depozitues nuk është në gjendje të plotësojë nevojat për furnizim me mostra, ose për çdo arsye tjetër, dhe në qoftë se mikroorganizmi nuk është transferuar në një institucion tjetër depozitues, nëpërmjet të cilit ai do të vazhdojë të jetë në dispozicion,

nuk konsiderohet të ketë ndodhur një ndërprerje e vlefshmërisë së të qenit të tij në dispozicion, në qoftë se një depozit[e re e mikroorganizmit të depozituar herën e parë në mënyrë origjinale është bërë brenda tre muajve nga data në të cilën personi depozitues njoftohet për ndërprerjen nga ana e institucionit depozitues, dhe një kopje e marrjes së depozitës e lëshuar prej institucionit, i dërgohet DPPI brenda 4 muajve nga data kur në depozitën e re vihet numri i kërkesës për patentë ose i patentës.

2. Depozita e re e mikroorganizmit

2.1 Në rastin e parashikuar në germën “a” të pikës 1.1 të këtij kreu, depozita e re bëhet në institucionin depozitues në të cilin është bërë depozitimi origjinal, ndërsa në rastet e parashikuara në germën “b” të pikës 1.1 të këtij kreu, ajo mund të bëhet në një institucion tjetër depozitues.

2.2. Kur institucioni në të cilin është bërë depozitimi origjinal pushon së qeni institucion depozitues, ose në tërësi ose të paktën për atë lloj mikroorganizmi të cilit i përket depozita e mikroorganizmit në fjalë, ose kur ai institucion ndërpret përkohësisht ose përfundimisht kryerjen e funksioneve të tij në lidhje me mikroorganizmat e depozituara, dhe njoftimi i referuar në pikën 1 të këtij kreu prej institucionit depozitues nuk merret brenda 6 muajve nga data e ndodhjes së një fakti të tillë, periudha tremujore e parashikuar në pikën 1 të këtij kreu do t[fillojë në datën kur një fakt i tillë njoftohet zyrtarisht nga DPPI.

2.3 Çdo depozit[e re shoqërohet me një deklaratë të nënshkruar prej depozituesit, ku pohohet se mikroorganizmi i ridedepozituar është i njëjtë me atë të depozituar për herë të parë në mënyrë origjinale.

KREU VIII E DREJTA PËR PRIORITET

1. Depozitimi i dokumentit të prioritetit

1.1 Në rast se pretendohet për prioritet, aplikanti duhet që, brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së aplikimit për patentë, të depozitojë pranë DPPI dokumentin e prioritetit në bazë të nenit 24 pika 2 t[ligjit. Në rast se aplikanti nuk e depoziton dokumentin e prioritetit brenda këtij afati, ose dokumenti i depozituar nuk përmbush kërkesat e këtij kreu, DPPI nuk e njeh të drejtën për prioritet.

1.2 Dokumenti i prioritetit mund të jetë dëshmi depozitimi i mëparshëm i një ose më shumë aplikimeve kombëtare, rajonale ose ndërkombëtare të depozituara nga aplikanti ose zëvendësuesi i tij ligjor në përputhje me pikën 1 të nenit 24 të ligjit ose certifikatën e lëshuar nga autoritetet përgjegjëse të ekspozitës ku është prezantuar shpikja për herë të parë në përputhje me pikën 7 të nenit 24 të ligjit.

1.3 Dokumenti i prioritetit duhet të përmbajë:

- a) datën e kërkesës më të hershme;
- b) numrin e kërkesës më të hershme;
- c) simbolin e klasifikimit ndërkombëtar të patentave që ka kërkesa më e hershme;
- ç) emrin e shtetit në të cilin është depozituar kërkesa më e hershme;
- d) zyrën në të cilën është depozituar kërkesa më e hershme, kur kërkesa është depozituar në një zyrë rajonale ose ndërkombëtare.

1.4 Kur në kohën e depozitimit të aplikimit për patentë, aplikanti deklaron prioritetin, por numri i kërkesës më të hershme është i panjohur, brenda tre muajve nga data e depozitimit të aplikimit për patentë, aplikanti duhet të deklarojë numrin e kërkesës së aplikimit më të hershëm dhe të depozitojë dokumentin e prioritetit.

1.5 Shfuqizuar.

1.6 Dokumenti i prioritetit i depozituar pranë DPPI në përputhje me kërkesat e këtij kreu, duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

2. Deklarimi i prioritetit

2.1 Deklarimi i prioritetit, i përmendur në nenin 24, paragrafi 1, paraqitet me depozitimin e kërkesës për patentë dhe duhet të përmbajë datën dhe numrin e aplikimit të mëparshëm, si dhe shtet[palë në Konventën e Parisit ose anëtar në Organizatën Botërore të Tregtisë, ku është bërë aplikimi i mëparshëm. Në rastin kur prioriteti kërkohet në bazë të paraqitjes në një ekspozitë ndërkombëtare, deklarata duhet të përmbajë datën e paraqitjes në ekspozitë dhe emërtimin e ekspozitës.

2.2 Kërkesi mund të korrigjojë deklaratën e prioritetit brenda gjashtëmbëdhjetë muajve nga data e prioritetit më të parë të pretenduar, ose, nëse korrigjimi do të shkaktonte një ndryshim në datën e prioritetit më të parë të pretenduar, brenda gjashtëmbëdhjetë muajve nga data e korrigjuar e prioritetit më të parë, cilado periudhë gjashtëmbëdhjetëmujore të mbarojë më parë,

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

*me kusht që një korrëgjim i tillë të paraqitet para mbarimit të katër muajve nga data e depozitimit të dhënë të kërkesës për patentë.
2.3 Deklarata e prioritetit nuk mund të bëhet ose të korrëgjet pas depozitimit të kërkesës për publikim të parakohshëm.*

KREU IX

EKZAMINIMI I APLIKIMIT PËR PATENTË DHE DHËNIA E PATENTËS

1. Rendi dhe afatet e ekzaminimit të aplikimit

1.1 Aplikimet e depozituara ekzaminohen sipas numrit të tyre rendor. DPPI shqyrton brenda një periudhe 3-mujore nga data e paraqitjes së aplikimit, nëse ai plotëson kërkesat e pikës 1 dhe 2 të nenit 18 të Ligjit.

2. Ekzaminimi i aplikimit dhe njohja e datës së depozitimit

2.1 Nëse aplikimi i përmbush kërkesat e pikës 1 dhe 2 të nenit 18 të ligjit, DPPI i lëshon aplikantit dëshminë e depozitimit duke njohur si datë depozitimi të aplikimit, datën kur aplikimi është paraqitur pranë DPPI. Kur aplikanti e ka depozituar përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe të dokumentit të parashikuar në germën “c” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit brenda afatit 2-mujor nga data e depozitimit, DPPI njeh si datë depozitimi, datën e paraqitjes së aplikimit.

2.2. Në rast se aplikimi nuk përmbush kërkesat e pikës 1 dhe 2 të nenit 18 të ligjit, DPPI njofton aplikantin që të plotësojë të metat brenda tre muajve nga data e njoftimit. Kur aplikanti i plotëson të metat brenda këtij afati, DPPI lëshon dëshminë e depozitimit duke njohur si datë depozitimi të aplikimit, datën kur janë plotësuar të metat. Nëse aplikanti nuk i plotëson të metat brenda afatit të caktuar, DPPI refuzon të depozitojë aplikimin dhe njofton aplikantin për refuzimin.

3. Ekzaminimi *formal* i kërkesës për patentë

3.1. *Pas përvaktimit të datës* të dëshmisë së depozitimit, DPPI shqyrton nëse aplikimi plotëson kërkesat e nenit 17, 19, 20 (3), e 24 të ligjit, si dhe kërkesat e kreut II të kësaj rregulloreje.

3.2 Nëse aplikimi nuk i përmbush kërkesat e nenit 17, 19, 20 (3), 21, 22, e 24 të ligjit, si dhe kërkesat e kreut II, III, IV dhe V të kësaj rregulloreje, DPPI njofton aplikantin për të bërë plotësimet brenda tre muajve nga data e njoftimit. Nëse aplikanti nuk i plotëson të metat brenda afatit të caktuar, DPPI e refuzon aplikimin për patentë dhe njofton aplikantin për refuzimin. Nëse aplikanti i plotëson të metat e aplikimit brenda afatit të caktuar, DPPI vazhdon ekzaminimin e aplikimit në përputhje me parashikimin e pikës 3.3 dhe 3.4 të këtij kreu.

3.3. DPPI boton në Buletinin e Pronësisë Industriale çdo aplikim të depozituar, menjëherë pas përfundimit të një periudhe prej 18 muajsh nga data e depozitimit ose, kur kërkohet prioritet, nga data e prioritetit. Nëse aplikanti kërkon me shkrim, përpara plotësimit të afatit prej 18 muajsh, që aplikimi të publikohet para kohe, dhe paguan tarifën përkatëse, DPPI e publikon atë menjëherë.

3.4 *Shfuqizuar.*

3.5 DPPI ka të drejtë t'i kërkojë aplikantit depozitimin e dokumenteve shtesë të nevojshme për ekzaminimin e aplikimit, nëpërmjet një njoftimi me shkrim si dhe të caktojë afatin për depozitimin e tyre kur e çmon të nevojshme.

4. Marrja e vendimit në lidhje me kërkesën për patentë

4.1 Në përfundim të ekzaminimit të bërë në përputhje me pikën 3 të këtij kreu, DPPI merr vendim për lëshimin ose jo të patentës dhe njofton menjëherë aplikantin për vendimin e marrë.

4.2 Kur DPPI vendos të lëshojë patentën, ekzaminuesi njofton aplikantin për kryerjen e pagesës së tarifës për lëshimin e patentës, brenda 3 muajve nga data e marrjes së njoftimit. DPPI lëshon patentën, brenda 3 muajve nga data që aplikanti ka depozituar pranë DPPI dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse.

4.3 Kur DPPI vendos të mos lëshojë patentën, ajo njofton me shkrim aplikantin për refuzimin e lëshimit të patentës, duke sqaruar shkaqet e refuzimit.

4.4 DPPI boton në Buletinin e Pronësisë Industriale çdo patentë të lëshuar

5. Kërkesa për shqyrtim të mëtejshëm i aplikimit për patentë

5.1 Në përputhje me parashikimin e nenit 34 të ligjit, aplikanti mund të kërkojë që afati kohor i parashikuar nga pikat 2.2 dhe 3.2 të këtij kreu të zgjatet deri në një muaj shtesë, duke paraqitur një kërkesë me shkrim bazuar në shkaqe të arsyeshme dhe kundrejt pagesës së tarifës *për shqyrtim të mëtejshëm*. Në çdo rast, kërkesa *për shqyrtim të mëtejshëm* duhet të depozitohet pranë DPPI pa mbaruar afati 3-mujor i plotësimit të të metave, parashikuar në pikën 2.2 dhe 3.2 të këtij kreu. Aplikanti nuk mund të kërkojë shtyrje afati për depozitimin e dokumenteve të prioritetit të parashikuar nga neni 24 i ligjit dhe të kërkesës për rivendosje në afat të të drejtave.

6. Të dhënat që përmban patentë

6.1 Patenta e lëshuar nga DPPI përmban të dhënat e mëposhtme:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- a) numrin e patentës;
- b) numrin e aplikimit kombëtar për patentë;
- c) datën e depozitimit;
- ç) emrin dhe adresën e pronarit të patentës;
- d) datën prioritare të kërkesës;
- dh) datën efektive të lëshimit të patentës;
- e) titullin e shpikjes;
- ë) pretendimet;
- f) datën dhe numrin e publikimit të aplikimit për patentë;
- g) emrin dhe adresën e shpikësit ose shpikësve.

6.2. Në rastin kur patenta e lëshuar është rezultat i një kërkesë për konvertim në bazë të nenit 87/ë, patenta e lëshuar do të përmbajë edhe të dhënat e mëposhtme:

- a) Datën e kërkesës për konvertim;
- b) Numrin dhe vendin e aplikimit fillestar;
- c) Datën e aplikimit fillestar.

7. Njohja e vlefshmërisë së patentës

7.1 Në zbatim të pikës 4, të nenit 28, të ligjit, pronari i patentës duhet të depozitojë brenda 10 (dhjetë) vjetëve nga data e depozitimit të aplikimit për patentë, dokumentin me anë të të cilit të provojë patentueshmërinë e shpikjes në përputhje me nenet 5, 6, 7, 9 dhe 10, të ligjit. Dokumenti i sipërpërmendur mund të jetë rezultat i ekzaminimit thelbësor të kryer mbi të njëjtën patentë nga ZEP-i, nga një zyrtë kombëtare, e cila gëzon statusin e Autoritetit Ndërkombëtar për Ekzaminim Paraprak, sipas nenit 32, të Traktatit të Bashkëpunimit për Patentat ose nga zyra kombëtare, e cila ka marrëveshje bashkëpunimi me DPPI-në, si dhe një patentë e dhënë për të njëjtën shpikje nga një prej këtyre zyrave. Ai duhet të depozitohet i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

7.2 DPPI shqyrton dokumentin e depozituar nga pronari i patentës, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 4 të nenit 28 të ligjit dhe pikës 7.1 të këtij kreu. Në rast se dokumenti plotëson kërkesat e lartpërmendura dhe rezultati i ekzaminimit në substancë të shpikjes që rezulton nga ky dokument është pozitiv, DPPI njeh vlefshmërinë e shpikjes, njofton aplikantin dhe bën shënimin përkatës në regjistrin e patentave.

Nëse procedura e njohjes së patentës në njërën nga zyrat përkatëse nuk është përfunduar ende, aplikuesi njofton DPPI-në para përfundimit të afatit 10-vjeçar nga data e depozitimit të aplikimit për patentë dhe kërkon zgjatje të afatit për depozitimin e provës shkresore, në bazë të nenit 34, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse. DPPI-ja mund të zgjatë afatin e depozitimit të provës shkresore deri në 3 muaj nga data e përfundimit të procedurës në zyrën përkatëse.

7.3 Në rast se rezultati i ekzaminimit në substancë të shpikjes që rezulton nga dokumenti i lartpërmendur është negativ, DPPI nuk e merr në konsideratë dokumentin dhe njofton për këtë pronarin e patentës. Nëse rezultati i ekzaminimit në substancë është pozitiv vetëm për një pjesë të pretendimeve, patenta është e vlefshme vetëm për këto pretendime dhe DPPI lëshon njoftimin përkatës dhe bën shënimin në regjistrin e patentave.

7.4 DPPI boton në Buletinin e Pronësisë Industriale njoftimin për vendimin e marrë në lidhje me patentën.

KREU X

PUBLIKIMI I APLIKIMEVE PËR PATENTË DHE I PATENTAVE

1. Publikimi i aplikimit për patentë

1.1 Në bazë të nenit 26 të ligjit, DPPI publikon çdo aplikim të depozituar menjëherë pas përfundimit të një periudhe prej 18 muajsh nga data e depozitimit ose, kur kërkohet prioritet, nga data e prioritetit. Nëse aplikanti kërkon me shkrim, përpara plotësimit të afatit prej 18 muajsh, që aplikimi të publikohet para kohe, dhe paguan tarifën përkatëse, DPPI e publikon atë menjëherë.

1.2 Publikimi i aplikimit për patentë përmban:

- a) datën e depozitimit dhe numrin e aplikimit;
- b) emrin e adresën e paraqitesit të aplikimit;
- c) emrin e adresën e shpik[si]t, përveç rasteve kur ai ka kërkuar të mos përmendet;
- ç) në qoftë se është kërkuar prioritet dhe ai është pranuar, të dhënat e prioritetit;
- d) titullin e shpikjes;
- dh) simbolin e klasifikimit ndërkombëtar të patentave;
- e) pretendimet e kërkesës për patentë;
- ë) pershkrimin;

- f) vizatimet;
- g) abstraktin.

1.3 Në rastin kur patenta e lëshuar është rezultat i një kërkesë për konvertim në bazë të nenit 87/ë, publikimi i aplikimit të saj do të përmbajë edhe të dhënat e mëposhtme:

- a) Datën e kërkesës për konvertim;
- b) Numrin dhe vendin e aplikimit fillestar;
- c) Datën e aplikimit fillestar.

2. Publikimi për dhënien e patentës

2.1 Publikimi për dhënien e patentës përmban:

- a) numrin e patentës;
- b) emrin dhe adresën e pronarit të patentës;
- c) emrin dhe adresën e shpikësit përveç rasteve kur ai ka kërkuar të mos përmendet në patentë;
- ç) datën e depozitimit dhe numrin e kërkesës;
- d) në qoftë se është kërkuar prioritet dhe ai është pranuar, të dhënat e prioritetit;
- dh) datën efektive të lëshimit të patentës;
- e) titullin e shpikjes;
- ë) vizatimet me ilustrativet, në qoftë se ka;
- f) simbolin e klasifikimit ndërkombëtar të patentave.

2.2 Në rastin kur patenta e lëshuar është rezultat i një kërkesë për konvertim në bazë të nenit 87/ë, publikimi i saj do të përmbajë edhe të dhënat e mëposhtme:

- a) Datën e kërkesës për konvertim;
- b) Numrin dhe vendin e aplikimit fillestar;
- c) Datën e aplikimit fillestar.

3. Aplikimet që nuk publikohen

3.1 DPPI nuk i publikon aplikimet, nëse ato janë tërhequr ose refuzuar, përpara mbarimit të afatit prej 18 muajsh, i cili fillon nga data e depozitimit ose, kur ka kërkesë për prioritet, nga data e prioritetit.

4. Publikimi i patentave të pavarlefshme

4.1 DPPI-ja publikon të dhënat për patentat e bëra të pavarlefshme për shkak të mospagimit të tarifës së ripërtëritjes, ose kur pavarlefshmëria e patentës është vendosur me vendim gjyqësor, si dhe në çdo rast tjetër pavarlefshmërie parashikuar nga ligji dhe nga kjo rregullore.

KREU XI

KUNDËRSHTIMI PËR DHËNIEN E PATENTËS

Paraqitja e kërkesës për kundërshtim

1.1 Kundërshtimi ndaj dhënies së një patente, mund të paraqitet pranë DPPI brenda një periudhe nëntëmuajore nga data e publikimit të dhënies së patentës, nga personat e parashikuar nga neni 13 i ligjit, nëpërmjet depozitimit të dokumenteve të mëposhtme:

- a) formulari përkatës i aplikimit për kundërshtimin e patentës;
- b) dokumenti i pagesës së tarifës për kundërshtimin.

1.2 Kundërshtuesi duhet të paraqesë edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) autorizimin e përfaqësimit në rast se kundërshtimi paraqitet nga përfaqësuesi i kundërshtuesit;
- b) dokumentet që provojnë se kundërshtuesi gëzon një nga të drejtat e parashikuara nga neni 13 i ligjit.

2. Shqyrtimi i kundërshtimit nga bordi i apelimit

2.1 Bordi i apelimit të DPPI e shqyrton kundërshtimin për dhënien e një patente, brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së tij.

2.2 Në rast se kundërshtimi nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga pika 1.1 e këtij kreu, bordi i apelimit e konsideron të paparaqitur kundërshtimin dhe njofton me shkrim kundërshtuesin.

2.3 Në rast se kundërshtimi nuk plotëson kërkesat e pikës 1.2 të këtij Kreu, bordi i apelimit i kërkon kundërshtuesit nëpërmjet një njoftimi me shkrim të plotësorë të metat brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, në të kundërt kundërshtimi quhet si i paparaqitur.

2.4 Kur kundërshtimi i plotëson të gjitha kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, bordi i apelimit pranon për shqyrtim kundërshtimin njofton me shkrim, pronarin e patentës kundër së cilës është depozituar kundërshtimi dhe i dërgon atij një kopje të kundërshtimit dhe të dokumenteve të tjera bashkëngjitur atij. Pronari i patentës ka

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

të drejtë që, brenda 3 muajve nga data e njoftimit, të depozitojë me shkrim pretendimet e tij lidhur me kundërshtimin dhe çdo dokument tjetër në mbështetje të pretendimeve të tij.

2.5 Gjatë shqyrtimit, bordi i apelimit ka të drejtë t'u kërkojë palëve, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të paraqesin materiale dhe dokumente të tjera shtesë brenda një periudhe njëmuajore nga data e njoftimit.

2.6 Bordi i apelimit merr vendim lidhur me kundërshtimin dhe njofton me shkrim palët. Vendimi i bordit të apelimit mund të apelohej në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

3. Trajtimi i aplikimit për patentë pas marrjes së vendimit mbi kundërshtimin

3.1 Kur bordi i apelimit vendos të rrëzojë kundërshtimin dhe vendimi nuk apelohej në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për patentë dhe DPPI reflekton vendimin në regjistrin e patentave.

3.2 Kur bordi i apelimit vendos të pranojë kundërshtimin dhe vendimi nuk apelohej në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për patentë dhe DPPI lëshon vendimin për revokimin e patentës së dhënë si dhe e reflekton atë në regjistrin e patentave dhe bën publikimin në Buletinin e Pronësisë Industriale.

3.3 Në rast se vendimi i bordit të apelimit lidhur me kundërshtimin për dhënien e patentës apelohej në gjykatë, një kopje e vendimit përfundimtar të gjykatës depozitohet në dosjen e aplikimit për patentë dhe DPPI reflekton vendimin e gjykatës në regjistrin e patentave, si dhe bën publikimin në Buletinin e Pronësisë Industriale, nëse është vendosur shfuqizimi i patentës.

KREU XII RIVENDOSJA E TË DREJTAVE

1. Paraqitja e kërkesës

1.1 Në përputhje me parashikimin e nenit 35 të ligjit, aplikanti ose pronari i një patente mund të kërkojë rivendosjen e së drejtës brenda dy muajve nga mënjanimi i shkakut të mosrespektimit të afatit, por jo më vonë se 1 (një) vit nga mbarimi i afatit të parespektuar, nëpërmjet një kërkesë me shkrim, e cila përmban:

- a) formularin përkatës të aplikimit;
- b) dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;
- c) autorizimin e përfaqësimit nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i aplikantit ose pronarit të patentës.

1.2 Pronari i një patente, e cila është bërë e pavlefshme për shkak të mospagimit të tarifës së ripërtëritjes brenda afatit të parashikuar nga ligji, mund të kërkojë rivendosjen e së drejtës mbi patentën brenda 2 (dy) muajve nga data e mbarimit të shkakut pengues ose brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e mbarimit të periudhës shtesë për pagesën e tarifës së ripërtëritjes, parashikuar nga pika 3 e nenit 41 të ligjit, cilado nga periudhat e mësipërme mbaron më herët, duke depozituar pranë DPPI dokumentet e përmendura në pikën 1.1 të këtij kreu.

1.3 Kur një kopje e aplikimit më të hershëm, të kërkuar sipas pikës 2 të nenit 24 të ligjit, nuk është depozituar pranë DPPI-së brenda afatit kohor të caktuar, aplikanti ka të drejtë të kërkojë rivendosjen e të drejtës prioritare nëse:

a) deklarata për prioritet është paraqitur pranë DPPI-së në përputhje me kërkesat e pikës 2.1, të kreu VIII, të kësaj rregulloreje;

b) kërkesa për rivendosje, së bashku me kopjen e aplikimit më të hershëm, është depozituar pranë DPPI-së brenda 1 (një) muaji nga data e mbarimit të afatit të parashikuar nga pika 2 e nenit 24, të ligjit.

1.4 Kur aplikimi që pretendon prioritet nuk është depozituar brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e aplikimit të mëparshëm, aplikuesi mund të depozitojë kërkesë për rivendosjen e së drejtës së prioritetit brenda dy muajve nga mbarimi i afatit të sipërpërmendur, të shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:

- a) Të dhënat për shkaqet që çuan në mosrespektimin e periudhës së prioritetit, pavarësisht nga marrja e masave të nevojshme;
- b) Tarifa për rivendosje në afat;
- c) Autorizimi i përfaqësimit.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI

2.1 DPPI-ja shqyrton kërkesën për rivendosjen e së drejtës brenda një afati njëmuajor nga data e marrjes së saj, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 35, të ligjit, dhe të pikave 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të këtij kreu. Në rast se DPPI e pranon kërkesën për rivendosjen e së drejtës, njofton me shkrim aplikantin ose pronarin e patentës për rivendosjen e së drejtës dhe afatin brenda të cilit ai duhet të plotësojë të metat dhe e publikon atë. Refuzimi i lëshuar nga DPPI shfuqizohet dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën në përputhje me ligjin.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2.2. Në rast se kërkesa për rivendosjen e së drejtës nuk është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 35 të ligjit dhe pikës 1.1 dhe 1.2 të këtij kreu, DPPI e refuzon kërkesën për rivendosjen e të drejtës dhe njofton me shkrim aplikantin ose pronarin e patentës.

2.3. Në përputhje me nenin 35 të ligjit, rivendosja e të drejtave mund të kërkohe vetëm një herë për çdo aplikim.

2.4 *Vendimi i DPPI-së për refuzimin e rivendosjes në afat mund të apelohe në Bordin e Apelit të DPPI-së brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes njoftim.*

KREU XIII

NDRYSHIMI I EMRIT DHE/OSE ADRESËS SË APLIKANTIT OSE PRONARIT TË PATENTËS

1. Paraqitja e kërkesës

1.1 Pronari ose aplikuesi i patentës mund të kërkojë ndryshimin e emrit dhe/ose adresës së tij në regjistrin e patentave. Kërkesa për ndryshimin e emrit paraqitet pranë DPPI nëpërmjet formularit *përkatës të aplikimit* dhe kërkesa për ndryshimin e adresës paraqitet nëpërmjet formularit *përkatës të aplikimit*. Së bashku me kërkesën, duhet të depozitohen edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) dokumenti i pagesës së tarifës përkatëse;
- b) autorizimi i përfaqësimit kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të patentës;
- c) në rastin kur kërkohe ndryshimi i emrit të pronarit të patentës, dokumenti që vërteton këtë ndryshim.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI

2.1 DPPI shqyrton kërkesën për ndryshim emri dhe/ose adrese të pronarit të patentës nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1.1 të këtij kreu dhe në rast ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.

2.2 Kur kërkesa për ndryshim emri dhe/ose adrese të pronarit të patentës është në përputhje me parashikimet e pikës 1.1 të këtij kreu, DPPI regjistron ndryshimin në regjistrin e patentave, njofton aplikantin dhe bën publikimin e ndryshimit në Buletinin e Pronësisë Industriale.

KREU XIV

TRANSFERIMI I PRONËSISË MBI PATENTËN

1. Paraqitja e kërkesës

1.1 Kërkesa për transferimin e pronësisë mbi patentën, parashikuar nga neni 44 i ligjit, paraqitet pranë DPPI nëpërmjet formularit *përkatës të aplikimit* nga pronari i patentës ose pronari i ri i saj. Së bashku me kërkesën, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;
- b) autorizimin e përfaqësimit kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të patentës;
- c) aktin e transferimit të pronësisë, i cili duhet të bëhet me akt noterial.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI

2.1 DPPI shqyrton kërkesën për transferimin e pronësisë, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1.1 të këtij kreu dhe në rast se ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.

2.2 Kur kërkesa për transferimin e pronësisë është në përputhje me parashikimet e pikës 1.1 të këtij Kreu, DPPI e regjistron transferimin e pronësisë në regjistrin e patentave, njofton aplikantin dhe bën publikimin e ndryshimit në Buletinin e Pronësisë Industriale.

KREU XIV/1

E DREJTA E PENGUT PËR PATENTAT E SHPIKJEVE

1. Paraqitja e kërkesës

1.1 Kërkesa për regjistrimin e një kontrate garancie ose pengu për një patentë, parashikuar nga neni 36/a i ligjit, paraqitet pranë DPPI-së nëpërmjet formularit *përkatës të aplikimit*, me kërkesë të njëjës prej palëve në kontratë. Së bashku me kërkesën, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) Dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;
- b) Autorizimin e përfaqësimit, kur paraqitësi i kërkesës nuk është njëri nga palët në kontratë;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

c) Dokumentin që vërteton se kemi të bëjmë me një kontratë garancie ose pengu.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI-ja

2.1 DPPI-ja shqyrton kërkesën për regjistrimin e kontratës së garancisë ose të pengut nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij kreu, dhe, në rast se ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit. Në të kundërt, kërkesa refuzohet.

2.2 Kur kërkesa për regjistrimin e kontratës së garancisë ose të pengut është në përputhje me parashikimet e pikës 1.1, të këtij kreu, DPPI-ja e regjistron kontratën e garancisë ose të pengut në regjistrin e patentave, njofton aplikantin dhe bën publikimin e saj në Buletinin e Pronësisë Industriale.

KREU XIV/2

PROCEDURA PËR ZBATIMIN E VEPRIMEVE PËRMBARIMORE

1. Paraqitja e kërkesës

1.1 Kërkesa për regjistrimin e një veprimi përmbarimor për një patentë, e parashikuar nga neni 36/b i ligjit, paraqitet pranë DPPI-së nëpërmjet formularit përkatës të aplikimit, me kërkesë të njëjës prej palëve në kontratë. Së bashku me kërkesën aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;

b) Autorizimin e përfaqësimit, kur paraqitësi i kërkesës nuk është njëri nga palët në kontratë;

c) Dokumentin që vërteton veprimin përmbarimor.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI-ja

2.1 DPPI-ja shqyrton kërkesën për regjistrimin e një veprimi përmbarimor, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij kreu, dhe, në rast se ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit. Në të kundërt, kërkesa refuzohet.

2.2 Kur kërkesa për regjistrimin e një veprimi përmbarimor është në përputhje me parashikimet e pikës 1.1 të këtij kreu, DPPI-ja, me një njoftim zyrtar, njofton, paraprkasht, pronarin e patentës, përpara se të regjistrojë veprimin përmbarimor në regjistrin e patentave dhe të bëjë publikimin e saj në Buletinin e Pronësisë Industriale.

KREU XV

REGJISTRIMI I KONTRATËS SË LICENCËS

1. Paraqitja e kërkesës

1.1 Kërkesa për regjistrimin e kontratës së licencës për një patentë, parashikuar nga neni 46 i ligjit, paraqitet pranë DPPI nëpërmjet formularit përkatës të aplikimit nga pronari i patentës. Së bashku me kërkesën, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;

b) autorizimin e përfaqësimit kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të patentës;

c) kontratën e licencës e cila duhet të ketë formën e një akti noterial. Nëse kontrata e licencës e lidhur mes palëve nuk është në gjuhën shqipe, kontrata duhet të depozitohet pranë DPPI e përkthyer në shqip dhe e noterizuar.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI

2.1 DPPI shqyrton kërkesën për regjistrimin e kontratës së licencës nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij kreu dhe në rast ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.

2.2 Kur kërkesa për regjistrimin e kontratës së licencës është në përputhje me parashikimet e pikës 1.1 të këtij kreu, DPPI e regjistron kontratën e licencës në regjistrin e patentave, njofton aplikantin dhe bën publikimin e licencimit në Buletinin e Pronësisë Industriale.

KREU XVI

RIPËRTËRITJA E PATENTËS

1. Paraqitja e kërkesës

1.1 Kërkesa për ripërtëritjen e patentës, parashikuar nga neni 41 i ligjit, paraqitet pranë DPPI nëpërmjet formularit përkatës të aplikimit. Së bashku me formularin, pronari i patentës duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

a) dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;

b) *shfuqizuar*.

2. Kushtet që duhet të plotësojë kërkesa për ripërtëritje të patentës

2.1 Ripërtëritja e patentës do të fillojë të bëhet nga viti i parë pas dhënies së patentës, për patentat kombëtare, ndërsa për patentat e shtrira europiane, duke filluar nga viti pasardhës i atij, në të cilin është publikuar dhënia e kësaj patente. Kërkesa për ripërtëritjen e patentës e përbërë nga formulari *përkatës të aplikimit* dhe dokumenti i pagesës së tarifës përkatëse duhet të depozitohet pranë DPPI përpara ditës së fundit të muajit që përmban datën e depozitimit, përfshirë edhe këtë ditë. Nëse kërkesa për ripërtëritjen e patentës së bashku me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse nuk depozitohet brenda afatit të larpërmendur, ato mund të depozitohen brenda periudhës 6-mujore pas datës së fundit të muajit të datës së depozitimit, kundrejt pagesës së një tarife shtesë ose brenda 2 (dy) muajve nga periudha 6-mujore pas datës së fundit të muajit të datës së depozitimit, kundrejt pagesës shtesë.

2.2 Kërkesa për ripërtëritjen e patentës dhe pagesa e tarifës së ripërtëritjes nuk mund të bëhet më parë se 12 (dymbëdhjetë) muaj që paraprijnë datën e fundit të afatit për kryerjen e pagesës së ripërtëritjes.

2.3 Në rastet kur është vendosur rivendosja e së drejtës për një patentë që është bërë e pavlefshme për shkak të mospagimit brenda afatit të tarifës së ripërtëritjes, pagesa e tarifës së ripërtëritjes për vitet e papaguara do të bëhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e marrjes së njoftimit për rivendosjen e të drejtës.

3. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI-ja

3.1 DPPI-ja shqyrton kërkesën për ripërtëritjen e patentës dhe, në rast se ka të meta që kanë të bëjnë me pagesën e tarifës së ripërtëritjes, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda periudhës 8-mujore pas datës së fundit të muajit të datës së depozitimit, kundrejt pagesës së një tarife shtesë, në të kundërt ajo refuzon aplikimin për ripërtëritjen e patentës.

3.2 Nëse të metat e kërkesës për ripërtëritje janë të tilla që nuk lejojnë të kuptohet se cila patentë kërkohet të ripërtërihet, DPPI-ja njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 (tre) muajve nga data e njoftimit, në të kundërt ajo refuzon kërkesën.

3.3 Kur kërkesa për ripërtëritjen e patentës plotëson kushtet e pikës 2, të këtij kreu, DPPI-ja e ripërtërin patentën dhe bën shënimin për ripërtëritjen e saj në regjistrin e patentave dhe i lëshon paraqitësit të kërkesës njoftim për ripërtëritjen e patentës.

3.4 Kur për një patentë janë paraqitur disa kërkesa për ripërtëritje, ripërtëritja e patentës bëhet në bazë të kërkesës që është paraqitur e para dhe DPPI-ja refuzon kërkesat e mëvonshme.

3.5 Nëse tarifa e ripërtëritjes nuk është paguar brenda afatit të parashikuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 41 të ligjit si edhe afatit të parashikuar në pikën 2.1, të këtij kreu, patenta konsiderohet se ka mbaruar në ditën që tarifa e ripërtëritjes ishte për t'u paguar dhe DPPI-ja njofton pronarin ose përfaqësuesin e autorizuar, të regjistruar në regjistrin e patentave, për skadimin e patentës.

3.6 Kur pagesa është kryer, por regjistrimi nuk mund të ripërtërihet ose është ripërtërirë si pasojë e një pagese tjetër, kjo pagesë do të rimbursohet nga zyra.

4. Ripërtëritja e patentave të licencuara

4.1 Nëse pronari i një patente nuk paguan tarifën e ripërtëritjes, sipas nenit 41 të ligjit dhe licenca në favor të një personi të tretë është regjistruar në regjistrin e patentave, DPPI-ja njofton të licencuarin, jo më vonë se 8 (tetë) javë para mbarimit të afatit për pagesën e ripërtëritjes, se pagesa nuk është kryer dhe se ai duhet të paguajë tarifën brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit, me qëllim që të ruajë vlefshmërinë e licencës së regjistruar.

KREU XVII

DORËHEQJA NGA PATENTA DHE NDRYSHIMET NË NJË PATENTË

1. Paraqitja e kërkesës për regjistrimin e dorëheqjes nga patenta

1.1 Kërkesa për regjistrimin e dorëheqjes nga patenta, parashikuar nga neni 71 i ligjit, paraqitet pranë DPPI nëpërmjet formularit *përkatës të aplikimit*. Së bashku me kërkesën, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) *shfuqizuar*;

b) autorizimin e përfaqësimit kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të patentës;

c) kur në regjistrin e patentave është regjistruar një kontratë licence për këtë patentë, deklaratën e lëshuar nga i licencuari, ku ai pohon se është në dijeni të kërkesës për dorëheqje në përputhje me parashikimin e pikës 3 të nenit 71 të ligjit;

ç) kur ka filluar një procedurë gjyqësore për të drejtat mbi patentën, deklaratën e lëshuar nga paditësi, ku ai deklaron se është dakord për regjistrimin e dorëheqjes.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2.1 DPPI shqyrton kërkesën për dorëheqje, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij kreu dhe në rast se ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.

2.2 Kur kërkesa për regjistrimin e dorëheqjes nga një patentë është në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij kreu, DPPI e regjistron dorëheqjen në regjistrin e patentave, njofton aplikantin dhe publikon dorëheqjen në Buletinin e Pronësisë Industriale.

2.3 *Shfuqizuar.*

2.4 *Shfuqizuar.*

3. *Paraqitja e kërkesës për regjistrimin, në regjistrin e patentave, të ndryshimeve në pretendimet e një patente*

3.1. *Pronari i një patente mund të kërkojë regjistrimin, në regjistrin e patentave, të ndryshimeve në pretendimet e një patente, kur këto ndryshime janë rezultat i një procedure të parashikuar nga pika 3 e nenit 82 të ligjit, si dhe neni 87/d, pika 3, brenda afatit të parashikuar në këto nene. Kërkesa për ndryshimin e pretendimeve përbëhet nga:*

a) formulari përkatës i aplikimit, i nënshkruar nga pronari i patentës ose përfaqësuesi i tij;

b) autorizimi i përfaqësimit, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të patentës;

c) dokumenti i pagesës së tarifës së publikimit;

d) pretendimet e ndryshuara, të përkthyer në gjuhën shqipe e të noterizuara në formë shkresore dhe elektronike.

d) vendimi për ripërtëritjen e patentës me pretendime të ndryshuara.

4. *Shqyrtimi i kërkesës për ndryshimin e pretendimeve të patentës*

4.1. DPPI-ja shqyrton kërkesën për regjistrimin, në regjistrin e patentave, të ndryshimeve në pretendimet e një patente, nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 3 të këtij kreu dhe, në rast se ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 (tre) muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.

4.2 Kur kërkesa për regjistrimin, në regjistrin e patentave, të ndryshimeve në pretendimet e një patente është në përputhje me parashikimet e pikës 3 të këtij kreu, DPPI-ja regjistron ndryshimet në pretendimet e patentës në regjistrin e patentave, njofton aplikantin dhe publikon ndryshimet në Buletinin e Pronësisë Industriale.

5. *Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesës për ndryshime në patentë*

5.1 *Pronari i një patente mund të kërkojë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim depozituar pranë DPPI-së dhe kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, bërjen e ndryshimeve në një patentë për korrigjimin e gabimeve apo pasaktësive formale të paqëllimshme, kur këto gabime janë bërë nga aplikanti në aplikimin për patentë dhe që nuk kanë të bëjnë me thelbin e patentës. DPPI-ja, pasi shqyrton kërkesën, njofton kërkesuesin për vendimin e marrë dhe, kur e pranon kërkesën, publikon ndryshimet e patentës në Buletinin e Pronësisë Industriale.*

KREU XVIII

APELIMET PRANË BORDIT TË APELIMIT

1. *Paraqitja e kërkesës*

1.1 Brenda një periudhe tremujore nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e aplikimit, aplikanti ka të drejtë ta apelojë vendimin e DPPI, në përputhje me nenin 28 pika 3 e ligjit, duke depozituar pranë DPPI:

a) formularin përkatës të kërkesës për apelim, të nënshkruar nga pronari i patentës ose përfaqësuesi i tij;

b) dokumentin e pagesës së tarifës për apelimin;

c) autorizimin e përfaqësimit nëse apelimi paraqitet nga përfaqësuesi i aplikantit.

2. *Shqyrtimi i kërkesës nga bordi i apelimit*

2.1 Bordi i apelimit shqyrton paraprakisht nëse apelimi përmbush kërkesat e pikës 1.1 të këtij kreu dhe nëse këto kërkesa nuk janë përmbushur, bordi i apelimit njofton me shkrim apeluesin se kërkesa e tij konsiderohet e paparaqitur.

2.2 Gjatë shqyrtimit, bordi i apelimit ka të drejtë t'i kërkojë apeluesit të vendimit të paraqesë materiale dhe dokumente të tjera shtesë brenda një periudhe njëmuajore nga data e njoftimit.

2.3 Kur kërkesa për apelim përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, bordi i apelimit e shqyrton kërkesën për apelim brenda një periudhe tremujore nga data e paraqitjes së tij dhe njofton apeluesin për vendimin e marrë. Apeluesi ka të drejtë të ankimojë në gjykatë vendimin e bordit të apelimit, brenda 30 ditëve nga marrja njoftim për vendimin e bordit, në përputhje me nenin 28 pika 3 e ligjit.

3. *Trajtimi i patentës pas marrjes së vendimit mbi apelimin*

3.1 Kur bordi i apelimit vendos të pranojë apelimin dhe vendimi nuk apelohe në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për patentë dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën për lëshimin e patentës në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3.2 Kur bordi i apelimit vendos të rrëzojë apelimin dhe vendimi nuk apelohehet në gjykatë, një kopje e vendimit të bordit depozitohet në dosjen e aplikimit për patentë dhe refuzimi merr formë të prerë.

3.3 Në rast se vendimi i bordit të apelimit apelohehet në gjykatë, një kopje e vendimit përfundimtar të gjykatës depozitohet në dosjen e aplikimit për patentë dhe DPPI refuzon aplikimin ose lëshon patentën në përputhje me vendimin e gjykatës.

KREU XIX

SHPIKJET QË LIDHEN ME MBROJTJEN DHE SIGURINË

1. Klasifikimi i aplikimit për patentë si sekret shtetëror

1.1 Në përputhje me parashikimin e nenit 31 pika 2 e ligjit, kur DPPI e klasifikon një aplikim për patentë “sekret shtetëror”, njofton me shkrim aplikantin. Aplikanti, brenda tre muajve nga data e njoftimit, duhet të depozitojë pranë DPPI një deklaratë me shkrim ku të shprehë vullnetin e tij lidhur me vlerësimin e bërë.

1.2 Në rast se aplikanti, në zbatim të pikës 1.1 të këtij kreu, është shprehur se është dakord me vlerësimin e DPPI, aplikimi i dërgohet për ekzaminim Ministrisë së Mbrojtjes.

2. Kundërshtimi i klasifikimit të patentës si sekret shtetëror

2.1 Në rast se aplikanti, në zbatim të pikës 1.1 të këtij kreu, deklaron se nuk e pranon vlerësimin e DPPI se shpikja përbën “sekret shtetëror”, ai duhet që brenda një periudhe kohe njëmuajore nga data e paraqitjes së deklaratës së cituar në pikën 1.1 të këtij kreu, të depozitojë pranë DPPI provat ku ai bazon pretendimet e tij. Nëse pas shqyrtimit të provave të paraqitura nga aplikanti, DPPI vendos se shpikja nuk përbën “sekret shtetëror”, fillon procedurën e ekzaminimit dhe të lëshimit të patentës, në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

2.2 Në rast se aplikanti, në zbatim të pikës 1.1 të këtij kreu, deklaron se nuk e pranon vlerësimin e DPPI-së, por nuk është në gjendje të sjellë prova për ta rrëzuar këtë vlerësim ose kur provat e sjella prej tij janë të pamjaftueshme për të provuar pretendimet e tij, DPPI e dërgon aplikimin në Ministrinë e Mbrojtjes për ekzaminim.

3. Trajtimi i patentës pas zhvlerësimit të saj si sekret shtetëror

3.1 Nëse një shpikje që është “sekret shtetëror” nuk vlerësohet më si e tillë, Ministria e Mbrojtjes e dërgon të gjithë dosjen e patentës tek DPPI, e cila e regjistron atë në regjistrin e patentave, lëshon patentën dhe e publikon atë në përputhje me pikën 4 të nenit 26 të ligjit.

KREU XX

APLIKIMET NDËRKOMBËTARE TË DEPOZITUARA NË DPPI

1. Parime të përgjithshme

1.1 Në zbatim të nenit 77 të ligjit, DPPI-ja vepron si zyrë pritëse sipas TBP-së, nëse aplikanti është banues i përhershëm ose shtetas i Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast, aplikimi ndërkombëtar depozitohet në shqip ose anglisht pranë DPPI dhe shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse. Tarifa duhet të paguhet brenda një muaji nga data e paraqitjes së aplikimit.

1.2 DPPI ekzaminon aplikimin ndërkombëtar në përputhje me parashikimet e traktatit të bashkëpunimit në fushën e patentave dhe rregulloreve të dala në zbatim të saj.

KREU XXI

DHËNIA E CERTIFIKATAVE TË MBROJTJES SHITESË PËR PRODUKTET MJEKËSORE DHE PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. Paraqitja e aplikimit për certifikatë

1.1 Në zbatim të nenit 103 të Ligjit, aplikimi për certifikatë të mbrojtjes shitesë mund të paraqitet pranë DPPI nga pronari i patentës bazë apo zëvendësuesi i tij ligjor, ose përfaqësuesi i tyre, brenda gjashtë muajve nga data në të cilën është dhënë autorizimi për ta hedhur produktin në treg si produkt mjekësor ose si produkt për mbrojtjen e bimëve.

1.2 Në zbatim të nenit 103 të ligjit, nëse autorizimi për ta hedhur produktin në treg është dhënë para se të jepet patenta bazë, aplikimi për një certifikatë të mbrojtjes shitesë duhet të paraqitet pranë DPPI brenda gjashtë muajve nga data në të cilën është dhënë patenta.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Elementet thelbësore që përmban aplikimi për certifikatë

2.1 Në zbatim të nenit 104 të ligjit, aplikimi për certifikatë të mbrojtjes shtesë duhet të përmbajë:

a) formularin *përkatës të aplikimit*, i cili duhet të përmbajë: emrin dhe adresën e aplikantit; emrin dhe adresën e përfaqësuesit nëse aplikanti ka caktuar një përfaqësues, numrin e patentës bazë dhe titullin e shpikjes, si dhe numrin dhe datën e autorizimit të parë për ta hedhur produktin në treg;

b) dokumentin e pagesës së tarifës së aplikimit për certifikatë;

c) një kopje të autorizimit për hedhjen e produktit në treg, në të cilin identifikohet produkti, si dhe përmbahen veçanërisht numri dhe data e autorizimit si dhe përmbledhja e karakteristikave të produktit;

ç) në rastin kur autorizimi i përmendur në germën “c” të kësaj pike nuk është autorizimi i parë për hedhjen në treg të produktit, të dhënat për produktin, për të cilin është lëshuar një autorizim i tillë, bazën ligjore, ku është mbështetur procedura e lëshimit të autorizimit, së bashku me një kopje të njoftimit të publikimit zyrtar të autorizimit ose, kur kjo është e pamundur, çdo dokument tjetër, që provon se autorizimi është lëshuar, datën e lëshimit të tij, si dhe produktin për të cilin është lëshuar ai.

3. Ekzaminimi i aplikimit për certifikatë

3.1 Në rastin kur aplikimi për certifikatë dhe produkti me të cilin ai lidhet nuk i plotëson kushtet e parashikuara në kreun XVI të ligjit dhe pikën 1.1, 1.2 dhe 2.1 të këtij kreu, DPPI njofton me shkrim aplikantin të plotësojë të metat, brenda një afati 6-mujor nga data e marrjes së njoftimit.

3.2 Kur aplikanti nuk i plotëson të metat e aplikimit brenda afatit të caktuar, DPPI e refuzon aplikimin, njofton aplikantin dhe njoftimin e refuzimit e publikon në Buletinin e Pronësisë Industriale. Publikimi i njoftimit të refuzimit duhet të përmbajë të dhënat e parashikuara në pikën 4.1 të këtij kreu.

3.3 Në zbatim të nenit 106 të Ligjit, në rastin kur aplikimi për certifikatë dhe produkti me të cilin ai lidhet, i plotëson kushtet e përcaktuara në kreun XVI të ligjit dhe pikën 1.1, 1.2 dhe 2.1 të këtij kreu, DPPI lëshon një njoftim për pranimin e depozitimit të aplikimit për certifikatë dhe e publikon atë.

4. Publikimi i aplikimit për certifikatë

4.1 Në zbatim të nenit 107 të ligjit, publikimi i aplikimit për certifikatë duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe adresën e aplikantit;

b) numrin e patentës bazë;

c) titullin e shpikjes;

ç) numrin dhe datën e autorizimit për hedhjen e produktit në treg dhe produktin e identifikuar në këtë autorizim

5. Publikimi i lëshimit të certifikatës

5.1 Nëse me kalimin e 3 muajve nga publikimi i aplikimit për certifikatë të mbrojtjes shtesë, pranë DPPI nuk është depozituar asnjë kundërshtim ndaj aplikimit të publikuar, DPPI lëshon certifikatën dhe publikon në Buletinin e Pronësisë Industriale, të dhënat e mëposhtme:

a) emrin dhe adresën e mbajtësit të certifikatës;

b) numrin e patentës bazë;

c) titullin e shpikjes;

ç) numrin dhe datën e autorizimit për hedhjen e produktit në treg dhe produktin e identifikuar në këtë autorizim;

d) kohëzgjatjen e certifikatës.

6. Paraqitja e kërkesës për deklarimin e pavlefshëm të certifikatës së mbrojtjes shtesë

6.1 Në zbatim të nenit 110 pika 2 e ligjit, çdo person mund të paraqesë pranë DPPI, një kërkesë për deklarimin e pavlefshëm të certifikatës së mbrojtjes shtesë, nëpërmjet formularit *përkatës të aplikimit*. Kërkesa duhet të përmbajë këto të dhëna:

a) emrin dhe adresën e paraqitësit të kërkesës;

b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit nëse paraqitësi i kërkesës ka caktuar një përfaqësues për ndjekjen e procedurave pranë DPPI;

c) emrin dhe adresën e mbajtësit të certifikatës;

ç) numrin e patentës bazë;

d) titullin e shpikjes;

dh) arsyet ligjore për të cilat kërkohet pavlefshmëria e certifikatës.

6.2 Kërkesa e përmendur në pikën 6.1 të këtij kreu, duhet të shoqërohet nga:

a) dokumenti i pagesës së tarifës përkatëse;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- b) autorizimi i përfaqësimit nëse paraqitësi i kërkesës ka caktuar një përfaqësues;
- c) provat mbi të cilat paraqitësi i kërkesës bazon pretendimin e tij.

7. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI

7.1 Bordi i apelimit shqyrton kërkesën për deklarimin e pavlefshëm të certifikatës së mbrojtjes shtesë nëse është në përputhje me parashikimet e pikës 6.1 dhe 6.2 të këtij kreu, brenda 6 muajve nga paraqitja e saj. Nëse kërkesa nuk është në përputhje me parashikimet e pikës 6.1 dhe 6.2 të këtij kreu, DPPI njofton paraqitësin e kërkesës që të plotësojë të metat brenda 3 muajve nga data e njoftimit.

7.2 Nëse paraqitësi i kërkesës nuk i plotëson të metat brenda afatit të caktuar, bordi i apelimit e refuzon kërkesën dhe njofton me shkrim kërkuuesin. Nëse kërkesa nuk ka të meta ose të metat plotësohen brenda afatit të parashikuar në pikën 7.1 të këtij kreu, bordi i apelimit shqyrton në themel kërkesën.

7.3 Bordi i apelimit njofton mbajtësin e certifikatës shtesë lidhur me kërkesën për shpalljen e pavlefshmërisë së certifikatës, brenda një muaji nga data e paraqitjes së kërkesës dhe i kërkon që të paraqesë shpjegimet e tij lidhur me kërkesën. Bordi i apelimit gjatë shqyrtimit të kërkesës mund t'u kërkojë palëve që të paraqesin shpjegime dhe dokumenta shtesë të nevojshme për shqyrtim, duke përcaktuar edhe afatin brenda të cilit duhet të paraqiten ato.

7.4 Në përfundim të shqyrtimit, bordi i apelimit vendos lidhur me kërkesën dhe njofton me shkrim palët për vendimin e marrë. Vendimi i bordi të apelimit mund të apelohej në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

8. Trajtimi i patentës pas marrjes së vendimit mbi kërkesën për pavlefshmëri të certifikatës së mbrojtjes shtesë

8.1 Nëse në përfundim të shqyrtimit, DPPI ose gjykata në rast apelimi, vendos se certifikata e mbrojtjes shtesë është e pavlefshme, DPPI publikon në Buletinin e Pronësisë Industriale njoftimin e pavlefshmërisë së saj dhe bën pasqyrimin në regjistrin e patentave.

9. Kohëzgjatja e certifikatës

9.1 Në zbatim të nenit 108 të ligjit, certifikata e mbrojtjes shtesë hyn në fuqi në fund të kohëzgjatjes së parashikuar në ligj të patentës bazë, për një periudhë të barabartë me periudhën që ka kaluar nga data në të cilën është depozituar aplikimi në datën e autorizimit të parë për hedhjen produktin në treg, duke e zvogëluar me një periudhë prej pesë vjetësh. Pavarësisht nga kjo kohëzgjatja e certifikatës nuk mund t'i kalojë pesë vjet nga data në të cilën ajo hyn në fuqi. Çdo periudhë e mbarimit të jetëgjatësisë së saj më e shkurtër se 12 muaj do të trajtohet si një vit i tërë.

10. Ripërtëritja e certifikatës

10.1. Tarifa e ripërtëritjes së certifikatës së mbrojtjes shtesë do të paguhet për çdo vit të jetëgjatësisë së saj. Procedurat që do të ndiqen për ripërtëritjen e certifikatës janë të njëjta me ato të ripërtëritjes së patentës bazë.

11. Mbarimi i afatit të certifikatës

11.1 Certifikatës së mbrojtjes shtesë i mbaron afati:

- a) në fund të periudhës së parashikuar në pikën 9.1 të këtij kreu;
- b) nëse mbajtësi i certifikatës heq dorë;
- c) nëse tarifa vjetore e caktuar nuk paguhet në kohë;
- ç) nëse dhe kur produkti që mbulohet nga certifikata nuk mund të hidhet më në treg, pas heqjes dorë nga autorizimi i duhur për hedhjen e produktit në treg. DPPI mund të vendosë mbarimin e afatit të certifikatës me nismën e vet ose me kërkesën e një pale të tretë.

11.2 Nëse certifikatës i mbaron afati, DPPI lëshon një njoftim me shkrim dhe e publikon atë.

KREU XXII

INSPEKTIMI I DOSJES DHE DOKUMENTE TË TJERA QË LËSHON DPPI LIDHUR ME PATENTAT

1. Hetime dhe ekstrakte nga regjistri i patentave

1.1 Në zbatim të nenit 192 pika 2 dhe nenit 194 të Ligjit, DPPI lëshon ekstrakte nga regjistri i patentave si dhe përgjigje të kërkesave për hetim.

1.2 Kërkesa për ekstrakt regjistri për një patentë paraqitet pranë DPPI me shkrim, shoqëruar me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, në të kundërt kërkesa quhet e paparaqitur. Ekstrakti i regjistrit lëshuar nga DPPI përmban të gjitha të dhënat e patentës dhe historikun e ndryshimeve që ka pësuar ajo.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

1.3 Kërkesa për hetim në lidhje me një patentë paraqitet pranë DPPI me shkrim, shoqëruar me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, në të kundërt kërkesa quhet e paparaqitur. DPPI njofton me shkrim paraqitësin e kërkesës lidhur me rezultatin e hetimit në regjistrin e patentave.

2. Kërkesat për dublikatë

2.1 Pronari i një patente ka të drejtë të kërkojë dublikatë të patentës, të njoftimit të ripërtëritjes së saj ose të njoftimeve të tjera të lëshuara nga DPPI për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e patentave, nëpërmjet një kërkesë me shkrim e cila duhet të shoqërohet me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse dhe me autorizimin e përfaqësimit kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të patentës, në të kundërt kërkesa quhet e paparaqitur.

3. Kërkesë për dokument prioriteti për patentën

3.1 Aplikanti i cili ka depozituar pranë DPPI një aplikim për patentë, ka të drejtë të kërkojë dokument prioriteti për patentën, brenda 12 muajve nga data e paraqitjes së aplikimit për patentë, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse. Dokumenti i prioritetit që lëshohet nga DPPI përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) datën dhe numrin e depozitimit;
- b) emrin dhe adresën e aplikantit;
- c) emrin dhe adresën e shpikësit;
- ç) simbolin e klasifikimit ndërkombëtar të patentave;
- d) titullin e shpikjes;
- dh) përshkrimin e shpikjes;
- e) pretendimet;
- ë) vizatimet;
- f) abstrakti.

4. Kërkesa për inspektim të dosjes së një patente

4.1 Çdo person mund të inspektojë dosjen e një patente në përputhje me parashikimet e nenit 30 të ligjit kundrejt paraqitjes së një kërkesë me shkrim dhe pagesës së tarifës përkatëse. Dosjet që lidhen me një aplikim për patentë që nuk janë publikuar, nuk mund të inspektohen pa pëlqimin e aplikantit.

4.2. Disa dokumenta nuk konsiderohen pjesë të dosjes së hapur për inspektim. Dokumenta të tilla përmbajnë në veçanti, projektvendime dhe opinione ose dokumente të tjera të përdorura për përgatitjen e vendimeve, përcaktimin e shpikësit, në qoftë se ai ka kërkuar të mos përmendet si shpikës në përputhje me nenin 16 pika 2 të ligjit, dhe ndonjë dokument të përjashtuar nga dosja prej DPPI me arsyetimin se inspektimi i atij dokumenti nuk i jep publikut llojin e informacionit që ai kërkon dhe për të cilin është i titulluar.

5. Korrigjimi i gabimeve në dokumentet e lëshuara nga DPPI

5.1 Në rastin e lëshimit nga DPPI të akteve që përmbajnë gabime ose pasaktësi jo për fajin e aplikantit ose pronarit të patentës, korrigjimi i tyre bëhet nga DPPI në bazë të një kërkesë me shkrim të paraqitur nga aplikanti ose pronari i patentës. DPPI rilëshon aktin e korrigjuar, pasi aplikanti ose pronari i patentës ka dorëzuar pranë DPPI origjinalin e aktit për të cilin kërkohet korrigjimi, bën pasqyrimin e korrigjimit në regjistrin e patentave dhe e publikon atë në Buletinin e Pronësisë Industriale. *Kur rilëshimi i aktit është i pamundur, DPPI-ja bën korrigjimin e gabimit në regjistrin e patentave dhe njofton, me shkrim, aplikantin ose pronarin e patentës për korrigjimin e bërë.*

KREU XXIII

APLIKIMET E PATENTAVE EVROPLANE

1. Paraqitja e kërkesës për vlefshmëri të patentës evropiane

1.1. Kërkesa për vlefshmëri të patentës evropiane parashikuar nga neni 87/d paraqitet pranë DPPI-së nëpërmjet formularit përkatës të aplikimit, brenda 3 (tre) muajve nga data e publikimit të vendimit për dhënien e patentës nga ZEP-i. Afati i përmendur mund të zgjatet me një muaj nëse aplikuesi paguan tarifën shtesë për shqyrtim të mëtejshëm. Së bashku me kërkesën, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

- a) Përkthimin në anglisht të specifikimeve të patentës evropiane të dhënë nëse ajo nuk është lëshuar në anglisht;
- b) Përkthimin në shqip të pretendimeve të patentës evropiane; Kur pretendimi përmban shenja referencë të përdorura në vizatime, këto vizatime i bashkëlidhen përkthimit;
- c) Dokumentin e pagesës së tarifës së publikimit;
- ç) Autorizimin e përfaqësimit.

2. Shqyrtimi i kërkesës nga DPPI-ja

2.1 DPPI-ja shqyrton kërkesën për vlefshmëri të patentës evropiane dhe, nëse aplikimi përmbush kërkesat e pikës 1.1, të këtij kreu, DPPI-ja lëshon njoftimin për njohjen e vlefshmërisë së patentës evropiane.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2.2 Nëse aplikimi nuk përmbush vetëm kërkesën e shkronjës “ç”, të pikës 1.1, të këtij kreu, DPPI-ja lëshon njoftimin për plotësim parregullsisht brenda afatit 2-mujor nga data e lëshimit të njoftimit, në të kundërt refuzon kërkesën. Në zbatim të nenit 34, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale” i ndryshuar ky afat mund të shtyhet me kërkesë të aplikantit me 3 (tre) muaj kundrejt pagesës së tarifës për shqyrtim të mëtejshëm.

2.3 Nëse kërkesat e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1.1, të këtij kreu, nuk janë depozituar në kohën e duhur ose tarifa e parashikuar nuk është paguar në kohën e duhur, DPPI-ja refuzon njohjen e vlefshmërisë së patentës evropiane dhe njofton me shkrim aplikantin.

3. Paraqitja e kërkesës për ndryshime në pretendime të patentës evropiane

3.1 Kërkesa për ndryshime të pretendimeve të patentës evropiane parashikuar nga pika 3, e nenit 87/d, paraqitet pranë DPPI-së nëpërmjet formularit përkatës të aplikimit, brenda 3 (tre) muajve nga data e publikimit të vendimit për mbajtjen në fuqi me ndryshimet e bëra ose kufizimin nga ZEP-i. Afati i përmendur mund të zgjatet me një muaj nëse aplikuesi paguan tarifën shtesë për shqyrtim të mëtejshëm. Së bashku me kërkesën për ndryshim në pretendime, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Vendimin për ndryshimin e pretendimeve.

b) Përkthimin në shqip të pretendimeve të patentës evropiane. Kur pretendimi përmban shenja referencë të përdorura në vizatime, këto vizatime i bashkëlidhen përkthimit.

c) Dokumentin e pagesës së tarifës së publikimit.

ç) Autorizimin e përfaqësimit.

4. Shqyrtimi i kërkesës për ndryshime në pretendime të patentës evropiane nga DPPI-ja

4.1 DPPI-ja shqyrton kërkesën për ndryshime në pretendime të patentës evropiane dhe, nëse aplikimi përmbush kërkesat e pikës 3.1, të këtij kreu, DPPI-ja lëshon njoftimin për njohjen e ndryshimit të pretendimeve të patentës evropiane.

4.2 Nëse aplikimi nuk përmbush vetëm kërkesën e shkronjës “ç”, të pikës 3.1, të këtij kreu, DPPI-ja lëshon njoftimin për plotësim parregullsisht brenda afatit 2-mujor nga data e lëshimit të njoftimit, në të kundërt e refuzon kërkesën. Në zbatim të nenit 34, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, ky afat mund të shtyhet me kërkesë të aplikantit me 3 (tre) muaj kundrejt pagesës së tarifës për shqyrtim të mëtejshëm.

4.3 Nëse kërkesat e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 3.1, të këtij kreu, nuk janë depozituar në kohën e duhur ose tarifa e parashikuar nuk është paguar në kohën e duhur, DPPI-ja refuzon kërkesën për ndryshime në pretendime të patentës evropiane dhe njëkohësisht bën edhe pavlefshmërinë e patentës evropiane dhe njofton me shkrim aplikantin.

VENDIM

Nr. 883, datë 13.5.2009

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE PËR REGJISTRIMIN E OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE¹

(ndryshuar me VKM nr.433, datë 16.6.2011; nr.37, datë 21.1.2015; nr.316, datë 31.5.2018)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 202, 25, 28, 33, 41, 44, 46, 76, 77, 79, 80, 82, 109, 137, 149, 172, 194, 198 të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me patentat e shpikjeve, janë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me certifikatat e mbrojtjes shtesë për produktet mjekësore dhe produktet për mbrojtjen e bimëve, janë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me modelet e përdorimit, janë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur disenjot industriale, janë sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me markat tregtare dhe të shërbimit, janë sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. Fletore Zyrtare nr. 134. Tiranë, 2009. f. 6247

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

6. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me treguesit gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, janë sipas lidhjes nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Tarifat për aplikimet dhe veprimet e tjera të kryera pranë DPPI, lidhur me qarqet e integruara, janë sipas lidhjes nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Tarifat për shërbime të tjera të kryera pranë DPPI janë sipas lidhjes nr.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

10. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.379, datë 15.08.1994 “Për tarifat e zyrës së patentave për objektet e pronësisë industriale” me ndryshimet e mëvonshme, shfuqizohet.

11. Shfuqizuar.

Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për të përcaktuar drejtëtimet dhe kriteret e përdorimit të të ardhurave që i liben DPPI -së.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Lidhja nr. 1

I. TARIFAT PËR PATENTAT E SHPIKJEVE

(ndryshuar me VKM nr.37, datë 21.1.2015; nr.316, datë 31.5.2018)

Nr.	Llojet e tarifave	Vlera në lekë
1.1	Tarifë për depozitim aplikimi për patentë	7 000
1.2	Tarifë për depozitimin e aplikimeve të PCT-së	7 000
1.3	Tarifë për çdo pretendim mbi pretendimin e 10-të të patentës	500
1.4	Tarifë për depozitimin e çdo aplikimi të ndarë të patentës	5 000
1.5	Tarifë për publikimin e shtrirjes së patentave evropiane dhe amendamenteve në patentë	1 000
1.6	Tarifë për publikim të parakohebsëm të patentës	2 000
1.7	Tarifë për rivendosjen në afat të të drejtave	7 000
1.8	Tarifë për shqyrtim të mëtejshëm	7 000
1.9	Tarifë për korrigjimin e gabimeve në aplikimin për patentë	2 000
1.10	Tarifë për korrigjimin e gabimeve në patentë	2 000
1.11	Tarifë për lëshimin e patentës	6 000
1.12	Tarifë për depozitimin e kundërshtimit të dhënies së patentës	7 000
1.13	Tarifë për apelim në Bordin e Apelit	7,000
1.14	Tarifë për regjistrimin e transferimit të pronësisë mbi aplikimin për patentë ose patentën	5 000
1.15	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të emrit të aplikantit/ pronarit të patentës	5 000
1.16	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/ pronarit të patentës	3 000
1.17	Tarifë për regjistrimin e kontratës së licencës mbi patentën	5 000
1.18	Tarifë për lëshimin e ekstraktit të regjistrit për një patentë	1 500
1.19	Tarifë për kryerjen e betimit mbi një patentë	2 000
1.20	Tarifë për lëshimin e dublikatave	1 000
1.21	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit për një patentë	3 000
1.22	Tarifë për inspektim dosje të patentës	1 000
1.23	Tarifë ripërtëritje viti II	5 000
1.24	Tarifë ripërtëritje viti III	6 000
1.25	Tarifë ripërtëritje viti IV	8 000
1.26	Tarifë ripërtëritje viti V	10 000
1.27	Tarifë ripërtëritje viti VI	12 000
1.28	Tarifë ripërtëritje viti VII	14 000
1.29	Tarifë ripërtëritje viti VIII	18 000
1.30	Tarifë ripërtëritje viti IX	20 000
1.31	Tarifë ripërtëritje viti X	25 000
1.32	Tarifë ripërtëritje viti XI	27 000
1.33	Tarifë ripërtëritje viti XII	30 000
1.34	Tarifë ripërtëritje viti XIII	35 000
1.35	Tarifë ripërtëritje viti XIV	40 000
1.36	Tarifë ripërtëritje viti XV	45 000

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

1.37	Tarifë ripërtëritje viti XVI	50 000
1.38	Tarifë ripërtëritje viti XVII	55 000
1.39	Tarifë ripërtëritje viti XVIII	60 000
1.40	Tarifë ripërtëritje viti XIX	65 000
1.41	Tarifë ripërtëritje viti XX	70 000
1.42	Tarifë për transferimin e aplikimeve të bëra në bazë të PCT-së	9 000
1.43	Tarifë për kërkesë për ndryshimin ose shtimin e prioritetit	7 000
1.44	Tarifën shtesë, për zgjatje afati	7 000
1.45	Tarifë për publikimin e vlefshmërisë së patentave evropiane dhe amendamenteve në patentë	10 000
1.46	Tarifë për regjistrimin e kontratës së pengut	5 000
1.47	Tarifë për regjistrimin e reprimave përmbartimore	5 000

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e patentave (nr. rendor 1.23–1.41) do të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës ka deklaruar me shkrim gatishmërinë e tij për dhënie licence, në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”.

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e patentave (nr. rendor 1.23–1.41) do të rriten në masën 50% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet pas përfundimit të afatit të caktuar në ligj, por brenda një periudhe 6-mujore nga përfundimi i këtij afati, në përputhje me parashikimin e nenit 41, pika 3 e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”.

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e patentave (nr. rendor 1.23–1.41) do të rriten në masën 100% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet brenda 2 muajve pas përfundimit të afatit të caktuar në përputhje me parashikimin e nenit 41, pika 3 e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”.

* Tarifat me nr. rendor 1.1, 1.4, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.11, 1.12, 1.13 do të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës është njëkohësisht edhe shpikësi i patentës. Për studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, këto tarifa do të jenë 100 lekë.

Lidhja nr.2

II. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR CERTIFIKATAT E MBROJTJES SHITESË PËR PRODUKTET MJEKËSORE DHE PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE (shtuar paragraf me VKM nr.37, datë 21.1.2015)

Nr.	Llojet e tarifave	Vlera në lekë
2.1	Tarifë për depozitim aplikimi për certifikatë të mbrojtjes shtesë	20,000
2.2	Tarifë ripërtëritje viti XXI	100,000
2.3	Tarifë ripërtëritje viti XXII	120,000
2.4	Tarifë ripërtëritje viti XXIII	150,000
2.5	Tarifë ripërtëritje viti XXIV	200,000
2.6	Tarifë ripërtëritje viti XXV	250,000
2.7	Tarifë për depozitim e kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë së certifikatës së mbrojtjes shtesë	8,000
2.8	Tarifë për apelim në ein e apelimit	8,000
2.9	Tarifë për regjistrimin e dorëheqjes nga certifikata e mbrojtjes shtesë	1,000
2.10	Tarifë për lëshimin e ekstraktit të regjistrit për një certifikatë të mbrojtjes shtesë	500
2.11	Tarifë për kryerjen e hetimeve për një certifikatë të mbrojtjes shtesë	500
2.12	Tarifë për lëshim dublikate	1,000
2.13	Tarifë për inspektim dosje	1,000

*Tarifat vjetore për ripërtëritjen e certifikatave të mbrojtjes shtesë (Nr.rendor 2.2-2.6) do të rriten në masën 50% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet pas përfundimit të afatit të caktuar në ligj, por brenda një periudhe 6-mujore nga përfundimi i këtij afati.

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e certifikatave të mbrojtjes shtesë (nr. rendor 2.2-2.6) të rriten në masën 100% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet brenda 2 (dy) muajve pas përfundimit të afatit të caktuar në përputhje me parashikimin e pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.

* Tarifa e aplikimit me nr. rendor 2.1 të reduktohet në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës është njëkohësisht edhe shpikësi i patentës.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Lidhja nr.3

III. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR MODELET E PËRDORIMIT

(shtuar paragraf me VKM nr.37, datë 21.1.2015; nr.316, datë 31.5.2018)

Nr.	Llojet e tarifave	Vlera në lekë
3.1	Tarifë për depozitim aplikimi për model përdorimi	6,000
3.2	Tarifë për kthimin e kërkesës për patentë shpikje në kërkesë për model përdorimi	3,500
3.3	Tarifa për çdo pretendim mbi pretendimin e 10-të	500
3.4	Tarifë për depozitim e çdo aplikimi të ndarë	4,000
3.5	Tarifë për publikim të parakohshëm të modelit të përdorimit	2,000
3.6	Tarifë për rivendosjen në afat të të drejtave	7,000
3.7	Tarifë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni	2,000
3.8	Tarifë për korrigjimin e gabimeve në aplikimet për modele përdorimit	2,000
3.9	Tarifë për korrigjimin e gabimeve në patentat për modele të përdorimit	2,000
3.10	Tarifë për lëshimin e patentës për modele të përdorimit	6,000
3.11	Tarifë për apelimet në bordin e apelimit lidhur me modele të përdorimit	10,000
3.12	Tarifë për depozitim e kundërshtimit të dhënies së patentës për modele të përdorimit	7,000
3.13	Tarifë për regjistrimin e kontratës së licensës për modele të përdorimit	4,000
3.14	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të modelit të përdorimit	3,000
3.15	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të modelit të përdorimit	3,000
3.16	Tarifë për regjistrimin e transferimit të pronësisë mbi një model përdorimi	4,000
3.17	Tarifë për regjistrimin e dorëheqjes nga një model përdorimi	1,000
3.18	Tarifë për lëshimin e ekstraktit të regjistrit për një model përdorimi	500
3.19	Tarifë për lëshimin e dublikatave	1,000
3.20	Tarifë për kryerjen e hetimit për një model përdorimi	500
3.21	Tarifë për inspektim dosje për modele të përdorimit	1,000
3.22	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit për modele të përdorimit	3,000
3.23	<i>Shfuqizuar</i>	
3.24	Tarifë ripërtëritje viti II	5,000
3.25	Tarifë ripërtëritje viti III	6,000
3.26	Tarifë ripërtëritje viti IV	7,000
3.27	Tarifë ripërtëritje viti V	8,000
3.28	Tarifë ripërtëritje viti VI	9,000
3.29	Tarifë ripërtëritje viti VII	10,000
3.30	Tarifë ripërtëritje viti VIII	12,000
3.31	Tarifë ripërtëritje viti IX	15,000
3.32	Tarifë ripërtëritje viti X	20,000
3.33	Tarifë për regjistrimin e kontratës së pengut	5,000
3.34	Tarifë për regjistrimin e veprimeve përmbardimore	5,000

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e modeleve të përdorimit (Nr.rendor 3.23-3.32) do të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastin kur pronari i modelit të përdorimit ka deklaruar me shkrim gadishmërinë e tij për dhënie licence, në përputhje me nenin 49 pika 1 e ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale".

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e modeleve të përdorimit (Nr.rendor 3.23-3.32) do të rriten në masën 50% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet pas përfundimit të afatit të caktuar në ligj, por brenda një periudhe 6-mujore nga përfundimi i këtij afati, në përputhje me parashikimin e nenit 41 pika 3 e ligjit nr.9947 datë 7.7.2008 "Për pronësinë industriale".

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e modeleve të përdorimit me numër rendor (3.23-3.32) të rriten në masën 100% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet brenda 2 (dy) muajve pas përfundimit të afatit të caktuar në përputhje me parashikimin e pikës 3, të nenit 41, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar.

* Tarifat me nr. rendor 3.1- 3.12 të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i modelit të përdorimit është njëkohësisht edhe shpikësi i modelit të përdorimit. Për studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, këto tarifa të jenë 100 (njëqind) lekë.

Lidhja nr.4

III. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR DISENJOT INDUSTRIALE

(ndryshuar me VKM-në nr.316, datë 31.5.2018)

Nr.	Llojet e Tarifave	Vlera në lekë
4.1	Tarifë për depozitim aplikimi për diseno industriale	4,000
4.2	Tarifë për regjistrimin e disenjos industriale	6,000
4.3	Tarifë aplikimi për çdo dizeno shtesë (në rastin e disenjove të shumëfishta)	2,000
4.4	Tarifë për depozitim e çdo kërkesë të ndarë nga kërkesa fillestare (në rastin e disenjove të shumëfishta)	2,000
4.5	<i>Shfuqizuar.</i>	
4.6	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të disenjos industriale	3,000
4.7	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të disenjos industriale	3,000
4.8	Tarifë për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë mbi një diseno industriale	4,000
4.9	Tarifë për regjistrimin e kontratës së licensës të disenjos industriale	4,000

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

4.10	Tarifë për ripërtëritjen e disenjosh industriale	6,000
4.11	Tarifë ripërtëritje për çdo diseno shtesë (në rastin e disenjove të shumëfishta)	2,000
4.12	Tarifë shtesë për ripërtëritjen e disenjosh industriale pas mbarimit të afatit të mbrojtjes, por brenda një periudhe 6 muajore nga përfundimi i tij	3,000
4.13	Tarifë për regjistrimin e dorëheqjes nga diseno industriale e regjistruar	1,000
4.14	Tarifë për transferimin e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar të disenjosh	4,000
4.15	<i>Shfuqizuar.</i>	
4.16	Tarifë për depozitimin e kundërshtimit ndaj një diseno industriale të publikuar	7,000
4.17	Tarifë për apelin e vendimit të refuzimit të disenjosh në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim	7,000
4.18	Tarifë për lëshimin e ekstraktit të regjistrit për një diseno industriale	500
4.19	Tarifë për kryerjen e hetimit për një diseno industriale	500
4.20	Tarifë për lëshimin e dublikatave	1,000
4.21	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit për disenjo industriale	3,000
4.22	Tarifë për inspektim dosje	1,000
4.23	Tarifë për zgjatjen e afatit	2,000
4.24	<i>Shfuqizuar.</i>	
4.25	Tarifë për shtyrjen e afatit të publikimit tek disenjo	2,000
4.26	<i>Tarifë për rivendosjen në afat të të drejtave</i>	7,000
4.27	<i>Tarifë për apelin në bordin e apelit</i>	10,000
4.28	<i>Tarifë për shfuqizimin e një disenoje të regjistruar në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim</i>	7,000
4.29	<i>Tarifë për regjistrimin e kontratës së pengut</i>	5,000
4.30	<i>Tarifë për regjistrimin e veprimeve përmburimore</i>	5,000
4.31	<i>Tarifë për saktësimin e të dhënave në regjistr</i>	2,000
4.32	<i>Tarifë për pasqyrimin e ndryshimeve të tjera në regjistr</i>	5,000

Lidhja nr. 5

V. TABELA E TARIFAVE TË MARKAVE¹

(ndryshuar me VKM-në nr. 433, datë 16.6.2011, nr.316, datë 31.5.2018)

Nr.	Llojet e tarifave	Vlera në lekë
5.1	Tarifë për depozitimin e aplikimit për marke individuale.	7000
5.2	Tarifë për depozitimin e aplikimit për marke kolektive ose certifikuese.	8000
5.3	Tarifë për çdo klasë shtesë.	2500
5.4	Tarifë për kufizimin e listës së mallrave.	5000
5.5	Tarifë për ndarjen e aplikimit fillestar.	6000
5.6	Tarifë për ekzaminim jashtë numrit rendor.	6000
5.7	Tarifë për regjistrimin e markës.	8000
5.8	Tarifë për kundërshtimin e regjistrimit të një marke në Dhomën e Kundërshtimeve.	7000
5.9	Tarifë për rivendosjen në afat.	7000
5.10	Tarifë për zgjatjen e afatit.	2000
5.11	Tarifë për shfuqizimin/zhvlerësimin e një marke në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim.	7000
5.12	Tarifë për apelin në Bordin e Apelit të vendimit të marrë në lidhje me kërkesën për shfuqizim/zhvlerësim nga Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim.	10000
5.13	Tarifë për apelin në Bordin e Apelit të vendimit të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve.	10000
5.14	Tarifë për apelin në Bordin e Apelit të vendimit të marrë në lidhje me apelin e refuzimit nga Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim.	10 000
5.15	Tarifë për apelin të refuzimit në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim.	5000
5.16	Tarifë për ripërtëritjen e markës.	8000
5.17	Tarifë për ripërtëritjen për çdo klasë shtesë të markës.	4000
5.18	Tarifë për regjistrimin në regjistr të transferimit të pronësisë.	5000
5.19	Tarifë për regjistrimin në regjistr të ndryshimit në emër.	5000
5.20	Tarifë për regjistrimin në regjistr të ndryshimit në adresë.	1000
5.21	Tarifë për regjistrimin në regjistr të kontratës së licencës.	5000
5.22	Tarifë për regjistrimin në regjistr të kontratës së pengut.	5000
5.23	Tarifë për regjistrimin në regjistr të veprimeve përmburimore.	5000
5.24	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit.	3000
5.25	Tarifë për transferimin e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar të markës dhe transferimi për shtrirje të mëvonshme.	5000
5.26	Tarifë për lëshim ekstrakti nga regjistri i markave.	1000
5.27	Tarifë për lëshim dublikati të akteve administrative.	1000
5.28	Tarifë për inspektim dosje.	1000
5.29	Tarifë për hetim.	1000
5.30	Tarifë për dorëheqje nga marka e regjistruar.	3000
5.31	Tarifë për saktësimin e të dhënave në regjistr.	2 000
5.32	Tarifë për pasqyrimin e ndryshimeve të tjera në regjistr.	5 000
5.33	Tarifë për transformimin e një aplikimi ndërkombëtar në një aplikim kombëtar.	7 000

¹ Korrigjuar me ndreqjen e botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84/2018, f. 5243.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

a) Nëse është depozituar kërkesë për regjistrim ndërkombëtar të markës së aplikuar, tarifa për ekzaminim jashtë numrit rendor do të reduktohet në masën 50%.

b) Tarifa për ripërtëritjen e markës sipas pikës 5.16 do të rritet në masën 50% të vlerës së dhënë në pasqyrë, në rastet kur pagesa e saj kryhet brenda periudhës gjashtë-mujore nga data e përfundimit të periudhës së mbrojtjes.

c) Tarifa për lëshimin e certifikatës së markës në formë elektronike do të reduktohet në masën 20% të vlerës së tarifës së regjistrimit.

Lidhja nr.6

VI. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT PËR TREGUESIT GJEOGRAFIKË DHE EMËRTIMEVE TË ORIGINËS

(ndryshuar me VKM nr.37, datë 21.1.2015; nr.316, datë 31.5.2018)

Nr.	Llojet e Tarifave	Vlera në lekë
6.1	Tarifë për depozitimin e aplikimit për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës.	5,000
6.2	Tarifë për depozitimin e kundërshtimit ndaj një treguesi gjeografik dhe emërtimeve të origjinës të publikuar	7,000
6.3	Tarifë për lëshimin e certifikatës së regjistrimit të treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës	6,000
6.4	Tarifë për apelimin e vendimit të refuzimit të treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës të dhoma për shfuqizim/ zhvlerësim	7,000
6.5	Shfuqizuar	
6.6	Shfuqizuar	
6.7	Shfuqizuar	
6.8	Tarifë për lëshimin e ekstraktit të regjistri për treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës	500
6.9	Tarifë për kryerjen e hetimit për treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës	500
6.10	Tarifë për lëshimin e dublikatave për treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës	1,000
6.11	Tarifë për inspektim dosje	1,000
6.12	Tarifë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni	2,000
6.13	Shfuqizuar	
6.14	Shfuqizuar	
6.15	Tarifë për ndryshimet në specifikimet e produktit	8,000
6.16	Tarifë e apelimit në bordin e apelit	10,000
6.17	Tarifë për shfuqizim/ zhvlerësim në dbomën për shfuqizim/ zhvlerësim dhe vlerë	7,000

Lidhja nr.7

VII. TABELA E TARIFAVE PËR SHËRBIMET LIDHUR ME TOPOGRAFITË E PRODUKTEVE GJYSMËPËRÇEUSE

(zëvendësuar fjalë me VKM nr.37, datë 21.1.2015)

Nr.	Llojet e tarifave	Vlera në lekë
7.1	Tarifë depozitimi të aplikimit për topografite e produkteve gjysmëpërçuese	6,000
7.2	Tarifë regjistrimi për topografite e produkteve gjysmëpërçuese	6,000
7.3	Tarifë ndryshimi emri dhe /ose adrese për topografite e produkteve gjysmëpërçuese	3,000
7.4	Tarifë transferimi pronësie për topografite e produkteve gjysmëpërçuese	4,000
7.5	Tarifë regjistrimi të kontratës së licencës për topografite e produkteve gjysmëpërçuese	4,000
7.6	Tarifë për apelimet pranë bordit të apelimit	7,000
7.7	Tarifë për kundërshtimin e aplikimit për topografite e produkteve gjysmëpërçuese	7,000
7.8	Tarifë për dorëheqje nga mbrojtja e topografite e produkteve gjysmëpërçuese	1,000
7.9	Tarifë për ekstrakt regjistri për topografite e produkteve gjysmëpërçuese	500
7.10	Tarifë për hetim lidhur me topografite e produkteve gjysmëpërçuese të regjistruara në regjistrin përkatës të DPPI	500
7.11	Tarifë për lëshim dublikate	1,000
7.12	Tarifë për lëshimin e dokumentit të prioritetit për topografite e produkteve gjysmëpërçuese	3,000
7.13	Tarifë për inspektim dosje	1,000

* Tarifat vjetore për ripërtëritjen e topografive të produkteve gjysmëpërçuese janë të njëjta me ato të patentave të parashikuara në lidhjen dhe do të reduktohen në masën 50% të vlerës përkatëse të dhënë në pasqyrë, në rastin kur pronari i patentës ka deklaruar me shkrim gatdismërinë e tij për dhënie licence, në përputhje me nenin 49 pika 1 e ligjit 9947 datë 7/7/2008 "Për pronësinë industriale.

*Tarifat vjetore për ripërtëritjen e topografisë e produkteve gjysmëpërçuese do të rriten në masën 50% të vlerave përkatëse të dhëna në pasqyrë, në rastet kur pagesa e tyre kryhet pas përfundimit të afatit të caktuar në ligj, por brenda një periudhe 6-mujore nga përfundimi i këtij afati. Kjo tarifë ripërtëritje konsiderohet gjobë (penalitet) për mospagim në kohë.

VIII. TABELA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË TJERA
(ndryshuar me VKM nr.316, date 31.5.2018)

Nr.	Llojet e tarifave	Vlera në lekë
8.1	TARIFAT PËR PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR	
8.1.1	Tarifë për pjesëmarrje në testimin kualifikues për përfaqësues të autorizuar	5000
8.1.2	Tarifë për ripërtëritje të licencës për përfaqësues të autorizuar	5000
8.1.3	Tarifë për ndryshimet në regjistrë të përfaqësuesve të autorizuar	1000
8.1.4	Tarifë për marrjen e licencës për përfaqësues të autorizuar	10000
8.1.5	Tarifë për publikimin në faqen zyrtare të DPPI-së	1000
8.2	TARIFAT PËR EKSPERTËT E PI-SË	
8.2.1	Tarifë për pjesëmarrje në testimin kualifikues për ekspert të PI-së	5000
8.2.2	Tarifë për ripërtëritje të licencës për ekspert të PI-së	5000
8.2.3	Tarifë për ndryshimet në regjistrë të ekspertëve të PI-së	1000
8.2.4	Tarifë për marrjen e licencës për ekspert të PI-së	10000
8.2.5	Tarifë për publikimin në faqen zyrtare të DPPI-së	1000
8.3	TARIFAT E QENDRËS SË TRAJNIMEVE NË FUSHËN E PI-SË	
8.3.1	Tarifë për pjesëmarrje në trajnimet e organizuara nga Qendra e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale të DPPI-së	700/orë

VENDIM

Nr. 252, datë 9.5.2018

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE TË KRITEREVE PËR SHPËRBLIMIN E KRYETARIT, ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TEKNIK TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE (DPPI)¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 189/e, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryetari, anëtarët dhe sekretari i këshillit mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) përfitojnë një shpërblim kundrejt pjesëmarrjes në mbledhje, përkatësisht:

- a) kryetari me 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë;
- b) anëtarët me 10 000 (dhjetë mijë) lekë;
- c) sekretari me 3 000 (tre mijë) lekë.

Në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 6 pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të këshillit.

2. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarit, të anëtarëve dhe të sekretarit teknik të këshillit mbikëqyrës, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentacionit që provon pjesëmarrjen në mbledhje, përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. Fletore Zyrtare nr. 71. Tiranë, 2018. f. 4514

VENDIM
Nr. 270, datë 16.5.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR DISENJOT INDUSTRIALE”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 119, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për disenjot industriale”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Për shqyrtimin e aplikimeve për regjistrimin e disenjove industriale, të paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të zbatohen dispozitat në fuqi në çastin e aplikimit.
 3. Vendimi nr. 381, datë 4.8.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore për regjistrimin e disenjove industriale”, i ndryshuar, shfuqizohet.
 4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

RREGULLORE
PËR DISENJOT INDUSTRIALE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Rregullorja për regjistrimin e disenjove industriale ka si qëllim të zbatojë dhe të përcaktojë në mënyrë të detajuar çështje të caktuara, të parashikuara në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, për procedurat dhe rregullat e regjistrimit të disenjove industriale lidhur me:

- 1.1 Paraqitjen e aplikimeve për regjistrimin e disenjove industriale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI);
- 1.2 Shqyrtimin e aplikimeve për regjistrim disenjoje;
- 1.3 Paraqitjen e aplikimeve për ripërtëritjen dhe ndryshimet e tjera në regjistrin e disenjove, si dhe shqyrtimin e tyre;
- 1.4 Paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kundërshtim, shfuqizim, si dhe apelimet e vendimeve të refuzimit nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve dhe Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim;
- 1.5 Paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për apelimet e vendimeve nga Bordi i Apelit;
- 1.6 Publikimin e të dhënave lidhur me disenjot industriale në Buletinin e Pronësisë Industriale nga DPPI-ja.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Të drejtën për të aplikuar pranë DPPI-së, për regjistrimin e një disenjoje, e ka çdo person fizik ose juridik, i cili krijon disenjo gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar.
2. DPPI-ja shqyrton aplikimet e depozituara dhe lëshon njoftimet dhe aktet e tjera në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar (në vijim, ligji) dhe të kësaj rregulloreje.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr.76. Tiranë, 2018. f. 4723

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Veprimet e DPPI-së lidhur me këto aplikime bazohen ekskluzivisht në dokumente të shkruara. Kërkesat dhe çdo lloj dokumentacioni tjetër që depozitohet pranë DPPI-së duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe të shtypura.

4. DPPI-ja krijon dhe administron bazën elektronike të të dhënave ku ruhen të gjitha veprimet e kryera në lidhje me disenjt.

Neni 3

Llojet e aplikimeve

1. Llojet e aplikimeve që mund të depozitohen pranë DPPI-së lidhur me disenjt janë:

1.1 Kërkesë për regjistrim disenjoje, nëpërmjet formularit “Për regjistrimin e disenjos industriale”, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

1.2 Kërkesë për ripërtëritje disenjoje, nëpërmjet formularit “Për ripërtëritjen e disenjos industriale”, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

1.3 Kërkesë për transferim pronësie mbi disenjon, regjistrim kontrate licence, ndryshim i emrit, ndryshim i adresës, vendosje e pengut, regjistrim i veprimeve përmbartimore, nëpërmjet formularit “Për regjistrimin e një ndryshimi në regjistër”, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

1.4 Kërkesë për dorëheqje nga disenjoja e regjistruar, nëpërmjet formularit “Për dorëheqje nga disenjoja industriale e regjistruar”, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

1.5 Kërkesë për kundërshtimin e regjistrimit të disenjos së publikuar pranë Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve të DPPI-së, nëpërmjet formularit “Për kundërshtimin e regjistrimit të disenjos së publikuar pranë Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve”, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

1.6 Kërkesë për apelimin e vendimit të refuzimit, në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim, nëpërmjet formularit “Për apelimin e vendimit të refuzimit, në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim”, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

1.7 Kërkesë për shfuqizimin e një disenjoje të regjistruar pranë Dhomës për Shfuqizim/ Zhvlerësim, nëpërmjet formularit “Për shfuqizimin e një disenjoje të regjistruar pranë Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim”, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

1.8 Kërkesë për ndarjen e aplikimit për disenjo të shumëfishta, nëpërmjet formularit “Për ndarjen e aplikimit për disenjo të shumëfishta”, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

1.9 Kërkesë për rivendosje në afat të të drejtave mbi disenjon industriale, nëpërmjet formularit “Për rivendosje në afat të të drejtave mbi disenjon industriale”, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

1.10 Kërkesë për apelimin e vendimeve në Bordin e Apelit, nëpërmjet formularit “Për apelimin e vendimeve në Bordin e Apelit”, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

KREU II

PARAQITJA E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E DISENJOS INDUSTRIALE

Neni 4

Mënyra e aplikimit

1. Aplikimi për regjistrimin e disenjos industriale mund t'i dërgohet DPPI-së, dorazi, me postë ose me faks, nga paraqitësi i kërkesës ose përfaqësuesi i tij. Në rastin e dërgimit të dokumentit me faks, aplikanti duhet që, brenda një muaji nga data e dërgimit të faksit, të depozitojë pranë DPPI-së kërkesën në formën e saj origjinale, në të kundërt kërkesa konsiderohet si e paparaqitur.

2. Aplikimi për regjistrimin e një disenjoje, mund të bëhet për një produkt të vetëm ose për regjistrimin e një disenjoje të shumëfishtë në kuptim të nenit 9 të kësaj rregulloreje.

3. DPPI-ja, ditën që merr në dorëzim formularin e aplikimit “Për regjistrim disenjo industriale”, shënon mbi formular datën dhe orën e paraqitjes së kërkesës, si dhe numrin e kërkesës.

Neni 5

Përmbajtja e aplikimit

1. Aplikimi për regjistrimin e një disenjoje do të përmbajë:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

1.1 Kërkesën për regjistrimin e disenjës nëpërmjet formularit “Për regjistrim diseno industriale”, me të dhënat e mëposhtme:

- 1.1.1 Emrin dhe adresën e aplikantit, në përputhje me nenin 46 të kësaj rregulloreje;
- 1.1.2 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, në përputhje me nenin 46 të kësaj rregulloreje, nëse aplikanti ka caktuar një përfaqësues;
- 1.1.3 Një tregues të qartë të produktit në të cilin disenjoja është përfshirë ose do të aplikohet;
- 1.1.4 Klasifikimin e secilit produkt në të cilin disenjoja është përfshirë ose do të aplikohet, në një klasë dhe nënklasë në bazë të marrëveshjes së Lokarnos (klasifikimi ndërkombëtar për disenjet industriale);
- 1.1.5 Të dhëna mbi numrin total të disenjave kur është kryer një aplikim i shumëfishtë;
- 1.1.6 Përshkrimin në detaje të disenjës industriale dhe paraqitjen e saj;
- 1.1.7 Një e dhënë që tregon se pretendohet për prioritet, nëse është në përputhje me nenin 120 të ligjit;
- 1.1.8 Të dhëna në lidhje me krijuesin e disenjës, kur është i ndryshëm nga aplikanti;
- 1.1.9 Nënshkrimi dhe/ose vula e aplikantit ose e përfaqësuesit të tij.

1.2 Paraqitjen e disenjës, e cila përbëhet nga riprodhimi grafik ose fotografik i saj (bardhezi ose me ngjyra) që duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

1.2.1 Riprodhimi i disenjës duhet të jetë i qartë, pa korrigjime, i vendosur mbi një sfond neutral dhe të ketë një cilësi të tillë që lejon të dallohen qartë të gjitha elementet e disenjës për të cilat kërkohet mbrojtja;

1.2.2 Riprodhimi i disenjës duhet të depozitohet së bashku me aplikimin, duke u ngjitur ose printuar mbi një fletë të bardhë format A4. Mbi këtë fletë nuk duhet të vendosen tekste shpjeguese, shkronja apo simbole, përveç një treguesi që tregon kreun e fletës, kur është e nevojshme. Riprodhimet grafike apo fotografike të disenjës duhet të përfshijnë vetëm pamjen e produktit pa ndonjë objekt tjetër aksesor, person ose kafshë;

1.2.3 Madhësia e riprodhimit të disenjës së vendosur mbi fletën e bardhë format A4, duhet të jetë në përmasa jo më të mëdha se 26,2 cm x 17 cm dhe jo më të vogla se 4cm x 4cm;

1.2.4 Paraqitja e disenjës duhet të përmbajë jo më shumë se shtatë pamje të ndryshme të disenjës, njëra prej të cilave duhet të jetë pamja e përgjithshme e saj;

1.2.5 Përfaqësimi grafik i disenjës duhet të jetë një prodhim cilësor me anë të materialeve të vizatimit ose me anë të mjeteve elektronike që lejojnë vazhdimësi të linjave (të pandërprera) dhe që kanë karakteristika të dallueshme qartë. Një diseno tredimensionale mundësisht të jetë e përfaqësuar me pamje që përmbajnë nuanca dhe ngjyrimë në mënyrë që të theksojnë tiparet tredimensionale.

1.2.6 Aplikanti duhet t'i vendosë secilës prej pamjeve të disenjës një numër rendor. Në rastin e aplikimeve për diseno të shumëfishta, për secilën pamje duhet të vendoset numri rendor, i cili përbëhet nga numri i disenjës dhe më pas numri i pamjes, të ndara mes tyre me një pikë;

1.2.7 Secili prej riprodhimeve grafike ose fotografike të disenjës duhet të përmbajë vetëm një pamje të disenjës;

1.2.8 Në rast se aplikanti depoziton më shumë se shtatë pamje të ndryshme të disenjës, DPPI-ja merr në konsideratë, për efekt të publikimit dhe regjistrimit, vetëm shtatë pamjet e para, sipas numrit rendor që u është vendosur pamjeve nga aplikanti.

1.3 Deklaratën e krijuesit ose të krijuesve, në rastet kur aplikanti nuk është krijuesi, në të cilën të shprehet vullneti për regjistrimin e disenjës në emrin e aplikantit dhe që duhet të bëhet me akt noterial;

1.4 Autorizimin e përfaqësimit, kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit. Autorizimi i përfaqësimit duhet të përmbajë nënshkrimin e aplikantit dhe kur aplikanti është person juridik, edhe vulën e tij. Kur aplikanti, person fizik ose juridik, nuk është rezident në Republikën e Shqipërisë, përfaqësimi i tij duhet të bëhet nga një përfaqësues i autorizuar i regjistruar si i tillë në regjistrin e disenjave industriale;

1.5 Një skemë të përgatitur, projekte ose një model të produktit, nëse është e nevojshme për të sqaruar thelbin e disenjës;

1.6 Dokumentin e prioritetit, kur pretendohet për prioritet, i cili përmban të dhëna, si: datën e depozitimit, numrin e aplikimit, si dhe zyrën ku është depozituar aplikimi i mëparshëm;

1.7 Certifikatën e lëshuar nga autoritetet përgjegjëse të paraqitjes së produktit, si dhe datën e paraqitjes së tij në ekspozita ndërkombëtare zyrtare, kur pretendohet për prioritet, në përputhje me nenin 120 të ligjit;

1.8 Mandatin e pagesës së tarifës së depozitimit të aplikimit.

Neni 6

Ekzaminimi i kushteve për depozitimin e aplikimit

1. DPPI-ja ekzaminon nëse aplikimi për diseno përmban elementet, si më poshtë vijon:

- 1.1 Formularin e aplikimit “Për regjistrim diseno industrial”;
- 1.2 Emrin dhe adresën e aplikantit;
- 1.3 Përfaqësimin e disenjos sipas kërkesave të ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
- 1.4 Dokumentin original të pagesës së tarifës së depozitimit.

Nëse një aplikim për diseno industriale i plotëson këto kushte, DPPI-ja lëshon dëshminë e depozitimit për aplikimin dhe si datë depozitimi caktohet data e paraqitjes së aplikimit.

2. Kur aplikimi nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, DPPI-ja i kërkon aplikantit të plotësojë të metat brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit.

3. Nëse aplikimi i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, brenda afatit të caktuar, DPPI-ja lëshon dëshminë e depozitimit dhe cakton si datë depozitimi për aplikimin datën kur përgjigja për plotësimin e të metave të paraqitet në DPPI.

4. Nëse të metat nuk plotësohen brenda afatit dymujor, DPPI-ja refuzon të depozitojë aplikimin dhe njofton aplikantin për vendimin e refuzimit.

5. Vendimi i refuzimit mund të apelohej në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim brenda 1 (një) muaji nga data e marrjes dijeni për vendimin.

Neni 7

Dëshmia e depozitimit

1. Dëshmia e depozitimit përmban të dhënat e mëposhtme:

- 1.1 Datën dhe numrin e depozitimit;
- 1.2 Emrin dhe adresën e aplikantit;
- 1.3 Të dhëna të tjera të deklaruara në formularin e kërkesës.

Neni 8

Depozitimi i dokumentit të prioritetit

1. Në rast se pretendohet për prioritet, aplikanti duhet që, brenda 3 (tre) muajve nga data e paraqitjes së aplikimit, të depozitojë pranë DPPI-së dokumentin e prioritetit në bazë të pikës 4, të nenit 119, të ligjit ose certifikatën e lëshuar nga autoritetet kompetente të ekspozitës, ku është paraqitur produkti, në bazë të pikës 2, të nenit 120 të ligjit.

2. Dokumenti i prioritetit, i depozituar në bazë të pikës 4, të nenit 119 të ligjit, duhet të përmbajë emrin dhe adresën e aplikantit, datën dhe numrin e aplikimit të mëparshëm, zyrën ku është bërë aplikimi, paraqitjen e disenjos, treguesin e produktit në të cilin disenjoja është përfshirë ose mbi të cilat do të aplikohet, dhe klasifikimin e produkteve në të cilat disenjoja është përfshirë ose mbi të cilat do të aplikohet, sipas klasifikimit të Lokarnos. Dokumenti i prioritetit duhet të depozitohet i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

3. Në rast se aplikanti, brenda 3 (tre) muajve nga data e paraqitjes së kërkesës për prioritet, nuk depoziton pranë DPPI-së dokumentin e prioritetit të zyrës, ku është depozituar aplikimi ose certifikatën e lëshuar nga autoritetet kompetente të ekspozitës, në përputhje me kërkesat e nenit 120 të ligjit dhe, me kërkesat e pikave 1.6 e 1.7, të nenit 4 të kësaj rregulloreje, kërkesa për prioritet nuk do të merret parasysh nga DPPI-ja.

4. Prioriteti i fituar në bazë të parashikimeve të ligjit dhe të kësaj rregulloreje e bën datën e prioritetit të jetë datë depozitimi e aplikimit për regjistrim diseno në DPPI, vetëm për efekt të përcaktimit se cili aplikim gëzon një të drejtë të mëparshme.

Neni 9

Disenjt e shumëfishta

1. Dy ose më shumë diseno mund të bashkohen në një aplikim të vetëm, në përputhje me parashikimin e pikës 2, të nenit 119 të ligjit, duke formuar një aplikim për regjistrimin e një disenjoje të shumëfishtë, me kusht që produktet ku ato janë përfshirë ose mbi të cilat do të aplikohen, t'i përkasin së njëjtës klasë dhe nënklasë të klasifikimit ndërkombëtar të disenjove industriale (marrëveshja e Lokarnos).

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Secila nga disenjot që përmban një aplikim ose regjistrim për disenjo të shumëfishta mund të trajtohet si një aplikim ose regjistrim i veçantë për qëllim të zbatimit të ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

3. Me kërkesën e aplikantit ose të pronarit të disenjos së shumëfishtë dhe kundrejt plotësimit të të gjitha kërkesave të parashikuara nga ligji dhe kjo rregullore, përfshirë pagesën e tarifave përkatëse, secila prej disenjove të një aplikimi ose regjistrimi të shumëfishtë mund të procedohet në mënyrë të veçantë për licencimin, transferimin e pronësisë, ripërtëritjen, dorëheqjen dhe çdo veprim tjetër të njohur nga ligji dhe kjo rregullore për disenjot.

Neni 10

Ndarja e aplikimit të shumëfishtë

1. Kur në një aplikim kërkohet regjistrimi i disa disenjove dhe produktet ku ato janë përfshirë ose mbi të cilat kanë për qëllim të aplikohen, që mund të mos klasifikohet në të njëjtën klasë dhe nënklasë të klasifikimit ndërkombëtar të disenjove industriale (Lokarno), DPPI-ja njofton aplikantin për ndarjen e aplikimit dhe kryerjen e pagesës së tarifës të parashikuar në rregulloren përkatëse.

2. DPPI-ja, në rastin e ndarjes së aplikimit, udhëzon aplikantin se për cilën/cilat disenjo në aplikimin e shumëfishtë duhet të plotësohet një aplikim i ri.

3. Kur paraqitësi i një aplikimi të shumëfishtë vepron pas njoftimit të lëshuar nga DPPI-ja për ndarjen e aplikimit të shumëfishtë, brenda një afati 3-mujor nga data e marrjes së njoftimit, DPPI-ja lëshon një vendim mbi ndarjen e këtij aplikimi.

Neni 11

Kërkesa për ndarjen e aplikimit të disenjos së shumëfishtë

1. Kërkesa për ndarjen e aplikimit për disenjo të shumëfishta duhet të përmbajë:

1.1 Formularin e aplikimit “Për ndarjen e aplikimit për disenjo të shumëfishta”, me të dhënat e mëposhtme:

1.1.1 Numrin e aplikimit të disenjos së shumëfishtë;

1.1.2 Emrin dhe adresën e aplikantit të disenjos së shumëfishtë;

1.1.3 Paraqitjen e disenjos që do të ndahet nga aplikimi fillestar;

1.1.4 Klasën dhe nënklasën sipas klasifikimit të Lokarnos;

1.1.5 Nënshkrimin dhe/ose vulën e personit që depoziton kërkesën ose përfaqësuesit të tij, nëse është caktuar një i tillë.

1.2 Dokumentin origjinal të pagesës së tarifës përkatëse.

2. Për çdo kërkesë për ndarje aplikimi fillestar, duhet të depozitohet një kërkesë e veçantë.

3. Një kopje e plotë e dokumenteve të aplikimit fillestar duhet të bëhet pjesë e aplikimit/aplikimeve të ndara dhe një kopje e kërkesës për ndarje duhet të bëhet pjesë e dokumenteve të aplikimit fillestar.

4. Aplikimit të ndarë do t'i caktohet një numër i ri aplikimi. Aplikimi i ndarë do të ruajë të njëjtën datë depozitimi ose prioriteti me aplikimin fillestar.

5. Përfaqësuesi i autorizuar në aplikimin fillestar do të konsiderohet si i tillë edhe në aplikimin e ndarë.

6. Kur kërkesat e parashikuara në pikat 1, 2 e 3 të këtij neni nuk janë plotësuar, DPPI-ja njofton aplikantin për plotësimin e të metave brenda 3 (tre) muajve nga data e marrjes së njoftimit. Nëse aplikanti nuk plotëson të metat brenda afatit të parashikuar, kërkesa për ndarjen e aplikimit do të refuzohet. Ndarja e aplikimit fillestar i fillon efektet nga data e pranimit të kërkesës.

7. Kërkesa për ndarjen e aplikimit për disenjo të shumëfishta do të publikohet në buletin e PI-së.

Neni 12

Ekzaminimi formal i aplikimit për regjistrim disenjoje

1. Ekzaminimi formal i kërkesës bëhet sipas parashikimeve të nenit 121 të ligjit dhe sipas radhës së paraqitjes së tyre pranë DPPI-së, në përputhje me kërkesat e nenit 119 të ligjit.

2. Aplikimi për regjistrim disenjoje shqyrtohet brenda 3 (tre) muajve nga data e depozitimit të tij, nëse i përmbush kërkesat që parashikohen në pikat 2 e 3, të nenit 119 të ligjit.

3. Nëse aplikimi për disenjo nuk i përmbush kërkesat e parashikuara në nenin 121 të ligjit, DPPI-ja njofton aplikantin të plotësojë të metat brenda 2 muajve në rastin e pikës 1, të nenit 121 të ligjit dhe, brenda 3 muajve në rastin e pikës 2, të nenit 121, të ligjit, në të kundërt DPPI-ja do të refuzojë aplikimin.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

4. Pas marrjes së përgjigjes ndaj njoftimit të DPPI-së, ekzaminuesi shqyrton përgjigjen brenda 1(një) muaji nga paraqitja e saj.

5. Nëse aplikanti, në përgjigje të njoftimit të marrë, nuk i ka plotësuar të metat e kërkuara nga DPPI-ja, kjo e fundit refuzon aplikimin dhe njofton me shkrim aplikantin për vendimin.

6. Afati për paraqitjen e plotësimeve sipas pikës 2, të nenit 121, të ligjit, zgjatet deri në 2 (dy) muaj shtesë nëse aplikanti paraqet brenda periudhës 3-mujore nga data e marrjes së njoftimit një kërkesë me shkrim për këtë qëllim dhe paguan tarifën përkatëse.

KREU III

EKZAMINIMI I KËRKESËS LIDHUR ME SHKAQET ABSOLUTE DHE PUBLIKIMI I DISENJOS

Neni 13

Ekzaminimi i arsyeve absolute për refuzim

1. DPPI-ja ekzaminon aplikimin për diseno industriale, për shkaqe absolute, në përputhje me nenin 121/a të ligjit.

2. Kur konstaton se aplikimi për diseno nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 115 të ligjit, DPPI-ja njofton aplikantin për të parashtruar argumentet e tij brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit. Ky afat mund të zgjatet deri në 2 (dy) muaj shtesë nëse aplikanti paraqet një kërkesë me shkrim për këtë qëllim dhe paguan tarifën përkatëse.

3. Pas marrjes së përgjigjes nga aplikanti brenda afatit të caktuar në pikën 2 të këtij neni, ekzaminuesi e shqyrton përgjigjen brenda 1(një) muaji nga paraqitja e saj.

4. Aplikimi për regjistrim disenjoje industriale refuzohet nëse:

4.1 Aplikanti nuk parashtron vërejtjet e tij;

4.2 Nuk plotëson dokumentacionin shtesë brenda afatit kohor;

4.3 Edhe pas përgjigjes së aplikantit, DPPI-ja vëren se aplikimi nuk është në përputhje me nenin 115 të ligjit.

5. Gjatë ekzaminimit për baza absolute, DPPI-ja ka të drejtë të kërkojë çdo dokument ose deklaratë, që del i nevojshëm gjatë shqyrtimit të aplikimit për regjistrim disenjoje.

6. Vendimi i refuzimit mbi arsye absolute merret vetëm pasi DPPI-ja ka marrë vendim mbi kërkesat formale të aplikimit dhe ky vendim i njoftohet me shkrim aplikantit.

Neni 14

Publikimi i aplikimit për diseno

1. DPPI-ja, në zbatim të nenit 122 të ligjit, publikon në Buletinin e Pronësisë Industriale të dhënat mbi aplikimet për regjistrimin e disenjove.

2. Në buletin publikohen të dhënat për regjistrimin e disenjove, ripërtëritjet, licencimin dhe transferimin e pronësisë së disenjove të regjistruara, ndryshimet në emër, ndryshimet në adresën e pronarit të disenjës, dorëheqjen dhe shfuqizimin e disenjove të regjistruara.

Neni 15

Të dhënat që publikohen në Buletinin e Pronësisë Industriale për disenjtë e aplikuarë ose të regjistruarë

1. Të dhënat që publikohen në Buletinin e Pronësisë Industriale për aplikimet për diseno përfshijnë:

1.1 Emrin dhe adresën e aplikantit;

1.2 Numrin e kërkesës dhe datën e depozitimit;

1.3 Emrin dhe adresën e krijuesit të disenjës, përveçse kur krijuesi, me anë të një deklarate me shkrim, ka kërkuar që emri i tij të mos përmendet;

1.4 Përfaqësimin/paraqitjen e disenjës;

1.5 Produktin në të cilin do të aplikohet disenjoja ose me të cilin do të bashkohet ajo, si dhe klasën e nënklasën në përputhje me klasifikimin e Lokarnos;

1.6 Të dhënat e prioritetit (nëse ka);

1.7 Numrin e disenjove të përfshira në aplikim në rastin e disenjove të shumëfishta.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Të dhënat që publikohen në Buletinin e Pronësisë Industriale për disenjot e regjistruara përfshijnë:
 - 2.1 Emrin dhe adresën e pronarit të disenjot së regjistruar;
 - 2.2 Numrin e kërkesës dhe numrin e regjistrimit të disenjot;
 - 2.3 Datën e depozitimit, datën e mbarimit të mbrojtjes, datën e regjistrimit, si dhe datën e prioritetit (nëse ka);
 - 2.4 Produktin në të cilin do të aplikohet disenjoja ose me të cilin do të bashkohet ajo, si dhe klasën e nënklasën në përputhje me klasifikimin e Lokarnos;
 - 2.5 Përfaqësimin/paraqitjen e disenjot;
 - 2.6 Emrin dhe adresën e krijuesit të disenjot, përveçse kur krijuesi, me anë të një deklarate me shkrim, ka kërkuar që emri i tij të mos përmendet;
 - 2.7 Numrin e disenjotëve të përfshira në regjistrim në rastin e disenjotëve të shumëfishta.
3. Nëse aplikanti, së bashku me aplikimin, ka paraqitur një kërkesë me shkrim për shtyrjen e publikimit të disenjot dhe ka paguar tarifën përkatëse, DPPI-ja publikon të dhënat e pronarit të aplikimit për disenjo në Buletinin e radhës. Pas mbarimit të periudhës së shtyrjes, DPPI-ja publikon dhe aplikimin për regjistrimin e disenjot.

KREU IV KUNDËRSHTIMI PËR REGJISTRIMIN E DISENJOS

Neni 16

Paraqitja e kundërshtimit ndaj regjistrimit të një disenjoje

1. Kërkesa për kundërshtimin e regjistrimit të një disenjoje të publikuar paraqitet në Dhomën për Shqyrtimin e Kundërshtimeve pranë DPPI-së, brenda një periudhe tremujore nga data e publikimit, nga personat e parashikuar në pikën 1, të nenit 123 të ligjit, nëpërmjet depozitimit të dokumenteve të mëposhtme:
 - 1.1 Formularin e aplikimit “Për kundërshtimin e regjistrimit të disenjot së publikuar”, me të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1.1 Numrin e aplikimit për regjistrimin e disenjot për të cilën është depozituar kërkesa për kundërshtim;
 - 1.1.2 Emrin dhe adresën e aplikantit ndaj të cilit është depozituar kërkesa për kundërshtim;
 - 1.1.3 Emrin dhe adresën e kundërshtuesit;
 - 1.1.4 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar nëse kundërshtuesi ka caktuar një të tillë;
 - 1.1.5 Klasën dhe nënklasën sipas të cilës është klasifikuar disenjoja, sipas klasifikimit ndërkombëtar të Lokarnos;
 - 1.1.6 Nënshkrimin e kundërshtuesit ose përfaqësuesit të tij.
 2. Dokumentin e pagesës së tarifës për kundërshtim;
 3. Autorizimin e përfaqësimit, nëse kërkesa depozitohet nga përfaqësuesi i kundërshtuesit;
 4. Dokumentet që provojnë se kundërshtuesi gëzon një nga të drejtat e parashikuara nga neni 116 i ligjit;
 5. Për kundërshtimin e regjistrimit të një disenjoje industriale depozitohet në DPPI një kërkesë e veçantë, e cila paraqitet në dy kopje të njëjta.

Neni 17

Shqyrtimi i kundërshtimit nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve

1. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve të DPPI-së e shqyrton një kundërshtim brenda 2 (dy) muajve nga data e paraqitjes së kërkesës për kundërshtim.
2. Nëse kërkesa për kundërshtim nuk paraqitet brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 123 të ligjit, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve e refuzon kërkesën për kundërshtim dhe njofton kundërshtuesin për vendimin e refuzimit.
3. Nëse kërkesa për kundërshtim nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga pika 1 e pika 2, e nenit 16 të kësaj rregulloreje, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve i kërkon kundërshtuesit, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të plotësojë të metat e konstatuara, brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit. Në rast se të metat nuk plotësohen brenda afatit, kundërshtimi do të konsiderohet sikur të mos jetë paraqitur.
4. Në rast se kërkesa për kundërshtim nuk plotëson kërkesat e parashikuara nga pikat 3 e 4 të nenit 16, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve i kërkon kundërshtuesit, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

plotësojë të metat brenda 2 (dy) muajve nga data e njoftimit, në të kundërt Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve refuzon kërkesën për kundërshtim dhe njofton kundërshtuesin për vendimin e refuzimit.

5. Kur kundërshtimi i plotëson të metat e nenit 16 të kësaj rregulloreje, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve i dërgon një kopje të kundërshtimit aplikantit të disenjës së kundërshtuar, si dhe e njofton atë me shkrim të paraqesë argumentet, si dhe çdo dokument tjetër në mbështetje të argumenteve të tij, brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit.

6. Gjatë shqyrtimit, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve ka të drejtë t'u kërkojë palëve, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të paraqesin materiale dhe dokumente të tjera shtesë brenda një periudhe dymujore nga data e marrjes së njoftimit.

7. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, nëse e konsideron të nevojshme, mund t'u kërkojë palëve nëpërmjet një njoftimi me shkrim, që të marrin pjesë në procedurën e shqyrtimit të kundërshtimit dhe të paraqesin argumentet e tyre me gojë, duke i njoftuar ata për datën dhe orën e zhvillimit të seancës së shqyrtimit të kundërshtimit.

8. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, kur shqyrton një kërkesë, në përputhje me kompetencat përkatëse të parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore, duhet të shprehet me pranim, pranim të pjesshëm ose rrëzim të kërkesës objekt shqyrtimi.

Neni 18

Trajtimi i aplikimit pas marrjes së vendimit mbi kundërshtimin

1. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve gjatë procedurës së shqyrtimit të kundërshtimit, nëse konstaton se kundërshtimi është i pabazuar, refuzon kundërshtimin dhe vendimi u njoftohet palëve pjesëmarrëse në këtë procedurë.

2. Një kopje e vendimit të Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, në rastin kur vendimi nuk apelohej në Bordin e Apelit, depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e disenjës dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën për regjistrimin e saj, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

3. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, gjatë procedurës së kundërshtimit, nëse konstaton se kundërshtimi është pjesërisht i bazuar, atëherë regjistrimi i disenjës refuzohet ose pranohet pjesërisht.

4. Një kopje e vendimit të Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, për refuzim ose regjistrim pjesërisht të disenjës, në rastin kur vendimi nuk apelohej në Bordin e Apelit, depozitohet në dosjen e aplikimit dhe ekzaminuesi lëshon njoftimin e refuzimit ose të regjistrimit të pjesshëm.

5. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, gjatë procedurës së kundërshtimit, nëse konstaton se kundërshtimi është tërësisht i bazuar, atëherë regjistrimi i disenjës refuzohet. Një kopje e vendimit të Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve për refuzimin e disenjës, në rastin kur vendimi nuk apelohej në Bordin e Apelit, depozitohet në dosjen e aplikimit.

6. Në çdo rast, kundër vendimit të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të bëhet ankimi në Bordin e Apelit të DPPI-së, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda një periudhe njëmuajore nga data e marrjes së vendimit.

7. Në rast se vendimi i Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, lidhur me kundërshtimin për regjistrimin e një disenjeje apelohej në Bordin e Apelit, një kopje e vendimit përfundimtar të Bordit të Apelit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e disenjës dhe DPPI-ja refuzon ose regjistron disenjën në përputhje me vendimin.

8. Në rast se vendimi i Bordit të Apelit apelohej në gjykatë, vendimi i formës së prerë i kësaj të fundit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e disenjës dhe DPPI-ja refuzon ose regjistron disenjën në përputhje me këtë vendim.

9. Vendimi i refuzimit publikohet në Buletinin e Pronësisë Industriale, pasi ka marrë formë të prerë.

KREU V

REGJISTRIMI I DISENJOS DHE TË DHËNAT E CERTIFIKATËS

Neni 19

Regjistrimi i disenjës

1. Kur aplikimi për disenjo plotëson kushtet e përcaktuara në ligj e në këtë rregullore dhe kur nuk është depozituar kërkesë për kundërshtim brenda 3 (tre) muajve nga data e publikimit të aplikimit, ose kur është

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

hequr dorë nga kundërshtimi apo kur kundërshtimi është refuzuar dhe vendimi i refuzimit ka marrë formë të prerë, DPPI-ja nxjerr njoftimin për pagesën e tarifës së regjistrimit dhe i kërkon aplikantit që brenda 1 (një) muaji nga data e marrjes së njoftimit, të kryejë pagesën e tarifës dhe një kopje origjinale të dokumentit të pagesës ta depozitojë pranë DPPI-së.

2. Nëse aplikanti nuk e paguan tarifën e regjistrimit të disenjës brenda afatit të caktuar në pikën 1, të nenit 125, të ligjit dhe në pikën 1 të këtij neni, DPPI-ja refuzon regjistrimin e disenjës dhe njofton me shkrim aplikantin për vendimin e marrë.

3. Kur aplikanti paguan tarifën e regjistrimit të disenjës brenda afatit të caktuar në nenin 125 të ligjit, DPPI-ja e regjistron disenjin në regjistrin e disenjave dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda një periudhe tremujore nga data e depozitimit të dokumentit të pagesës së tarifës pranë DPPI-së.

4. DPPI-ja e publikon disenjin e regjistruar në Buletinin e Pronësisë Industriale.

5. Datë e regjistrimit të disenjës, në regjistrin e disenjave, quhet data e lëshimit të certifikatës së regjistrimit të disenjës nga DPPI-ja.

Neni 20

Të dhënat që përmban certifikata e regjistrimit të disenjës

1. Certifikata e regjistrimit të disenjës duhet të përmbajë:
 - 1.1 Emrin dhe adresën e pronarit të disenjës së regjistruar;
 - 1.2 Numrin e kërkesës dhe numrin e regjistrimit të disenjës;
 - 1.3 Datën e depozitimit, datën e mbarimit të mbrojtjes, datën e regjistrimit, si dhe datën e prioritetit (nëse ka);
 - 1.4 Produktin që përfaqëson disenjoja, si dhe klasën e nënklasën e produktit, në përputhje me klasifikimin e Lokarnos;
 - 1.5 Përfaqësimin (pamjen) e disenjës;
 - 1.6 Datën e publikimit të disenjës;
 - 1.7 Numrin e disenjave të përfshira në regjistrim në rastin e disenjave të shumëfishta;
 - 1.8 Emrin dhe adresën e krijuesit të disenjës, përveç rastit kur krijuesi, me anë të një deklarate me shkrim, ka kërkuar që emri i tij të mos përmendet.

KREU VI

NDRYSHIME NË REGJISTRIN E DISENJOVE

Neni 21

Përmbajtja e kërkesës për ndryshime në regjistër

1. Kërkesa për regjistrimin e një ndryshimi në regjistër do të përmbajë:
 - 1.1 Formularin e aplikimit “Për regjistrimin e një ndryshimi në regjistër”, në të cilin do të jenë të specifikuar të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1.1 Numri i aplikimit ose numri i regjistrimit të disenjës;
 - 1.1.2 Emri dhe adresa e aplikantit ose e pronarit të disenjës, ashtu siç është shënuar në regjistër;
 - 1.1.3 Emri dhe adresa e personit që depoziton kërkesën në përputhje me nenin 46 të kësaj rregulloreje;
 - 1.1.4 Emri dhe adresa e përfaqësuesit të autorizuar, nëse është caktuar një i tillë;
 - 1.1.5 Lloji i ndryshimit të kërkuar;
 - 1.1.6 Ndryshimi i kërkuar nga aplikanti ose pronari i disenjës;
 - 1.1.7 Nënshkrimi i personit që depoziton kërkesën ose i përfaqësuesit të tij;
 2. Dokumentin ligjor ku bazohet ndryshimi, përveç rasteve të ndryshimit të adresës së aplikantit, ndryshimit të adresës të pronarit të disenjës apo ndryshimit të adresës së përfaqësuesit të autorizuar;
 3. Dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;
 4. Autorizimin e përfaqësimit, nëse aplikanti/ pronari i disenjës ka caktuar një përfaqësues;
 5. Parashikimet e këtij neni, si dhe të neneve 22 e 23 të kësaj rregulloreje, aplikohen gjithashtu, për pasqyrimin në regjistër të transferimit të pronësisë, ndryshimit të emrit, ndryshimit të adresës, kontratave të licencimit, pengut, veprimeve përmbartimore, si dhe çdo ndryshimi tjetër, i cili duhet ose kërkohet të pasqyrohet në regjistër.

Neni 22

Dokumente të tjera në lidhje me kërkesën për regjistrimin e ndryshimeve në regjistër

1. Kur kërkesa për regjistrimin e një ndryshimi lidhet me disa aplikime/regjistrime, të cilat kanë aplikantë ose pronarë të njëjtë, mund të depozitohet një kërkesë e vetme me kusht që:

1.1 Numrat e aplikimit ose të regjistrimit të të gjitha aplikimeve ose regjistrimeve të jenë treguar në kërkesë;
1.2 Në rastin e transferimit të pronësisë së disenjës, transferimi duhet të bëhet nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim para noterit dhe të nënshkruar nga të dyja palët, e cila depozitohet në DPPI.

1.3 Pagesa të jetë kryer për të gjitha ndryshimet e kërkuara;

2. Nëse është kërkuar një transferim i pjesshëm i pronësisë, DPPI-ja krijon një aplikim dhe/ose regjistrim të ri të disenjës, i cili përmban të dhënat e disenjës (në rastin e disenjave të shumëfishta) për të cilat është kryer transferimi.

3. Një kopje e plotë e dokumenteve të aplikimit apo e regjistrimit fillestar të disenjës duhet të bëhet pjesë e dokumenteve të aplikimit ose e regjistrimit të referuar në pikën 1 të këtij neni. Një kopje e kërkesës për regjistrimin e transferimit të pjesshëm të pronësisë duhet të bëhet pjesë e dokumenteve të aplikimit ose regjistrimit fillestar.

4. Aplikimit ose regjistrimit të një disenjoje sipas pikës 2 të këtij neni i jepet një numër i ri aplikimi dhe/ose regjistrimi.

5. Procedurat e filluara në lidhje me aplikimin ose regjistrimin fillestar të një disenjoje do të konsiderohen edhe për aplikimet ose regjistrimet e referuara në pikën 2 të këtij neni, për të cilat kanë nisur procedurat.

6. Dokumenti ligjor, ku bazohet ndryshimi sipas pikës 2, të nenit 21 të kësaj rregulloreje, duhet të jetë si më poshtë:

6.1 Për transferimin e pronësisë, sipas rastit:

6.1.1 Dokumenti që vërteton transferimin e pronësisë në formën e një marrëveshjeje të nënshkruar nga të dyja palët dhe të vërtetuar nga noteri;

6.1.2 Ekstrakti tregtar i lëshuar nga autoriteti kompetent për shoqëritë tregtare, ku të evidentohet pronari i ri i disenjës.

6.2 Në rastet kur transferimi i pronësisë ka të bëjë me ndryshimin e formës ligjore të shoqërisë, do të depozitohet:

6.2.1 Ekstrakti tregtar i lëshuar nga autoriteti kompetent për shoqëritë tregtare ku të evidentohet ndryshimi përkatës.

6.3 Për ndryshimin e emrit, sipas rastit:

6.3.1 Dokumenti që vërteton ndryshimin;

6.3.2 Ekstrakti tregtar i lëshuar nga autoriteti kompetent për shoqëritë tregtare ku të evidentohet ndryshimi përkatës.

6.4 Për regjistrimin e kontratës së licencës:

6.4.1 Marrëveshja/kontrata e licencës e nënshkruar nga të dyja palët dhe e vërtetuar nga noteri;

6.4.2 Kohëzgjatja e licencës;

6.4.3 Forma e përdorimit të disenjës nga i licencuari;

6.4.4 Lista dhe cilësia e produkteve që do të prodhohë i licencuari;

6.4.5 Territorin ku do të përdoret disenjoja për të cilën është dhënë licenca;

6.4.6 Detyrimet që licencuesi i vendos të licencuarit për zbatimin e kushteve të përcaktuara në kontratë;

6.4.7 Lloji i licencës: licencë ekskluzive ose joekskluzive.

7. Një kontratë licence e regjistruar mund të ndryshohet ose të anulohet me kërkesë të njëres prej palëve dhe çdo ndryshim i saj duhet të regjistrohet në regjistër. Çdo ndryshim duhet të shoqërohet me dokumentet provuese përkatëse.

Neni 23

Procedura në lidhje me shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin e ndryshimeve në regjistër

1. Nëse kërkesa për regjistrimin e një ndryshimi në regjistër nuk është depozituar në përputhje me ligjin dhe këtë rregullore, DPPI-ja njofton me shkrim aplikantin/pronarin e disenjës për plotësimin e të metave ose për depozitimin e dokumenteve shtesë, brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit.

2. Nëse aplikanti që ka depozituar kërkesën i plotëson të metat ose depoziton dokumentet shtesë brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit, DPPI-ja vendos lidhur me kërkesën për regjistrimin e ndryshimit.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Me kërkesë të aplikantit, afati dymujor mund të zgjatet deri në 2 (dy) muaj shtesë, nëse një kërkesë për zgjatje afati depozitohet brenda afatit të lartpërmendur dhe kryhet pagesa e tarifës përkatëse për këtë qëllim.

4. Nëse aplikanti nuk plotëson të metat ose nuk depoziton dokumentet shtesë sipas pikës 1 të këtij neni, brenda 2 (dy) muajve ose brenda afatit shtesë kur kërkohet afat shtesë, DPPI-ja refuzon kërkesën për regjistrimin e ndryshimit në regjistrë.

KREU VII RIPËRTËRITJA E DISENJOS

Neni 24

Paraqitja e kërkesës për ripërtëritjen e disenjës

1. Kërkesa për ripërtëritjen e disenjës, e parashikuar nga neni 128 i ligjit, paraqitet pranë DPPI-së nëpërmjet formularit të aplikimit “Për ripërtëritje disenjoje industriale”, i shoqëruar nga dokumenti i pagesës së tarifës përkatëse.

2. Në rastin e disenjave të shumëfishta, së bashku me kërkesën, duhet të depozitohet edhe autorizimi i përfaqësimit, kur ripërtëritja kërkohet për një ose disa disenjo që përmban regjistrimi.

3. Kërkesa për ripërtëritjen e disenjës, e përbërë nga formulari i aplikimit “Për ripërtëritje disenjoje industriale” dhe dokumenti i pagesës së tarifës përkatëse, duhet të depozitohet pranë DPPI-së, brenda periudhës gjashtëmujore, para datës së mbarimit të afatit të mbrojtjes së disenjës. Data e mbarimit të afatit të mbrojtjes së disenjës përbën ditën e fundit të këtij afati. Në rast se kërkesa nuk depozitohet brenda këtij afati, ajo mund të depozitohet brenda një periudhe kohe shtesë prej 6 (gjashtë) muajsh, nga data e përfundimit të afatit të mbrojtjes së disenjës, kundrejt pagesës së një tarife shtesë.

4. Në rastin e disenjave të shumëfishta, pronari i disenjës mund të kërkojë ripërtëritjen për të gjitha disenjet që përmban regjistrimi, ose për disa prej tyre.

5. Ripërtëritja i fillon efektet nga e nesërmeja e datës kur regjistrimi mbaron efektet.

Neni 25

Shqyrtimi i kërkesës për ripërtëritjen e disenjës nga DPPI-ja

1. DPPI-ja shqyrton kërkesën për ripërtëritjen e disenjës nëse është në përputhje me parashikimet e nenit 24 të kësaj rregulloreje dhe, në rast se ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet. Ky afat mund të zgjatet me 2 (dy) muaj shtesë kundrejt kërkesës dhe pagesës së tarifës për shtyrje afati.

2. Kur kërkesa për ripërtëritje nuk është depozituar ose është depozituar pas periudhës së përcaktuar në pikën 3, të nenit 24 të kësaj rregulloreje ose kur nuk janë paguar tarifat përkatëse, ose kur nuk janë rregulluar mangësitë e njoftuara, DPPI-ja njofton pronarin e disenjës se regjistrimi ka mbaruar efektet e mbrojtjes dhe do të bëjë pasqyrimin e këtij vendimi në regjistrin e disenjave.

3. Kur kërkesa për ripërtëritjen e disenjës është në përputhje me parashikimet e nenit 24 të kësaj rregulloreje, DPPI-ja e regjistron ripërtëritjen në regjistrin e disenjave dhe lëshon certifikatën e ripërtëritjes, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data kur aplikimi plotëson të gjitha kërkesat e nenit 128 të ligjit dhe kërkesat e nenit 24 të kësaj rregulloreje.

4. Certifikata e ripërtëritjes së disenjës përmban:

4.1 Emrin dhe adresën e pronarit të disenjës;

4.2 Numrin e kërkesës dhe numrin e regjistrimit të disenjës;

4.3 Datën e depozitimit, datën e mbarimit të mbrojtjes, datën e ripërtëritjes, si dhe datën e prioritetit (nëse ka);

4.4 Produktin që përfaqëson disenjoja, si dhe klasën dhe nënklasën e produktit, në përputhje me klasifikimin e Lokarnos;

4.5 Pamjet/paraqitjen e disenjës;

4.6 Datën e publikimit të disenjës;

4.7 Numrin e disenjave të përfshira në regjistrim në rastin e disenjave të shumëfishta;

4.8 Emrin dhe adresën e krijuesit të disenjës, përveç rastit kur krijuesi ka kërkuar që emri i tij të mos përmendet.

5. DPPI-ja bën publikimin e ripërtëritjes në Buletinin e Pronësisë Industriale.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KREU VIII DORËHEQJA NGA NJË DISENJO E APLIKUAR OSE E REGJISTRUAR

Neni 26

Paraqitja e kërkesës për dorëheqje nga disenjoja e aplikuar

1. Aplikanti ka të drejtë të heqë dorë nga aplikimi për disenjo, nëpërmjet një kërkesë me shkrim, në çdo kohë, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar mbi disenjon.
2. Nëse kërkesa për dorëheqje bëhet para se DPPI-ja të ketë ekzaminuar aplikimin për regjistrim disenjoje për formalitete, sipas pikës 2, të nenit 121 të ligjit, DPPI-ja do t'i kthejë aplikantit 80% të shumës së paguar në momentin e aplikimit.
3. Me depozitimin e një kërkesë të tillë, aplikimi konsiderohet i tërhequr. Dorëheqja bëhet efektive dhe nuk mund të revokohet nëse kërkesa për dorëheqje nuk është revokuar me një deklaratë tjetër brenda së njëjtës ditë nga aplikanti.
4. Në rastin e disenjove të shumëfishta, aplikanti mund të heqë dorë nga disa prej disenjove për të cilat është bërë aplikimi ose nga i gjithë aplikimi.

Neni 27

Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesës për dorëheqje nga disenjoja e regjistruar

1. Kërkesa për regjistrimin e dorëheqjes nga një disenjo e regjistruar, e parashikuar në nenin 137 të ligjit, paraqitet pranë DPPI-së nëpërmjet formularit të aplikimit “Për dorëheqje nga disenjoja industriale e regjistruar” nga pronari i disenjës së regjistruar.
2. Së bashku me kërkesën, aplikanti duhet të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:
 - 2.1 Dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse;
 - 2.2 Autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të disenjës;
 - 2.3 Kur në regjistrin e disenjove është regjistruar një kontratë licence për këtë disenjo, deklaratën e lëshuar nga i licencuari, ku ai pohon se është në dijeni të kërkesës për dorëheqje, në përputhje me parashikimin e pikës 2, të nenit 137 të ligjit;
 - 2.4 Kur ka filluar një procedurë gjyqësore për të drejtën për mbrojtjen e disenjës, deklaratën e lëshuar nga paditësi, ku ai deklaron se është dakord për regjistrimin e dorëheqjes, në përputhje me parashikimin e pikës 2, të nenit 137 të ligjit.
3. DPPI-ja shqyrton kërkesën për dorëheqje, nëse është në përputhje me parashikimet e pikave 1 e 2 të këtij neni dhe, në rast se ka të meta, njofton aplikantin të bëjë plotësimet e nevojshme brenda 3 (tre) muajve nga data e njoftimit, në të kundërt kërkesa refuzohet.
4. DPPI-ja e regjistron dorëheqjen në regjistrin e disenjove dhe njofton aplikantin për regjistrimin e dorëheqjes brenda 3 (tre) muajve nga data kur aplikimi plotëson të gjitha kërkesat e pikave 1 e 2 të këtij neni. Njoftimi për regjistrimin e dorëheqjes publikohet në Buletinin e Pronësisë Industriale.
5. Në rastin kur disenjoja e regjistruar është disenjo e shumëfishtë, pronari i saj mund të kërkojë heqjen dorë për të gjitha disenjot ose për disa prej tyre, duke deklaruar në momentin e aplikimit se nga cilat disenjo kërkon të heqë dorë.

KREU IX PROCEDIMET PRANË DHOMËS PËR SHFUQIZIM/ZHVLERËSIM DHE SHFUQIZIMI I DISENJOS

Neni 28

Përmbajtja e kërkesës për shfuqizimin e një disenjoje industriale

1. Për çdo kërkesë për shfuqizimin e një disenjoje industriale, duhet të depozitohet kërkesë më vetë.
2. Kërkesa për shfuqizimin e një disenjoje industriale duhet të përmbajë:
 - 2.1 Formularin e aplikimit “Për shfuqizimin e një disenjoje të regjistruar”, në të cilin do të jenë të specifikuar të dhënat e mëposhtme:
 - 2.1.1 Numri i regjistrimit të disenjës industriale në lidhje me të cilën është depozituar kërkesa;
 - 2.1.2 Emri dhe adresa e pronarit të disenjës industriale;
 - 2.1.3 Emri dhe adresa e përfaqësuesit që depoziton kërkesën;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- 2.1.4 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar nëse është caktuar një i tillë;
- 2.1.5 Produktet për të cilat është depozituar kërkesa;
- 2.1.6 Nënshkrimi dhe/ose vula e personit që depozitoi kërkesën ose përfaqësuesi i tij të autorizuar;
- 2.2 Argumentet dhe baza ligjore ku mbështetet kërkesa për shfuqizim;
- 2.3 Provat në lidhje me bazën ligjore ku mbështetet kërkesa për shfuqizimin e disenjës;
- 2.4 Autorizimin e përfaqësimit, nëse kërkuar ka caktuar një përfaqësues;
- 2.5 Mandatpagesën e tarifës përkatëse.
- 3. Kërkesa për shfuqizimin e disenjës duhet të depozitohet në dy kopje të njëjta.

Neni 29

Shqyrtimi i kërkesave për shfuqizim të disenjës së regjistruar

1. Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim shqyrton kërkesën për shfuqizimin e një disenjeje brenda një periudhe dymujore nga data e paraqitjes së saj. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për shfuqizimin e një disenjeje të regjistruar, Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim fton palët, për aq sa të jetë e nevojshme, që të depozitojnë pretendimet e tyre, brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit, në lidhje me komunikimet e paraqitura nga palët e tjera ose të bëra nga vetë Dhoma për Shfuqizim/ Zhvlerësim.

2. Nëse Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim e konsideron të arsyeshme, ajo mund t'i ftojë palët të bëjnë një zgjidhje me mirëkuptim nëpërmjet një marrëveshjeje, e cila, nëse arrihet, duhet të jetë me shkrim dhe e nënshkruar nga të dyja palët.

3. Vendimi i DPPI-së për shfuqizimin e disenjës së regjistruar do të publikohet dhe do të regjistrohet në regjistrin e disenjave kur të marrë formë të prerë.

KREU X

RIVENDOSJA NË AFAT E TË DREJTAVE

Neni 30

Paraqitja e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës

1. Në përputhje me parashikimin e nenit 122/b të ligjit, aplikanti i një aplikimi për regjistrim disenjeje ose përfaqësuesi i tij mund të kërkojë rivendosjen në afat të së drejtës brenda 2 (dy) muajve nga mënjanimi i shkakut të mosrespektimit të afatit, por jo më vonë se 1 (një) vit nga mbarimi i afatit të humbur. Kërkesa me shkrim përmban:

1.1 Formularin e aplikimit “Për rivendosje në afat të të drejtave mbi disenjon industriale”, me të dhënat e mëposhtme:

- 1.1.1 Numrin e aplikimit të disenjës, për të cilën është depozituar kërkesa për rivendosje në afat;
- 1.1.2 Emrin dhe adresën e aplikantit të aplikimit për disenjon, për të cilën është kërkuar rivendosje në afat;
- 1.1.3 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse aplikanti ka caktuar një të tillë;
- 1.1.4 Shkaqet/arsyet e mosrespektimit të afatit;
- 1.1.5 Nënshkrimi dhe/ose vula e aplikantit ose përfaqësuesit të tij.
- 1.2 Mandatin e pagesës së tarifës përkatëse;
- 1.3 Autorizimin e përfaqësimit, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i aplikantit.

Neni 31

Shqyrtimi i kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës

1. DPPI-ja shqyrton kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës brenda një afati njëmuor nga data e paraqitjes së saj, nëse është në përputhje me parashikimet e nenit 122/b të ligjit dhe të nenit 30 të kësaj rregulloreje.

2. Në rast se DPPI-ja e pranon kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës, njofton me shkrim aplikantin e disenjës për rivendosjen në afat të së drejtës dhe afatin brenda të cilit ai duhet të plotësojë të metat dhe e publikon atë në Buletinin Zyrtar. Refuzimi i bërë nga DPPI-ja shfuqizohet dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën në përputhje me ligjin.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Në rast se kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 122/b të ligjit dhe të nenit 30 të kësaj rregulloreje, DPPI-ja e refuzon kërkesën për rivendosjen në afat dhe njofton me shkrim aplikantin.

4. Vendimi i DPPI-së për refuzimin e rivendosjes në afat të së drejtës mund të apelohej në Bordin e Apelit, brenda 1 (një) muaji nga data e marrjes së vendimit të refuzimit.

Neni 32

Rivendosja në afat kur bëhet fjalë për prioritet

1. Kur dokumenti i parashikuar sipas pikës 2, të nenit 120, të ligjit nuk është depozituar pranë DPPI-së brenda afatit kohor të caktuar, aplikanti ka të drejtë të kërkojë rivendosjen në afat të së drejtës prioritare, nëse:

1.1 Deklarata për prioritet është paraqitur pranë DPPI-së në përputhje me kërkesat e nenit 8 të kësaj rregulloreje;

1.2 Kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës, së bashku me kopjen e aplikimit më të hershëm, është depozituar pranë DPPI-së brenda periudhës së parashikuar nga pika 3, e nenit 8 të kësaj rregulloreje.

2. Kërkesa për rivendosje në afat të së drejtës shoqërohet me dokumentin që tregon shkaqet që çuan në mosrespektimin e periudhës së prioritetit, pavarësisht marrjes së masave të nevojshme.

KREU XI

APELIMI

Neni 33

Apelimi i vendimeve në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim

1. Çdo vendim për refuzim, që merret gjatë procesit të ekzaminimit, mund të apelohej në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim brenda 1 (një) muaji nga data e marrjes njoftim, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në ligj ose në këtë rregullore, duke depozituar dokumentet e mëposhtme:

1.1 Formularin e aplikimit “Për apelimin e vendimit të refuzimit në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim”, që përmban:

1.1.1 Emrin dhe adresën e apeluesit, në përputhje me nenin 46 të kësaj rregulloreje;

1.1.2 Vendimin e DPPI-së ndaj të cilit është depozituar apelimi;

1.1.3 Numrin e aplikimit ose regjistrimit të disenjës;

1.1.4 Një të dhënë që tregon nëse është apeluar vendimi i DPPI-së në tërësi apo një pjesë e tij.

1.1.5 Nënshkrimin e apeluesit ose përfaqësuesit të tij.

1.2 Dokumentin e pagesës së tarifës për apelimin;

1.3 Arsyet për të cilat është depozituar apelimi, i shoqëruar me provat mbështetëse;

1.4 Autorizimin e përfaqësimit, nëse apelimi paraqitet nga përfaqësuesi i aplikantit.

Neni 34

Shqyrtimi i kërkesës nga Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim

1. Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim shqyrton kërkesën për apelim brenda 2 (dy) muajve nga data e paraqitjes. Nëse apelimi nuk është depozituar brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 33, ose nuk përmbush kërkesat e pikave 1.1 e 1.2, të nenit 33, të kësaj rregulloreje, Dhoma njofton me shkrim apeluesin se kërkesa e tij konsiderohet e paparaqitur. Nëse apelimi nuk përmbush kërkesat e pikave 1.3 e 1.4, të nenit 33, Dhoma njofton me shkrim apeluesin të plotësojë të metat brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit.

2. Dhoma refuzon kërkesën për apelim, nëse apeluesi nuk përmbush të metat sipas njoftimit, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dhe njofton apeluesin për vendimin e refuzimit. Kur apelimi përmbush kërkesat e nenit 33 të kësaj rregulloreje, Dhoma shqyrton kërkesën për apelim brenda një periudhe dymujore nga data e paraqitjes së tij dhe njofton apeluesin për vendimin e marrë.

3. Apeluesi ka të drejtë të ankimojë në Bordin e Apelit vendimin e Dhomës, në përputhje me parashikimin e paragrafit 4, të nenit 126, të ligjit dhe paguan tarifën përkatëse.

4. Gjatë shqyrtimit, Dhoma ka të drejtë t'i kërkojë apeluesit të vendimit të paraqesë materiale dhe dokumente të tjera shtesë, brenda një periudhe njëmujore nga data e njoftimit.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

5. Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim, kur shqyrton një kërkesë, në përputhje me kompetencat përkatëse të parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore, duhet të shprehet me pranim, pranim të pjesshëm ose rrëzim të kërkesës objekt shqyrtimi.

Neni 35

Trajtimi i aplikimit pas marrjes së vendimit mbi apelin

1. Kur dhoma vendos të pranojë apelin dhe vendimi nuk apelohehet në Bordin e Apelit, një kopje e këtij vendimi depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e disenjës dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën për regjistrimin e disenjës, në përputhje me parashikimet e ligjit dhe kësaj rregulloreje.

2. Kur dhoma vendos të rrëzojë apelin dhe vendimi nuk apelohehet në Bordin e Apelit, një kopje e vendimit të Dhomës depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e disenjës dhe refuzimi merr formë të prerë.

3. Në rast se vendimi i Dhomës apelohehet në Bordin e Apelit, një kopje e vendimit përfundimtar të Bordit të Apelit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e disenjës dhe DPPI-ja refuzon ose regjistron disenjën në përputhje me vendimin e Bordit.

4. Në rast se vendimi i Bordit të Apelit apelohehet në gjykatë, një kopje e vendimit përfundimtar të gjykatës depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e disenjës dhe DP PI-ja refuzon ose regjistron disenjën në përputhje me vendimin e gjykatës.

Neni 36

Apelimi i vendimeve në Bordin e Apelit

1. Vendimet që mund të apelohehen në Bordin e Apelit janë:

1.1 Vendimet e marra nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve;

1.2 Vendimet e marra nga Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim;

1.3 Vendimet për rivendosjen në afat të së drejtës.

2. Apelimi i një vendimi sjell si pasojë pezullimin e ndjekjes së mëtejshme të procedurës përkatëse.

3. Vendimet e parashikuara më lart hyjnë në fuqi pasi marrin formë të prerë.

Neni 37

Paraqitja e kërkesës për apelim në Bordin e Apelit

1. Procedura e apelit në Bordin e Apelit fillohet nëpërmjet depozitimit të dokumenteve të mëposhtme:

1.1 Formularin e aplikimit “Për apelin e vendimeve në Bordin e Apelit”, që përmban:

1.1.1 Emrin dhe adresën e apellesit në përputhje me nenin 46 të kësaj rregulloreje;

1.1.2 Vendimin e DPPI-së ndaj të cilit është depozituar apelimi;

1.1.3 Numrin e aplikimit ose të regjistrimit të disenjës;

1.1.4 Një e dhënë që tregon nëse është apeluar vendimi i DPPI-së në tërësi apo një pjesë e tij;

1.1.5 Nënshkrimin e apellesit ose përfaqësuesit të tij;

1.2 Dokumentin e pagesës së tarifës për apelin;

1.3 Argumentet dhe/ose provat mbi të cilat mbështetet apelimi;

1.4 Autorizimin e përfaqësimit, nëse apelimi paraqitet nga përfaqësuesi i aplikantit.

2. Kërkesa për apelim duhet të depozitohet në dy kopje të njëjta.

Neni 38

Shqyrtimi i kërkesave nga Bordi i Apelit

1. Sekretari i Bordit të Apelit, brenda 1 (një) muaji nga data e paraqitjes së kërkesës për apelim, kontrollon kërkesën nëse përmban dokumentet e parashikuara në nenin 37 të kësaj rregulloreje.

2. Kur një kërkesë për apelim është paraqitur në përputhje me nenin 37 të kësaj rregulloreje, sekretari i Bordit të Apelit i dërgon palës kundër së cilës është paraqitur apelimi, një kopje të kërkesës për apelim, si dhe e njofton atë të paraqesë brenda 2 (dy) muajve nga data e marrjes së njoftimit, argumentet dhe çdo dokument tjetër lidhur me apelin.

3. Në rast se një kërkesë për apelim nuk është paraqitur në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 37

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

të kësaj rregulloreje, sekretari i Bordit të Apelit e njofton me relacion me shkrim Bordin e Apelit, i cili refuzon kërkesën për apelim dhe njofton apeluesin për vendimin e marrë.

4. Sekretari i Bordit të Apelit, brenda 1 (një) muaji nga mbarimi i afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, i paraqet për shqyrtim Bordin të Apelit kërkesën për apelim.

5. Bordin i Apelit e shqyrton një kërkesë brenda 3 (tre) muajve nga data e paraqitjes së saj në Bord.

6. Gjatë shqyrtimit të një kërkesë, Bordin i Apelit, kur e konsideron të arsyeshme ka të drejtë t'u kërkojë palëve, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të paraqesin prova dhe dokumente të tjera shtesë, brenda një periudhe të arsyeshme, por, në çdo rast, jo më vonë se 1 (një) muaj nga data e marrjes së njoftimit nga pala.

7. Nëse Bordin i Apelit e konsideron të arsyeshme, i fton palët në seanca dëgjimore, si dhe u kërkon atyre të gjejnë një zgjidhje me mirëkuptim, e cila, nëse arrihet, duhet të materializohet në një marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët para noterit ose para Bordit të Apelit.

8. Sekretari i Bordit të Apelit i njofton palët e interesuara menjëherë pas marrjes së vendimit të Bordit të Apelit, por, në çdo rast, jo më vonë se 1 (një) muaj nga marrja e vendimit.

9. Bordin i Apelit, kur shqyrton një kërkesë, në përputhje me kompetencat përkatëse të parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore, duhet të shprehet me pranim, parim të pjesshëm ose rrëzim të kërkesës objekt shqyrtimi.

Neni 39

Efekti i vendimeve

1. Vendimi i Bordit të Apelit merr formë të prerë nga e nesërmja e datës së mbarimit të afatit për ankim në gjykatë, kur asnjë nga palët nuk ka bërë ankim kundër vendimit të Bordit.

2. Kur vendimi i Bordit të Apelit ose vendimi i gjykatës merr formë të prerë, DPPI-ja ekzekuton vendimin sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në rast ankimi të vendimit të Bordit të Apelit në gjykatë, ankimuesi ka detyrimin të njoftojë DPPI-në brenda 1 (një) muaji nga data e depozitimit të ankimit në gjykatë, me qëllim që të evitohet ekzekutimi i vendimit të Bordit të Apelit.

KREU XII

APLIKIME PËR REGJISTRIM NDËRKOMBËTAR TË DISENJOVE INDUSTRIALE

Neni 40

Paraqitja e aplikimeve për regjistrim ndërkombëtar

1. Aplikimi ndërkombëtar depozitohet në përputhje me kërkesat e marrëveshjes së Hagës dhe duhet të përmbajë:

1.1 Formularin e përcaktuar nga Byroja Ndërkombëtare e WIPO-s me specifikimet e mëposhtme:

1.1.1 Emrin dhe adresën e aplikantit;

1.1.2 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të aplikantit;

1.1.3 Numrin e aplikimit ose të regjistrimit të disenjës mbi të cilin bazohet aplikimi për regjistrim ndërkombëtar;

1.1.4 Paraqitjen/pamjen e disenjës, e cila duhet të jetë identike si në aplikimin ose regjistrimin kombëtar;

1.1.5 Të dhëna në lidhje me prioritetin, nëse është pretenduar për prioritet ose kur pretendohet prioritet nga ekspozita ndërkombëtare, të dhënat e ekspozitës zyrtare ndërkombëtare;

1.1.6 Klasa dhe nënklasa sipas klasifikimit të Lokarnos;

1.1.7 Numri i disenjave të përfshira në aplikimin ndërkombëtar në rastin e disenjave të shumëfishta;

1.1.8 Vendet anëtare të Unionit për të cilat kërkohet shtrirja e regjistrimit ndërkombëtar;

1.1.9 Përshkrimi i disenjës, ku do të përshkruhen vetëm karakteristikat e disenjës industriale që shfaqen në riprodhimet e saj. Përveç kësaj, materiali që shfaqet për riprodhim, por për të cilin mbrojtja nuk kërkohet, mund të tregohet në përshkrimin e saj. Në përshkrim mund të tregohet përdorimi i mundshëm i disenjës për sa kohë nuk është teknik. Ky përshkrim nuk mund t'i kalojë 100 fjalë, pasi ka kosto shtesë. Përshkrimi i disenjës duhet të jetë i njëjtë me përshkrimin e bërë në aplikimin apo regjistrimin kombëtar;

1.1.10 Identiteti i krijuesit/krijuesve;

1.1.11 Publikimi i regjistrimit ndërkombëtar, nëse aplikanti përzgjedh një nga opsionet e tjera, përveç atij të përcaktuar tashmë në formularin e aplikimit për regjistrim diseno ndërkombëtare;

1.1.12 Nënshkrimi dhe/ose vula e aplikantit ose e përfaqësuesit të tij.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

1.2 Mandatet e pagesave të tarifave përkatëse.

1.3 Formulari i përmendur në pikën 1.1 të këtij neni duhet të paraqitet në 2 (dy) kopje të njëjta.

Neni 41

Kërkesa të tjera në lidhje me aplikimin për regjistrim ndërkombëtar

1. Regjistrimi ndërkombëtar përfundon nëse disenjoja industriale nuk është më e mbrojtur në Republikën e Shqipërisë.

2. Kërkesa për regjistrim ndërkombëtar duhet t'i referohet një disenjoje industriale të aplikuar ose të regjistruar në DPPI.

3. Përpara se të aplikohet për regjistrim ndërkombëtar të disenjove industriale, duhet të kryhet aplikimi për regjistrimin kombëtar në Regjistrin Kombëtar të Disenjove Industriale.

4. Të gjitha të dhënat e përfshira në aplikimin për regjistrim ndërkombëtar duhet të përputhen plotësisht me të dhënat në Regjistrin Kombëtar të disenjove industriale.

5. Tarifa për regjistrimin ndërkombëtar parashikohet në marrëveshjen Hagës dhe kryhet në Byronë Ndërkombëtare.

6. Tarifa për marrjen, verifikimin dhe transmetimin e kërkesës për regjistrim ndërkombëtar depozitohet në llogarinë e DPPI-së.

7. Formulari i aplikimit dhe formularët e tjerë zyrtarë gjenden në faqen e Byrosë Ndërkombëtare për Pronësinë Intelektuale.

KREU XIII

DOKUMENTE TË TJERA QË LËSHON DPPI-JA LIDHUR ME DISENJOT INDUSTRIALE

Neni 42

Ekstraktet dhe hetimet e lëshuara nga regjistri i disenjove

1. Në zbatim të pikës 2, të nenit 192 dhe nenit 194 të ligjit, DPPI-ja u lëshon personave të interesuar ekstrakte nga regjistri i disenjove, si dhe përgjigje të kërkesave për hetim.

2. Kërkesa për ekstrakt regjistri për një disenjo të regjistruar paraqitet pranë DPPI-së me shkrim, shoqëruar me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, në të kundërt kërkesa konsiderohet e paparaqitur. Ekstrakti i regjistrit lëshuar nga DPPI-ja përmban të gjitha të dhënat e disenjës dhe historikun e ndryshimeve që ka pësuar ajo.

3. Kërkesa për hetim, në lidhje me një disenjo, paraqitet pranë DPPI-së me shkrim, shoqëruar me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, në të kundërt kërkesa konsiderohet e paparaqitur.

4. DPPI-ja njofton me shkrim paraqitësin e kërkesës lidhur me rezultatin e hetimit.

Neni 43

Dublikatat dhe dokumenti i prioritetit

1. Pronari i një disenjoje të regjistruar ka të drejtë të kërkojë dublikatë të certifikatës së regjistrimit të disenjës, të certifikatës së ripërtëritjes së saj ose të njoftimeve të tjera të lëshuara nga DPPI-ja për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e disenjove.

2. Kërkesa për dublikatë bëhet me shkrim dhe duhet të shoqërohet me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, si dhe me autorizimin e përfaqësimit kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të disenjës, në të kundërt, kërkesa konsiderohet e paparaqitur.

3. Aplikanti, i cili ka depozituar pranë DPPI-së një aplikim për regjistrimin e një disenjoje, ka të drejtë të kërkojë dokument prioriteti për disenjon, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e disenjës, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

4. Dokumenti i prioritetit, që lëshohet nga DPPI-ja, përmban të dhënat e mëposhtme:

4.1 Datën dhe numrin e depozitimit;

4.2 Emrin dhe adresën e aplikantit;

4.3 Emrin dhe adresën e krijuesit të disenjës;

4.4 Produktin që përfaqëson disenjoja, si dhe klasën dhe nënklasën e produktit, në përputhje me klasifikimin e Lokarnos;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

4.5 Numrin e disenjove të përfshira në aplikim, në rastin e disenjove të shumëfishta;

4.6 Përfaqësimin (riprodhimin) e disenjës sipas pamjeve të depozituara nga aplikanti.

Neni 44

Inspektimi i dosjes për disenjon e regjistruar

1. Dosja e një aplikimi për regjistrim disenjoje ende të papublikuar nuk mund të inspektohet pa pëlqimin e aplikantit.

2. Pas publikimit të aplikimit për disenjo, dosja që lidhet me këtë aplikim dhe disenjoja që rezultojnë prej saj mund të inspektohen pas depozitimit të një kërkesë me shkrim dhe kryerjes së pagesës përkatëse.

3. Kur dosjet inspektohen sipas pikës 2 të këtij neni, dokumentet në lidhje me përjashtimin ose kërkesën për përjashtim të një anëtarit të Dhomës së Kundërshtimeve ose Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim apo të Bordit të Apelit për shkak të konfliktit të interesit, draftet e vendimeve dhe opinioneve, si dhe të gjitha dokumentet e brendshme të përdorura për përgatitjen e vendimeve dhe mendimeve, ashtu si dhe pjesët e dosjes për të cilat pala e interesuar tregon një interes të veçantë për ruajtjen e konfidencialitetit, përpara se të jetë depozituar kërkesa për inspektim të dosjes, ndalohen për inspektim, përveçse kur inspektimi i këtyre dokumenteve të dosjes justifikohet nga interesi legjitim thelbësor i palës që kërkon inspektim.

4. Inspektimi i dosjes së një aplikimi për regjistrim disenjo dhe/ose të një disenjoje të regjistruar do të bëhet me dokumente origjinale, kopje të tyre ose me mjete ose pajisje të tjera teknike të ruajtjes.

5. Inspektimi i dosjeve duhet të zhvillohet në mjediset e DPPI-së. Mbështetur në një kërkesë me shkrim, inspektimi i dosjeve shoqërohet me lëshimin e kopjeve të dokumenteve të dosjes. Lëshimi i këtyre kopjeve kushtëzohet me kryerjen e pagesës së tarifës përkatëse. Mbështetur në kërkesën me shkrim dhe kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, DPPI-ja lëshon edhe kopje të vërtetuara ose të pavërtetuara të aplikimit për regjistrim disenjoje.

6. Kur dosjet inspektohen sipas pikës 5 të këtij neni, kërkesa për inspektim të dosjes do të konsiderohet si e padepozituar deri në momentin që do të kryhet pagesa e tarifës përkatëse.

7. Në përputhje me kufizimet e vendosura në pikën 3 të këtij neni, si dhe bazuar në një kërkesë me shkrim, DPPI-ja mund të japë informacion nga çdo dosje që i përket një aplikimi për disenjo ose disenjës së regjistruar, pas kryerjes së pagesës së tarifës për hetim.

Neni 45

Shfuqizimi ose ndryshimi i akteve administrative me gabime

1. Aplikanti mund të kërkojë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim, korrigjimin e gabimeve ose pasaktësive që përmban aplikimi për regjistrimin e disenjës, kur këto kanë të bëjnë me emrin ose adresën e aplikantit, të krijuesit ose të përfaqësuesit të aplikantit apo të pasaktësive të tjera, të cilat nuk cenojnë thelbin e elementeve të aplikimit, për aq kohë sa aplikimi nuk është regjistruar në regjistrin e disenjove.

2. Në rastin e lëshimit nga DPPI-ja të akteve që përmbajnë gabime ose pasaktësi, jo për fajin e aplikantit ose të pronarit të disenjës, korrigjimi i tyre bëhet nga DPPI-ja me nismën e saj ose në bazë të një kërkesë me shkrim, të paraqitur nga aplikanti ose pronari i disenjës. DPPI-ja rilëshon aktin e korrigjuar, pasi aplikanti ose pronari i disenjës ka dorëzuar pranë DPPI-së origjinalin e aktit për të cilin kërkohet korrigjimi dhe bën pasqyrimin e korrigjimit në regjistrin e disenjove, si dhe e publikon atë në Buletinin e Pronësisë Industriale.

3. Kërkesa për korrigjimin e një gabimi të bërë në aplikim ose në dokumentet e tjera të dorëzuara në DPPI, të paraqitura nga aplikanti ose pronari, sipas rastit, përmban:

3.1 Numrin dhe datën e depozitimit të kërkesës me të cilën ka të bëjë kërkesa për të korrigjuar gabimin;

3.2 Emrin dhe adresën e aplikantit ose pronarit;

3.3 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse është caktuar një i tillë;

3.4 Disenjon e kërkuar për korrigjimin e gabimeve dhe korrigjimin e propozuar;

3.5 Nënshkrimin e kërkesës ose, sipas rastit, të përfaqësuesit.

4. Kërkesa për korrigjimin e gabimit konsiderohet e paraqitur vetëm pasi paguhet shuma e përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për tarifat për objektet e pronësisë industriale.

5. Nëse kërkohet korrigjimi i gabimit të njëjtë në shumë aplikime të paraqitura nga i njëjti aplikant, mjafton paraqitja e një kërkesë të vetme për korrigjimin e gabimit, që tregon numrin dhe datën e aplikimeve me të cilat ai lidhet. Pagesa e tarifës së përcaktuar në rregulloren përkatëse duhet të kryhet për çdo aplikim më vete. Dokumenti origjinal i pagesës i bashkëngjitet çdo aplikimi.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

6. DPPI-ja mund të kërkojë paraqitjen e provave shtesë mbi vërtetësinë e gabimit të raportuar.
7. Çdo korrigjim i bërë në një aplikim për diseno të publikuar, duhet të publikohet në Buletinin e radhës të Pronësisë Industriale.

KREU XIV KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 46 Emri dhe adresa

1. Në komunikimet që depozitohen para DPPI-së, emri dhe adresa e aplikantit duhet të tregohen në mënyrën e mëposhtme:

1.1 Nëse aplikanti, kundërshtuesi ose personi që depoziton kërkesën është person fizik: emri, mbiemri, adresa, qyteti, shteti;

1.2 Nëse aplikanti, kundërshtuesi ose personi që depoziton kërkesën është person juridik: emrin e shoqërisë, adresa, qyteti, shteti.

2. Në komunikimet që depozitohen pranë DPPI-së, emri dhe adresa e përfaqësuesit të autorizuar duhet të tregohen në mënyrën që vijon: emri, mbiemri, adresa, qyteti, shteti dhe/ose kodi i përfaqësuesit.

3. Kur një aplikim është depozituar nga disa aplikantë, korrespondenca në lidhje me aplikimin do të dërgohet në adresat e secilit aplikant, përveçse kur ata kanë caktuar një përfaqësues të autorizuar.

4. Aplikanti mund të deklarojë mënyra të tjera kontakti, si: numër telefoni, *fax*, adresë *e-mail*-i.

5. Parashikimet e këtij neni, si dhe të neneve 47 e 48 të kësaj rregulloreje, do të aplikohen gjithashtu, për korrespondencat që i komunikohen Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim, si dhe Bordit të Apelit.

6. Në të gjithë formularët e disenjove do të parashikohet rubrika me tekstin e mëposhtëm:

“Unë i/e nënshkruari/a pranoj që DPPI-ja mund të më kontaktojë nëpërmjet mjeteve vijuese të komunikimit për çështje të lidhura me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij nëpërmjet:

- ☐ Postës elektronike (*e-mail*), në adresën vijuese: _____;
- ☐ Komunikimit (SMS, telefonatë), në numrin vijues: _____;
- ☐ *Fax*-it, në numrin vijues: _____.”.

DPPI-ja njofton se shënimi i të dhënave të mësipërme të kontaktit është vullnetar. DPPI-ja do të ruajë këto të dhëna (në vijim, të dhënat personale), që aplikanti dhe/ose personi i autorizuar (në vijim, subjekti) kanë shënuar në këtë formular aplikimi.

Të dhënat personale do të përpunohen e përdoren nga DPPI-ja, në cilësinë e kontrolluesit apo nga persona të tretë të caktuar nga DPPI-ja, në cilësinë e përpunuesit, ekskluzivisht për të komunikuar me subjektin, për sa u përket procedurave të lidhura me këtë aplikim. Të dhënat personale nuk do t'i kalohen një marrësi të tretë pa pëlqimin paraprak të subjektit dhe nuk do t'i nënshtrohen transferimit ndërkombëtar. Gjithashtu, DPPI-ja mund të përdorë herë pas here të dhënat personale për të kontaktuar subjektin dhe për t'i dërguar informacione që mund të jenë në interes të tij/saj, të tilla, si: njoftime, ngjarje dhe/ose zhvillime ligjore në fushën e veprimtarisë së DPPI-së.

DPPI-ja do të ndalojë dërgimin e këtij informacioni nëse subjekti njofton shprehimisht me shkrim DPPI-në, se ai/ajo nuk dëshiron të kontaktohet më tej për të marrë informacione të tilla.

Subjekti ka të drejtën e aksesit, bllokimit, korrigjimit ose fshirjes së të dhënave personale, që DPPI-ja ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrojë çdo të drejtë tjetër që i njihet nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Data _____._____.

_____ (emri, mbiemri, firma)

Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi jep pëlqimin që DPPI-ja të ruajë, të përpunojë e përdorë të dhënat personale të subjektit, në pajtim me kushtet e mësipërme. Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi, gjithashtu, deklaron, nën përgjegjësinë e tij/saj, se të dhënat e kontaktit si më sipër janë të dhënat e tij/saj, ose të një personi të tretë, që ka autorizuar nënshkruesin të kryejë këto veprime.

7. Në të gjithë formularët e disenjove që do të depozitohen në DPPI, do të vendoset adresa e zyrës dhe logoja e saj.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 47

Kërkesa lidhur me korrespondencën

1. DPPI-ja do të pranojë vetëm nënshkrimet me dorë në dokumentet e depozituara pranë saj.
2. Nëse një komunikim me DPPI-në përmban disa dokumente që kanë të bëjnë me disa aplikime, atëherë në çdo dokument duhet të shënohet numri i aplikimit me të cilin lidhet dokumenti.

Neni 48

Depozitimi i dokumenteve

1. Korrespondenca me DPPI-në bëhet dorazi ose me postë.
2. Kërkesa ose çdo lloj dokumenti tjetër që depozitohet pranë DPPI-së duhet të jetë me shkrim dhe e përkthyer në gjuhën shqipe.

Neni 49

Njoftimi dhe dërgimi i dokumenteve

1. Data e njoftimit të një dokumenti do të konsiderohet data e marrjes në dorëzim të njoftimit nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij. Afatet e njoftimit do të llogariten duke filluar nga e nesërmja e marrjes në dorëzim e njoftimit.
2. Çdo njoftim, dërguar përfaqësuesit, do të ketë të njëjtin efekt si t'i jetë dërguar personit të përfaqësuar.
3. Çdo komunikim i adresuar DPPI-së nga një përfaqësues do të konsiderohet si të jetë dërguar nga personi i përfaqësuar.
4. Nëse është caktuar një përfaqësues i autorizuar, DPPI-ja do t'i dërgojë të gjitha njoftimet këtij të fundit.

Neni 50

Autorizimi i përfaqësimit

1. Autorizimi i përfaqësimit duhet të përmbajë:
 - 1.1 Nënshkrimin e aplikantit të vërtetuar nga noteri, kur aplikanti është person fizik shqiptar ose i huaj;
 - 1.2 Nënshkrimin dhe vulën ose nënshkrimin e vërtetuar nga noteri, kur aplikanti është person juridik shqiptar ose i huaj.
2. Nëse autorizimi i përfaqësimit nuk është në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore, DPPI-ja njofton përfaqësuesin që e ka depozituar aplikimin për të plotësuar të metat brenda 3 (tre) muajsh nga dita e marrjes së njoftimit.
3. Nëse personi, i cili ka depozituar autorizimin e përfaqësimit nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar në njoftimin e DPPI-së, sipas pikës 2 të këtij neni, DPPI-ja refuzon aplikimin.
4. DPPI-ja regjistron në regjistrin e disenjove një përfaqësues të autorizuar në lidhje me një disenjo, kur përfaqësuesit i jepen me autorizim të drejta në ndjekjen e procedurave dhe kryerjen e veprimeve, që parashikohen në ligj dhe rregullore lidhur me disenjot.
5. Për veprimet dhe ndjekjen e procedurave në lidhje me një disenjo, përfaqësuesi i regjistruar, sipas paragrafit të mëparshëm, nuk ka nevojë të depozitojë autorizimin origjinal, por një fotokopje të tij.
6. Kur aplikanti ose pronari i një disenjoje revokon ose ndryshon autorizimin e përfaqësimit, ai duhet të depozitojë në DPPI kërkesën për revokim ose ndryshimin e autorizimit, si dhe për caktimin e përfaqësuesit të ri. Kërkesa regjistrohet në regjistrin e disenjove, sipas pikës 4 të këtij neni.

Neni 51

Seancat dëgjimore

1. Kur konsiderohet e nevojshme, DPPI-ja ose Bordi i Apelit zhvillon seanca dëgjimore, si dhe thërret palët të marrin pjesë në seanca.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 52

Marra e provave

1. Marra dhe sigurimi i provave nga DPPI-ja dhe Bordi i Apelit përbëhet nga:
 - 1.1 Dëgjimi i palëve;
 - 1.2 Kërkimi i informacionit shtesë palëve;
 - 1.3 Depozitimi i dokumenteve dhe i provave;
 - 1.4 Dëgjimi i personave të tjerë kur çmohet e nevojshme nga DPPI-ja, Bordi i Apelit ose me kërkesë të palëve.

VENDIM

Nr. 315, datë 31.5.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MARKAT¹

(ndryshuar me vendimin nr. 543, datë 29.7.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 143, 151/c, 152, 155, 163/a, 163/b, 175/a e 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore për markat, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Vendimi nr. 1706, datë 29.12.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullore për regjistrimin e markave tregtare dhe të shërbimit”, të ndryshuar, shfuqizohet.
 3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

RREGULLORE PËR MARKAT

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Rregullorja për regjistrimin e markave ka si qëllim të zbatojë dhe të përcaktojë në mënyrë të detajuar çështje të caktuara të parashikuara në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, për sa u takon procedurave në lidhje me markat, të ndjekura nga DPPI-ja.

Neni 2

Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termet e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Rregullorja”, kjo rregullore për markat;
2. “Ligji”, ligji nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar;
3. “Zyra”, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (në vijim “Zyra” ose “DPPI”);
4. “Buletini Zyrtar”, Buletini Zyrtar i Pronësisë Industriale;
5. “Klasifikimi i Nicës” klasifikimi ndër-kombëtar i mallrave dhe shërbimeve, në funksion të regjistrimit të markave, i miratuar me marrëveshjen e Nicës, më 15 korrik 1957, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. Fletore Zyrtare nr. 82. Tiranë, 2018. f. 5118

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

6. “Kodet INID”, kodet e themeluara nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI ose WIPO) (standardet e WIPO-s, ST.60 dhe ST.3), për të identifikuar të dhënat bibliografike lidhur me markat;
7. “Klasifikimi i Vjenës”, klasifikimi i elementeve figurative të markës në përputhje me klasifikimin e miratuar nga marrëveshja e Vjenës;
8. “Rregullore e përbashkët”, rregullorja sipas marrëveshjes së Madridit për regjistrimet ndërkombëtare të markave dhe protokollit, që lidhet me këtë marrëveshje;
9. “Marrëveshja e Madridit”, marrëveshja e datës 14.4.1891, për regjistrimin ndërkombëtar të markave, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme;
10. “Protokolli i Madridit”, protokollin lidhur me marrëveshjen e Madridit, miratuar më 27.6.1989, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme;
11. “Zyra Ndërkombëtare”, Zyra Ndër-kombëtare e OBPI-së;
12. “Autoriteti kompetent”, autoritet administrativ ose gjyqësor, i cili është kompetent të përcaktojë nëse një markë është e mirënjohur apo të garantojë mbrojtjen e markave të mirënjohura;
13. “Sisteme ndërkombëtare të ngjyrave”, sisteme të standardizuara të riprodhimit të ngjyrave të njohura botërisht, si: *Pantone*, *Hex*, *RAL*, *RGB* ose *CMYK*;
14. “Konsumatori përkatës”, konsumatori faktik që blen ose përdor mallra dhe/ose shërbime;
15. “Publiku përkatës”:
 - a) Konsumatorët faktikë/përkatës ose potencialë që faktikisht blejnë/përdorin ose do të blejnë/përdorin në të ardhmen mallra/shërbime;
 - b) Për vlerësimin e mundësisë së shkaktimit të konfuzionit, publiku përkatës përbëhet nga konsumatorët që kanë mundësi të përdorin mallrat dhe shërbimet e mbuluara nga marka e mëparshme, ashtu si dhe produktet e mbuluara nga marka e aplikuar për to kur ato konsiderohen si identike ose të ngjashme;
 - c) Personat e përfshirë në rrugët/kanalet e shpërndarjes së mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat mbrohet marka;
16. “Rekomandimi i përbashkët”, rekomandimi i përbashkët në lidhje me dispozitat për mbrojtjen e markave të mirënjohura, miratuar nga Asambleja e Unionit të Parisit “Për mbrojtjen e pronësisë industriale” dhe Asambleja e Përgjithshme e OBPI-së;
17. “Dhoma e Kundërshtimeve”, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve.

KREU II

APLIKIMI PËR REGJISTRIMIN E NJË MARKE

Neni 3

Përmbajtja e kërkesës

1. Të drejtën për të aplikuar për markë në DPPI e ka çdo person.
2. Aplikimi për regjistrimin e markës përmban:
 - 2.1 Formularin e aplikimit për regjistrimin kombëtar të markës, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, me të dhënat e mëposhtme:
 - 2.1.1 Emrin dhe adresën e aplikantit, sipas nenit 62 të kësaj rregulloreje;
 - 2.1.2 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, sipas nenit 62 të kësaj rregulloreje, nëse kërkesa depozitohet nga një përfaqësues;
 - 2.1.3 Listën e mallrave dhe/ose shërbimeve, sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje;
 - 2.1.4 Të dhëna në lidhje me prioritetin, në rast se aplikanti pretendon për prioritet, në përputhje me nenet 147 e 148 të ligjit;
 - 2.1.5 Përfaqësimin (pamja) e markës që kërkohet të regjistrohet, në përputhje me nenet 4, 5, 6, 7, 8, 9 e 10 të kësaj rregulloreje;
 - 2.1.6 Deklaratën për përjashtimin nga mbrojtja të elementeve të markës që nuk mund të mbrohen sipas nenit 142, të ligjit nr. 9947;
 - 2.1.7 Një tregues që përcakton llojin e markës që kërkohet të regjistrohet: markën fjalë, markën figurë, markën e pozicionit, markë me elemente përsëritëse, markë formë, markë ngjyrë ose një lloj marke tjetër;
 - 2.1.8 Konvertimin e shkronjave dhe/ose numrave të markës, nëse marka përmban elemente të shkruara në karaktere të ndryshme nga shkronjat latine ose numra të ndryshëm nga ata arabë ose romakë;
 - 2.1.9 Një tregues që përcakton kategorinë e markës që kërkohet të regjistrohet: markën individuale, markën kolektive ose markën certifikuese;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2.1.10 Përshkrimin e markës, kur kjo nuk është markë fjalë dhe përkthimin e markës në shqip, kur ajo është në gjuhë të huaj dhe ka një kuptim të caktuar.

2.1.11 Nënshkrimin e aplikantit ose të përfaqësuesit të tij.

2.2 Pagesën e tarifës së aplikimit;

2.3 Autorizimin e përfaqësimit, nëse aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi.

2.4 Rregulloren e përdorimit të markës kolektive ose certifikuese, në përputhje me pikën 4, të nenit 165 dhe pikën 3, të nenit 166 të ligjit, kur kërkohet regjistrimi i një marke kolektive apo certifikuese.

Neni 4

Markat fjalë

1. Në rast se marka tregtare përbëhet ekskluzivisht nga fjalë apo shkronja, numra, karaktere tipografike, standarde të tjera ose nga një kombinim i tyre, marka do të konsiderohet si një markë fjalë.

2. Marka fjalë do të përfaqësohet nëpërmjet paraqitjes së një riprodhimi të shenjës në shkronja standarde, pa asnjë ngjyrë apo paraqitje grafike.

3. Marka fjalë do të jetë e shtypur ose e printuar në hapësirën përkatëse të formularit të aplikimit të rezervuar për këtë qëllim.

4. Marka që konsiston në një tekst me paraqitje jostandarde, për shembull, e shkruar në më shumë se një rresht, nuk do të kategorizohet si një markë fjalë, pasi këto marka konsiderohen marka figurë.

Neni 5

Markat figurë

1. Në rast se marka tregtare përbëhet nga karaktere jostandarde, stilizime, paraqitje grafike, me ngjyra, elemente figurative ose një kombinim të elementeve fjalë dhe figurative, marka do të konsiderohet si markë figurë.

2. Marka figurë do të përfaqësohet nëpërmjet paraqitjes së një riprodhimi të shenjës që tregon të gjitha elementet e saj dhe, kur është e mundur, edhe ngjyrat e saj. Marka figurë do të paraqitet në hapësirën përkatëse të formularit të aplikimit të rezervuar për këtë qëllim.

3. Nëse regjistrimi i markës është kërkuar në ngjyra, aplikimi do të përmbajë një prezantim të markës me ngjyra. Nëse regjistrimi i markës nuk është kërkuar me ngjyra, marka duhet të shfaqet bardhezi në të gjitha dokumentet, në bazën e të dhënave dhe në buletin e zyrtar.

4. Në regjistrin e markave që mbahet nga zyra, në publikime, në vendimin për regjistrimin e markës dhe në certifikatën e regjistrimit të markës, marka me ngjyra do të përfaqësohet në cilësinë teknike më të mirë të mundshme nga zyra. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me nuancat dhe hijet e ngjyrave në të cilat marka riprodhohet, përfaqësimi i markës përcaktohet sipas përfaqësimit origjinal të markës në formularin e aplikimit.

5. Për sa i takon pozicionimit të markës në hapësirën e ofruar për këtë qëllim në formular, pozicioni korrekt do të përcaktohet nga pozicioni i markës në formularin e aplikimit.

Neni 6

Markat formë

1. Në rast se marka tregtare përbëhet nga ose tregon një formë tredimensionale, duke përfshirë kuti, paketime, vetë produktin ose pamjen e tyre, marka tregtare do të konsiderohet si markë formë.

2. Marka formë do të përfaqësohet nëpërmjet paraqitjes së riprodhimit grafik të formës, duke përfshirë imazhe të gjeneruara nga kompjuteri ose një riprodhim fotografik.

3. Riprodhimi grafik ose fotografik mund të përmbajë disa pamje të ndryshme të markës.

4. Në rast se marka formë është një markë tredimensionale, pamja e markës duhet të tregojë qartësisht karakteristikat e saj tredimensionale.

5. Kur pamja e markës tredimensionale është vizatim, riprodhimi duhet të bëhet në vija të zeza uniforme dhe të qarta. Vizatimi mund të përmbajë vijëzime dhe hije për të përfaqësuar më mirë detajet.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 7

Markat e pozicionit

1. Marka e pozicionit tregon mënyrën specifike sipas së cilës marka vendoset ose ngjitet në produkte përkatëse.
2. Marka e pozicionit do të përfaqësohet nëpërmjet paraqitjes së një riprodhimi, i cili identifikon në mënyrë të përshtatshme pozicionin e markës dhe madhësinë ose përmasat e saj në lidhje me mallrat përkatëse.
3. Elementet që nuk janë pjesë e objektit të regjistrimit do të përjashtohen nga mbrojtja në mënyrë vizuale (të dukshme), duke i paraqitur ato me vija të ndërprera ose të pikëzuara.
4. Përshkrimi i markës duhet të përcaktojë se si marka ngjitet në mallrat përkatëse, por ky përshkrim nuk duhet të shërbejë si arsye për mosparaqitjen vizualisht të pamjes së markës. Përfaqësimi i markës mund të shoqërohet edhe me një përshkrim që tregon në mënyrë të detajuar se si bashkëngjitet shenja në produktet përkatëse.

Neni 8

Markat me elemente përsëritëse

1. Marka me elemente të përsëritura përbëhet ekskluzivisht nga një grup elementesh që përsëriten në mënyrë të rregullt.
2. Marka me elemente të përsëritura do të përfaqësohet nëpërmjet paraqitjes së një riprodhimi që tregon modelin e përsëritjes.
3. Përfaqësimi i markës mund të shoqërohet edhe me një përshkrim që tregon në mënyrë të detajuar se si përsëriten rregullisht elementet e markës.

Neni 9

Markat që konsistojnë në një ngjyrë apo kombinim ngjyrash

1. Nëse në aplikim është kërkuar regjistrimi i një marke, e cila konsiston në një ngjyrë ose kombinim ngjyrash, ngjyrat mund të listohen dhe të përshkruhen në aplikim së bashku me kodin përkatës të ngjyrave nga sistemet ndërkombëtare të ngjyrave, si: *Pantone*, *Hex*, *RAL*, *RGB* ose *CMYK*.
2. Kur kodet e ngjyrave janë dukshëm të ndryshme nga ngjyrat e përfaqësuara në pamjen e markës, zyra njofton aplikantin. Nëse aplikanti nuk i përgjigjet njoftimit të zyrës ose edhe pas përgjigjes kodet e përcaktuara prej tij janë përsëri dukshëm të ndryshme nga ngjyrat e përfaqësuara në pamjen e markës, zyra nuk i merr ato në konsideratë dhe njofton aplikantin për vendimin e marrë.
3. Nëse në aplikim është kërkuar regjistrimi i një marke, e cila konsiston në kombinim ngjyrash, riprodhimi duhet gjithashtu të tregojë rregullimin sistematik të kombinimit të ngjyrave në një mënyrë uniforme dhe të përcaktuar, së bashku me përcaktimin e këtyre ngjyrave sipas kodit përkatës të ngjyrave në përputhje me sistemet ndërkombëtare të ngjyrave. Kërkesa për regjistrim marke mund të përmbajë gjithashtu një përshkrim të detajuar të rregullimit sistematik të ngjyrave.

Neni 10

Llojet e tjera të markave

1. Nëse në aplikim është kërkuar regjistrimi i një lloji tjetër marke, ai duhet të citohet në formularin e aplikimit.
2. Në varësi të llojit të markës për të cilin është kërkuar regjistrimi në aplikim, aplikimi duhet të shoqërohet me paraqitjen grafike të markës, e cila duhet të jetë e qartë, e saktë, lehtësisht e disponueshme, e qëndrueshme dhe objektive.

Neni 11

Korrigjimi i llojit të markës

1. Nëse lloji i markës së treguar në kërkesën për regjistrim marke nuk përputhet me përfaqësimin (pamjen) e depozituar, ose në rast se asnjë lloj marke nuk është përcaktuar nga aplikanti në kërkesë dhe nëse rezulton qartësisht se cili është lloji i markës që aplikanti kërkon të regjistrojë, zyra do të korrigjojë llojin e markës dhe do të njoftojë me shkrim aplikantin.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Aplikanti duhet të paraqesë shpjegimet/ dokumentet e tij shtesë brenda një afati 3-mujor nga data e marrjes së njoftimit.
3. Nëse aplikanti nuk i përgjigjet njoftimit të zyrës brenda afatit ligjor të lartpërmendur, korrigjimi i bërë nga zyra do të konsiderohet se është pranuar nga aplikanti.
4. Nëse aplikanti nuk është dakord me ndryshimin, zyra do të rivendosë llojin e markës ashtu siç është përcaktuar fillimisht nga aplikanti në momentin e depozitimit të kërkesës për regjistrim. Megjithatë, kërkesa për regjistrim marke mund të refuzohet më pas në rast se natyra (lloji) e markës nuk është e qartë.
5. Nëse lloji i markës së treguar në kërkesën për regjistrim marke nuk përputhet me përfaqësimin (pamjen) e depozituar ose në rast se asnjë lloj marke nuk është përcaktuar nga aplikanti në kërkesë, dhe nëse nuk rezulton qartësisht se cili është lloji i markës që aplikanti kërkon të regjistrojë, zyra do të nxjerrë një njoftim për plotësim të parregullsive.
6. Aplikanti duhet të plotësojë parregullsitë e kërkuara në njoftimin e lëshuar nga zyra brenda një afati 3-mujor nga data e marrjes së njoftimit. Nëse parregullsitë e njoftimit të lëshuar nga zyra nuk plotësohen brenda afatit ligjor të lartpërmendur, kërkesa për regjistrim marke do të refuzohet.
7. Nëse përshkrimi i markës nuk përputhet me përfaqësimin e markës, zyra do t'i kërkojë aplikantit që të fshijë ose të ndryshojë përshkrimin e markës. Përfaqësimi i markës nuk mund të ndryshojë për të qenë në përputhje me përshkrimin e markës.

Neni 12

Kërkesa të tjera në lidhje me riprodhimin e markës

1. Riprodhimi i markës duhet të jetë i një cilësie, forme dhe ngjyre, që lejon elementet e markës të jenë qartësisht të dallueshme në çdo detaj të tyre. Përfaqësimi i markës nuk duhet të jetë i mbikopjuar, si dhe duhet të jetë i pastër nga fshirjet dhe mbingjyrimet.
2. Përfaqësimi i markës duhet të përfshihet brenda hapësirës së rezervuar për këtë qëllim në formularin e aplikimit (kuadrat i përmasave 8 x 8 cm) dhe distanca ndërmjet dy pikave më të largëta horizontale, vertikale dhe diagonale të markës nuk duhet të jetë më pak se 1.5 cm.
3. Aplikimi nuk duhet të shoqërohet me mostra apo objekte në të cilat do të përdoret marka që kërkohet të regjistrohet. Nëse depozitohen mostra ose objekte të tilla, ato i kthehen aplikantit, dhe, në rast se kthimi i tyre nuk është i mundur, ato duhet të shkatërrohen me shpenzimet e aplikantit përpara publikimit të aplikimit të regjistrimit të markës.

Neni 13

Lista e mallrave ose shërbimeve

1. Mallrat dhe/ose shërbimet duhet të paraqiten me qartësi dhe saktësi të mjaftueshme në mënyrë që autoritetet kompetente dhe operatorët ekonomikë të kuptojnë qëllimin e mbrojtjes së kërkuar.
2. Një përshkrim i listës së mallrave dhe/ose shërbimeve është mjaftueshëm i qartë dhe i saktë kur qëllimi i saj mund të kuptohet nga kuptimi i saj normal dhe i zakonshëm. Nëse përdoren terma të përfshirë në tituj e klasave të klasifikimit të Nicës ose terma të tjerë të përgjithshëm, këto duhet të përmbushin kushtet e qartësisë dhe saktësisë të përcaktuara në këtë paragraf. Përdorimi i termave të përgjithshëm, duke përfshirë treguesit e përgjithshëm të titujve të klasave të klasifikimit të Nicës, do të interpretohet se përfshin të gjitha mallrat ose shërbimet e mbuluara në mënyrë të qartë nga kuptimi literal i treguesit ose termit të përgjithshëm brenda kontekstit të klasës së aplikuar.
3. Mallrat dhe/ose shërbimet duhet të listohen saktësisht dhe të grupohen në përputhje me klasat e klasifikimit të Nicës. Numri i klasës duhet të paraprijë çdo klasë në përputhje me klasifikimin e Nicës.
4. Një term (mall ose shërbim) mund të jetë pjesë e përshkrimit të mallrave dhe shërbimeve në disa klasa të ndryshme. Ky term duhet të jetë i qartë dhe i saktë në një klasë të veçantë pa specifikime të mëtejshme, nëse kuptimi i tij normal e i zakonshëm dhe numri i klasës nuk lënë dyshime për sa i përket qëllimit të mbrojtjes.
5. Në rast se qëllimi i mbrojtjes nuk mund të kuptohet, qartësia dhe saktësia e mjaftueshme e termit (mall/shërbim) mund të arrihet nëpërmjet identifikimit të faktorëve të tillë, si: karakteristikat, qëllimi dhe/ose sektori i identifikueshëm i tregut.
6. Klasifikimi i mallrave dhe/ose shërbimeve duhet të shërbejë ekskluzivisht për qëllime administrative dhe mallrat ose shërbimet nuk mund të konsiderohen si të ngjashme vetëm për faktin që ato shfaqen në të njëjtën

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

klasë sipas klasifikimit të Nicës. Mallrat ose shërbimet nuk do të konsiderohen si të ndryshme vetëm për faktin që ato shfaqen në klasa të ndryshme sipas klasifikimit të Nicës.

7. Zyra njofton aplikantin nëse ka mallra dhe/ose shërbime që nuk janë mjaftueshëm të sakta dhe të qarta, duke i kërkuar atij që të paraqesë shpjegimet ose saktësimet/specifikimet përkatëse të tyre brenda një periudhe 3-mujore nga data e marrjes së njoftimit.

8. Zyra refuzon aplikimin në lidhje me ato mallra dhe/ose shërbime, të cilat nuk janë mjaftueshëm të sakta dhe të qarta dhe kur aplikanti nuk paraqet shpjegime ose saktësime të përshtatshme sipas këtij neni brenda periudhës 3-mujore.

Neni 14

Kufizimi i listës së mallrave dhe/ose shërbimeve

Kërkesa për kufizimin e listës së mallrave dhe /ose shërbimeve përmban:

1. formularin e aplikimit për kufizimin e listës së mallrave dhe/ose shërbimeve, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, me të dhënat e mëposhtme:

1.1 Numrin e aplikimit për regjistrimin e markës ose numrin e regjistrimit të markës;

1.2 Emrin dhe adresën e aplikantit ose të pronarit të markës, në përputhje me nenin 62 të kësaj rregulloreje;

1.3 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse kërkesa paraqitet nga një përfaqësues, sipas nenit 62 të kësaj rregulloreje;

1.4 Listën e kufizuar të mallrave dhe/ose të shërbimeve, në përputhje me nenin 13 të kësaj rregulloreje.

2. Pagesën e tarifës përkatëse.

3. Autorizimin e përfaqësimit, nëse kërkesa paraqitet nga një përfaqësues.

Neni 15

Ndarja e aplikimit fillestar të një marke

(shtuar pika 9.1 me vendimin nr. 543, datë 29.7.2022)

1. Kërkesa për ndarjen e aplikimit fillestar për regjistrim marke përmban:

1.1 Formularin e aplikimit për ndarjen e aplikimit fillestar për regjistrim marke, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, me të dhënat e mëposhtme:

1.1) numrin e aplikimit të markës;

1.2) emrin dhe adresën e aplikantit;

1.3) emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse kërkesa për ndarje paraqitet nga një përfaqësues;

1.4) listën e mallrave dhe/ose shërbimeve që përfshihen në aplikimin e ndarë;

1.5) nënshkrimin e aplikantit ose të përfaqësuesit, nëse kërkesa për ndarje depozitohet nga një përfaqësues;

1.2 Pagesën e tarifës përkatëse;

1.3 Autorizimin e përfaqësimit, nëse kërkesa për ndarje depozitohet nga një përfaqësues.

2. Për çdo ndarje të aplikimit fillestar për regjistrim marke duhet të depozitohet një kërkesë e veçantë.

3. Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve të një aplikimi të ndarë dhe lista e mallrave dhe/ose shërbimeve që mbeten në aplikimin fillestar, të marra së bashku, duhet të jenë identike me listën e mallrave dhe/ose shërbimeve të aplikimit fillestar në kohën kur është depozituar kërkesa për ndarjen e aplikimit fillestar. Kur kërkesa për ndarje ka të bëjë me mallra dhe/ose shërbime që i referohen një termi të përgjithshëm të klasifikimit të tyre, ky term i përgjithshëm do të përdoret si në pjesën e mbetur të aplikimit fillestar, ashtu edhe në aplikimin e ndarë dhe do të kufizohet me shtesa të përshtatshme për të shmangur mbivendosjen e listës së mallrave dhe/ose shërbimeve.

4. Kur një kërkesë nuk plotëson kushtet e parashikuara në pikat 1, 2 e 3 të këtij neni, zyra njofton aplikantin që të plotësojë të metat brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Nëse aplikanti nuk plotëson të metat brenda këtij afati, kërkesa për ndarjen e aplikimit refuzohet. Ndarja e aplikimit fillestar i fillon efektet nga data e regjistrimit në dosje nga zyra në lidhje me aplikimin fillestar.

5. Një kopje e plotë e dokumenteve të aplikimit fillestar duhet të bëhet pjesë e dokumenteve të aplikimit të ndarë dhe një kopje e kërkesës për ndarje duhet të bëhet pjesë e dokumenteve të aplikimit fillestar.

6. Të gjitha kërkesat e paraqitura dhe tarifatat e paguara në lidhje me aplikimin fillestar përpara datës së depozitimit të kërkesës për ndarje të aplikimit fillestar do të konsiderohen se janë paraqitur dhe paguar edhe për kërkesën ose kërkesat për ndarje. Tarifatat për aplikimin fillestar, që janë paguar përpara datës së depozitimit të

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

kërkesës për ndarje të aplikimit fillestar, nuk do të rimbursohen.

7. Përfaqësuesi i autorizuar i caktuar në aplikimin fillestar do të konsiderohet si i tillë edhe në aplikimin e ndarë, përveç rastit kur aplikanti e ka revokuar si përfaqësues.

8. Kërkesa për ndarjen e aplikimit fillestar për regjistrim marke nuk do të pranohet nëse:

8.1 është depozituar kërkesë për kundërshtim ndaj aplikimit fillestar; Një ndarje e tillë ka efekt tek ato mallra dhe/ose shërbime kundër të cilave drejtohet kundërshtimi, deri në momentin e marrjes së një vendimi të formës së prerë ose të zgjidhjes së mosmarrëveshjes përfundimisht me mirëkuptim midis palëve;

8.2 aplikimi fillestar nuk ka marrë datë depozitimi nga zyra;

8.3 depozitohet gjatë periudhës tremujore të publikimit në buletin zyrtar.

9. Aplikimit të ndarë i caktohet një numër i ri aplikimi. Aplikimi i ndarë do të ruajë të njëjtën datë depozitimi ose prioriteti me aplikimin fillestar.

9.1 Zyra do të konsiderojë si ndarje të aplikimit të markës edhe rastet kur një kërkesë për regjistrimin e markës është publikuar me më pak mallra dhe/ose shërbime sesa ka në dëshminë e depozitimit. Zyra pas publikimit të aplikimit fillestar me mallrat dhe/ose shërbimet e munguara në buletin e PI-së do të vazhdojë procedurat e parashikuara në ligj apo në këtë rregullore për regjistrimin e saj për të gjitha mallrat dhe/ose shërbimet e kërkuara.

10. Ndarja e aplikimit fillestar për regjistrim marke do të publikohet në buletin zyrtar. Publikimi i ndarjes së aplikimit nuk fillon periudhë të re kundërshtimi.

Neni 15/a

Ndarja e një marke të regjistruar

(shtuar me vendimin nr. 543, datë 29.7.2022)

1. Parashikimet e dhëna në pikat 1–7, të nenit 15, të kësaj rregulloreje, gjejnë zbatim edhe për kërkesën e dorëzuar për ndarjen e një marke të regjistruar.

1.1 Formulari i kërkesës për ndarjen e markës së regjistruar, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, do të përmbajë, gjithashtu, të dhënat e mëposhtme:

1.1.1 numrin e regjistrimit të markës;

1.1.2 emrin dhe adresën e pronarit.

2. Nëse përpara dorëzimit të kërkesës, për ndarjen apo jo të markës së regjistruar, është duke u shqyrtuar një kërkesë për shfuqizim apo pavlefshmëri të markës së regjistruar nga DPPI-ja ose gjykata, vendimarrja për kërkesën për ndarjen e markës së regjistruar pezullohet, sipas rastit, deri në momentin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me mirëkuptim midis palëve apo marrjes së formës së prerë të vendimit të gjykatës.

Detyrimin për njoftimin e DPPI-së, në lidhje me një kërkesë të depozituar zyrtarisht për shfuqizim apo pavlefshmëri të markës së regjistruar në DPPI apo në gjykatë e ka kërkuuesi i shfuqizimit/zhvlerësimit të markës së regjistruar, që kërkohet të ndahet.

3. Markës së ndarë i caktohet një numër i ri kërkesë, si dhe një numër i ri regjistrimi. Marka e ndarë do të ruajë të njëjtën datë depozitimi ose prioriteti, si dhe datë regjistrimi me markën fillestare dhe do të njoftojë pronarin e markës për ndarjen. Njoftimi do të përmbajë ekstraktin e regjistrimit për markën fillestare dhe markën e ndarë.

4. Pas vendimarrjes së DPPI-së për ndarjen e markës së regjistruar, marka e ndarë nuk do të jetë objekt i publikimit, në kuptim të nenit 151 të ligjit, dhe as kundërshtimit në kuptim të nenit 152 të ligjit.

5. Ndarja e markës së regjistruar do të publikohet në Buletin Zyrtar.

6. Zyra do të konsiderojë si ndarje të regjistrimit të markës edhe rastet, kur një kërkesë për regjistrimin e markës është:

6.1 publikuar dhe regjistruar me më pak mallra dhe/ose shërbime se sa ka në dëshminë e depozitimit. Zyra pas publikimit të kërkesës fillestare me mallrat dhe/ose shërbimet e munguara në buletin e PI-së do të vazhdojë procedurat e parashikuara në ligj apo në këtë rregullore për regjistrimin e saj për mallrat dhe/ose shërbimet e munguara;

6.2 publikuar me më pak mallra dhe/ose shërbime nga sa ka në dëshminë e depozitimit dhe regjistruar me të gjitha mallrat dhe/ose shërbimet. Në këtë rast, zyra do të bëjë korrigjimin e certifikatës së markës së regjistruar, dhe, pas publikimit të kërkesës fillestare me mallrat dhe/ose shërbimet e munguara në buletin e PI-së, do të vazhdojë procedurat e parashikuara në ligj apo në këtë rregullore për regjistrimin e saj për këto mallra dhe/ose shërbime.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

7. Kërkesa për ndarjen e markës së regjistruar do të jetë sipas formularit që bashkëlidhet këtij vendimi.

Neni 16

Pretendimi për prioritet

1. Kërkesa për prioritet përmban:
 - 1.1 datën e depozitimit të aplikimit më të hershëm;
 - 1.2 numrin e aplikimit më të hershëm; dhe
 - 1.3 zyrën në të cilën kërkesa më e hershme është depozituar ose ekspozitën në të cilën janë ekspozuar mallrat dhe/ose shërbimet.
2. Kërkesa për prioritet duhet të shënohet në formularin e aplikimit për regjistrimin e markës. Në rast se kërkohet prioritet, aplikanti, brenda 3 (tre) muajve nga data e paraqitjes së kërkesës për prioritet, duhet të depozitojë në DPPI dokumentin e prioritetit, sipas nenit 147 të ligjit, ose certifikatën e lëshuar nga autoriteti kompetent përfaqësues i ekspozitës ku janë paraqitur mallrat dhe/ose shërbimet, sipas nenit 148 të ligjit. Dokumenti i prioritetit, origjinali ose kopja e njëzuar me origjinalin, duhet të depozitohet i përkthyer në gjuhën shqipe.
3. Aplikanti mund të kërkojë prioritet për një, disa ose të gjitha klasat e mallrave dhe/ose shërbimeve, si dhe/ose me data të ndryshme prioriteti për secilën prej tyre, duke depozituar dokumentet përkatëse të prioritetit.
4. Në rast se aplikanti, brenda 3 (tre) muajve nga data e paraqitjes së kërkesës për prioritet, nuk depoziton dokumentin e prioritetit të zyrës ku është depozituar aplikimi më i hershëm, sipas nenit 147 të ligjit ose certifikatën e autoritetit përfaqësues të ekspozitës, sipas nenit 148 të ligjit, DPPI-ja e refuzon kërkesën për prioritet.
5. Prioriteti i fituar në bazë të dispozitave të ligjit dhe të kësaj rregulloreje e bën datën e prioritetit të jetë datë depozitimi e aplikimit për regjistrim marke në DPPI vetëm për efekt të përcaktimit se cili aplikim gëzon një të drejtë të mëparshme.

Neni 17

Përjashtimet nga mbrojtja

1. Përjashtimi nga mbrojtja i elementeve të një marke që nuk mund të mbrohen nuk përbën pengesë për vazhdimin e procedurës së ekzaminimit për shkaqe absolute nga zyra.
2. Kur një markë përbëhet nga një kombinim elementesh dhe secili prej tyre në vetvete nuk është qartësisht i dallueshëm, nuk është e nevojshme të depozitohet për secilin element një deklaratë për përjashtim nga mbrojtja. Në një rast të tillë, përjashtimi do të konsiderohet për të gjitha elementet në tërësi.
3. Kur aplikanti kërkon përjashtimin nga mbrojtja të një elementi jodallues në aplikimin e tij, ky përjashtim do të qëndrojë edhe nëse zyra nuk e konsideron atë të nevojshëm.
4. Përjashtimet nga mbrojtja të elementeve dalluese do të refuzohen nga zyra, nëse nga këto përjashtime do të rezultonte një markë pa një mbrojtje të qartë.

Neni 18

Dorëheqja nga aplikimi

1. Aplikanti ka të drejtë të heqë dorë nga aplikimi për një markë në çdo kohë para se sa të jetë marrë vendimi për regjistrimin e markës.
2. Nëse kërkesa për dorëheqje nga aplikimi bëhet para se sa zyra të ketë filluar ekzaminimin formal të aplikimit, sipas nenit 21 të kësaj rregulloreje, zyra i kthen aplikantit 80% të shumës së paguar në momentin e aplikimit.
3. Dorëheqja bëhet e vlefshme në datën e paraqitjes në zyrë dhe nuk mund të revokohet.

**KREU III
PROCEDURAT E REGJISTRIMIT**

Neni 19

Ekzaminimi i kushteve për depozitimin e aplikimit

1. Zyra ekzaminon nëse aplikimi për markë përmbush kushtet e parashikuara në pikën 4, të nenit 145 të ligjit. Nëse një aplikim për markë i plotëson këto kushte, zyra lëshon dëshminë e depozitimit për aplikimin dhe si datë depozitimi caktohet data e paraqitjes së aplikimit.
2. Kur aplikimi për markë nuk i plotëson kushtet e pikës 4, të nenit 145 të ligjit, zyra i kërkon aplikantit të plotësojë të metat brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.
3. Nëse aplikimi i plotëson këto kushte brenda afatit të caktuar në paragrafin e mëparshëm, zyra lëshon dëshminë e depozitimit dhe cakton si datë depozitimi për aplikimin datën kur përgjigja për plotësimin e të metave paraqitet në zyrë.
4. Nëse të metat nuk plotësohen brenda afatit 2-mujor, zyra refuzon aplikimin dhe njofton aplikantin për vendimin e refuzimit. Vendimi i refuzimit mund të apelohej në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit.

Neni 20

Dëshmia e depozitimit

Dëshmia e depozitimit përmban të dhënat e mëposhtme:

1. Datën e depozitimit;
2. Numrin e aplikimit;
3. Emrin dhe adresën e aplikantit;
4. Përfaqësimin e markës;
5. Listën e mallrave dhe/ose shërbimeve;
6. Të dhëna të tjera të deklaruara në formularin e aplikimit për regjistrimin kombëtar të markës.

Neni 21

Ekzaminimi formal i aplikimit për regjistrim marke

1. Ekzaminuesi i ekzaminon aplikimet për markë sipas radhës së paraqitjes së tyre në DPPI në përputhje me pikat 4 e 5 të nenit 150 të ligjit.
2. Nëse aplikanti kërkon ekzaminim jashtë numrit rendor (të përshpejtuar) për një aplikim për markë, duke bërë pagesën përkatëse, zyra e ekzaminon aplikimin për markë brenda një kohe sa më të shkurtër që të jetë e mundur, duke mos respektuar numrin rendor.
3. Ekzaminimi i aplikimit për markë bëhet brenda 3 (tre) muajve nga data e paraqitjes së tij. Brenda kësaj periudhe ekzaminuesi shqyrton nëse aplikimi është në përputhje me nenin 145 të ligjit dhe kreun II të kësaj rregulloreje.
4. Nëse aplikimi për markë nuk përmbush kushtet e parashikuara në nenin 145 të ligjit dhe kreun II të kësaj rregulloreje, DPPI-ja njofton aplikuesin të plotësojë të metat brenda 3 muajve nga data e marrjes së njoftimit.
5. Afati për paraqitjen e plotësimit të të metave zgjatet deri në dy muaj shtesë, nëse aplikuesi paraqet, brenda periudhës 3-mujore të specifikuar më lart, një kërkesë me shkrim për këtë qëllim dhe paguan tarifën përkatëse. Nëse plotësimi nuk bëhet brenda afateve të parashikuara në pikat 4 e 5 të këtij neni, zyra e refuzon aplikimin. Ky vendim mund të apelohej nga aplikanti në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim brenda 1 muaji nga data e marrjes së vendimit.
6. Pasi merr përgjigjen nga aplikanti për plotësimin e të metave brenda afatit 3-mujor, ekzaminuesi e shqyrton përgjigjen brenda 1 muaji nga data e marrjes së përgjigjes për plotësimin e të metave.
7. Nëse aplikanti në përgjigjen e tij sërish nuk i ka plotësuar të metat, zyra e refuzon aplikimin dhe i njofton aplikantit aktin e refuzimit.
8. Nëse aplikanti në përgjigjen e tij i ka plotësuar pjesërisht të metat në lidhje me listën e mallrave dhe/ose shërbimeve, zyra heq nga lista mallrat dhe/ose shërbimet që nuk janë saktësuar dhe qartësuar dhe i

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

njofton aplikantit vendimin e marrë. Ky vendim mund të apelohej nga aplikanti në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim brenda 1 muaji nga data e marrjes së aktit.

Neni 22

Ekzaminimi për shkaqe absolute

1. Zyra ekzaminon aplikimin për markë për shkaqe absolute, sipas nenit 142 të ligjit.
2. Kur konstaton se aplikimi për markë nuk është në përputhje me nenet 140 e 142 të ligjit ose kur konstaton se aplikimi nuk është në përputhje me këto nene vetëm për një pjesë të mallrave dhe/ose shërbimeve, zyra njofton aplikantën, duke dhënë argumente konkrete për refuzimin pjesërisht ose tërësisht të aplikimit për shkaqe absolute dhe e fton atë të paraqesë shpjegime dhe/ose dokumente shtesë në lidhje me njoftimin e zyrës ose të japë dorëheqjen nga aplikimi brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Ky afat mund të zgjatet me dy muaj, nëse aplikuesi paraqet brenda këtij afati dymujor një kërkesë me shkrim për zgjatje afati dhe paguan tarifën përkatëse.
3. Pas marrjes së përgjigjes nga aplikanti brenda afatit të caktuar në pikën 2 të këtij neni, ekzaminuesi e shqyrton përgjigjen brenda 1 (një) muaji nga paraqitja e saj.
4. Nëse aplikanti nuk i paraqet shpjegimet dhe/ose dokumentet brenda afatit dymujor ose zyra nuk i konsideron të mjaftueshme ose të bazuara shpjegimet/dokumentet e paraqitura, zyra refuzon, sipas rastit, pjesërisht apo tërësisht, aplikimin dhe i njofton aplikantit vendimin e refuzimit.
5. Nëse një element konsiderohet nga zyra si jodallues, element i cili zë pjesën më të madhe ose kryesore të përfaqësimit (pamjes) të markës, zyra e refuzon regjistrimin e aplikimit edhe kur aplikanti kërkon përjashtimin nga mbrojtja të këtij elementi.
6. Nëse pas njoftimit të zyrës aplikanti nuk kërkon përjashtimin e një ose disa elementeve jodalluese të markës, zyra refuzon mbrojtjen e këtyre elementeve dhe i njofton aplikantit vendimin e marrë, i cili mund të ankimohej në Dhomën e Shqyrtimit të Kundërshtimeve brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit nga aplikanti.
7. Marka nuk mund të regjistrohet nëse është identike me një markë të mëparshme dhe mallrat dhe/ose shërbimet e tyre janë të njëjta apo të ngjashme, si edhe në rastet kur mallrat dhe/ose shërbimet e njërës lidhen ngushtësisht me ato të tjetrës.
8. Markat do të konsiderohen identike kur në pamje të parë ato nuk dallojnë ose ndryshojnë vetëm në aspekte të parëndësishme nga njëra-tjetra.
9. Nëse zyra konstaton se një aplikim për markë në shqyrtim është identik me një markë të mëparshme, zyra njofton aplikantën me shkrim për këtë fakt.
10. Nëse aplikanti i një marke të mëvonshme kërkon pezullimin e ekzaminimit të aplikimit, pasi ka filluar të negociojë me aplikantën ose pronarin e një marke të mëparshme për zgjidhjen e konfliktit me këtë të fundit, zyra e pranon kërkesën për pezullim, nëse është e mbështetur në prova shkresore që tregojnë fillimin ose ekzistencën e negociatave midis palëve dhe vendos pezullimin e ekzaminimit për aplikimin e markës së mëvonshme deri në përfundimin e negociatave.
11. Zyra ka të drejtë, sa herë që e konsideron të nevojshme, të kërkojë informacion nga aplikanti i markës së mëvonshme për ecurinë e negociatave midis palëve. Në rast se aplikanti i markës së mëvonshme nuk paraqet prova shkresore në lidhje me negociatat brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit të zyrës, kjo e fundit shfuqizon vendimin e pezullimit dhe vazhdon procedurat.
12. Nëse aplikimi i markës së mëparshme refuzohet me vendim të formës së prerë, zyra vazhdon ekzaminimin e aplikimit të markës së mëvonshme.
13. Kur zyra konstaton se një markë e aplikuar më vonë për regjistrim është identike me një markë të mëparshme të regjistruar, për të cilën afati 10-vjeçar i ripërtëritjes ka përfunduar, por është ende brenda afatit 6-mujor shtesë të parashikuar në pikën 2 të nenit 164 të ligjit, zyra e pezullon procedurën e regjistrimit të markës së mëvonshme, deri në përfundim të këtij afati.
14. Nëse nuk paraqitet kërkesa për ripërtëritjen e markës së mëparshme, sipas pikës 13 të këtij neni, pezullimi përfundon dhe zyra vijon procedurën e ekzaminimit të aplikimit të markës së mëvonshme.
- Nëse marka e mëparshme ripërtërihet brenda afatit 6-mujor shtesë, sipas pikës 13 të këtij neni, pezullimi përfundon dhe zyra vepron sipas pikës 9 të këtij neni.
15. Nëse e gjykon të nevojshme, zyra ka të drejtë të kërkojë dokumente ose deklarata nga një aplikant që ka paraqitur një aplikim për markë gjatë shqyrtimit të aplikimit për baza absolute.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

16. Mbi bazën e një observimi të depozituar nga një palë e tretë, sipas nenit 151/a të ligjit, zyra shqyrton observimin me anën e Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve dhe, kur është e përshtatshme, mund të riçelë me iniciativën e saj procedurën e ekzaminimit për shkaqe absolute në çdo kohë, deri para regjistrimit të markës. Nëse zyra vendos të riçelë procedurën e ekzaminimit, ajo vijon më tej sipas pikave 3, 4 e 5, të nenit 151/a, të ligjit.

Neni 23

Raporti i hetimit

1. Gjatë ekzaminimit për shkaqe absolute të aplikimit për markë, zyra harton një raport hetimi ku do të renditen të gjitha markat ose aplikimet për marka të mëparshme që rezultojnë nga hetimi në bazën e të dhënave të zyrës, mbi bazën e të cilave mund të kundërshtohet regjistrimi i aplikimit për markë, në bazë të nenit 143 të ligjit. Raporti i hetimit përmban datën e depozitimit, elementet fjalë, përfaqësimin e markës, emrin e pronarit ose aplikantit dhe klasat e mallrave dhe/ose të shërbimeve, sipas klasifikimit të Nicës.

2. Raporti i hartuar në bazë të pikës 1 të këtij neni i dërgohet një aplikanti vetëm në rast se ai e ka kërkuar raportin e hetimit në aplikimin për regjistrimin e markës dhe ka paguar tarifën për hetimin.

3. Menjëherë pas publikimit të aplikimit për regjistrim marke, zyra njofton përfaqësuesit e autorizuar dhe/ose pronarët e markave apo aplikimeve të mëparshme, që renditen në raportin e hetimit, për publikimin e aplikimit për markë, pavarësisht nëse është kërkuar ose jo raporti i hetimit nga aplikanti. Njoftimet bëhen vetëm në adresat që aplikantët dhe/ose pronarët e markave apo aplikimeve të mëparshme ose përfaqësuesit e tyre kanë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 24

Regjistrimi i markës

1. Kur aplikimi për markë i plotëson kushtet e përcaktuara në ligj dhe në këtë rregullore dhe nuk është depozituar kërkesë për kundërshtim brenda periudhës së përcaktuar në nenin 152 të ligjit, ose kur është hequr dorë nga kundërshtimi apo kur kundërshtimi është refuzuar dhe vendimi i refuzimit ka marrë formë të prerë, zyra njofton aplikantin për depozitimin e pagesës për regjistrimin e markës brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit.

2. Me marrjen e pagesës së regjistrimit, zyra regjistron markën në regjistrin e markave dhe publikon regjistrimin.

3. Nëse aplikanti nuk paguan tarifën për regjistrimin e markës brenda afatit të përcaktuar, zyra e refuzon regjistrimin e markës dhe ia njofton vendimin aplikantit.

4. Vendimi për refuzimin e markës për mospagim në kohë të tarifës së regjistrimit mund të ankimohet në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim brenda 1 muaji nga data e marrjes së vendimit të refuzimit.

5. Pas kryerjes në afat të pagesës së tarifës së regjistrimit, zyra lëshon certifikatën e regjistrimit në formatin e përcaktuar për këtë qëllim. Me kërkesë të aplikantit, certifikata e regjistrimit mund të lëshohet edhe në mënyrë elektronike kundrejt një pagese të reduktuar për regjistrimin e markës.

KREU IV

REGJISTRI, PUBLIKIMI DHE CERTIFIKATA E NJË MARKE

Neni 25

Përmbajtja e regjistrit të markave

1. Regjistri i markave përmban të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1 Numrin e aplikimit dhe të regjistrimit të markës;
 - 1.2 Datën e depozitimit të aplikimit;
 - 1.3 Të dhënat në lidhje me aplikantin dhe pronarin e markës, siç janë paraqitur në aplikim;
 - 1.4 Të dhënat në lidhje me përfaqësuesin e autorizuar, nëse është caktuar një i tillë;
 - 1.5 Listën e mallrave dhe/ose të shërbimeve;
 - 1.6 Të dhënat në lidhje me prioritetin (data dhe numri i aplikimit të mëparshëm, si dhe shtetin ku është depozituar ky aplikim ose datën e prioritetit nga ekspozita/panairi, sipas rastit);
 - 1.7 Përfaqësimin (pamjen) e markës;
 - 1.8 Elementet në pamjen e markës, që përjashtohen nga mbrojtja;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

1.9 Llojin e markës (markë fjalë, markë figurë, markë e pozicionit, markë me elemente përsëritëse, markë formë, markë ngjyrë ose lloj tjetër marke);

1.10 Ngjyrën ose kombinimin e ngjyrave që kërkohen të mbrohen dhe emrat e ngjyrës ose ngjyrave të pretenduara si dalluese të markës;

1.11 Kategorinë e markës (individuale, kolektive, certifikuese);

1.12 Konvertimin e shkronjave dhe/ose të numrave të markës;

1.13 Përshkrimin e markës;

1.14 Përkthimin e markës në gjuhën shqipe;

1.15 Klasifikimin e elementeve të markës figurë në përputhje me klasifikimin e Vjenës;

1.16 Rregullat e përdorimit sipas një kontrate të depozituar për përdorimin e markës kolektive ose certifikuese, nëse marka e regjistruar është e tillë.

1.17 Datën e publikimit të aplikimit në buletin zyrtar;

1.18 Të dhënat në lidhje me statusin e markës;

1.19 Datën e regjistrimit të markës;

1.20 Datën e mbarimit të mbrojtjes së markës;

1.21 Datën e publikimit të regjistrimit të markës në buletin zyrtar;

1.22 Të dhënat në lidhje me ndryshimet / korrigjimet e aplikimit ose të regjistrimit, sipas nenit 37 të kësaj rregulloreje;

1.23 Datën dhe numrin e regjistrimit ndërkombëtar, nëse kjo markë ka një regjistrim ndërkombëtar;

1.24 Të dhënat në lidhje me ripërtëritjen e regjistrimit të markës;

1.25 Të dhënat në lidhje me ndarjen e një aplikimi;

1.26 Të dhënat në lidhje me ndryshimet në markë, si: transferimi, licencimi, pengu, veprime përmbare, ndryshime në emër dhe adresë të aplikantit, të pronarit të markës ose të përfaqësuesit të autorizuar, kufizimet e listës së mallrave ose të shërbimeve, ndryshimet në kontratat e përdorimit të markave kolektive dhe tregues të tjerë thelbësorë në lidhje me statusin ligjor të markës;

1.27 Të dhënat në lidhje me kundërshtimin e depozituar;

1.28 Të dhënat në lidhje me kërkesën për shfuqizimin e një marke;

1.29 Të dhënat në lidhje me kërkesën për deklarimin si të pavlefshme të një marke;

1.30 Të dhënat në lidhje me dorëheqjen nga marka;

1.31 Të dhënat në lidhje me ndërprerjen e efekteve të markës, si dhe shkaqet përkatëse;

1.32 Të dhënat në lidhje me ankimin e vendimit të zyrës, si: ankuesi, numri dhe data e vendimit të ankuar të zyrës, data e paraqitjes së ankimit, përfaqësuesi i autorizuar, nëse është caktuar një i tillë, data dhe lloji i vendimit të lëshuar në lidhje me ankimin, kur depozitohet një kërkesë për ankim.

2. Përmbledhja zyrtare e të dhënave në lidhje me regjistrimin ndërkombëtar të markave administrohet nga Byroja Ndërkombëtare e OBPI-së. Me kërkesë të çdo personi të interesuar dhe pas pagesës së tarifës përkatëse, zyra lëshon ekstrakte nga përmbledhjet e të dhënave në lidhje me regjistrimet ndërkombëtare të markave që janë në dispozicion të zyrës.

Neni 26

Të dhënat që publikohen në buletin zyrtar për një markë të aplikuar

1. Zyra publikon në buletin zyrtar të dhënat e mëposhtme për një aplikim për markë:

1.1 Numrin e aplikimit;

1.2 Datën e depozitimit të aplikimit;

1.3 Emrin dhe adresën e aplikantit;

1.4 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse aplikanti ka caktuar një të tillë;

1.5 Listën e mallrave dhe/ose të shërbimeve;

1.6 Të dhënat për prioritetin (datën e ekspozimit të mallrave dhe/ose të shërbimeve në ekspozitë ose në panair, llojin e ekspozitës ose të panairit, vendin e organizimit ose datën e depozitimit dhe numrin i aplikimit të mëparshëm dhe vendin e depozitimit);

1.7 Përfaqësimin (pamjen) e markës;

1.8 Elementet në pamjen e markës që përjashtohen nga mbrojtja;

1.9 Emrat e ngjyrave që pretendohen kur marka kërkohet të regjistrohet ose të mbrohet në një ngjyrë ose kombinim ngjyrash. Ngjyra ose kombinimi i ngjyrave që kërkohet të mbrohet dhe emrat e ngjyrës ose ngjyrave të pretenduara si dalluese të markës;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

1.10 Një tregues që përcakton llojin e markës që kërkohet të regjistrohet: markë fjalë, markë figurë, markë e pozicionit, markë me elemente përsëritëse, markë formë, markë ngjyrë ose një lloj tjetër marke;

1.11 Një tregues që përcakton kategorinë e markës që kërkohet të regjistrohet: markë individuale, markë kolektive ose markë certifikuese.

2. Të dhënat e referuara në pikën 1 të këtij neni duhet të prezantohen nëpërmjet kodeve INID të vendosura nga OBPI-ja (standardet e OBPI-së, ST.60 dhe ST.3), duke identifikuar të dhënat bibliografike lidhur me markat.

3. Në buletin zyrtar publikohet si aplikimi për regjistrimin e një marke, ashtu dhe të dhënat korresponduese që referohen në pikën 1 të këtij neni. Në buletin publikohen gjithashtu edhe:

3.1 Ndryshimet në lidhje me aplikimin, që regjistrohen në regjistër;

3.2 Ndryshimet e aplikimit, sipas nenit 37 të kësaj rregulloreje;

3.3 Ndarja e aplikimit fillestar.

4. Në rastin kur një aplikim refuzohet, vendimi i refuzimit të aplikimit publikohet vetëm pasi të marrë formë të prerë.

5. Kur publikimi i një aplikimi përmban një gabim të bërë nga zyra ose nga aplikanti, zyra e korrigjon gabimin me iniciativën e vet ose me kërkesë të aplikantit dhe e publikon korrigjimin nëse aplikimi është publikuar më parë.

Neni 27

Të dhënat që publikohen në buletin zyrtar për një markë të regjistruar

1. Të dhënat që publikohen në buletin zyrtar për një markë të regjistruar janë:

1.1 Numri i aplikimit dhe i regjistrimit të markës;

1.2 Data e depozitimit të aplikimit;

1.3 Të dhëna në lidhje me aplikantin dhe pronarin e markës, siç janë paraqitur në regjistër;

1.4 Të dhëna në lidhje me përfaqësuesin e autorizuar, nëse është caktuar një i tillë;

1.5 Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve;

1.6 Të dhëna për prioritetin (data e prioritetit nga ekspozita/panairi ose data dhe numri i aplikimit të mëparshëm, si dhe shteti ku është depozituar);

1.7 Përfaqësimi (pamja) i markës;

1.8 Elemente të pamjes së markës që përjashtohen nga mbrojtja;

1.9 Lloji i markës (markë fjalë, markë figurë, markë e pozicionit; markë me elemente përsëritëse, markë formë, markë ngjyrë ose një lloj marke tjetër);

1.10 Ngjyra ose kombinimi i ngjyrave për një markë, që tregon se marka kërkohet të mbrohet në një ngjyrë ose kombinim ngjyrash;

1.11 Një tregues që përcakton kategorinë e markës që kërkohet të regjistrohet: markë individuale, markë kolektive ose markë certifikuese;

1.12 Data e mbarimit të mbrojtjes së markës.

2. Të dhënat e referuara në pikën 1 të këtij neni duhet të paraqiten nëpërmjet kodeve INID.

3. Të dhënat e referuara në pikën 1 të këtij neni duhet të publikohen në buletin zyrtar, ku publikohet gjithashtu çdo ndryshim që ka të bëjë me regjistrimin në regjistër të ndryshimeve në lidhje me një markë të regjistruar.

Neni 28

Të dhënat që përmban certifikata e regjistrimit të markës

Certifikata e regjistrimit të markës përmban të dhënat e mëposhtme:

1. Numrin e aplikimit dhe të regjistrimit të markës;

2. Datën e aplikimit dhe të regjistrimit të markës;

3. Emrin dhe adresën e pronarit të markës;

4. Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar nëse është caktuar një i tillë;

5. Listën e mallrave dhe/ose shërbimeve;

6. Të dhënat në lidhje me prioritetin;

7. Përfaqësimin (pamjen) e markës;

8. Elementet në pamjen e markës që përjashtohen nga mbrojtja;

9. Të dhënat në lidhje me llojin e markës (markë fjalë, markë figurë, markë e pozicionit; markë me elemente përsëritëse, markë formë, markë ngjyrë ose një lloj marke tjetër);

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

10. Emrin/emrat e ngjyrës ose kombinimit të ngjyrave të një marke të regjistruar;
11. Një tregues që përcakton kategorinë e markës që kërkohet të regjistrohet: markë individuale, markë kolektive ose markë certifikuese;
12. Datën e publikimit të regjistrimit në buletin zyrtar;
13. Datën e mbarimit të mbrojtjes.

KREU V

KUNDËRSHTIMI PËR REGJISTRIMIN E MARKËS

Neni 29

Paraqitja e kundërshtimit ndaj regjistrimit të një marke

1. Kërkesa për kundërshtimin e regjistrimit të markës së publikuar në Dhomën për Shqyrtimin e Kundërshtimeve depozitohet brenda tre muajve nga data e publikimit të aplikimit në buletin zyrtar. Kërkesa mund të paraqitet nga personat e parashikuar në pikën 1 të nenit 152 të ligjit.
2. Për kundërshtimin e regjistrimit të një marke të publikuar depozitohet në zyrë një kërkesë e veçantë, e cila paraqitet në dy kopje të njëjta.
3. Kërkesa për kundërshtimin e regjistrimit të markës së publikuar në Dhomën për Shqyrtimin e Kundërshtimeve përmban:
 - 3.1 Formularin për kundërshtimin e regjistrimit të markës së publikuar në Dhomën për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje, me të dhënat e mëposhtme:
 - 3.1.1 Numrin e aplikimit për regjistrimin e markës për të cilën është depozituar kërkesa për kundërshtim;
 - 3.1.2 Emrin dhe adresën e aplikantit ndaj aplikimit të të cilit është depozituar kërkesa për kundërshtim;
 - 3.1.3 Emrin dhe adresën e kundërshtuesit, në përputhje me nenin 62 të kësaj rregulloreje;
 - 3.1.4 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse kundërshtuesi ka caktuar një të tillë, në përputhje me nenin 62 të kësaj rregulloreje;
 - 3.1.5 Listën e mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat është depozituar kërkesa për kundërshtim;
 - 3.1.6 Nënshkrimin e kundërshtuesit ose të përfaqësuesit të tij;
 - 3.2 Bazën ligjore të kundërshtimit, sipas nenit 143 të ligjit;
 - 3.3 Provat në lidhje me bazën ligjore të kërkesës për kundërshtim;
 - 3.4 Argumentet e kërkesës për kundërshtim;
 - 3.5 Pagesën e tarifës përkatëse.
 - 3.6 Autorizimin e përfaqësimit, nëse kërkesa depozitohet nga përfaqësuesi i kundërshtuesit.

Neni 30

Shqyrtimi i kundërshtimit

1. Dhoma e Kundërshtimeve e shqyrton një kundërshtim brenda dy muajve nga data e paraqitjes së kërkesës për kundërshtim.
2. Nëse kërkesa për kundërshtim nuk paraqitet brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit 152 të ligjit, Dhoma e Kundërshtimeve e refuzon kërkesën për kundërshtim dhe njofton kundërshtuesin për vendimin e refuzimit.
3. Në rast se kundërshtimi nuk i plotëson kushtet e nenit 29 të kësaj rregulloreje, Dhoma e Kundërshtimeve i kërkon kundërshtuesit, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të plotësojë të metat e konstatuara brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit. Në rast se të metat nuk plotësohen brenda afatit, kundërshtimi do të konsiderohet sikur të mos jetë paraqitur.
4. Kur kundërshtuesi i plotëson të metat, Dhoma e Kundërshtimeve i dërgon një kopje të kundërshtimit aplikantit të markës së kundërshtuar, si dhe e njofton atë me shkrim të paraqesë argumentet, si dhe çdo dokument tjetër në mbështetje të argumenteve të tij, brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.
5. Gjatë shqyrtimit, Dhoma e Kundërshtimeve ka të drejtë t'u kërkojë palëve, nëpërmjet njoftimit me shkrim, të paraqesin materiale dhe dokumente të tjera shtesë, brenda një periudhe dymujore nga data e marrjes së njoftimit.
6. Dhoma e Kundërshtimeve merr vendim lidhur me kundërshtimin brenda dy muajve nga data e plotësimit të dosjes, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni dhe njofton me shkrim palët mbi vendimin e marrë.
7. Vendimi i Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të ankimohet në bordin e apelit kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

8. Kur Dhoma e Kundërshtimeve vendos se marka nuk mund të regjistrohet për një ose disa mallra dhe/ose shërbime për të cilat është bërë aplikimi për markë, aplikimi do të refuzohet në lidhje me ato mallra dhe/ose shërbime.

9. Kur Dhoma e Kundërshtimeve vendos për rrëzimin e kundërshtimit dhe vendimi i refuzimit nuk ankimohet në bordin e apelit, ky vendim merr formë të prerë dhe një kopje e tij depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e markës dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën për regjistrimin e saj.

10. Kur Dhoma e Kundërshtimeve vendos për pranimin e kundërshtimit dhe vendimi i pranimit nuk apelohehet në bordin e apelit, ky vendim merr formë të prerë e një kopje e tij depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e markës dhe ekzaminuesi refuzon regjistrimin e markës e njofton aplikantin e aplikimit për vendimin e refuzimit të regjistrimit. Ky vendim publikohet në buletin zyrtar.

11. Kur vendimi i Dhomës së Kundërshtimeve, lidhur me kundërshtimin për regjistrimin e një marke, apelohehet në bordin e apelit, vendimi i këtij të fundit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e markës, si dhe publikohet në buletin zyrtar.

12. Kur vendimi i bordit të apelit apelohehet në gjykatë, vendimi i kësaj të fundit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e markës, si dhe publikohet në buletin zyrtar.

KREU VI

RIVENDOSJA NË AFAT E SË DREJTËS

Neni 31

Paraqitja e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës

Në përputhje me parashikimin e nenit 151/c të ligjit, aplikanti i një aplikimi për markë ose përfaqësuesi i tij mund të kërkojë rivendosjen në afat të së drejtës brenda dy muajve nga mënjanimi i shkakut të mosrespektimit të afatit, por jo më vonë se 1 (një) vit nga mbarimi i afatit të humbur. Kërkesa për rivendosje në afat të së drejtës përmban:

1. Formularin e aplikimit për rivendosje në afat të së drejtës, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje me të dhënat e mëposhtme:

1.1 Numrin e aplikimit të markës për të cilën është depozituar kërkesa për rivendosje në afat;

1.2 Emrin dhe adresën e aplikantit të aplikimit për markë për të cilën është depozituar kërkesa për rivendosje në afat;

1.3 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse aplikanti ka caktuar një të tillë, në përputhje me nenin 62 të kësaj rregulloreje;

1.4 Shkaqet/arsyet e mosrespektimit të afatit;

1.5 Nënshkrimin e aplikantit ose të përfaqësuesit të tij.

2. Pagesën e tarifës përkatëse;

3. Autorizimin e përfaqësimit, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i aplikantit.

Neni 32

Shqyrtimi i kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës

1. Zyra shqyrton kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës brenda një afati njëmuajor nga data e marrjes së saj, nëse është në përputhje me parashikimet e nenit 151/c të ligjit dhe nenit 31 të kësaj rregulloreje. Në rast se zyra e pranon kërkesën për rivendosjen e së drejtës, njofton me shkrim aplikantin e markës për rivendosjen e së drejtës dhe afatin brenda të cilit ai duhet të plotësojë të metat dhe e publikon atë në buletin zyrtar. Refuzimi i bërë nga zyra shfuqizohet dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën në përputhje me ligjin.

2. Kur një aplikant i janë rivendosur të drejtat në lidhje me aplikimin për markë, ai nuk mund të përdorë të drejtat e tij kundrejt një pale të tretë, e cila, në mirëbesim, ka hedhur mallra dhe/ose shërbime në treg nën një shenjë identike ose të ngjashme me aplikimin për markë gjatë periudhës midis humbjes të të drejtave të aplikimit dhe publikimit të vendimit të zyrës për rivendosjen në afat të këtyre të drejtave.

3. Në rast se kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 151/c të ligjit dhe të nenit 31 të kësaj rregulloreje, zyra e refuzon kërkesën për rivendosjen në afat dhe njofton me shkrim aplikantin.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

4. Vendimi i zyrës për refuzimin e rivendosjes në afat mund të apelohej në bordin e apelit brenda 1 muaji nga data e marrjes së vendimit të refuzimit.

KREU VII

NDRYSHIME NË REGJISTRIN E MARKAVE

Neni 33

Përmbajtja e kërkesës për ndryshime në regjistër

1. Kërkesa për regjistrimin e një ndryshimi në regjistër përmban:
 - 1.1 Formularin e kërkesës për regjistrimin e një ndryshimi në regjistrin që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, në të cilin do të jenë të specifikuar të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1.1 Numrin e aplikimit ose numrin e regjistrimit të markës;
 - 1.1.2 Emrin dhe adresën e aplikantit ose të pronarit të markës, ashtu siç është shënuar në regjistër;
 - 1.1.3 Emrin dhe adresën e personit që depoziton kërkesën, në përputhje me nenin 62 të kësaj rregulloreje;
 - 1.1.4 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse është caktuar një i tillë;
 - 1.1.5 Llojin e ndryshimit të kërkuar;
 - 1.1.6 Ndryshimin e kërkuar nga aplikanti ose pronari i markës;
 - 1.1.7 Listën e mallrave apo/dhe të shërbimeve për të cilat është kërkuar ndryshimi në regjistër;
 - 1.1.8 Nënshkrimin e personit që depoziton kërkesën ose të përfaqësuesit të tij;
 - 1.2 Dokumentin ligjor ku bazohet ndryshimi, përveç rasteve për ndryshim të adresës së aplikantit, ndryshim të adresës së pronarit të markës apo ndryshim të adresës së përfaqësuesit të autorizuar;
 - 1.3 Pagesën e tarifës përkatëse;
 - 1.4 Autorizimin e përfaqësimit, nëse aplikanti/ pronari i markës ka caktuar një përfaqësues.
2. Parashikimet e këtij neni, si dhe të neneve 34 e 35 të kësaj rregulloreje, aplikohen gjithashtu për pasqyrimin në regjistër të transferimit të pronësisë, ndryshimit të emrit, adresës së pronarit apo aplikantit të një marke, kontratave të licencimit, pengut, veprimeve përmbartimore, si dhe të çdo ndryshimi tjetër, i cili duhet ose kërkohej të pasqyrohet në regjistër.
3. Nëse elementi fjalë i markës tregtare të aplikuar ose të regjistruar më parë përkon me TGJM-në ose EOM-në, marka tregtare në fjalë nuk mund të transferohet, të licencohet ose të lihet peng me një marrëveshje.

Neni 34

Dokumente të tjera në lidhje me kërkesën për regjistrimin e ndryshimeve në regjistër

1. Kur kërkesa për regjistrimin e një ndryshimi në regjistër lidhet me disa aplikime/regjistrime, të cilat kanë aplikantë ose pronarë të njëjtë, mund të depozitohet një kërkesë e vetme, me kusht që:
 - 1.1 Numrat e aplikimit ose të regjistrimit të të gjitha aplikimeve ose të regjistrimeve të jenë treguar në kërkesë;
 - 1.2 Në rastin e transferimit të pronësisë së markës, transferimi duhet të jetë i plotë për të gjitha mallrat apo shërbimet;
 - 1.3 Paga të jetë kryer për të gjitha ndryshimet e kërkuara.
2. Nëse është kërkuar një transferim i pjesshëm i pronësisë, zyra krijon një aplikim dhe/ose regjistrim të ri të markës, i cili përmban mallrat apo shërbimet për të cilat është kryer transferimi. Kur transferimi përmban mallra ose shërbime që i referohen një termi të përgjithshëm, ky term duhet të përdoret në të gjitha listat e mallrave dhe/ose të shërbimeve të cilat është transferuar ky term, duke e kufizuar me shtesa të përshtatshme për të shmangur mbivendosjen e listës së mallrave dhe/ose të shërbimeve.
3. Një kopje e plotë e dokumenteve të aplikimit apo të regjistrimit fillestar të markës bëhet pjesë e dokumenteve të aplikimit ose të regjistrimit të referuar në pikën 2 të këtij neni. Një kopje e kërkesës për regjistrimin e transferimit bëhet pjesë e dokumenteve të aplikimit ose të regjistrimit fillestar.
4. Aplikimit ose regjistrimit të një marke, sipas pikës 2 të këtij neni, i jepet një numër i ri aplikimi dhe/ose regjistrimi.
5. Të gjitha kërkesat e paraqitura dhe tarifat e paguara në lidhje me aplikimin ose regjistrimin fillestar të një marke do të konsiderohen se janë paraqitur dhe paguar edhe për aplikimet ose regjistrimet e referuara në pikën 2 të këtij neni, nëse ato mbulojnë të njëjtat mallra dhe/ose shërbime për të cilat kanë nisur procedurat.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

6. Dokumenti ligjor ku bazohet ndryshimi, sipas pikës 1.2, të nenit 33, të kësaj rregulloreje, duhet të jetë, si më poshtë vijon:

6.1 Për transferimin e pronësisë, sipas rastit:

6.1.1 Dokumenti që vërteton transferimin e pronësisë në formën e një marrëveshjeje të nënshkruar nga të dyja palët dhe e vërtetuar nga noteri.

6.1.2 Ekstrakti tregtar i lëshuar nga autoriteti kompetent për shoqëritë tregtare ku të evidentohet pronari i ri i markës.

6.1.3 Në rastet kur transferimi i pronësisë ka të bëjë me ndryshimin e formës ligjore të shoqërisë, do të depozitohet ekstrakti tregtar i lëshuar nga autoriteti kompetent për shoqëritë tregtare ku të evidentohet ndryshimi përkatës.

6.2 Për ndryshimin e emrit, sipas rastit:

6.2.1 Dokumenti që vërteton ndryshimin e emrit;

6.2.2 Ekstrakti tregtar i lëshuar nga autoriteti kompetent për shoqëritë tregtare ku të evidentohet ndryshimi përkatës.

6.3 Për regjistrimin e kontratës së licencës:

6.3.1 Marrëveshja/kontrata e licencës, e cila nënshkruhet nga të dyja palët dhe e vërtetuar nga noteri;

6.3.2 Kohëzgjatja e licencës;

6.3.3 Mënyra e përdorimit të markës nga i licencuari;

6.3.4 Mallrat dhe/ose shërbimet për të cilat është dhënë licenca;

6.3.5 Territori ku do të përdoret marka për të cilën është dhënë licenca;

6.3.6 Cilësia e mallrave të prodhuara apo shërbimeve të ofruara;

6.3.7 Detyrimet që licencuesi i vendos të licencuarit për zbatimin e kushteve të përcaktuara në kontratë;

6.3.8 Lloji i licencës: licencë ekskluzive ose joekskluzive.

7. Një kontratë licence e regjistruar mund të ndryshohet ose të anulohet me kërkesë të njëres prej palëve dhe çdo ndryshim i saj duhet të regjistrohet në regjistër. Çdo ndryshim duhet të shoqërohet me dokumentet provuese përkatëse.

Neni 35

Procedura në lidhje me shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin e ndryshimeve në regjistër

1. Nëse kërkesa për regjistrimin e një ndryshimi në regjistër nuk është depozituar në përputhje me ligjin dhe këtë rregullore, zyra njofton me shkrim personin për plotësimin e të metave ose për depozitim të dokumenteve shtesë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

2. Nëse aplikanti që ka depozituar kërkesën i plotëson të metat ose depoziton dokumentet shtesë brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit, zyra vendos në lidhje me kërkesën për regjistrimin e ndryshimit.

3. Me kërkesë të aplikantit, afati dymujor mund të zgjatet deri në dy muaj shtesë kundrejt pagesës së tarifës përkatëse për këtë qëllim.

4. Nëse aplikanti nuk plotëson të metat ose nuk depoziton dokumentet shtesë, sipas pikës 1 të këtij neni, brenda dy muajve ose brenda afatit shtesë, kur kërkohet afat shtesë, zyra e refuzon kërkesën për regjistrimin e ndryshimit në regjistër.

Neni 36

Ripërtëritja e regjistrimit të një marke

1. Regjistrimi i markës ripërtërihet me kërkesë, pasi të jetë bërë pagesa e tarifës përkatëse.

2. Zyra informon pronarin e markës dhe çdo përfaqësues të pronarit ose person tjetër që ka një të drejtë të regjistruar në lidhje me markën, për mbarimin e mbrojtjes të paktën 6 muaj para kësaj date. Mospërmbushja e këtij detyrimi nuk sjell përgjegjësi për zyrën dhe as nuk ndikon në mbarimin e mbrojtjes së markës.

3. Kërkesa për ripërtëritjen e markës dhe tarifa bazë për ripërtëritje, duke përfshirë tarifat për klasat shtesë, duhet të paguhet e duhet të depozitohet brenda 6 (gjashtë) muajve para datës së mbarimit të mbrojtjes.

4. Kërkesa për ripërtëritjen e markës dhe pagesat përkatëse mund të depozitohen dhe të paguhen edhe pasi afati i mbrojtjes të ketë mbaruar, por jo më vonë se gjashtë muaj nga data e mbarimit të mbrojtjes. Në këtë rast, paguhet një tarifë shtesë.

5. Kërkesa për ripërtëritje e markës përmban:

5.1 Formularin e aplikimit për ripërtëritjen e markës, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, me të dhënat e mëposhtme:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- 5.1.1 Numrin e aplikimit ose numrin e regjistrimit të markës që kërkohet të ripërtërihet;
- 5.1.2 Emrin dhe adresën e pronarit të markës;
- 5.1.3 Emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse është caktuar një i tillë;
- 5.1.4 Listën e mallrave dhe/ose të shërbimeve të grupuara sipas klasifikimit të Nicsës vetëm nëse ripërtëritja kërkohet për një pjesë të listës së mallrave dhe/ose të shërbimeve;
- 5.1.5 Nënshkrimin e personit që depoziton kërkesën ose të përfaqësuesit të tij.
- 5.2 Pagesën e tarifës përkatëse.
- 5.3 Autorizimin e përfaqësimit, nëse ripërtëritja kërkohet për një pjesë të listës së mallrave dhe/ose shërbimeve dhe pronari ka caktuar një përfaqësues.
6. Kur kërkesa është paraqitur dhe pagesa është kryer vetëm për disa mallra dhe/ose shërbime për të cilat është regjistruar marka, regjistrimi do të ripërtërihet vetëm për ato mallra dhe/ose shërbime.
7. Kur pagesa e kryer nuk është e mjaftueshme për të mbuluar të gjitha klasat e mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat kërkohet ripërtëritja, regjistrimi do të ripërtërihet nëse është e qartë se cila ose cilat klasa duhet të mbulohen.
8. Nëse nuk është e qartë se nga cilat klasa mbulohen mallrat dhe/ose shërbimet, zyra do të ripërtërijë markën sipas rendit të klasifikimit.
9. Ripërtëritja i fillon efektet nga e nesërmja e datës kur mbaron afati i regjistrimit ekzistues.
10. Ripërtëritja duhet të regjistrohet në regjistrin e markave.
11. Kur kërkesa për ripërtëritjen e markës është depozituar dhe pagesa e tarifës përkatëse është kryer brenda afateve të parashikuara në pikat 3 e 4 të këtij neni, por nuk janë plotësuar të gjitha kushtet për ripërtëritjen, zyra njofton me shkrim aplikantin për plotësimin e të metave brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit. Ky afat mund të zgjatet me dy muaj shtesë kundrejt kërkesës dhe pagesës së tarifës për shtyrje afati.
12. Kur kërkesa për ripërtëritjen e markës nuk është depozituar ose është depozituar pas periudhës së përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, ose kur nuk janë paguar tarifat përkatëse brenda afateve të përcaktuara më lart në këtë nen, zyra njofton pronarin e markës ose përfaqësuesin e tij se regjistrimit i ka mbaruar mbrojtja dhe se do të bëjë pasqyrimin e këtij fakti (vendim) në regjistrin e markave.
13. Kur pronari ose përfaqësuesi i tij nuk kanë plotësuar të metat brenda afatit ose ato nuk janë plotësuar si duhet brenda afatit, zyra njofton pronarin e markës ose përfaqësuesin e tij në lidhje me vendimin e marrë sipas këtij neni.
14. Zyra publikon çdo vendim për ripërtëritjen e një marke ose refuzimin e ripërtëritjes së markës.
15. Kur pagesa është kryer, por kërkesa për ripërtëritje refuzohet nga zyra, kjo pagesë rimbursohet në masën 80% kundrejt një kërkesë me shkrim të aplikantit ose përfaqësuesit të tij.

Neni 37

Korrigjime në aplikimin ose regjistrimin e një marke

1. Me kërkesë të aplikantit, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, ose me iniciativë të zyrës, mund të bëhen korrigjime në aplikim ose regjistrim në lidhje me emrin, adresën e aplikantit ose listën e mallrave dhe/ose të shërbimeve, vetëm në rastet kur është e nevojshme për të korrigjuar gabime ortografike të dukshme.
2. Në rastin kur gabimi në aplikim ose regjistrim është shkaktuar nga zyra, aplikanti nuk ka detyrim të paguajë tarifën përkatëse, sipas pikës 1 të këtij neni.
3. Përfaqësimi (pamja) i një marke nuk mund të ndryshohet (korrigjohet), me përjashtim të rastit kur ai përmban emrin dhe adresën e aplikantit. Në këtë rast, me kërkesë të aplikantit dhe kundrejt pagesës përkatëse, pamja mund të ndryshohet (korrigjohet), por pa prekur thelbin e pamjes së markës së aplikuar.
4. Zyra shqyrton kërkesën për korrigjim brenda një muaji nga data e paraqitjes së saj.
5. Çdo korrigjim i bërë në një aplikim për markë të publikuar ose markë të regjistruar publikohet në buletin zyrtar të radhës.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

KREU VIII PROCEDIMET PARA ZYRËS NË LIDHJE ME SHFUQIZIMIN DHE ME ZHVLERËSIMIN E MARKAVE

Neni 38

Përmbajtja e kërkesës për shfuqizimin e një marke

1. Kërkesa për shfuqizimin e një marke të regjistruar në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim, bazuar në nenin 173 të ligjit, duhet të depozitohet si kërkesë më vete në dy kopje të njëjta.
2. Kërkesa për shfuqizimin e markës përmban:
 - 2.1 Formularin e aplikimit për shfuqizimin/ zhvlerësimin e një marke të regjistruar në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, ku do të jenë të specifikuara të dhënat, si më poshtë vijon:
 - 2.1.1 Numri i regjistrimit të markës për të cilën është kërkuar shfuqizimi;
 - 2.1.2 Emri dhe adresa e pronarit të markës;
 - 2.1.3 Emri dhe adresa e personit që depoziton kërkesën, sipas nenit 62 të kësaj rregulloreje;
 - 2.1.4 Emri dhe adresa e përfaqësuesit të autorizuar, nëse është caktuar një i tillë në përputhje me nenin 62 të kësaj rregulloreje;
 - 2.1.5 Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat kërkohet shfuqizimi;
 - 2.1.6 Nënshkrimi i personit që depoziton kërkesën ose i përfaqësuesit të autorizuar të tij.
 - 2.2 Bazën ligjore ku mbështetet kërkesa për shfuqizimin e markës;
 - 2.3 Provat në lidhje me bazën ligjore ku mbështetet kërkesa për shfuqizimin e markës;
 - 2.4 Argumentet ku mbështetet kërkesa për shfuqizimin;
 - 2.5 Pagesën e tarifës përkatëse;
 - 2.6 Autorizimin e përfaqësimit, nëse aplikuesi ka caktuar një përfaqësues.

Neni 39

Përmbajtja e kërkesës për zhvlerësimin e një marke

1. Kërkesa për zhvlerësimin e një marke të regjistruar, bazuar në nenin 174 të ligjit, duhet të depozitohet si kërkesë më vete në dy kopje të njëjta.
2. Kërkesa për zhvlerësimin e markës përmban:
 - 2.1 Formularin e aplikimit për shfuqizimin/ zhvlerësimin e një marke të regjistruar në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, ku do të jenë të specifikuara të dhënat, si më poshtë vijon:
 - 2.1.1 Numri i regjistrimit të markës për të cilën është depozituar kërkesa;
 - 2.1.2 Emri dhe adresa e pronarit të markës;
 - 2.1.3 Emri dhe adresa e personit që depoziton kërkesën, në përputhje me nenin 62 të kësaj rregulloreje;
 - 2.1.4 Emri dhe adresa e përfaqësuesit të autorizuar, nëse është caktuar një i tillë në përputhje me nenin 62 të kësaj rregulloreje;
 - 2.1.5 Lista e mallrave ose e shërbimeve për të cilat është kërkuar zhvlerësimi;
 - 2.1.6 Nënshkrimi i personit që depoziton kërkesën ose e përfaqësuesit të autorizuar të tij.
 - 2.2 Bazën ligjore ku mbështetet kërkesa për zhvlerësimin e markës;
 - 2.3 Argumentet ku mbështetet kërkesa për zhvlerësimin e markës;
 - 2.4 Pagesën e tarifës përkatëse;
 - 2.5 Autorizimin e përfaqësimit, nëse aplikuesi ka caktuar një përfaqësues.

Neni 40

Shqyrtimi i kërkesave për shfuqizimin e një marke

1. Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim shqyrton kërkesën për shfuqizim të një marke të regjistruar brenda dy muajve nga data e paraqitjes së saj. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për shfuqizimin e një marke të regjistruar, Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim fton palët, për aq sa është e nevojshme, që të depozitojnë pretendimet e tyre brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit, në lidhje me komunikimet e paraqitura nga palët e tjera ose të bëra nga vetë Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Nëse Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim e konsideron të arsyeshme, ajo mund t'i ftojë palët të gjejnë një zgjidhje me mirëkuptim, nëpërmjet një marrëveshjeje, e cila, nëse arrihet, duhet të jetë me shkrim dhe e nënshkruar nga të dyja palët.

3. Kur Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim vendos se marka shfuqizohet për një ose disa mallra dhe/ose shërbime për të cilat marka është regjistruar, marka shfuqizohet në lidhje me ato mallra dhe/ose shërbime.

4. Çdo vendim i Dhomës për Shfuqizim/ Zhvlerësim në lidhje me një markë, pasi merr formë të prerë, publikohet në buletin zyrtar dhe regjistrohet në regjistrin e markave.

Neni 41

Shqyrtimi i kërkesave për zhvlerësimin e një marke

1. Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim shqyrton kërkesën për zhvlerësim të një marke brenda dy muajve nga data e paraqitjes së saj. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për zhvlerësimin e një marke të regjistruar, Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim fton palët, për aq sa është e nevojshme, që të depozitojnë pretendimet e tyre, brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit, në lidhje me komunikimet e paraqitura nga palët e tjera ose të bëra nga vetë Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim.

2. Në rastin e një kërkesë për zhvlerësimin e një marke të regjistruar, barra e provës bie mbi pronarin e markës për të cilën është kërkuar zhvlerësimi, vetëm në rast se kërkesa për zhvlerësim paraqitet sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 174, të ligjit, i cili duhet të paraqesë prova për përdorimin e markës ose prova që ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për mospërdorimin e markës.

3. Kur Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim vendos se marka zhvlerësohet për një ose disa mallra dhe/ose shërbime për të cilat marka është regjistruar, marka zhvlerësohet në lidhje me ato mallra dhe/ose shërbime.

4. Çdo vendim i Dhomës për Shfuqizim/ Zhvlerësim për shfuqizimin e një marke të regjistruar, pasi merr formë të prerë, publikohet në buletin zyrtar dhe regjistrohet në regjistrin për markat.

KREU IX

APELIMI

Neni 42

Apelimi i vendimeve

1. Çdo vendim për refuzim që merret gjatë procesit të ekzaminimit mund të apelohej në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim brenda 1 muaji nga data e marrjes së vendimit, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në ligj ose në këtë rregullore.

2. Vendimet që mund të apelohej në bordin e apelimit, janë:

2.1 Vendimet e marra nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve;

2.2 Vendimet e marra nga Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim;

2.3 Vendimet për rivendosjen në afat.

3. Apelimi i një vendimi sjell si pasojë pezullimin e ndjekjes së mëtejshme të procedurës përkatëse.

4. Vendimet e parashikuara më lart hyjnë në fuqi pasi marrin formë të prerë.

Neni 43

Procedurat e apelimit

1. Procedura e apelimit kundër një vendimi të zyrës fillon me paraqitjen e kërkesës për apelim në strukturën përkatëse.

2. Kërkesa për apelim, sipas pikës 1, të nenit 42, të kësaj rregulloreje përmban:

2.1 Formularin për apelimin vendimeve të refuzimit në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, në të cilin do të jepen të dhënat e mëposhtme:

2.1.1 Emri dhe adresa e apellesit, në përputhje me nenin 62 të kësaj rregulloreje;

2.1.2 Vendimi i zyrës ndaj të cilit është depozituar apelimi;

2.1.3 Numri i aplikimit të markës;

2.1.4 Një tregues që përcakton nëse kemi të bëjmë me një apelim të pjesshëm apo të plotë të vendimit të zyrës.

2.2 Bazën ligjore ku është mbështetur apelimi;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- 2.3 Argumentet dhe/ose provat mbi të cilat mbështetet apelimi;
- 2.4 Pagesën e tarifës përkatëse;
- 2.5 Autorizimin e përfaqësimit, nëse apelimi është depozituar nga një përfaqësues.
3. Kërkesa për apelim, sipas pikës 2, të nenit 42, të kësaj rregulloreje, përmban:
 - 3.1 Formularin e aplikimit për apelimin e vendimit në bordin e apelit, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, në të cilin do të jepen të dhënat, si më poshtë vijon:
 - 3.1.1 Emri dhe adresa e apeluesit, në përputhje me nenin 62 të kësaj rregulloreje;
 - 3.1.2 Vendimi i zyrës ndaj të cilit është depozituar apelimi;
 - 3.1.3 Numri i aplikimit ose i regjistrimit të markës;
 - 3.1.4 Një tregues që përcakton nëse kemi të bëjmë me një apelim të pjesshëm apo të plotë të vendimit të zyrës.
 - 3.2 Argumentet dhe/ose provat mbi të cilat mbështetet apelimi;
 - 3.3 Pagesën e tarifës përkatëse;
 - 3.4 Autorizimin e përfaqësimit, nëse apelimi është depozituar nga një përfaqësues.
4. Kërkesa për apelim depozitohet si kërkesë më vete në dy kopje të njëjta.
5. Çdo strukturë përkatëse, si: Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim dhe bordi i apelit, kur shqyrton një kërkesë, në përputhje me kompetencat përkatëse të parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore, duhet të shprehet me pranimin, pranimin e pjesshëm ose rrëzimin e kërkesës, objekt shqyrtimi.
6. Pretendimi i një pale kundërshtare, që nuk lidhet me objektin e kërkesës, nuk merret në shqyrtim nga bordi i apelimit.

Neni 44

Shqyrtimi i kërkesave nga bordi i apelimit

1. Sekretari i bordit të apelimit, brenda një muaji nga data e paraqitjes së kërkesës për apelim, kontrollon kërkesën nëse përmban dokumentet e parashikuara në pikën 3, të nenit 43, të kësaj rregulloreje.
2. Kur një kërkesë për apelim është paraqitur në përputhje me pikën 3, të nenit 43, të kësaj rregulloreje, sekretari i bordit të apelimit i dërgon palës kundër së cilës është paraqitur apelimi, një kopje të kërkesës për apelim, si dhe e njofton atë të paraqesë, brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit, argumentet dhe çdo dokument tjetër në lidhje me apelimin.
3. Në rast se një kërkesë për apelim nuk është paraqitur në përputhje me kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit 43, të kësaj rregulloreje, sekretari i bordit të apelimit e njofton me relacion me shkrim bordin e apelit, i cili e refuzon kërkesën për apelim dhe njofton apeluesin për vendimin e marrë.
4. Sekretari i bordit të apelimit, brenda 1 muaji nga mbarimi i afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, i paraqet bordit për shqyrtim kërkesën për apelim.
5. Bordi i apelit e shqyrton një kërkesë brenda tre muajve nga data e paraqitjes së saj në bord.
6. Gjatë shqyrtimit të një kërkesë apelimi, bordi i apelit, kur e konsideron të arsyeshme, ka të drejtë t'u kërkojë palëve, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të paraqesin prova dhe dokumente të tjera shtesë brenda një periudhe të arsyeshme, por, në çdo rast, jo më vonë se një muaj nga data e marrjes së njoftimit nga pala.
7. Nëse bordi i apelit e konsideron të arsyeshme, i fton palët në seanca dëgjimore, si dhe u kërkon atyre të gjejnë një zgjidhje me mirëkuptim, e cila, nëse arrihet, duhet të materializohet në një marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët para noterit ose para bordit të apelit.
8. Sekretari i bordit i njofton palët e interesuara menjëherë pas marrjes së vendimit të bordit të apelit, por, në çdo rast, jo më vonë se 1 muaj nga marrja e vendimit.

Neni 45

Efekti i vendimeve

1. Vendimi i bordit të apelit merr formë të prerë nga e nesërmja e datës së mbarimit të afatit për ankim në gjykatë, kur asnjë nga palët nuk ka bërë ankim kundër vendimit të bordit.
2. Kur vendimi i bordit të apelit ose vendimi i gjykatës merr formë të prerë, zyra ekzekuton vendimin sipas legjislacioni në fuqi.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Në rast ankimi të vendimit të bordit të apelit në gjykatë, ankimuesi ka detyrimin të njoftojë DPPI-në brenda 1 muaji nga data e depozitimit të ankimit në gjykatë, me qëllim që të shmanget ekzekutimi i vendimit të bordit të apelit.

KREU X REGJISTRIMET NDËRKOMBËTARE

Neni 46

Aplikimi për regjistrim ndërkombëtar të markës dhe shqyrtimi i aplikimit nga zyra

1. Aplikimi për regjistrim ndërkombëtar të markës përmban:
 - 1.1 Formularin e përcaktuar nga Byroja Ndërkombëtare e *WIPO*-s, me specifikimet, si më poshtë vijon:
 - 1.1.1 Numri i aplikimit ose i regjistrimit të markës mbi të cilin bazohet aplikimi për regjistrim ndërkombëtar (në vijim, aplikimi ose regjistrimi bazë);
 - 1.1.2 Emri dhe adresa e aplikantit;
 - 1.1.3 Emri dhe adresa e përfaqësuesit të autorizuar, nëse është caktuar një i tillë;
 - 1.1.4 Përfaqësimi (pamja) i markës, e cila duhet të depozitohet identike si në aplikimin ose regjistrimin kombëtar.
 - 1.1.5 Të dhëna në lidhje me prioritetin, kur pretendohet për prioritet;
 - 1.1.6 Nëse regjistrimi i markës është kërkuar me ngjyrë, një tregues në lidhje me këtë fakt, si dhe emrat e ngjyrave që aplikanti i pretendon si karakteristika dalluese të markës. Ngjyrat duhet të tregohen sipas përcaktimeve të rregullores së përbashkët;
 - 1.1.7 Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat është kërkuar regjistrimi ndërkombëtar, në gjuhën e përcaktuar nga rregullorja e përbashkët. Lista e mallrave dhe/ose shërbimeve mund të mbulojë të gjithë mallrat ose shërbimet e aplikimit bazë ose një pjesë të tyre;
 - 1.1.8 Vendet anëtare të Unionit të Madridit, për të cilat kërkohet shtrirja e regjistrimit ndër-kombëtar;
 - 1.1.9 Përshkrimi i markës në aplikimin ndërkombëtar duhet të jetë i njëjtë me atë të aplikimit/regjistrimit bazë. Përkthimi i markës duhet të bëhet në një nga gjuhët e përcaktuara në rregulloren e përbashkët.
 - 1.1.10 Nënshkrimi i aplikantit ose i përfaqësuesit të tij.
 - 1.2 Pagesat e tarifave përkatëse.
2. Formulari sipas pikës 1.1 duhet të paraqitet në dy kopje të njëjta.
3. Zyra ekzaminon nëse aplikimi ndërkombëtar është depozituar në përputhje me rregullat e lartpërmendura dhe lëshon një njoftim për plotësim të parregullsive të aplikimit në rast se konstaton mospërputhje midis aplikimit bazë dhe aplikimit ndërkombëtar.
4. Aplikanti duhet të plotësojë parregullsitë e aplikimit të konstatuara nga zyra brenda një muaji nga data e marrjes së njoftimit.
5. Në rast se aplikanti nuk plotëson parregullsitë e aplikimit, zyra refuzon që të dërgojë aplikimin ndërkombëtar në *WIPO*-s.
6. Të njëjtat rregulla do të zbatohen edhe në rast të një kërkesë për shtrirje territoriale të markës në vijim të aplikimit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 3 (ter) (2) të Protokollit të Madridit. Kërkesa për shtrirje territoriale në vijim të aplikimit ndërkombëtar mund të depozitohet nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrës.

Neni 47

Kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin ndërkombëtar

1. Kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin ndërkombëtar duhet të përmbajë:
 - 1.1 Formularin përkatës të përcaktuar nga Byroja Ndërkombëtare e *WIPO*-s;
 - 1.2 Dokumentin që vërteton ndryshimin përkatës në regjistrë;
 - 1.3 Pagesat e tarifave përkatëse.
2. Formulari sipas pikës 1.1 duhet të paraqitet në dy kopje identike.
3. Kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrimin ndërkombëtar do të ekzaminohet nga zyra, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Marrëveshjen e Madridit dhe/ose Protokollin e Madridit.

Neni 48

Transformimi i një marke ndërkombëtare në një aplikim kombëtar për regjistrim marke

1. Kërkesa për transformimin e një marke ndërkombëtare në një aplikim për regjistrim kombëtar duhet të depozitohet brenda tre muajve nga data në të cilën regjistrimi ndërkombëtar është anuluar dhe duhet të shoqërohet me dokumentet, si më poshtë vijon:
 - 1.1 Formularin për transformimin e një marke ndërkombëtare në aplikim kombëtar;
 - 1.2 Dokumentin që vërteton se aplikimi ndërkombëtar është anuluar nga OBIP-ja, bazuar në kërkesën e zyrës së origjinës. Ky dokument duhet të depozitohet i përkthyer në gjuhën shqipe;
 - 1.3 Autorizimin e përfaqësimit, në rast se kërkesa depozitohet nga përfaqësuesi;
 - 1.4 Pagesën e tarifës përkatëse.
2. Kërkesat për transformimin e një aplikimi ndërkombëtar në një aplikim për regjistrim kombëtar do t'i nënshtrohen të njëjtave procedura ekzaminimi si një aplikim kombëtar.
3. Nëse gjatë ekzaminimit për formalitete zyra konstaton se kërkesa për transformim nuk është depozituar brenda afatit 3-mujor të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ose mallrat dhe/ose shërbimet për të cilat marka kërkon të regjistrohet nuk përmbahen në listën e mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat regjistrimi ndërkombëtar ishte regjistruar, zyra njofton aplikantin për plotësimin e të metave brenda 3 muajve nga data e marrjes së njoftimit.
4. Nëse të metat, sipas pikës 3 të këtij neni, nuk plotësohen brenda afatit të përcaktuar nga zyra, e drejta për datën e regjistrimit ndërkombëtar ose të shtrirjes territoriale dhe e drejta e prioritetit, nëse është pretenduar për prioritet, do të humbasë. Nëse kërkesa për transformim refuzohet nga zyra, aplikimi do të ekzaminohet si një aplikim i rregullt kombëtar.

**KREU XI
MARKAT KOLEKTIVE**

Neni 49
Rregulloret e përdorimit

1. Aplikanti i një marke kolektive duhet të depozitojë rregulloren e përdorimit të markës kolektive brenda tre muajve nga data e depozitimit.
2. Rregullorja e përdorimit duhet të specifikojë:
 - 2.1 Personat e autorizuar për të përdorur markën;
 - 2.2 Kushtet e anëtarësisë në organizatë;
 - 2.3 Kushtet e përdorimit të markës, kur është e mundur;
 - 2.4 Sanksionet.
3. Rregullorja e përdorimit të markës duhet të autorizojë çdo person, mallrat ose shërbimet e të cilit kanë origjinën në zonën gjeografike përkatëse, për t'u bërë anëtar i organizatës që është pronare e markës.
4. Përdorimi i një marke kolektive nga çdo person që ka të drejtë ta përdorë atë, duhet të përmbushë kërkesat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje, me kusht që të përmbushen edhe kërkesat e tjera të parashikuara nga ligji dhe kjo rregullore në lidhje me përdorimin e markave.

Neni 50
Refuzimi i aplikimit

1. Përveç bazave për refuzim për një aplikim për markë, sipas neneve 142 e 143 të ligjit, aplikimi për një markë kolektive do të refuzohet kur nuk përmbushen kushtet e parashikuara në nenin 165 të ligjit dhe në nenin 49 të kësaj rregulloreje, ose kur rregullorja e përdorimit është në kundërshtim me politikat publike ose parimet e moralit.
2. Aplikimi për një markë kolektive do të refuzohet, gjithashtu, nëse ekziston mundësia që publiku të keqorientohet në lidhje me karakterin apo domethënien e markës, në veçanti, nëse ekziston mundësia që të kuptohet si e ndryshme nga një markë kolektive.
3. Aplikimi nuk do të refuzohet nëse aplikanti, si rezultat i ndryshimeve në rregulloren e përdorimit, përmbush kërkesat e paragrafëve 1 e 2.
- 4.

Neni 51

Ndryshimet në rregullore lidhur me përdorimin e markave kolektive

1. Pronari i një marke kolektive duhet të depozitojë pranë zyrës çdo ndryshim të rregullores së përdorimit të markës.
2. Ndryshimet nuk do të pasqyrohen në regjistër nëse nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në nenin 49 të kësaj rregulloreje ose përmbajnë ndonjë nga bazat për refuzim të parashikuara në nenin 50 të kësaj rregulloreje.
3. Për qëllim të aplikimit të kësaj rregulloreje, ndryshimet në rregulloren e përdorimit do t'i fillojnë efektet nga data e regjistrimit të tyre në regjistër.
4. Forma e aplikimit për ndryshim në regjistër të rregullores së përdorimit të markës kolektive, si dhe procedurat e shqyrtimit të këtyre kërkesave nga zyra do të jenë sipas neneve 33 e 35 të kësaj rregulloreje.

KREU XII MARKAT CERTIFIKUESE

Neni 52

Rregullorja e përdorimit të markës certifikuese

1. Aplikanti i një marke certifikuese duhet të depozitojë rregulloren që parashikon rregullat e përdorimit të markës brenda tre muajve nga data e depozitimit.
2. Rregullorja duhet të specifikojë personat e autorizuar për të përdorur markën, karakteristikat që do të certifikohen nga marka, si do të testohen këto karakteristika nga autoriteti certifikues dhe mbikëqyrjen e përdorimit të markës.
3. Rregullorja duhet të parashikojë kushtet e përdorimit të markës, duke përfshirë edhe sanksionet.

Neni 53

Refuzimi i aplikimit

1. Përveç bazave për refuzimin e regjistrimit të një marke, sipas neneve 141 e 142 të ligjit, aplikimi për regjistrimin e një marke certifikuese do të refuzohet kur nuk plotësohen kushtet e vendosura në nenin 166 të ligjit dhe në nenin 52 të kësaj rregulloreje, ose kur rregullorja në lidhje me përdorimin e markës është në kundërshtim me parimet morale apo rendin publik.
2. Një aplikim për markë certifikuese do të refuzohet gjithashtu nëse publiku mund të keqorientohet në lidhje me karakterin apo rëndësinë e markës, veçanërisht nëse ajo mund të interpretohet si diçka e ndryshme nga një markë certifikuese.
3. Aplikimi nuk do të refuzohet nëse aplikanti ndryshon rregulloren e përdorimit të markës, duke plotësuar kërkesat e paragrafëve 1 e 2.

Neni 54

Përdorimi i markës certifikuese

Përdorimi i një marke certifikuese nga çdo person që ka të drejtën ta përdorë atë sipas rregullores, të referuar në nenin 52 të kësaj rregulloreje, duhet të përmbushë kërkesat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje, me kusht që të përmbushen edhe kërkesat e tjera të parashikuara nga ligji dhe nga kjo rregullore në lidhje me përdorimin e markave.

Neni 55

Ndryshimet në rregulloren e përdorimit të markës certifikuese

1. Pronari i markës certifikuese duhet të depozitojë pranë zyrës çdo ndryshim në rregulloren e përdorimit të markës.
2. Ndryshimet nuk duhet të pasqyrohen në regjistër nëse nuk plotësojnë kërkesat e nenit 52 të kësaj rregulloreje ose përmbajnë ndonjë nga bazat për refuzim të përmendura në nenin 53 të kësaj rregulloreje.
3. Për qëllim të kësaj rregulloreje, ndryshimet e rregullores së përdorimit do fillojnë efektet nga data e regjistrimit të këtyre ndryshimeve në regjistër.
4. Një markë certifikuese mund të transferohet vetëm te personat që përmbushin kriteret e nenit 166 të ligjit.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 56

Bazat për shfuqizim

Përveç arsyeve për shfuqizim, të parashikuara në nenin 173 të ligjit, të drejtat e pronarit të markës së certifikuar do të shfuqizohen me anë të një kërkesë në zyrë, kur plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

1. Pronari nuk i plotëson më kërkesat e nenit 166 të ligjit;
2. Pronari nuk ndërmerr masa të arsyeshme për të parandaluar përdorimin e markës certifikuese në një mënyrë që vjen në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në rregulloren e përdorimit, ndryshimet e saj, të cilat janë pasqyruar në regjistrë;
3. Mënyra e përdorimit të markës certifikuese nga pronari ka sjellë keqorientim të publikut;
4. Ndryshimet në rregulloren e përdorimit, të cilat janë regjistruar në regjistrë, në kundërshtim me nenin 55 të kësaj rregulloreje, përveçse nëse pronari i markës, duke ndryshuar më tej rregulloren e përdorimit, përmbush kërkesat e nenit të përmendur më sipër.

Neni 57

Bazat për zhvlerësim

Përveç bazave për zhvlerësimin e markës të parashikuar në nenin 174 të ligjit, një markë certifikuese e regjistruar do të zhvlerësohet nëpërmjet një kërkesë drejtuar zyrës, përveçse kur pronari i markës certifikuese ndryshon rregulloren e përdorimit, duke përmbushur kërkesat e nenit 53 të kësaj rregulloreje.

KREU XIII

KRITERET NË LIDHJE ME MARKAT E MIRËNJOHURA

Neni 58

Kriteret për markat e mirënjohura

1. Autoriteti kompetent në përcaktimin e markave të mirënjohura do t'i referohet rekomandimit të përbashkët lidhur me dispozitat për mbrojtjen e markave të mirënjohura të miratuar nga Asambleja e Unionit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Asambleja e Përgjithshme e Organizatës Botërore të Pronësisë Intellektuale.

2. Për të përcaktuar nëse një markë është e mirënjohur, autoriteti kompetent merr në konsideratë informacionin e paraqitur në lidhje me kriteret dhe rrethanat, sipas të cilave mund të rezultojë nëse një markë është ose jo e mirënjohur, duke përfshirë kriteret e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to:

- 2.1 Shkalla e njohjes apo njohja e markës në sektorin përkatës të publikut;
- 2.2 Kohëzgjatja, shtrirja dhe hapësira gjeografike në të cilën përdoret marka;
- 2.3 Kohëzgjatja, shtrirja dhe hapësira gjeografike e promovimit të markës, duke përfshirë reklamat, publicitetet ose prezantimet në panairë ose ekspozita, të mallrave dhe/ose shërbimeve mbi të cilat aplikohet marka;
- 2.4 Kohëzgjatja dhe hapësira gjeografike e çdo regjistrimi dhe/ose e çdo aplikimi për regjistrim të markës, në masën që ato pasqyrojnë përdorimin ose njohjen e markës;
- 2.5 Të dhënat e zbatimit të suksesshëm të të drejtave të lidhura me markën dhe, në veçanti, shkalla në të cilën marka është pranuar si e mirënjohur nga autoritetet kompetente;
- 2.6 Vlera e lidhur me markën.

3. Kriteret e mësipërme shërbejnë si udhëzues për të ndihmuar autoritetin kompetent që të përcaktojë nëse një markë është e mirënjohur, por nuk janë parakushte për të arritur këtë përcaktim. Megjithatë, përcaktimi nëse një markë është e mirënjohur apo jo do të varet nga rrethanat specifike të çdo rasti. Në disa raste, mund të nevojiten të gjitha kriteret e mësipërme të marra së bashku për të bërë një përcaktim të tillë, në disa raste të tjera mund të mjaftojnë vetëm disa prej këtyre kriterëve. Në raste të tjera të caktuara, mund të konsiderohen edhe kriteret e tjera shtesë që nuk janë renditur më sipër.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 59

Sektori përkatës i publikut

1. Sektori përkatës i publikut përfshin, por nuk do të kufizohet vetëm në sa vijon:
 - 1.1 Konsumatorët faktikë/përkatës ose potencialë që faktikisht blejnë ose përdorin ose do të blejnë ose do të përdorin në të ardhmen mallra ose shërbime;
 - 1.2 Personat e përfshirë në rrugët ose kanalet e shpërndarjes së mallrave dhe/ose të shërbimeve për të cilat mbrohet marka;
 - 1.3 Rrethet ose qarqet e biznesit që kanë të bëjnë me mallrat dhe/ose shërbimet për të cilat mbrohet marka.
2. Kur një markë është përcaktuar si e mirënjohur në të paktën një sektor përkatës të publikut në vend, marka mund të konsiderohet se është e mirënjohur.
3. Kur një markë është përcaktuar si e njohur në të paktën një sektor përkatës të publikut në vend, marka mund të konsiderohet se është e mirënjohur.
4. Një markë e mirënjohur do të konsiderohet si e tillë edhe nëse nuk përcaktohet si e mirënjohur ose e njohur në ndonjë sektor përkatës të publikut.

Neni 60

Kriteret që përjashtohen nga përcaktimi i markave të mirënjohura

1. Autoriteti kompetent nuk duhet të kërkojë si kusht për përcaktimin e një marke si markë të mirënjohur, që:
 - 1.1 Marka të jetë përdorur ose të jetë regjistruar ose që të jetë aplikuar për regjistrimin e markës në vend;
 - 1.2 Marka të jetë përdorur ose të jetë regjistruar ose që të jetë aplikuar për regjistrimin e markës në ndonjë juridiksion tjetër të ndryshëm nga ai i vendit;
 - 1.3 Marka të jetë e mirënjohur nga publiku i gjerë në vend.
2. Për qëllime të zbatimit të pikës 3, të nenit 59, të kësaj rregulloreje, autoriteti kompetent mund të kërkojë që marka të jetë e mirënjohur në një ose disa juridiksione të ndryshme nga ai i vendit.

KREU XIV

INFORMACIONI I DISPONUESHËM PËR PUBLIKUN DHE AUTORITETET E TJERA

Neni 61

Inspektimi i dosjeve

1. Dosja që i përket një aplikimi për regjistrim marke ende të papublikuar nuk mund të inspektohet pa pëlqimin e aplikantit.
2. Çdo person që vërteton se aplikanti i një marke ka deklaruar që pas regjistrimit të markës do të kërkojë të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i saj kundrejt vetë personit, mund të kërkojë inspektimin e dosjes pa pëlqimin e aplikantit edhe para publikimit të këtij aplikimi.
3. Pas publikimit të aplikimit për regjistrim marke, dosja në lidhje me këtë aplikim dhe marka tregtare që rezultojnë prej aplikimit, mund të inspektohen pas depozitimit të një kërkesë me shkrim dhe kryerjes së pagesës përkatëse.
4. Kur dosjet inspektohen sipas paragrafit 2 ose 3 të këtij neni, dokumentet në lidhje me përjashtimin ose kërkesën për përjashtim të një anëtarit të Dhomës së Kundërshtimeve ose Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim apo të bordit të apelit, për shkak të ekzistencës së konfliktit të interesit, draftet e vendimeve dhe opinioneve, si dhe të gjitha dokumentet e brendshme të përdorura për përgatitjen e vendimeve dhe opinioneve, ashtu si edhe pjesët e dosjes për të cilat pala e interesuar tregon një interes të veçantë për ruajtjen e konfidencialitetit përpara se të jetë depozituar kërkesa për inspektim të dosjes, ndalohen për inspektim, përveç kur inspektimi i këtyre dokumenteve të dosjes justifikohet me një interes legjitim të palës që kërkon inspektimin.
5. Inspektimi i dosjes së një aplikimi për regjistrim marke dhe/ose të një marke të regjistruar do të bëhet me dokumente origjinale, kopje të tyre ose me mjete ose pajisje të tjera teknike të ruajtjes.
6. Inspektimi i dosjeve bëhet brenda mjediseve të zyrës. Bazuar në një kërkesë me shkrim, inspektimi i dosjeve shoqërohet me lëshimin e kopjeve të dokumenteve të dosjes. Lëshimi i këtyre kopjeve kushtëzohet me

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

kryerjen e pagesës së tarifës për dublikatë. Bazuar në kërkesën me shkrim dhe përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, zyra lëshon edhe kopje të vërtetuara ose të pavërtetuara të një aplikimi për regjistrim marke.

7. Kur dosjet inspektohen sipas paragrafit 6 të këtij neni, kërkesa për inspektim të dosjes do të konsiderohet si e padepozituar deri në momentin që do të kryhet pagesa e tarifës përkatëse.

8. Dosjet që mbahen nga zyra për regjistrimet ndërkombëtare mund të inspektohen mbi bazën e një kërkesë me shkrim, duke filluar nga data e publikimit të aplikimit ndërkombëtar, në përputhje me paragrafët 1, 3 e 4 të këtij neni.

9. Në përputhje me kufizimet e vendosura në paragrafin 4 të këtij neni, si dhe bazuar në një kërkesë me shkrim, zyra mund të japë informacion nga çdo dosje që i përket një aplikimi për regjistrim marke ose një marke të regjistruar, pas kryerjes së pagesës së tarifës për hetim.

KREU XV

KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 62

Emri dhe adresa

1. Në komunikimet që depozitohen në zyrë, emri dhe adresa e aplikantit duhet të tregohen në mënyrën e mëposhtme:

1.1 Nëse aplikanti, kundërshtuesi ose personi që depoziton kërkesën është person fizik: emri, mbiemri, adresa, qyteti, shteti.

1.2 Nëse aplikanti, kundërshtuesi ose personi që depoziton kërkesën është person juridik: emri i shoqërisë, adresa, qyteti, shteti.

2. Në komunikimet që depozitohen në zyrë, emri dhe adresa e përfaqësuesit të autorizuar tregohen në mënyrën që vijon: emri, mbiemri, adresa, qyteti, shteti dhe/ose kodi i përfaqësuesit.

3. Kur një aplikim është depozituar nga disa aplikantë, korrespondenca në lidhje me aplikimin do të dërgohet në adresat e secilit aplikant, përveçse kur ata kanë caktuar një përfaqësues të autorizuar.

4. Aplikanti mund të deklarojë mënyra të tjera kontakti, si: numër telefoni, adresë e-mail-i, faksi etj.

5. Parashikimet e këtij neni, si dhe të neneve 63 e 64 të kësaj rregulloreje, do të aplikohen gjithashtu për korrespondencat që i komunikohen Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim, si dhe bordit të apelit.

6. Në të gjithë formularët e markave do të parashikohet rubrika me tekstin e mëposhtëm:

(1) “Unë, i/e nënshkruari(a) _____, pranoj që DPPI-ja mund të më kontaktojë nëpërmjet mjeteve vijuese të komunikimit, për çështje të lidhura me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij nëpërmjet:

(2) ☐ postës elektronike (e-mail), në adresën vijuese: _____;

(3) ☐ komunikimit (SMS, telefonatë) në numrin vijues: _____;

(4) ☐ faksit, në numrin vijues: _____;

DPPI-ja njofton se shënimi i të dhënave të mësipërme të kontaktit është vullnetar.

DPPI-ja do të ruajë këto të dhëna (në vijim, të dhënat personale), që aplikanti dhe/ose personi i autorizuar (në vijim, subjekti) kanë shënuar në këtë formular aplikimi.

Të dhënat personale do të përpunohen e përdoren nga DPPI-ja, në cilësinë e kontrolluesit, apo nga persona të tretë të caktuar nga DPPI-ja, në cilësinë e përpunuesit, ekskluzivisht për të komunikuar me subjektin, për sa u përket procedurave të lidhura me këtë aplikim.

Të dhënat personale nuk do t'i kalohen një marrësi të tretë pa pëlqimin paraprak të subjektit dhe nuk do t'i nënshtrohen transferimit ndërkombëtar. Gjithashtu, DPPI-ja mund të përdorë herë pas here të dhënat personale për të kontaktuar subjektin dhe për t'i dërguar informacione që mund të jenë në interes të tij/saj, të tilla, si: njoftime, ngjarje dhe/ose zhvillime ligjore në fushën e veprimtarisë së DPPI-së.

DPPI-ja do të ndalojë dërgimin e këtij informacioni nëse subjekti njofton shprehimisht me shkrim DPPI-në, se ai/ajo nuk dëshiron të kontaktohet më tej për të marrë informacione të tilla.

Subjekti ka të drejtë të kërkojë informacionin, korrigjimin apo përditësimin/anulimin e të dhënave personale, që DPPI-ja ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrojë çdo të drejtë tjetër që i njihet nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Data: _____._____._____

_____ (emri, mbiemri, firma)

Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi jep pëlqimin që DPPI-ja të ruajë, të përpunojë e të përdorë të dhënat personale të subjektit, në pajtim me kushtet e mësipërme. Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi gjithashtu deklaron nën përgjegjësinë e tij/saj se të dhënat e kontaktit si më sipër janë të dhënat e tij/saj ose të një personi të tretë, që ka autorizuar nënshkruesin të kryejë këto veprime.”.

7. Në të gjithë formularët e markave që do të depozitohen në zyrë do të vendoset adresa e zyrës dhe logoja e saj.

Neni 63

Kërkesa të tjera për korrespondencën

1. Zyra do të pranojë vetëm nënshkrimet me dorë në dokumentet e depozituara në zyrë.
2. Nëse një komunikim me zyrën përmban disa dokumente, të cilat kanë të bëjnë me disa aplikime, atëherë në çdo dokument duhet të shënohet numri i aplikimit me të cilin lidhet dokumenti.

Neni 64

Depozitimi i dokumenteve

1. Korrespondenca me zyrën bëhet dorazi ose me postë.
2. Kërkesa ose çdo lloj dokumenti tjetër që depozitohet në DPPI duhet të jetë me shkrim dhe e përkthyer në gjuhën shqipe.

Neni 65

Autorizimi i përfaqësimit

1. Autorizimi i përfaqësimit duhet të përmbajë:
 - 1.1 Nënshkrimin e aplikantit të vërtetuar nga noteri, kur aplikanti është person fizik shqiptar ose i huaj;
 - 1.2 Nënshkrimin dhe vulën e aplikantit ose nënshkrimin e aplikantit të vërtetuar nga noteri, kur aplikanti është person juridik shqiptar ose i huaj.
2. Nëse autorizimi i përfaqësimit nuk është në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore zyra njofton përfaqësuesin që ka depozituar aplikimin që të plotësojë parregullsitë brenda 3 muajve nga dita e marrjes së njoftimit
3. Nëse personi që ka depozituar autorizimin e përfaqësimit nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar në njoftimin e zyrës, sipas pikës 2 të këtij neni, zyra refuzon aplikimin.
4. DPPI-ja regjistron në regjistrin e markave një përfaqësues të autorizuar në lidhje me një markë, kur përfaqësuesit i jepen me autorizim të drejta në ndjekjen e procedurave dhe kryerjen e veprimeve që parashikohen në ligj dhe rregullore në lidhje me markën.
5. Për veprimet dhe ndjekjen e procedurave në lidhje me një markë, përfaqësuesi i regjistruar, sipas paragrafit të mëparshëm, nuk ka nevojë të depozitojë autorizimin origjinal, por një fotokopje të tij.
6. Kur aplikanti ose pronari i një marke revokon ose ndryshon autorizimin e përfaqësimit, ai duhet të depozitojë në DPPI kërkesën për revokimin ose ndryshimin e autorizimit, si dhe për caktimin e përfaqësuesit të ri. Kërkesa regjistrohet në regjistrin e markave, sipas parashikimeve të pikës 4 të këtij neni.

Neni 66

Ekzaminimi i fakteve

1. Gjatë ndjekjes së procedurave në lidhje me shkaqet absolute, zyra i ekzaminon faktet me iniciativën e vet.
2. Gjatë ndjekjes së procedurave në lidhje me shkaqet relative, zyra e shqyrton një kërkesë për kundërshtim marke, duke u kufizuar vetëm në ekzaminimin e fakteve, provave dhe argumenteve të paraqitura nga palët në lidhje me këtë kërkesë, sipas nenit 43 të kësaj rregulloreje.
3. Gjatë ndjekjes së procedurave të shfuqizimit/ zhvlerësimit, sipas nenit 174 të ligjit, zyra duhet të kufizojë ekzaminimin mbi bazat dhe argumentet e parashtruara nga palët, sipas nenit 43 të kësaj rregulloreje.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

4. Zyra nuk merr parasysh faktet ose provat që nuk janë depozituar në afat, si dhe ato që nuk kanë lidhje më çështjen.

Neni 67

Seancat dëgjimore

Kur konsiderohet e nevojshme, zyra ose bordi i apelit zhvillon seanca dëgjimore, si dhe thërret palët të marrin pjesë në seanca.

Neni 68

Marrja e provave

Marrja dhe sigurimi i provave nga zyra dhe bordi i apelimit përbëhet nga:

1. Dëgjimi i palëve;
2. Kërkimi i informacionit shtesë palëve;
3. Depozitimi i dokumenteve dhe provave;
4. Dëgjimi i personave të tjerë, kur çmohet i nevojshëm nga zyra, bordi i apelit ose me kërkesë të palëve.

Neni 69

Njoftimi dhe dërgimi i dokumenteve

1. Data e njoftimit të një dokumenti do të konsiderohet data e marrjes në dorëzim të njoftimit nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij. Afatet e njoftimit do të llogariten duke filluar nga e nesërmja e marrjes në dorëzim të njoftimit.

2. Çdo njoftim i dërguar përfaqësuesit, do të ketë të njëjtin efekt si t'i jetë dërguar personit të përfaqësuar.

3. Çdo komunikim i adresuar zyrës nga një përfaqësues, do të konsiderohet si të jetë dërguar nga personi i përfaqësuar.

4. Nëse është caktuar një përfaqësues i autorizuar, zyra do t'i dërgojë të gjitha njoftimet këtij të fundit.

Neni 70

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 317, datë 31.5.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE”¹

(ndryshuar me VKM nr. 453, datë 29.6.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 195, 198 e 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për përfaqësuesit e autorizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr.82. Tiranë, 2018. f. 5148

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

RREGULLORE **PËR PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË** **PRONËSISË INDUSTRIALE**

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave lidhur me përfaqësimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (në vijim "DPPI") nga përfaqësuesit e autorizuar të regjistruar në DPPI.

Neni 2

Përfaqësimi

(shfuqizuar pika 3 me vendimin e KM-së nr. 453, datë 29.6.2022)

1. Personat fizikë dhe juridikë, të cilët nuk e kanë vendbanimin apo selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të emërojnë përfaqësuesin e tyre për çështje të pronësisë industriale, si: të markave tregtare, treguesve gjeografikë, disenjove industriale dhe patentave, i cili do t'i përfaqësojë gjatë procedurave në DPPI.

2. Personat që kanë vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë ose që kryejnë veprimtari brenda territorit të saj, mund të përfaqësohen në DPPI vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tjerë që nuk janë të regjistruar në këtë drejtori, por drejtojnë ose janë të punësuar te ky person dhe janë të pajisur me autorizim përfaqësimi.

3. Shfuqizuar.

Neni 3

Përfaqësuesit e autorizuar të pronësisë industriale

1. Përfaqësues të autorizuar të pronësisë industriale, janë:

- a) Përfaqësuesit e patentave të shpikjeve dhe modeleve të përdorimit;
- b) Përfaqësuesit e markave tregtare, treguesve gjeografikë dhe disenjove industriale.

2. Përfaqësues i autorizuar i pronësisë industriale është çdo ish-punonjës i DPPI-së, i diplomuar, që ka jo më pak se 3 vjet eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale në DPPI.

Neni 4

Certifikimi si përfaqësues i autorizuar

1. Kandidati, që kërkon të certifikohet si përfaqësues i autorizuar për markat tregtare, treguesit gjeografikë dhe disenjt industrialë, duhet të depozitojë dokumentacionin e nevojshëm pranë komisionit të vlerësimit të DPPI-së, si më poshtë vijon:

- a) Kërkesën për certifikim si përfaqësues i autorizuar;
- b) Jetëshkrimin;
- c) Diplomën e noterizuar;
- ç) Certifikatën e kualifikimeve/trajnimeve;
- d) Pagesën e tarifës përkatëse për të marrë pjesë në testim.

2. Kandidati, që kërkon të certifikohet si përfaqësues i autorizuar për patentat e shpikjeve dhe të modeleve të përdorimit, duhet të depozitojë dokumentacionin e nevojshëm pranë komisionit të vlerësimit të DPPI-së, si më poshtë vijon:

- a) Kërkesën për certifikim si përfaqësues i autorizuar;
- b) Jetëshkrimin;
- c) Diplomën e noterizuar;
- ç) Certifikatën e kualifikimeve/trajnimeve;
- d) Pagesën e tarifës përkatëse për të marrë pjesë në testim.

3. Dokumenti i ekstraktit të regjistrimit të QKB-së do të sigurohet nga vetë komisioni i vlerësimit të DPPI-së.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 5

Komisioni i vlerësimit

(ndryshuar fjalë në pikën 10 me vendimin e KM-së nr. 453, datë 29.6.2022)

1. Komisioni i vlerësimit funksionon si një strukturë e ngritur brenda DPPI-së, për certifikimin e përfaqësuesve të autorizuar të pronësisë industriale, në përputhje me parashikimet e nenit 193/ç, të ligjit nr. 9947, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.
2. Komisioni i shqyrton kërkesat një herë në 3 muaj dhe vendos për datën kur zhvillohet testimi. Data e zhvillimit të testimit caktohet jo më shumë se 1 (një) muaj nga shqyrtimi i kërkesave.
3. Drejtori i përgjithshëm i DPPI-së urdhëron krijimin e komisionit të certifikimit të përfaqësuesve të autorizuar të pronësisë industriale, të përbërë nga tre punonjës të DPPI-së si anëtarë të komisionit, njëri nga të cilët emërohet kryetar.
4. Kryetari cakton një nga anëtarët e komisionit të mbajë dokumentet e kandidatëve, si dhe të kryejë veprimet e ndërmjetme deri në përfundim të procedurës së certifikimit.
5. Komisioni i shqyrton kërkesat për përfaqësues një herë në 3 muaj dhe vendos për datën e zhvillimit të testimit.
6. Testimi vlerësues për përfaqësuesit e autorizuar bëhet me shkrim.
7. Tezat e testimit vlerësues i përgatit komisioni i vlerësimit.
8. Kandidati që ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për të marrë pjesë në testim lajmërohet nga komisioni me anë të postës elektronike/telefonit për vendin, datën dhe orën kur do të zhvillohet testimi.
9. Nëse kandidati nuk plotëson dokumentacionin e nevojshëm për të marrë pjesë në testim, njoftohet që, brenda 5 ditëve nga njoftimi, të plotësojë dokumentacionin; në të kundërt, kërkesa e tij për të marrë pjesë në testim refuzohet.
10. Komisioni i vlerësimit, brenda 30 ditëve nga data e testimit kualifikues, njofton kandidatët që i janë nënshtruar testimit nëse janë kualifikuar apo jo.
11. Kandidatët e kualifikuar ftohen të kryejnë pagesën e certifikimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 8 të këtij neni.
12. Kandidatët e kualifikuar, që kryejnë pagesën brenda afatit të parashikuar në pikën 8 të këtij neni, pajisen nga DPPI-ja me certifikatën e përfaqësuesit të autorizuar të pronësisë industriale brenda 15 ditësh nga data e pagesës.

Neni 6

Fitimi i së drejtës së ushtrimit të veprimtarisë së përfaqësuesit të autorizuar

1. E drejta për ushtrimin e veprimtarisë së përfaqësuesit të autorizuar fitohet me regjistrimin e tij në regjistr dhe më dhënien e certifikatës për përfaqësues të autorizuar nga DPPI-ja.
2. Të drejtë përfaqësimi në DPPI kanë vetëm personat që janë të pajisur me certifikatë nga DPPI-ja.
3. Certifikata përmban:
 - a) Emrin e përfaqësuesit;
 - b) Llojin e objektit të pronësisë industriale për të cilën certifikohet;
 - c) Datën e regjistrimit në regjistr.
4. Certifikata nënshkruhet nga drejtori i përgjithshëm i DPPI-së.
5. Për certifikatën duhet paguar tarifa e parashikuar në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.
6. Regjistrimi në regjistr është subjekt i ripërtëritjes në bazë vjetore, sipas pikës 7, të nenit 197, të ligjit nr. 9947, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar.
7. Nëse përfaqësuesi i autorizuar nuk kryen pagesën e ripërtëritjes brenda afatit, atij i humbet e drejta e përfshirjes në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar. Kjo e drejtë rifitohet pas kryerjes së pagesës së ripërtëritjes sipas vendimit nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, nga përfaqësuesi i autorizuar. Me kryerjen e pagesës nga përfaqësuesi, kryhet përditësimi dhe ripërfshirja e tij në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 7

Detyrat e përfaqësuesve të autorizuar

1. Përfaqësuesi i autorizuar ka për detyrë:
 - 1.1 Të këshillojë palët e interesuara në fazën fillestare, para se ta dorëzojnë kërkesën;
 - 1.2 Të përpilojë dhe të paraqesë kërkesën;
 - 1.3 Të marrë pjesë në mbrojtjen e çështjes për të cilën është i autorizuar, gjatë procedurave të regjistrimit të objekteve;
 - 1.4 Të përpilojë dhe të parashtrojë kundër-shtimet apo kërkesat për anulimin e vendimit me të cilin nuk është i kënaqur;
 - 1.5 T'i respektojë rregullat procedurale, duke përfshirë edhe ato të procedurave gjyqësore.
2. Përfaqësuesi i autorizuar duhet t'i kryejë detyrat e marra dhe t'i mbrojë me mirëbesim interesat e palës që e përfaqëson:
 - 2.1 duke iu përmbajtur dispozitave ligjore dhe duke respektuar kodin e etikës profesionale;
 - 2.2 duke siguruar fshehtësinë e të dhënave që i janë besuar si përfaqësues.
3. Përfaqësuesi, në çdo kohë, ka të drejtë të heqë dorë nga përfaqësimi për çka e informon klientin dhe DPPI-në.

Neni 8

Autorizimi

1. Përfaqësuesi i autorizuar e përfaqëson palën në DPPI, sipas përcaktimit në autorizim.
2. Autorizimi mund të përfshijë një ose më shumë kërkesa, regjistrime, procedura apo, nëse një gjë e tillë është në autorizim, të gjitha kërkesat, regjistrimet ekzistuese dhe ato të ardhshmet.
3. Dokumentet në DPPI dorëzohen nga përfaqësuesi i autorizuar.
4. Kur autorizimi ka mungësi, DPPI-ja fton paraqitësin e autorizimit që, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ftesës, t'i shmanjë mungësitë e konstatuara. Nëse paraqitësi i autorizimit nuk i shmanjë mungësitë në afatin e caktuar, kërkesa refuzohet.
5. Përfaqësuesi do të konsiderohet i autorizuar deri në momentin kur pala i heq autorizimin.

Neni 9

Regjistri i përfaqësuesve të autorizuar

1. Regjistri i përfaqësuesve të autorizuar përmban:
 - 1.1 Përfaqësuesit e patentave të shpikjeve dhe modeleve të përdorimit;
 - 1.2 Përfaqësuesit e markave tregtare, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë;
 - 1.3 Numrin e përfaqësuesit të autorizuar;
 - 1.4 Për persona fizikë, emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, profesionin dhe adresën;
 - 1.5 Datën e regjistrimit në regjistër;
 - 1.6 Datën e regjistrimit të ndryshimeve në regjistër;
 - 1.7 Datën e çregjistrimit nga regjistri.

Neni 10

Ndryshimet në regjistër

Nëse ndryshohet adresa ose emri i përfaqësuesit, ose bëhen ndryshime tjera, përfaqësuesi duhet të paraqesë kërkesë për ndryshimet në regjistër dhe të bëjë pagesën, sipas tarifave të përcaktuara në rregulloren për miratimin e tarifave të objekteve të pronësisë industriale.

Neni 11

Publikimet

DPPI-ja do të publikojë në faqen zyrtare të saj listën e përfaqësuesve të autorizuar që janë certifikuar, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet e bëra në regjistër.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 12

Tarifat

Procedura e regjistrimit të përfaqësuesve të autorizuar në regjistër, si dhe mbajtja e regjistrit, do t'i nënshtrohet pagesës, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale".

VENDIM

Nr. 501, datë 29.8.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR EKSPERTËT E OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE¹

(ndryshuar me VKM nr. 477, datë 13.7.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 198/b, 198/c, 198/ç dhe 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore për ekspertët e objekteve të pronësisë industriale, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE

PËR EKSPERTËT E OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave të regjistrimit për ekspertët e objekteve të pronësisë industriale (në vijim, PI), të cilët certifikohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

Neni 2

Ekspertët e objekteve të pronësisë industriale

1. Ekspertët e PI-së, janë:
 - a) Ekspertët për patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit;
 - b) Ekspertët për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë.
2. Kandidati që kërkon të certifikohet si ekspert për patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit duhet të depozitojë dokumentacionin e nevojshëm pranë komisionit të vlerësimit të DPPI-së, si më poshtë vijon:
 - a) Kërkesën për certifikim si ekspert i PI-së për patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit;
 - b) Jetëshkrimin;
 - c) Pagesën e tarifës përkatëse për të marrë pjesë në testim;
 - ç) Diplomën e ciklit të dytë të studimeve "Master shkencor" në fushën ku kërkohet ekspertizë;
 - d) Çdo dokument tjetër që vërteton pjesëmarrjen në aktivitete me temën e pronësisë industriale, si dhe njohuritë e posaçme në fushën e PI-së.
3. Kandidati që kërkon të certifikohet si ekspert për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr. 128. Tiranë, 2018. f. 8742

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

gjeografikë duhet të depozitojë dokumentacionin e nevojshëm pranë komisionit të vlerësimit të DPPI-së, si më poshtë vijon:

- a) Kërkesën për certifikim si ekspert për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë;
- b) Jetëshkrimin;
- c) Diplomën e noterizuar të ciklit të dytë të studimeve “Master shkencor”;
- ç) Pagesën e tarifës përkatëse për të marrë pjesë në testim.

4. Dokumenti i ekstraktit të regjistrimit të QKB-së do të sigurohet nga vetë komisioni i vlerësimit të DPPI-së.

5. Ish-punonjësit e DPPI-së, që kanë jo më pak se 4 vjet eksperiencë pune në çështjet e pronësisë industriale, që depozitojnë një kërkesë për t’u certifikuar si ekspertë të PI-së, nuk i nënshtrohen testimit vlerësues.

6. Ish-anëtarët e bordit të apelit të DPPI-së, që kanë jo më pak se 2 vjet përvojë pune në këtë bord, që depozitojnë një kërkesë për t’u certifikuar si ekspertë të PI-së, nuk i nënshtrohen testimit vlerësues.

7. Eksperti ka për detyrë kryerjen e ekspertizës në fushën e PI-së pranë çdo organi, ku kjo mund të kërkohej:

- a) të japë shpjegime profesionale mbi objektet e PI-së përpara organit që e ka kërkuar si ekspert;
- b) të japë mendimin e specializuar përpara organit që kërkon ekspertizën në zgjidhjen e konflikteve me objekt PI-në.

8. Eksperti duhet të kryejë detyrat e marra:

- a) duke iu përmbajtur dispozitave ligjore dhe duke respektuar kodin e etikës profesionale;
- b) duke siguruar fshehtësinë e të dhënave që i janë besuar si ekspert;
- c) duke respektuar rregullat procedurale, përfshirë dhe ato të procedurave gjyqësore.

9. Eksperti ka të drejtë të heqë dorë nga ekspertimi në çdo kohë, nëse paraqet me shkrim arsyet e ligjshme të dorëheqjes apo pamundësinë fizike të justifikuar.

Neni 3

Komisioni i vlerësimit

1. Komisioni i vlerësimit funksionon si një strukturë e ngritur brenda DPPI-së, për certifikimin e ekspertëve të PI-së, në përputhje me parashikimet e nenit 193/ç, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”.

2. Komisioni i shqyrton kërkesat një herë në 3 muaj dhe vendos për datën kur zhvillohet testimi. Data e zhvillimit të testimit caktohet jo më shumë se 1 (një) muaj nga shqyrtimi i kërkesave.

3. Drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së urdhëron krijimin e komisionit të vlerësimit të ekspertëve të PI-së, të përbërë nga tre punonjës të DPPI-së, si anëtarë të komisionit, njëri nga të cilët emërohet kryetar.

4. Kryetari cakton një nga anëtarët e komisionit të mbajë dokumentet e kandidatëve, si dhe të kryejë veprimet shkresore deri në përfundim të procedurës së certifikimit.

5. Komisioni i shqyrton kërkesat për përfaqësues një herë në 3 muaj dhe vendos për datën e zhvillimit të testimit.

6. Testimi vlerësues për ekspertët e PI-së bëhet me shkrim.

7. Tezat e testimit vlerësues i përgatit komisioni i vlerësimit.

8. Kandidati, që ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për të marrë pjesë në testim, lajmërohet nga komisioni me anë të postës elektronike/telefonit për vendin, datën dhe orën kur do të zhvillohet testimi.

9. Nëse kandidati nuk plotëson dokumentacionin e nevojshëm për të marrë pjesë në testim, njoftohet që, brenda 5 ditëve nga njoftimi, të plotësojë dokumentacionin, në të kundërt, kërkesa e tij për të marrë pjesë në testim refuzohet.

10. Komisioni i vlerësimit, brenda 30 ditëve nga data e testimit kualifikues, njofton kandidatët që i janë nënshtruar testimit nëse janë kualifikuar apo jo.

11. Kandidatët e kualifikuar ftohen të kryejnë pagesën e certifikimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

12. Kandidatët e kualifikuar, që kryejnë pagesën brenda afatit të parashikuar në pikën 11 të këtij neni, pajisen nga DPPI-ja me certifikaten e përfaqësuesit të autorizuar të PI-së brenda 15 ditësh nga data e pagesës.

13. Nëse kandidati nuk paguan pagesën në afat, komisioni i vlerësimit e rrezon kërkesën për ekspert dhe njofton kandidatin.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

14. Të drejtën e ushtrimit të profesionit si ekspertë të PI-së e kanë vetëm personat, të cilët janë të pajisur me certifikatë nga DPPI-ja, e cila përmban:

- a) Emrin e ekspertit;
- b) Numrin e ekspertit në regjistrin e ekspertëve të PI-së;
- c) Llojin e objektit të pronësisë industriale për të cilën certifikohet;
- ç) Datën e regjistrimit në regjistër.

15. Certifikata nënshkruhet nga drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

16. Për marrjen e certifikatës paguhet tarifa e parashikuar në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të PI-së".

Neni 4

Regjistri i ekspertëve të PI-së

1. E drejta për ushtrimin e veprimtarisë të ekspertit të PI-së fitohet me regjistrimin e tij në regjistër dhe më dhënien e certifikatës nga DPPI-ja.

2. Regjistri i ekspertëve të PI-së përmban:

- a) Ekspertët e patentave të shpikjes dhe modeleve të përdorimit;
- b) Ekspertët për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë;
- c) Numrin e ekspertit të PI-së në regjistër;
- ç) Datën e regjistrimit në regjistër;
- d) Datën e regjistrimit të ndryshimeve në regjistër;
- dh) Datën e çregjistrimit nga regjistri;

e) Ekstraktin e përftuar nga regjistri i ekspertëve të PI-së që lëshohet nga komisioni i vlerësimit i DPPI-së me firmë të drejtorit të Përgjithshëm.

3. Ekspertët e PI-së, për t'u regjistruar në regjistër, duhet të kenë kaluar testimin për ekspertë dhe të kenë bërë pagesën për marrjen e certifikatës.

4. Regjistrimi në regjistrin e ekspertëve të PI-së bëhet çdo vit para skadimit të afatit njëvjeçar të ripërtëritjes, sipas pikës 7, të nenit 198/c, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", kundrejt tarifës për ripërtëritje e parashikuar në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të PI-së". Nëse përfaqësuesi nuk kryen pagesën e ripërtëritjes brenda afatit, atij i humbet e drejta e përfshirjes në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar. Kjo e drejtë rifitohet pas kryerjes së pagesës së ripërtëritjes nga përfaqësuesi. Me kryerjen e pagesës nga përfaqësuesi, kryhet përditësimi dhe ripërfshirja e tij në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar.

5. Nëse eksperti i PI-së nuk e ushtron aktivitetin tregtar për një periudhë 5-vjeçare, certifikata nuk ripërtërihet dhe eksperti duhet t'i nënshtrohet edhe një herë testimit për marrjen e certifikatës.

6. Certifikata e ekspertit të PI-së ripërtërihet çdo vit, pa testim, kundrejt tarifës së pagesës përkatëse.

Neni 5

Shënimi i ndryshimeve në regjistër

Në rastin kur eksperti kërkon ndryshimin e adresës ose të të dhënave të tjera, ai duhet të paraqesë kërkesë për pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në regjistër dhe të bëjë pagesën e tarifës së parashikuar në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të PI-së".

Neni 6

Publikimet

1. Zyra do të publikojë regjistrin e ekspertëve dhe të gjitha ndryshimet e bëra në regjistër, në faqen *web* të DPPI-së dhe në buletinin e saj zyrtar.

2. DPPI-ja i publikon ekspertët e PI-së në format elektronik në faqen zyrtare të saj, vetëm pasi të ketë verifikuar që kandidati për ekspert të jetë regjistruar për lejin e ushtrimit të aktivitetit tregtar.

3. Publikimi në faqen zyrtare të DPPI-së do të bëhet kundrejt pagesës së tarifës përkatëse të parashikuar në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të PI-së".

VENDIM

Nr. 752, datë 19.12.2018

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE¹

(ndryshuar me VKM-në nr. 171, datë 24.3.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 5 e 7, të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare që lindin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë pas botimit të tij në “Fletoren zyrtare”.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi

RREGULLORE

E ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT DHE PËRCAKTIMIT TË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË APELIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave lidhur me organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit të apelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

2. Bordi i apelit (në vijim BA) është organ i krijuar në bazë të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, (në vijim ligji) dhe shqyrton çështjet e zgjidhjes së konflikteve që lidhen me pronësinë dhe të drejtat mbi objektet e PI-së.

Neni 2

Përbërja, emërimi dhe lirimi i anëtarëve të BA-së

(ndryshuar pika 1, ndryshuar fjalë në fjalinë e parë të pikës 3 dhe 4 me VKM-në nr. 171, datë 24.3.2023)

1. Bordi i Apelit përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 2 janë punonjës të DPPI-së dhe 3 anëtarë të jashtëm të fushës së PI-së, të cilët plotësojnë kushtet për ekspertë të PI-së.

2. Kryetari i BA-së është drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

3. Kandidatët për anëtarë në BA, nga radhët e punonjësve të DPPI-së, si dhe 3 anëtarët e jashtëm të përzgjedhur nga drejtori i Përgjithshëm nga kandidaturat e paraqitura, i propozohen për miratim këshillit mbikëqyrës, në fillim të çdo viti kalendarik, nga drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së, për emërim si anëtarë të BA-së. Drejtori i Përgjithshëm, gjithashtu, e njeh këshillin mbikëqyrës me të gjitha kandidaturat që plotësojnë kushtet e pikës 1, të nenit 193/b, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, si dhe me arsyet e përzgjedhjes.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr. 185. Tiranë, 2018. f. 14055

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

4. Në muajin nëntor të çdo viti do të shpallen tre vende vakante për vitin e ardhshëm kalendarik, për anëtarët e jashtëm të BA-së. Shpallja e vendeve vakante do të bëhet me njoftim në faqen zyrtare web të DPPI-së.

5. Kërkesa zyrtare për të kandiduar si anëtar i jashtëm i BA-së duhet të nënshkruhet nga vetë kandidati dhe duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) Të dhënat mbi identitetin personal, adresë korrespondence, e-mail dhe çdo pikë të saktë kontakti tjetër të parashikuar me ligj;

b) Jetëshkrim;

c) Diplomë e ciklit të dytë të studimeve “Master shkencor”;

ç) Çdo dokument tjetër që provon kontributin dhe njohuritë në fushën e PI-së.

Dokumentet e shkronjave “c” dhe “ç”, të kësaj pike, që nuk do të jenë origjinale ose të noterizuara, do të konsiderohen të padepozituara. DPPI-ja nuk do të dërgojë njoftim për plotësim dokumentacioni.

Kërkesa zyrtare për të kandiduar si anëtar i BA-së, e pashoqëruar me dokumentet përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, e “ç”, të kësaj pike, do të konsiderohet e padorëzuar dhe, si e tillë, nuk do të shqyrtohet.

6. Lirimi i anëtarëve të BA-së bëhet nga këshilli mbikëqyrës për këto arsye:

a) Çdo anëtar i BA-së do të konsiderohet i liruar në fund të vitit kalendarik, me të drejtë riemërimi;

b) Me kërkesën e tij për dorëheqje;

c) Kur i është ndaluar ushtrimi i këtij aktiviteti me vendim gjyqësor të formës së prerë;

ç) Kur cenon më shumë se një herë, në mënyrë të pajustificuar, detyrimet që lindin në bazë të kësaj rregulloreje;

d) Me vendim të këshillit mbikëqyrës, për shkelje të rregullave të etikës.

7. Anëtar i BA-së, që jep dorëheqjen, sipas shkronjës “c”, të nenit 193/c, të ligjit, është i detyruar të paraqesë kërkesën me shkrim për dorëheqje dhe arsyet e dorëheqjes, të paktën një muaj përpara datës së lirimit nga detyra, përveç rastit kur provon ose vërtetohet se kjo nuk ka qenë e mundur.

8. Mbledhja për shqyrtimin e çështjes së lirimit të anëtarit të BA-së thirret nga drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

Mbledhja për shqyrtimin e lirimit të anëtarit të BA-së nuk zhvillohet pa e thirrur atë të marrë pjesë dhe të paraqesë shpjegimet e tij, përveç rastit kur kjo nuk është e mundur.

Vendimi i marrë në këtë mbledhje është i formës së prerë dhe zbatohet menjëherë.

9. Kryetari i BA-së dhe këshilli mbikëqyrës marrin masa për zëvendësimin sa më të shpejtë të anëtarit të liruar nga detyra, duke shpallur vendin vakant në faqen web të DPPI-së dhe duke proceduar si në pikat 4 e 5, të këtij neni. Afatet e procedimit në këtë rast përcaktohen nga kryetari i BA-së. Për çdo rast, këto afate nuk mund të jenë më të shkurtra se 7 (shtatë) ditë.

Neni 3

Sekretari teknik

1. Mbledhjet e BA-së asistohen nga sekretari teknik. Drejtori i Përgjithshëm cakton një punonjës të DPPI-së në rolin e sekretarit teknik në fillim të çdo viti kalendarik.

2. Sekretari teknik i BA-së është punonjësi i DPPI-së i cili ushtron këto detyra:

a) Merr në dorëzim me firmë të drejtorit të Përgjithshëm, dosjen e kërkesës së depozituar për shqyrtim pranë BA-së;

b) Është personi i autorizuar që konstaton fillimisht këto mangësi dhe dërgon njoftime për plotësimin e mangësive dhe/ose pasaktësive të kërkesës;

c) Njofton palët të depozitojnë pranë BA-së argumentet, prapësimet dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm të përcaktuar në ligj dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave, për miratimin e rregullores së patentave, rregullores së disenjove industriale, rregullores së markave, rregullores së treguesve gjeografikë, rregullores së tarifave;

ç) Mban procesverbalin e mbledhjes me të gjitha elementet që duhet të përmbajë procesverbali, si dhe detyra të tjera të ngarkuara nga BA-ja.

3. Brenda 10 (dhjetë) ditësh nga plotësimi i të gjitha dokumenteve të përcaktuara me ligj, sekretari teknik një kopje të dosjes së plotë ia dërgon secilit anëtar të BA-së për njohje.

4. Sekretari teknik pasi merr nga drejtori i Përgjithshëm urdhrin për datën e mbledhjes së BA-së, ua komunikon atë së bashku me rendin e ditës anëtarëve me e-mail dhe/ose telefon.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 4

Mbledhja e BA-së dhe vendimarrja

(ndryshuar pika 6 me VKM-në nr. 171, datë 24.3.2023)

1. Mbledhjen e BA-së e çel kryetari.
2. Përpara fillimit të shqyrtimit të çdo çështjeje të re, sekretari teknik paraqet verbalisht përpara BA-së një pasqyrë të përmbledhur të kërkesave të palëve, fakteve dhe provave të depozituara në lidhje me çështjet dhe mban procesverbalin e mbledhjes dhe të diskutimeve të anëtarëve.
3. BA-ja, nën drejtimin e kryetarit, shtron për diskutim me radhë të gjitha çështjet që janë vendosur në rendin e ditës.
4. Në përfundim të të gjithë procedurës së shqyrtimit dhe të shkëmbimit të opinioneve nga anëtarët e BA-së, kryetari i fton anëtarët të votojnë. Së pari voton anëtari më i ri në moshë dhe së fundi voton kryetari i seancës. Asnjë nga anëtarët nuk mund të abstenojë nga vendimarrja. Votimi është i hapur në të gjitha rastet. Mendimi i anëtarit të mbetur në pakicë, i parashtruar me shkrim, bashkohet me vendimin.
5. Në rast se rreth një çështjeje propozohen disa zgjidhje dhe votimi i parë është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare në përputhje kjo me nenin 15, të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.
6. Kryetari i Bordit të Apelit cakton një anëtar të Bordit të Apelit, që brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e vendimit, të përgatitë vendimin e arsyetuar, një kopje e të cilit i dorëzohet sekretarit teknik nëpërmjet zyrës së protokollit për t’ia bashkëlidhur dosjes së çështjes.
7. Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e BA-së që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Anëtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin.
8. Vendimi i marrë i dorëzohet zyrës së protokollit të DPPI-së, për t’ia njoftuar atë palëve.

Neni 5

Shpërblimi i anëtarëve të BA-së

1. Kryetari, anëtarët dhe sekretari teknik i BA-së do të përfitojnë shpërblim për çdo mbledhje të BA-së.
2. Shpërblimi i kryetarit dhe i anëtarëve të BA-së është i barabartë në shumën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për çdo mbledhje të BA-së, por në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 6 pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të BA-së.
3. Shpërblimi i sekretarit teknik është i barabartë me shumën 5 000 (pesë mijë) lekë, për çdo mbledhje të BA-së, por në çdo rast, numri i shpërblimeve nuk duhet të jetë më shumë se 6 pagesa në vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të BA-së.
4. Shpenzimet që parashikohen nga zbatimi i kësaj rregulloreje janë parashikuar të mbulohen nga buxheti i DPPI-së, si agjenci autonome.

VENDIM

Nr. 251, datë 24.4.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR TREGUESIT GJEORAFIKË DHE EMËRTIMET E ORIGINËS¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 182 e 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 1705, datë 29.12.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për regjistrimin e treguesve gjeografikë””, i ndryshuar, shfuqizohet.

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr. 61. Tiranë, 2019. f. 4717

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

RREGULLORE **PËR TREGUESIT GJEOGRAFIKË DHE EMËRTIMET E ORIGJINËS**

KREU I **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1 **Qëllimi**

Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave lidhur me:

- a) paraqitjen e aplikimeve për regjistrimin e treguesve gjeografikë dhe/ose emërtimeve të origjinës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe shqyrtimin e tyre;
- b) paraqitjen dhe shqyrtimin e kundërshtimeve në Dhomën për Shqyrtimin e Kundërshtimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, lidhur me treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës;
- c) paraqitjen e kërkesave për apelimin e vendimeve në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim si edhe paraqitjen e kërkesave për shfuqizim në lidhje me shfuqizimin e TGJM-ve apo EOM-ve;
- ç) publikimin e të dhënave lidhur me treguesit gjeografikë dhe/ose emërtimet e origjinës në Buletinin e Pronësisë Industriale nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

Neni 2 **Shkurtime e termave**

1. Për qëllim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:
 - 1.1 “EO”, emërtim origjine, sipas pikës 2, të nenit 176, të ligjit;
 - 1.2 “TGJ”, tregues gjeografik, sipas pikës 3, të nenit 176, të ligjit;
 - 1.3 “EOM”, emërtim origjine i mbrojtur;
 - 1.4 “TGJM”, tregues gjeografik i mbrojtur;
 - 1.5 “Rregullorja”, rregullore për TGJ-në dhe EO-në;
 - 1.6 “Ligji”, ligji nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar;
 - 1.7 “DPPI”, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale;
 - 1.8 “Zyra”, nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale;
 - 1.9 “Autoriteti kompetent”, një autoritet administrativ (Ministri, institucion), i cili jep vlerësimin në lidhje me specifikimet teknike për TGJ-në apo EO-në;
 - 1.10 “Klasifikimi i Nicës”, nënkupton klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve, në funksion të regjistrimit të markave, i miratuar me marrëveshjen e Nicës më 15 korrik 1957, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

Neni 3 **Informacion i përgjithshëm**

1. DPPI-ja shqyrton aplikimet e depozituara dhe lëshon njoftimet dhe aktet e tjera, në përputhje me dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.
2. Veprimet e DPPI-së lidhur me këto aplikime bazohen, ekskluzivisht, në dokumente të shkruara. Kërkesat dhe çdo lloj dokumentacioni tjetër, që depozitohet pranë DPPI-së, duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe të shtypura.
3. Korrespondenca me Zyrën bëhet dorazi ose me postë.
4. DPPI-ja krijon dhe administron bazën elektronike të të dhënave, ku ruhen të gjitha veprimet e kryera në lidhje me treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 4

Llojet e aplikimeve

1. Llojet e aplikimeve, që mund të depozitohen pranë DPPI-së lidhur me TGJ-në apo EO-në, janë, si më poshtë vijon:

- 1.1 Kërkesë për regjistrimin e treguesit gjeografik, nëpërmjet formularit FTGJ1 (aneksi 1 i rregullores);
- 1.2 Kërkesë për regjistrimin e emërimit të origjinës, nëpërmjet formularit FEO1 (aneksi 1 i rregullores);
- 1.3 Kërkesë për kundërshtimin e regjistrimit të treguesit gjeografik të publikuar, nëpërmjet formularit FTGJ2 (aneksi 1 i rregullores);
- 1.4 Kërkesë për kundërshtimin e regjistrimit të emërimit të origjinës të publikuar, nëpërmjet formularit FEO2 (aneksi 1 i rregullores);
- 1.5 Kërkesë për apelimin e vendimit të refuzimit për formalitete, nëpërmjet formularit FTGJ3 ose FEO3 (aneksi 1 i rregullores);
- 1.6 Kërkesa për shfuqizim të TGJ/ EO (FTGJ/FEO/4) (aneksi 1 i rregullores);
- 1.7 Kërkesë për apelimin e vendimit të Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve në bordin e apelit, nëpërmjet formularit FTGJ/FEO/5 (aneksi 1 i rregullores);
- 1.8 Kërkesë për ndryshime në specifikimet e produktit (FTGJ/FEO/6) (aneksi 1 i rregullores).

KREU II

PËRMBAJTJA E APLIKIMIT

Neni 5

Paraqitja e aplikimit

1. Aplikimi për regjistrimin e TGJ-së bëhet nëpërmjet formularit FTGJ1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, i cili nënshkruhet nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij.
2. Aplikimi për regjistrimin e EO-së bëhet nëpërmjet formularit FEO1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, i cili nënshkruhet nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij.
3. Aplikimi mund të paraqitet nga paraqitësi i kërkesës ose përfaqësuesi i tij:
 - a) me postë;
 - b) me faks; ose
 - c) pranë DPPI-së.
4. Në rastin e dërgimit me faks, aplikanti duhet që, brenda një muaji, nga data e dërgimit të faksit, të depozitojë pranë DPPI-së kërkesën në formën e saj origjinale, në të kundërt kërkesa konsiderohet si e paparaqitur. Aplikimi paraqitet në gjuhën shqipe dhe në 2 (dy) kopje.
5. Aplikimi për regjistrimin e treguesit gjeografik apo emërimit të origjinës bëhet vetëm për një tregues apo emërim dhe për një lloj produkti.

Neni 6

Përmbajtja e aplikimit për TGJ-në ose EO-në

3. Aplikimi për regjistrimin e një TGJ-je ose EO-je do të përmbajë:
 - 1.1 formularin e kërkesës për regjistrimin e TGJ-së (FTGJ1) ose EO-së (FEO1) bashkëlidhur kësaj rregulloreje, të nënshkruar nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij;
 - 1.2 të dhënat dhe dokumentet e parashikuara në nenin 182, të ligjit;
 - 1.3 prova që vërtetojnë shkronjat “a” ose “b”, të pikës 3, të nenit 177, të ligjit, kur aplikanti është person fizik;
 - 1.4 dokumentin zyrtar, që vërteton krijimin e grupit.

Neni 7

Të dhënat në formularin e aplikimit

1. Formulari i aplikimit do të përmbajë:
 - 1.1 të dhëna identifikuese të aplikantit dhe/ose përfaqësuesit të tij ligjor, nëse një i tillë është caktuar;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- 1.2 riprodhimin e treguesit gjeografik ose të emërimit të origjinës që kërkon të mbrohet;
- 1.3 të dhëna që identifikojnë produktin, i cili do të mbrohet nëpërmjet TGJ-së ose EO-së, i klasifikuar sipas klasifikimit të Nicës;
- 1.4 të dhëna në lidhje me zonën gjeografike;
- 1.5 të dhëna në lidhje me pagesën e aplikimit;
- 1.6 përshkrimin e karakteristikave të produktit;
- 1.7 përshkrimi i metodës së prodhimit të produktit.

KREU III RREGULLA TË TJERA PËR APLIKIMIN

Neni 8

Rregulla specifike të grupit

Grupi që kërkon regjistrimin e një TGJ/EO-je duhet të operojë në bazë të një statuti dhe mund të përfaqësojë kategori të ndryshme operatorësh, që marrin pjesë në zhvillimin e produktit.

Grupi duhet të sigurojë që specifikimet e produktit nuk duhet të jenë të tilla, që të mund të krijojnë monopol për prodhuesin e produktit.

Neni 9

Rregulla specifike për një emër

1. Një tregues gjeografik ose emërtim origjine duhet, domosdoshmërisht, të jetë një emër gjeografik. Ky mund të jetë emri i një rajoni administrativ ose historik i një njësie administrative, një vend i cili i referohet një zone gjeografike.

4. Duke qenë se treguesit gjeografikë ose emërtimet e origjinës nuk mund të regjistrohen me një emër që nuk përfaqëson zonën gjeografike, duhet të ketë një lidhje ndërmjet emrit dhe zonës gjeografike. Regjistrimi i emërimit të origjinës ose treguesit gjeografik nuk mbron përdorimin e emrave gjeografikë të një zone tjetër gjeografike.

5. Emërtimi i një vendi mund të regjistrohet si emërtim i origjinës ose tregues gjeografik vetëm nëse vendi ka karakteristika të veçanta, të cilat i japin produktit cilësi të veçanta.

6. Përveç emrit gjeografik, treguesi gjeografik ose emërtimi i origjinës mund të përmbajë disa të dhëna mbi produktin, siç është emri i tij, lloji, disa veçori thelbësore, që u japin konsumatorëve informacion shtesë për produktin.

7. Në rastet kur një zonë mbulon një sërë produktesh, si “qumështi” ose “salsiçe”, për të njëjtin tregues gjeografik ose emërtim origjine, aplikimet duhen dorëzuar të veçanta dhe duhet të paraqitet dokumentacion i përshtatshëm për secilin produkt.

8. Nëse emri i kërkuar për regjistrim si tregues gjeografik ose emërtim i origjinës përmban terma shtesë si “klasike”, “tradicionale”, “autentike” etj., të cilat nuk mund të mbrohen, ato do të përjashtohen nga mbrojtja.

7. Vetëm një emër që përdoret në tregti për të përshkruar produktin do të regjistrohet si një emërtim origjine ose tregues gjeografik. Ky emër mund të regjistrohet vetëm në gjuhët që përdoren historikisht në zonën gjeografike për të përshkruar produktin në fjalë. Grupi i aplikantëve duhet të provojë (të paktën për produktet bujqësore apo ushqimore) përdorimin e mëparshëm të emrit në fjalë. Për këtë qëllim, kërkesa për regjistrim duhet të shoqërohet me etiketa, reklama, artikuj shtypi etj.

Neni 10

Rregulla specifike për përshkrimin e produktit dhe lëndëve të para

1. Specifikimet për emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografikë duhet të përmbajnë përshkrimin dhe, nëse është e zbatueshme, dhe karakteristikat:

1.1 fizike [forma, masa, përbërja, lagështia, dendësia, ngjyra, gjendja (të freskëta, të ngrira, të konservuara, të plota, të prera etj.);

1.2 kimike (përbërja, përbërësit themelorë të përmbajtjes dhe përbërësit, përmbajtja e ujit, sheqeri, alkooli, acidet etj.);

1.3 biologjike (lloji, raca etj.);

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

1.4 mikrobiologjike (lloji i baktereve të pranishme etj.);

1.5 Vetitë organoleptike (ngjyra, pamja, struktura, shija, aroma e produktit etj.).

Neni 11

Rregulla specifike mbi kufijtë e zonës gjeografike

1. Zona gjeografike përfshin zonën e kufizuar ku prodhohet produkti. Për këtë qëllim, do të merren parasysh elementet që duhet të theksohen për të provuar lidhjen e tij me origjinën e produktit. Kufijtë e zonës gjeografike duhet të përcaktohen në mënyrë të detajuar.

2. Zona gjeografike mund të përcaktohet nga lista e kufijve territorialë-administrativë, ose nga lista e kufijve natyrorë ose gjeografikë. Kufijtë gjeografikë mund të tregohen nga njësi administrative ose vendndodhja, duke treguar pozicionin e përbashkët të vendeve, objektet gjeografike, si malet, lumenjtë, ndërtimet etj.

Neni 12

Rregulla specifike për lëndët e para

1. Çdo kufizim mbi origjinën e lëndëve të para, për emërtimin e origjinës ose të treguesit gjeografik, duhet të arsyetohet në lidhjen ndërmjet cilësisë ose karakteristikave të produktit dhe mjedisit gjeografik, apo në lidhjen ndërmjet një cilësie, reputacioni ose karakteristike tjetër të produktit dhe origjinës gjeografike të tij.

2. Për një produkt të përfutur nga kafshët, të mbrojtur nga emërtimi i tyre i origjinës, specifikimet do të përmbajnë rregulla të hollësishme mbi origjinën dhe cilësinë e ushqimit. Ushqimi duhet të ketë origjinë në zonën gjeografike të përcaktuar.

3. Për verërat, rregullat specifike për EO-në apo TGJ-në, për lëndët e para, përcaktohen në ligj.

Neni 13

Rregullat që përfshijnë metodat specifike të prodhimit

1. Përshkrimi i metodave për përfutimin e produktit duhet të përfshijë procesin e përfutimit të produktit, praktikat e teknikave të përdorura si dhe kriteret e cilësisë së produktit final, duke vënë në pah veçoritë e tij.

2. Për produktet shtazore përshkrimi duhet të përfshijë informacion mbi kushtet, teknologjitë dhe metodat e mbarështimit (baza foragjere, kullotja, ushqimi, statusi shëndetësor, mosha e therjes, maturimi, klasifikimi i karkasave, pH), si dhe çdo informacion tjetër në përputhje me legjislacionin përkatës.

3. Për produktet bimore përshkrimi duhet të përfshijë informacion mbi speciet, varietetin, datën e mbjelljes dhe datën e korres, metodën e korres, rendimentin maksimal për hektar, ruajtjen, fortësinë, statusin shëndetësor, transportin, si dhe çdo informacion tjetër në përputhje me legjislacionin përkatës.

4. Për produktet e përpunuara përshkrimi duhet të përfshijë informacion për lëndët e para, përbërësit e përdorur në teknologjinë e përpunimit, proceset e prodhimit si dhe çdo informacion tjetër në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 14

Rregulla të veçanta për lidhjen ndërmjet karakteristikave të produktit dhe mjedisit gjeografik

1. Elementet, që justifikojnë lidhjet e përmendura në nënndarjet “i” dhe “ii”, të shkronjës “c”, të nenit 182, të ligjit, duhet të shpjegojnë se si karakteristikat e përcaktuara nga zona gjeografike ndikojnë në produktin përfundimtar.

2. Për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, specifikimet e produktit duhet të përmbajnë:

2.1 informacion të detajuar për mjedisin gjeografik, duke përfshirë vendin, faktorin natyror dhe njerëzor;

2.2 informacion të detajuar për cilësinë ose karakteristikat e produkteve, të cilat vijnë ekskluzivisht ose esencialisht si rezultat i mjedisit gjeografik.

2.3 një përshkrim i ndërveprimit rastësor midis të dhënave në pikat 2.1 dhe 2.2.

3. Nëse një aplikim për regjistrimin e treguesit gjeografik është bazuar vetëm në reputacionin e produktit, specifikimet do të përfshijnë evidenca të detajuara për këtë reputacion, duke përfshirë literaturë ose vlerësime të konsumatorit.

4. Informacioni mbi faktorët natyrorë në zonën gjeografike të përcaktuar mund të përmbajë:

4.1 karakteristikat mjedisore, që ndikojnë në teknikat dhe praktikat e prodhimit;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- 4.2 llojin e nëntokës, tipin e tokës;
- 4.3 gjeografinë (topografia, pjerrësia, lartësia etj.);
- 4.4 klimën, mikroklimën;
- 4.5 bimësinë, peizazhin;
- 4.6 karakteristikat mjedisore, të përshtatura në llojin e përdorur të përpunimit ose të ruajtjes së produktit.
- 5. Informacioni mbi faktorët njerëzorë në zonën gjeografike të përcaktuar duhet të përfshijë:
 - 5.1 zgjedhjen e vendeve për aktivitete të kryera nën kushte mjedisore (të thata, mbjellja e kulturave në zonat e mbrojtura nga era etj.);
 - 5.2 rregullim, në përputhje me kërkesat e mjedisit për kulturat bujqësore ose kafshët në rritje (tarracat, rezervuarët, kullota me rotacion etj.);
 - 5.3. nevojat për prodhime specifike për ndërtim (tharëse, mullinj, hambarë për sanë, etj.);
 - 5.4. zhvillimi i njohurive specifike për teknikat e përpunimit dhe metodat e prodhimit për mbarështimin e kafshëve ose kultivimin e bimëve për përshtatjen e varieteteve apo racave me kushtet mjedisore.

Neni 15

Rregullat specifike të etiketimit

Aplikimi duhet të përmbajë të gjitha elementet specifike, që do të paraqiten në etiketën e një produkti me emërtimin e origjinës apo treguesit gjeografik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për etiketimin.

KREU IV

PROCEDURAT PËR REGJISTRIMIN E NJË TREGUESI GJEOGRAFIK OSE EMËRTIMI ORIGJINE

Neni 16

Ekzaminimi i kushteve për depozitimin e aplikimit

- 5. Zyra duhet të ekzaminojë nëse aplikimi për TGJ-në ose EO-në përmban të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1 Emrin dhe adresën e grupit të prodhuesve.
 - 1.2 Riprodhimin e TGJ-së ose EO-së.
 - 1.3 Produktin për të cilin TGJ-ja ose EO-ja aplikohet.
 - 1.4 Zonën gjeografike të prodhimit ose të origjinës së produktit.
 - 1.5 Mandatpagesa e tarifës përkatëse.
- 6. Kur aplikimi për TGJ-në ose EO-në nuk përmban të dhënat e referuara në pikën 1, të këtij neni, Zyra do t'i kërkojë aplikantit të plotësojë parregullsitë apo të kryejë pagesën përkatëse brenda dy muajve, nga marrja e njoftimit.
- 7. Nëse aplikimi përmbush kërkesat, Zyra do të lëshojë dëshminë e depozitimit dhe do të njohë si datë depozitimi të aplikimit datën kur janë plotësuar parregullsitë, në përputhje me pikën 1, të këtij neni.
- 8. Nëse parregullsitë e parashikuara sipas pikës 1 nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, Zyra do të refuzojë aplikimin dhe do të njoftojë aplikantin për vendimin e marrë.
- 9. Vendimi për refuzim mund të apelohej brenda një muaji, nga data e marrjes së njoftimit për refuzim në Dhomën për Shfuqizim dhe Zhvlerësim.

Neni 17

Dëshmia e depozitimit

- 3. Dëshmia e depozitimit do të përmbajë të dhënat e mëposhtme:
 - 1. datën e depozitimit;
 - 2. numrin e aplikimit;
 - 3. emrin dhe adresën e grupit të prodhuesve;
 - 4. të dhëna të tjera të deklaruara në formularin e kërkesës.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 18

Publikimi i aplikimit

1. Zyra ekzaminon aplikimin në mbështetje të nenit 182/a, të ligjit, si dhe në mbështetje të neneve 5, 6 e 7, të kreut II, të kësaj rregulloreje, dhe e publikon atë në buletin e radhës.
2. DPPI-ja publikon elementet e mëposhtëm të aplikimit:
 - 2.1 numrin e kërkesës së aplikimit;
 - 2.2 datën e depozitimit;
 - 2.3 emrin dhe adresën e aplikantit si dhe të përfaqësuesit të autorizuar, nëse është caktuar një i tillë;
 - 2.4 riprodhimin e treguesit gjeografik apo emërimit të origjinës;
 - 2.5 produktin për të cilin është kërkuar mbrojtja, i klasifikuar sipas klasifikimit të Nicës;
 - 2.6 elementet e TGJ-së apo EO-së që përjashtohen nga mbrojtja;
 - 2.7 përshkrimin e produktit;
 - 2.8 specifikimet e produktit, të parashikuara në nenin 182, të ligjit;
 - 2.9 zonën gjeografike.

Neni 19

Korrespondenca me autoritetet kompetente

Kërkesat në mbështetje të pikave 1 e 2, të nenit 182/c, si dhe pikat 7 e 8, të nenit 182/ç, të ligjit, do të dorëzohen edhe në format elektronik, nëse një adresë e tillë është caktuar nga ministria përgjegjëse apo autoriteti kompetent për vlerësim të specifikimeve teknike sipas rastit.

Neni 20

Ekzaminimi në substancë dhe regjistrimi

Ekzaminimi në substancë i aplikimit bëhet në përputhje me pikat 1 e 2, të nenit 182/c të ligjit. Materialet e dorëzuara, gjithashtu, do të jenë në format elektronik.

Mendimi i Autoritetit Kompetent do të jetë në formë të shkruar dhe elektronike dhe do të përfshijë argumente që TGJ-të ose EO-të përmbushin kriteret për t'u regjistruar si të tilla.

Gjatë ekzaminimit, Autoriteti Kompetent, nëse e sheh të nevojshme, mund të kërkojë nga aplikanti dokumente shtesë ose shpjegime të nevojshme për vendimin përfundimtar. Në këtë rast, periudha 2-mujore e vlerësimit të parashikuar në pikën 4, të nenit 182/c, të ligjit, mund të zgjatet me 2 muaj shtesë, nga data e dorëzimit të kërkesës tek autoritetet kompetente.

Pas marrjes së një vlerësimi pozitiv nga autoriteti kompetent dhe nëse nuk ka pasur kundërshtim në lidhje me TGJ-në apo EO-në e publikuar, DPPI lëshon ftesën për pagesë regjistrimi.

Brenda një muaji, nga data e marrjes së ftesës për pagesë regjistrimi, aplikanti kryen pagesën e parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për tarifat për objektet e pronësisë industriale dhe dorëzon dokumentin e pagesës origjinale në DPPI.

Brenda tri muajve, nga data e dorëzimit të dokumentit të pagesës së regjistrimit, DPPI-ja lëshon certifikatën e regjistrimit.

Kur pagesa nuk kryhet brenda afatit të lartpërmendur, aplikimi refuzohet për t'u regjistruar.

Vendimi për refuzim mund të apelohej brenda një muaji, nga data e marrjes së njoftimit për refuzim në Dhomën për Shfuqizim dhe Zhvlerësim.

Neni 21

Regjistri kombëtar për TGJ-në dhe EO-në

1. Për emërimet e mbrojtura të origjinës, regjistri kombëtar përmban të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1 numrin e kërkesës;
 - 1.2 numrin dhe datën e regjistrimit;
 - 1.3 datën e depozitimit;
 - 1.4 një përfaqësim të EO-së;
 - 1.5 produktin e klasifikuar sipas klasifikimit të Nicës;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- 1.6 termat e përjashtuar nga mbrojtja;
- 1.7 zonën gjeografike;
- 1.8 përshkrimin e cilësive specifike të produktit ekskluzivisht për shkak të origjinës së tij gjeografike, duke theksuar lidhjen e produktit me këtë origjinë gjeografike;
- 1.9 emrat dhe adresat e autoriteteve ose organeve përgjegjëse për verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet;
- 1.10 emrin dhe adresën e mbajtësit/mbajtësve të së drejtës së përdorimit të emërimit të origjinës.
2. Për treguesit gjeografikë të mbrojtur, regjistri kombëtar përmban të dhënat e mëposhtme:
 - 2.1 numrin e kërkesës;
 - 2.2 numrin dhe datën e regjistrimit;
 - 2.3 datën e depozitimit;
 - 2.4 riprodhimin e treguesit gjeografik;
 - 2.5 llojin e produktit të klasifikuar nën klasifikimin e Nicës;
 - 2.6 elementet e treguesve gjeografikë të përjashtuar nga mbrojtja;
 - 2.7 zonën gjeografike;
 - 2.8 përshkrimin që karakterizon produktin, të cilit i atribuohet origjina gjeografike dhe thekson lidhjen ndërmjet karakteristikave të produktit dhe origjinës gjeografike të tij;
 - 2.9 emrat dhe adresat e autoriteteve ose organeve përgjegjëse për verifikimin e përputhshmërisë; specifikimet dhe saktësimin e detajeve;
 - 2.10 emrin dhe adresën e mbajtësit/sve të të drejtës për të përdorur treguesin gjeografik të mbrojtur.

Neni 22

Të dhënat që përmban certifikata e regjistrimit të TGJ-së apo EO-së

1. Certifikata e regjistrimit të TGJ-së apo EO-së përmban të dhënat e mëposhtme:
 - 1.1 numrin e aplikimit e të regjistrimit të TGJ/EO-së;
 - 1.2 datën e aplikimit e të regjistrimit të TGJ/EO-së;
 - 1.3 emrin dhe adresën e pronarit të TGJ/EO-së;
 - 1.4 emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse është caktuar një i tillë;
 - 1.5 llojin e produktit, të klasifikuar sipas klasifikimit të Nicës;
 - 1.6 riprodhimin e TGJ-së apo EO-së;
 - 1.7 elementet që përjashtohen nga mbrojtja;
 - 1.8 datën e publikimit të regjistrimit në buletin e pronësisë industriale.

KREU V

PROCEDURA PËR KUNDËRSHTIMIN E REGJISTRIMIT TË TGJ/EO-së, SHFUQIZIMI DHE APELIMI I VENDIMEVE

Neni 23

Përmbajtja e kërkesës për kundërshtim

1. Kërkesa për ekzaminimin e kundërshtimit përmban, përveç parashikimeve të pikës 2, të nenit 182/ç, të ligjit, edhe:
 - 1.1 të dhëna për kundërshtuesin, sipas pikave 1.1 dhe 1.2, të nenit 35, të kësaj rregulloreje;
 - 1.2 nëse është e aplikueshme, të dhëna të përfaqësuesit, në përputhje me pikën 2, të nenit 35, të kësaj rregulloreje;
 - 1.3 të dhënat që lidhen me regjistrimin e emërimit të origjinës ose treguesin gjeografik ndaj të cilit është parashtruar kundërshtimi: numrin, datën e depozitimit, aplikantin dhe numrin e publikimit ku është publikuar kërkesa;
 - 1.4 listën e dokumenteve në 2 (dy) kopje;
 - 1.5 nënshkrimin e përfaqësuesit të aplikantit ose të vetë aplikantit, sipas pikës 5, të nenit 35, të kësaj rregulloreje;
 - 1.6 bazën ligjore për depozitimin e kundërshtimit, sipas nenit 182/d, të ligjit;
 - 1.7 prova, në lidhje me bazën ligjore për depozitimin e kërkesës për kundërshtim;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- 1.8 argumentet e kërkesës për kundërshtim;
- 1.9 dokumentin e pagesës së tarifës për kundërshtim;
- 1.10 autorizimin e përfaqësimit, nëse kërkesa depozitohet nga përfaqësuesi i kundërshtuesit.

Neni 24

Shqyrtimi i kundërshtimit

13. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve e shqyrton një kundërshtim brenda dy muajve, nga data e paraqitjes së tij.

14. Nëse kërkesa për kundërshtim nuk paraqitet brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 182/ç, të ligjit, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve e refuzon kërkesën për kundërshtim dhe njofton kundërshtuesin për vendimin e refuzimit.

15. Në rast se kundërshtimi nuk i plotëson kushtet e nenit 23, të kësaj rregulloreje, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve i kërkon kundërshtuesit, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të plotësojë të metat e konstatuara brenda dy muajve, nga data e marrjes së njoftimit. Në rast se të metat nuk plotësohen brenda afatit, kundërshtimi do të konsiderohet sikur të mos jetë paraqitur.

16. Kur kundërshtuesi i plotëson të metat, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve i dërgon një kopje të kundërshtimit aplikantit të TGJ/EO-së së kundërshtuar, dhe e njofton atë me shkrim të paraqesë argumentet dhe çdo dokument tjetër, në mbështetje të argumenteve të tij, brenda dy muajve, nga data e marrjes së njoftimit.

17. Gjatë shqyrtimit, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve ka të drejtë t'u kërkojë palëve, nëpërmjet njoftimit me shkrim, të paraqesin materiale dhe dokumente të tjera shtesë, brenda një periudhe dymujore, nga data e marrjes së njoftimit.

18. Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve merr vendim lidhur me kundërshtimin, brenda dy muajve nga data e plotësimit të dosjes, sipas pikave 4 e 5, të këtij neni, dhe njofton me shkrim palët mbi vendimin e marrë.

19. Në rastin kur kundërshtimi bëhet për specifikimet e produktit bujqësor apo ushqimor, Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve i dërgon dosjen e aplikimit, së bashku me dosjen e plotë për kundërshtim, ministrit përgjegjës për bujqësinë, për miratim brenda një muaji, nga plotësimi i të gjitha dokumenteve. E njëjta procedurë ndiqet dhe për produktet jobujqësore ose joushqimore, siç parashikohet në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar.

20. Vendimi i Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve mund të ankohet në bordin e apelit, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, brenda një muaji, nga data e marrjes së vendimit.

21. Kur Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve vendos për rrëzimin e kundërshtimit dhe vendimi i refuzimit nuk apelohej në bordin e apelit, ky vendim merr formë të prerë, një kopje e tij depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e TGJ/EO-së dhe ekzaminuesi vazhdon procedurën për regjistrimin e tij.

22. Kur Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve vendos për pranimin e kundërshtimit dhe vendimi i pranimit nuk apelohej në bordin e apelit, ky vendim merr formë të prerë, një kopje e tij depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e TGJ/EO-së dhe ekzaminuesi refuzon regjistrimin e TGJ/EO-së e njofton aplikantin e aplikimit për vendimin e refuzimit të regjistrimit. Ky vendim publikohet në buletin zyrtar.

23. Kur vendimi i Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, lidhur me kundërshtimin për regjistrimin e një TGJ/EO-je, apelohej në bordin e apelit, vendimi i këtij të fundit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e TGJ/EO-së si dhe publikohet në buletin zyrtar.

24. Kur vendimi i bordit të apelit apelohej në gjykatë, vendimi i kësaj të fundit depozitohet në dosjen e aplikimit për regjistrimin e TGJ/EO-së si dhe publikohet në buletin zyrtar.

Neni 25

Përmbajtja e kërkesës për shfuqizimin e një treguesi gjeografik/emërtimi origjine

1. Kërkesa për shfuqizimin e një treguesi gjeografik/emërtimi origjine, bazuar në nenin 183 të ligjit, paraqitet si kërkesë më vete në dy kopje të njëjta.

2. Kërkesa për shfuqizimin e një treguesi gjeografik/emërtimi origjine përmban:

2.1 Formularin e kërkesës "FTGJ/FEO/4", bashkëlidhur kësaj rregulloreje, në të cilin do të jenë të specifikuar të dhënat e mëposhtme:

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- a) numri i regjistrimit të treguesit gjeografik/emërimit të origjinës në lidhje me të cilin është depozituar kërkesa;
- b) numri dhe adresa e pronarit të treguesit gjeografik/emërimit të origjinës;
- c) emri dhe adresa e personit që depoziton kërkesën;
- ç) emri dhe adresa e përfaqësuesit të autorizuar nëse është caktuar një i tillë.
- 2.2 Bazën ligjore ku mbështetet kërkesa për shfuqizimin apo zhvlerësimin e TGJ-së apo EO-së.
- 2.3 Provat, në lidhje me bazën ligjore ku mbështetet kërkesa për shfuqizimin apo zhvlerësimin e TGJ-së apo EO-së.
- 2.4 Argumentet ku mbështetet kërkesa për shfuqizim.
- 2.5 Mandatpagesa e tarifës përkatëse.
- 2.6 Autorizimi i përfaqësimit, nëse aplikuesi ka caktuar një përfaqësues.

Neni 26

Shqyrtimi i kërkesave për shfuqizimin e një TGJ/EO-je

5. Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim shqyrton kërkesën për shfuqizim të një TGJ/EO-je brenda dy muajve, nga data e paraqitjes së saj. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për shfuqizimin e një TGJ/EO-je të regjistruar, Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim fton palët, për aq sa është e nevojshme, që të depozitojnë pretendimet e tyre, brenda 2 (dy) muajve, nga data e marrjes së njoftimit, në lidhje me komunikimet e paraqitura nga palët e tjera ose të bëra nga vetë dhoma për shfuqizim/zhvlerësim.

6. Nëse Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim e konsideron të arsyeshme, ajo mund t'i ftojë palët të gjejnë një zgjidhje me mirëkuptim, nëpërmjet një marrëveshjeje, e cila, nëse arrihet, duhet të jetë me shkrim dhe e nënshkruar nga të dyja palët.

7. Çdo vendim i Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim për shfuqizim e një TGJ/EO-je të regjistruar, pasi merr formë të prerë, publikohet në buletin zyrtar dhe regjistrohet në regjistrin e treguesve/emërtimeve.

Neni 27

Apelimi i vendimeve

1. Çdo vendim për refuzim që merret gjatë procesit të ekzaminimit mund të apelohej në Dhomën për Shfuqizim/Zhvlerësim brenda 1 (një) muaji, nga data e marrjes së vendimit, përveç kur nuk parashikohet ndryshe në ligj ose në këtë rregullore.

2. Vendimet që mund të apelohej në bordin e apelimit janë:

2.1 vendimet e marra nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve;

2.2 vendimet e marra nga Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim.

3. Apelimi i një vendimi sjell si pasojë pezullimin e ndjekjes së mëtejshme të procedurës përkatëse.

4. Vendimet e parashikuara më sipër hyjnë në fuqi pasi marrin formë të prerë.

5. Çdo vendim tjetër, që nuk përfshihet në vendimet e parashikuara në pikat 1 e 2, të këtij neni, dhe nuk e ndërpret vazhdimin e procedurave, mund të apelohej vetëm me vendimin përfundimtar.

Neni 28

Procedura e apelimit

4. Procedura e apelimit kundër një vendimi të Zyrës fillon me paraqitjen e kërkesës për apelim në strukturën përkatëse.

2. Kërkesa për apelim, sipas pikës 1, të nenit 27, të kësaj rregulloreje, përmban:

2.1 formularin e kërkesës për apelim "FTGJ3 ose FEO3", bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

2.2 bazën ligjore ku është mbështetur apelimi;

2.3 argumentet dhe/ose provat mbi të cilat mbështetet apelimi;

2.4 mandatpagesën e tarifës përkatëse;

2.5 autorizimin e përfaqësimit, nëse apelimi është depozituar nga një përfaqësues.

3. Kërkesa për apelim, referuar pikës 2, të nenit 27, të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë:

3.1 formularin e kërkesës për apelim "FTGJ ose FEO/5", bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

3.2 bazën ligjore ku është mbështetur apelimi;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- 3.3 argumentet dhe/ose provat mbi të cilat mbështetet apelimi;
- 3.4 pagesën e tarifës përkatëse;
- 3.5 autorizimin e përfaqësimit, nëse apelimi është depozituar nga një përfaqësues.
4. Kërkesa për apelim depozitohet si kërkesë më vete, në dy kopje të njëjta.
5. Çdo strukturë përkatëse, si Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, Dhoma për Shfuqizim/Zhvlerësim dhe bordi i apelit, kur shqyrton një kërkesë, në përputhje me kompetencat respektive të parashikuara në ligj dhe në këtë rregullore, duhet të shprehet për gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.
6. Pretendimi i një pale kundërshtare, që nuk lidhet me objektin e kërkesës, nuk merret në shqyrtim nga bordi i apelimit.

Neni 29

Shqyrtimi i kërkesave nga bordi i apelimit

3. Sekretari i bordit të apelimit, brenda një muaji, nga data e paraqitjes së kërkesës për apelim, kontrollon nëse kërkesa është paraqitur në përputhje me pikën 3, të nenit 27, të kësaj rregulloreje.
4. Kur një kërkesë për apelim është paraqitur në përputhje me pikën 3, të nenit 27, të kësaj rregulloreje, sekretari i bordit të apelimit i dërgon palës, kundër së cilës është paraqitur apelimi, një kopje të kërkesës për apelim dhe e njofton atë të paraqesë brenda dy muajve, nga data e marrjes së njoftimit, argumentet dhe çdo dokument tjetër në lidhje me apelimin.
5. Në rast se një kërkesë për apelim nuk është paraqitur në përputhje me kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit 27, të kësaj rregulloreje, sekretari i bordit të apelimit e njofton me relacion me shkrim bordin e apelit, i cili e refuzon kërkesën për apelim dhe njofton apeluesin për vendimin e marrë.
6. Sekretari i bordit të apelimit, brenda 1 (një) muaji, nga mbarimi i afatit të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, i paraqet për shqyrtim bordit kërkesën për apelim.
7. Bordi i apelimit e shqyrton një kërkesë brenda 3 (tre) muajve, nga data e paraqitjes së saj në bord.
8. Gjatë shqyrtimit të një kërkesë apelimi, bordi i apelit, kur e konsideron të arsyeshme, ka të drejtë t'u kërkojë palëve, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të paraqesin prova dhe dokumente të tjera shtesë brenda, një periudhe të arsyeshme nga data e njoftimit, por, në çdo rast, jo më vonë se një muaj nga data e marrjes së njoftimit nga pala.
9. Nëse bordi i apelimit e konsideron të arsyeshme, i fton palët në seanca dëgjimore dhe u kërkon atyre të gjejnë një zgjidhje me mirëkuptim, e cila, nëse arrihet, duhet të materializohet në një marrëveshje me shkrim, të nënshkruar nga të dyja palët para noterit ose para bordit të apelit.
10. Sekretari i bordit i njofton palët e interesuara menjëherë pas marrjes së vendimit të bordit të apelimit, por në çdo rast, jo më vonë se 1 (një) muaj nga marrja e vendimit.

Neni 30

Efekti i vendimeve

5. Vendimi i bordit të apelit merr formë të prerë nga e nesërmja e datës së mbarimit të afatit për ankim në gjykatë, kur asnjë nga palët nuk ka bërë ankim kundër vendimit të bordit.
6. Kur vendimi i bordit të apelit ose vendimi i gjykatës merr formë të prerë, Zyra ekzekuton drejtpërdrejt vendimin menjëherë, sapo ai të depozitohet në zyrë nga vetë Zyra, gjykata ose nga pala e interesuar, pa qenë nevoja për ndjekjen e procedurave të tjera.
7. Në rast ankimi të vendimit të bordit të apelit në gjykatë, ankimesi ka detyrimin të njoftojë DPPI-në brenda 1 (një) muaji, nga data e depozitimit të ankimit në gjykatë, me qëllim që të evitohet ekzekutimi i vendimit të bordit të apelit.

KREU VI

LOGOT PËR TGJM DHE EOM

Neni 31

Logot dhe përdorimi i tyre

1. Logot e një treguesi gjeografik të mbrojtur dhe një emërtimi origjine të mbrojtur paraqiten në aneksin 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

2. Logot duhet të jenë në etiketën e produkteve bujqësore apo ushqimore të mbrojtura si TGJM apo EOM, shoqëruar me emrin e regjistruar, ndërsa vetë prodhuesit mund të bien dakord për pozicionin e vendosjes së logos në paketimin e tyre.
3. Logot mund të përdoren në Shqipëri si edhe në tregjet e vendeve të tjera.
4. Përdorimi i tyre është opsional për verërat apo pijet alkoolike apo TGJM/EOM-të që vijnë nga vendet e tjera.
5. Logot mund të përdoren vetëm mbi produktin për të cilin është regjistruar TGJM-ja ose EOM-ja. Logot nuk mund të përdoren në një produkt që e ka si përbërës një TGJM apo EOM apo është një përzierje e TGJM/ EOM-ve të ndryshëm.
6. Logot duhet të përdoren me ngjyra. Përdorimi i tyre bardhë e zi lejohet vetëm kur ato janë të vetmet ngjyra të përdorura në paketim.
7. Shkrimi i përdorur në logo do të jetë *Times New Roman*, me shkronja kapitale.
8. DPPI-ja do të mundësojë për prodhuesit e TGJM-ve apo EOM-ve versionin digjital të logos për printim.

KREU VII

INFORMACIONI I DISPONUESHËM PËR PUBLIKUN DHE AUTORITETET E TJERA

Neni 32

Ekstrakti i regjistrit dhe hetimi

1. Në zbatim të nenit 194, të ligjit, DPPI-ja u lëshon personave të interesuar ekstrakte nga regjistri i TGJ/EO-së, si edhe përgjigje të kërkesave për hetim.
2. Kërkesa për ekstrakt regjistri për një TGJ/EO të regjistruar paraqitet pranë DPPI-së me shkrim, shoqëruar me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, në të kundërt kërkesa quhet e paparaqitur. Ekstrakti i regjistrit, lëshuar nga DPPI-ja, përmban të gjitha të dhënat mbi TGJ/EO-në.
3. Kërkesa për hetim në lidhje me një TGJ/EO paraqitet pranë DPPI-ja me shkrim, shoqëruar me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse, në të kundërt kërkesa quhet e paparaqitur. DPPI-ja njofton me shkrim paraqitësin e kërkesës lidhur me rezultatin e hetimit.

Neni 33

Dublikatat

1. Pronari i një TGJ/EO-je të regjistruar ka të drejtë të kërkojë dublikatë të certifikatës së regjistrimit ose të njoftimeve të tjera të lëshuara nga DPPI-ja për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e TGJ/EO-së.
2. Kërkesa depozitohet me shkrim dhe duhet të shoqërohet me dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse dhe me autorizimin e përfaqësimit, kur kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pronarit të TGJ/EO-së, në të kundërt ajo konsiderohet e paparaqitur.

Neni 34

Inspektimi i dosjes

1. Dosja, që i përket një aplikimi për regjistrim treguesi apo emërtimi ende të pa publikuar, nuk mund të inspektohet pa pëlqimin e grupit të aplikantëve.
2. Pas publikimit të TGJ/EO-së, dokumentet që lidhen me këtë aplikim mund të inspektohen mbi bazë të një kërke.
- 3.
4. Kur dosjet inspektohen sipas pikës 2, të këtij neni, dokumentet në lidhje me përjashtimin/kërkesën për përjashtim të një anëtar të Dhomës së Kundërshtimeve ose Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim apo të Bordit të Apelit për shkak të konfliktit të interesit, draftet e vendimeve e të opinioneve, të gjitha dokumentet e brendshme të përdorura për përgatitjen e tyre dhe pjesët e dosjes, për të cilat pala e interesuar tregon një interes të veçantë për ruajtjen e konfidencialitetit, përpara se të jetë depozituar kërkesa për inspektim e dosjes, ndalohen për inspektim, përveçse kur inspektimi i këtyre dokumenteve të dosjes justifikohet nga interesi legjitim, thelbësor i palës që kërkon inspektim.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

5. Inspektimi i dosjes së një aplikimi për regjistrim ose regjistrimi i një TGJ/EO-je do të bëhet me dokumente origjinale, kopje të tyre ose me mjete apo pajisje të tjera teknike të ruajtjes.

6. Inspektimi i dosjeve bëhet brenda mjediseve të zyrës. Bazuar në një kërkesë me shkrim, inspektimi i dosjeve shoqërohet me lëshimin e kopjeve të dokumenteve të dosjes. Lëshimi i këtyre kopjeve kushtëzohet me kryerjen e pagesës së tarifës për dublikatë. Bazuar në kërkesën me shkrim dhe përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, Zyra lëshon edhe kopje të vërtetuara ose të pavërtetuara të një aplikimi për regjistrim TGJ/EO-je.

7. Kur dosjet inspektohen sipas pikës 5, të këtij neni, kërkesa për inspektim të dosjes do të konsiderohet si e pa depozituar deri në momentin që do të kryhet pagesa e tarifës përkatëse.

8. Dosjet që mbahen nga Zyra për regjistrimet ndërkombëtare mund të inspektohen mbi bazën e një kërkesë me shkrim, duke filluar nga data e publikimit të aplikimit ndërkombëtar, në përputhje me pikat 1, 2 e 3, të këtij neni.

9. Në përputhje me kufizimet e vendosura në pikën 3, të këtij neni, si dhe bazuar në një kërkesë me shkrim, Zyra mund të japë informacion nga çdo dosje që i përket një aplikimi për regjistrim TGJ/EO-je ose një TGJ/EO-je të regjistruar, pas kryerjes së pagesës së tarifës për hetim.

KREU VIII KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 35 Emri dhe adresa

1. Në komunikimet që depozitohen në zyrë, emri dhe adresa e aplikantit duhet të paraqiten, si më poshtë:

1.1 Nëse aplikanti është grup, në kuptim të pikës 1, të nenit 177, të ligjit: emri i shoqatës, adresa, qyteti, shteti;

1.2. Nëse aplikanti është person fizik ose juridik: emri, mbiemri, emri i shoqërisë, në rastin e një personi juridik, adresa, qyteti, shteti.

2. Në komunikimet që depozitohen në zyrë, emri dhe adresa e përfaqësuesit të autorizuar paraqiten, si vijon: emri, mbiemri, adresa, qyteti, shteti dhe/ose kodi i përfaqësuesit.

3. Aplikanti mund të deklarojë mënyra të tjera kontakti, si numër telefoni, adresë *e-mail*-i, *fax* etj.

4. Parashikimet e këtij neni si dhe të neneve 36 e 37, të kësaj rregulloreje, do të aplikohen, gjithashtu, për korrespondencat që i komunikohen Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim si dhe bordit të apelit.

5. Në të gjithë formularët e TGJ/EO-së do të parashikohet rubrika me tekstin e mëposhtëm:

“Unë, i/e nënshkruari(a) pranoj që DPPI-ja mund të më kontaktojë nëpërmjet mjeteve vijuese të komunikimit, për çështje të lidhura me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij nëpërmjet:

- postës elektronike (*e-mail*), në adresën vijuese: _____;
- komunikimit (SMS, telefonatë) në numrin vijues: _____;
- *fax*-it, në numrin vijues: _____;

DPPI-ja njofton se shënimi i të dhënave të mësipërme të kontaktit është vullnetar.

DPPI-ja do të ruajë këto të dhëna (në vijim të “Dhënat personale”), që aplikanti dhe/ose personi i autorizuar (në vijim “Subjekti”) kanë shënuar në këtë formular aplikimi.

Të dhënat personale do të përpunohen e përdoren nga DPPI-ja në cilësinë e kontrolluesit apo nga persona të tretë, të caktuar nga DPPI-ja, në cilësinë e përpunuesit, ekskluzivisht për të komunikuar me subjektin, për sa i përket procedurave të lidhura me këtë aplikim.

Të dhënat personale nuk do t'i kalohen një marrësi të tretë pa pëlqimin paraprak të subjektit dhe nuk do t'i nënshtrohen transferimit ndërkombëtar. Gjithashtu, DPPI-ja mund të përdorë, herë pas here, të dhënat personale për të kontaktuar subjektin dhe për t'i dërguar informacione, që mund të jenë në interes të tij/saj, të tilla si njoftime, ngjarje dhe/ose zhvillime ligjore në fushën e veprimtarisë së DPPI-së.

DPPI-ja do të ndalojë dërgimin e këtij informacioni nëse subjekti njofton shprehimisht me shkrim DPPI-në se ai/ajo nuk dëshiron të kontaktohet më tej për të marrë informacione të tilla.

Subjekti ka të drejtë të kërkojë informacion, korrigjim apo përditësim/anulimin e të dhënave personale që DPPI-ja ka ruajtur në bazën e të dhënave, si dhe të kërkojë të ushtrojë çdo të drejtë tjetër, që i njihet nga ligji nr.9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Data : ____/____/____

____ (emri, mbiemri, firma)

Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi jep pëlqimin që DPPI-ja të ruajë, të përpunojë e të përdorë të dhënat personale të subjektit, në pajtim me kushtet e mësipërme. Nëpërmjet këtij nënshkrimi të posaçëm, nënshkruesi, gjithashtu, deklaron nën përgjegjësinë e tij/saj se të dhënat e kontaktit si më sipër janë të dhënat e tij/saj, ose të një personi të tretë, që ka autorizuar nënshkruesin të kryejë këto veprime”.

6. Në të gjithë formularët e TGJ/EO-së, që do të depozitohen në zyrë, do të vendoset adresa e zyrës dhe logoja e saj.

Neni 36

Kërkesa të tjera për korrespondencën

1. Zyra do të pranojë vetëm nënshkrimet me dorë në dokumentet e depozituara në zyrë.
2. Nëse një komunikim me Zyrën përmban disa dokumente, të cilat kanë të bëjnë me disa aplikime, atëherë në çdo dokument duhet të shënohet numri i aplikimit me të cilin lidhet dokumenti.

Neni 37

Autorizimi i përfaqësimit

2. Autorizimi i përfaqësimit duhet të përmbajë:
 - 1.1 nënshkrimin e përfaqësuesit të grupit të aplikantëve/aplikantit, të vërtetuar nga noteri, kur grupi i aplikantëve/aplikanti është person fizik shqiptar ose i huaj;
 - 1.2 nënshkrimin dhe vulën ose nënshkrimin e vërtetuar nga noteri, kur grupi i aplikantëve/aplikanti është person juridik shqiptar ose i huaj.
2. Nëse autorizimi i përfaqësimit nuk është në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë rregullore, Zyra njofton përfaqësuesin që e ka depozituar aplikimin për të plotësuar parregullsitë brenda 3 (tre) muajve, nga dita e marrjes së njoftimit.
3. Nëse personi, i cili ka depozituar autorizimin e përfaqësimit nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar në njoftimin e zyrës, sipas pikës 2, të këtij neni, Zyra refuzon aplikimin.
4. DPPI-ja regjistron në regjistrin e TGJ/EO-së një përfaqësues të autorizuar, i cili është caktuar si përfaqësues nga grupi i aplikantëve ose pronarëve, me anë të një autorizimi të përgjithshëm, që i jep përfaqësuesit të drejtën t'i përfaqësojë ata në ndjekjen e procedurave dhe kryerjen e veprimeve që parashikohen në ligj dhe rregullore, në lidhje me regjistrimin e treguesit/emërtimit.
5. Kur grupi i aplikantëve ose pronarëve të një TGJ/EO-së revokon autorizimin e përfaqësimit, ata duhet të depozitojnë në DPPI kërkesën për revokimin ose ndryshimin e autorizimit si dhe për caktimin e përfaqësuesit të ri. Kërkesa regjistrohet në regjistrin e TGJ/EO-së, sipas parashikimeve të pikës 4, të këtij neni.

Neni 38

Seancat dëgjimore

Kur konsiderohet e nevojshme, Zyra ose bordi i apelit zhvillon seanca dëgjimore si dhe thërret palët të marrin pjesë në seanca.

Neni 39

Marrja e provave

1. Marrja dhe sigurimi i provave nga Zyra dhe bordi i apelimit parashikon:
 5. dëgjimin e palëve;
 6. kërkimin e informacionit;
 7. depozitimin e dokumenteve dhe të provave;
 8. dëgjimin e personave të tjerë, kur çmohet i nevojshëm nga zyra, bordi i apelit ose me kërkesë të palëve.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

Neni 40

Njoftimi dhe dërgimi i dokumenteve

1. Data e njoftimit të një dokumenti do të konsiderohet data e marrjes në dorëzim të njoftimit nga grupi i aplikantëve ose përfaqësuesi i tyre. Afatet e njoftimit do të llogariten duke filluar nga e nesërmeja e marrjes në dorëzim të njoftimit.
2. Çdo njoftim i dërguar përfaqësuesit do të ketë të njëjtin efekt si t'i jetë dërguar personit të përfaqësuar.
3. Çdo komunikim i adresuar Zyrës nga një përfaqësues do të konsiderohet si të jetë dërguar nga personi i përfaqësuar.
4. Nëse është caktuar një përfaqësues i autorizuar, Zyra do t'i dërgojë të gjitha njoftimet e këtij të fundit.

ANEKSI 2 LOGOT



VENDIM Nr. 457, datë 3.7.2019

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR PJESËMARRJE NË QENDRËN E TRAJNIMEVE NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE, SI DHE PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËRKATËSE DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË LEKTORËVE¹

(ndryshuar me vendimin nr. 327, datë 18.5.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 193/d, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e procedurave për pjesëmarrje në Qendrën e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale, si dhe përcaktimin e tarifave përkatëse dhe masën e shpërblimit të lektorëve.
2. Ky vendim zbatohet për:
 - a) personat fizikë dhe juridikë, të cilët aplikojnë për t'u pajisur me certifikatë të kualifikimit profesional në fushën e pronësisë industriale;
 - b) përfaqësuesit e autorizuar të objekteve të pronësisë industriale, të cilët regjistrohen në modulet e trajnimit të organizuar nga kjo qendër;
 - c) ekspertët në fushën e pronësisë industriale, të cilët regjistrohen në modulet e trajnimit të organizuar nga kjo qendër;
 - ç) punonjës të institucioneve të përfshira në sistemin e pronësisë industriale;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare* nr. 97. Tiranë, 2019. f. 7071

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

d) stafi akademik i universiteteve të ndryshme, të cilët regjistrohen në modulet e trajnimit të organizuar nga kjo qendër;

dh) punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

3. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) “Qendra e Trajnimeve në Fushën e Pronësisë Industriale”, në vijim “Qendra”, është pjesë e strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe zhvillon aktivitete trajnuese në fushën e pronësisë industriale;

b) “Trajner”, individ i zgjedhur nga DPPI-ja për të shërbyer si lektor në aktivitetet e Qendrës.

4. Kandidatët, të cilët kërkojnë të marrin pjesë në trajnimet që organizon Qendra, duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme pranë Qendrës, si më poshtë vijon:

a) Kërkesë me shkrim për pjesëmarrje në trajnim;

b) Mandatpagesën sipas tarifës së parashikuar në vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, të ndryshuar.

5. Me dorëzimin e dokumentacionit për pjesëmarrje në trajnim, Qendra njofton kandidatët për kohën në të cilën do të organizohet trajnimi.

6. Në përfundim të trajnimit, Qendra lëshon certifikatë kualifikimi për pjesëmarrësit në trajnim.

7. Qendra, në bashkëpunim me strukturat e tjera të brendshme të DPPI-së, harton programin e formimit të vazhdueshëm të punonjësve të DPPI-së, sipas kërkesave.

8. Në programin e formimit të vazhdueshëm të stafit të DPPI-së përfshihen:

a) trajnimi i detyrueshëm në lidhje me pronësinë industriale gjatë periudhës së provës;

b) trajnimi vullnetar i nëpunësve për përparimin e njohurive të tyre.

9. Numri i pjesëmarrësve, për çdo trajnim të organizuar nga Qendra, duhet të jetë jo më i vogël se 10.

10. Programet e formimit të vazhdueshëm të stafit të DPPI-së miratohen nga drejtori i Përgjithshëm i DPPI-së.

11. Qendra informon punonjësit e DPPI-së 30 (tridhjetë) ditë para, pas miratimit nga eprori direkt i tyre për planin dhe kohëzgjatjen e trajnimit.

12. Njohuritë e marra nga trajnimet e zhvilluara për punonjësit e DPPI-së, shpenzimet, të cilat janë siguruar nga fondet të DPPI-së dhe/ose donatorët, konsiderohen si shpenzime kapitale për rritjen e cilësisë dhe nivelit të kapacitetit profesional të institucionit.

13. Qendra mund të aplikojë dy lloje trajnimesh, si më poshtë vijon:

a) Trajnime direkte, me lektorë të pranishëm në qendër;

b) Trajnime *on-line*, në rastet kur mundësohet nga organizatat e huaja.

14. Pjesa e pjesëmarrjes në trajnim duhet të kryhet në llogarinë e DPPI-së, në momentin e regjistrimit.

15. Për trajnimet e parashikuara në këtë vendim, pjesëmarrësi i nënshtrohet testimit në fund të trajnimit. Trajnimi konsiderohet i ndjekur me sukses nëse merr, të paktën, 50% të pikëve në testim.

16. Ambienti dhe logjistika për të dyja këto lloje trajnimesh do të sigurohen nga DPPI-ja.

17. Çdo trajnim zgjat deri në përfundimin e programit, sipas modulit të trajnimit. Një ditë trajnimi është jo më shumë se 6 (gjashtë) orë.

18. Punonjësit e DPPI-së i kryejnë pa pagesë trajnimet pranë Qendrës.

18/1. Masa e shpërblimit të lektorëve, për të cilët lidhet kontratë ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe lektorëve, të jetë, si më poshtë vijon:

a) 500 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi, për kontratat me lektorët, të cilët do të përmbushin kriteret e mëposhtme:

i. të zotërojnë një diplomë “Master i shkencave” apo të barasvlershme me të, sipas legjislacioni të arsimit të lartë;

ii. të zotërojnë kualifikimin e nevojshëm në përputhje me modulën apo kurrikulën për të cilën do të angazhohen si trajner, të vërtetuar me dëshmi, diploma, për eksperiencën profesionale;

iii. të kenë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune në fushën e pronësisë industriale;

iv. të kenë afësi të prezantimit dhe të transmetimit të saktë e të qartë të informacionit të pjesëmarrësit;

v. të mos kenë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë;

vi. zotërimi i gjuhës angleze përbën përparësi.

b) 1000 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi për kontratat me lektorët të cilët do të përmbushin këto kritere:

i. të zotërojnë një diplomë universitare;

ii. të zotërojnë kualifikimin e nevojshëm profesional në përputhje me modulën apo kurrikulën për të cilën do të jenë angazhuar si trajner, të vërtetuar me dëshmi, diploma, rekomandime apo vërtetime për eksperiencën profesionale;

iii. të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën përkatëse;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

- iv. të kenë aftësi të prezantimit dhe të transmetimit të saktë e të qartë të informacionit të pjesëmarrësit;
- v. të mos kenë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë;
- vi. zotërimi i gjubës angleze përbën përparësi.
- c) 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë, në rastet e hartimit të kurrikulave apo të materialeve të trajnimit për më pak se 6 orë trajnimi 60-minutësh;
- ç) Në rastet e rishikimit të kurrikulave, pagesa të jetë deri në 50% të pagesës së përvaktuar sipas shkronjës “c”.
- d) Për trajnerët e dërguar në kuadër të një projekti apo marrëveshjeje teknike të lidhur nga DPPI-ja me organizata të huaja në fushën e PI apo zyra homologe, kushtet për pagesat e trajnerëve sipas kësaj pike përvaktoben në marrëveshjen dypalëshe me atë organizatë apo në kontratën e projektit.
19. Punonjësit e institucioneve të përfshira në sistemin e mbrojtjes së pronësisë industriale dhe që i kanë të detyrueshme për procesin kryesor të punës së tyre njohuritë dhe kualifikimet në fushën e pronësisë industriale i kryejnë trajnimet pranë Qendrës, pa pagesë.
20. Tarifat e pjesëmarrjes në trajnimet e organizuara nga Qendra, nga persona të tjerë që nuk bëjnë pjesë në grupin e parashikuar në pikat 18 dhe 19, të këtij vendimi, janë ato të miratuara me vendimin nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, të ndryshuar.
21. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIGJ
Nr.8488, datë 13.5.1999

PËR MBROJTJEN E TOPOGRAFISË SË PRODUKTEVE GJYSMËPËRÇUESE¹ (ndryshuar me ligjin nr. 9957, datë 17.7.2008; nr. 66/2014, datë 26.6.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
I. DISPOZITA KRYESORE

Neni 1

Ky ligj rregullon mbrojtjen e topografisë së produkteve gjysmëpërçuese.

Neni 2
(ndryshuar shkronjat “a” dhe “b”, shtuar fjalë në shkronjën “c” me ligjin nr. 66/2014, datë 26.4.2014)

Në këtë ligj, përsa nuk thuhet ndryshe në përmbajtje:

- a) “një produkt gjysmëpërçues” është forma përfundimtare ose e ndërmjetme e një produkti, i cili plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:
- i) përbëhet nga një masë materiali, e cila përfshin një shtresë materiali gjysmëpërçues;
- ii) ka një ose më shumë shtresa të tjera që përbëhen nga material përcjellës, izolues apo gjysmëpërçues, të cilat vendosen sipas një modeli të paracaktuar tredimensional;
- iii) ka për qëllim të kryejë, vetëm ose së bashku me funksionet e tjera, një funksion elektronik;

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. Fletore Zyrtare nr. 18. Tiranë, 1999. f. 562

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

b) “topografia e një produkti gjysmëpërçues” është një seri imazhesh të lidhura, pavarësisht nga mënyra e fiksimit apo kodimit të tyre:

i) të cilat përfaqësojnë modelin tredimensional të shtresave, nga të cilat përbëhet një produkt gjysmëpërçues;

ii) ku në secilën seri, çdo imazh ka modelin ose një pjesë të modelit të sipërfaqes së produktit gjysmëpërçues në çdo fazë të prodhimit të tij.

c) “shfrytëzimi tregtar” i topografive nënkupton prodhim, shitje, qiradhënie ose ndonjë metodë tjetër të përhapjes tregtare, e lidhur drejtpërdrejt me një topografi apo produkt gjysmëpërçues, prodhuar në bazë të topografisë respective ose çdo ofertë për këtë qëllim.

II. SUBJEKTET E MBROJTJES

Neni 3

(shtuar paragraf me ligjin nr. 66/2014, datë 26.4.2014)

E drejta e mbrojtjes së një topografie garantohej për të gjithë krijuesit.

Kur topografia është krijuar si rrjedhojë e punës së krijuesit apo në bazë të porosisë, e drejta e mbrojtjes garantohej në favor të punëdhënësit të krijuesit apo të personit që ka dhënë porosinë, me përjashtim të rasteve kur në kontratë parashikohet ndryshe.

Të drejtën e mbrojtjes e gëzojnë, gjithashtu, edhe trashëgimtarët e personave të përmendur në paragrafët e parë dhe të dytë të këtij neni.

Neni 4

Personat e huaj, që kërkojnë të mbrojnë një topografi, gëzojnë të njëjtat të drejta si personat vendas, në përputhje me traktatet dhe konventat ndërkombëtare ose në bazë të parimit të reciprocitetit.

Personi, që i referohet parimit të reciprocitetit, duhet të provojë ekzistencën e tij.

III. RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR PROCEDURËN E MBROJTJES

Neni 5

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM) jep të drejtën dhe mbrojtjen e topografisë.

Neni 6

(zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 9957, datë 17.7.2008)

DPPM-ja merr vendime sipas procedurës administrative për dhënien e së drejtës dhe mbrojtjen e topografisë në nivelin e parë.

Kundër vendimit të marrë nga DPPM -ja mund të bëhet ankim pranë bordit të apelit.

Neni 7

DPPM -ja ruan regjistrin e topografive të aplikuara dhe regjistrin e topografive të mbrojtura.

Regjistrat e referuar në paragrafin e parë të këtij neni janë të hapur për publikun.

Neni 8

Një topografi mbrohet nëse ajo është origjinale.

Një topografi konsiderohet origjinale nëse është rezultat i përpjekjeve intelektuale të vetë krijuesit dhe në momentin e krijimit nuk përbën rast të zakonshëm në industrinë e gjysmëpërcjellësve, kur ajo u krijua.

Kur një topografi përbëhet nga elementë të zakonshëm në industrinë respektive, atëherë mbrohet vetëm kombinimi i këtyre elementeve, duke provuar se ai i plotëson kushtet, lidhur me origjinalitetin, në përputhje me paragrafin e dytë të këtij neni.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

IV. PËRMBAJTJA, TË DREJTAT DHE KUFIZIMI I TYRE

Neni 9

(shtuar paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr. 66/2014, datë 26.4.2014)

Pronari i topografisë së mbrojtur lejon të drejtat ekskluzive të shfrytëzimit tregtar, duke përfshirë të drejtën e autorizimit apo të ndalimit të ndonjërës prej akteve të mëposhtme:

- a) Riprodhimi i topografisë, në kuptim apo formë;
- b) importimi, shitja apo ndonjë formë tjetër e përhapjes e topografisë ose e produkteve që përfshijnë produktin gjysmëpërçues, i cili ka lidhje me topografinë respektive.

E drejta ekskluzive për të autorizuar apo ndaluar ndonjë prej veprimeve të parashikuara në shkronjën “b”, të paragrafit të parë, të këtij neni, nuk zbatohet për veprimet e kryera, pasi topografia ose produkti gjysmëpërçues është hedhur në treg në Republikën e Shqipërisë nga personi që ka të drejtën të autorizojë tregtimin e saj ose me pëlqimin e tij.

Të drejtat ekskluzive, të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni nuk shtrihen në ndonjë koncept, proces, sistem apo mishërim teknik në topografi, me përjashtim të vetë topografisë.

Neni 10

(ndryshuar me ligjin nr. 66/2014, datë 26.4.2014)

Një topografi konsiderohet e mbrojtur kur ajo regjistrohet në regjistrin e topografisë.

Të drejtat ekskluzive për pronarin e topografisë së mbrojtur lindin në njërin prej datave të mëposhtme, cilado është më e hershmja.

- a) Data e depozitimit e kërkesës për mbrojtje, në bazë të nenit 12 të këtij ligji;
- b) data kur topografia respektive është tregtuar për herë të parë kudo në botë.

Të drejtat ekskluzive mbarojnë me kalimin e 10 vjetëve nga njëra prej datave të mëposhtme, cilado është më e hershmja.

- a) Fundi i vitit kalendarik, në të cilin topografia është tregtuar për herë të parë kudo në botë;
- b) fundi i vitit kalendarik në të cilin kërkesa për mbrojtje është depozituar në formën e kërkuar nga ligji.

Të drejtat ekskluzive mund të humbasin edhe para periudhës së përcaktuar në paragrafin e tretë të këtij vendimi, nëse nuk janë shlyer, në përputhje me ligjin, tarifat respektive ose pronari i së drejtës të topografisë së mbrojtur heq dorë me shkrim nga mbrojtja.

Pa cenuar mjetet juridike në dispozicion për të zbatuar të drejtat ekskluzive që burojnë nga neni 9, personi që gëzon të drejtën e mbrojtjes dhe që provon se një person tjetër me mashtrim ka riprodhuar, shfrytëzuar në treg ose importuar për këtë qëllim një topografi, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të parandalojë shkeljen, si dhe shpërblimin e dëmit për periudhën para se ato të drejta të lindin.

Në qoftë se një topografi nuk është shfrytëzuar për qëllime tregtare askund në botë, të drejtat ekskluzive shfuqizohen 15 vjet pas datës së fiksimit apo kodimit. Një e drejtë e re ekskluzive mund të lindë vetëm pas depozitimit, brenda kësaj periudhe, të një kërkesë për regjistrim në formën e kërkuar nga ky ligj.

Sipas termit të mbrojtur, mbajtësi i së drejtës është i autorizuar të shënojë produktin respektiv gjysmëpërçues me shkronjën “T”.

Neni 11

Nuk mund të depozitohet një aplikim pas një periudhe 2-vjeçare nga data kur një topografi është shfrytëzuar për herë të parë komercialisht.

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

V.PROCEDURA PËR MBROJTJEN DHE REGJISTRIMIN

Neni 12

Aplikimi

(shtuar paragraf me me ligjin nr. 66/2014, datë 26.4.2014)

Procedura për regjistrimin e së drejtës së mbrojtjes fillon me një kërkesë për hyrjen në regjistër, i cili shoqërohet nga të gjithë termat përshkruar (më poshtë: aplikimi).

Aplikimi përmban emrin e aplikantit dhe të krijuesit, imazhet për topografinë respektive të shoqëruara me përmendjen e sekuencave të tyre, një ekstrakt që përmban funksionet elektronike ose funksionet e një produkti gjysmëpërçues, prodhimin në bazë të topografisë së mbrojtur, një dokument të shkruar që vërteton datën kur topografia respektive është shfrytëzuar për herë të parë komercialisht.

Për çdo topografi depozitohet një kërkesë e veçantë.

Materiali i depozituar në përputhje me kërkesat e këtij ligji nuk vihet në dispozicion për publikun, kur ai është sekret tregtar. Kjo dispozitë nuk cenon zbulimin e këtij materiali, në zbatim të një urdhri nga një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent, ndaj personave të përfshirë në çështje gjyqësore, lidhur me vlefshmërinë ose shkeljen e të drejtave ekskluzive të përmendura në nenin 9.

Neni 13

Shqyrtimi i aplikimit

DPPM -ja shqyrton nëse aplikimi i plotëson kriteret e regjistrimit në regjistrin e topografive, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji.

Kërkesa nuk pranohet nëse aplikimi nuk i plotëson kriteret e vendosura në nenin 12 të këtij ligji.

Nëse aplikimi i plotëson pjesërisht kushtet, sipas nenit 12 të këtij ligji, DPPM -ja i kërkon aplikuesit të bëjë përmirësimet e duhura në aplikim, brenda 2 muajve nga data e njoftimit. Nëse aplikuesi nuk i bën përmirësimet në kohën e duhur, aplikimi vlerësohet i pavlefshëm.

Nëse aplikimi i plotëson të gjitha kushtet e nenit 12 të këtij ligji, regjistrohet në regjistrin e topografisë dhe aplikuesit i jepet një certifikatë për hyrjen në regjistër.

Hyrja në regjistrin respektiv botohet në Buletinin Zyrtar të DPPM -së.

VI. PAVLEFSHMËRIA E REGJISTRIMIT

Neni 14

Regjistrimi është i pavlefshëm nëse vendoset që:

- a) Topografia respektive nuk është origjinale;
- b) aplikimi nuk është depozituar nga një person fizik apo juridik, i cili është i autorizuar për të drejtën e mbrojtjes;
- c) aplikimi është i depozituar pas datës së vendosur në nenin 10 paragrafi i tretë apo në nenin 11 të këtij ligji;
- ç) imazhet lidhur me topografinë nuk japin mundësi për identifikimin e tij.

VII. SHKELJA E TË DREJTAVE DHE SHPËRBLIMI I DËMIT

Neni 15

Shkelja e së drejtës

(shtuar fjalë në shkronjën "a" me me ligjin nr. 66/2014, datë 26.4.2014)

Një person, të drejtat e të cilit janë shkelur, mundet që në bazë të dëmit, të kërkojë që personi i cili e ka shkaktuar atë, të ndalohet nga vazhdimi i akteve të dhunimit.

Nëse personi që shkel të drejtat të mbrojtjes së një topografie të mbrojtur mashtron për dëmin e shkaktuar, sipas parimeve të përgjithshme, ai përgjigjet me shpërblimin e dëmit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Nuk konsiderohen shkelje të të drejtave për mbrojtje rastet kur:

- a) riprodhohet një topografi e mbrojtur për qëllime private joftimprurëse;

Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale

b) riprodhohet një topografi e mbrojtur për qëllim të analizës apo të vlerësimit të konceptit të saj, të proceseve, sistemeve dhe të teknikave të mishëruara në topografi apo për qëllime kërkimi ose arsimimi;

c) shfrytëzimi tregtar i një topografie të re, e cila është krijuar në bazë të analizave dhe të vlerësimit të topografisë së mbrojtur, por ajo vlerësohet origjinale dhe rezultat i përpjekjeve intelektuale të vetë krijuesit, nuk është rast i zakonshëm në industrinë e gjysmëpërcjellësve.

Përmbajtja e paragrafit të parë të këtij neni zbatohet edhe ndaj trashëgimtarit të personit të referuar në paragrafin e parë.

Neni 16

Shpërblimi i dëmit

Një person, i cili shfrytëzon komercialisht një produkt gjysmëpërçues, që ka të inkorporuar topografinë e mbrojtur dhe nuk di apo nuk ka baza të arsyeshme të besojë se topografia e produktit është e mbrojtur, nuk privohet nga e drejta e shfrytëzimit tregtar të qarkut të integruar.

Dëmshpërblimi, shuma e të cilit varet nga qëllimi i shfrytëzimit komercial të topografisë së mbrojtur, pretendohet ndaj personit të referuar në paragrafin e parë nga pronari i topografisë së mbrojtur, që nga data kur personi i referuar në paragrafin e parë nuk e ka ditur apo nuk ka pasur baza të arsyeshme të besojë se topografia është e mbrojtur.

Shuma e dëmshpërblimit sipas paragrafit të dytë përcaktohet në marrëveshje ndërmjet pronarit të së drejtës së topografisë të mbrojtur dhe personit të referuar në paragrafin e dytë. Nëse nuk arrihet marrëveshja, shuma e dëmshpërblimit përcaktohet nga gjykata.

E drejta e shfrytëzimit komercial kufizohet për importim, shitje ose shpërndarje të produkteve të produkteve gjysmëpërçuese apo të produkteve të tjera, të cilat kanë të inkorporuar topografinë respektive, që nga koha e pretendimit, sipas paragrafit të dytë.

VIII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Nga ky ligj përfitojnë vetëm topografite e krijuara pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 18

(ndryshuar me ligjin nr. 9957, datë 17.7.2008)

Dispozitat e përfaqësimit të të huajve, pavlefshmëria e aplikimeve të publikuara, pranimit i aplikimit, data e hyrjes dhe ndryshimet në regjistër, pavlefshmëria e të drejtave, afatet kohore të shkeljes së të drejtave, masat kundër shkeljeve të të drejtave, transferimi i të drejtave, licencat, si dhe çdo rregull tjetër procedural, i parashikuar në ligjin nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, rregullohen dhe janë të vlefshme edhe për këtë ligj.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2379, datë 24.5.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Qendra e Botimeve Zyrtare
Përmbledhje legjislacioni për pronësinë industriale /
Qendra e Botimeve Zyrtare. - Tiranë :
Qendra e Botimeve Zyrtare, 2023. - ... f. : cm.

ISBN: 9789928011527

1.Prona industriale

2.Legjislacioni

3.Shqipëri

347.779(496.5) (094)